MËSIMDHËNIA E HISTORISË BASHKËKOHORE E EVROPËS JUGLINDORE

LIBRA MBËSHTETËS PËR MËSUESIT E HISTORISË

VËLLIMI 2

LUFTËRAT, NDASITË DHE INTEGRIMI (1990-2008)

Botuesi: Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE)
Redaktori në anglisht: Philip Carabott
Përktheu nga anglishtja: Ergys Bezhani
Faqosja: Language Solutions
Dizajni grafik: LYNX, Karavasiloglou Ioulia, Eressou 65, 10683, Athinë, Greqi
Tirazhi: 200 kopje

"Ky botim u realizua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij botimi mbajnë përgjegjësi vetëm autorët e tij, dhe pikëpamjet e shprehura në libër nuk pasqyrojnë domosdoshmërish edhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian"

Raportuesi i CDRSEE-së në Bordin për Projektin e Përbashkët të Historisë: Costa Carras
Drejtori ekzekutiv i CDRSEE-së: Zvezdana Kovac
Ekipi i projektit të CDRSEE-së: Antonis Hadjiyannakis, Jenny Demetriou, Susan Nadeau, Ruth Sutton, Sasa Kulenovic, Michaela Zervidou dhe Elena Farini

REALIZIMI I KËTIJ LIBRI U MUNDËSUA NGA:

FONDATION PRO VICTIMIS GENÈVE

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

SOE Dialog Südosteuropa

Deklaratë: Emërtimet që përdoren në këtë libër, si edhe të gjitha materialet që do të paraqiten në vijim, nuk nënkuptojnë medoemos pikëpamjet e botuesit (Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore), apo të donatorëve të këtij të fundit (Fondacionet Shoqëria e Hapur). Ky libër pasqyron këndvështrimet e autorëve si individë, dhe ato nuk janë detyrimisht edhe pikëpamjet e Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore, apo të donatorëve të saj.

Përmbajtja e librit bazohet në kontributet e ndryshme të partnerëve tanë, që e ofrojnë përmbajtjen, e garantojnë dhe e përfaqësojnë atë, në dijeninë e tyre, nuk cenon të drejtat e ndonjë pale të tretë. Rrjedhimisht, botuesi nuk mban përgjegjësi, për ndonjë shkelje të të drejtave të asnjë pale të tretë, që mund të shkaktojë si rezultat i përmbajtjes së ofruar nga partnerët e ndryshëm.

Të drejtat e autorit: Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE):
Krispou 9, Ano Poli, 546 34 Selanik, Greqi
Tel: +30 2310 960820-1 Fax: +30 2310 960822 e-mail: info@cdrsee.org web: www.cdrsee.org

ISBN: 978-960-88963-8-3

MËSIMDHËNIA E HISTORISË BASHKËKOHORE E EVROPËS JUGLINDORE

LIBRA MBËSHTETËS PËR MËSUESIT E HISTORISË

VËLLIMI 2

LUFTËRAT, NDASITË DHE INTEGRIMI (1990-2008)

Redaktuar nga

KRISTINA KOULOURI dhe BOZHO REPE

Redaktore e serisë

KRISTINA KOULOURI

Redaktor për botimin në gjuhën shqipe:

ARTAN PUTO

CDRSEE

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe

Prishtinë 2018

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I: RËNIA DHE RINDËRTIMI 1990-1992 8
Hyrje 9
I.1. Fundi i Luftës së Ftohtë 11
I.2. Partitë politike dhe zgjedhjet 13
I.3. Shpallja e pavarësisë 21
I.4. Simbole të reja, monedha të reja, flamuj të rinj 29

KAPITULLI II: SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË
Hyrje 37
II.1. Rruga drejt shpërbërjes 41
II.2. Luftërat e periudhës 1991-1995 47
II.3 Rrethimi i Sarajevës 60
II.4. Kampet 64
II.5. Luftërat e periudhës 1998-2001 66
II.6. Barbaritë dhe spastrimi etnik 77
II.7. Emigrimet e detyruara dhe refugjatët 80
II.8. Fëmijët dhe të rinjtë gjatë luftës 85
II.9. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore 87
II.10. Kundër luftës 90
II.11. Lufta e gazetarëve 95
II.12. Reagime ndërkombëtare dhe vendeve të Ballkanit 97

KAPITULLI III; AKTORËT NDËRKOMBËTARË, ÇËSHTJET VENDORE 102
Hyrje 103
III.1. Çështja e Qipros 105
III.1.1. Gjatë viteve 1990 105
III.1.2. Nga Samiti i Helsinkit te Plani Annan 107
III.2. Çështja e Jugosllavisë 110
III.2.1. Ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare 110
III.2.2. Bisedimet dhe traktatet e paqes 115
III.2.3. Ndjekjet penale, gjykatat, tribunalet 123
III.2.4. Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Pakti i Stabilitetit 132
III.3. Vendet Ballkanike në BE dhe NATO 133
III.3.1. Aderimi në BE 134
III.3.2. Integrimi në Organizatën e Traktatit të Atlantkut Verior NATO 137
III.4. Tranzicionet dhe traditat politike 138

KAPITULLI IV: EKONOMIA DHE SHOQËRIA 150
Hyrje 151
IV.1. Privatizimi dhe çindustrializimi 153
IV.2. Shkatërrimi dhe mbrojtja e mjedisit 158
IV.3. Financat 161
IV.4. Demografia dhe emigrimi 170
IV.5. Pabarazitë sociale dhe minoritetet 175

KAPITULLI V: KULTURA 184
Hyrje 185
V.1. Teknologjitë e reja dhekomunikimi 187
V.2. Feja 190
V.3. Kinemaja, teatri dhe muzika 202
V.4. Sporti dhe Lojërat Olimpike 206

PËRMBAJTJA


KAPITULLI VI: MËNYRAT E PËRKUJTIMIT
Hyrje 211
VI.1. Fshirja dhe rishikimi i të shkuarës komuniste 213
VI.2. Rishikimi i kujtesës së Luftës së Dytë Botërore 221
VI.3. Përkujtimi i luftërave të fundit 226
VI.4. Pajtimi nëpërmjet rindërtimit ose shkatërrimit të kujtesës 229

KRONOLOGJIA (1944-2008) **235**

BIBLIOGRAFIA **293**

HARTAT
Përbërja etnike e Jugosllavisë 1987 45
Luftërat dhe shpërbërja e Jugosllavisë (1991-1995) 50
Dislokimet e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci 114
Marrëveshja e Paqes e Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën, 1995 119
Forcat paqeruajtëse të NATO-së në Kosovë, 1999 123
Anëtarët dhe vëzhguesit e SEECP-së në vitin 2006 132
Aderimi i vendeve të Evropës Juglindore në BE 134





KAPITULLI I: RËNIA DHE RINDËRTIMI 1990-1992

Hyrje	9
I.1. Fundi i Luftës së Ftohtë	11
I.2. Partitë politike dhe zgjedhjet	13
I.3. Shpallja e pavarësisë	21
I.4. Simbole të reja, monedha të reja, flamuj të rinj	29

HYRJE

Në vitet 1980, falë presionit ekonomik, politik dhe ushtarak që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ushtronin kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Traktatit të Varshavës, erdhi fundi i Luftës së Ftohtë. Barra ekonomike e garës së armatimeve po bëhej gjithnjë e më e vështirë për t'u përballuar nga vendet e Evropës Lindore. Në Bashkimin Sovjetik, kishin ndodhur ndryshime të rëndësishme nga udhëheqësi sovjetik Mikhail Gorbaçov, i cili kishte nisur reformimin politik (*glasnost*) dhe atë ekonomik (*perestroika*). Procesi i reformave në Bashkimin Sovjetik, në fund të viteve 1980, shërbeu si nxitës për një radhë revolucionesh që ndodhën në vendet e Evropës Lindore: Poloni, Hungari, Gjermani Lindore, Bullgari, Çekosllovaki dhe Rumani. Ato ishin kryesisht lëvizje sociale e civile paqësore. Vetëm në Rumani revolucioni ishte i dhunshëm. Në nëntor të vitit 1989, demonstratat masive në disa qytete të Gjermanisë, çuan në rënien e Murit të Berlinit. Kjo gjë solli nga ana tjetër bashkimin e Gjermanisë, shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe instalimin atje të një sistemi shumëpartiak, si edhe kapitalizmin e tregut të lirë në vendet ish-socialiste, të cilat kishin nisur tashmë rrugëtimin e dhimbshëm të tranzicionit. Me fundin e një bote bipolare, u riorganizuan marrëdhëniet gjeostrategjike, në një botë që po bëhej e njëanshme. Shtetet e Bashkuara po fitonin epërsi. Traktati i Varshavës u shpërbë, teksa nisën diskutimet mbi të ardhmen e NATO-s. Më vonë, në vitin 1999, NATO u forcua dhe numri i anëtarëve të saj u shtua duke përfshirë vendet ish-socialiste të Evropës Lindore. Fundi i botës bipolare ndryshoi gjithashtu rrënjësisht marrëdhëniet gjeostrategjike në Ballkan.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë (1990), vendet e Evropës Juglindore u ndodhën në situata shumë të ndryshme. Niveli i trazirave në rajon u manifestua edhe me ndryshime të tjera: kështu nga vetëm shtatë shtete që ishin deri atëherë në atë hapësirë, u krijuan trembëdhjetë. Në rrjedhën e luftërave të shumta, Jugosllavia u shpërbë në shtatë shtete të vogla. Nga ana tjetër, edhe pse Qipro ishte ndarë me anë të forcës ushtarake, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, pjesa e ishullit nën pushtimin ushtarak turk, nuk u njoh ndërkombëtarisht nga asnjë vend si shtet i pavarur, përveçse nga vetë Turqia, pavarësisht deklaratës së njëanshme të pavarësisë. Gjithashtu ndryshoi edhe pozita gjeostrategjike e vendeve. Greqia ishte i vetmi shtet në rajon që ishte anëtarësuar në Komunitetin Evropian të asaj kohe, madje edhe më herët sesa të afrohej fundi i Luftës së Ftohtë. Greqia dhe Turqia ishin edhe anëtare të NATO-s. Bullgaria dhe Rumania ishin anëtare të Traktatit të Varshavës. Gjatë Luftës së Ftohtë, Shqipëria ishte vendi më i izoluar i Evropës Juglindore. Fillimisht, pas Luftës së Dytë Botërore, ajo u lidh ngushtë me Jugosllavinë, por pas ndarjes së Jugosllavisë nga Bashkimi Sovjetik, ajo mbajti lidhje me Bashkimin Sovjetik. Pas ndarjes së Bashkimit Sovjetik me Kinën, ajo bashkëpunoi ngushtë vetëm me Kinën. Nga viti 1970 e më pas, Shqipëria u tregua shumë e kujdesshme në krijimin e marrëdhënieve me vendet e tjera. Megjithatë, kjo politikë nuk e ndryshoi gjendjen e popullsisë që mbeti tërësisht e izoluar deri në vitin 1991. Përveç Maltës, Jugosllavia dhe Qipro ishin të vetmet vende evropiane që ishin anëtare të Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara.

Gjithashtu, shtetet dallonin shumë për nga rendi i tyre i brendshëm dhe niveli i demokracisë. Shqipëria kishte sistemin më të ashpër komunist, i cili bazohej në modelin e Stalinit dhe nuk kishte ndryshuar aspak për shumë dhjetëvjeçarë pas Luftës së Dytë Botërore. Ndër vendet e bllokut sovjetik që aderuan në të ashtuquajturin sistem të socializmit real, ajo që ngjasonte më së shumti me Shqipërinë, ishte Rumania, por që gjithsesi kishte pavarësi në politikën e saj të jashtme.

Udhëheqësit rumunë dhe bullgarë ishin kundër ndryshimeve të kryera në Bashkimin Sovjetik me anë të politikave të Gorbaçovit për *glasnostin* dhe *perestrojkën*. Fillimisht, Bullgaria i kundërshtoi, por më pas, ndryshe nga Rumania, nisi të zbatojë modelin sovjetik e madje pretendonte se po zbatonte politikën e saj të reformës. Në Bullgari, ndryshimet u zbatuan në mënyrë paqësore, ndërsa në Rumani, u zbatuan vetëm pas një revolucioni të dhunshëm.

Gjatë Luftës së Ftohtë, Turqia dhe Greqia kaluan të dyja nga një periudhë diktature, ndërsa njëkohësisht mes tyre kishte një konflikt të mprehtë, gati në prag fillimi të një lufte. Megjithatë, të gjitha vendet e Evropës Juglindore, me përjashtim të Greqisë, Turqisë dhe Qipros, kishin vendosur formalisht sisteme shumëpartiake, përpara përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ndër to Greqia ishte vendi më demokratik, por demokracia e saj kishte një zë të fuqishëm konservator, në veçanti menjëherë pas Luftës Civile. Megjithatë, edhe para përfundimit të Luftës së Ftohtë, Greqia e kaloi me sukses tranzicionin e saj demokratik, pas rënies së diktaturës së kolonelëve (1974) dhe u bë vendi i parë në rajon që u anëtarësuar

281011_WARS-DIVISIONS-INTEGRATION_I.indd 9 21/10/16 10:39 π.μ.

në Bashkimin Evropian. Sistemi i Jugosllavisë ishte i ndërmjetëm. Ai quhej socializëm i vetë-administruar, bazuar në pronësinë e përbashkët (fabrikat ishin formalisht pronë e gjithë shoqërisë [pronësi shoqërore] dhe administroheshin nga punëtorët), por që synonte të vepronte në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut. Jugosllavia ishte gjithashtu i vetmi vend i hapur si ndaj Lindjes ashtu edhe ndaj Perëndimit. Shtetasit e saj lejoheshin të udhëtonin kudo, në të gjitha vendet (me përjashtim vetëm të Shqipërisë, për shkak të izolimit të saj të vetë-imponuar).

Gjithsesi, në vitet 1980, Jugosllavia ishte nën kthetrat e një krize të rëndë ekonomike; nacionalizmi ishte në rritje dhe, nga fundi i Luftës së Ftohtë, vendi ishte në prag copëzimi. Komuniteti Evropian, Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Sovjetik dhe OKB-ja ishin të gjitha kundër shpërbërjes, por nuk bënë aq sa duhej për ta ndihmuar Jugosllavinë të mbetej e bashkuar. Një sërë ndryshimesh kushtetuese në vitin 1989 u pasuan nga referendumet dhe shpalljet e pavarësisë së republikave përbërëse të saj. Në vitin 1990, ato hapën rrugën e shpërbërjes dramatike të vendit, gjë që përshkruhet në kapitullin që vijon. Ky proces historik mund të kuptohet duke studiuar në kombinim dokumentet e Kapitullit VIII të vëllimit 1 (Kriza e viteve 1980) dhe kapitujt II dhe III të vëllimit 2 (Luftërat, ndërhyrjet ndërkombëtare dhe traktatet e paqes).

I.1. FUNDI I LUFTËS SË FTOHTË

Në Samitin e Maltës, më 3 dhjetor 1989, presidenti amerikan Xhorxh H. W. Bush dhe udhëheqësi sovjetik Mikail Gorbaçov deklaruan fundin e Luftës së Ftohtë. Negociatat për pakësimin e numrit të armëve strategjike bërthamore vazhduan në vitet që pasuan dhe përfunduan me nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik. Më 17 nëntor 1990 në Paris, udhëheqësit e NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës nënshkruan Traktatin për Forcat Konvencionale në Evropë (FKE), dhe dy ditë më pas, Kartën e Parisit për një Evropë të Re duke deklaruar fundin e ndarjes ekonomike dhe ushtarake të Evropës. Më 25 shkurt të vitit 1991, gjashtë vendet e mbetura të Traktatit të Varshavës u takuan në Budapest dhe morën vendim t'i shpërbënin strukturat e tyre ushtarake.Në një takim të dytë në Budapest, më 18 qershor 1991, Pakti vendosi shpërbërjen e organizimit të tij ekonomik, COMECON. Përfundimisht, Pakti i Varshavës u shpërbë në Samitin e Pragës, më 1 korrik 1991.

I-1. Raport i CIA-s për të ardhmen e Evropës Lindore dhe Ballkanit, Prill 1990

Rajoni do të evoluojë në një gjendje, përherë e më pak precize, që do të quhet "Evropa Lindore", sepse vendet e Evropës Lindore-Qendrore, si Polonia, Çekosllovakia, Hungaria dhe Gjermania Lindore, do të bëjnë përpara në bashkëpunim të ngushtë me Perëndimin, po ashtu në këtë drejtim do të ecnin dhe vendet e Ballkanit, si Bullgaria, Rumania e Shqipëria, që janë disi më të veçuara. Jugosllavia, nëse qëndron e bashkuar, do të vazhdojë lidhjet e ngushta me Perëndimin.

Megjithatë, në disa vende të Evropës Lindore, do të shohim destabilitet politik, e ndoshta, edhe ringjalljen e autoritarizmit, mes prapambetjes së vazhdueshme ekonomike dhe ringjalljes së armiqësive të hershme etnike. Pavarësisht ndihmës dhe investimeve perëndimore, ekonomitë e Evropës Lindore, duke përjashtuar atë të Gjermanisë Lindore, kanë gjasa për të patur zhvillim jo të barabartë përgjatë periudhës pesëvjeçare të këtij vlerësimi.

E ardhmja e Evropës Lindore, 1990, fq.182

Komentoni raportin e CIA-s. Cilat ishin parashikimet? A ndodhi realisht kështu? Në çfarë mënyre? Studioni paragrafin e dytë dhe diskutoni përse Gjermania Lindore përjashtohet nga e ardhmja pesimiste e parashikuar. Si mund ta përshkruani 25 vjet më pas, përkufizimin e dhënë "zhvillim jo i barabartë"?

I-2. "Gozhda e fundit në Traktatin e Varshavës". Artikull i një gazete shqiptare mbi shpërbërjen e strukturës ushtarake të Traktatit të Varshavës

Në Moskë, si të ishte një ceremoni mortore, Gjenerali sovjetik Vladimir Lobov, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Aleancës Lindore, zhvilloi takimin e lamtumirës së fundit me krerët e strukturave ushtarake të Traktatit të Varshavës. I mbajtur vetëm një muaj pas takimit të Budapestit, në këtë takim u ndezën formalisht qirinjtë për këtë aleancë dhe u përcaktua protokolli i nekrologjisë së saj, si dhe dita kur do të vendosej gozhda e fundit në arkivolin e saj. Në takimin e Budapestit u vendos që shpërbërja e të gjitha strukturave ushtarake të këtij blloku të bëhej përpara 31 marsit. Ky protokoll u zbatua praktikisht në mënyrë rigoroze. Disa ditë më pas, përfaqësuesit e Komandës së Traktatit të Varshavës do të kthehen në vendet e tyre. Goditja përfundimtare ndaj Aleancës Lindore do të lajë, bashkë me të, turpin për veprimet e gushtit 1968. Gjithsesi, historia e saj do të zërë një vend të rëndësishëm në muze, duke i shërbyer kështu brezave të ardhshëm.

Në fakt, shpërbërja reale e Traktatit të Varshavës ka filluar shumë kohë më parë. Por, praktikisht, tashmë i erdhi fundi agonisë së tij të vazhdueshme, duke bërë që popujt e Evropës Lindore të marrin frymë lirisht, e jo vetëm kaq, por edhe popujt e Evropës Perëndimore, duke marrë parasysh se tashmë po zhdukej një nga kërcënimet e mundshme ndaj lirisë dhe pavarësisë së tyre. [...]

Gjatë ditëve të fundit të Traktatit të Varshavës, popujt e Evropës që kishin vuajtur gjatë dy luftërave botërore, padyshim që dëshironin të shihnin bllokun tjetër ushtarak, NATO-n në muzetë e historisë moderne, në një të ardhme të afërt. [...] Ndërkohë, ish-anëtarë të Traktatit të Varshavës po nënshkruanin marrëveshje bilaterale bashkëpunimi ushtarak me njëri-tjetrin. Disa prej tyre shkuan edhe më tej duke kërkuar të krijojnë lidhje politike dhe ushtarake me NATO-n, e pse jo të bëhen edhe anëtare të saj në një të ardhme të afërt. [...]

Lulëzim Çota, *gazeta "Zëri i Popullit", 27 mars 1991.*

I-3. Gazeta e djathtë greke dhe zëdhënësja zyrtare e Partisë Komuniste greke (KKE), raporton për shpërbërjen e Traktatit të Varshavës

A. "Funerali i Traktatit të Varshavës", gazeta "Eleftheros Typos", 2 korrik 1991

Duket se ka qenë e shkruar se organizata ushtarake, e cila frikësonte më shumë vetë anëtarët e saj, do të duhej t'i vinte fundi në kryeqytetin e vendit ku ajo kishte kryer edhe krimin më të rëndë. Në mesditën e djeshme, Praga e lirë e vitit 1991, mori hak për gjakun e derdhur në Pragën e vitit 1968.

Në kryeqytetin çekosllovak, gjashtë anëtarët e mbetur të Traktatit të Varshavës vendosën dje për vetë-shpërndarjen përfundimtare të tij. Organizata që për 36 vjet me radhë kishte mbajtur nën kontroll dhe kishte frikësuar pjesën tjetër të botës, nuk ekzistonte më.

Në të njëjtën kohë, Parlamenti i "nënës" së Traktatit të tretur, Bashkimit Sovjetik, është në prag të kalimit të ligjit, i cili do të ketë pasoja për të ardhmen e vendit: një ligj që shtron hapat e procesit në lidhje me privatizimin e ndërmarrjeve. Sipas këtij ligji, të gjitha ndërmarrjet që deri në atë kohë kishin qenë shtetërore, përveç atyre që kanë të bëjnë me Shëndetësinë, Mbrojtjen, Sigurinë dhe Mjedisin, mund të viheshin në ankand, mund t›iu kalonin shoqërive me përgjegjësi të kufizuara dhe kooperativave, ose mund të bëheshin shoqëri aksionare.

B. "Shpërbërja e plotë e Traktatit të Varshavës", gazeta "Rizospastis", 2 korrik 1991

Konferenca u kryesua nga V. Havel, i cili e përshkroi Traktatin e Varshavës si një "institucion i modës së vjetër, si një fëmijë i Luftës së Ftohtë". Në fjalën e tij, lideri çekosllovak theksoi se: "Vendimi i sotëm është historik. Ne po i themi lamtumirë epokës kur Evropa ishte e ndarë nga papajtueshmëritë ideologjike ... Vizioni i një Evrope të bashkuar, demokratike, të sigurt e paqedashëse ngrihet para nesh". […]

Zëvendës Presidenti sovjetik G. Yanayev shprehu shpresën se edhe NATO së shpejti do të ndjekë hapat e Traktatit të Varshavës. Ai nënvizoi faktin se organizatat e krijuara për Luftën e Ftohtë janë "vjetërsuar" dhe se qeveria e tij është në pritje të një "zhvillimi apo ndoshta revolucioni [të ngjashëm] të NATO-s". "NATO do të kuptojë se realiteti politik mbizotërues nuk e justifikon mbijetesën e saj si një organizatë kundërshtare. Kjo është arsyeja pse ne pranuam shpërbërjen e Traktatit të Varshavës ... Kam shpresë se NATO nuk do të mbijetojë për një kohë të gjatë ", përfundoi ai.

I-4. Riorientimi i politikës së jashtme turke pas rënies së ish-BRSS.

Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, shumë politikanë, përfshirë Presidentin Turgut Ozal dhe kryeministrin e tij, si dhe presidentin e mëvonshëm Sulejman Demirel, deklaruan se shekulli i 21-të do të ishte "Shekulli i turqve", i cili do të karakterizohej nga një integrim i shpejtë ekonomik, politik, kulturor e gjuhësor të Turqisë me Republikat e Azisë Qendrore dhe shumë më pak varësi ndaj Evropës Perëndimore. Megjithatë, ky optimizëm nuk zgjati shumë. Republikat e Azisë Qendrore preferuan të ruajnë aleancat e tyre me Rusinë.


A. Presidenti kazak Nazarbayev, refuzon planet turke për krijimin e një "hapësire turke" në Azinë Qendrore

Nazarbayev, 1991 - "Në këtë rajon të botës, turqizmi lulëzoi si reagim kundër hegjemonisë sovjetike ... Por, unë jam plotësisht kundër kategorizimit të njerëzve sipas turqizmit apo islamizmit. Por, këto prirje nuk kanë shans të kenë sukses. Në këtë moment, ne jemi dëshmitarë të qasjes pro-turke, e cila po zhvillohet për shkak të vlerave të përbashkëta që ndajnë njerëzit turqishtfolës. Gjithsesi kjo nuk duhet të shndërrohet në shovinizëm të rrezikshëm."

Nazarbayev, 1997: - "Kjo çështje u shpreh qartë në deklaratën që kolegët tanë turq dhanë në samitin e parë të krerëve të shteteve turke. U deklarua se ne do të zgjidhnim rrugën e bashkëpunimit me Turqinë, bazuar në unitetin historik të rrënjëve tona, gjuhës sonë të përbashkët dhe kulturës, bashkësisë së traditave tona. U detyrova ta lëndoj Turgut Özalin. I kisha thënë se nuk do ta nënshkruaja këtë deklaratë. I kisha thënë se do të mbështesja vetëm marrëdhëniet ekonomike, politike dhe humanitare. Është e vërtetë se rrënjët tona janë të njëjta, por gjithashtu dihet se kemi qenë të ndarë nga njëri-tjetri për një kohë shumë të gjatë. Kështu që i propozova të rivendosim lidhjet e këputura të qytetërimit tonë, duke respektuar pavarësinë e fituar rishtazi, sovranitetin e secilit shtet. Megjithatë, dua të shtoj se ne nuk do t'i ndërpresim marrëdhëniet tona me popujt dhe shtetet e tjera, nuk do të hyjmë sërish në marrëdhënie jo të drejta, pavarësisht se cili shtet është ai".

Oran, 2002, vëllimi. 2, fq. 394-395.

B. Karikaturë: Nga portat e Vjenës në portat e Azisë Qendrore



(Ali Ulvi)

Oran, 2002, vëllimi. 2, fq. 374.

1. Përshkruani figurën. Përse përmenden portat e Vjenës dhe pse po braktisen ato? Cilat ngjarje historike evokon karikatura? Mendoni se autori i saj është pro ose kundër në lidhje me orientimin e ri të Turqisë? Cilat janë argumentet tuaja?
2. Cilat janë "rrënjët e përbashkëta" të Turqisë me disa nga ish-republikat sovjetike (p.sh. turqit edhe kazakët) si grupe etnike?
3. Pse mendoni se Turqia është kthyer në drejtim të Azisë? Sipas jush cilat janë arsyet që mendoni se politika e "panturqizmit" mund të materializohet?
4. Sipas gjykimit tuaj pse mendoni se Nazarbayev reagon kështu në këtë deklaratë?
5. Ju vijnë ndër mend qëndrime të ngjashme politike që bazohen te qasje etnologjike/racore, në historinë moderne dhe bashkëkohore evropiane?

I.2. PARTITË POLITIKE DHE ZGJEDHJET

I-5. Rënia e Zhivkovit dhe zgjedhjet shumëpartiake në Bullgari

Më 15 janar 1990, u shfuqizua neni 1 i Kushtetutës që përcaktonte Partinë Komuniste Bullgare si "forcën kryesore të shoqërisë dhe shtetit". Zgjedhjet e para të lira për Kuvendin e Shtatë të Madh Kombëtar, u mbajtën më 10 dhe 17 qershor 1990. Gjysma e 400 anëtarëve të Kuvendit u zgjodhën me përfaqësim proporcional dhe gjysma tjetër me shumicë votash. Në to morën pjesë pothuajse shtatë milionë zgjedhës, ose rreth 91% e të gjithë votuesve.

Rezultatet e zgjedhjeve shkaktuan protesta publike. Mbështetës të BFD-së (Bashkimit të Forcave Demokratike) ishin të sigurt se zgjedhjet ishin manipuluar dhe pasi u shpallën rezultatet paraprake të raundit të parë të votimit më 10 qershor filluan protesta masive, duke ngritur barrikada dhe duke bllokuar trafikun në rrugët kryesore të Sofjes.
Më 11 qershor, studentë mbështetës të BFD-së njoftuan fillimin e një greve duke zënë ambientet

e godinës kryesore të Universitetit të Sofjes. Më 13 qershor, BFD-ja iu bëri thirrje përkrahësve të saj për të pranuar rezultatet e zgjedhjeve dhe për t›i dhënë fund shkeljes së rendit publik. Gjithsesi, të nesërmen, BFD-ja publikoi një regjistrim video të presidentit bullgar të asaj kohe, Petar Mladenov, teksa thoshte gjatë një demonstrate antiqeveritare se do të ishte më mirë "të sillnin tanket" kundër protestuesve. Pasi u shpallën rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, BDF refuzoi të bashkohej në koalicionin qeveritar dhe protestat vazhduan.

A. "Mjaft më, 45 vjet janë shumë! Është koha jonë", platforma zgjedhore e Bashkimit të Forcave Demokratike (BFD)

Bashkimi i Forcave Demokratike lindi gjatë përpjekjeve për demokraci. Partitë politike, anëtare të saj, frymëzoheshin nga ideja e shfuqizimit të sistemit totalitar çnjerëzor dhe kalimi i një faze tranzicioni të qetë e të civilizuar të vendit tonë drejt një sistemi demokratik ...

Socializmi ishte një shoqëri e sajuar. Ne jemi për një shoqëri të vërtetë.

"Mjaft më, 45 vjet janë shumë! Është koha jonë!" Platforma zgjedhore e Bashkimit të Forcave Demokratike

BFD do të thotë Bashkimi i Forcave Demokratike. Ne jemi për demokracinë. Demokraci për njerëzit dhe qytetarët. Demokraci, thjesht, pa përcaktorë. Demokracia që shndërroi shumë vende në shtete të pasura e të mirërregulluar. Ne mund dhe duan të bëhemi pjesë e asaj Evrope, ku zbatimi i parimeve të demokracisë në dy shekujt e fundit ka çuar në progresin më të madh në historinë e qytetërimit njerëzor. NE DUAM NJË BULLGARI TË PAVARUR, DEMOKRATIKE DHE TË BEGATË!

Bashkimi i Forcave Demokratike lindi gjatë përpjekjeve për demokraci. Partitë dhe organizatat politike, anëtare të saj, frymëzoheshin nga ideja e shfuqizimit të sistemit totalitar çnjerëzor dhe kalimin e qetë e të civilizuar të vendit në një sistem demokratik. Ne jemi trashëgimtarë të traditave demokratike të Rilindjes, të arritjeve politike dhe kulturore, të idealeve të ndërtuesve të një Bullgarie të re pas çlirimit. E gjithë kjo, që u mohua dhe u shtyp brutalisht gjatë viteve të diktaturës komuniste, është e jona dhe ne duhet ta ringjallim. […]

Socializmi ishte një shoqëri e sajuar. Ne jemi për një shoqëri të vërtetë. Ne nuk po deklarojmë se jemi në favor të "shpërbërjes" së ndonjë organizate zyrtare cilado qoftë. Jemi për një shoqëri, ku vetë jeta do të tregojë se cilat janë lëvizjet dhe organizatat e nevojshme për qytetarët. […]

DEMOKRACIA + NATYRË = EKOLOGJI

Socializmi nuk ishte vetëm një shoqëri e sajuar, por edhe artificiale. Ideja e fuqisë së njeriut mbi natyrën është thjesht ana tjetër e medaljes së idesë së pushtetit mbi njeriun. Njeriu u shpall "objektiv suprem" dhe, njëkohësisht, u përdorur si mjeti më i lirë për arritjen e këtij objektivi! Njeriu u sakrifikuar në emër të njeriut! Industrializimi i gabuar e shndërroi Bullgarinë, të njohur për bukuritë e saj natyrore, në një nga pjesët më të ndotura të botës. […]

NE JEMI PËR NJË QASJE NATYRORE NDAJ SHOQËRISË DHE PËR NJË QASJE SHOQËRORE NDAJ NATYRËS!

Gazeta "Demokracija" (Demokracia), 28 prill 1990. http://old.omda.bg/arhiv/predizborna_platforma_sds.htm, parë më 04.07.2016.

B. Për një tranzicion pa kaos: platforma zgjedhore e Partisë Socialiste

[…] QYTETARË! Partia Socialiste Bullgare (PSB) është një parti e ndryshuar dhe në ndryshim rrënjësor. Ajo ka bërë një sërë gabimesh. Por, ndihmoi popullin tonë të kapërcejë prapambetjen shekullore të vendit e mjerimin e fshatit, për të ngritur industrinë, për të ndërtuar qytete bashkëkohore, për të krijuar kushte jetese njerëzore për miliona njerëz.

TRANZICION PA KAOS

Nuk ka krizë pa zgjidhje. Por dalja nga kriza është e ndryshme.

Duke votuar për kandidatët e PSB-së, ju votoni për dalje nga kriza në mënyrë paqësore dhe për qëndrueshmëri të familjeve dhe të afërmve tuaj të dashur. […]

PSB-ja është për një tranzicion të PËRSHPEJTUAR drejt ekonomisë së tregut, për ndërtimin dhe zhvillimin e PËRSHPEJTUAR të tre përbërësve kryesorë të saj: tregu i mallrave, tregu i aksioneve dhe tregu i punës.

TRANZICION I PËRSHPEJTUAR, JO "TË PAPRITUR E TRONDITËS"!

I PËRSHPEJTUAR, POR JO I MENJËHERSHËM!

Ne nuk duam dhe nuk mund të lejojmë që populli ynë të paguajë çmimin e rëndë social të kalimit të menjëhershëm drejt një tregu krejtësisht të lirë. Kjo politikë ekonomike u promovua nga opozita. Por BDF-ja duhet të thotë haptazi se ajo çfarë ofron për popullin tonë është PAPUNËSI MASIVE, ÇMIME TË PAKONTROLLUARA, INFLACION TRONDITËS, SHTERIM I NJË PJESE TË MADHE TË TË ARDHURAVE KOMBËTARE, ULJE DRASTIKE TË VLERËS SË TË MIRAVE (ASETEVE) TË PAKTA QË KA BULLGARIA. Opozita ka të drejtë të mbrojë programin e saj ekonomik. Por ajo duhet të shpjegojë, në një mënyrë të qartë e të kuptueshme për këdo, pasojat e rënda të "terapisë së shokut". […]

PA LIRI TË SHPIRTIT, POPULLI NUK ËSHTË I LIRË

PSB-ja ka ideologjinë e saj bashkëkohore marksiste.

Por, ne nuk ia imponojmë atë kujtdo. Ne jemi kundër shndërrimit të një ideologjie çfarëdo në një ideologji zyrtare e të detyrueshme. Ideologjia është një çështje e bindjes personale. PSB-ja i përmbahet rreptësisht këtij parimi dhe lufton kundër kujtdo që përpiqet t›i imponojë popullit një këndvështrim të caktuar me anë të forcës. Shprehja e lirë, krijuese, e natyrshme dhe jo mbi bazë partie! Përzgjedhja dhe afirmimi i talenteve: këto janë parimet e PSB-së në sferën e shkencës, artit dhe kulturës.

http://www.omda.bg/public/arhiv/platforma%20na%20BSP.htm, parë më 04.07.2016.

Ndani nxënësit/ studentët në dy grupe. Studioni burimet e mëparshme, përgatisni dhe paraqisni, duke përdorur argumente të dokumentuara, karakteristikat themelore të zgjedhjeve politike dhe sugjerimet e të dyja partive. Çfarë qasje ka secila prej tyre për ekonominë e tregut të lirë? Cili është qëndrimi i tyre ndaj demokracisë? Cilat janë elementet kryesore të ideologjive të tyre të theksuara në këto burime? Gjeni ngjashmëritë dhe dallimet.

C. I ashtuquajturi "Qytet i së vërtetës" në Sofje, verë 1990



"Qyteti i së vërtetës", Sofje, 16 korrik 1990, Foto për shtyp nga BTA, autor: Zhivko Angelov 90-383N-19a.

Kur Andrei Lukanov i Partisë Socialiste Bullgare (PSB) u riafirmua si kryeministër më 29 qershor, protestuesit filluan një grevë duke qëndruar ulur në trotuar jashtë zyrave të Presidentit, gjë që më pas u zmadhua në një çadër të madhe që u quajt "Qyteti i së vërtetës". Për afro dy muaj, rreth 150 - 300 protestues, duke përfshirë lektorë universitetesh, njerëz të artit dhe disidentë të shquar, qëndruan në çadër. Pothuajse çdo natë mbaheshin mitingje dhe demonstrata. "Qyteti i së vërtetës" kishte kryetarin e tij të bashkisë, Këshillin dhe kishën e tij. Banorët e tij kërkonin, ndër të tjera, të "vërtetën" mbi zgjedhjet e manipuluara dhe pronat që PSB-ja kishte trashëguar nga PKB, dhe gjithashtu bënin thirrje për gjykimin e Todor Zhivkovit. Qyteti i së vërtetës u shpërbë natën e 26/27 gushtit, pasi selisë së partisë (ish-selia e Komitetit Qendror të PKB-së) iu vu zjarri. Pavarësisht protestave, PSB në këtë periudhë formoi dy qeveri të saja- e para (8 shkurt - 21 shtator 1990) dhe e dyta (22 shtator - 19 dhjetor 1990) - të dyja të kryesuara nga Andrei Lukanov si kryeministër.

D. Zgjedhjet e para në Bullgari, qershor 1990

Partia	Vota	Vende
Partia Socialiste Bullgare (PSB, Partia Komuniste e riemërtuar)	47.15%	211
Forcat e Bashkuara Demokratike (BDF)	36.2%	144
Bashkimi Kombëtar Agrar Bullgar (BANU)	8.03%	16
Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë (MRF)	6.02%	23

E. Një kujtim nga zgjedhjet në Bullgarinë e vitit 1990 nga Alfred (Fredi) Foscolo, gazetar me origjinë bullgaro-frënge, si vëzhgues antikomunist nga Franca.

Përveç një vizite të fshehtë prej 24 orësh në atdheun tim për të nxjerrë familjen time [nga Bullgaria], kishin kaluar tashmë 18 vjet që kur kisha shkelur për herë të fundit në Bullgari. Kishte kaluar një kohë edhe me e gjatë që kur kisha kaluar për herë të fundit pragun e ambasadës së Republikës Popullore të Bullgarisë në Paris. Por, ja, kishte ardhur koha që ta hidhja këtë hap, teksa Bullgaria po bëhej gati të zhvillonte më 10 qershor [1990]zgjedhjet e para të lira ndër dekada. […]

Të dielën e zgjedhjeve, pas një të shtune të kthjellët, mbërtheva në këmishën time kapësen që më identifikonte si vëzhgues zgjedhjesh dhe së bashku me ekipin e televizionit francez, u drejtuam për në lagjen Levski, të Sofjes, për të cilën nuk dija kurrfarë gjëje. Qendra e votimit ishte në një shkollë. Tavolinat ishin shtyrë në këndet e klasave dhe në mes qëndronte një tavolinë e gjatë ku binte në sy kutia e votimit. Një radhë e ngathët njerëzisht të zemëruar zgjatej në tërë korridorin, përmes oborrit të shkollës e deri në rrugë. Votuesit ankoheshin se kishin pritur me orë të tëra për të hedhur fletët e votimit sepse kishte vetëm një kabinë votimi. Përveç kësaj, fletët e votimit me ngjyrë blu të opozitës rezultonin se ishin të pakta. Ndërkohë që prisja për dorëzimin e fletëve të votimit shtesë, vura në përdorim autoritetin tim si vëzhgues zgjedhjesh për të marrë disa tavolina të vendosura pirg njëra mbi tjetrën, të cilat i mbuluam më pas me perdet e hequra nga dritaret për të krijuar kështu kabina votimi shtesë. Pra, deri në fund të votimit, votuesit në radhë po pakësoheshin dhe të gjithë ata që donin të votonin mund të afroheshin pranë kutisë së votimit.

I rraskapitur u ula në shkallët para ndërtesës për të pirë një cigare. Aty gati sa s'u përplasa me një grua në moshë të thyer, të përgjumur që m'u hakërrye me nervozizëm: "Shok, jam me vonesë, duhet të votoj, ju lutem më lejoni të kaloj!" "Më vjen keq, zonjë," i thashë, "votimi është mbyllur!" Sytë e saj u mbushën me lot. U kthye për t›u larguar dhe filloi të qante: "Oh zot, o zot! Si më ndodhi kjo mua ... çfarë do të bëj tani?"
Dëshpërimi i saj tregonte se ajo ishte e frikësuar nga fakti që nuk arriti të votonte. Zyrtari ose sekretari i partisë do ta ruanin ... ose edhe më keq akoma. Ajo nuk e kishte kuptuar ende se këto ishin zgjedhje të lira, ku secili ishte i lirë të vendoste nëse do të votonte apo jo.

https://bulgaria1989.wordpress.com/2010/06/09/izbori90/, parë më 4.07.2016.

1. Pse zonja e përmendur më sipër është e dëshpëruar? Nga se kishte frikë?
Çfarë domethënie kishin këto zgjedhje për kohën?

2. A është liria e shprehjes diçka që mund t›iu jepet vetëm njerëzve, apo duhet të fitohet me vetëdije dhe të ndërtohet hap pas hapi si një qëndrim dhe mënyrë jetese, përmes një procesi më të komplikuar? Diskutoni.

I-6. Zgjedhjet e vitit 1990 në Jugosllavi

Një numër i madh partish të reja u formuan për zgjedhjet e para shumëpartiake që u mbajtën në të gjitha republikat jugosllave, në vitin 1990 (atë vit nuk u zhvilluan zgjedhje federale). Pjesëmarrja në votime ishte shumë e lartë (pothuajse 80% në të gjitha republikat), duke treguar se njerëzit ishin të gatshëm për ndryshime politike. Në katër republika (Sllloveni, Kroaci, Bosnje-Hercegovinë dhe Maqedoni), zgjedhjet sollën ndryshim të pushtetit, ndërsa ish-Partia Komuniste fitoi në Serbi dhe në Mal të Zi, sepse ato kishin bërë ndryshime në udhëheqjet e tyre në fund të viteve 1980, me ardhjen në pushtet të Sllobodan Milosheviçit. Në të gjitha republikat, partitë jugosllave humbën në zgjedhjet e para , ndërsa partitë konservatore, të djathta dhe kryesisht nacionaliste u ngjitën në pushtet. Në Sllloveni, koalicioni i krahut të

djathtë, DEMOS fitoi (me një shumicë prej 54%). Në Kroaci, Bashkimi Konservator Demokrat Kroat fitoi (41.9%). Tre parti etnike fituan në Bosnje-Hercegovinë: Partia Boshnjake e Veprimit Demokratik (35.83%), Partia Demokratike Serbe (30%) dhe Bashkimi Demokratik Kroat (18.35%), duke çuar në një ndarje parlamentare sipas ndarjes etnike. Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas, VMRO, në Maqedoni mundi ish-komunistët me një diferencë të ngushtë, duke fituar 38 vende në parlament (komunistët fituan 31 vende). Në Serbi, Partia Socialiste Serbe e Millosheviçit fitoi 46.1% të votave dhe në Malin e Zi, Lidhja e Komunistëve të Malit të Zi, e kryesuar nga Momir Bulatoviç (president i zgjedhur i Republikës në vitin 1990) fitoi 83 vende në parlamentin me 125 vende gjithsej. Megjithëse ishin ish-komunistë, ata luajtën kartën e nacionalistëve gjatë fushatës zgjedhore.

A. Programi i Opozitës Demokratike të Sllovenisë "Demos"

"Demos" ishte një koalicion i partive të cilat dolën bashkë në zgjedhjet e para të lira pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1990 dhe, si koalicion, fitoi shumicën për të krijuar qeverinë e cila e çoi Sllovenine drejt shkëputjes nga Jugosllavia. Programi zgjedhor i "Demosit", me titull "Të Bashkuar për Demokraci" (në Sllovenisht: Združeni za demokracijo), u bë i njohur si Kushtetuta e "Demosit", ku përfshiheshin kërkesat për liri dhe demokraci. Zgjedhjet e para shumëpartiake u mbajtën më 8 prill 1990, me pjesëmarrjen e 83.5% të votuesve të mundshëm. "Demosi" fitoi zgjedhjet me 54% të votave.

2. Në fushën e organizimit të shtetit, Opozita Demokratike e Sllovenisë, "DEMOS", lufton për:
– një shtet sovran të kombit slloven, të pavarur ose në konfederatë me shtete të tjera, të cilat nuk do të krijohen nga projekti utopik i socializmit; organizimi i brendshëm i Sllovenisë, si dhe lidhjet e saj me jashtë do të vendosen nga qytetarët me anë të referendumit;
– demokraci parlamentare dhe pluralizëm partiak, duke kërkuar që partitë politike të mos krijoheshin nga shoqëritë apo organizatat e tjera të punës; vendosjen e referendumit në Sllloveni, si një nga format e drejtpërdrejta vendimmarrje të të gjithë shtetasve sllovenë; [...]
– respektimi i plotë dhe mbrojtja e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut, ku ushtrimi i të drejtave civile do të jetë i lidhur me zotërimin e shtetësisë sllovene; shqetësim në lidhje me ruajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e plotë të të drejtave të pakicave italiane dhe hungareze në Sllloveni;
[…]
3. Në fushën e ekonomisë, opozita do të luftojë për:
– një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë dhe sipërmarrjes, të cilat mund të kufizohen vetëm me ligj, kur është e nevojshme për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e burimeve dhe pasurive natyrore, së bashku me trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si dhe për garantimin e mbrojtjes shoqërore minimale; do të bëhen përpjekje për të hequr pronësinë shoqërore dhe për të krijuar një përkufizim të qartë të pronësisë së kapitalit;

Gazeta "Demokracija" (Demokracia), 19 dhjetor 1989.

Krahaso programin elektoral të "Demosit" me platformën elektorale të Bashkimit të Forcave Demokratike (BDF) në Bullgari. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet? Cili është qëndrimi i tyre drejt Evropës?

B. Fushata zgjedhore në Sllloveni. Një poster i "Demos"-it



Përkthimi: Ta tërheqim së bashku! Ejani në zgjedhje!
i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Para zgjedhjeve të para demokratike në Sllloveni, u krijuan një sërë partish dhe koalicionesh gjatë fushatën parazgjedhore. "Demos" e portretizoi vetveten si fuqia e popullit, koha e të cilit kishte ardhur dhe që përfundimisht do të mbizotëronte. Ndërsa autoritetet u paraqitën si një forcë e bazuar në diktaturën e proletariatit, që kishte në dorë burgjet, median dhe gëzonte mbështetjen më të madhe financiare.

C. Një poster i Partisë Komuniste të reformuar

Një nga partitë që mori pjesë në zgjedhjet parlamentare ishte Aleanca e Komunistëve të Sllovenisë (ish-Partia Komuniste), e cila kundërshtoi zgjedhjet si një parti individuale, pavarësisht se, koalicioni i krahut të djathtë, "Demos" mori pushtetin. Posteri tregon se ylli i kuq i mëparshëm ishte zëvendësuar nga një yll i verdhë.



Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Cila është simbolika e zëvendësimit të yllit të kuq me një yll të verdhë mbi një sfond blu? A njihni ndonjë simbol tjetër me të njëjtin kombinim ngjyrash?

D. "Një votë për Maqedoninë": Nga zgjedhjet e para të referendumit për pavarësi, 1990-1991

Zgjedhjet e para shumëpartiake në Republikën e Maqedonisë (e cila, në atë kohë, formalisht ishte ende anëtare e Federatës Jugosllave) u zhvilluan në nëntor të vitit1990, pasi partitë e para politike në vend ishte themeluar në vitin 1989. Zgjedhjet u zhvilluan me sistemin zgjedhor mazhoritar, me pjesëmarrjen e 18 partive politike dhe 43 kandidatëve të pavarur. Raundi i parë u mbajt më 11 nëntor, që u pasua nga një raund i dytë më 26 nëntor. Pjesëmarrja e votuesve në raundin e parë ishte 84.8%, ndërsa në të dytin 76.8%. Shumica e vendeve në parlament u fituan nga partitë etnike maqedonase: VMRO-DPMNE fitoi 38 vende; SKM-PPD (sot SDSM-ja) 31 vende dhe partia etnike shqiptare, PDP mori 17 vende. Më 25 janar 1991, parlamenti miratoi Deklaratën mbi sovranitetin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, dhe dy ditë më pas, zgjodhi Kiro Gligorov presidentin e parë të vendit, me shumicë votash. Në bazë të Deklaratës, në gusht të vitit 1991, Parlamenti vendosi të nxjerrë një njoftim për referendum publik për pavarësinë. Referendumi u mbajt më 8 shtator, ku morën pjesë 75.74% të elektoratit. 95,26% votuan për një shtet sovran e të pavarur. Partitë politike etnike shqiptare dhe shumica e elektoratit shqiptar bojkotuan referendumin. Që nga viti 1991, 8 shtatori festohet si festa kombëtare e Ditës së Pavarësisë në vend.

Faqja e parë e së përditshmes "Nova Makedonija" (Maqedonia e re), 8.09.1991.

→

АЛКАЛАКС®
ЧАЈ ЗА ПРОЧИСТУВАЊЕ
UVE-MIX
чај за дезинфекција на мочните патишта
АЛКАЛОИД СКОПЈЕ


НОВА МАКЕДОНИЈА

YU ISSN 0350-4298

ДИРЕКТОР ПАНДЕ КОЛЕМИШЕВСКИ
ГЛАВЕН И ОДГОВОРЕН УРЕДНИК ГЕОРГИ АЈАНОВСКИ

СКОПЈЕ, НЕДЕЛА 8 СЕПТЕМВРИ 1991 ГОДИНА

Год. XLVII – БРОЈ 16029



ГЛАС ЗА МАКЕДОНИЈА

Денес граѓаните на Македонија, не со оружје и крв, туку со молив в рака, на најдемократски начин, со референдум, ќе го заокружат суверенитетот и самостојноста на својата држава

Граѓаните на Македонија денес излегуваат на референдум на кој, препат во својата историја, гласаат за Македонија. Гласајќи „ЗА", тие гласаат за суверена и самостојна држава Македонија со право да стапи во иден сојуз на суверените држави на Југославија.

Овој осми септември ќе остане забележан со ... ја, треба да решат дали таа ќе стане независна држава која ќе биде рамноправен фактор во преговорите за политичката иднина на Југославија, но и рамноправен фактор во Европа, или пак ќе остане на опашката на европските интеграциони процеси, ставајќи се под нечие патронатство. Гласот „ЗА" на овој референдум е глас за Македонија и за нејзината рамноправница. Референдумот во Македонија не е за отцепување од Југославија, како што тоа некои сакаат да го прикажат, туку за Македонија како рамноправен фактор во Југославија како сојуз на суверени држави, но и рамноправен фактор во Европа и светот.

Оние притисоци што за цело време на подготовките на референдумот се упатуваа до граѓа-

Инаку, за ова прво изјаснување за суверенеста и самостојноста на македонската држава се очекува да гласаат околу 1.452.972 граѓани во Републиката, колку што се јавиле на минатогодишните парламентарни избори. Покрај тоа, се очекува масовен одзив и на голем број граѓани кои се на привремена работа во странство, како и голем број Македонци, кои немаат државјан-

I-7. Pushteti i ri: Komunikatë drejtuar vendit nga Këshilli i Frontit Kombëtar të Shpëtimit, publikuar menjëherë pas arratisjes së çiftit presidencial nga Bukureshti

Këshilli i Frontit Kombëtar të Shpëtimit (KFKSH) ishte një organizëm politik, që e vendosi veten në krye të shtetit, menjëherë pasi çifti Nikolai dhe Elena Çaushesku i shpëtuan turmës armiqësore më 22 dhjetor 1989. Ky organ u kryesua nga Ion Iliesku, një anëtar i Partisë Komuniste Rumune i margjinalizuar nga diktatorët e mëparshëm në vitet 1980. Udhëheqësit kryesorë, që mbetën në pushtet në vitet pasardhëse, pretenduan se ai ishte një grup i krijuar vetvetiu, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e revolucionit antikomunist në dhjetor të vitit 1989. Megjithatë, shumë zëra opozitarë deklaruan se KFKSH-ja ishte një forcë politike alternative që ishte organizuar para revolucionit, në favor të reformës në përgjithësi, por jo në favor të shembjes së regjimit komunist. Ky organ ia doli të përfshinte disa qeliza pushteti që vinin kryesisht nga hallkat e Partisë Komuniste Rumune, të forcave të armatosura dhe të policisë politike (Sigurimit), dhe inteligjencia. Masat e para që KFKSH-ja mori synonin rrëzimin e atyre dekreteve të Çausheskut që kishin një karakter drejtpërdrejt shtypës: si rrjedhojë, ata anuluan ndalimin e abortit, lejuan aksesin e lirë të popullsisë te burimet ushqimore, dhe shpërbënë fermat kolektive. Fillimisht, Fronti e shpalli veten një strukturë jopolitike dhe se misioni i tij i vetëm ishte të garantonte kalimin drejt një udhëheqjeje të re demokratike të vendit. Megjithatë, më 6 shkurt 1990, ai u regjistrua si parti politike me emrin e Frontit Kombëtar të Shpëtimit (FKSH) që arriti një fitore dërrmuese (67% të votave) në zgjedhjet e para "të lira" në maj të vitit 1990. FKSH-ja vendosi një ritëm të ngadaltë të transformimit demokratik pasi ngurronte në vendosjen e një sistemi të vërtetë shumëpartiak, gjë që në muajt në vazhdim do të shënonte fillimin e tensioneve të dhunshme shoqërore dhe politike. Më 11 maj 1993, FKSH-ja mori emrin Partia Social Demokratike, e udhëhequr nga Petre Roman, ish anëtar i rëndësishëm i KFKSH-së.

Të nderuar qytetarë,
Ne po jetojmë një moment historik. Klani i Çausheskut, që e çoi vendin drejt shkatërrimit, u largua nga pushteti. Ne të gjithë e dimë dhe e pranojmë se fitorja për të cilën i gjithë vendi ynë po gëzohet sot është fryt i shpirtit të sakrificës së masave popullore, të të gjitha kombësive, dhe para së gjithash i të rinjve tanë të guximshëm, që na kthyen, me çmimin e gjakut të tyre, ndjenjën e dinjitetit kombëtar. Mirënjohje të veçantë shprehim për ata që kanë rrezikuar jetët e tyre për vite me radhë duke protestuar kundër tiranisë.

Në jetën politike dhe ekonomike të Rumanisë fillon një faqe e re.

Në këtë moment me rëndësi të madhe, ne kemi vendosur të krijojmë Frontin Kombëtar të Shpëtimit, që mbështetet tek ushtria rumune dhe bashkon të gjitha forcat progresive të vendit, pavarësisht kombësisë së tyre, të gjitha organizatat dhe grupet që u krijuan për të mbrojtur lirinë dhe dinjitetin gjatë viteve të tiranisë së egër.

Nga ky moment dhe në vazhdim, të gjitha strukturat e pushtetit të klanit të Çausheskut janë të shpërbëra. Qeveria është shkarkuar; Këshilli Shtetëror dhe institucionet e tij ndërpresin tërësisht veprimtarinë. I gjithë pushteti i popullit do të merret nga Këshilli i Frontit Kombëtar të Shpëtimit. Këshilli i Lartë Ushtarak, që bashkërendon veprimtarinë e ushtrisë dhe njësive të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është në varësi të tij. Të gjitha ministritë dhe organet qendrore në strukturën e tyre të tanishme do të vazhdojnë veprimtarinë normale, nën varësinë e Frontit Kombëtar të Shpëtimit, për të garantuar zhvillimin normal të gjithë jetës ekonomike dhe shoqërore. […]

Fronti parashtron axhendën e mëposhtme:

1. Shfuqizimi i sistemit njëpartiak dhe vendosja e sistemit qeveritar pluralist demokratik.
2. Organizimi i zgjedhjeve të lira në prill.
3. Ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në vend, dhe zgjedhja e të gjithë udhëheqësve për një, ose të shumtën, dy mandate. Askush nuk mund të pretendojë pushtet gjatë gjithë jetës. [...]

Adevărul-ziar al Frontului Democratic Român din Arad, 23 dhjetor 1989, fq. 1.

I-8. Thirrja e Timishoaras (11 mars 1990)

"Thirrja e Timishoaras" ishte thirrja më e hershme dhe më radikale për lustracionin në shoqërinë rumune post-komuniste, dhe mbetet_një pikë referimi për alternativat politike anti-komuniste. Teksti me trembëdhjetë pika, kritikonte gjithashtu qeverinë e Frontit Kombëtar të Shpëtimit.

[…] 7. Timishoara filloi revolucionin kundër regjimit komunist dhe kundër *nomenklaturësa* së saj, dhe jo vetëm për ofrimin e një mundësie për krijimin e një grupi disidentësh kundër Çausheskut brenda Partisë Komuniste Rumune (PKR). Prania e tyre në udhëheqjen e vendit e bën të pavlerë vdekjen e heronjve të Timishoaras. Ne mund t'i kishim pranuar ata dhjetë vite më parë nëse, në Kongresin e 12-të të Partisë, ata do i ishin bashkuar Konstandin Parvuleskut dhe do të rrëzonin klanin diktatorial. Por, ata nuk e bënë këtë edhe pse e kishin mundësinë dhe funksionet e rëndësishme që iu dhanë atyre pushtet dhe mjete. Por ndodhi krejt e kundërta, disa prej tyre iu bindën urdhrit të diktatorit për t'iu kundërvënë disidentëve. Frika e tyre në vitin 1979 na kushtoi edhe dhjetë vite më shumë diktaturë, që në fakt ishin vitet më të vështira të të gjithë periudhës, dhe një gjenocidi të dhimbshëm.

8. Duke marrë shkas prej paragrafit të mësipërm, ne propozojmë që ligji zgjedhor duhet të mos pranojë, për tre mandate të njëpasnjëshme, të drejtën e ish-aktivistëve komunistë dhe ish-oficerëve të Sigurimit të kandidojnë për poste. Prania e tyre në jetën politike të vendit është burimi kryesor i tensionit dhe dyshimeve që shkaktojnë sot trazira në shoqërinë rumune. Deri në stabilizimin e situatës dhe arritjen e bashkimit kombëtar, mospjesëmarrja e tyre në jetën publike është plotësisht e nevojshme. Ne kërkojmë gjithashtu që ligji zgjedhor të përmbajë një paragraf të veçantë sipas të cilit ish- aktivistët komunistë nuk mund të lejohen të kandidojnë për president. Presidenti i Rumanisë duhet të jetë një prej simboleve të ndarjes sonë nga komunizmi. Fakti se ke qenë anëtar i Partisë Komuniste të Rumanisë në vetvete nuk është një faj, Ne të gjithë e dimë se deri në çfarë mase jeta e dikujt varej nga tesera e "kuqe" e anëtarësisë në atë kohë, duke filluar që nga arritja profesionale deri te sigurimi i një shtëpie, dhe se cilat ishin pasojat shkatërruese të humbjes së anëtarësisë. Por aktivistët ishin ata persona që braktisën profesionet e tyre për t'i shërbyer partisë komuniste dhe për të përfituar nga përparësitë e veçanta materiale që ajo ofronte. Një person që bëri një zgjedhje të tillë nuk ofron garancitë morale që duhet të ofrojë një president. Duke ndjekur modelin e shumë shteteve të tjera të civilizuara në botë, ne propozojmë pakësimin e privilegjeve të këtij funksioni. Si rrjedhojë, personalitete të rëndësishme të jetës kulturore dhe shkencore pa përvojë të veçantë politike mund të kandidojnë për president të Rumanisë. Në të njëjtin kontekst, ne propozojmë që mandati i parë në detyrë i çdo të zgjedhuri të jetë vetëm dy vite, që është kohë e nevojshme për institucionet demokratike që të forcohen dhe për të qartësuar pozicionin ideologjik të secilës prej partive që u krijuan. Vetëm atëherë ne mund të të bëjmë një zgjedhje më të ndërgjegjshme, duke hapur kartat mbi tavolinë. […]

România liberă, 20 mars 1990, fq. 3.

1. Cilat janë elementet e përbashkëta të partive politike të krijuara së fundmi në shtetet ish socialiste/komuniste të Ballkanit që shprehen në thirrjet dhe programet e tyre politike gjatë procesit të zgjedhjeve të para të lira?
2. Ku përqendrohen kryesisht ata dhe çfarë iu premtojnë qytetarëve?
3. Si ishin transformuar ish partitë e sundimit komunist?

I.3. SHPALLJA E PAVARËSISË

Jugosllavia socialiste ndryshoi disa herë rendin kushtetues (Kushtetuta e vitit 1946, Ligji Kushtetues i vitit 1953, Kushtetuta e vitit 1963 dhe Kushtetuta e vitit 1974). Të gjitha këto kushtetuta përmbanin të drejtën për vetëvendosje, përfshirë të drejtën e ndarjes, por kurrë nuk u ra dakord se si republikat e veçanta do ta ushtronin këtë të drejtë dhe kurrë nuk u miratua një ligj për këtë qëllim. Avokatët e orientuar drejt centralizimit ranë dakord se e drejta e vetëvendosjes, që ishte përfshirë në një vendim të miratuar nga përfaqësuesit e popujve jugosllavë që votuan për një Jugosllavi federale në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (AVNOJ) në qytetin boshnjak të Jajcës, më 29 nëntor 1943, e kishte ezauruar funksionin e saj njëherë e mirë. Kushtetuta e vitit 1974 iu dha Republikave shumë të drejta (tiparet e përbashkëta ishin një treg i vetëm jugosllav që nuk funksiononte mirë, politikë fiskale dhe tradita të përbashkëta, politikë e jashtme dhe të mbrojtjes). Të dyja krahinat, ajo e Kosovës dhe Vojvodinës ishin pjesë e Serbisë, dhe në të njëjtën kohë, secila ishte një "element federal përbërës". Kjo nënkuptonte se ato kishin organet e tyre (Asambleja dhe Qeveria) dhe përfaqësues të drejtpërdrejtë në organet federale, dhe se Serbia nuk mund t'i ndryshonte ligjet, që

mund të paragjykonin marrëdhëniet ndëretnike, pa miratimin e asambleve krahinore. Pakicat kombëtare u mbrojtën nga kushtetutat federale ose republikane, por ata nuk kishin të drejtën për vetëvendosje dhe ndarje (për shembull, shqiptarët në Kosovë). Serbët në Kroaci nuk kanë statusin e pakicës sipas kushtetutës së Kroacisë të vitit 1974, e cila e përcakton atë si më poshtë: "Republika Socialiste e Kroacisë është shteti i popullit kroat, popullit serb dhe shteti i kombeve dhe kombësive të tjera që jetojnë në të."

Rendi kushtetues i Jugosllavisë filloi të shembej në mars të vitit 1989, kur Serbia ndryshoi Kushtetutën e saj duke shfuqizuar shumicën e të drejtave të krahinave autonome (megjithëse ato mbajtën pozicionin e tyre në Federatë, duke qenë se presidenti serb Millosheviç, së bashku me Republikën e Malit të Zi, presidenti i të cilit ishte besnik i tij, mund të mbështeteshin te katër nga tetë votat në Presidencën Federale). Më vonë, në shtator të vitit 1989, Sllovenia e ndryshoi gjithashtu kushtetutën e saj për mbrojtjen e saj ligjore nga paraqitja e gjendjes së emergjencës, si edhe forcimin e shtetësisë kundrejt Federatës. Në dhjetor të vitit 1990, Sllovenia organizoi një referendum ku shumica e votuesve votuan për Sllovenínë sovrane dhe të pavarur, e cila do të arrihej brenda gjashtë muajve (pavarësia u shpall në qershor të vitit 1991). Veprimet e Sllovenisë u ndoqën nga ato të Kroacisë. Ajo ndryshoi kushtetutën e saj në vitin 1990, duke i përjashtuar serbët e republikës nga statusi i kombit përbërës dhe duke i përcaktuar ata si pakicë. Sipas ndryshimeve, Republika e Kroacisë ishte një shtet i popullit kroat dhe i pjesëtarëve të pakicave që janë qytetarë të tij: serbë, myslimanë, sllovenë... Përgjigja e serbëve ishte shpallja e rajoneve autonome, mbajtja e referendumeve dhe kryengritjet. Kjo nënkuptonte gjithashtu fundin e rendit kushtetues jugosllav. Kur Sllovenia shpalli pavarësinë, serbët deklaruan se vendimi i saj për t'u shkëputur ishte e drejta e saj në parim, por kjo dhe kufizimet financiare për të do të vendosen nga ligji federal. Pikëpamja e Sllovenisë ishte se duke qenë se Jugosllavia ishte krijuar mbi bazën e një marrëveshjeje reciproke të popullit të saj, e njëjta gjë duhej të ndodhte edhe për shkëputjen e saj. Në fund të vitit 1991, Komisioni Badinter, i krijuar nga Komuniteti Evropian (më vonë, BE) deklaroi se shteti nuk ekzistonte më dhe si rrjedhojë, të gjitha njësitë e tij përbërëse kishin mundësi të kërkonin pavarësinë e tyre. Ai komision deklaroi se Jugosllavia ishte shpërbërë dhe BE-ja duhet t'i njihte si shtete të pavarura, ato republika që kërkonin njohjen dhe që përmbushnin kushtet e nevojshme, dhe se pasuritë e përbashkëta dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga RFSJ-ja do të ishin subjekt i marrëveshjeve pasardhëse. Pjesa e mbetur e Jugosllavisë, që përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi dhe e quajtura Republika Federale e Jugosllavisë, nuk u bënë automatikisht pasuese të ish RFSJ-së (siç ishte rasti i Rusisë dhe Bashkimit Sovjetik) në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo u zbatua edhe për anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, që duhej ta kërkonte si të gjitha ish republikat e tjera.

I-9. Shpalljet e pavarësisë nga republikat dhe krahinat autonome të ish Jugosllavisë Socialiste.

DATA	SHTETI
25 qershor 1991	Kroacia
25 qershor 1991	Sllovenia
8 shtator 1991	Maqedonia
1 mars 1992	Bosnjë-Hercegovina
3 qershor 2006	Mali i Zi
17 shkurt 2008	Kosova

I-10. Kushtetuta e re e Serbisë, 1990

Sipas Kushtetutës së vitit 1974, Republika e Serbisë, dhe krahinat e saj si krahina autonome e Vojvodinës dhe krahina autonome e Kosovës dhe Metohisë, praktikisht gëzuan të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë të Federatës. Gjatë asaj kohe, udhëheqja shtetërore serbe i kishte në juridiksion krahinat vetëm për çështjen e mbrojtjes kombëtare (JNA, Ushtria Popullore Jugosllave) dhe për problemet financiare. Më 28 mars 1989, udhëheqja serbe miratoi ndryshime në Kushtetutën e Serbisë. Ajo ditë është shënuar si data e shpalljes së kushtetutës së re dhe e

→

rikthimit në Republikën e Serbisë të sovranitetit shtetëror dhe kushtetues mbi të gjithë territorin. Krahinat u zhveshën nga të gjitha funksionet e shtetësisë dhe kompetencat e tyre u konsideruan të pakësuara. Kushtetuta e re e Serbisë u miratua në vitin 1990. Ajo konfirmoi të gjitha vendimet që iua kishin hequr krahinave nga të gjitha funksionet e shtetit.

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SERBISË VI ORGANIZIMI TERRITORIAL

Krahina autonome e Vojvodinës dhe
krahina autonome e Kosovës dhe Metohisë
Neni 108 – Krahinat autonome janë krijuar në përputhje me karakteristikat e veçanta kombëtare, historike dhe kulturore, dhe të tjera të zonave të tyre. […]

Neni 109 – Krahina autonome, nëpërmjet agjencive të saj:

a) do të miratojë një program për zhvillimin ekonomik, shkencor, teknologjik, demografik, rajonal dhe shoqëror, zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, në përputhje me planin e zhvillimit të Republikës së Serbisë, dhe të paraqesë masa për zbatimin e tyre;

b) do të miratojë një buxhet dhe bilanc vjetor; do të marrin vendime dhe miratime të përgjithshme në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, për të zgjidhur çështjet që prekin qytetarët në krahinën autonome lidhur me fushat e: kulturës; arsimit; përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetit të pakicës kombëtare; informimit publik, shëndetit dhe mirëqenies shoqërore; mirëqenies së fëmijës, mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; planifikimit urban dhe rural; dhe në fusha të tjera të përcaktuara nga ligji;

c) do të zbatojë ligjet, rregulloret dhe miratimet e tjera të përgjithshme të Republikës së Serbisë, zbatimi i të cilave iu është besuar agjencive të krahinës autonome, dhe të kalojë rregulloret e nevojshme për zbatimin e tyre, nëse e parashikon ligji; vëzhgojë ekzekutimin e vendimeve të krahinës dhe miratimet e përgjithshme; […]

Krahina autonome do të mbledhë të ardhura siç e parashikon ligji.

Neni 111 – Agjencitë e krahinës autonome të jenë asambleja e saj, këshilli ekzekutiv, dhe agjencitë e administrimit. […]

Neni 112 – Nëse një agjenci e krahinës autonome, pavarësisht lajmërimit të agjencisë republikane përkuese, dështon të ekzekutojë një vendim ose një miratim të përgjithshëm të krahinës autonome, agjencia republikane mund të sigurojë ekzekutimin e drejtpërdrejtë të tij.

Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 1/1990
Ustav Republike Srbije, Službeni glasnik Republike Srbije, broj 1/1990.

I-11. Kushtetuta e Krishtlindjeve në Kroaci

Asambleja Kroate, pak para Krishtlindjeve të vitit 1990, miratoi të ashtuquajturën Kushtetuta e Krishtlindjeve. Megjithëse ishte ende pjesë e Jugosllavisë socialiste, dispozitat e reja kushtetuese zëvendësuan sistemin komunist njëpartiak në Kroaci me demokracinë parlamentare. Problemi lindi për shkak të pozicionit të serbëve, që deri më atë kohë gëzonin statusin e kombit përbërës dhe që tashmë ishin barazuar me atë të pakicës kombëtare, një status që në Jugosllavi iu ishte dhënë bashkësive etnike, shtetet e të cilave ndodheshin jashtë Jugosllavisë. Ndryshimi kushtetues provokoi kryengritjen e serbëve në Kroaci.

Fjalim nga presidenti Tuxhman

[...] 2. Rregullore e pozicionit të ri kushtetues të Kroacisë në Jugosllavi. Nisur nga pikëpamja se vendi ynë është pjesë e Jugosllavisë, që është një anëtar i njohur i bashkësisë ndërkombëtare, ne jemi të përgatitur për të negociuar me përfaqësues të popujve të tjerë të RFSJ-së (Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë) dhe organe federale për rregullimin kontraktual të marrëdhënieve reciproke.

Nisur nga përvoja e përgjithshme historike, ne besojmë se sovraniteti i shtetit të Kroacisë në një bashkësi me popuj të tjerë të RFSJ-së së ditëve të sotme, mund të sigurohet vetëm mbi një themel konfederal, si një aleancë kontraktuale e shteteve sovrane

3. Të qenit pjesë e Evropës dhe evropianizimit të Kroacisë. Paralelisht me transformimin e brendshëm demokratik, duhen marrë të gjitha masat e nevojshme për përfshirjen e Kroacisë në Bashkësinë Evropiane në të ardhmen.

"Vjesnik", 31 maj 1990.

A po e përkrah Tuxhman në fjalimin e tij Kroacinë e pavarur? Si e sheh ai të ardhmen e Jugosllavisë?

I-12. Referendumi për pavarësinë e Sllovenisë, 23 dhjetor 1990



Përkthimi: Toka me katër milionë duar punëtore nuk duhet të ketë frikë për një të ardhme të pavarur.
Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Referendumi u organizua më 23 dhjetor 1990, ku populli sllloven vendosi për shkëputjen nga Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë. Gjatë periudhës parazgjedhore njëmujore, shumë afishe i drejtoheshin popullit sllloven, duke përfshirë thirrje patriotike.

Çfarë mesazhi është paraqitur në afishen "Katër milionë duar pune"? Çfarë imazhi të Sllovenisë promovon ajo?

I-13. Referendumet në Bosnjë-Hercegovinë

"Deklarata e Sovranitetit dhe Pandashmërisë së Republikës së Bosnjë-Hercegovinës", e propozuar nga Partia Boshnjake e Veprimit Demokratik (SDA) më 27 shkurt 1991, nuk u pranua nga Partia Demokratike Serbe (SDS). Disa muaj më vonë, më 24 dhjetor 1991, u krijua Asambleja e popullit serb në Bosnjë-Hercegovinë, dhe ky organ vendosi të mbajë një referendum më 9 dhe 10 nëntor 1991. Me një

shumicë dërrmuese, u votua për të krijuar Republikën e Pavarur Serbe brenda kufijve të Bosnjë-Hercegovinës, për të qëndruar në RFSJ (Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë). Qeveria e Sarajevës nuk e njohu rezultatin e referendumit. Më 18 nëntor 1991 në Grude (Hercegovinë), Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) miratoi një vendim për krijimin e Bashkësisë Kroate të Herceg-Bosnjës dhe vendosi të mbështeste pavarësinë e Bosnjë-Hercegovinës. Megjithatë, Komisioni Badinter (shihni vëll. 2, kap. III.2.2) ka rekomanduar se mbajtja e një referendumi do të ishte parakusht për njohjen ndërkombëtare të Bosnjë-Hercegovinës si shtet i pavarur. Vendimi për të organizuar një referendum u miratua nga Asambleja e Republikës Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës (RSBH) më 25 janar 1992, por pa marrëveshje me partinë serbe (Partia Demokratike Serbe SDS) – do të thotë nëpërmjet fitores me votë të partive të boshnjako-myslimanëve dhe partisë së kroatëve. Ligjshmëria e organizimit të referendumit u vu në dyshim nga pjesa serbe bazuar në ndryshimin kushtetues nr. 70, që ishte miratuar në vitin 1990. Në të njëjtin kontekst, serbët vendosën të shpallin Republikën Serbe të Bosnjë-Hercegovinës (9 janar 1992). Si përfundim referendumi u mbajt më 29 shkurt dhe 1 mars 1992: 62.68% e qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës, kryesisht myslimanë dhe kroatë, votuan pro pyetjes: "A jeni ju për shtetin sovran dhe të pavarur të Bosnjë-Hercegovinës me qytetarë dhe kombe të barabarta të Bosnjë-Hercegovinës, si myslimanë, serbë dhe kroatë, dhe pjesëtarë të kombeve të tjera që jetojnë në të?" Ligjshmëria e rezultateve u vu gjithashtu në dyshim nga pjesa serbe, duke qenë se pjesëmarrja në referendum nuk arriti dy të tretat e kërkuara nga kushtetuta. Megjithatë, Komuniteti Evropian e njohu Bosnjë-Hercegovinën si shtet të pavarur dhe sovran më 6 prill
1992. Kjo përkoi me fillimin e bombardimit të Sarajevës dhe luftës së përgjithshme në Bosnjë-Hercegovinë.

A. Ndryshime në Kushtetutën e Bosnjë-Hercegovinës 1990

NDRYSHIMI LX
1. Republika Socialiste e Bosnjë-Hercegovinës është shtet sovran demokratik i qytetarëve të barabartë myslimanë, serbë dhe kroatë të Bosnjë-Hercegovinës dhe pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive që jetojnë në të.

NDRYSHIMI LXII
1. Territori i RSBH-së është një dhe i pandashëm.
Kufijtë e Republikës mund të ndryshohen me vendim të Asamblesë së RSBH-së vetëm në përputhje me vullnetin e gjithë popullit siç shprehet nga të paktën dy të tretat e votuesve të regjistruar në referendum.

NDRYSHIMI LXX
10. Në Asamblenë e RSBH-së (Republikës Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës) do të krijohet një *Këshill* për Problemet dhe Krijimin e *Barazisë* së *Kombeve dhe Kombësive të Bosnjë-Hercegovinës*. Si anëtarë të Këshillit do të zgjidhen një numër deputetësh nga kombësitë e Bosnjë-Hercegovinës, myslimanë, serbë dhe kroatë, dhe një numër i përshtatshëm deputetësh nga kombet dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Bosnjë-Hercegovinë. Këshilli të miratojë vendime bazuar në marrëveshjen e arritur mes anëtarëve që përfaqësojnë të gjitha kombet dhe kombësitë: përbërja, kufijtë e ndikimit dhe punës së Këshillit të përcaktohen me ligj, të miratohen nga një shumicë prej dy të tretash të numrit të përgjithshëm të deputetëve në Asamblenë e RSBH-së. [...]

Me nismën e deputetëve të Asamblesë së RSBH-së, Këshilli të rishikojë çështjen e barazisë së kombeve dhe kombësive. Nëse të paktën 20 deputetë besojnë se një rregullore e propozuar apo miratime të tjera të Asamblesë së RSBH-së bien ndesh me barazinë e kombeve dhe kombësive, Këshilli të hartojë një propozim i cili të votohet nga Asambleja e RSBH-së.

Me propozim të Këshillit, çështjet e interesit për barazinë e kombeve dhe kombësive të Bosnjë-Hercegovinës të caktohen nga Asambleja e RSBH-së sipas një procedure të veçantë të përcaktuar në Rregullat e Procedurës së Asamblesë së RSBH-së, me një shumicë prej dy të tretash të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

"Fletorja Zyrtare e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës", Viti XLVI, Nr. 21 E martë, 31 korrik 1990.

B. Karikaturë lidhur me mëdyshjen për pavarësinë



Unë nuk e di nëse Bosnja do të jetë autonome, e varur apo e pavarur, por e di se do të jetë E URITUR.
Oslobođenje, Sarajevë, 3. 02. 1992, fq. 2.

C. Deklarata e Sovranitetit dhe Pandashmërisë Shtetërore të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës (Sarajevë, 27 shkurt 1991)

1. Republika e Bosnjë-Hercegovinës të jetë shtet demokratik sovran, i bashkuar dhe i pandashëm i të gjithë qytetarëve të tij, i themeluar mbi liritë dhe të drejtat e popullit dhe qytetarëve, shtetin e së drejtës dhe drejtësisë sociale.

2. Kufijtë e Bosnjë-Hercegovinës të mbeten të pandryshueshëm.

3. Sovraniteti të jetë e drejtë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, e ushtruar nëpërmjet një referendumi ku merr pjesë i gjithë populli dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me vullnet të lirë. […]

5. Sistemi kushtetues i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës të krijohet mbi garancitë dhe barazinë e të gjitha formave të pronësisë, ushtrimin dhe garantimin e lirisë, barazitarizmin, barazinë etnike dhe të tjera, dhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe ato civile, sistemin politik shumëpartiak dhe demokracinë parlamentare, shtetin e së drejtës dhe ruajtjen dhe promovimin e natyrës dhe mjedisit. […]

6. Për të zgjidhur krizën jugosllave mbi parimet e barazisë, sipas një mënyre paqësore dhe demokratike, qytetarët, kombet dhe kombësitë e Bosnjë-Hercegovinës janë të vendosur për të mbrojtur jetesën e tyre paqësore, së bashku me sovranitetin, pandashmërinë dhe integritetin territorial të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës.

Skupština Republike Bosne i Hercegovine, 1996, fq. 30-32.

D. Karikaturë e ndarjes etnike të Bosnjë-Hercegovinës para referendumit



Oslobođenje, Sarajevë, 24.02.1992, fq. 6.

E. Deklarata e shpalljes së Republikës së popullit serb të Bosnjë-Hercegovinës (Sarajevë, 9 janar 1992)

1. Në vijim të referendumit të mbajtur më 9 dhe 10 nëntor 1992, ku populli serb votoi për të qëndruar në shtetin e përbashkët të Jugosllavisë, REPUBLIKA E POPULLIT SERB TË BOSNJË-HERCEGOVINËS u themelua dhe u shpall në zonat e rajoneve dhe rretheve autonome serbe, grupe të tjera etnike serbe në Bosnjë-Hercegovinë, përfshirë zonat ku populli serb është pakicë për shkak të gjenocidit të kryer kundër tij gjatë Luftës së Dytë Botërore.

2. Republika është pjesë përbërëse e shtetit federal të Jugosllavisë si një prej njësive të saj federale.

3. Demarkacioni territorial me bashkësitë politike të popujve të tjerë të Bosnjë-Hercegovinës, dhe zgjidhja e të drejtave dhe detyrimeve reciproke të arrihet në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje, duke respektuar kriteret etnike, historike, ligjore, kulturore, ekonomike, gjeografike dhe të komunikimit, edhe kritere të tjera të rëndësishme, si dhe duke respektuar parimet dhe shtetin ndërkombëtar të së drejtës. […]

5. Kushtetuta e Republikës të garantojë të drejta të plota të barabarta dhe barazi, dhe të mbrojë me ligj popujt dhe qytetarët nga çdo lloj diskriminimi. […]

9. Organet e qeverisë së ish RSBH-së të përfaqësojnë organet e përbashkëta të bashkësive kombëtare

gjatë periudhës tranzitore deri në demarkacionin territorial përfundimtar dhe zgjidhjen e të drejtave dhe detyrimeve të tjera.

Gjatë periudhës tranzitore, organet e përbashkëta të miratojnë me konsensus vendimet dhe ligjet e nevojshme.

10. Kjo Deklaratë hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe zbatimi i saj të bëhet që nga dita e njohjes së pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës. Zbatimi i Deklaratës të shtyhet për një periudhë kohore të pacaktuar me kushtin që ata që dorëzuan kërkesën për njohje të pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës të tërheqin kërkesën e mësipërme deri më 15 janar 1992.

"Fletorja Zyrtare e Popullit Serb në Bosnjë-Hercegovinë", viti I, nr. 1, 15 janar 1992, fq. 9-11.

I-14. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990 dhe shpallja e Republikës së Kosovës

Delegatët shqiptarë të Asamblesë së Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës shpallën Deklaratën Kushtetuese për Republikën e Kosovës më 2 korrik 1990. Kjo ndodhi para godinës së Asamblesë, duke qenë se ata nuk lejoheshin të hynin në Asamble. Më 5 korrik 1990 Asambleja u shpërbë. Në shator të vitit 1991 u mbajt një referendum për pavarësinë e Kosovës.

Bazuar në vullnetin e shprehur qartë në të gjithë Kosovën nga shumica e popullsisë së saj, vullnet që përfshihet edhe në deklaratën ASA të Kosovës për pozicionin e ri kushtetues të saj, si edhe e nxitur nga roli dhe pozicioni i Asamblesë së Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe kushtetues i pushtetit dhe vetëqeverisjes në Kosovë, Asambleja e Kosovës shpall solemnisht:

DEKLARATËN KUSHTETUESE PËR KOSOVËN SI NJËSI E PAVARUR DHE E BARABARTË BRENDA FEDERATËS (KONFEDERATËS) SË JUGOSLLAVISË SI NJËSI E BARABARTË ME NJËSITË E TJERA NË FEDERATË (KONFEDERATË)

1. Kjo Deklaratë shpreh dhe e shpall qëndrimin e vërtetë kushtetues të popullsisë së Kosovës dhe të kësaj Asambleje si një akt të vetëvendosjes politike brenda Jugosllavisë.

2. Ky akt i Asamblesë në shpalljen, brenda kompetencave të saj, e Kosovës si një njësi të barabartë brenda Jugosllavisë, bazuar në parimet e vërteta të respektimit të vullnetit të popullit, është marrë në pritje të konfirmimit të aktit të saj kushtetues si pjesë e Kushtetutës së Jugosllavisë në mbështetje të plotë të bashkësisë demokratike në Jugosllavi dhe bashkësisë ndërkombëtare.

3. Kjo Asamble konfirmon Kosovën dhe pozicionin e saj të ri kushtetues, si një bashkësi të përbashkët politiko-kushtetues dhe pozicionin politiko-kushtetues të qytetarëve dhe kombësive të barabarta të Kosovës, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë së saj dhe një nga popujt më të shumtë në numër në Jugosllavi, të cilët së bashku me serbët dhe të tjerët në Kosovë të konsiderohen më shumë si popull-komb sesa kombësi.

4. Në të njëjtën kohë, deri në zbatimin e saktë ligjor të kësaj Deklarate Kushtetuese, Asambleja dhe autoritetet e Kosovës mbështeten më shumë te Kushtetuta e Jugosllavisë në fuqi, sesa te ndryshimet në Kushtetutën e vitit 1989 të Republikës Socialiste të Serbisë lidhur me pozicionin e Kosovës brenda rendit kushtetues të Jugosllavisë dhe, në këtë rast, vlerësimi i Asamblesë së Kosovës i datës 23 mars 1989 për miratimin e këtyre ndryshimeve anulohet.

5. Asambleja e Kosovës, deri në prezantimin e Kushtetutës së re të Kosovës, të komunikojë publikisht duke përdorur në të njëjtën kohë konfirmimin e emërtimit të bashkësisë sociale dhe politike që tashmë ekziston vetëm si Kosovë.

Prishtinë, 2 korrik 1990.
Delegatët nënshkrues të Deklaratës.

Shumë shpejt Kroacia do të kishte një monedhë të re,

Krahasoni se si përcaktohet pozicioni politik i Kosovës në kushtetutën e Serbisë të vitit 1990 (dok. I-10) dhe në Deklaratën Kushtetuese për Republikën e Kosovës (dok. I-14).

I-15. Reagimet greke për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë



Demonstratë në Selanik, 1994; në parullën kryesore lexohet "Maqedonia është Greqi".
Gazeta "*To Vima*", 15 gusht 2014, http://www.tovima.gr/books-ideas/article/?aid=623345, vizituar më 20.03.2016.


Pavarësia e Republikës Socialiste të Maqedonisë nga Jugosllavia federale dhe deklarata e pavarësisë së saj si "Republika e Maqedonisë" në shtator të vitit 1991 (shihni dok. I-6D) provokoi reagime të menjëhershme të qytetarëve grekë si brenda ashtu edhe jashtë kufirit të Greqisë. U organizuan demonstrata masive; u shtuan botimet për greqizimin e Maqedonisë nga periudha antike; në vende turistike u shitën pulla, monedha dhe sende personale të ngjashme; aeroporteve dhe departamenteve qeveritare iu vunë emra të rinj nga e kaluara maqedonase greke; ndërsa në nivel politik, jo vetëm qeveria e krahut të djathtë e asaj kohe, por edhe pasueset e saj, kanë vënë veton e tyre për përfshirjen e shtetit të ri si anëtar në organizata ndërkombëtare me emrin "Republika e Maqedonisë".

1. Përse mendoni se kishte një reagim të tillë në Greqi pas deklarimit të pavarësisë së "Republikës së Maqedonisë"? Çfarë nënkupton emri "Maqedoni" për të dyja shtetet dhe si është përdorur ai? Krahasojeni gjithashtu me I-18.
2. Bëni kërkime se si mosmarrëveshjet për përdorimin e emrit janë pasqyruar në fushat e arsimit dhe historisë publike në të dyja vendet: kurrikula, tekstet shkollore, fletushka propagandistike, harta, histori publike dhe arsim, etj

I.4. SIMBOLE TË REJA, MONEDHA TË REJA, FLAMUJ TË RINJ

Shtetet që dolën nga blloku i vendeve socialiste vijuan të hiqnin dhe ndryshonin gjithçka që lidhej me socializmin, duke filluar me emrat dhe simbolet e tyre. Shtetet e formuara në territorin e ish-Jugosllavisë paraqitën simbole të reja (stema dhe flamuj), monedha, dhe madje edhe himne kombëtare. Ndonjëherë, këto simbole, siç ishte rasti i flamujve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës, ishin krijuar dhe zhveshur nga ndonjë kontekst historik me kërkesë të bashkësisë ndërkombëtare, me qëllim shmangien e mosmarrëveshjeve ndëretnike. Shumica e shteteve të reja, tashmë kanë rikthyer traditat e tyre historike të vërteta ose imagjinare, si stemat mesjetare (për shembull, Serbia filloi të përdorte stema të ish-Mbretërisë së Serbisë), ose stema të reja që bazohen te traditat e tyre historike. Megjithatë, kjo ka provuar se ka qenë shkak për mosmarrëveshje: një shembull i tillë është ai ndërmjet Austrisë (Krahina e Karinthias) dhe Sllovenisë për shkak të përdorimit nga ana e sllovenëve të simbolit mesjetar të gurit të Princit si simbol të shtetësisë së tyre mesjetare. Që prej shpalljes së pavarësisë, Sllovenia e përdori atë fillimisht në obligacionet e saj (shihni dok. I-21) dhe më pas në monedhën në euro prej dy centësh. Për këtë arsye, guvernatori i Karinthias, Haider, e kishte zhvendosur gurin e Princit nga Muzeu Krahinor në Klagenfurt në Parlamentin Krahinor. Një mosmarrëveshje tjetër më serioze në lidhje me përdorimin e simboleve vazhdon edhe në ditët e sotme ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Greqisë (shihni dok. I-18).

I-16. Nga Jugosllavi në shtete kombëtare. Karikaturë nga Jugoslav Vlahoviç



JUGOSLAV, Karikature Yugoslav Vlahovic, publikuar nga Nip Knjizevine Novine dhe NIN, Beograd 1991.

Përshkruani karikaturën. Çfarë simbolizon ngjyra e kuqe që hyn në makineri? Gjeni ndërmjet simboleve shtetërore të ish Jugosllavisë,
republikat, stemat e të cilave kanë fusha me kuadrate me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë (shihni gjithashtu dok. I-19). A mendoni se qëndrimi i autorit ndaj krijimit të shteteve të pavarura në territorin e Jugosllavisë është pozitiv apo negativ?

I-17. Prezantimi me *dinarin* maqedonas, 1992

Republika e Maqedonisë u bë e pavarur në aspektin monetar më 26 prill 1992, me miratimin e Ligjit për Monedhën. Emri i monedhës maqedonase, ***denari***, u propozua nga Petar H. Ilievski, filolog klasik dhe studues i historisë mikenase, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë. Emri vinte nga monedha e argjendtë romake ***denarius***. Këshilli i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë bëri një thirrje të hapur për një konkurs anonim për të projektuar denarin. Sipas kërkesave të konkursit, modelet për ***denarin*** maqedonas ishin për të pasqyruar momentet historike të pavarësisë të shtetësisë së vendit, si tipare nga e kaluara historike dhe kulturore e Republikës së Maqedonisë, gjurmët e saj natyrore, ekonomike dhe arkitekturore, florën dhe faunën e saj, etj. Nga shtatë modelet e paraqitura në konkursin anonim, juria përzgjodhi unanimisht modelin e paraqitur nga krijuesi me pseudonimim "Dorian".



Kartëmonedha ***20 denarë*** tregon hamamet e Daut Pashës në hyrje të qytetit të vjetër të Shkupit, të ndërtuara në gjysmën e dytë të shekullit të 15-të.
Në vitin 1948, hamamet u restauruan dhe u përshtatën me funksionin e tyre të ri, si galeri arti.



Kartëmonedha ***100 denarë*** tregon Katedralen e Shën Sofisë në Ohër, të ndërtuar në shekullin e 11-të. Afresket dhe arkitektura e kësaj katedraleje renditen ndër
perlat e artit bizantin në periferi të Perandorisë. Ruajtja dhe pastrimi i afreskeve, si edhe restaurimi i një prej mureve të kishës, kishin filluar që në vitin 1949. Dhjetë vite më vonë përfundoi puna restauruese mbi afresket dhe kishës iu rikthye pamja origjinale.

I-18. Flamuri i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë

Greqia e kundërshtoi simbolin e zgjedhur për flamur nga njësia e re ndërkombëtare që mbajti "Republika e Maqedonisë"
pas daljes nga ish-federata socialiste e Jugosllavisë. Përplasjet e forta për flamurin ndërmjet dy shteteve zgjatën nga viti 1992 deri në vitin 1995. Sipas arkeologut grek Manolis Andronikos, që kishte zbuluar sarkofagun dhe varrin që e mbante atë sarkofag në Vergina (Greqi) në vitin 1977, simboli i quajtur "ylli Vergina" nga pala greke dhe "dielli Kutlesh" nga pala tjetër, ishte një simbol i dinastisë antike maqedonase. Gjatë dekadave të shkuara, ky "yll" ose "diell" ishte trajtuar nga shumë persona në të dyja shtetet si pjesë e historisë së tyre etnike dhe kombëtare përkatëse, gjë që çoi në akuza reciproke për përvetësim të historisë. Banorët në diasporat e të dyja shteteve, veçanërisht në Australi dhe Amerikën e Veriut, ishin veçanërisht aktivë në këtë përplasje. Në vitin 1995, flamuri ndryshoi në përputhje me Marrëveshjen e Përkohshme ndërmjet Greqisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (shihni vëll. 2 dok. III-15).

A. Flamuri i parë, 1992



B. Flamuri i dytë, 1995





I-19. Kroacia: flamujt dhe stemat



Vini re ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet dy stemave.

I-20. Monedha kroate: *kuna*

Pasi u shkëput nga Jugosllavia dhe u bë shtet i pavarur, Kroacia u përpoq gjithashtu të arrinte pavarësinë monetare. Që në fillim të vitit 1991, monedha zyrtare jugosllave, ***Dinari***, u zëvendësua përkohësisht nga ***dinari*** kroat. Në maj të vitit 1994, ***kuna*** u bë njësia monetare zyrtare e Kroacisë. Megjithatë, i njëjti emër, ***kuna***, ishte përdorur për monedhën në shtetin e pavarur të Kroacisë gjatë periudhës së luftës, nga viti 1941 deri në vitin 1945, dhe kjo ishte edhe arsyeja se përse emri i zgjedhur për monedhën e shtetit të ri shkaktoi shumë polemika.

kunën. Protestat publike të organizuara herë pas here kundër prezantimit të saj ishin shumë të pafuqishme.

Politikanët e opozitës që mendohej se do thoshin diçka qëndruan në heshtje, sipas praktikës së tyre të zakonshme. Figurat e pakta publike që thanë diçka nuk u dëgjuan mjaftueshëm ose nuk u dëgjuan fare. [...] Arsyet për heshtjen e tyre lidhen pjesërisht me oportunizmin dhe pjesërisht me dështimin për të kuptuar se çfarë nënkuptonte vërtetë përdorimi i monedhës *kuna*.

Me shpalljen e *kunës* si monedhë të saj, Republika e Kroacisë kishte bërë identifikimin e saj më të fortë me regjimin e Ustashëve. Kroatët kanë ende një tjetër çështje që mund të shkaktojë mosmarrëveshje gjatë viteve në vijim (sepse, siç duket, shumë prej tyre e kanë të pamundur të heshtin dhe nuk do ta bëjnë një gjë të tillë), diçka që do t'i ndajë ata në dy kampe të papajtueshme. Të huajt do të përgojojnë sërish faktin se prirjet profashiste në vend po bëhen më të forta dhe në këtë sens Kroacia ka kontribuar me dëshirë. Duke qenë se ishte vetë presidenti Tuxhman ai që këmbënguli fuqishëm për futjen në qarkullim të *kunës*, të gjitha pretendimet për simpati ndaj antifashizmit, të cilat ai i shfaqi në shumë raste, e kishin humbur plotësisht besueshmërinë.

Për një dorë kuna,
"Feral tribune", 30 maj 1994.

I-21. *Tolari* slloven

Në tetor të vitit 1991, parlamenti slloven miratoi monedhën e re, ***tolarin*** slloven. Megjithatë, duke qenë se këto kartëmonedha nuk ishin printuar ende, më 9 tetor 1991 hynë në qarkullim kartëmonedha pa emër. Motivet në këto kartëmonedha krijuan shqetësim te disa shtete të tjera, pasi ato mbanin imazhin e gurit të Princit, që shfaqej si simbol i Sllovenisë në mitologjinë sllovene. Megjithatë, simboli ishte përdorur edhe nga austriakët dhe pjesërisht nga sllovakët. Këto kartëmonedha u përdorën deri në vitin 1994, kur ato u zëvendësuan përfundimisht me kartëmonedhat ***tolar***.

I-22. Ndryshimi i pushimeve zyrtare: nga





Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

A gjeni ndonjë ngjashmëri ndërmjet kësaj historie dhe historisë për flamurin maqedonas?

RFSJ në shtetet e reja

A. Pushimet e reja zyrtare në Serbi

Pushimet zyrtare në Serbi, pësuan një ndryshim të madh gjatë periudhës postko-muniste, kur shumë pushime nga periudha e Jugosllavisë Socialiste u zëvendësuan me pushime të reja, "më të rrënjosura në tradita". Një shembull i mirë i këtij "rikthimi te tradita" është dita e re e shtetësisë në Serbi. Pas 5 tetorit të vitit 2002, Serbia miratoi ditën e Sretenje që është dita e Candlemas, ose e Prezantimit të Krishtit në Tempull, si edhe ditën kur filloi Kryengritja e Parë Serbe (1804) dhe kur u miratua Kushtetuta e parë Serbe (1835). Është mëse e qartë se qeveria postkomuniste donte t'i ndërpriste lidhjet në mënyrë simbolike me shtetin e mëparshëm, duke krijuar një lidhje ndërmjet kremtimeve fetare ortodokse dhe rrënjëve historike të shtetësisë serbe. Si rrjedhojë, pushimet kombëtare kanë një mbështetje të fortë fetare dhe janë shembull i mirë i ripërtëritjes së traditave të shoqërisë serbe, që bën një kontrast të fortë me periudhën e Jugosllavisë Socialiste.

Ndryshimi i pushimeve zyrtare nga RFSJ-ja te Serbia

DATA	RFSJ (Republika Socialiste		SERBI	
	DITË PUSHIMI	DITË PUNE	DITË PUSHIMI	DITË PUNE
1 janar	Viti i Ri		Viti i Ri	
7 janar			Krishtlindjet Ortodokse	
14 janar				Viti i Ri Ortodoks
27 janar				Dita e Shën Savës
15 shkurt			Dita e Shtetësisë (përkujtimi i Kryengritjes së Parë Serbe në vitin 1804, dhe kushtetutës së parë serbe të vitit 1835) festohet që prej vitit	
8 mars		Dita Ndërkombëtare e Grave		
22 prill				Dita e Përkujtimit të
1 maj	Dita e 1 majit		Dita e 1 majit	
9 maj		Dita e Fitores (1945)		Dita e Evropës / Dita e Fitores
13 maj		Dita e Shërbimeve dhe Organeve të Sigurimit		
15 maj		Dita e Fitores në Jugosllavi		
21 maj		Dita e Forcave Ajrore		
25 maj		Ditëlindja e Marshall Titos Dita e të Rinjve		
28 qershor				Dita e Shën Vitus
4 korrik	Dita e Luftëtarëve (1941, kryengritja kundër pushtimit			
7 korrik	Dita e kryengritjes në Republikën			
21 tetor				Dita e Përkujtimit të Viktimave të
7 nëntor		Dita e Revolucionit të Tetorit		
11 nëntor			Dita e Armëpushimit (Lufta e Parë Botërore, 1918)	
29 nëntor	Dita e Republikës			
22 dhjetor		Dita e Ushtrisë së Popullit		
25 dhjetor				Krishtlindjet (Kalendari gregorian)

Studioni tabelën ku paraqiten pushimet e ndryshme zyrtare në Serbinë socialiste dhe postsocialiste. Deri në çfarë pike mund të përcaktoni ndryshimet më të rëndësishme? Jepni shpjegimet e mundshme në lidhje me këtë.

B. Pushimet zyrtare në Bosnjë-Hercegovinë

Bosnjë-Hercegovina nuk ka të njëjtat pu-shime në të gjithë territorin. Në kantonet e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës me shumicë boshnjake, 25 nëntori festohet si Dita Ndërkombëtare 1 marsi festohet si Dita e Pavarësisë. Në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës me shumicë kroate, ata festoj-në jozyrtarisht 18 Nëntorin si Ditën e krijimit të Bashkësisë Kroate të Herceg-Bosnjës. Në Republikën Srpska ata festojnë 9 janarin si Dita e Republikës Srpska, dhe 21 nëntori festohet si Dita e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Daytonit. Ditët e zakonshme pushim zyrtar në Bosnjë-Hercegovinë janë Viti i Ri (1 dhe 2 janar) dhe 1 maji – Festa e punëtorëve.

Ndarjet etnike lidhur me festimin e pushimeve

DATA	FEDERATA Shumica mys-limane	REPUBLIKA SRPSKA	FEDERATA Shumicë kroate
1 janar	Viti i Ri	Viti i Ri	Viti i Ri
9 janar		Dita e Republikës Srpska (1992)	
1 mars	Dita e Pavarësisë (1992)		
1 maj	Dita e majit	Dita e majit	Dita e majit
18 nëntor			Dita e Bashkësisë Kroate të Herceg-Bosnjës (1991)
21 nëntor	Dita e Nënshkrimit të Mar-rëveshjes së Daytonit	Dita e Nënshkrimit të Mar-rëveshjes së Daytonit	Dita e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Daytonit (1995)

Pse ka pushime të ndryshme kombëtare për bashkësitë etnike në Bosnjë-Hercegovinë pas shpalljes së pavarësisë?

Diskutoni mungesën e një pushimi kombëtar të përbashkët dhe kuptimin e "festimit" të Marrëveshjes së Daytonit.

I-22. Mosmarrëveshja për simbolet në Universitetin e Qipros zbulon kundërshti në lidhje me identitetin - 1996

Disa vite pas themelimit të Universitetit të Qipros lindi një diskutim lidhur me karakterin e tij, që është tregues i proceseve politike brenda bashkësisë greko-qipriote. Mos-marrëveshja për të valëvitur flamurin qipriot apo grek në universitet, ishte një zgjatim i debatit për identitetin e qipriotëve grekë.

A. Opinion prej eksperti i Prokurorit të Për-gjithshëm të Republikës së Qipros lidhur me flamurin e Universitetit të Qipros

Universiteti e ka detyrim që të ngrejë çdo ditë flamurin e Republikës së Qipros. Ai ka të drejtën të ngrejë çdo ditë flamurin grek. Ai ka të drejtën të ngrejë flamurin qipriot dhe atë grek pranë njëri-tjetri në ditët e pushimeve zyrtare.

Gazeta *"Philelefθeros"*, 12 nëntor 1996.

B. Një koment nga Gazeta *"Simerini"* më 13 nëntor 1996


E gjithë çështja iu la tërësisht në dorë vullnetit të shumicës së studentëve: ata ose do ta mbronin flamurin grek, për të cilin ata vendosën se nuk do të ndaheshin, ose do të ishin dëshmitarë të uljes së tij nën duartrokitjen festuese të kolegëve të tyre në pakicë... Për marrjen e vendimeve të tyre, lërini ata të tregojnë se, 38 vite më parë, disa grupe studentësh duke vepruar me vullnetin e tyre nën shtizën e flamurit, u vetësakrifikuan për ta parë flamurin grek dhe dritën shpirtërore greke që buronte prej tij.

Mavratsas, 1998, fq. 129-130.

Përse kishte debate nëse duhej ngritur flamurin qipriot apo grek në Universitetin e Qipros? Cili identitet kundërshtohej këtu?



281011_WARS-DIVISIONS-INTEGRATION.indd 35 21/10/16 10:40 ก.ย.



KAPITULLI II: SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Hyrje	37
II.1. Rruga drejt shpërbërjes	41
II.2. Luftërat e periudhës 1991-1995	47
II.3 Rrethimi i Sarajevës	60
II.4. Kampet	64
II.5. Luftërat e periudhës 1998-2001	66
II.6. Barbaritë dhe spastrimi etnik	77
II.7. Emigrimet e detyruara dhe refugjatët	80
II.8. Fëmijët dhe të rinjtë gjatë luftës	85
II.9. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore	87
II.10. Kundër luftës	90
II.11. Lufta e gazetarëve	95
II.12. Reagime ndërkombëtare dhe vendeve të Ballkanit	97

HYRJE

Pas vdekjes së Titos, në vitin 1980, Jugosllavia, një vend socialist dhe i paangazhuar, që lëvdohej për kufijtë e saj të hapur dhe një sistem të caktuar shoqëroro-ekonomik të quajtur vetadministrim ose Titizëm (sipas udhëheqësit Josif Broz Tito), degradoi në një krizë shumëplanëshe, që ishte pikësëpari ekonomike dhe politike, dhe më pas ndëretnike. Në mesin e popujve jugosllavë, ideja e "bashkim-vëllazërimit" kishte filluar të venitej, ndërsa nacionalizmi fuqizohej dita-ditës. Lidhja e Komunistëve Jugosllavë u përpoq t'i bënte ballë kësaj situate përmes masave administrative dhe organizimeve të plenumeve ideologjike. Organet e shtypit u "ngujuan" brenda kufijve të republikave përkatëse, së bashku me disa udhëheqës të tjerë të atyre republikave, karriera politike nacionaliste e të cilëve kishte nisur nga fundi i viteve 1980. E gjitha kjo, shërbeu si shtysë për konsolidimin e themeleve nacionaliste të luftës. Çdo komb i Jugosllavisë mendonte se ishte shfrytëzuar dhe privuar nga pikëpamja ekonomike dhe kombëtare. Konfliktet historike ndërmjet serbëve, shqiptarëve dhe kroatëve u ndezën sërish. Në Serbi, Sllobodan Millosheviçi po fuqizohej gjithnjë e më shumë, duke i bashkuar forcat me intelektualët nacionalistë, që këmbëngulnin se të gjithë serbët duhet të jetonin në një shtet të vetëm.

Duke qenë se ata jetonin në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, kjo ide nënkuptonte ndryshimin e kufijve brenda Jugosllavisë, si dhe krijimit të një ekuilibri të ri ndërmjet popujve jugosllavë dhe ndërtimit të Federatës Jugosllave (kritikët e quanin këtë projekt "Serbia e Madhe"). Kjo gjë solli lindjen e konfliktit të parë në vazhdën e një sërë konfliktesh të tjera ndëretnike në Jugosllavi ndërmjet Serbisë dhe Sllovenisë. Konflikti ishte i veçantë në shumë drejtime, pasi nuk zhvillohej ndërmjet popujve, që kishin qenë armiqësorë ndaj njëri-tjetrit në të shkuarën. Ai u shkaktua nga dikotomia ndërmjet një (kon) federate demokratike jugosllave në Evropë, që do të ishte tejet e hapur ndaj botës dhe një federate tejet të përqendruar nën kontrollin e shumicës serbe, me shumë gjasa nën regjimin komunist. Ndërhyrjet ushtarake në Sllloveni nuk u kryen drejtpërdrejtë nga Ushtria e Serbisë, që asokohe nuk ekzistonte, por nga Ushtria Popullore e Jugosllavisë (UPJ). Pas vdekjes së Titos, Ushtria Popullore Jugosllave shihej si mbrojtësja e vetme e Federatëssë Jugosllavisë, e bashkim-vëllazërimit, si dhe Jugosllavisë komuniste. Ajo nuk e njohu autoritetin e presidencës së dyzuar federale, që formalisht ishte autoriteti komandandues më i lartë i ushtrisë. Të gjithë ministrat e mbrojtjes, pa përjashtim, kishin qenë gjeneralë, dhe ushtria luante një rol politik tepër të rëndësishëm.

Lufta dhjetë ditëshe sllovene, që nisi në fund të qershorit dhe përfundoi në fillim të korrikut të vitit 1991, u përkufizua si një ndërhyrje e kufizuar e UPJ-së , fill pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë, dhe synonte të merrte nën kontroll të gjitha pikat kufitare dhe aeroportet në Sllloveni, me arsyetimin se roli i ushtrisë ishte të mbronte unitetin e shtetit jugosllav. Kjo ndërhyrje hasi qëndresën e Mbrojtjes Territoriale të Sllovenisë dhe policisë, që ishin të gatshme ta mbronin shtetin e pavarur të saposhpallur. UPJ-ja, që ishte ende e përzier nga pikëpamja etnike, pasi përbëhej nga ushtarë të kombësive të ndryshme nga të gjitha vendet e Republikës Federative të Jugosllavisë, duke përfshirë edhe sllovenë, ra pre e dezertimit masiv. Oficerët jugosllavë, që kishin jetuar dhe kishin krijuar familjet e tyre në Sllloveni prej disa dhjetëvjeçarësh, gjendeshin përballë një ndërdyshjeje të madhe. Edhe pala sllovene, gjendej përballë ndërdyshjeve psikologjike, pasi ushtarët e saj ishin të papërvojë dhe duhej të luftonin kundër bashkatdhetarëve të tyre, madje edhe kundër sllovenëve.

Kishte ardhur ora që Bashkësia Evropiane të ndërhynte. Nga data 3 deri më 7 korrik të vitit 1991, përfaqësuesit e Sllovenisë, Kroacisë, Qeverisë Federale dhe treshes evropiane, u mblodhën në ishujt Brijuni, ku arritën marrëveshjen për armëpushim dhe për pezullimin e masave të Sllovenisë për pavarësi për tre muaj. Nga fundi i luftës, në vijim të konferencës së pasuksesshme në Jugosllavi dhe nën trysninë e veçantë të Gjermanisë (që në fillim e kishte mbështetur Jugosllavinë, përpara se të ndryshonte mendim), Bashkimi Evropian vendosi t'i njihte si shtete më vete republikat e ish-Jugosllavisë, që kishin shpallur pavarësinë. Shtetet që kishin mbetur nga Jugosllavia, pra Serbia dhe Mali i Zi, formuan një shtet të vetëm që tani më pas u njoh si Republika Federale e Jugosllavisë.

Marrëdhëniet me Kroacinë u përkeqësuan pas zgjedhjeve të para shumëpartiake të mbajtura në prill dhe maj të vitit 1990, kur në pushtet erdhi Bashkimi Demokratik Kroat (BDK) i udhëhequr nga Franjo Tudjman. Qeveria republikane dëshironte ta ndryshonte ekuilibrin eforcave politike në Kroaci sa më shpejt të ishte e mundur, pasiserbët përbënin 14% (580,000) të popullsisë, dhe për arsye historike, kishin ndikim domethënës në politikë, polici dhe agjencitë e zbulimit së shtetit kroat. Gjithashtu, regjimi i ri filloi të ushqente nostalgji ndaj regjimit të Ustashëve të Shtetit të Pavarur të Kroacisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Serbët e Kroacisë nisën një rebelim, që u nxit nga Serbia, përmes furnizimit me armë dhe mbështetjes materiale, pasi ishin kundër synimit të udhëheqjes së re kroate për t'u shkëputur nga Jugosllavia. Tuxhmani u orvat t'i shtypte protestat e tyre përmes ndërhyrjeve policore, që synonin ta vinin territorin që banohej nga shumica serbe plotësisht nën kontroll, por, në verë të vitit 1990, serbët filluan të bllokonin rrugët dhe të formonin të ashtuquajturin rajonin autonom, që kishte administratën e vet. Shpërndarja e vendbanimeve serbe ishte e një natyre të tillë favorizoi ndarjen e Kroacisë më dysh. Në tetor të vitit 1990, serbët filluan të sulmonin rajonet vendore të policisë dhe të ndërmerrnin veprime të tjera të armatosura. Rajoni Autonom Serb (RAS) i Krajinës në Knin u themelua në dhjetor të vitit 1990 dhe në vitin 1991 u shkëput nga Kroacia. Pasi Kroacia shpalli pavarësinë nga Jugosllavia në qershor të vitit 1991, situata përshkallëzoi në luftë të armatosur, që zgjati nga viti 1991 deri në vitin 1995. UPJ-ja u përfshi në luftë duke mbajtur anën e serbëve, paçka se Jugosllavia nuk ishte shpërbërë ende.

Lufta për pavarësinë e shtetit Kroat ("Lufta për atdheun", siç njihej nga kroatët) u përqendrua kryesisht në zonat me popullsi të përzier nga pikëpamja etnike (Slavoni, Banijë, Kordun, Likë dhe Dalmaci) dhe në territore që serbët i konsideronin si të tyre. Gjatë luftës, Kroacia fitoi simpatinë e bashkësisë ndërkombëtare, falë rrethimit të gjatë dhe bombardimit të Dubrovnikut, si dhe rrethimit dhe pushtimit të Vukovarit, një porti në lumin Danub në Sllavoninë Lindore afër kufirit me Serbinë, dhe masakrës që u krye pas pushtimit të qytetit. Në maj të vitit 1995, ushtria kroate mposhti forcat ushtarake serbe në Operacionin "Stuhia" duke e vënë sërish Sllavoninë Perëndimore nën kontrollin kroat. Operacioni "Stuhia" u ndërmor në vitin 1995 duke i dhënë fund luftës, kur Knini, kryeqyteti i të ashtuquajturës Republika e Krajinës Serbe, u pushtua nga forcat kroate. Kroatët i referohen sulmit si "çlirimi" i Kninit, ndërsa serbët si "rënia" e Kninit. Operacioni u krye me ndihmën e ish-ushtarëve amerikanë, dhe me mbështetjen e nënkuptuar të qeverisë amerikane dhe përfshirjen e Ushtrisë së Bosnjë-Hercegovinës. Si rrjedhojë e këtij operacioni, u shpërngulën në masë 200,000 serbë dhe u dogjën disa fshatra. Sipas marrëveshjes së Erdutit, territori në Slavoninë Lindore dhe Baranja, që kishte mbetur ende nën kontrollin e serbëve, do të riintegrohej paqësisht në Kroaci gjatë viteve 1996-1998, me ndihmën e Administratës Tranzitore të OKB-së në Slavoninë Lindore (ATKBSL). Gjatë luftës për pavarësinë e Kroacisë 13,233 kroatë humbën jetën, 1,149 të tjerë u zhdukën, ndërsa 33,043 u plagosën. Numri i viktimave serbe përllogaritet në 7,000 persona. Të dyja palët kryen spastrime çnjerëzore etnike dhe shumë krime lufte. Qindra mijëra njerëz u detyruan t'i linin shtëpitë e tyre. Shumë të tjerë u vranë dhe shumë prona u shkatërruan. Në Kroaci, vala e refugjatëve arriti kulmin në fund të vitit 1991, ndërsa në Serbi, pas operacioneve përfundimtare, në vitin 1995.

Lufta në Kroaci i parapriu një konflikti të parashikuar dhe më çnjerëzor në Bosnjë-Hercegovinë. Kjo republikë kishte popullsinë më të përzierë etnike në ish-Jugosllavi. Sipas censusit të vitit 1991, 43% e popullsisë ishte myslimane, 31% serbe dhe 17% kroate, dhe shpërndarja gjeografike e grupeve të pleksura etnike, i ngjasonte lëkurës së leopardit, duke e bërë thuajse të pamundur caktimin e një vije të qartë ndarëse ndërmjet tyre. Zgjedhjet e para shumëpartiake u mbajtën në dhjetor të vitit 1990, dhe u fituan nga tre parti kombëtare. Rezultati pasqyronte përbërjen etnike të Bosnjë-Hercegovinës. Pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë, Bosnjë-Hercegovina pranoi propozimin e Komunitetit Evropian, që republikat jugosllave të vendosnin nëse donin të bëheshin shtete të pavarura apo jo, dhe të plotësonin kushtet për njohje ndërkombëtare. Vendimi solli krisjen e koalicionit, pasi serbët donin t'i ruanin lidhjet me Jugosllavinë (ose të bëheshin pjesë e "Serbisë së madhe"), kroatëve në Bosnjë u interesonte t'i bashkoheshin "Kroacisë së madhe", dhe një hap që mund të ishte ndërmarrë në këtë drejtim ishte krijimi i shtetit të tyre në Bosnjë, ndërsa myslimanët ishin pro pavarësisë së një Bosnjë-Hercegovine të bashkuar, që, sipas përllogaritjeve të numrit të banorëve dhe prirjeve demografike, ishin popullsi mbizotëruese. Më 29 shkurt dhe 1 mars të vitit 1992, u mbajt referendumi për pavarësinë. Ai u parapri nga përpjekjet e dështuara të Komunitetit Evropian për ta ndarë vendin në kantone sipas etnisë. Myslimanët dhe kroatët votuan për një shtet të pavarur, por referendumi u bojkotua nga serbët. Më tre mars të vitit 1992, Bosnjë-Hercegovina u shpall shtet i pavarur, me përkrahjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që mendonin se kjo ishte rruga më e mirë për shmangien e luftës në Bosnjë.

Tensionet ndëretnike u përshkallëzuan fill pas zgjedhjeve të vitit 1990. Bashkësia serbe, filloi të krijonte rajone autonome falë mbështetjes së përforcuar të Beogradit dhe furnizimit me armë dhe pajisjeushtarake, që ishin më se të mjaftueshme për një luftë disavjeçare, nga Sllovenia, Kroacia Perëndimore dhe Maqedonia, duke ndjekur kështu modelin e serbëve të Kroacisë. Në nëntor të vitit 1991, serbët e Bosnjës mbajtën një referendum më vete, sipas të cilit u vendos të qëndronin në një shtet me Serbinë dhe Malin e Zi. Më 18 mars të vitit 1992, plani i paqes së KE-së/OKB-së për decentralizimin e Bosnjë-Hercegovinës,

që u shpall nga Hose Kutileiro, u refuzua nga udhëheqësi boshnjak Alija Izetbegoviçi, duke nxitur kështu prirjet separatiste si të serbëve, ashtu edhe kroatëve. Më 9 janar të vitit 1992, serbët e Bosnjës shpallën Republikën e Popullit Serb të Bosnjë-Hercegovinës dhe më pas, në vazhdën e përshkallëzimit të këtyre veprimeve, shpallën pavarësinë e plotë. Më në fund, në muajin gusht të vitit 1992, ata e zëvendësuan emrin Bosnjë-Hercegovinë me emrin Republika Srpska.

Më 18 nëntor të vitit 1991, duke ndjekur shembullin serb, kroatët shpallën Bashkësinë Kroate të Herceg-Bosnjës, që u përqendrua në pjesën kroate të Mostarit dhe u udhëhoq nga Mate Bobani. Ajo ekzistoi deri në mars të vitit 1994, por, më 28 gusht të vitit 1993, u bë pjesë e Republikës Kroate të Herceg-Bosnjës. Njësitë e saj ushtarake, si Këshilli i Mbrojtjes së Kroacisë (HVO), që u pajis dhe armatos kryesisht nga Kroacia, fillimisht, përbëheshin dhe nga boshnjakë. Nga prilli i vitit 1993 deri në mars të vitit 1994 HVO-ja luftoi kundër serbëve, si dhe kundër myslimanëve (boshnjakëve). Në rajonet autonome që krijoheshin si në Serbi, ashtu edhe Kroaci, kryheshin spastrime etnike, ku përfshihej edhe shkatërrimi i përmendoreve kulturore dhe fetare të palës kundërshtare.

Më 6 prill të vitit 1992, pavarësia e Bosnjë-Hercegovinës u njoh në shkallë ndërkombëtare, dhe një ditë më pas, njësitë paraushtarake serbe nisën bombardimin e qytetit të Sarajevës nga kodrinat përreth. Njëkohësisht, UPJ-ja ndërmori edhe një fushatë ushtarake kundër Zvornikut, Foçës, Vishegradit dhe qyteteve të tjera. Ushtria e Republikës së Srpskës, që përbëhej nga 80,000 trupa dhe udhëhiqej nga gjenerali Ratko Mlladiç, në fillim të operacioneve të 12 majit të vitit 1992, formohej nga njësitë e UPJ-së. Ushtria vijonte të financohej nga Jugosllavia (Serbia). Plani i Serbisë ishte relativisht i thjeshtë: të pushtonte luginën e Drinës dhe Savës, të krijonte një territor të përbashkët me Republikën e Krajinës Serbe në Kroaci, të pushtonte sa më shumë që të ishte e mundur territore të Bosnjës, ta mbante Sarajevën nën rrethim, dhe të shtypte qëndresën myslimane. Duke qenë se territori kishte popullsi të përzier nga pikëpamja etnike, u kryen shumë spastrime etnike dhe vrasje civilësh, burrat u dërguan në kampe përqendrimi, ndërsa shumë gra u përdhunuan. Plani i spastrimit etnik u realizua plotësisht. Brenda gjashtë javëve, forcat serbe morën nën kontroll dy të tretat e territorit të Bosnjës, ndërsa në vitin 1994, kur Serbia ishte në kulmin e fuqisë të saj, mori nën kontroll 70% të saj. Në Bosnjë po zhvillohej një luftë "të gjithë kundër të gjithëve". Kështu, në vitet 1993 dhe 1994, në Krajinë, pati përplasje të armatosur ndërmjet boshnjakëve, kryesisht ndërmjet Ushtrisë së Federatës dhe Fikret Adbiçit, kundërshtarit të Izetbegoviçit. Gjithashtu, pati të tilla përplasje edhe midis boshnjakëve dhe kroatëve, ku këta të fundit ishin bërë palë me serbët në sulmet kundër boshnjakëve në disa zona të Bosnjës.

Embargoja e OKB-së për eksportimin e armëve drejt ish-republikave jugosllave dëmtonte në raport të zhdrejtë boshnjakët dhe kroatët, ndërsa pikëpamjet e ndryshme të disa shteteve (Franca dhe Mbretëria e Bashkuar përkrahnin serbët, ndërsa Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin me këmbëngulje kroatët dhe myslimanët) dhe pavendosmëria e Komunitetit Evropian vetëm sa e vazhduan më tej agoninë e Bosnjës. Ndër nismat diplomatike dështake që u ndërmorën për t'i dhënë fund luftës dhe për ta zgjidhur krizën, ishte Plani i ashtuquajur Vens-Ouen (Vance-Owen) që u paraqit në Konferencën e Paqes, në janar të vitit 1993. Sipas këtij plani, që vendoste si kusht paraprak armëpushimin; Bosnja do të ndahej në dhjetë krahina autonome, duke shtuar edhe Sarajevën si zonë të çmilitarizuar. Çdo grup etnik duhej të përbënte shumicën e tre krahinave nga dhjetë gjithsej, ndërsa popullsia e Sarajevës do të mbetej e përzier nga pikëpamja etnike. Plani u kundërshtua nga serbët, si dhe ukritikua shumë nga bashkësia ndërkombëtare.

Në vitin 1994, nën trysninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kroatët dhe boshnjakët (të kryesuar nga Tudjmani dhe Izetbegoviçi) ranë në ujdi për të lidhur aleancë. Këshilltarët e SHBA-së filluan të stërvitnin ushtrinë boshnjake dhe kroate, dhe me miratimin e nënkuptuar të SHBA-së, ajo u armatos nga shtetet islamike. Faktorët që kontribuan më së shumti në përfundimin e luftës ishin: krimet e luftës, si masakra që kryen serbët në Srebenicë në korrik të vitit 1995 ku u vranë mbi 8000 boshnjakë, që u cilësua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) si gjenocid, dhe masakra të tjera si ajo e Sarajevës, që u mbajt rrethuar nga serbët prej më se 1,000 ditë. Diplomati amerikan Riçard Hollbruku ndërmori një fushatë ndërkombëtare të efektshme, që përfshinte shumë kompromise dhe pati efekte anësore negative. Kundër serbëve u krijua një koalicion ndërkombëtar shumëpalësh, që solli izolimin e tyre. Në vitin 1995, avionët e NATO-s filluan të bombardonin pozicionet e tyre ushtarake, ndërsa njësitë kroato-myslimane u hodhën në sulm masiv, duke marrë nën kontroll hapësira të gjera. Pas një muaji luftimesh, si pasojë e krijimit të rrethanave të jashtme të pafavorshme, Millosheviçit iu desh të ndërpriste mbështetjen ushtarake për serbët e Bosnjës.

Më 1 nëntor të vitit 1995, në Bazën Ushtarake të Forcave të Ajrore në Deiton,Ohajo, nisën bisedimet për paqe, ku morën pjesë të gjitha palët të përfshira

në konflikt. Negociatat dramatike përfunduan më 27 nëntor dhe prej tyre Bosnjë-Hercegovina u njoh si shtet i pavarur, megjithëse aktualisht është pjesë përbërëse e Federatës Boshnjako-Kroate, me 51% të territorit, dhe Republikës Srpska, me 49% të saj. Ekzistenca e saj garantohet nga OKB-ja dhe NATO-ja. Më 14 dhjetor, u nënshkrua marrëveshja në Paris, dhe në Bosnjë-Hercegovinë, u vendosën mbi 60,000 trupa ushtarake të forcave ndërkombëtare. Lufta kishte marrë jetët e mbi 100,000 njerëzve dhe ishte bërë shkak i largimit të 2,2 milion refugjatëve (pothuajse gjysma e popullsisë). Rreth 50,000 njerëz u torturuan, 20,000 gra u përdhunuan, dhe në të gjithë vendin numëroheshin 715 kampe përqendrimi. Duke marrë shkas nga krimet e luftës të kryera nga të trija palët (më së shumti prej serbëve), në maj të vitit 1993, Këshilli i Sigurimit të OKB-së krijoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) për ish-Jugosllavinë.

Përplasjet në Kosovë filluan të shtoheshin nga mesi i viteve 1998, pas krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Me kalimin e kohës, përplasjet e armatosura me forcat serbe filluan të bëheshin më se të zakonshme, dhe kjo gjë, së bashku me trysninë diplomatike të bashkësisë ndërkombëtare, solli në shkurt të vitit 1999, hapjen e negociatave në Rambuje, në afërsi të Parisit. Pala serbe e kundërshtoi planin e paqes që iu ofrua nga diplomatët perëndimorë. Menjëherë pas këtij kundërshtimi, pavarësisht mungesës së autorizimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, filloi më 24 mars të vitit 1999, ndërhyrja e forcave ushtarake të NATO-s kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Bombardimi i NATO-s vijoi çdo ditë pothuajse tre muaj, duke shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe materiale, kryesisht në Serbi. Gjatë bombardimeve, forcat serbe detyruan pothuajse një milion shqiptarë të Kosovës të shpërnguleshin në shtetet fqinje. Bombardimi përfundoi në qershor të vitit 1999 me nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës, pas së cilës, forcat serbe, si dhe 200,000 civilë serbë u larguan nga Kosova, që tashmë ishte nën kontrollin e forcave ushtarake ndërkombëtare. Në shkurt të vitit 2008, Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia, dhe aktualisht, Evropa Juglindore ndahet dy kampe: në vendet që e njohin dhe në vendet që nuk e njohin pavarësinë e shtetit të Kosovës. Ndërkohë, në vitin 2001, dy vjet pas bombardimit të NATO-s ndaj Serbisë, ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë filluan konfliktet etnike.

Pas Luftës Ballkanike të vitit 1912-1913, si dhe Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, luftërat në Jugosllavi, që përfshijnë luftën në Kosovë të vitit 1998-1999; bombardimin e Serbisë nga NATO-ja, nga muaji mars deri në qershor të vitit 1999; dhe konfliktin e vitit 2001 ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë; ishin konflikti i katërt i armatosur në Ballkan në vitet e shekullit të njëzetë, duke lanë pas qindra mijëra viktima, miliona refugjatë dhe dhjetëra fshatra e qytete të shkatërruara. Ato shpërthyen nga ndërthurja e konflikteve kulturore, fetare dhe ndëretnike, por pikësëpari ishin luftëra për të caktuar kufij të rinj në territorin e Jugosllavisë. Shtetet-kombe, që u formuan në territorin e ish-Jugosllavisë, ishin spastruar pak a shumë nga pikëpamja etnike. Çmimi dhe pasojat e këtyre luftërave do të rëndojnë mbi brezat që do të vijnë në të ardhmen. I gjithë rajoni, është ende "fuçi baruti", siç u përshkrua në fillim të shekullit të njëzetë. Për më tepër, luftërat në Jugosllavi e vunë Bashkimin Evropian dhe bashkësinë ndërkombëtare në provë, duke treguar se asnjëra prej tyre nuk ishte e aftë ta administronte krizën.

II.1. RRUGA DREJT SHPËRBËRJES

II-1. Kongresi i Katërmbëdhjetë i Partisë Komuniste Jugosllave, janar 1990

Delegacioni slloven braktis Kongresin

Pas refuzimit të të gjitha propozimeve për reformimin e Lidhjes së Komunistëve të Sllovenisë (që ishte pjesë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, si të gjitha partitë e tjera të republikave komuniste) në Kongresin e Katërmbëdhjetë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ku u diskutua për kalimin në sistem shumëpartiak; respektimin e të drejtave të njeriut; krijimin e një shoqërie civile të pavarur dhe për dhënien fund të shtypjes politike; delegacioni slloven pas përfundimit fjalimit të udhëheqësit të tyre, Ciril Ribiçiçit e braktisi Kongresin. Sonja Lokari, njëra prej delegateve shpërtheu në lot.



Repe, 2015, fq. 224.

Çfarë simbolizonte braktisja e Kongresit nga delegacioni slloven?

B. Fjalim nga Ciril Ribiçiçi

Shokë dhe deputetë,
Nuk kam se çfarë të shtoj, por do të doja të mbaja një fjalim për miratimin e kësaj Deklarate. Për ne, deputetët e Sllovenisë, këtij Kongresi të veçantë të Katërmbëdhjetë i ka ardhur fundi. U orvatëm ta ndryshonim rrjedhën e këtij Kongresi disa herë. Doja t'ju kujtoja edhe një herë fjalimin dhe propozimin e djeshëm të delegacionit tonë.

Nuk ka pikën e dyshimit se vendimet e miratuara nga ky Kongres nuk plotësojnë as minimumin e kërkesave, që Kongresi i Njëmbëdhjetë i Lidhjes së Komunistëve të Sllovenisë kishte parashtruar në rrafshin ekonomik, të reformave politike dhe transformimit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Në këto kushte kaq të veçanta, komunistët sllovenë do të vazhdojnë të ngulmojnë që të nxisin socializmin demokratik dhe idenë e bashkimit të republikave sovrane dhe të barabarta në një shtet të vetëm, të quajtur Jugosllavi, si dhe do të vijojë të bashkëpunojnë me ato republika, që kanë drejtime dhe programe të ngjashme.

Pas këtij kongresi, Liga e Komunistëve të Sllovenisë do të vazhdojë të bashkëpunojë me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë vetëm mbi bazën e programeve, drejtimeve dhe interesave të përbashkëta, por në asnjë marrëveshje të veçantë.

Ne i vërejmë me kujdes vendimet që shumica mori në këtë seancë plenare, por për ne nuk janë as të pranueshme, dhe as të detyrueshme me ligj.

Prandaj, propozoj që të gjithë delegatët e Lidhjes së Komunistëve të Sllovenisë që bien dakord se, fatkeqësisht, ka ardhur ora e largimit tonë nga Kongresi i Katërmbëdhjetë i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë të largohen, pasi ne nuk duam ta ndajmë me ju përgjegjësinë e agonisë së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, që është rezultat i imponimit të vullnetit të imponuesve. Ju faleminderit.

Arkiva e Republikës së Sllovenisë. Koleksion i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Sllovenisë, 1589/IV, Kutia 2072.

1. Çfarë përkrahën komunistët sllovenë? Pse të gjitha propozimet e tyre u kundërshtuan në Kongresin e Katërmbëdhjetë? Për t'iu përgjigjur pyetjes së dytë, duhet informacion shtesë. Si e shpjegoi Ribiçiçi arsyen e

2. braktisjes së Kongresit nga delegacioni slloven? Shpjegoni fjalinë: Në këto kushte kaq të veçanta, Lidhja e Komunistëve të Sllovenisë do të vazhdojë të ngulmojë që të nxisë socializmin demokratik dhe idenë e bashkimit të republikave sovrane dhe të barabarta në një shtet të vetëm, të quajtur Jugosllavi, si dhe do të vijojë të bashkëpunojnë me ato republika që kanë drejtime dhe programe të ngjashme. Si i shihnin komunistët sllovenë marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet republikave jugosllave? Çfarë donte të thoshte C. Ribiçiçi kur theksoi se Lidhja e Komunistëve të Sllovenisë "do të vazhdojë të bashkëpunojë me ato republika që kanë drejtime dhe programe të ngjashme?"

II-2. Lufta zë fill që në stadium: Ndeshja e futbollit ndërmjet skuadrës së "Dinamos" dhe "Crvena Zvezdës"

Në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990, trazirat e tifozëve, të ndërthurura me nacionalizmin, u bënë pjesë e pandashme e aktiviteteve sportive në Jugosllavi. Shembulli më i njohur i përshkallëzimit të nacionalizmit dhe dhunës sportive ndodhi në Zagreb, më 13 maj të vitit 1990, gjatë një ndeshjeje ndërmjet "Dinamos" së Zagrebit dhe "Crvena Zvezdës" të Beogradit (Ylli i Kuq).

A. Artikull i botuar në një gazetë kroate: Maksimiri - Një fushëbetejë e mirëfilltë

DITË ZIE PËR FUTBOLLIN Ndeshja e futbollit ndërmjet "Dinamos" dhe "Crvena Zvezdës" nuk arriti të zhvillohej për shkak të vandalizmit të paparë dhe tërbimit të tifozëve të të dyja klubeve, si dhe paaftësisë së plotë të policisë për ta normalizuar situatën.

Zagreb- Ditë zie për futbollin! Dihej se gjakrat do të nxeheshin në ndeshjen ndërmjet skuadrave të "Dinamos" dhe "Crvena Zvezdas" dhe që mund të kishte ndodhi të padëshiruara. Por, asnjë nuk e kishte parashikuar se do këto ndodhi, nuk do të lejonin as fillimin e ndeshjes në Maksimir (rrethi ku ndodhet stadiumi). Për ta përmbledhur, stadiumi Dinamo u kthye në një fushëbeteje të mirëfilltë, dhe rrjedhimisht ndeshja nuk mundi të zhvillohej. Më në fund, situata në stadium u vu nën kontroll, pak para orës njëmbëdhjetë të natës, kur tifozët e skuadrës së "Crvena Zvezdës" u larguan me autobusë të posaçëm.

S'ka pikën e dyshimit që shkaktarët ishin tifozët e të dyja klubeve, por edhe policia mund të fajësohet për paaftësinë që tregoi për normalizimin e situatës. Atë mëngjes, në Zagreb mbërritën rreth 1,000 tifozë të "Crvena Zvezdës" dhe u sulën rrugëve të qytetit, duke u sjellë si të tërbuar e duke kryer vandalizma. Policia i përcolli të gjithë drejt stadiumit i Maksimirit, ku u pozicionuan brenda portave të stadiumit, dhe shkaktuan dëme të mëdha. Ata shkatërruan gjithçka që u dilte përpara, deri edhe makina dhe madje i nxorrën syrin vendit edhe një polici.

"Fushëbeteja e Maksimirit ", "*Vjesnik*", 14 maj 1990

B. Gazetë serbe: "Tifozët e "Dinamos" kryen akte të pahijshmetë paramenduara"

Kërcënimet e udhëheqësve të tifozëve të "Dinamos" u shpërfillën deri në mesnatë-Udhëheqja e "Crvena Zvezdës" (Ylli i Kuq) i paralajmëroi paraprakisht tifozët të mos shkonin në Zagreb- Prindër të shqetësuar në stadiumin e Dinamos dhe në stacionin hekurudhor të Beogradit

Duket sheshit se kush e ka fajin për aktet e pahijshme në stadiumin e Maksimirit. Kjo çështje duhet ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, trajtohen ngjarjet që ndodhën në tribunën jugore, nga ku tifozët e "Crvena Zvezdës" që ndodheshin në radhët e para të tribunës (një tjetër gabim i organizuesve) u qëlluan me gurë, dhe këta të fundit filluan të kryenin vandalizma, si dhe të shkatërronin banderolat publicitare. Disa vepruan në këtë mënyrë për t'u mbrojtur nga gurët dhe ndenjëset e thyera, ndërsa të tjerët për "hir të shkatërrimit". […]

Agresorët e tradhtuan shumë shpejt veten

Kur më në fund u duk se ndeshja do të fillonte, atëherë filloi lufta e vërtetë, veçse në anën tjetër të stadiumit. Ajo çka udhëheqësit e tifozëve të "Dinamos" paralajmëruan se do të ndodhte në mesnatë, ndodhi vërtet. Veprat e turpshme ishin të paramenduara! […] Kur maniakët e Bashkimit Demokratik Kroat u mblodhën rreth stadiumit, lojtarët e "Crvena Zvezdës" filluan të dridheshin nga frika, pasi druheshin se turma do të thyente kordonin e policisë, përgjegjësi i të cilit nuk dukej asgjëkundi, dhe do të vërshonte drejt zonës së dhomave të zhveshjes, ku mbrojtja linte për të dëshiruar. Me shumë gjasa, gjakrat u ulën vetëm kur, në këtë zonë, mbërriti një grup policësh ushtarakë. […] Jankoviç, 15 Maj 1990.

1. Krahasojini të dyja këto burime. Ku ngjasojnë dhe ku ndryshojnë këto dy shkrime? Sipas këtyre burimeve, kush duhet fajësuar për dhunën? A mund t'i ndani faktet nga interpretimet në të dyja këto burime? Dalloni shprehjet dhe pikëpamjet subjektive në të dyja burimet. Si i shpjegoni këto ndryshime? A shërben kjo ndodhi si tregues i krisjes së mëtejshme të marrëdhënieve ndëretnike në Jugosllavi në fund të viteve 1980?

2. Përfytyroni sikur për këtë ndodhi të jenë të disponueshme vetëm këto dy burime. Si do t'i përdornit për të ndërtuar versionin tuaj, por të paanshëm, të historisë? Përdorni shprehje si "duket se", "ajo çka dihet me siguri është se", "... është ende e paqartë", "burimi i parë/i dytë tregon se..." etj.

II-3. Demonstrata të dhunshme kundër Millosheviçit në Beograd. Rrugët u pushtuan nga tanket, 9 mars 1991

Demonstratat e para masive kundër regjimit të Milloshviçit në Beograd, filluan të organizoheshin më 9 mars të vitit 1991 nga Lëvizja për Përtëritjen Serbe (SPO). Udhëheqësi i SPO-së, Vuk Drashkoviçi bëri thirrje për demonstrata, i nxitur nga programet propagandistike të Televizionit të Beogradit, të cilin e pagëzoi si "Televizioni i Bastijës". Presidenti serb Sllobodan Millosheviçi ndërmori masa shtypëse kundër demonstruesve duke përdorurtopa uji, polici kalorësiake, gaz lotsjellës, edhe tanket e ushtrisë. Të nesërmen, me mijëra studentë u mblodhën në sheshin "Terazije" duke kërkuar dorëheqjen e drejtorëve kryesorë të stacionit televiziv të Beogradit dhe të Ministrit të Brendshëm; lirimin e udhëheqësve të arrestuar të opozitës dhe anulimin e urdhrit për pezullimin e veprimtarisë së Radio B92 dhe Studio B TV. Kjo pjesë e protestave njihet si "revolucioni i kadifenjtë serb". Asambleja e Serbisë vendosi ta pranonte me ngut dorëheqjen e drejtorëve të Radio Televizionit të Beogradit dhe të Ministrit të Brendshëm. Vuk Drashkoviçi u lirua nga burgu në 14 mars. Pas disa muajsh, në ish-Jugosllavi shpërtheu lufta.



Fotografi nga Emil Çonkic.

Revolta e popullit u shtyp nga tanket.

II-4. Platforma Izetbegoviç-Gligorov, 1991: Kiro Gligorovi në parlamentin e Republikës Socialiste të Maqedonisë (RSM), 15 qershor 1991

Gjatë periudhës së shpërbërjes së Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, në samitin e republikave jugosllave, që u mbajt në qershor të vitit 1991, në Sarajevë, Presidenti Kiro Gligorov i Republikës Federale Socialiste të Maqedonisë dhe Presidenti i Bosnjës Alija Izetbegoviç, propozuan disa reforma kushtetuese për të ardhmen e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Propozimi i tyre, i quajtur Platforma Izetbegoviç-Gligorov, parashikonte një "federatë asimetrike", ku autonomia kushtetuese e republikave jugosllave të ndryshonte, dhe favorizonte mundësinë e integrimit të vendit në të ardhmen në Evropë, në formën e një konfederate të lirë. Megjithëse udhëheqësit e republikave e diskutuan gjatë, Platforma u kundërshtua shpejt, pasi nuk kënaqte interesat e atyre që dëshironin pavarësi të plotë, si të Sllovenisë dhe Kroacisë nga njëra anë, dhe të Serbisë nga ana tjetër, që kërkonte të krijonte një federatë tejet të centralizuar, në të cilën do të luante rol kryesor.

ASAMBEJA E REPUBLIKËS SOCIALISTE TË MAQEDONISË […] – KIRO GLIGOROV: E nderuar presidencë, president dhe deputetë, Do të përpiqem t'ju informoj shkurtimisht rreth platformës së propozuar nga Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia. Menduam se, duhet të përpiqeshim të krijonim një pikëmbështetje për të kapërcyer pikën e vdekur të bisedimeve, për të ardhmen e bashkimit jugosllav. […]

Cilët janë gurët themeltarë të platformës së propozuar? Së pari, çdo marrëveshje për të ardhmen e Jugosllavisë duhet të mbështetet dhe të burojë nga sovraniteti i republikave, si shtete që u formuan gjatë Luftës Popullore Çlirimtare dhe përmes anëtarësimit vullnetar të shteteve dhe popujve përkatës në federatë. Askujt nuk iu fal liria. Të gjithë e fituam duke rrokur armët dhe me sakrifica të mëdha, ndaj bisedimet ndërmjet shteteve për të ardhmen mund të zhvillohen vetëm nëse të gjithë gjenden në kushte të barabarta…

Së dyti, çdo lloj bashkimi nënkupton marrëveshje për disa veprime dhe funksione të përbashkëta që do të ndërmerren nga organe të përbashkëta. Pa marrëveshje, nuk ka bashkim. Nuk duhet të ekzistojë frika se funksionet dhe organet e përbashkëta do të jenë në konflikt me sovranitetin e secilës republikë. Kjo gjë do të arrihet nëse do të kuptojmë se ne do ta


ushtrojmë së bashku atë pjesë të sovranitetit tonë që përmbahet në këto funskione të përbashkëta dhe se ai do të ushtrohet si pjesë e patjetërsueshme e sovranitetit fillestar të secilës republikë. Dhe kjo nuk mohon assesi sovranitetin fillestar të republikës.[...]

Komuniteti Ekonomik Evropian e ka cilësuar dokumentin tonë si një pikëmbështetje shumë të mirë dhe udhërrëfyes, që mundëson dhe premton daljen nga kriza. Ne duhet ta mbajmë gjallë nismën dhe të bashkëpunojmë, si dhe ta përgatisim më tej veten me propozime edhe më konkrete, kur të vijojmë me diskutimet rreth të drejtave të veçanta dhe funksioneve të përbashkëta.


Shënime me dorë nga Seanca e Shtatëmbëdhjetë e Asamblesë së Republikës Socialiste të Maqedonisë, mbajur më 15 qershor 1991,Shkup: http://62.220.196.22/WBStorage/Files/17sednica15juni91god0.pdf

1. Cilat prej tre pikënisjeve të negociatave propozohen në tekst? A i nxjerr në pah ky tekst druajtjet që ekzistonin në Jugosllavi në atë kohë? Nëse po, cilat janë?

2. Shpjegoni: Pse u kundërshtua ky propozim? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet ta lidhni informacionin e dokumentit me informacionin e ofruar në çelës.



Përbërja etnike e Jugosllavisë, 1987



II-5. Shtypja dhe sistemi "sistemi paralel arsimor" në Kosovë

Përgjatë viteve 1980, Krahina Autonome e Kosovës u prek nga trazira të vazhdueshme të shkaktuara nga konfliktet ndërmjet shumicës shqiptare dhe pakicës serbe. Serbët e Kosovës ndjeheshin të përndjekur dhe të diskriminuar nga shumica. Bashkësia shqiptare, që gëzonte autonomi dhe pushtet domethënës, që buronte nga Kushtetuta e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë e vitit 1974, kërkoi statusin e republikës. Autoritetet jugosllave vendosën t'iu kundërpërgjigjeshin këtyre konflikteve përmes përdorimit të dhunës. Në vitin 1989, autoritet serbe, nën udhëheqjen e Millosheviçit, bënë ndryshime kushtetuese, përmes së cilave u bë e mundur heqja e autonomisë së krahinës së Kosovës dhe Vojvodinës. Kështu, Kosova nuk kontrollohej më nga shumica shqiptare, pasi kjo e fundit ra pre e formave të ndryshme të shtypjes si: shkurtimi në masë i vendeve të punës për zyrtarët, gazetarët, mjekët dhe punëtorët shqiptarë. Dhuna policore dhe diskriminimi në shkolla u rrit. Si kundërpërgjigje, bashkësia shqiptare e udhëhequr nga Ibrahim Rugova, krijoi një sistem paralel politik duke përfshirë zgjedhje, si dhe media e institucione kulturore të veçuara. Ata krijuan edhe një sistem paralel arsimor. Shtëpitë private u shndërruan në klasa, ku jepnin mësim mësues shqiptarë që ishin shkarkuar nga sistemi arsimor shtetëror. Për më tepër, tekstet mësimore futeshin kontrabandë në Kosovë. Këto shkolla funksiononin mbi bazën e një sistemi të veçantë taksash dhe dhurimeve vullnetareve, kryesisht nga diaspora shqiptare në Evropë dhe në vende të tjera të botës. Numri i ndjekësve të këtij sistemi arsimor arrinte në 330, 000 nxënës.

A.Nxënës që ndiqnin gjimnazin "Sami Frashëri" në Irzniq (1992)



Arkivat e Institutit të Historisë, Prishtinë.

Përshkruani kushtet e klasave të improvizuara.

A. Sulmet kundër arsimit duhen ndalur, nëntor 1990

Në mbledhjen e datës 30.11.1990, Këshilli i Drejtorëve të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme të Komunës së Prishtinës, pasi shqyrtoi situatën e rëndë të procesit arsimor në gjuhën shqipe, që vinte si rrjedhojë e veprimeve shkatërruese të qëllimshme të autoriteteve të Republikës Socialiste të Serbisë, Vëren se puna dhe procesi arsimor në shkollat tetëvjeçare të Komunës së Prishtinës, gjendet në një situatë të vështirë për shkak të trysnisë dhe shantazheve e përditshme të autoriteteve të paligjshme, personave dhe grupeve të papërgjegjshme, ndasive, çorientimit dhe pamjaftueshmërisë së motivimit të mësuesve dhe nxënësve për të punuar. [...]

Këshilli i Drejtorëve arriti në përfundimin se, do të punojnë me vendosmëri, si dhe do të përdornin programe dhe plane mësimore të përpiluara nga Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe të miratuara nga zyrtarët e lartë të sistemit arsimor të Kosovës, duke u shprehur se "i bindemi dhe pranojmë vetëm ligjet e Kosovës dhe njohim vetëm autoritetet ligjore të arsimit të Kosovës". Gjithashtu, deklarojmë se nuk e njohim Institutin Pedagogjik të Arsimit të Prishtinës, si dhe Institutin Pedagogjik të Arsimit të Kosovës nëse nuk kthehen këshilltarët shqiptarë që u pezulluan dhe shkarkuan".[...]

Në rast se kërkesat tona bien në vesh të shurdhët të autoriteteve përkatëse, ne do t'iu bëjmë thirrje organizatave ndërkombëtare.

"Shkëndija", nëntor 1990: Komunikata e Këshillit të Drejtorëve të shkollave tetëvjeçare.

1. Çfarë tregon harta në faqen 45 për përbërjen e Jugosllavisë? Sa republika dhe krahina autonome ka? Cilat janë kombet dhe grupet etnike që jetojnë në to? Cilat prej tyre janë më homogjene dhe cilat më heterogjene nga pikëpamja etnike?

2. Duke përdorur hartën dhe të gjitha burimet në kapitullin II.1, rendisni problemet që sollën shpërbërjen e Jugosllavisë. Përpiquni të shihni përtej çdo ngjarjeje apo rasti të përshkruar në këtë burim, dhe të gjeni shkaqe më të qenësishme.

II.2LUFTËRAT E PERIUDHËS 1991-1995

II-6. Lufta dhjetëditore sllovene

Gjatë luftës dhjetëditore sllovene, që zgjati nga 27 qershori deri më 7 korrik të vitit 1991, humbën jetën 75 njerëz, nga të cilët 45 ishin ushtarë të Ushtrisë Popullore Jugosllave (që në këtë libër do ta hasni me shkurtesën UPJ), 19 ishin civilë dhe ushtarakë të Mbrojtjes Territoriale Sllovene, ndërsa 12 ishin shtetas të huaj. Një nga sulmet më të përgjakshme të UPJ-së u zhvillua në Medvegjë në 28 qershor, ku forcat ajrore jugosllave hapën zjarr ndaj shoferëve me shtetësi të huaj të kamionëve, që ishin bllokuar përpara një barrikade. Megjithëse të dyja palët e dinin se atje kishte qytetarë të huaj, avionët luftarakë sulmuan prapëseprapë, duke i vrarë shtetasit turq dhe bullgarë. Gjatë sulmit, një fermë që ndodhej atypari, u godit nga një raketë, duke marrë jetën e një qytetari tjetër. Duke qenë se lufta zgjati shumë pak, dhe nuk ishte shumë intensive, dhe duke qënë se Ushtria Popullore e Jugosllavisë ishte ende e përzierë nga pikëpamja etnike, si dhe falë përpjekjeve të presidencës sllovene, majorëve dhe oficerëve të Mbrojtjes Terriotriale Sllovene (MTS) dhe UPJ-së, asnjë shtetas slloven nuk u gjykua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare. Megjithatë, për sytë e publikut, disa ngjarje përbënin krime lufte, veçanërisht goditja me predhë i një helikopteri të UPJ-së me predhë, më 27 qershor të vitit 1991, mbi luginën e Rozhnës në Lubjanë, që po transportonte bukë për në kazermat e Vrhnikës dhe që pilotohej nga shtetasi slloven Anton Mrlak (që në atë kohë ishte anëtar i MTS-së), së bashku me shtetasin maqedonas Bojançe Sibinovski. Helikopteri "Gazelle SA 341", siç dihet, ishte i paarmatosur. Krerët, Ministri i Mbrojtjes Janez Jansha dhe Komandanti i Përgjithshëm Anton Krkoviçi, pretendonin se Mrlaku nuk ishte anëtar i MTS-së, edhe pse anëtarësia e tij u njoh më pas nga Forcat e Armatosura Sllovene, dhe se helikopteri ishte qëlluar, sepse po fluturonte mbi objekte qeveritare (gjë që ishte gënjeshtër). Të afërmit e Mrlakut pretendonin se objekti ishte qëlluar enkas për arsye propagande, në mënyrë që MTS-ja të tregonte se kishte kurajon të qëllonte një helikopter të UPJ-së. Rasti u denoncua vetëm në vitin 2016, dhe nuk dihet ende nëse do të zhvillohet ndonjë gjyq i mirëfilltë.

Barrikadë në fshatin Medvegjë



Fotografi nga Srdjan Zhivuloviçit, gazeta "Delos".

II-7. Tanku i UPJ-së shtyp një makinë "Fico", në një prej rrugëve të Osijekut, 27 qershor 1991

Më 27 qershor të vitit 1991, në fillim të luftës së Kroacisë, një tank i Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë shtypi një makinë "Fiat 500", që njihej gjerësisht si Fico në një prej rrugëve të Osijekut. Videoja e kësaj ngjarjeje u transmetua në të gjithë botën, dhe shërbeu si një prej dëshmive të para të dhunës së Jugosllavi dhe se shumë shpejt ajo u shndërrua në një simbol shumëkuptimësh. Në Kroaci, simbolizonte dhunën ndaj qytetarëve të thjeshtë, që kishin në pronësi makinat më të lira në Jugosllavi, si dhe luftën ndërmjet Davidit dhe Goliatit, ku makina "Fico" përfaqësonte popullin kroat të paarmatosur, që luftonte kundër një ushtrie të fuqishme. Në disa raste të tjera, ngjarja simbolizonte edhe kapitullimin e Jugosllavisë dhe sistemit të saj, pasi Fico-ja ishte simbol i industrisë jugosllave dhe produkteve të saj, që prodhoheshin për njerëzit e thjeshtë. Iu mëshua fort përkimit të ngjyrës së veturës "Fico" me ngjyrën e kuqe të komunistëve jugosllavë. Në vitin 2011, pikërisht në këtë vend u ngrit një përmendore, ku ndryshimi i rrjedhës së ngjarjes (makina "Fico" shtyp tankun), simbolizonin fitoren e popullit kroat ndaj Ushtrisë Jugosllave.

A. Tanku i UPJ-së shtyp veturën "Fico"



Fotograf: Jozo Petriç, Koleksion vetjak.

B. Përmendorja: Fico-ja shtyp tankun e UPJ-së



Koleksion vetjak.

Luftërat dhe shpërbërja e Jugosllavisë (1991-1995)



II-8. Vendimi i Këshillit Ekzekutiv të Krahinës Autonome Serbe të Krajinës, për të aneksuar pjesë të territorit kroat në Republikën e Serbisë, 1 prill 1991

NENI 1 Në këtë dokument, shpallet bashkimi i Krahinës Autonome Serbe të Krajinës me Republikën e Serbisë.
NENI 2 Territori i Krahinës Autonome Serbe të Krajinës bëhet pjesë përbërëse e territorit të njësuar shtetëror të Republikës së Serbisë, kur ky vendim të hyjë në fuqi.

Në përputhje me pikat e mëparshme të këtij neni, Kushtetuta e Republikës së Serbisë hyn në fuqi për Krahinën Autonome Serbe të Krajinës menjëherë pas miratimit të këtij Vendimi, dhe për këtë krahinë zbatohen ligjet e Republikës së Serbisë, si dhe sistemi kushtetues dhe ligjor i Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë.
NENI 4 Në mbështetje të këtij vendimi, territori i Krahinës Autonome Serbe të Krajinës, që i bashkohet territorit të njësuar shtetëror të Republikës së Serbisë përbëhet nga bashkitë e Kninit, Benkovacit, Obrovacit, Graçacit, Donji Lapcit, Korenicës, Vojniçit, Virginmostit, Dvornaunit, Petrinjës dhe Pakracit.

Edhe të gjitha ato qyteza dhe fshatra serbe që i janë bashkuar, si dhe ato që do të zgjedhin dhe vendosin që t'i bashkohen njërës prej këtyre bashkive në të ardhmen gjatë procesit të ndarjes së kufijve, janë pjesë e këtij territori.
NENI 5 Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KËSHILLI EKZEKUTIV I KRAHINËS AUTONOME SERBE TË KRAJINËS
PRESIDENTI I KËSHILLIT EKZEKUTIV Të KRAHINËS AUTONOME SERBE TË KRAJINËS
Dr. Milan Babiç nga njësitë paraushtarake të Mbrojtjes Territoriale

Numri: 32/91-1
Korenicë, kopje e shtypur e 1 prillit të vitit 1991
Dorëshkrimi në gjuhë latine HR-HMDCDR. 2 kut. 232

II-9. Beteja e Vukovarit, gusht-nëntor 1991

Nga fundi i gushtit të vitit 1991, përplasjet e armatosura në qytetin e Vukovarit kulmuan me rrethimin e qytetit për 87 ditë, ku u përfshinë rreth 30,000 ushtarë të UPJ-së si dhe një numër i madh ushtarakësh nga Parada e Luftës "Beograd-Vukovar", 1991. ThereForcat kroate filluan të pakësoheshin gjithnjë e më shumë. Njësitë e UPJ-së hynë në Vukovar më 18 nëntor të vitit 1991. Gjatë luftimeve, u shkatërrua 90% e qytezës. Sipas burimeve jozyrtare serbe, numri i ushtarëve dhe i vullnetarëve të vrarë ishte rreth 1, 103 dhe 1, 500, ndërsa numri i të plagosurve arrinte në 2,500. Sipas përllogaritjeve zyrtare kroate, nga radhët e UPJ-së mbetën të vrarë 8,000 ushtarë gjithsej, ndërsa numri i të plagosurve arrinte në 15,000. Nga pala kroate, duke iu referuar sërish burimeve kroate, 621 ushtarë kroatë mbetën të vrarë, 770 u plagosën, dhe 1,527 të tjerë u zunë rob. Pas gjithë kësaj, shumica e banorëve të Vukovarit u larguan ose u dëbuan nga qyteza. Për sa i përket krimeve të luftës të kryera në Vukovar, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ngriti pesë akuza, ndërsa në vitin 2015 u dënuan dy persona. Gjykatat serbe dënuan 15 persona me burgim disavjeçar për krimet në zonën e Vukovarit në vitin 1991. Presidenti serb Boris Tadiç vizitoi Vukovarin më 4 nëntor të vitit 2010 dhe i kërkoi ndjesë të gjitha familjeve të njerëzve të pafajshëm që

→

A. Autokolona e UPJ-së në Beogradin e Ri rrugës për në Vukovar, 1991



Parada e Luftës "Beograd-Vukovar", 1991.24128642&viewfull=1#post24128642, vizituar më 07.07.2016.

B. Pikëpamja serbe: "Vukovari u çlirua më në fund"

FALË LUFTIMEVE TË PANDËRPRERA QË ZGJATËN TRE MUAJ, më në fund Vukovari u çlirua
Rojet e ushtrisë janë pozicionuar para portave të spitalit, ku ishin të shtruar 420 të sëmurë dhe të plagosur. -Edhe Komandanti i Mbrojtjes së Borovo Naseljes u dorëzua. -Nga Vukovari u evakuan rreth 5,000 njerëz. -Mbetet ende për t'u përcaktuar numri i saktë i të vrarëve.

Vukovar, 10 nëntor (Tanjug)
Përplasjet e armatosura në Vukovar morën fund sot, në afërsi të spitalit, ku, sipas burimeve ushtarake, rojet dhe policët kroatë u orvatën të sulmonin institucionin shëndetësor.

UPJ-ja ka dislokuar roje në portat e spitalit, si dhe një njësi ushtarake. Sipas Vesna Bosanacës, drejtoreshës së Spitalit të Vukovarit, në spital janë të shtruar rreth 420 të sëmurë dhe të plagosur, si dhe kanë kërkuar strehim aty 400 civilë.

Spitali nuk do të evakuohet sot, siç ishte parashikuar. Negiociatat, që u ndërmorën nga anëtarët e Kryqit të Kuq, u zhvilluan me vonesë, ndaj evakuimi u shty për të nesërmen.

Sipas burimeve ushtarake, të gjithë civilët që kërkuan strehim në spital, fillimisht duheshin kontrolluar, pasi ata që morën pjesë në luftime nuk do të lejohen të lëvizin lirisht.

Në rrugën "Ive Lole Ribara", që ndodhet në afërsi të spitalit, gazetarët e huaj dhe vendas, kishin parë, jo vetëm sot, por edhe herë të tjera 33 kufoma, kryesisht civilë. Pirgje kufomash ishin gjetur edhe në rrugë të tjera në afërsi të spitalit, duke paraqitur një pamje të llahtarshme.

Duke filluar nga sot, nuk ka më ushtarë kroatë në Vukovar. Të gjithë i janë dorëzuar UPJ-së. […]

Politika, 20 nëntor 1991.

C. Pikëpamja kroate: "Kush po e manipulon tragjedinë e Vukovarit"

Gjatë negociatave, autokolona, që mendohej se do të mblidhte të plagosurit që u sulmuan përgjatë rrugës që lidhte Vinkovcin dhe Nushtarin me raketahedhëse prej Çetnikëve,1 nga fshatrat Ceriç dhe Paçetin. Profesor Hebrangu theksoi se ky sulm na kujton edhe njëherë se me kë kemi të bëjmë, pra me një armik që mund të kryejë gjithfarë veprimesh. [...] Gazetarët morën informata se, mijëra civilë po shtrëngoheshin të largoheshin nga Vukovari me 15 autobusë, që janë ende rrugës. [...] Në konferencën për shtyp, mori pjesë edhe Stevo Bushiçi nga Stafi për Përballimin e Krizës së Vukovarit në Zagreb, i cili tha se, në atë çast, sipas informatave që kishte marrë, vukovarasit po vriteshin dhe jetët e fëmijëve ishin në rrezik. Gjithashtu, ai përcolli zhgënjimin e ushtarëve vukovaras që kishin ardhur në Zagreb, si dhe foli për fëmijët që kishin dhuruar disa herë gjak për të plagosurit dhe për 10 vjeçarët që mbanin pushkë në sup. [...] Profesor Hebrangu iu tregoi gazetarëve rreth asaj çka po ndodhte në Vukovar, pra, rreth përpjekës për të shpëtuar të plagosurit. Gjatë 40 ditëve, të gjitha përpjekjet që u ndërmorën për ta furnizuar spitalin e Vukovarit me barna dhe materiale mjekësore rezultuan të pamundura. Gjashtëqind të plagosur po qëndronin në bodrumet e spitalit pa marrë asnjë ndihmë të mirëfilltë mjekësore, dhe situata u përkeqësua për shkak të pamjaftueshmërisë së gjakut dhe të instrumenteve për të marrë gjak nga civilët. Profesor Hebrangu vërejti se numri i të plagosurve arriti pikën kritike dhe qëndrimi i tyre në spital ishte e pamundur si nga mungesa e hapësirave fizike, ashtu edhe nga mungesa e pajisjeve teknike. [...] Dy orë pasi një përfaqësues i Kryqit të Kuq kishte filluar të përpilonte një listë të të plagosurve, që hamendësohej se ishin me ta në autokolonë, ushtarët e UPJ-së, u sulën drejt spitalit, pavarësisht se ky veprim, siç tha edhe Profesor Hebrangu, binte ndesh me të gjitha rregulloret dhe ligjet ndërkombëtare, sepse asnjë ushtar i armatosur i cilësdo palë nuk duhet të hyjë në spital. Ushtria flaku jashtë përfaqësuesit e Kryqit të Kuq dhe morën nën kontroll centralin telefonik, dhe e gjitha kjo na u përshkrua përmes komunikimit në radio të një përfaqësuesi të kësaj organizate ndërkombëtare. Për më tepër, disa nga të plagosurit u morën me kamionë ushtarakë. [...]

"Tko manipulira vukovarskom tragedijom",
Vjesnik, 21.11.1991.

1 *për Çetnikët shikoni faqen 91.*

D. Vuk Drashkoviçi për Vukovarin (28 nëntor 1991)

Le t'i heqim kapelet në heshtje
Nuk mundem t'i shpreh përgëzimet e mia për fitoren e Vukovarit, që Serbia, e helmatisur nga propaganda e luftës, po e feston me kaq shumë entuziazëm. Nuk mundem, sepse nuk dua t'iu hyj në hak atyre mijëra njerëzve që humbën jetën, apo të mbijetuarve të Vukovarit, që sprovuan dhimbje të zvargur dhe mjerim. [...] Vukovari është Hiroshima e marrëzisë kroate dhe serbe... Çdo qytetar i këtij vendi, që nuk

ekziston më, veçanërisht serbë dhe kroatë, po jeton në ditët e turpit dhe rrënimit tonë më të madh. (*Srpska reč*, 1991)

Vuk Drashkoviçi "Le t'i heqim kapelet në heshtje (28 nëntor 1991) për Vukovarin)
http://www.helsinki.org.rs/serbian/npakteri_t06.html, vizituar më 17.9. 2015.

E. Gjatë luftës, Spitali i Vukovarit ishte mbushur plot me të plagosur dhe funksiononte në kushte shumë të vështira në katin e bodrumit të nëndheshëm



Verthaime-Baletiç, 1993.

1. Krahasoni dokumentet 9B dhe 9C. Cilat të dhëna janë të ngjashme dhe cilat bien ndesh me njëra tjetrën? Cilat informacione mund të gjenden
në të dyja këto burime dhe cilat vetëm në njërën prej tyre? Si e përvijojnë "veten" dhe "palën tjetër"?
2 Lexoni çelësin dhe rendisni disa arsye që mund të shpjegojnë se pse burimet përkatëse serbe dhe kroate ofrojnë shifrat që janë kaq të ndryshme për humbjet e pësuara nga UPJ-ja.
3 Shikoni këtë video në YouTube. Diskutoni deklaratat e kalimtarëve të intervistuar për sa i përket aksionit ushtarak.
B92: Beograd, Serbi 1991 - Bacanje cveca po tenkovima JNA https://www.youtube.com/watch?v=Xz 42ucCGunU, vizituar më 21.10.2015.

II-10. Fushata e Dubrovnikut, tetor 1991-tetor 1992

Më 1 tetor të vitit 1991, forcat e UPJ-së, flota, forcat ajrore dhe Mbrojtja Territoriale e Malit të Zi ndërmorën sulmin kryesor kundër Dubrovnikut. Në fillim të nëntorit, Bashkia e Dubrovnikut u rrethua nga toka, deti dhe ajri, ndërsa në fund të atij muaji, njësitë e armatosura të UPJ-së kishin pushtuar periferitë e Dubrovnikut dhe e kishin rrethuar qytetin. Asokohe, në qytet, jetonin 50,000 banorë dhe refugjatë. Qyteti u godit nga disa mijëra predha. Rrethimi vazhdoi deri në maj të vitit 1992, kur njësitë e armatosura të UPJ-së u tërhoqën. Në tetor të vitit 1992, kur zona e Dubrovnikut u vendos nën kontrollin e forcave të OKB-së, operacionet ushtarake u ndërprenë. Në frontin e luftimeve të Dubrovnikut, morën pjesë rreth 30,000 ushtarë dhe vullnetarë, kryesisht nga Mali i Zi. U vranë 442 ushtarë gjithsej, prej të cilëve, 165 ishin malazezë. Qyteza u mbrojt nga afro 1,000 ushtarë kroatë. Gjatë luftës, në zonën e Dubrovnikut u vranë 417 ushtarë kroatë dhe 92 civilë.

A. Përfundimet e Asamblesë së Malit të Zi, 4 tetor 1991

Ndodhemi në mes të një lufte të pashpallur nga formacionet neofashiste të Ustashëve të Republikës së Kroacisë, kundër Jugosllavisë dhe UPJ-së, që është kundër të gjitha përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje politike për problemet kryesore të vendit. Asambleja e Malit të Zi shpreh përkrahjen e saj të plotë për UPJ-në dhe synimin e saj për të përdorur fuqinë ushtarake që zotëron për të parandaluar luftën civile, përplasjet ndëretnike dhe gjenocidin kundër popullit serb... Organet shtetërore të Republikës së Malit të Zi, dhe të gjitha organet e parashikuara nga programi operativ i masave për fuqizimin e kapacitetit mbrojtës të republikës, të miratuar nga qeveria e Republikës së Malit të Zi, duhet të kryejnë detyrat e tyre deri më një, jo vetëm gjatë kryerjes së veprimeve luftarake në brezin e kufirit me Republikën e Kroacisë, por edhe derisa situata politike përreth Republikës së Malit të Zi të ndryshojë.
Vojiçiç dhe Biserko, 2006, fq. 324-325.

B. Gazeta serbe "Politika", 7 dhjetor 1991

Numri i parë i së përditshmes "Politika" në Beograd, në Mbretërinë e Serbisë u botua më 25 janar të vitit 1904. Botimi u ndërpre gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore.An →

Në shtator të vitit 1987, Kur e përditshmja u vu nën kontrollin e regjimit të Millosheviçit, për gazetën filloi periudha më famëkeqe në historinë e saj, duke u kthyer në një mjet të propagandës populiste. Për këtë qëllim, në vitin 1988, komenteve të ashtuquajtura të lexuesve, iu kushtua një rubrikë e veçantë e quajtur Jehonat dhe Reagimet (Odjeci i reagovanja). Nga fundi i shekullit të XX, krahas veprave të printuara, publikimeve dhe rrjetit të shitjeve në mbarë vendin, gazeta "Politika AD", kishte edhe stacionin e saj të radios dhe televizionit. Pas ndryshimeve politike të vitit 2000 në Serbi, pronësia e gazetës i kaloi medias gjermane WAZ, që në vitin 2012, ia shiti Grupit rus të Mediave Lindore.

LUFTIMET PËRRETH DUBROVNIKUT.
Njësitë paraushtarake kroate sulmojnë UPJ-në, menjëherë pasi ministrat kroatë, në një mbledhje në Cavtat, i siguruan ata se nuk do të hapnin zjarr.

DUBROVNIKU NUK U BOMBARDUA NGA UPJ-JA.
Milan Gvero, zëdhënësi i Sekretariatit Federal për Mbrojtjen Kombëtare (SFMK), i tha dje "Tanjugut" se Dubrovniku nuk u bombardua nga UPJ-ja, dhe që në qytet nuk ra as edhe një grimcë pluhuri nga ana e saj. Ai i cilësoi të gjitha raportimet që ngrinin pretendimin se Dubrovniku ishte bombarduar nga UPJ-ja si "keqinformime tinzare që synojnë të njollosin emrin e mirë të UPJ-së në këtë çast kaq të brishtë të negociatave". Gvero theksoi se ishin forcat kroate rreth Dubrovnikut ata që i sulmuan njësitë e UPJ-së, duke u përpjekur t'i zmbrapsnin në pozicionet e rrethimit, dhe që njësitë e ushtrisë thjesht ishin kundërpërgjigjur. Sipas Gveros, provokimet e forcave të armatosura kroate, u kryen kryesisht në zonën e Srdjsë, dhe UPJ-ja u detyrua të përgjigjej me zjarr, për të parandaluar sulmet e mëtejshme në këtë zonë. Ai tha se UPJ-ja nuk kishte ndërmend ta bombardonte Dubrovnikun, dhe se forcat kroate, duke qenë në dijeni të kësaj, e provokonin ushtrinë që t'i sulmonte, gjë që, siç i mëshonte fort Gveroja, nuk kishte asnjë gjasë të ndodhte. (Tanjug)

Millosheviç, "Politika", 7 dhjetor 1991.

Analizoni gjuhën e këtij artikulli, dalloni faktet nga mendimet personale, si dhe gjeni shembuj të gjuhës subjektive. Synimi i këtij teksti është të informojë, apo ka ndonjë synim tjetër? Tregoni se si përvijohet "pala tjetër" (kroatët), duke gjetur shembuj nga teksti. Në ç'mënyrë e përligj ky burim veprimin ushtarak ndaj Dubrovnikut dhe bombardimin e qytetit? Krahasojeni këtë burim me fotografinë e Dubrovnikut (burimi II-42B).

II-11.Propaganda e luftës

A. Fotografi propagandistike: Artileria e UPJ-së mbi Dubrovnik

Kjo është fotografia më e spikatur nga lufta në zonën e Dubrovnikut, që u publikua në 10 nëntor të vitit 1991, në të përditshmen malazeze pro qeveritare "Pobjeda"
Në fotografi ka dalë një grup artiljerësh të UPNJ-së mbi Dubrovnik. Në diçiturë shkruhet: "Pamje nga Dubrovniku: grup artiljerësh mbi Zharkovicë" (Fotograf Nikica Mihailoviç).



"Pobjeda", 9320, 10 Nëntor 1991.

Çfarë synohet përmes kësaj fotografie? Çfarë mesazhi përcjell ajo?

B. Propaganda mediatike e Millosheviçit

Propaganda mediatike shërbeu si kumtuesja e luftërave që do të zhvilloheshin në Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë; madje, gjatë këtyre luftërave, disa media serbe, që përfshinin
Radio Televizionin Serb, si dhe të përditshmet "Politika", "Politika Ekspres" dhe "Večernje novosti", luajtën rol kyç në propagandën e regjimit të Sllobodan Millosheviçit. Gjatë luftës në Bosnjë-Hercegovinës, e përditshmja "Večernje novosti" paraqiti një shembull të kësaj propagande përmes këtij ekstrakti. Në vitin 1994, "Večernje novosti" botoi veprën e piktorit të shquar serb Urosh Prediç "Jetimi ndanë varrit të nënës" të shekullit të XIX, në formën e një fotografie, ku kishte dalë një djalë jetim nga Srebenica,

[2]"Jetimi ndanë varrit të nënës", Urosh Prediç, kanavacë me bojëra vaji,1888,100x124cm,inv.nr.312,dhuratë e Dr. Mihailo Pupin, Muzeu Kombëtar i Beogradit.

→

teksa qëndronte ndanë varrit të të atit, nënës, vëllezërve dhe të afërmve të tjerë, që ishin vrarë gjatë mësymjes myslimane". Nuk u ngrit as edhe një akuzë e vetme ndaj asnjë redaktori, drejtori mediaje, apo gazetari, për ndihmesën që kishin dhënë në këtë tragjedi dhe luftë.



KUJTIM I HIDHUR

Pjesa dërrmuese e viktimave të luftës janë fëmijët. I njëjti rast vlen edhe për popullin serb, që nuk po lufton për asgjë tjetër veçse për mbijetesë. Në fotografi, që u kthye në kryeartikullin e të gjitha gazetave para një viti e gjysmë, ka dalë një jetim në një varrezë afër Skelanit, i kapluar nga pikëllimi, teksa qëndron ndanë varrit të babait, nënës dhe të afërmve të tjerë, që ishin vrarë gjatë mësymjes myslimane. Edhe sot e kësaj dite, ajo vijon të prekë thellë të gjithë ata që e dinë mirë se ç'duan të thonë vuajtjet e fëmijërisë. Djali në fotografi është birësuar nga një familje nga Zvorniku dhe, aktualisht, është kadet në vitin e parë të shkollës së mesme ushtarake.

"Večernje novosti", 19 Nëntor 1994.

Studioni me kujdes burimet rreth luftës në ish-Jugosllavi. Shumë prej tyre janë rreth përdorimit të propagandës në luftë dhe materialeve të kësaj natyre. Gjejini këto burime. Analizojini duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme: Në cilën prej mediave u publikua burimi (nga cila prej mediave)? Kur u publikua burimi? Për ç'arsye u publikua? Cilët ishin lexuesit e synuar? Përpiloni një listë të shembujve të propagandës, që keni gjetur në këto burime.

	Fotografi-grup artiljerësh të UPJ-së mbi Dubrovnik	*"Politika"*	"Kujtim i hidhur"
Ngjarja			
Lloji i medias			
Kur u publikua burimi?			
Qëllimi i publikimit			
Lexuesit e synuar			
Shembuj			

II-12. Takimi i presidentit kroat Franjo Tudjman me oficerët madhorë të Ushtrisë Kroate, 31 korrik 1995, Brijuni

Presidenti Franjo Tudjman: Zotërinj, këtë takim e organizova për të vlerësuar situatën aktuale dhe për të dëgjuar mendimet tuaja, përpara se të ndërmarr veprime të mëtejshme në ditët në vijim. .[…] Duket se gjendemi përballë një situate të favorshme politike në Kroaci, demoralizimit të radhëve serbe, si dhe gëzojmë përkrahjen e popujve evropian, të asaj pjese të Evropës, që është pro zgjidhjes së krizës dhe Kroacisë. Gjermania, mikja jonë më e ngushtë, na ka ofruar mbështetje jo vetëm për negociatat politike, por edhe në NATO, ku i kanë mirëkuptuar pikëpamjet tona. Gjithashtu, nëse ju zotërinj, kryeni një punë profesioniste, njësoj siç bëtë në Sllovenínë Perëndimore, brenda pak ditëve, ne do të kemi edhe përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, deri në njëfarë shkalle. Kemi vetëm tetë ditë kohë, që do të thotë se operacioni ynë duhet të shtrihet në tre ose katër ditë, jo vetëm për të mos pësuar ndonjë dëmtim politik, por edhe për të arritur që të kemi edhe mbështetjen në arenën ndërkombëtare. […] Duhet të gjejmë një shfajësim për operacionin, që do të kryhet sipas planit të djeshëm, të nesërm, apo sipas planit të djeshëm për të nesërmen, ose të shohim se kur është koha e përshtatshme. […] Armiku duhet shpartalluar përgjatë segmentit jugoro-verior dhe, po jua them shkoqur që tani se, gjatë këtij operacioni, lindja nuk duhet prekur. Përse lindja nuk duhet prekur? Sepse miqtë tanë i druhen përfshirjes së Jugosllavisë në

një "luftë totale" me Rusinë, që do të thotë një luftë e gjithanshme. Prandaj lindja nuk duhet prekur, dhe duhet të merremi vetëm me veriun dhe jugun. Thamë që do të merremi vetëm me veriun dhe jugun, po shtrohet pyetja: Në ç'mënyrë? Ja pra, kjo është edhe tema e diskutimit të sotëm. Ne duhet t'u japim serbëve një goditje të tillë të rëndë, që ata praktikisht të mos ekzistojnë dhe të kapitullojnë brenda pak ditësh edhe në ato zona ku ne nuk veprojmë. Prandaj, plani që kemi hartuar për nesër duhet shqyrtuar sërish dhe ndryshuar. Vendimin do ta marr pasi të kem dëgjuar vlerësimet dhe mendimet tuaja.

http://snv.hr/oluja-u-haagu/media/sg1/sg1-01-brijunski-sastanak-hr.pdf, vizituar më 21.10.2015.

II-13. Urdhri i Shtabit së Mbrojtjes së Civilëve të Republikës së Krajinës Serbe për zbatimin e planeve të evakuimit, 2.08.1995

2 gusht 1995 Knin
Shtabi i Mbrojtjes së Civilëve të Republikës së Krajinës Serbe (RKS), u kërkon punonjësve rajonalë të përpilojnë një raport për zbatimin e planeve të mbrojtjes, evakuimit dhe strehimit të civilëve

REPUBLIKA E KRAJINËS SERBE SHTABI I MBROJTJES SË CIVILËVE
TË REPUBLIKËS SEKRET ZYRTAR I MBROJTJES DOKUMENT SEKRET
Numri: Dokument sekret 01 – 82/95
Knin, 2 gusht 1995

DREJTUAR TË GJITHË PUNONJËSVE TË MBROJTJES CIVILE

Në mbështetje të Urdhrit sekret nr. 01 – 78/95, datë 29 korrik 1994, më 3 gusht të po këtij viti, brenda orës 19:00 dhe jo më vonë, u përpilua raporti që trajton çështjet e mëposhtme:

1. Strehimin (përditësimi i planit, sistemimi dhe përgatitja e mjediseve të strehimit, dhe aktivizimi i popullsisë);
2. Evakuimin (përditësimi i planit, mbështetje materiale, gatishmëria e zbatuesve të këtij plani, ngritja e komisioneve dhe ekipeve për pranimin dhe shpërndarjen e civilëve);
3. Kujdesin (kapacitetet për pranimin e civilëve, disponimi i pajisjeve dhe kushteve për strehim, ushqimi, artikujt e higjienës vetjake dhe të përbashkët);
4. Gatishmërinë e zbatimit të masave për mbrojtje dhe shpëtim (përimtimi i asaj çka është zbatuar dhe planifikuar, duke përfshirë aftësinë e sipërmarrjeve për të marrë pjesë në operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit);
5. Praninë e lëndëve të rrezikshme luftarake dhe masat që janë ndërmarrë për t'u mbrojtur prej tyre;
6. Forcat e mobilizuara për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe forcat në gatishmëri;
7. Vështirësitë e hasura në ndërmarrjen dhe zbatimin e masave të nevojshme.

Hrvatski memorijalno-dokumentacijski centar Domovinskograta [Qendra kroate dokumentuese përkujtimore e Luftës së Atdheut], 2, kutia 265.

1. Lexoni dokumentin II-2, studioni me kujdes hartën "Luftërat dhe Shpërbërja e Jugosllavisë" dhe kontrolloni kronologjinë (fq. 279). Cili ishte qëllimi i mbledhjes? Çfarë operacioni ushtarak ka ndërmend të kryejë Franjo Tudjmani? Përse e përshkroi situatën politike si të favorshme për operacionin? Pse po kërkon shfajësim politik për veprimet e tij? Gjeni në hartë qytezat dhe territoret që përmenden në fjalim. Përmes dokumentit dhe hartës, nxirrni përfundimet tuaja duke iu përgjigjur pyetjeve: Cilat mund të jenë arsyet e ndërmarrjes së një operacioni të tillë? Përse në atë çast, Sllavonia Lindore u la jashtë planeve? Gjeni se ç'ndodhi më vonë.

2. Procesverbalet e asaj mbledhjeje u botuan pak më vonë. Njëra prej fjalive të fjalimit ngjalli shumë polemika, duke u interpretuar në mënyra të ndryshme. Disa mendonin se kjo fjali iu referohej civilëve serbë, ndërsa të tjerë mendonin se përqendrohej kryesisht te forcat ushtarake serbe. A mund ta ilustroni në tekst? Si mund të ndryshojë kuptimi i këtij fjalimi në varësi të këtyre dy interpretimeve?

II-14. Mirëseardhja e ushtrisë kroate pas Operacionit "Stuhia"

Pas dështimit të negociatave ndërmjet autoriteteve kroate dhe serbëve rebelë të Kroacisë, Kroacia vendosi t'i merrte sërish në kontroll zonat e pushtuara përmes përdorimit të forcës ushtarake. Operacioni ushtarak katërditor "Stuhia" filloi më 4 gusht të vitit 1995, pas të cilit, në Republikën e Krajinës Serbe, u rivendos rendi kushtetues dhe ligjor i Republikës së Kroacisë (me përjashtim të Sllavonisë Lindore). Gjatë dhe pas Operacionit "Stuhia", shumica e serbëve që jetonin në Republikën e Krajinës Serbe i braktisën si shtëpitë e tyre, ashtu edhe atdheun. Operacioni "Stuhia" spikati edhe për shkelje tejet të rënda të të drejtave të njeriut, shkatërrimin e pronave të serbëve dhe vrasjen e qindra mijëra civilëve serbë nga forcat e armatosura kroate.



Arkivat Hrvatski Vojnik.

II-15. Luftëtarë të huaj në Luftën e Bosnjës

Në Luftën e Bosnjës, që u zhvillua gjatë viteve 1992-1995, morën pjesë edhe nënshtetas të huaj, që luftonin për arsye politike,fetare,ose si mercenarë. Muxhahedinët, që luftonin për fenë Islame, mbanin anën e myslimanëve (boshnjakëve). Ata formuan një batalion të veçantë brenda ushtrisë boshnjake (për të qenë lehtësisht të kontrollueshëm), që quhej Batalioni i Luftëtarëve të Shenjtë. Numri i saktë i këtyre luftëtarëve nuk dihet ende, por mendohet se numri më i lartë arrin në 6, 000 luftëtarë. Palët serbe dhe kroate, e shfrytëzuan praninë e muxhahedinëve për propagandë, duke pretenduar se po mbronin Evropën e Krishterë. Në Ushtrinë e Mbrojtjes Kroate, u formua një brigadë e posaçme për të huajt, ku vullnetarët vinin kryesisht nga vende evropiane të krishtera si Spanja, Italia, Irlanda, Franca, Hungaria, Austria, por edhe nga Gjermania, Suedia dhe Kosova. Milicia paraushtarake (HOS), që luftoi në Bosnjë, u krijua nga Partia Kroate e së Djathtës. Megjithatë, gjatë vitit 1992, HOS-i u përfshi në shumë pak luftime, pasi kontrollohej nga shteti kroat, dhe më pas, ishte po ky i fundit që e shpërndau. Në krahun serb, vepronin disa njësi paraushtarake çetnike, që vinin nga Serbia dhe Mali i Zi dhe njiheshin si të ashtuquajturit "luftëtarët e fundjavës". Disa vullnetarë vinin nga vende ortodokse, kryesisht nga Rusia, por edhe nga Greqia, Rumania etj. Shumica luftonin për para dhe vepronin më shumë në pjesën perëndimore të Bosnjës, së bashku me ushtrinë e Republika Srpskës. Grekët kishin njësinë e tyre të vullnetarëve, që quhej Roja Greke e Vullnetarëve, që përbëhej nga afro 100 veta. Hamendësohet se, në të gjitha njësitë e armatosura të të gjitha palëve, numri i përgjithshëm i luftëtarëve të huaj nuk e kalonte 5%-shin.

A. Luftëtarët rusë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së



Tafro, 2014, fq. 40.

B. Muxhahedinët



www.glasbrotnja.net,vizituar më 21.10.2015.

Çfarë i shtynte luftëtarët e huaj të merrnin pjesë në Luftën e Bosnjë-Hercegovinës? Rendisni të paktën tre shkaqe.

II-16. Sanksionet ndërkombëtare kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ)

Sanksionet ndërkombëtare kundër RFJ-së për përfshirjen e saj në Luftën e Bosnjë-Hercegovinës, u vendosën në përputhje me Rezolutën e 757 të datës 30 maj 1992. Sanksionet, ndër të tjera, përfshinin ndërprerjen e marrëdhënieve ekonomike dhe pezullimin e bashkëpunimit shkencor dhe kulturor, si dhe RFJ-ja u ndalua të merrte pjesë në aktivitete ndërkombëtare sportive. Me kalimin e viteve, sanksionet herë rëndoheshin e herë lehtësoheshin, derisa më 22 nëntor të vitit 1995, një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Deitonit, që i dha fund luftës në Bosnjë, u hoqën përfundimisht. Sanksionet shërbyen si shtysë për hyrjen, jo vetëm të RFJ-së, por edhe të Kroacisë dhe Sllovenisë, në një krizë ekonomike shkatërruese. Lufta u financua nga hiperinflacioni, që arriti pikun në vitin 1993, dhe i përfshin qytetarët në probleme të rënda ekonomike dhe shoqërore. Gjatë kësaj periudhe, arriti të prodhohej kartmonedha me vlerën më të lartë, prej 500 miliardë dinarësh. Dyqanet u boshatisën dhe njerëzit u detyruan të furnizoheshin në tregun e zi. Duke qenë se nëpër pikat e karburantit nuk kishte më naftë, kjo e fundit shitej në shishe plastike në rrugë nga ndërmjetësit.

A. Jeta e përditshme nën sanksione



→

Kopertina e së përjavshmes së pavarur malazeze "Monitor", botuar të premten, më 6 korrik 1993. Fotografia, që shoqërohet me diçiturën "Qeveria kundër sindikatave deri në raftin e fundit", përqendrohet te raftet e boshatisura të dyqaneve, duke vërtetuar kështu pamjaftueshmërinë e të mirave për shkak të sanksioneve, si dhe inflacionin që arrinte deri në kupë të qiellit. Çmimi prej 800,000 dinarësh i këtij numri, është vendosur në kopertinë.

B. Inflacioni në Serbi. Kartmonedha në kohën e inflacionit në vitin 1993



https://en.wikipedia.org/wiki/Banknotes_of_the_Yugoslav_dinar, vizituar më 21.10.2015.

C. Lufta për bukë në Serbi



"Lufta për bukë: Ndodhi e përditshme e kohëve të fundit", ***"Borba"***, 10-11 korrik1993.

D. Artikulli i gazetës: Një bukë për njeri

Beograd- Megjithëse si furrat e bukës private, ashtu edhe ato shtetërore pretendojnë se përgjegjës për pakësimin e furnizimit të tregut me bukë nuk ishin ata, por pala tjetër, dje pati mungesë të theksuar të këtij artikulli ushqimor. Meqenëse dje u vendos rritja e çmimit të bukës, mbetet ende për t'u parë se cila palë tha të vërtetën. Duhet theksuar se, dyqanxhinjtë, herë me kokën e tyre, e herë me urdhër të seksionit të furnizimit të qytetit, u detyruan ta kufizonin shitjen në dy bukë për njeri, madje, në rastin e Nishit, në një bukë për njeri, pasi qytetarët, për të kursyer para, përpara ngritjes së çmimit filluan të blinin më shumë bukë nga ç'iu nevojitej në të vërtetë, duke i futur në frigorifer në ngrirje. […]

Megjithëse sasia e prodhimit të bukës nuk u pakësua, qytetarët mbanin radhë para furrave që në orën tre të mëngjesit, të bindur se mund të arrinin të merrnin bukë vetëm nëse zgjoheshin në atë orë. […]

Megjithatë, në disa zona të Beogradit, nuk shpërndahej bukë. […] Shumica e beogradasve, që sorollateshin më kot nga një furrë në tjetrën, thonë se nuk gjenin bukë fare.

"Dje nuk gjeta dhe nuk bleva dot asnjë bukë, dhe me shumë gjasa, e njëjta gjë do të ndodhë edhe sot, kështu që më duhet ta gatuaj në shtëpi. Hera e fundit kur bleva qumësht ishte para pesë ditësh", thotë nëpunësi Ruzhica Bogosavljeviç. […]

Prishtina pa bukë për javë të tëra

Prishtinë- Banorët e Prishtinës janë mësuar tashmë me mungesën e bukës, pasi kjo situatë vazhdon prej kohësh. Vetëm ata që ngrihen që në pikë të mëngjesit, që janë shumë pak, munden të zënë radhë dhe të blejnë një copë bukë kaq të vyer për të gjithë. Në Prishtinë, Metohi dhe gjetiu nëpër Kosovë, buka mungon prej javësh. Në hotelin "Grand" dhe në tre a katër dyqane të tjera, ajo u shit në sasi shumë të vogla. Buka vinte nga Rashka, dhe një copë kushtonte 200,000 dinarë. Një njeri lejohej të blinte vetëm dy bukë, maksimumi tre me mik, megjithëse njerëzit kërkonin nga 10 të tilla.

Bukë vetëm për ata që zgjohen që pa gdhirë

Podgoricë -Vetëm disa njerëz që zgjohen që pa gdhirë dhe ata që janë më të fuqishëm fizikisht mund të gjejnë bukë nëpër furrat e Podgoricës, apo të merrnin ndonjë copë, maksimumi dy, nga furnizimet e pakta. […]

"Luftë për bukë: Ndodhi e përditshme e kohëve të fundit",


Borba, 10-11 korrik 1993.

Luftërat jugosllave, megjithëse në mënyra dhe shkallë të ndryshme, i prekën popujt e pjesës më të madhe të territorit të ish Jugosllavisë. Shfletoni burimet e këtij kreu dhe përpiloni një listë të pasojave të tyre.

II.3. RRETHIMI I SARAJEVËS

Rrethimi i Sarajevës ishte një ndër rrethimet më të gjata, pas rrethimit të Stalingradit në Luftën e Dytë Botërore, në historinë e betejave luftarake të ditëve të sotme, pasi zgjati plot 44 muaj. Ai filloi më 5 prill të 1992-shit dhe mbaroi më 29 shkurt të 1996-s, vit kur u shpall zyrtarisht përfundimi i rrethimit të Sarajevës dhe se, më në fund, qyteti ishte çliruar. Gjatë kësaj kohe, qyteti ishte izoluar pothuajse plotësisht nga pjesa tjetër e vendit, dhe kishte mungesa të artikujve ushqimorë, energjisë elektrike, gazit, ujit dhe barnave. Sipas burimeve të ndryshme, përllogaritet se numri i të vdekurve në Sarajevë gjatë kohës së rrethimit arriti në 11,000 njerëz. Në historinë e rrethimit të Sarajevës pleksen bashkë vdekja me mbijetesën.

II-17. Sarajeva nën rrethim



Nga ekspozita në Muzeun "Tuneli i Shpresës", Dobrinja-Butmir, Sarajevë. Fotografi nga Vera Katz.

II-18. Aeroporti i Sarajevës

Situata në kryeqytetin e Bosnjë-Hercegovinës ishte tejet e vështirë. Ushtria serbe, me ndihmën e UPJ-së, kishte pushtuar pa shumë përpjekë, disa vendbanime në Sarajevë si: Ilidzhën, Hadzhiçin, Vogoshçën, Ilijashin dhe Grbavicën. Pushtimi i Aeroportit të Sarajevës nënkuptonte se, qyteti, ishte veçuar nga territoret e tjera të lira. Sarajeva e rrethuar kishte mbetur pa ujë, pa ushqime, pa barna, pa energji elektrike dhe pa gaz. Në qendrën e qytetit ishin dislokuar një grusht njerëzish të armatosur [...]. Megjithatë, marrja e Aeroportit të Sarajevës nga forcat e OKB-së në korrik të vitit 1992, ishte pozitive për banorët e qytetit, pasi filluan të furnizoheshin me ushqime në rrugë ajrore. Por, në një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet OKB-së dhe ushtrisë serbe, që ishte nën komandën e Ratko Mlladiçit tashmë, serbët këmbëngulën që aeroporti të përdorej

vetëm për qëllimet e OKB-së. Aeroporti kishte rëndësi strategjike për ushtrinë boshnjake dhe banorët e Sarajevës, pasi ndodhej ndërmjet qytetit dhe territoreve të lira. Ushtarët e OKB-së respektuan marrëveshjen e tyre me serbët, dhe penguan kalimin e boshnjakëve nga ana tjetër e aeroportit gjatë natës, për t'u bashkuar me familjarët e tyre, ose për të siguruar ushqimet dhe armatimet e nevojshme [...]. Edhe snaiperat serbë, që ndodheshin pranë aeroportit iu vunë punës, për të penguar kalimin e njerëzve në anën tjetër të rripit tokësor, që për disa qindra ishe vdekjeprurëse. Duke marrë shkas nga humbjet e mëdha, duheshin gjetur rrugëzgjidhje të reja.

Edis & Bajro Kolar, broshurë për Muzeun e "Tunelit të Shpresës".

II-19. "Tuneli i Shpresës": Dobrinja-Butmir (D-B) nën Aeroportin e Sarajevës

"Tuneli i Shpresës", ose Tuneli i Sarajevës, u ndërtua nën pistën e aeroportit, për të lidhur Sarajevën me territoret e tjera të lira të Bosnjës, në anën tjetër të aeroportit. Ndërtimi tij përfundoi në korrik të vitit 1993. Tuneli u hap duke gërmuar me krahë, me kazma dhe lopata. Gjatësia e tij arriti në 800 metra, lartësia në një metër dhe gjerësia në 1,5 metra. Përmes tij bëhej furnizimi i mbrojtësve të Sarajevës me materiale ushtarake, barna, ushqime etj.

Ndonjëherë, njerëzve të ndarë në grupe të mëdha u duheshin dy orë për të përshkuar tunelin, i cili përdorej mesatarisht nga afro 4,000 njerëz në ditë. Qeveria gjermane dhuroi një kabllo elektrike, që kalonte në qytet përmes tunelit. Sapo u vunë në dijeni për ekzistencën e tunelit, forcat serbe i goditën me predha të dyja skajet e tij. Shumë njerëz mendonin se, tuneli ishte një ndër faktorët kryesorë që e ndihmoi Sarajevën t'i mbijetonte rrethimit.

A. Pamje ajrore grafike e "Tunelit të Shpresës"



Nga bileta e Muzeut të "Tunelit të Shpresës", Dobrinja-Butmir.

B. Pamje nga brenda tunelit



Fotografi nga Muzeu i "Tunelit të Shpresës" Dobrinja-Butmir, Sarajevë.

II-20. Mbijetesa në rrethim

A. Pyetësori i mbijetesës

Nga e gjenit ujin, energjinë elektrike, cigaret etj…?
- Krijuam njëfarë llambe vajguri vetë, në vend të duhanit dridhnim gjethet e çajit, si ushqim hanim vetëm fasule dhe peshk të qelbur, ndërsa ujin e merrnim nga sternat;
- Jetoja në vijën e parë, që ishte zona që i jepej përparësi më e madhe. Kisha energji elektrike, ujë dhe ngrohje;
Për të gjetur ujë, shkova në Luginën e Pionierëve, gjë që ishte shumë e rrezikshme sepse një snaiper qëllonte gjatë gjithë kohës.
- Ujin e mbusha në bombola dy litërshe, ndërsa ushqim më dha vetëm njësia e Ndihmës Humanitare. […]
- Si mbijetuam? Epo, mendoj se çdo banor i Bosnjë-Hercegovinës mund të shkruajë një libër voluminoz se si mbijetuam në atë gjendje lufte. Ujin e merrnim nëpër puse dhe pellgje, ndërsa gjetja apo marrja hua e energjisë elektrike na vinte ndorësh. Për sa i përket ngrohjes, digjnim rrecka, dhe me raste dru zjarri, që i prisnim te kodra "Zuric". Për cigare, dridhnim gjethet e çajit e të mendrës që i mbështillnim me fletë gazetash të vjetra;
- […]Për t'u ngrohur i vija flakën ndonjë divani, kolltuku apo disa rafteve. Cigare nuk pija;
- […]Digjnim dru zjarri (pemët i prisnim në kopshtin tonë);
- Duke qenë se jam duhanpirës, këmbeja shpesh vaj ushqimor ose ndonjë artikull tjetër ushqimor me cigare;
- Ujin duhet të shkoja ta mbushja, si gjithë të tjerët. Shumicën e kohës nuk kisha energji elektrike dhe për ta siguruar lidhja ndonjë kablol të trashë te ndonjë objekt fetar (xhami). Ngrohje nuk kisha. Më interesonin vetëm cigaret, i këmbeja me ushqime;
- Ujin e mbushja nga pompa, por vetëm natën, energjinë elektrike e vidhja, ndërsa cigaret m'i jepte ushtria. Ngrohje nuk kisha;
- Nuk di t'jua rrëfej se si ia bëra, por mbijetova. [...]

Pyetësori i mbijetesës - Rrethimi i Sarajevës 1992-1996, 2000, fq. 834-924.

B. Treg në Sarajevë



Nga koleksioni i fotografive të Muzeut Historik të Bosnjë-Hercegovinës.

C. "Si të shpëtojmë nga ky ferr". Material serb për mbijetesën

Qyteti i Sarajevës përngjan me ferrin. Nëpër rrugët e qytetit vërshojnë furishëm uria, etja, acari, si dhe sëmundjet e aparatit tretës dhe të lëkurës. Autoritetet myslimane mundohen që banorët të mos e ndjejnë edhe aq urinë, ndërsa serbët dhe të tjerët, për të jetuar, duhet të paguajnë 30 marka gjermane për një kilogram patate, 25 marka për një kilogram oriz, 50 marka për kafe, 10 marka për një gjethe lakre […] . Pesëdhjetë e dy vjeçarja Nada Radosavljeviç, që u largua nga Sarajeva vetëm dy javë më parë, pretendon se ka marrë më pak se një litër vaj nga Ndihma Ndërkombëtare dhe që, po të mos e kishin ndihmuar miqtë, disa prej të cilëve ishin myslimanë, do të kishte vdekur nga uria. Edhe

pesëdhjetë e dy vjeçarja Milena Panduroviçi, që ka jetuar deri para pak kohësh në Sarajevë, mbart vetëm mbresa të këqija. Ajo thotë se serbët i kanë përdorur të gjitha orenditë dhe dërrasat e dyshemesë për t'u ngrohur. Vetëm faqet e mureve të shtëpisë kanë lënë pa djegur. Të gjitha pemët në parkun e Sarajevës janë prerë, sepse njerëzit nuk kishin dru zjarri.
Vetëm pemët e parkut të madh, që ndodhet jashtë Klubit të Punonjësve të Policisë kanë mbetur pa u prerë, se është zonë e minuar. Të tre korridoret, përmes së cilave qytetarët largohen nga qyteti, i japin mundësinë të paktën një të tretës së popullsisë aktuale të Sarajevës, që mendohet se është afro 250,000-300,000 banorë, për t'u larguar nga ai ferr dhe për të shpëtuar kokën.

Daniloviç, 17 dhjetor 1992, fq. 8.

II-21. Sarajeva, Qendra kulturore e Evropës gjatë luftës

"Dimri i Sarajevës", është një festival ndërkombëtar artesh, që zhvillohet historikisht në Sarajevë. Për herë të parë, festivali u organizua nga 21 dhjetori i vitit 1984, deri më 21 mars të vitit 1985. Së bashku me Qendrën Ndërkombëtare të Paqes, festivali "Dimri i Sarajevës" krijoi dhe organizoi projektin "Sarajeva, Qendra Kulturore e Evropës" nga 21 dhjetori i vitit 1993, deri më 21 mars të vitit 1994. Ideja e organizimit të këtij festivali u mbështet nga asambleja e Qytetit të Sarajevës, nga 11,000 figura të shquara nga e gjithë bota dhe institucionet më të rëndësishme të Evropës. Gjatë luftës, "Dimri i Sarajevës" organizoi një mori aktivitetesh të ndryshme.





Afishet e festivalit "Dimri i Sarajevës" 1992, 1993, 1994, 1995 (Muzeu Historik i Bosnjë-Hercegovinës).

Termi urbicid rrjedh nga latinishtja (Latinisht urbus: qytet dhe caedere-të vrasësh) dhe përkthehet si "dhunimi i qytetit". Në Sarajevë, janë shënuar raste dhune, që synojnë kryesisht shkatërrimin e zonës urbane, sidomos pas ngjarjeve që ndodhën.

1. Analizoni mesazhet e këtyre afisheve, duke marrë informacione për simbolet, ngjyrat dhe tekstet. Pse afishja e parë përqas Berlinin dhe Sarajevën? Mësoni më shumë rreth historisë së albumit të Pink Flojdit të titulluar "Muri", dhe filmit që u frymëzua prej tij, si dhe përpiquni të zbuloni se përse mund të jetë përdorur imazhi i saj për afishen e parë.

2. Krijoni historinë tuaj rreth "Tunelit të Shpresës" accompanying duke përdorur materiale pamore, dokumente, harta dhe tekstet që shoqërojnë këtë kapitull, si dhe njohuritë që keni për luftën e Bosnjë-Hercegovinës. Ndërthurni informacione nga burime të ndryshme. Merrni parasysh elementet e mëposhtme: procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, shkaqet dhe rrjedhën e luftës së Bosnjë-Hercegovinës, palët kundërshtare, rrethimin e Sarajevës dhe se si t'i mbijetosh luftës.

II.4. KAMPET

II-22. Kampet e të burgosurve në Bosnjë-Hercegovinë, 1992-1995

Sipas informacioneve të shoqatave të të burgosurve, gjatë luftës në Bosnjë-Hercegovinë kishte rreth 1,360 kampe dhe qendra të tjera ndalimi, prej të cilave 656 ishin për boshnjakët, 173 për kroatët dhe 532 për serbët. Autorët dhe rrethanat e vrasjes së afro 1,000 të burgosurve janë gjykuar nga gjykatat e Bosnjë-Hercegovinës dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, me akuzën e dhunimit të rregulloreve ndërkombëtare për trajtimin e civilëve dhe robërve të luftës. Sipas burimeve të pavarura, në këto qendra ndalimi janë dërguar, në intervale të ndryshme kohore, rreth 200,000 qytetarë të Bosnjë-Hercegovinës, kryesisht civilë.

A. Kampi në Omarska

Jeta e qytetarëve të Prijedorit (Krajinës Boshnjake) mori rrjedhë krejt tjetër, pas pushtimit të qytetit nga Partia Demokratike e Serbëve (PDS). Autoritetet e reja ritën praninë e forcave ushtarake, dhe iu shpallën luftë propagandistike të gjithë atyre që nuk ishin serbë. Në mbështetje të vendimeve të "Shtabit të Përballimit të Krizës", në të gjithë bashkinë, u ndërmorën sulme të armatosura kundër joserbëve. Atmosfera e frikës në Prijedor, kulmoi me ngritjen e kampeve të burgimit në Omarska, Keraterm dhe Trnopolje me vendim të Shtabit për Përballimin e Krizës.



www.radiosarajevo.ba, marrë më 21.10.2015.

B. Kampet për boshnjakët dhe kroatët

[...] 13) Dhoma Gjyqësore pohoi se vrasjet nëpër kampe ishin tejet të shpeshta. Fakti se disa masakra u kryen, midis të tjerash, në qelinë numër tre të kampit të Keratemit, më 24 korrik të vitit 1992, është i padiskutueshëm. Nga fundi i korrikut, në kampin e Omarskës, u vranë mbi 100 njerëz, ndërsa vetëm në datën pesë gusht, po nga ky kamp, u morën dhe u larguan me autobusë afro 120 të burgosur, të cilët më pas u vranë. Më 21 gusht, anëtarët e Togës së Ndërhyrjes së qytetit të Prijedorit Prijedorit, që po shoqëronte një vargan të dëbuarish, vrau rreth 200 prej tyre në Bashkinë e Vlashiçit. Sipas përllogaritjeve të Dhomës Gjyqësore, humbën jetën mbi 1,500 qytetarë, prej të cilëve janë identifikuar vetëm 485.

14) Në këto kampe janë kryer krime seksuale si përdhunime, dhe mijëra njerëz janë trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, si rrahje dhe tortura fizike të përditshme. Të burgosurit jetonin në kushte higjienike të këqija dhe ushqimi që u jepej mjaftonte sa për të mbajtur frymën gjallë.

15) Myslimanët boshnjakë, që jetonin në Bashkinë e Prijedorit, kanë vuajtur nga dëbimi i dhunshëm masiv prej shtëpive dhe nga banimi i tyre. Këto dëbime organizoheshin kryesisht në varganë dhe mbikëqyreshin nga autoritetet serbe të Prijedorit. Shpërngulja, kryesisht e qytetarëve joserbë të Prijedorit, filloi në vitin 1991, por përmasat e saj filluan të zmadhoheshin pak para marrjes së pushtetit, duke arritur kulmin gjatë muajve të parë. Kjo përndjekje shënoi 20,000

viktima. Shumica u larguan me autokolona autobusësh dhe kamionësh, që niseshin përditë nga kjo zonë.

16) Shtëpitë e joserbëve, pasi shënjoheshin, shkatërroheshin. Të njëjtin fat pësuan edhe xhamitë e myslimanëve dhe kishat e të katolikëve.

Përmbledhje e procesit gjyqësor të rastit të Dr. Milomir Stakiç të Dhomës Gjyqësore numër 2, http://www. icty.org/x/cases/stakic/tjug/bcs/030731_summary_bcs.pdf, marrë më 08.07.2016.

C. Kampi "Çelebiçi" në Konjic për serbët

Kampi "Çelebiç" në Konjic gjatë periudhës maj-dhjetor të vitit 1992 shërbente si burg për civilët me kombësi serbe.

Gjatë luftës në Bosnjë-Hercegovinë dhe konfliktit të armatosur ndërmjet Ushtrisë së Bosnjë-Hercegovinës dhe të Republikës Serbe të Bosnjë-Hercegovinës, civilët serbë që mbaheshin në kampin "Çelebiç" në Bashkinë e Konjicës gjatë periudhës maj-dhjetor të vitit 1992, jetonin në kushte çnjerëzore, dhe iu nënshtroheshin vrasjeve, torturave dhe keqtrajtimeve fizike e mendore të shkaktuara me paramendim. Eso Macici, si pjesëtar i Ushtrisë së Bosnjë-Hercegovinës, veproi në kundërvajtje me dispozitat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, duke shkelur Nenin 3, pikën 1, gërmat a) dhe c) të Konventave të Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë të 12 gushtit, 1949 në rastet e mëposhtme:

2) Në pesëmbëdhjetë ditëshin e parë të muajit qershor të vitit 1992, me rastin e festës fetare të myslimanëve të Kurban Bajramit, ai vrau në kampin "Çelebiç" Milorad Kuljanin (lindur në vitin 1966). Kurnjëri nga rojet tha se duhej të bënin kurban për festën e Bajramit, ai e qëlloi Milorad Kuljanin në kokë dhe në gjoks nga një metër largësi, duke e lënë të vdekur në vend.

3) Në pesëmbëdhjetë ditëshin e muajit qershor të vitit 1992, në një datë të papërcaktuar, ai së bashku me disa roje të Kampit "Çelebiç", para godinës numër 22, mori pjesë në trajtimin çnjerëzor dhe torturimin fizik e mendor të Momir dhe Velibor Mrkajiçit, duke i goditur dhe rrahur egërsisht palët e dëmtuara. Pas kësaj, ata u urdhëruan të hynin në një pusetë të ujërave të zeza me përmasa dy me dy metër, ku qëndruan për mbi nëntë orë, bashkë me disa të burgosur të tjerë, njëri prej të cilëve ishte Velimir Kuljanin, duke përjetuar kështu vuajtje të mëtejshme fizike dhe mendore.

Procesit gjyqësor kundër Eso Maciçit, www.sudbih.gov.ba/, marrë më 21.10.2015.

D. Kampet Kroate për serbët në Dretelj (1992-1993)

Kampi Dretelj '92, që ishte ndërtuar nga Forcat e Armatosura Kroate (HOS), shërbente për boshnjakët, dhe ishte krijuar nga Këshilli i Mbrojtjes Kroate (HVO-Ushtria e Kroatëve të Bosnjës) në prill të vitit 1993. Kur kampi u mbyll në fillim të tetorit të vitit 1993, të burgosurit u transferuan në kampet e Gabelas dhe Heliodromit.

Kampi Dretelj '92



www.bhrt.ba, marrë më 21.10.2015.

KAMPET DRETELJ '92 DHE DRETELJ '93

"Kampi Dretelj '92": Në maj të vitit 1992, Forcat e Armatosura Kroate (HOS) krijuan një kamp në Dretelj për civilët serbë të Mostarit dhe tëendbanimeve përreth. Nga fillimi i majit e deri më 18 gusht të vitit 1992, në këtë kamp u burgosën të paktën 224 serbë, pesë prej të cilëve, për të mos thënë më shumë, u vranë ose gjetën vdekjen si pasojë e dëmtimeve të pësuara gjatë rrahjeve. Më 13 prill të vitit 2013, Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Norvegjisë dënoi Mirsad Repak, një ish-anëtar të HOS-it me tetë vite burgim.

"Kampi Dretelj '93": Njëra prej depove të UPJ-së filloi të përdorej si kamp në prill të vitit 1993. Këshilli i Mbrojtjes Kroate (HVO) filloi të burgoste boshnjakët e arrestuar nga të gjitha zonat e Bosnjës. Në mesin e

muajit korrik të vitit 1993, në këtë kamp ndodheshin 2,270 boshnjakë, prej të cilëve disa ishin të mitur, e shumë të tjerë mbi pesëdhjetë vjeçarë. Të paktën gjashtë të burgosur u vranë ose gjetën vdekjen si pasojë e torturave. [...] Më 29 maj të vitit 2013, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për ish-Jugosllavinë, dënoi gjashtë ish-udhëheqës të bashkësisë kroate, që më vonë u njoh si Republika e Herceg-Bosnjës, për krimet që kishin kryer kundër myslimanëve dhe qytetarëve të tjerë jokroatë gjatë viteve 1991-1994. Gjyqtarët morën vendim unanim duke e dënuar Jardanko Prliçin, ish-Kryeministrin e Herceg-Bosnjës, me 25 vjet burgim; Bruno Stojiçin, Ministrin e Mbrojtjes, Sllobodan Praljakun dhe Milivoj Petkoviçin, komandantët e Këshillit të Mbrojtjes Kroate, me 20 vjet burgim secilin; Valentin Çoriçin, Komandantin e Policisë Ushtarake me 16 vjet burgim; dhe Berislav Pushiçin, kryetarin e Zyrës së Shkëmbimit të të Burgosurve me 10 vjet burgim.

Qendra për Demokracinë dhe Drejtësinë Tranzitore, http://cdtp.org, *vizituar më 21.10.2015.*

1. Studioni burimet në kapitullin II-22 për kampet e përqendrimit. Më pas, kujtoni se ç'rol kanë luajtur këto kampe në historinë bashkëkohore evropiane të shekullit të XX. Në varësi të periudhës, zbuloni arsyen kryesore të përndjekjeve. Si mendoni, përse trajtimi çnjerëzor i shtetasve të "palës kundërshtare", është kaq i rëndësishëm në kohë lufte? Diskutoni.

2. Përse në kohën e luftës në Bosnjë-Hercegovinë vlera e jetës njerëzore zvetënohej? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ndërthurni informacionet nga burimet e këtij kapitulli me ato të kapitujve të tjerë.

3. "Lufta totale" përkufizohet si një lloj përleshjeje që përfshin civilët, si objekte ushtarake legjitime, si dhe përdorimin e armëve dhe taktikave, që shkaktojnë vdekjen e një numri civilësh. A do ta përkufizonit luftën në Bosnjë-Hercegovinë si "luftë totale"? Argumentojeni përgjigjen tuaj përmes fakteve të paraqitura në burimet e këtij kapitulli.

C II.5. LUFTËRAT E PERIUDHËS 1998-2001

II-23. Lëvizja paqësore e Rugovës për pavarësi

Ibrahim Rugova (1944-2006), ishte Presidenti i parë i Republikës së vetëshpallur të Kosovës gjatë viteve 1992-2000 dhe 2002-2006.

Ai përkrahu shpalljen e pavarësisë përmes lëvizjes paqësore, duke fituar kështu epitetin"Gandi i Ballkanit". Në rininë e tyre u mor me gazetari e letërsi, dhe në vitin 1968, mori pjesë në protestat e studentëve në Kosovë. Gjithashtu, ai ishte anëtar i Partisë Komuniste Jugosllave. Në vitin 1989, kur Presidenti i Serbisë Sllobodan Millosheviçi shfuqizoi autonominë e Kosovës, duke e kthyer krahinën në statusin që kishte para vitit 1974, Rugova, që ishte kthyer në udhëheqësin jozyrtar të shqiptarëve të Kosovës, ishte një prej 215 nënshkruesve të "Apelit të intelektualëve të Kosovës" kundër vendimit të Millosheviçit. Në po të njëjtin vit, shqiptarët e Kosovës, bojkotuan zgjedhjet jugosllave dhe serbe, dhe më pas, vitin tjetër, anëtarët e ish-Asamblesë Krahinore të Kosovës brenda Jugosllavisë, shpallën në mënyrë të paligjshme, Republikën e Kosovës, një shtet të ri, por që nuk u njoh nga shtetet e tjera (shihni kapitullin I, dok. I-14). Rugova u bë udhëheqësi i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), një partie të sapoformuar politike, së cilës iu bashkuan edhe 700,000 shtetas të tjerë, pra, pothuajse e gjithë popullsia në moshë madhore e shqiptarëve të Kosovës, duke fituar kështu zgjedhjet e majit të vitit 1992. U formua Kuvendi dhe qeveria "hije" e Kosovës, që formoi një sistem shoqëror dhe arsimor paralel me atë zyrtar. Më pas, Rugova jo vetëm që fitoi zgjedhjet e para presidenciale, që u mbajtën në Republikën e Kosovës, që nuk ishte njohur zyrtarisht, por në vitin 1998 siguroi edhe një mandat të dytë. Si president, ai vijoi të ndiqte rrugën e lëvizjes politike paqësore, që synonte pavarësinë e plotë.

Megjithëse në fillesë, strategjia e tij e qëndresës pasive gëzoi mbështetje unanime, në vitin 1997, ai u përball me kundërshtinë e ithtarëve të qëndresës së armatosur, që kishin formuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Shumë shpejt, mbështetja që kishte fituar deri në atë kohë filloi të rrëgjohej, ndërsa përkrahja për Hashim Thaçin, udhëheqësin politik të UÇK-së, rritej dita ditës. Kuvendi "hije" i Kosovës, kishte propozuar që, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, që do të merrte pjesë në bisedimet shumëpalëshe (të pasuksesshme) të Rambujesë në vitin 1999, të udhëhiqej nga Thaçi, dhe jo nga Rugova.

Gjatë bombardimit të Jugosllavisë nga NATO-ja, Rugova, së bashku me familjen e tij, u mbajtën nën arrest shtëpie për disa javë. Në fillim të muajit prill të vitit 1999, ai u detyrua të shfaqej së bashku me Millosheviçin në një emision televiziv në Beograd, ku bënte thirrje për përfundimin e luftës. Në maj të vitit 1999, ai u lejua të largohej nga Kosova dhe të mërgonte përkohësisht në Itali. Ai u kthye në Kosovë në muajin korrik, kur Kosova administrohej nga OKB-ja. Ibrahim Rugova arriti të fitonte zgjedhjet →

e zhvilluara në tetor të vitit 2000, me 58% të votave kundër Hashim Thaçit dhe UÇK-së, që kishin siguruar vetëm 27% të votave,pasi, megjithëse UÇK-ja ishte pritur krahëhapur nga shqiptarët e Kosovës si çlirimtarë, ndaj saj ishin ngritur akuza për përfshirje në krimin e organizuar, zhvatje dhe ushtrim dhune ndaj kundërshtarëve politikë dhe grupeve të pakicave etnike. Rugova vijoi të përballej me kundërshtime të dhunshme deri në vdekje. Më 15 mars të vitit 2005, ai i shpëtoi një përpjekjeje për ta vrarë, kur një kazan plehrash u hodh në erë nga një bombë, teksa makina e tij po kalonte atypari. Ai ndërroi jetë në janar të vitit 2006, pas një lëngimi të gjatë nga kanceri i mushkërive.



Gazeta "Mladina", Slloveni, autor Denis Sarkiç, 2003.

II-24. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

Megjithëse u krijua në nëntor të vitit 1997, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) filloi të kryente sulme të armatosura kundër autoriteteve serbe, kryesisht rajoneve të policisë, që në shkurt të vitit 1996. Fillimisht, ajo vepronte në zonën e Drenicës dhe Prizrenit, por më pas, veprimtaria e saj u zgjerua, duke përfshirë edhe zona të tjera të Kosovës. UÇK-ja furnizohej me armë në rrugë të paligjshme, kryesisht nga Shqipëria. Mendohet se numri i anëtarëve të saj u rrit nga 6,000 në 25,000. Autoritet serbe e shpallën UÇK-në organizatë terroriste. Sulmet e UÇK-së dhe konflikti i armatosur, që thellohej gjithnjë e më shumë, sollën emigrimin në masë të popullsisë serbe. Autoritet serbe u përgjigjën duke dislokuar forca të përforcuara policie dhe njësi ushtarake në vend. Në Kosovë filluan të vepronin njësitë paraushtarake serbe. Rrjedhimisht, popullsia shqiptare ose u arratis, ose u dëbua në masë. Gjatë periudhës 24 mars-10 qershor të vitit 1999, NATO-ja kreu sulme ajrore kundër Serbisë, megjithëse kjo ndërhyrje nuk gëzoi përkrahjen e Këshillit të Sigurisë së OKB-së. Më në fund, lufta përfundoi përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje në qershor të vitit 1999, në Kumanovë, ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë, që përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi, dhe KFOR-it, Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare. Forcat jugosllave u tërhoqën, dhe Kosova u vu nën kontrollin e OKB-së (UNMIK-ut).

→

A. Deklarata nr.8 e UÇK-së, shtator 1998

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) ka përkrahur me vendosmëri dhe vetëdije të plotë rrugën drejt lirisë dhe pavarësisë; dhe në shumë raste e për një kohë të gjatë, ka ftuar forcat politike, intelektuale dhe profesionale t'i bashkohen UÇK-së, për të realizuar vullnetin e përgjithshëm. UÇK-ja, jo vetëm që e ka përkrahur lirinë dhe bashkimin, por po lufton me vendosmëri në këtë drejtim, për të gjetur një zgjidhje për kauzën shqiptare, që siç duket, është e pazgjidhshme. Për UÇK-në dhe Shtabin e saj të Përgjithshëm, çdo zgjidhje e përkohshme që e lë Kosovën nën sundimin e Serbisë, apo që e bën pjesë të saj, është e papranueshme. Çdo marrëveshje të nënshkruar nën këto kushte, e konsiderojmë dhe e shpallim si tradhti të lartë kombëtare.

[…]Të gjithë ne jemi mbështetës dhe përkrahës të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe popullit të saj, që është edhe çështja më madhore e kombit tonë. Ata që nuk luftojnë për liri dhe pavarësinë e institucioneve të Kosovës, në emër të humanizmit, mbështesin forcat antikombëtare dhe antidemokratike, që dëshirojnë dhe vijojnë të kërkojnë zhdukjen e Shqipërisë dhe të kauzës shqiptare në përgjithësi.

[…] Vetëm një Shqipëri e qëndrueshme, e fortë, e lirë dhe demokratike do të mund të garantojë jetën dhe pronat private e kolektive të të gjithë shqiptarëve në të gjithë botën. I bëjmë thirrje bashkësisë ndërkombëtare që ta ndihmojë sinqerisht Shqipërinë, t'i ndalojë dhe t'i luftojë me drejtësi dhe vendosmëri zhvillimet e kobshme kundër shqiptarëve dhe popullit shqiptar në përgjithësi, të mbështesë me vendosmëri dhe konkretisht çështjen e Kosovës, dhe t'i ndihmojë shqiptarët të shpëtojnë nga rreziku i barbarive serbe.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës;
Fondi "Koha Ditore".

B. Deklaratë për shtyp e UÇK-së, 23 shtator 1998

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS
Drejtoria e Informacionit
Deklarata për shtyp nr. 55
[…]Lufta e popullit tonë po hyn në fazën e ballafaqimeve të fundit me armikun tonë shekullor. Prandaj, iu bëjmë thirrje të gjithë bashkëkombësve që të na bashkohen dhe të angazhohen në kauzën e drejtë të luftës sonë, që vërtet mund të jetë e gjatë, e vështirë dhe plot sakrifica, por fitorja nuk ka qenë kurrë kaq e afërt dhe e prekshme. Ne i kemi hyrë kësaj lufte për t'u vetëflijuar dhe, nëse angazhohemi të gjithë, pasojat negative do të pakësohen dhe kjo do të jetë një ndihmë për të gjithë ne. Vetëm së bashku, pa përjashtuar askënd, mund ta rrokim fitoren. […] Iu shprehim ngushëllimet tona të sinqerta të gjitha familjeve të dëshmorëve, dhe i sigurojmë se lufta jonë e drejtë do të vazhdojë.

Nderime për dëshmorët!
Fitore!

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës; Fondi: "Koha Ditore".

Sipas këtyre burimeve, cilat ishin qëllimet kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

C. UÇK-ja sulmon policinë serbe. Artikull i një gazete serbe

Operacionet e armatosura të së ashtuquajturës UÇK, janë shtuar që pas përpjekjes së policisë serbe për të spastruar Drenicën në muajin mars. Terroristët mësyjnë shtëpitë dhe kontrollojnë rrugët, ndërsa Ushtria Jugosllave lufton kundër kontrabandistëve të armëve në kufirin shqiptaro-jugosllav. Aktualisht, po përdoren armatimet më të sofistikuara të këmbësorisë. Nga mesi i janarit, janë organizuar 70 operacione terroriste, ndërsa në mars, numri i sulmeve tejkalonte 130-n. Në 46 sulme të terroristëve shqiptarë janë vrarë 8 persona, dhe janë kryer 45 kallëzime penale ndaj autorëve të paidentifikuar. Burimet shqiptare thonë se, në operacionin e policisë në Drenicë, janë vrarë mbi 100 shqiptarë. Serbët e zonës së Deçanit, të tmerruar nga sulmet e ushtarëve të maskuar të UÇK-së, po kërkojnë strehim nëpër manastire. Ushtria Jugosllave po i dislokon forcat e saj në kufirin me Shqipërinë. Krijimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 22 prill të vitit 1996; dhe sulmet në Deçan, Peç, Shtimlje dhe Mitrovicë; ku u vranë pesë serbë dhe u plagosën pesë të tjerë tregojnë se nëse nuk gjendet shpejt një zgjidhje paqësore, numri i viktimave do të shtohet. […] Krahas sulmeve terroriste, pati edhe 13 incidente të tjera, që përfshinin ndalimin e automjeteve nga persona të maskuar dhe të armatosur, për t'iu kërkuar pasagjerëve dokumentet e identifikimit në kërkim të disa personave, dhe në dy raste, persona po të armatosur dhe të maskuar, i mësynë rajonet e policisë dhe godina të tjera, duke marrë të gjitha armatimet…

"Naša Borba", 16 Maj 1998,http://www.yurope.com/nasa-borba/arhiva/Maj98/1605/1605_14.HTM, vizituar marrë më 13.11.2015.

Krahasoni dy burimet e mësipërme, si atë në gjuhën shqipe, ashtu edhe atë të botuar në gazetën opozitare serbe. Analizoni gjuhën e përdorur dhe gjeni
fjalët dhe shprehjet që tregojnë se si paraqitet pala kundërshtare.

Serbët në burimet shqiptare	Shqiptarët në burimet serbe

II-25. Mijëra shqiptarë etnikë mblidhen në Shkup, për të mbështetur bashkëkombësit e tyre në Kosovë, duke kërkuar ndërhyrjen e ndërkombëtarëve

Në Shkup dhe në qytezën e Tetovës të Maqedonisë Perëndimore, që shërbente si bastion politik shqiptar, një ditë më parë, u mblodhën disa mijëra vetë, siç ishte rënë dakord më përpara, për të protestuar kundër dhunës së policisë dhe Ushtrisë Jugosllave në Kosovë, dhe reagimit të papranueshëm të bashkësisë ndërkombëtare. Të dyja protestat nisën me himnin kombëtar shqiptar, dhe mbi kokat e tubuesve, valëviteshin vetëm flamuj të Republikës së Shqipërisë, që në këtë mënyrë ligjërohen si flamujt kombëtarë të pakicës shqiptare.

Raportim i gazetarit Budo Vukobrat: "Shqiptarët po e kalojnë cakun", AIM (Rrjeti Alternativ i Informacionit)) Shkup, 11 Mars 1998: http://www.aimpress.ch/dyn/trae/archive/data/199803/80316-019-trae-sko.htm, marrë më 8.07.2016.

II-26. Kufiri shqiptaro-jugosllav në kohën e krizës së Kosovës, pranverë e vitit 1999

Gjatë bombardimeve të NATO-s, në vijim të veprimeve të ndërmarra nga policia dhe ushtria serbe, qindra mijëra shqiptarë u dëbuan nga Kosova, gjë që solli lindjen e një krize të madhe humanitare.



http://www.nato.int/pictures/review/9902/b9902-13.jpg, vizituar më 8.07.2016.

II-27. Rasti i Reçakut në Kosovë

Policia serbe dhe UÇK-ja u përleshën në fshatin Reçak të Kosovës, më 15 janar të vitit 1999. Edhe sot e kësaj dite, pikëpamjet rreth kësaj ngjarjeje, janë krejt të kundërta. Sipas organizatës Human Rights Watch, OSBE-së dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, ajo çka ndodhi në Reçak ishte një masakër e pastër e e ndërmarrënga forcat e sigurisë serbe ndaj civilëve shqiptarë. Autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë pretenduan se të gjithë personat e vrarë kishin qenë ushtarë të UÇK-së, dhe që ishin angazhuar në përplasjet e armatosura me forcat e sigurisë. Gjithashtu, të tre raportet mjekoligjore krijuan kundërshti. Këshilli i Sigurisë së OKB-së e dënoi ashpër masakrën ndaj shqiptarëve të Kosovës në Reçak, dhe rasti shihet si një prej faktorëve kryesorë që nxitën bombardimin e RFJ-së nga NATO-ja. Për shkak të provave të pamjaftueshme, rasti i Reçakut, nuk u përfshi në padinë që Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë kishte ngritur ndaj zyrtarëve jugosllavë të nivelit të lartë. Në qershor të vitit 2001, Gjykata e Prishtinës dënoi Zoran Stojanoviçin me 15 vite burgim për vrasjet dhe përpjekjet për vrasje që kishte kryer në Reçak, por u fal në vitin 2007 për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, dhe u lirua me kusht. Asnjë nuk u dënua për përfshirjen në këtë masakër, të paktën deri në vitin 2015.

A. Raporti mjeko-ligjor i ekipit të specialistëve të BE-së për ngjarjen e Reçakut: Deklarata e Dr. Helena Ranta, 17 mars, 1999

[…]Duhet theksuar se, specialistët e BE-së, kanë kryer vetëm një pjesë të hetimit të përgjithshëm në lidhje me ngjarjen e Reçakut, përkatësisht të hetimit mjekoligjor. Për të pasur një panoramë sa më të plotë të asaj ç'ka ndodhi në Reçak, duhet të kryhet hetimi i plotë penal i ngjarjeve, duke ndërthurur hetimin e skenës së krimit, marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe analizën e provave, së bashku me përfundimet e autopsisë së specialistëve.

[…]Në rrobat e viktimave nuk u gjet asnjë distinktiv apo shenjë dalluese identifikuese e ndonjë njësie ushtarake. Nuk ka asnjë tregues se distinktivët apo shenjat dalluese jenë hequr. Në bazë të përfundimeve të autopsisë dhe fotografive të skenës së krimit, nuk ka asnjë gjasë se rrobat janë ndryshuar apo hequr. Nuk ka asnjë tregues që në mesin e këtyre njerëzve ka pasur edhe civilë të armatosur.

Ngjarja e Reçakut u përshkrua si masakër. Megjithatë, as ekipi mjekoligjor i BE-së, dhe asnjë prej personave që morën pjesë vetëm në hetimin e trupave, nuk kanë kompetencat e duhura për të dalë në një përfundim të tillë. Termi masakër nuk mund të bazohet vetëm te faktet mjekoligjore, pasi është një përshkrim ligjor i rrethanave të vdekjes së njerëzve, dhe gjykohet përmes një analize më gjithëpërfshirëse e të gjithë informacionit të disponueshëm. Prandaj, është më e përshtatshme, që ky term të përdoret nga organet që po kryejnë hetimin penal, me qëllim nisjen e ndjekjes penale. Për më tepër, hetimet mjekoligjore nuk mund t'i japin një përgjigje përfundimtare pyetjes nëse u zhvillua apo jo ndonjë betejë, apo nëse viktimat vdiqën në rrethana të tjera. Hetimi i plotë penal, i ndërthurur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga organet përkatëse të hetimit, mund të hedhë më shumë dritë rreth rrethanave të vdekjes para dhe në çastin e vrasjes.

Burimi: Agjencia e Informacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

B. Artikull nga revista opozitare serbe ''Vreme" për rastin e Reçakut

Autoritetet jugosllave pretendojnë se, të dyzetë shqiptarët që u vranë, ishin të armatosur, kishin hapur zjarr kundër tyre dhe mbanin veshje ushtarake, por gjatë natës, ishin ndërruar me rroba civile. Pala shqiptare pretendon ende se ata ishin civilë të paarmatosur, që policët serbë, me ndihmën e vullnetarëve serbë, i kishin vrarë thjeshtë për hakmarrje. […]

Pas një vizite të shkurtër në vendin ku ndodhi tragjedia, Uilliam Uokëri (William Walker), kreu i Misionit të Verifikimit në Kosovë, tha se ai nuk "ngurron aspak ta përshkruajë ngjarjen si masakër dhe krim kundër njerëzimit". "Nuk ngurroj aspak, që për këtë krim, të akuzoj forcat qeveritare", u shpreh Uokëri. Kjo deklaratë, që u dha prej tij para se të ndërmerrej hetimi, shkaktoi një varg akuzash, kërcënimesh dhe trysnie kundër autoriteteve jugosllave, që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. […]

Përfundimet e hetimit, që natyrisht do të kryhet nën mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve, çfarëdo qofshin, nuk mund t'i eliminojnë pasojat e kësaj trazire politike, e cila u shkaktua nga interpretimi që Ambasadori Uilliam Uokër iu paraqiti mediave rreth ngjarjes së Reçakut.

Zoran B. Nikoliç, "Tragjedia e Reçakut , provë e nxehjes së gjakrave", "Vreme", nr. 431, 23 Janar 1999



http://www.vreme.com/arhiva_html/431/index.html, vizituar më 7. 04. 2015.

A. Artikull nga gazeta kosovare ''Koha Ditore'' për Reçakun, 17.1.1999

REÇAK, 16 JANAR– Në mëngjesin e së shtunës, në një kodrinë mbi fshatin Reçak, që ndodhet në periferi të Shtimes, shtriheshin 23 trupa civilësh shqiptarë.

Me ndihmën e Ushtrisë Jugosllave, dhe me shfajësimin se po kërkonin një grup terroristësh, forcat serbe filluan ta sulmonin këtë fshat në orët e para e mëngjesit të djeshëm.

Sot, viktimat, që ishin nga 18 deri në 80 vjeç, u përcollën përmes fshatit, për t'u prehur në varrezat e kodrave përreth. Të shtunën, fshatarët e Reçakut, u gdhinë duke numëruar trupat e pajetë të të afërmve të tyre në çdo cep shtëpie. Katër prej tyre janë nga familja Haxhaj; këta janë dy vëllezër; këta të dy të tjerët janë babë e bir; këta i përkasin së njëjtës familje. Këto ishin fjalët e një fshatari, që i kishte shpëtuar asgjësimit të djeshëm nga forcat policore serbe, teksa po identifikonin pirgun me trupat e pajetë të fshatarëve, që ishin masakruar në një hendek në Kodrën e Babushit.

[…]

Sulmi serb dhe asgjësimi i dhjetëra civilëve shqiptarë, u krye pas lirimit të ushtarëve të Ushtrisë Jugosllave, që ishin zënë rob nga forcat e UÇK-së, pavarësisht shpresave se situata po qetësohej. Tani, që gjendemi në prag të kaosit, duket se ka rrezik që situata të përshkallëzohet sërish në luftë të përgjithshme. Anëtarët e qeverisë serbe, prania e të cilëve në Prishtinë, e kishte tensionuar më tej situatën, u mblodhën dje në godinën e Komunës së Prishtinës. Edhe kjo masakër u krye gjatë një fundjave, kur ambasadat e huaja ishin pushim, dhe u zhvillua pas perdes së tymit së qetësisë së rreme, fill pas lirimit të ushtarëve të Ushtrisë Jugosllave.

[…]

Dje, anëtarët e Misionit të Verifikimit të OSBE-së në Kosovë, u përpoqën më kot të hynin në zonën e konfliktit, pasi u ndaluan nga forcat policore serbe. Dështimi i Misionit të Verifikimit ,për të vendosur paqen, që tani thuajse nuk ekziston më, dëmton më tej përpjekjet diplomatike për të gjetur çfarëdo zgjidhje politike. Në një situatë të tillë, prania e verifikuesve të paarmatosur e bën çdo ndërhyrje përfundimtare të NATO-s të pamundur, pasi një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm pasi verifikuesit të jenë tërhequr. Ndërkohë, forcat serbe, që na e kanë treguar me fakte se mund ta pengojnë lëvizjen e lirë të vëzhguesve ndërkombëtarë, kanë dorë të lirë për të kryer çfarëdolloj veprimesh "në kuadër të kërkimit të grupeve terroriste, dhe hetimeve për vrasjen e policëve serbë".


Clinton: "Kjo është masakër e qëllimshme e forcave serbe"

KOHA Ditore

Masakër në Reçak

45 të vrarë - a është kjo përgjigje jugosllave ndaj tetë ushtarëve të liruar nga UÇK-ja

1. Ngjarja e Reçakut ngjalli dhe një polemikë: nëse ishte masakër ndaj civilëve shqiptarë nga forcat serbe, apo nëse të gjitha viktimat ishin anëtarë të UÇK-së. A ka ndonjë të dhënë kontradiktore në burimet që janë shkruar në kohën e ngjarjes (në revistën serbe ''Vreme'' dhe gazetën kosovare ''Koha Ditore")? Përse ekipi i specialistëve mjekoligjorë të BE-së nuk arriti ta zgjidhte këtë polemikë? Përse termi "masakër" ngjallte polemika? Përse ekipi i specialistëve mjekoligjorë të BE-së ngurronte ta përdorte këtë term në raport (paragrafi i tretë i raportit)? Rendisni arsyet.

2. Diskutoni rolin që luajtën institucionet ndërkombëtare në konfliktet vendore, duke marrë si shembull ish-Jugosllavinë. Përdorni edhe burime nga Kapitulli III.

II-28. Bombardimi i RFJ-së nga NATO-ja

Bombardimi i RFJ-së nga NATO-ja (Operacioni i Forcave Aleate) filloi më 24 mars të vitit 1999, dhe përfundoi më 10 qershor të po atij viti. Ndërhyrja ushtarake u ndërmor
pasi pretendohej se, forcat e sigurisë serbe po kryenin spastrime etnike të shqiptarëve të Kosovës, por një ndër arsyet e bombardimit ishte edhe ngjarja e Reçakut. Megjithatë, faktori i vërtetë nxitës ishte refuzimi i marrëveshjes së Rambujesë nga Millosheviçi. Këshilli i Sigurimit të OKB-së e nuk e miratoi ndërhyrjen ushtarake. Gjatë bombardimit, u dëmtuan rëndë banesat dhe godinat industriale, infrastruktura, rafineritë, shkollat, institucionet shëndetësore, qendrat mediatike dhe përmendoret kulturore. U kryen 2,300 sulme ajrore gjithsej. Sipas përllogaritjeve të qeverisë serbe, gjatë bombardimeve u vranë të paktën 2,500 perona, 89 prej të cilëve fëmijë. Sipas përllogaritjeve të organizatave të të drejtave të njeriut, 500 civilë humbën jetën. Ministria serbe e Mbrojtjes deklaroi se ishin vrarë 1,008 ushtarë e policë. Sulmet u pezulluan pas nënshkrimit të marrëveshjes ushtarake dhe teknike në Kumanovë, për tërheqjen e ushtrisë dhe policisë jugosllave nga Kosova. Pas tërheqjes së ushtrisë dhe policisë, mbi 200,000 serbë dhe shtetas të tjerë me kombësi joshqiptare u shpërngulën drejt Serbisë.

A. Operacioni i NATO-s në Mal të Zi

U GODITËN GJASHTË OBJEKTIVA
Podgoricë, 24 mars- Sipas raportimeve të para të pakonfirmuara, gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, që filluan rreth orës 20:00 të kësaj mbrëmjeje, në Mal të Zi, u qëlluan gjashtë objekte. Sipas gazetës "Pobjeda", objektivat vijojnë si më poshtë: Rreth orës 20:00 të mbrëmjes, Shipçaniku, që ndodhet në afërsi të Podgoricës, u godit me shtatë ose tetë predha dhe fill pas kësaj, aeroporti ushtarak në Golubovc u godit nga katër të tilla. Pas dhjetë minutash, avionët luftarakë të NATO-s, goditën kazermat e Danilovgradit. Gjithashtu, mësuam se janë goditur me predha edhe objektivat në bashkinë e Tivarit. Sipas raportimeve të para, sulmet ajrore të NATO-s kanë shkaktuar disa viktima. Sipas informacioneve jozyrtare, në Danilovgrad, u vra ushtari Sasha Stojiç. Gjithashtu, janë shkaktuar dëme të mëdha materiale, kryesisht të objekteve ushtarake, ndërsa dëmtimi që kanë pësuar banesat e civilëve janë ende në proces vlerësimi. Kazermat e ushtrisë në Danilovgrad kishin marrë flakë, ndërsa ndërtesa e aeroportit të Golubovcit po përpihej nga flakët e një zjarri të furishëm që kishte rënë në pistën e avionëve. Edhe Shipçaniku po digjet; raportime të ngjashme po vijnë edhe nga vende të tjera, që ishin objektiva të avionëve luftarakë të NATO-s.

PRESIDENTI MILO DJUKANOVIÇ IU DREJTOHET QYTETARËVE TË MALIT TË ZI

Podgoricë, 24 mars- Fatkeqësisht, ajo çka ne paralajmëruam për muaj të tërë, u bë realitet sonte. NATO-ja kreu sulme ajrore kundër objekteve ushtarake në Republikën Federale të Jugosllavisë. Sonte, territori i Malit të Zi u godit nga bombat e NATO-s. Objektivat e këtyre sulmeve ishin objektet ushtarake, por vdiqën edhe njerëz. Këto janë pasojat tragjike të një politike marrake të përballjes me të gjithë botën. Kjo politikë e ka shtyrë vendin tonë drejt një aventure të rrezikshme, duke hedhur në turrën e druve jo vetëm paqen, por edhe jetën e njerëzve [...]. Mali i Zi ka bërë çmos për ta parandaluar këtë aventurë vetëvrasëse, që ka pasoja afatgjata dhe dëmtuese të paparashikueshme. Megjithatë, Mali i Zi nuk ka asnjë faj në këtë mes. Ne iua kemi thënë prerazi të gjithë faktorëve kryesorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë se, problemi i Kosovës nuk mund të zgjidhet përmes përdorimit të forcës së çfarëdo pale, duke përfshirë edhe forcën ushtarake ndërkombëtare, sepse përdorimi i forcës nuk mund të sjellë paqe në Kosovë, Serbi apo në Jugosllavi. […] E ardhmja jonë nuk duhet të jenë konfliktet me të gjithë botën, prandaj i kërkojmë Presidentit të Republikës Federale të Jugosllavisë që ta ndërpresë menjëherë këtë politikë, që nuk po sjell gjë tjetër veçse vuajtje për njerëzit e pafajshëm.[…] Njëkohësisht, i bëjmë thirrje bashkësisë ndërkombëtare të ndalojë sulmet ajrore ndaj objektivave të Malit të Zi dhe Jugosllavisë... Po ju drejtohem si Presidenti i të gjithë atyre qytetarëve malazezë dhe jugosllavë, që po përjetojnë çaste të vështira dhe tronditëse, si dhe bëj thirrje për qetësi dhe vetëpërmbajtje, paqe dhe harmoni, për t'i kapërcyer të gjitha mosmarrëveshjet dhe ndasitë, për të cilat Mali i Zi ka paguar shtrenjtë në të shkuarën. Për hir të qëllimit më të lartë, për mbrojtjen e Malit të Zi, i bëj thirrje qytetarëve të Malit të Zi, të gjitha partive dhe subjekteve politike, që të bëjnë të pamundurën për realizimin e këtij qëllimi kaq të shtrenjtë dhe të vyer.

"Pobjeda", 25 mars 1999, fq. 2-3.

A. Bombardimi i një treni pasagjerësh

Sulmi në grykën e Grdelicës , ku NATO-ja goditi një tren pasagjerësh që po kalonte mbi një urë hekurudhore përgjatë lumit Morava në pjesën jugore, u krye më 12 prill të vitit 1999.

→

Si rrjedhojë e kësaj goditjeje dhe zjarri të shkaktuar nga predhat, shumë pasagjerë humbën jetën dhe u plagosën. Numri i saktë i atyre që humbën jetën gjatë këtij sulmi, nuk dihet ende edhe sot e kësaj dite. Nebojsha Stojiçiç, gjyqtari hetues i Gjykatës së Rrethit të Leskovacit, tha pas sulmit se, në trenin e linjës Beograd-Selanik, humbën jetën rreth 30-50 qytetarë. Shumë njerëz janë ende në listat e të zhdukurve.

Gjenerali Klark: […] Kemi punuar shumë për këtë fushatë. Kjo nuk është një fushatë kundër popullit serb, pasi siç kemi thënë që në fillim, synimi kryesor është që ta bëjmë Presidentin Millosheviç të ndryshojë qëndrimin dhe mënyrën e sjelljes, për të arritur disa qëllime të qarta politike. Ne nuk duam të lëndojmë njerëz dhe civilë të pafajshëm, prandaj po punojmë shumë fort për të parandaluar dëmet anësore. Prandaj, po përdorim armë me precizion. Numri i armëve me precizioni, që po përdoret në këtë fushatë, është më i larti, krahasuar me çdo operacion tjetër ajror në botë. Ne jemi në ndjekje të objektivave ushtarake dhe po përpiqemi të shmangim dëmtimin e civilëve duke marrë të gjitha masat e nevojshme. Doja t'ju tregoja kasetën e pamjes nga kabina e pilotit të avionit, që goditi urën hekurudhore dhe trenin... Por dua t'ju përshkruaj, sepse në këtë rast, piloti që ishte ngarkuar të godiste një urë hekurudhore, që është pjesë e rrjetit të komunikimeve të integruara të Serbisë, e lëshoi raketën kur avioni i tij ndodhej disa kilometra larg objektivit, dhe nuk pati mundësi ta shihte qartë urën. Pra, ishte një sulm i kontrolluar nga largësia. Teksa ai e vështronte me kujdes dhe nuk ia shqiste sytë objektivit në urë, unë po flisja me ekipin në Aviano, që ishte përgjegjësi kryesor i këtij operacioni, dhe krejt befas, në çastin e fundit, kur raketa do të lëshohej brenda vetëm një sekonde, ai pa kalimthi në ekran lëvizjen e një objekti, që në fakt ishte treni. Fatkeqësisht, ai nuk arriti ta ndalonte hedhjen e bombës, pasi në atë fazë ishte dhënë komanda. Raketa po shkonte drejt objektivit. Ky ishte një incident i kobshëm për të cilin, ai dhe ekuipazhi shprehin pendesë të thellë. Sigurisht që, ne nuk duam të shkaktojmë dëme anësore. Misioni ishte shkatërrimi i urës.Vetëm pasi kishte ndodhur piloti arriti ta kuptonte se, në të vërtetë, nuk kishte goditur urën, por trenin…

Konferencë për shtyp nga Xheimi Shi dhe Gjenerali Uesli Klark, NATO Selia e Brukselit, 13 prill, 1999, http://www.nato.int/kosovo/press/p990413a.htm, vizituar më 7.11.2015.

B. Ura e shkatërruar përgjatë Danubit në Novi Sad



Fotografi nga Darko Dozeti, 3 prill 1999.

C. Godina e qeverisë serbe në Beograd, e shkatërruar nga bombardimet e NATO-s, më 8 maj të vitit 1999



Devetnaest na jednoga, ***Politika***, Photo: D. Đurđević, http://www.politika.rs/scc/clanak/252679/Devetnaest-na-jednoga, vizituar më 21.10.2015.

1. Studioni burimet e këtij kapitulli dhe të kapitujve të tjerë, dhe përpiloni një listë të shkaqeve të mundshme afatgjata dhe afatshkurtra, që e detyruan NATO-n të merrte vendimin për të kryer sulme ajrore ndaj Serbisë. Përse ky vendim ngjalli kaq shumë polemika?

2. Çfarë nënkuptonte presidenti malazez Milo Djukanoviç, kur tha se, sulmet ajrore të NATO-s janë "... pasojat tragjike të një politike marrake të përballjes me të gjithë botën"?

3. Përse përllogaritjet e numrit të viktimave gjatë sulmit ajror të NATO-s në Serbi, ishin kaq të ndryshme nga njëra tjetra? Burimet e cituara në këtë kapitull e mbështesin, apo e kundërshtojnë pretendimin e Gjeneralit Klark, se NATO-ja synonte vetëm objektet ushtarake? Sipas Gjeneralit Klark, gjatë fushatës, NATO-ja po punonte fort, që të parandalonte dëmet anësore dhe të shmangte lëndimin e civilëve të pafajshëm. Atëherë, përse numri i viktimave civile ishte ende i lartë?

II-29. Konflikti i armatosur në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në vitin 2001

Qeveria e koalicionit, që u formua pas shpalljes së pavarësisë të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në rrugë paqësore, përfshinte edhe partitë politike shqiptare. Megjithatë, nivelet më të larta të pushtetit qendror kontrolloheshin nga partitë politike maqedonase. Gjatë viteve 1990, midis shqiptarëve dhe shtetit maqedonas pati disa përplasje, si rrjedhojë e të cilave, u arrestuan kryebashkiakët shqiptarë të Gostivarit dhe Tetovës. Pas bombardimit të Serbisë dhe tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, në pranverën e vitit 2001, shpërthyen përplasjet e armatosura ndërmjet forcave të sigurisë së shtetit dhe një grupi të panjohur, të quajtur Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) (shkurtesa e grupit përkon me atë që përdorte grupi guerilas që luftonte kundër forcave serbe në Kosovë para dy vjetësh). Bashkësia ndërkombëtare ushtroi trysni për përfundimin paqësor të luftimeve, dhe në maj të vitit 2001, u formua qeveria e bashkimit kombëtar. Konflikti i armatosur përfundoi në muajin gusht, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, që u mbështet plotësisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe OSBE-ja. Dorëzimi armëve nga luftëtarët e UÇK-së u krye nën mbikëqyrjen e forcave të NATO-s. Në shtator, parlamenti miratoi ndryshimin e kushtetutës, që synonte të trajtonte shqetësimet kryesore të partive politike shqiptare. Për shembull, ndryshimet kushtetuese dhe ligjore fuqizuan karakterin shumetnik të vendit, i dhanë më tepër hapësirë gjuhës shqipe, ofruan përfaqësim të barabartë të shqiptarëve etnikë, si dhe të pakicave më të vogla etnike në administratën publike dhe në institucionet e tjera shtetërore, siguruan decentralizimin e kompetencave nga qeveria qendrore në njësitë e qeverisë vendore etj.

A. Një luftë e papërfunduar: Nga marrëdhëniet e shtendosura te konflikti i armatosur

Profesor Ljubomir Frçkoski, ishte anëtar i qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë gjatë viteve 1990-1997, ku ushtroi detyrën e Ministrit pa portofol, deri në vitin 1992; Ministrit të Brendshëm, gjatë viteve 1992-1996; dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nga viti 1996, deri në vitin 1997. Që prej vitit 2000, ai ka punuar si këshilltar i Presidentit të ish-Republikës së Maqedonisë për çështjet kushtetuese dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Ai ishte një ndër personat që luajtën rol të rëndësishëm gjatë negociatave të Marrëveshjes Kuadër të Ohrit.

Prof. Ljubomir Frçkoski për konfliktin e armatosur të vitit 2001: "Ishte pak a shumë e qartë për të gjithë se, nëse nuk do të kishim pasur Kosovën si shtet fqinj, nuk do të kishte luftë. Është pak e vështirë ta thuash, por kjo është e vërteta. Lufta nuk kishte të bënte aspak me të drejtat e shqiptarëve, që ishin përcaktuar në Kushtetutën e vitit 1991. Ne jemi përgëzuar për trajtimin kushtetues që iu është bërë të drejtave të pakicave. Madje, ky trajtim, është vlerësuar si më i miri në të gjithë rajonin. Po të përdorim këtë logjikë, nuk ka asnjë gjasë që, në Maqedoni, të lindë një konflikt nga shkelja e të drejtave të çdo minoriteti. Çdo pikëpamje tjetër që bie ndesh me këtë, është e pasaktë dhe e gabuar. Disa liberalë mbështesin tezën se, lufta mund të ishte shmangur nëse pakicave do t'iu ishin dhënë më shumë të drejta në Kushtetutë. Unë mendoj se absolutisht jo.Konflikti ishte pothuajse i pashmangshëm, për shkak të operacioneve në Kosovë dhe krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndoshta, po të ishim treguar më të shkathët, mund të ishte trajtuar ndryshe; mund të ishte zbutur dhe shtyrë drejt kufirit. Por nuk mund të shmangej", thotë Frçkoski.

Revista "Globus" nr.414,http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=D72ED9AE7AC0 5748872862B8D78DA0EC, vizituar më 7.04. 2015.

A. Shmangia e katastrofës humanitare në Kumanovë dhe Lipkovë

Shkup, 18 qershor 2001
[…]Digat e Liqenit Glaznja u hapën ditën e shtunë, rreth orës tetë të mëngjesit, pasi nëpër tubat e ujësjellësit të qyteti, nuk kishte kaluar ujë që prej 12 ditësh. Liqeni i Lipkovës, që furnizonte me ujë mbi 100,000 qytetarë të Kumanovës dhe rrethinave të saj, filloi të mbushej me ujë.Pesë ditë pas mosmarrëveshjeve dhe caktimit të kushteve, terroristët e lejuan të hynte në fshat varganin, që përbëhej nga ekipet e ekspertëve të Ndërmarrjes së Ujësjellësit dhe, që udhëhiqej nga përfaqësuesit e OSBE-së.. Katastrofa që kërcënonte jetën e banorëve të Lipkovës të zënë rob nga terroristët shqiptarë për 45 ditë, dhe të 100,000 qytetarëve të Kumanovës, përmes ndërprerjes së ujit prej 12 ditësh, praktikisht u shmang. Duhet të kalojnë dhe disa ditë, që uji i liqenit të Lipkovës të mbërrijë në stacionin e trajtimit të ujërave, për t'iu nënshtruar analizave kimike dhe bakteriologjike. Derisa ujësjellësi të normalizohet, qytetarët e Kumanovës, do të furnizohen me ujë të pijshëm nga autobotet e ujit, ndërsa për nevojat që nuk kërkojnë ujë të pijshëm, mund të përdorin ujin me të cilin do të furnizohen pas ndërhyrjes në Liqenin e Lipkovës. Për shkak të përqindjes së lartë të klorit, qytetarët , mund ta përdorin ujin e papijshëm vetëm për nevoja sanitare.

http://reliefweb.int/report/former-yugoslav-republic- macedonia/macedonia-security-humanitarian-catastrophe-averted, vizituar më 8.07.2016.

B. Dëshmitë e fshatarëve maqedonas që u shpëtuan na Kryqi i Kuq Ndërkombëtar për të përditshmen ''Utrinski Vesnik'', korrik 2001

Një shtatëdhjetë e shtatë vjeçar maqedonas nga fshati Neproshten, që i dridheshin buzët dhe mjekra nga ngashërimi, tha mes lotësh se kishte arritur të shpëtonte duke u fshehur në oxhakun e kuzhinës së tij verore (kuzhinë që ndodhet jashtë në oborrin e prapmë të shtëpisë). Mezi arritëm ta qetësonim paksa, që të paktën të mund të kuptonim se ç'po thoshte. Nëpër dhëmbë dhe, pothuajse në mënyrë të pakuptueshme, ai tha se kur disa burra me uniforma, të maskuar dhe të armatosur gjer më dhëmb, kishin hyrë në oborrin e tij të prapmë, nuk kishte arritur të mendonte për asgjë tjetër veçse të fshihej në oxhak, duke futur në fillim kokën dhe më pas duke u ngjitur lart përmes zinxhirit, sa për t'u fshehur. Kur hynë në kuzhinën e vogël, njerëzit e panjohur nuk gjetën asnjë. Goditën disa prej kapakëve të bufeve me qytën e pushkës, murmuritën diçka në shqip dhe shkuan drejt shtëpisë përgjatë oborrit.Në fillim shpartalluan derën, dhe më pas, pasi e kthyen shtëpinë përmbys, u larguan. […]

Утрински ВЕСНИК, 30.07.2001, nr. 633.

C. Raport për kontekstin shoqëror dhe arsimor të konfliktit

[…]Me përafërsi, dy të tretat e popullsisë përbëheshin nga maqedonas, një e treta nga shqiptarë, si dhe disa turq, romë dhe serbë; ndërsa pjesa tjetër nga qytetarë të etnive të tjera. Bashkësitë maqedonase dhe shqiptare, nën regjimin jugosllav, jetonin në harmoni me njëra tjetrën, por në kushte krejt të ndryshme, pasi maqedonasit ishin vendosur në qendra urbane dhe ishin krahu mbizotërues i punës në sektorin publik, ndërsa shqiptarët, jo vetëm që jetonin nëpër fshatra tejet të varfra, por vuanin edhe nga niveli i ulët i arsimimit dhe punësimit. Kushtetuta e re e Republikës iu garantonte qytetarëve dhe shtetasve të tjerë "barazi të plotë si qytetarë, dhe bashkëjetesë të përhershme me popullin maqedonas", por pabarazitë strukturore ndërmjet grupeve etnike vazhdonin të ekzistonin, duke ushqyer më tej mërinë e shqiptarëve. Pala maqedonase dyshonte se bashkësia shqiptare merrej me veprimtari kriminale dhe se nuk i qëndronte besnike shtetit të ri. Kjo pabesi fillonte nga evazioni fiskal, e arrinte deri te komplotet separatiste dhe irredentiste. Në të trija qeveritë e koalicionit që u formuan në vitet 1990, paçka se përfshiheshin edhe partitë politike shqiptare, mbizotëronin partitë politike maqedonase [...]

Arsimi dhe ndasitë etnike

Një nga faktorët kryesorë që kanë ''ushqyer'' de facto ndasitë ndërmjet bashkësisë së shqiptarëve dhe asaj maqedonase, ishte sistemi arsimor i Maqedonisë. Shqiptarët, sipas mundësive që u ofronte ky sistem, bënin mësim në klasa të veçanta në sistemin parashkollor, fillor, tetëvjeçar dhe të mesëm, ku mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën shqipe (gjuha maqedonase mësohej si lëndë më vete nga klasa e tretë e sipër). Gjatë pushimeve dhe veprimtarive jashtë shkollore, ndasitë dhe mungesa e komunikimit midis nxënësve shqiptarë dhe maqedonas ishin më se të dukshme edhe në shkollat ndëretnike, ku këto dy grupe mësonin në të njëjtën çati [...]

Petroska-Beska et al, Raport i posaçëm, Maqedoni. Të kuptuarit e historisë, parandalimi i konfliktit të ardhshëm, USIP, shkurt 2004, http:// www.usip.org/sites/default/files/sr115.pdf, vizituar më 8.07.2016.

Si përshkruhen shkaqet e konfliktit midis maqedonasve dhe shqiptarëve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në këtë burim? Përse autorët e shohin arsimimin më vete si një prej problemeve më madhorë?

D. Rufi Osmani shpjegon revoltën e armatosur të shqiptarëve

Revolta e armatosur e shqiptarëve në Maqedoni është dëshmi e gjallë e dështimit tërësor të politikave ndaj shqiptarëve, pasi oferta institucionale për të plotësuar kërkesat e shqiptarëve të Maqedonisë, që janë shtuar gjithnjë e më shumë, është e vonuar. Arsyet e revoltës janë kryesisht politike dhe, si rrjedhojë, duhen kapërcyer përmes mënyrave dhe ofertës politike, pasi vetëm kështu, zgjidhja mund të jetë e qëndrueshme dhe afatgjatë. […] Respektimi i integritetit territorial dhe sovranitetit të Maqedonisë nga kryengritësit shqiptarë, që është kërkesa kyçe si e palës maqedonase, ashtu edhe e faktorit ndërkombëtar, është kushti kryesor që ka vendosur pala maqedonase për hapjen e dialogut rreth kërkesave të parashtruara nga shqiptarët. Fakti që, faktori ndërkombëtar i ka cilësuar veprimet ushtarake si mënyra për të përmbushur qëllimet politike, por që njëkohësisht, ka mbështetur kërkesat e shqiptarëve dhe nxitur zgjidhjen e problemeve në mënyrë demokratike, është një zhvillim shumë pozitiv drejt fillimit të dialogut dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ndërmjetësimi ndërkombëtar është hapi i parë drejt fillimit të dialogut demokratik.

Iseni et al, p. 85, http://soros.org.mk/dokumenti/FIOOM-Zbornik-05.pdf, vizituar më 8.07.2016.

E. Funerali i dy shqiptarëve civilë të vrarë nga forcat e sigurimit të shtetit maqedonas në Tetovë, në mars të vitit 2001



http://www.magnumphotos.com/Asset/-2S5RYDZNTNTN.html, vizituar më 1.10.2016.

II.6. BARBARITË DHE SPASTRIMI ETNIK

Gjatë luftërave jugosllave, të viteve 1991-2001, u kryen disa krime, vrasje dhe tortura. Në spastrimin etnik dhe krijimin e territoreve homogjene nga pikëpamja etnike, u përfshinë të gjitha palët, duke i kthyer kështu civilët në objektin kryesor të dhunës. Midis krimeve të tjera, mund të përmenden edhe një sërë përdhunimesh. Shumica e barbarive, u kryen në Bosnjë-Hercegovinë, prej të cilave, si më mizorja mund të përmendet masakra e Srebenicës në korrik të vitit 1995, kur ushtria e Republikës së Srpskës, nën udhëheqjen e Ratko Mlladiçit, vrau 8,000 civilë boshnjakë, kryesisht burra e djem. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dënoi masakrën e Srebenicës si gjenocid. Krahas vrasjes së 8,000 njerëzve, u shkatërruan me dhjetëra fshatra dhe qyteza. Objekt shkatërrimi ishin edhe objektet e kultit dhe ato kulturore. U ngritën edhe kampe përqendrimi për të burgosurit. Një prej pasojave të luftës ishte edhe rritja marramendëse e numrit të refugjatëve. Gjatë luftërave, u shpërngulën katër milion njerëz, që përbëjnë rreth gjysmën e popullsisë së Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa pas përfundimit të tyre, 2.3 milion njerëz kishin marrë statusin e refugjatëve të përhershëm. Pas luftës, disa territore si Kosova, pjesa më e madhe e Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacia, u kthyen në zona të banuara nga popullsi homogjene nga pikëpamja etnike. Vetëm disa qyteza si Bosnjë Hercegovina; Mostari, që ishte i ndarë në zona boshnjake dhe kroate; Brçko dhe Sarajeva, që para luftës kishin qenë të përziera nga pikëpamja etnike, mbetën sërish zona heterogjene. Disa qytete si Vukovari, Mostari, Zadari, Pakraci, Gospiçi, Karlovaci, Dereventa, Dubrovniku, Prishtina dhe Sarajeva

u bënë objekt i bombardimeve dhe rrethimeve të gjata, ku si më i gjati njihet ai i Sarajevës. Numri i përgjithëm i të vrarëve gjatë këtyre luftërave arriti në 140,000 njerëz. Sipas Qendrës së Kërkimit dhe Dokumentimit të Sarajevës, shumica, pra, 100,000-110,000 viktima ishin nga Bosnjë-Hercegovina, prej të cilëve rreth 60,000 ishin ushtarë të rënë dëshmorë në fushën e luftimeve, ndërsa 40,000 ishin civilë (83% ishin boshnjakë). Vendin e dytë për viktimat e zinte Kroacia me rreth 13,000- 14,000 të vrarë. Sipas një studimi të përbashkët të Qendrës së të Drejtës Humanitare, Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur dhe Komisionit të Serbisë për Personat e Zhdukur, të kryer në vitin 2008, nga muaji janar i vitit 1998, e deri në muajin dhjetor të vitit 2000, gjatë konfliktit në Kosovë, u vranë 13,421 njerëz, prej të cilëve 10,533 ishin shqiptarë; 2,238 serbë; 126 romë dhe 100 boshnjakë.

II-30. Gjenocidi në Srebenicë

Sipas Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, më 26 shkurt të vitit 2007, u arrit në përfundimin se, gjenocidi në Srebenicë dhe rrethinat e saj u krye "enkas për të shkatërruar grupin e myslimanëve të Bosnjë-Hercegovinës" (paragrafi 297 i vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, 26 janar 2007). Shikoni kapitullin III.2 dhe burimin VI-21.

A. Dëshmia e një nëne

Më kujtohet mirë fytyra e tim biri dhe rrëketë e lotëve që iu rrëkëllyen faqeve, teksa ma morën përgjithmonë nga duart. Pas kësaj, nuk mora më vesh asgjë për të". Ky është kujtimi që mbart Sabaheta Fejzhiçi, anëtare e "Nënave të Enklavave të Srebenicës dhe Zhepës".
Nettelfield dhe Wagner, 2014, f. 46.

B. Kronikat e mediave serbe për Srebenicën, 1995

[…]Shumica e mediave serbe nuk shtruan asnjë pyetje dhe nuk hapën asnjë hetim për ngjarjet që kishin ndodhur në rajonet e luftës. Sipas tyre, Srebenica ishte thjesht një tjetër episod i luftës, ku viktimat merreshin si të mirëqena, dhe as që numëroheshin më. Ose thjesht nuk përmendeshin fare […] Megjithatë, ata që lexonin gazetën e përditshme "Naša Borba" mësuan më 12 korrik, përmes një deklarate të Stefan Oberit , një përfaqësuesi të organizatës "Mjekë pa kufij", për agjencinë e lajmeve "Beta" se, ditën e djeshme, nga Srebenica, ishin arratisur rreth 20,000-30,000 njerëz drejt bazës së OKB-së në Potoçari, dhe se gjatë përpjekjes së tyre për t'u arratisur ishin goditur me artileri të rëndë, nga ku mbetën të plagosur shumë persona. Gazeta citonte raportimin e fundit në radio të korrespondentit Nino Çatiç, që u transmetua pak çaste para rënies së Srebenicës. "Vendi po shndërrohet në një kasaphanë të stërmadhe.
Në spital po mbërrijnë vazhdimisht të vrarë dhe të plagosur. E kam të pamundur ta përshkruaj. Çdo tre sekonda, qyteti goditet nga tri predha. […] Nuk ka asnjë në këtë rruzull tokësor, që të dëshmojë tragjedinë që po ndodh në Srebenicë? Kronika u realizua nga AFP-ja dhe u botua nga gazeta "Naša Borba". […] Kur masakra e refugjatëve të Srebenicës ishte në kulmin e saj, më 13 korrik, gazeta "Večernje Novosti" botoi një deklaratë të Gjeneral Ratko Mlladiçit, në të cilën thuhej se civilët ishin të sigurt. […] Më 15 korrik, "Studioja B TV" transmetoi një pjesë të raportimit të Zoran Petroviç Piroçanacit, që filmonte ushtarët e Gjeneral Mlladiçit, që ndodheshin në Srebenicë më 13 dhe 14 korrik. Raportimi përfshinte edhe një filmim të shkurtër, ku kishin dalë rreth 20 burra të vrarë, të shtrirë pranë një muri të bërë shoshë me plumba, në një magazinë kooperativiste në fshatin Kravicë. Mund të duket e pabesueshme, por ky filmim nuk e tërhoqi aspak vëmendjen e publikut në atë kohë, as të mediave, që po bënin përpjekje të raportonin në mënyrë sa më të paanshme që të ishte e mundur. […] Vetëm më vonë, gjatë një gjyqi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, publiku mësoi se filmimet në të cilat kishin dalë civilët e vrarë "kishin shpëtuar padashur" dhe ishin konfiskuar pak pas ngjarjes nga përfaqësuesit e Republika Srpskës. […]
CENZOLOVKA: Antonela Riha, http://www.b92.net/info/vesti/pregled_stampe.php?nav_id=1014239, vizituar më 8.07.2016.

II-31. Vrasja e të rinjve në Tuzla


Ngjarja e parë tragjike ndodhi në Tuzla, në fillim të luftës, në maj të vitit 1992, kur autokolona e UPJ-së, që përbëhej nga rekrutë të rinj, kryesisht serbë, u bombardua në tërheqje e sipër, ku mbetën të vrarë me dhjetëra ushtarë të rinj. Gjatë vitit të fundit të luftës, po në këtë qytet, u krye edhe një prej krimeve më të rënda kundër civilëve. Mbrëmjen e 25 majit të vitit 1995, Ushtria e Republikës Serbe goditi me predhë një shëtitore të quajtur Kapija, që shërbente si vend ku mblidheshin të rinjtë. Nga ky sulm mbetën të vrarë 71 qytetarë dhe u plagosën mbi 150 të tjerë. Mosha mesatare e të vrarëve ishte rreth 24 vjeç.

A. Bombardimi i ushtarëve në Tuzla

Më 15 maj të vitit 1992, në Tuzla, forcat myslimane sulmuan një autokolonë ushtarake gjatë tërheqjes së forcave të Brigadës së Nëntëdhjetë e dy të Motorizuar të UPJ-së nga qyteti. Kjo ngjarje njihet si "Autokolona e Tuzlës". Numri i saktë i oficerëve, rekrutëve të rinj dhe rezervistëve të UPJ-së, që u vranë gjatë tërheqjes nga Tuzla, nuk u përcaktua kurrë, pasi ende nuk janë gjetur eshtrat e të gjitha viktimave, megjithëse 29 trupa janë varrosur në mauzoleun përkujtimor të Bijeljinës. Në vitin 2003, hetuesit e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, ia referuan ngjarjen e "Autokolonës së Tuzlës" Prokurorisë së Bosnjë-Hercegovinës. Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës, i pezulloi hetimet për çështjen në fjalë në dhjetor të vitit 2009. Në maj të vitit 2007, Ilija Jurishiçi u arrestua në Serbi. Gjatë kohës kur u krye sulmi, ai shërbente si nëpunës i rangut të lartë të Ministrisë së Brendshme të Bosnjë-Hercegovinës, dhe si nëpunësi përgjegjës për Stafin e Operacioneve të Sigurisë Publike të Tuzlës. Me vendim të Dhomës Gjyqësore së Posaçme të Krimeve të Luftës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beogradit, Ilija Jurishiçi u dënua me 12 vjet burgim, por më 11 tetor të vitit 2010, Gjykata e Apelit të Beogradit e ktheu sërish çështjen për gjykim. Më pas, më 2 dhjetor të vitit 2013, Gjykata e Apelit të Beogradit e dënoi sërish Jurishiçin me 12 vjet burgim, por, rasti nuk është mbyllur ende. Ngjarja e "Autokolonës së Tuzlës" shërben ende si burim tensionesh politike ndërmjet Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës.

B92, TANJUG, 15 Maj 2010, përvjetori i 18 i krimit në Tuzla, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2010&mm=05&dd=15&nav_id=431349, vizituar më 8.07.2016.

B. Në kujtim të viktimave në Tuzla



http://rtv7.ba/arhive/72455, vizituar më 8.07.2016.

Ndajeni klasën në dy grupe:

- Njëri grup duhet të kërkojë informacione rreth Të Drejtës Ndërkombëtare të luftës (*Jus in Bello*) në formën e dokumenteve ligjore, protokolleve, dhe konventave si Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve të Gjenocidit (1948), Konventat e Gjenevës (1949), Protokollet Shtesë të Konventave të Gjenevës (1977) etj., që synojnë të caktojnë caqet, gjithmonë nëse është e mundur, e veprimeve ushtarake; përkufizojnë trajtimin e personave të paarmatosur, refugjatëve dhe robërve të luftës; si dhe të ndalojnë përdorimin e disa armëve të caktuara gjatë konflikteve ushtarake.
- Grupi tjetër duhet të analizojë me kujdes termat "spastrim etnik" dhe "gjenocid", së bashku me termin e ri "spastrim kulturor" (shikoni kapitullin II.9). Gjithashtu, ata duhet të gjejnë se cilat prej gjenocideve të shekullit të njëzetë janë njohur zyrtarisht si të tilla nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, ose nga parlamentet e disa shteteve.
- Më pas, të dyja grupet duhet të studiojnë me kujdes burimet e përzgjedhura në kapitujt II.2, II.4, II.5 dhe II.6 dhe të diskutojnë nëse veprimtaritë e palëve kundërshtare të përfshira në konflikt (e) i përmbahen ligjeve bazë apo jo, si dhe si ndikon përdorimi i termave "gjenocid" dhe "spastrim etnik", kur i referohemi ngjarjeve tronditëse dhe çnjerëzore te mendimi i publikut dhe nxehja e gjakrave. Grupet duhet të sjellin edhe shembuj nga rajone/vende të tjera. Përse mendoni se përdorimi ose jo i termave të tilla ngjall kaq shumë polemika dhe debat publik?

II.7. EMIGRIMET E DETYRUARA DHE REFUGJATËT

II-32. Vargan njerëzish duke u larguar nga Vukovari, nëntor 1991



Fotograf: Ron Haviv.

II-33. Vargane qytetarësh serbë duke u larguar nga Kroacia pas Operacionit "Stuhia"



Reuters.

II-34. Emigrimet nga Bosnja gjatë dhe pas luftës

Zhvendosja e emigrantëve të Bosnjë-Hercegovinës dhe pasardhësve të tyre (të brezit të dytë dhe të tretë) në vendet e përzgjedhura:

Vendi pritës	Numri	Qytetarë të natyralizuar në vendet e përzgjedhura
SHBA	350,000	66,642 (në vitin 2010)
Gjermani	240,000	83,000 (në vitin 2009)
Kroaci	300,000	Nuk ka informacion
Serbi	150,000	Nuk ka informacion
Austri	150,000	48,924 (në vitin 2008)
Slloveni	150,000	96,744 (në vitin 2010)
Suedi	80,000	48,595 (në vitin 2010)
Zvicër	60,000	25,900 (në vitin 2010)
Australi	60,000	17,339 (në vitin 2009)
Kanada	50,000	21,583 (në vitin 2009)
Itali	30,000	Nuk ka informacion
Mali i Zi	25,000	Nuk ka informacion
Danimarkë	23,000	11,196 (në tetor të vitit 2011)
Holandë	16,000	Nuk ka informacion
Norvegji	16,000	11,559 (në vitin 2009)
GJITHSEJ	1,700,000	431,482

Profili i Emigrimit të Bosnjë-Hercegovinës për Vitin 2001, Ministria e Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës, Sarajevë, mars 2012, fq. 72,73. (Të dhënat për nëntë shtetet e përfshira në raportin e vitit 2011 janë ofruar nga Ministria e Të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve të Bosnjë-Hercegovinës)

II-35. Refugjatët e Kosovës

Sipas censusit të popullsisë në vitin 1981 në Jugosllavi, popullsia e Kosovës përbëhej 77,42% nga shqiptarët dhe 13,22% nga serbët. Kjo e fundit, ra gjatë viteve 1980, ndërsa shqiptarët e bojkotuan censusin e vitit 1991. Mendohet se gjatë bombardimeve të NATO-s, nga Kosova u dëbuan 862,979 shqiptarë gjithsej, ose mbi 80% e popullsisë në tërësi. Sipas informacioneve të NATO-s, në fund të majit, mbi 230,000 refugjatë u larguan drejt Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, mbi 430,000 drejt Shqipërisë, afro 64,000 drejt Malit të Zi, afro 21,500 drejt Bosnjë-Hercegovinës dhe mbi 61,000 në vende të tjera. Sipas të dhënave të UNHCR-së, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, nga Kosova ishin shpërngulur 187,129 njerëz. Rreth 143,000-210,000 njerëz që u shpërngulën nga Kosova dhe u larguan drejt Serbisë dhe Malit të Zi ishin serbë, ndërsa mbi 25,000 ishin romë. Gjatë po së njëjtës periudhë, disa mijëra romë dhe serbë u larguan drejt Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa numri i atyre që u larguan drejt vendeve të tjera, mbetet ende i panjohur. Ata që qëndruan në Kosovë, u larguan drejt enklavave serbe dhe rumune nën mbrojtjen e KFOR-it.

A. Shqiptarët e dëbuar të Maqedonisë në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 1999



Fotograf: Robert Atanasovski.

B. Kampi i refugjatëve të shqiptarëve të kosovarëve në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë



Fotograf: Cendomir Nenkovic.

C. Analiza e krizës së refugjatëve në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë gjatë konfliktit në Kosovë në vitin 1999

Kriza e refugjatëve të Kosovës në vitin 1999, në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ishte e veçantë për sa i përket përmasave të papara më parë, të ndërthurura me kohëzgjatjen e shkurtër (duke përfshirë një rritje të menjëhershme dhe ulje të beftë të numrit të refugjatëve), pranisë së lartë në botën mediatike dhe tërheqjes së vëmendjes së donatorëve. Refugjatët e Kosovës filluan të hynin në Maqedoni në fund të marsit të vitit 1999, pasi NATO-ja kishte nisur fushatën e bombardimeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë. Brenda nëntë javëve, në vend kishin hyrë 344,500 refugjatë. Duke pasur si qëllim kryesor ofrimin e ndihmës urgjente humanitare, Organizata e Kombeve të Bashkuara, në bashkërendim me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, vendin pritës, donatorët dhe palët e tjera të interesuara, dhanë ndihmë të menjëhershme për të plotësuar nevojat e refugjatëve. Këtu përfshihej strehimi në qendrat e përbashkëta (kampe) dhe në familjet pritëse, si dhe ofrimi i ushqimit, kujdesit shëndetësor dhe ujit/higjienës. Shkalla e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë ishte e ulët falë masave të efektshme të ndërmarra nga një numër i madh organizatash humanitare, të mbështetura fort sigurisht, edhe nga qeveria. Gjatë krizës, nëpër kampe apo gjetiu nuk pati përhapje domethënëse epidemish.

Shkalla e vdekshmërisë së refugjatëve ishte më e ulët krahasuar me situatat e tjera urgjente. Donev et al 2002, fq. 184-9, http://neuron.mefst.hr/docs/CMJ/issues/2002/43/2/11885045.pdf, vizituar më 08.07.2016.

D. Organizata humanitare "Mjekët pa Kufij" (MSF) duke ndihmuar refugjatët e Kosovës, që po largoheshin prej mizorive dhe bombardimeve ajrore



Fotograf: Roger Job, koleksion vetjak.

E. Serbët duke u larguar nga Kosova

Sipas shifrave zyrtare të UNHCR-së, pas tërheqjes së Ushtrisë Jugosllave dhe policisë serbe, nga Kosova janë larguar mbi 100,000 serbë.
Në Beograd mbërritën vetëm të privilegjuarit, ndërsa të tjerët u strehuan te të afërmit dhe miqtë nëpër fshatra.
Televizionet shtetërore dhe autoritetet nuk kanë raportuar për largimin e tyre nga krahina.
Kërkesa për një kthim të organizuar nga shteti në Kosovë është e lartë.
Marrëveshjet paketë për personat e kthyer përfshinin strehim në qendrat e përbashkëta në periferi të atyre enklavave serbe, që kishin mbetur, si dhe dhënia e rrogave dhe pensioneve.
Siguria për jetën e tyre dhe të pronave të mbetura është në dorën e KFOR-it.
Grujiç, 24 korrik 1999.
Grujiç, 24 1999.

II-36. Refugjatët serbë gjatë bombardimit të NATO-s

Numri i qytetarëve serbë që u larguan nga Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk dihet ende me saktësi. Nga 24 marsi e deri më 20 qershor të vitit 1999, në Maqedoni kanë kërkuar azil 2,315 qytetarë të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, prej të cilëve 825 ishin shqiptarë, 787 hungarezë dhe 506 serbë. Shumë qytetarë të tjerë të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë hynë në vend ose në mënyrë të jashtëligjshme, ose me viza turistike. Sipas disa informacioneve, 8 000 qytetarë të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë hynë në Hungari me viza turistike. Gjatë muajit marsit të vitit 1999, në Rumani mbërriti një grup refugjatësh serbë të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë prej 4 000 vetash, nga ku shkuan më pas në SHBA.

Refugjatë serbë në Rumani: "Ne jemi të përbuzurit e Evropës"

Përmes këtij artikulli, raportohen të gjitha vështirësitë që hasin autoritetet rumune në kufi me Serbinë, për shkak të numrit të madh të kërkesave të serbëve për statusin e refugjatit, pas intensifikimit të bombardimeve të NATO-s.

[…] Në Rumani janë regjistruar tashmë 200 kërkesa për statusin e refugjatëve nga ana e serbëve, që u larguan si nga regjimi i Millosheviçit, ashtu edhe nga sulmet ajrore të NATO-s. Numri i kërkesave është shtuar gjatë ditëve të fundit, për shkak të intensifikimit të bombardimit. Sipas burimeve vendore në kufirin rumuno-serb, ka shumë gjasa që, numri i refugjatëve serbë që qëndrojnë te të afërmit dhe miqtë në zonën kufitare të kontesë së Timishoarës, të jetë më i lartë se ai i refugjatëve të regjistruar zyrtarisht. Në këtë konte, shumica e rumunëve tregojnë solidaritet për fqinjët e tyre serbë dhe nuk e fshehin mërinë që kanë ndaj kësaj lufte, që po zhvillohet kaq pranë tyre.

Pavarësisht kësaj, pritja e refugjatëve serbë ka disa probleme. Strehimi i tyre nëpër shtëpi private po merr një pjesë të konsiderueshme të buxheteve të kufizuara të këtyre infrastrukturave turistike...

Legjislacioni rumun u zu në befasi nga vala hyrëse e refugjatëve. Për shembull, një ligj i vitit 1996 "Për statusin e refugjatit", për mbulimin e shpenzimeve ditore, cakton shumën prej 10,000 lei për refugjat, që janë të barabartë me 5 franga. Në ditët e sotme, me këtë shumë mund të blesh vetëm gjysmën e një sanduiçi.

Për më tepër, Rumania ka pranuar të presë 6,000 refugjatë nga Kosova, që aktualisht po qëndrojnë në Maqedoni dhe Shqipëri. Për hartimin e një udhëzimi emergjence, ku do të caktohet edhe kuadri i nevojshëm ligjor për trajtimin e kësaj çështjeje, u ngrit një komitet për refugjatët, që përbëhej nga përfaqësues të pesë ministrive. Që prej asaj kohe, tensionet që ekzistonin ndërmjet shërbimeve të ndryshme publike kanë filluar të ngjallen sërish. Burimet e financimit mbeten ende të paqarta. Pavarësisht zotimit për të strehuar refugjatë, Rumania po i kërkon ndihmë bashkësisë ndërkombëtare për të mbuluar shpenzimet dytësore si ushqyerjen dhe mjekimin. Për këtë çështje, Ministria e Punëve të Jashtme ka kontaktuar me Bashkimin Evropian dhe Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR).

Tani për tani, duket se asnjë nuk po shpejton t'i kthejë përgjigje kërkesës rumune. "Le Monde", 30 prill 1999, nr. 16877, fq. 3.

II-37. Refugjatët maqedonas kthehen në shtëpi, Tetovë, 17 shtator 2001



http://www.apimages.com/metadata/Index/EURO-AP-I-MKD-XNG102-MACEDONIA/d07b3edabde0da11af9f0014c2589dfb/59/0, vizituar më 08.07.2016.

1. Shkruani një ese me temë "Çfarë do të thotë të jesh refugjat lufte?" duke përdorur burimet e shkruara dhe pamore të këtij kapitulli.

2. Krahasoni krizën e shkaktuar nga luftërat jugosllave me (a) luftërat civile bashkëkohore përtej Evropës dhe me (b) konfliktin dhe luftën në Qipro (shikoni vëll. 1, kap. VIII). Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet?

3. Në kapitullin II.36, lexoni fjalinë "Legjislacioni rumun u zu në befasi nga vala hyrëse e refugjatëve": Çfarë do të thotë kjo praktikisht? Problemi humanitar i refugjatëve, që u larguan nga shtëpitë e tyre për të mbijetuar, është një problem i gjithëkohshëm. Zakonisht, shtetet fqinje ose shtetet e tjera të mbërritjes zihen të papërgatitura për sa i përket administrimit të nevojave të ngutshme të njerëzve që vijnë dhe kërkojnë strehë, numri i të cilëve vjen gjithmonë në rritje. Nxënësit duhet të kuptojnë se refugjati detyrohet të largohet për të mbrojtur jetën dhe të drejtat njerëzore themelore, dhe zakonisht, nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të vuajnë ose të vdesin. Diskutojeni problemin duke iu referuar krizës aktuale të refugjatëve, që po lind për shkak të luftës në Siri.

4. Përfytyrojeni veten në vendin e një korrespondenti, që informon për valën hyrëse të refugjatëve; një vullnetari të një OJF-je, që po ndihmon refugjatët; një banori të një qyteze, ku refugjatët po arrijnë në shifra të panumërta dhe të një adoleshenti refugjat. Përshkruani një ditë kur mblidheni të gjithë së bashku. Shkruani një dialog të shkurtër ku të shprehni qëndrimet, druajtjet, shpresat dhe ndjenjat tuaja. Zgjedhja e një konteksti të veçantë historik nuk është e detyrueshme.

II.8. FËMIJËT DHE TË RINJTË GJATË LUFTËS

II-38. Shkollë fillore në Sarajevë

Gjatë rrethimit të Sarajevës, shumë fëmijë (mbi 1,600 gjithsej) vriteshin çdo ditë nëpër shtëpitë e tyre, godina të tjera të jashtme, kënde lojrash dhe nëpër shkolla. Orët e mësimit në Sarajevë zhvilloheshin në klasa të improvizuara. Shumë fëmijë u vranë ose rrugës për në shkollë, ose brenda në shkollë. Një tragjedi e tillë ndodhi në një prej shkollave të Sarajevës së Re.



Shkollë e improvizuar në Sarajevë. Nga koleksioni i fotografive të Muzeut Historik të Bosnjë-Hercegovinës.

Dy muaj pas fillimit të vitit shkollor 1993-1994, rreth orës 10:50, më 9 nëntor të vitit 1993, zona e Fushës së Ali Pashës, në sheshin "ZAVNO" nr. 18 i Bosnjë- Hercegovinës u godit nga një predhë thërrmuese, e cila shpërtheu jashtë katit përdhes të një banese, ku ishte transferuar përkohësisht shkolla fillore "Prvi Maj". Si pasojë e shpërthimit, vdiqën tre persona, përkatësisht: Adis Kujala, lindur në vitin 1984; Vedad Mujkanoviç, lindur në vitin 1984; Fedja Salkiç, lindur në vitin 1987; dhe mësuesja e tyre Fatima Guniç; lindur në vitin 1948; si dhe u plagosën 21 civilë të tjerë. Predha ra përpara pllakave të betonit, që ishin vendosur si mburojë përpara hyrjes së shkollës, ndërsa predhat e shrapnelit kaluan përmes të çarave të pllakave dhe u fut brenda në shkollë.Në çastin kur ra predha, nxënësit e klasës së tretë po shkonin drejt klasës së improvizuar, ndërsa nxënësit e klasës së parë,

po prisnin jashtë për t'u futur brenda, pasi mësimi i tyre fillonte në orën 11:00. Disa minuta më vonë, po e njëjta zonë u godit nga një shrapnel tjetër, i cili shpërtheu në rrugën Rade Konçara, jashtë komunës (bashkësisë) Jedinstvo, duke iu marrë jetën tre civilëve dhe duke plagosur shtatë të tjerë. Më pas, shkolla mori emrin e mësueses që u vra, dhe aktualisht quhet Shkolla Fillore "Fatima Guniç".

Kazoviç Babiç, 2014, fq. 130.

II-39. Fëmijët në Zadar luajnë përpara një muzeu që rrethohet i gjithë nga thasë rëre, pranverë 1992



Fotograf: Drazhen Breitenfeld, koleksion privat.

II-40. Mësimi pezullohet në shkollat fillore dhe të mesme, ndërsa në Universitetin e Prishtinës shkurtohen orët e leksioneve, mars 1999

Prishtinë, 22 mars-Këshilli i Arsimit të Komunës së Prishtinës, njoftoi sot se kishte marrë vendimin të pezullonte procesin e rregullt mësimor në disa shkolla të kësaj komune, ndërsa Rektorati i Universitetit të Prishtinës, bëri me dije se orët e leksioneve në universitet do të shkurtohen.

Në njoftimin që u firmos nga Zijadin Gashi, kryetari i CEC-it, shkruhet se "në mbështetje të analizës së mëposhtme të situatës, dhe për të parandaluar vënien e mëtejshme në rrezik të jetës së nxënësve dhe mësuesve, është arritur një marrëveshje, ku, sipas së cilës, procesi mësimor do të pezullohet në shkollat fillore dhe të mesme deri më 31 mars të vitit 1999".

[...]

Ndërkohë, për të njëjtat arsye, Rektorati i Universiteti të Prishtinës vendosi të shkurtonte numrin e orëve të leksioneve dhe provimeve, si dhe të përshtaste programin mësimor me kushtet e situatës në të cilën ndodhet Kosova.

Arkiva e Institutit të Historisë, Prishtinë.

Përdorni burimet e kësaj pjese dhe të pjesës së mëparshme (II.7) për të përshkruar përjetimet e shumëllojshme të fëmijëve, që jetonin në zonat e prekura nga lufta.

II-41. Dizelaši në Serbi

Termi Dizelaši u krijua në Serbi rreth viteve 1990 për të përshkruar anëtarët e një nënkulture që merrej me kontrabandën e karburantit gjatë kohës kur ndaj vendit ishin vendosur sanksione, ose me veprimtari të tjera kriminale. Ata vishnin rroba të shtrenjta dhe sportive si xhinse Diesel, atlete dhe xhaketa aviatorësh. Makina e tyre e parapëlqyer ishte BMW-ja. Zakonisht, kokat i kishin të rruara, mbanin armë dhe zinxhirë të florinjtë me kryqe të mëdhenj. Mesa duket, ky stil nuk ishte gjë tjetër veçse një kopje e stilit të mundësit amerikan Mr. T, që vinte nga një geto e Çikagos dhe u bë i njohur për rolin që luajti në filmin Roki 3. Identiteti pamor i nënkulturës Dizelaši ndikohej shumë edhe nga muzika. Në vargjet e mëposhtme të këngës "Atlantis" të grupit VIP, Dizelaši lidhet ngushtësisht me muzikën rep: "Brenda këtyre katër mureve jam mësuar veç të fitoj, Plako, repistët dhe Dizelaš-ët janë serbë të vërtetë!" Sociologët e lidhin këtë dukuri me lindjen e nacionalizmit, shpërbërjen e sistemit të vlerave, dhe formimin e një "elite të re serbe", ku përfshiheshin: politikanët në fuqi, spekulatorët e kohës së luftës, njerëzit e biznesit, dhe kriminelët që mbështesnin regjimin e Millosheviçit.

CYA, I suksesshmi

Jam një djalë i ri nga rrugët e Beogradit,
Udhës kur kaloj të gjithë plasin nga inati,
Ngas makina fringo, që vlejnë nga njëmijë marka ,
Xhepi përherë plot me nga 150 franga,

Kam 10 kostume sporti e qafën plot me ar,
N' brez pistoletë prej kromi që ma dha im at'
Vetullat ia ngrys çdo gjëje që lëviz,
ata që më dalin para ta dinë se e kan' pisk. […]
http://tekstovi.net/2,171,1844.html, vizituar më 21.10.2015.

Si përshkruhet "serbi i vërtetë" në vargjet e mësipërme? A mund të gjeni elementet e nacionalizmit në sjelljen e Dizelaš-ëve? Paraqitini argumentet tuaja duke i shpjeguar.

II.9. SHKATËRRIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

Gjatë luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë, u shkatërruan shumë përmendore kulturore dhe objekte fetare. Disa u rrënuan si pasojë e përplasjeve të armatosura, ndërsa të tjerat u shkatërruan qëllimisht. Pjesë e spastrimeve etnike, ishte edhe "spastrimi kulturor". U vodhën dhe u plaçkitën shumë sende të çmuara, origjina e të cilave nuk bëhej menjëherë e ditur (p.sh pas shkatërrimit të Vukovarit, u vodhën shumë vepra arti).

Antagonizmat fetare luajtën rol thelbësor në luftërat jugosllave, duke u kthyer në një tjetër motiv për shkatërrimin e objekteve fetare. Rrjedhimisht, u shkatërruan qindra xhami (shumica në Bosnjë), kisha katolike dhe ortodokse, manastire, sinagoga dhe objekte të tjera fetare. Nuk u kursyen as bibliotekat, arkivat, muzetë, varrezat dhe vendet historike të qyteteve. Biblioteka Kombëtare e Sarajevës për shembull, u dogj nga zjarri që ra si pasojë e bombardimit nga një njësit i ushtrisë serbo-boshnjake, ku 1.5 milion libra dhe dorëshkrime të rralla u përpinë nga flakët. Në vitin 1993, Ura e Vjetër e Mostarit, që ishte ndërtuar në shekullin e XVI dhe konsiderohej si simboli kryesor i qytetit, u shemb nga bombardimet e palës boshnjako-kroate. Qendra historike e Dubrovnikut u dëmtua rëndë gjatë sulmeve të UPJ-së, duke përfshirë disa objekte historike. Në Kosovë, u dëmtuan ose u shkatërruan plotësisht mbi 35 kisha ortodokse (156 objekte fetare ortodokse gjithsej) dhe manastire, që konsideroheshin si përmendore historike. Para kësaj, ushtria serbe kishte shkatërruar mbi një të tretën e xhamive të Kosovës, pra mbi njëzet, shumicën e shtëpive tradicionale shqiptare dhe disa përmendore të tjera të periudhës otomane. Gjithashtu, gjatë bombardimit të NATO-s u rrënuan ose u dëmtuan shumë objekte të tjera fetare dhe kulturore.

II-42. Qyteti i vjetër i Dubrovnikut

Gjatë Luftës për Pavarësi në Kroaci, njësitë e UPJ-së bombarduan disa herë qytezën e Dubrovnikut nga toka dhe deti. Këto sulme, krahas viktimave, dëmtuan edhe qendrën vjetër të qytetit, si dhe disa përmendore kulturore dhe historike, që ishin pjesë e Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Sulmi më i dhunshëm që u krye në Dubrovnik, ishte ai i 6 dhjetorit të vitit 1991.

A. Konferenca për shtyp e Kolonel Radomir Damjanoviçi në Trebinjë

"Palës tjetër ose nuk i bëhet vonë fare, ose i bie shumë pak ndërmend, për ruajtjen e vlerave të Dubrovnikut, që konsiderohet si perla e trashëgimisë botërore", tha Kolonel Radomir Damjanoviçi, Zv. Komandanti i Grupit të Dytë të Operacioneve. "Nëse do shqetësoheshin qoftë edhe fare pak, do t'i kishin dorëzuar armët dhe do t'i kishin dëbuar nga qyteti mercenarët e tyre afrikanë, holandezë, gjermanë e argjentinas, lëkurëzi e lëkurëbardhë bashkë, që janë llumi i tokës. Ata na detyruan të kryenim operacione kundër Dubrovnikut, megjithëse s'kishim ndërmend ta bënim diçka të tillë. Nuk e prekëm kurrë "Qytetin e Vjetër" me dorë, megjithëse na qëlluan me armë nga ai drejtim."

Vojiçiç, 2006, fq. 171-172.

B. Shatërvan i shkatërruar në sheshin Gunduliç, maj 1992



Fotograf: Josip Bistroviç, koleksion privat.

Qyteti i Dubrovnikut ka hyrë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s që prej vitit 1979. Prandaj, media ndërkombëtare dhe Federiko Major Zaragoza, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, protestuan ashpër kundër sulmit të Qytetit të Vjetër më 6 dhjetor. Si do ta komentonit fjalimin e Kolonel Radomir Damjanoviçit, në këtë kontekst?

II-43. Shkatërrimi i Vukovarit

Para Luftës për Pavarësinë e Kroacisë, Vukovari ishte një nga qytetet më të bukura me ndërtesa të stilit barok në Kroaci. Pasi u kthye në objekt shkatërrimi dhe rrethimi për disa muaj rresht, në nëntor të vitit 1991, Vukovari dukej sikur sapo kishte përjetuar një kataklizëm të llahtarshëm.





Qendra e "Vukovarit të Vjetër" në stilin barok.



Wertheime-Baletić, 1993

II-44. Xhamia e Ferhat Pashës në Banja Luka, Bosnjë, para dhe pas shkatërrimit



https://zokstersomething.files.wordpress.com, vizituar më 21.10.2015.

II-45. Kisha të shkatërruara ortodokse serbe në Kosovë

Që prej qershorit të vitit 1999, në Kosovë janë shkatërruar dhe dhunuar tridhjetë e nëntë kisha dhe manastire ortodokse serbe, midis të cilave edhe Kisha Ortodokse "Zonja e bekuar Levishkë", që u ndërtua në Prizren, në fillim të shekullit të XIV, me urdhër të Mbretit Milutin. Për shkak të zjarrit që ra në kishë, në mars të vitit 2004, pjesa e altarit u shkatërrua plotësisht, ndërsa afresket u dëmtuan rëndë.



http://www.eparhija-prizren.com/sr/vesti/podsecanje-na-martovski-pogrom-2004, vizituar më 21.10.2015.

1. Studioni fotografitë e kësaj pjese që janë bërë para dhe pas shkatërrimit. Cila prej tyre ju ka lënë më shumë mbresa? Përse

2. Në këtë pjesë, janë përmendur disa prej shembujve më të njohur të shkatërrimit të objekteve të trashëgimisë kulturore gjatë luftës në ish-Jugosllavi. Cili mund të jetë qëllimi i shkatërrimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore të palës kundërshtare, gjatë një lufte që "ushqehet" nga nacionalizmi dhe nxitet nga dëshira për të pushtuar apo spastruar territorin ku banojnë pjesëtarët e grupeve të tjera etnike apo fetare? Deri në ç'pikë bini dakord me fjalinë e mëposhtme: "Pjesë e spastrimit etnik ishte edhe "spastrimi kulturor", që konsiderohej si themeli i tokave të reja nga pikëpamja etnike."

3. Si mendoni, shkatërrimi i këtyre objekteve dhe ndërtesave emblemë të sipërpërmendura ndodhte rastësisht apo ishte i qëllimshëm? Si mendoni, përse shkatërrimi i simboleve kulturore dhe fetare ishte kaq i rëndësishëm gjatë luftës? Pasi t'i keni studiuar me kujdes burimet dhe çelësin, përgjigjuni pyetjes duke shpjeguar dhe diskutuar. (Shikoni edhe kapitullin II-51, "Apeli i historianëve të Universiteti të Beogradit për ushtrinë jugosllave, 4 tetor 1991").

4. Gjeni shembuj të tjerë të shkatërrimit ose ruajtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore në rajonin dhe vendin tuaj, para dhe pas luftërave jugosllave.

5. Gjeni dhe diskutoni tekstin e protokollit të Hagës "Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore"/ Konventa për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Rast Konflikti të Armatosur (1954).

II.10. KUNDËR LUFTËS

I-46. E dua vëllain në shtëpi!!! Protesta në Sllloveni



Muzeu i historisë bashkëkohore, Ljubanë.

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak në ushtrinë jugosllave, kryhej larg vendlindjes së rekrutëve dhe hamendësohej që kjo gjë ruante karakterin shumetnik të ushtrisë. Përpara ndarjes së Jugosllavisë, u parashtrua kërkesa që, shërbimi ushtarak të kryhej në qytetet e tyre të lindjes. Kjo kërkesë e cila u mbështet edhe me protesta.

II-47. Letra e Olga Careviçit, një shkencëtareje kroate me prejardhje serbe, drejtuar nacionalistit serb Vojislav Çeçilit, 5 gusht 1991

ARMA IME E VETME JANË FJALËT

Mesazhi i Dr. Vojislav Çeçili, drejtuar ne serbëve, që jemi kundër krimeve të Çetnikëve, do të thotë se ai do të flasë me ne përmes snajperave. Unë nuk kam armë, arma ime e vetme janë fjalët.

Prandaj, duke pasur parasysh fjalën e urtë serbe: "Nëse dikush të qëllon me gurë, vrite me pambuk", këtij provokimi i përgjigjem me këto fjalë: I bëj thirrje ndërgjegjes që fle te çdo njeri; titullit tuaj prej doktori, që e morët nga Universiteti i Beogradit, duke pretenduar se jeni sjellë në mënyrë të njerëzishme, dhe së fundi, ju bëj thirrje si serbi serbit.

Tërhiqini çetnikët tuaj gjakpirës nga territori i Republikës së Kroacisë. Vetëm në këtë mënyrë kroatët dhe serbët do të mund të bashkëjetojnë në harmoni me njëri-tjetrin dhe ta ndërtojnë sërish atdheun e tyre të përbashkët, Kroacinë, që tani ndodhet nën rrënoja.

"Vjesnik", 5 gusht 1991.

Gjatë luftërave, termat "çetnikë", "ustashë" dhe "muxhahedinë" janë përdorur për të diskredituar përkatësisht luftëtarët serbë, kroatë dhe boshnjakë në përgjithësi. Dy termat e parë lidheshin me Luftën e Dytë Botërore, kujtimi i së cilës është ende tejet i gjallë në Jugosllavinë socialiste. Termi i tretë nënkuptonte një lidhje ndërmjet boshnjakëve dhe fundamentalistëve islamikë. (Për t'iu referuar myslimanëve, përdorej edhe termi "Balija"). Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Lëvizja e Ustashëve, që përhapte nacionalizmin profashist dhe ekstremist kroat, dhe që erdhi në pushtet gjatë kohës së sundimit nazist, në prill të vitit 1941 themeloi si shtet kukull Shtetin e Pavarur të Kroacisë. Çetnikët, nën udhëheqjen e oficerit serb Drazha Mihailoviçi, përfaqësonin një lëvizje rezistence mbretërore, që si e tillë, bashkëpunonte me pushtuesit gjermanë dhe zhvilloi luftime kundër partizanëve të Titos. Gjatë luftërave të viteve 1990, termi përdorej për të përshkruar nacionalistët serbë, veçanërisht njësitë paraushtarake. Rreth situatës në Jugosllavi, gjatë Luftës së Dytë Botërore, shikoni Librin e Punës nr.4.

II-48. "Muri i dashurisë", protestë në Zagreb, gusht 1991

I ashtuquajturi "Muri i dashurisë" ishte një lëvizje e atyre nënave, djemtë e të cilave ishin dërguar në luftë gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Ushtrinë Jugosllave. Në fund të muajit gusht të vitit 1991, kjo lëvizje organizoi një tubim në Zagreb, përpara Rrethit të Pestë Ushtarak të Ushtrisë Jugosllave. Gjatë këtij tubimi, shkrimtari dhe politikani kroat Valdo Gotovac, mbajti një prej fjalimeve më të shquara kundër luftës të mbajtur ndonjëherë gjatë asaj lufte.



Fotograf: Robert Shipek, koleksion vetjak.

II-49. Varr për Miroslav Milenkoviçin, rezervistin që nuk pranoi të shkonte në frontin e luftës



Miroslav Milenkoviçi (i lindur në vitin 1951), babai i dy punëtorëve të ndërtimit dhe një rezervist nga Gornjo Milanovaçi, u vetëvra më 20 shtator të vitit 1991, në pazarin e gjedhëve në Shid, pasi hezitonte se cilit prej dy grupeve duhej t'i bashkohej: grupit që kishte dorëzuar armët dhe ishin kthyer mbrapsht; apo grupit tjetër, që kishte rrokur pushkën, dhe ishin nisur drejt frontit të luftës të Tovarnikut.

Në banderola bardh e zi, ata kishin shkruar parullat:
PËR TË RËNËT E LUFTËS; SOLIDARITET PËR TË GJITHË KUNDËRSHTARËT E LUFTËS

Varr për Miroslav Milenkoviçin, Beogradasit kundër luftës, nëntor 1991.

II-50. Maratona kundër luftës në Serbi, tetor 1991

Më 5 tetor, në parkun Pionirski (Parku i Pionierëve), Qendra për Aksionin Kundër Luftës, që ishte krijuar verën e kaluar nga Shoqata për Nismën Demokratike Jugosllave. Lëvizja Evropiane për Jugosllavinë, Partia e Grave, Parlamenti i Grave, Asambleja e Qytetarëve të Helsinkit dhe Komiteti i Helsinkit, organizuan një tubim, ku u protestua kundër luftës. Tubuesit, krahas protestimit kundër luftës, i bënë thirrje Asamblesë Federale për t'u mbledhur më 10 tetor, dhe për të marrë në dorë frenat e kontrollit civil dhe demokratik të Ushtrisë Jugosllave. […] Në fillim, ishte rënë dakord që Maratona e Beogradit Kundër Luftës (MBKK), do të zgjaste deri në 10 tetor, por pikërisht në këtë datë, u vendos që të vijonte më tej. Qëllimi i maratonës ishte të shkëmbente informacion rreth nismave civile për paqe dhe t'i diskutonte ato pa pretenduar të arrinte përmasa të mëdha, apo të imponontе një mbikëqyrje dhe kontroll të centralizuar. Ishte një bashkërendim i nismave të ngjashme të qytetarëve për paqe, veprimet e të cilëve ishin kapilare, të përmasave të vogla dhe të decentralizuara. Çdo grup mbante përgjegjësi publike për nismat që ndërmerrte.

Gazeta "Republika", nr. 31, 16-30.10.1991.

II-51. Thirrja e historianëve të Beogradit për Ushtrinë Jugosllave, 4 tetor 1991

Letër e hapur të gjitha forcave të armatosura të Jugosllavisë

JU LUTEMI, MOS E PREKNI DUBROVNIKUN!
Në lidhje me luftimet që po zhvillohen rreth Dubrovnikut, ne ju lutemi, madje, nëse është e nevojshme, ju përgjërohemi që të mos lejoni shkatërrimin e asnjë pjese të këtij qyteti historik. Dubrovniku nuk është pjesë e trashëgimisë kulturore vetëm e popullit serb dhe atij kroat, por e mbarë botës. E gjithë bota e qytetëruar nuk do t'jua falte kurrë këtë gjë, ashtu siç nuk e ka falur kurrë shkatërrimin e Universitetit në Leuven në vitin 1914, një akt që, ndër të parët që e dënuan, ishin profesorët e Beogradit të asaj kohe, por edhe ka skalitur thellë në histori emrat e atyre që, pavarësisht luftërave, kanë ruajtur si përmendoret e veta historike, ashtu edhe të të tjerëve. Asnjë qëllim apo kufi nuk ia vlen para shkatërrimit të diçkaje, që e kemi për detyrë t'iua lëmë trashëgim pasardhësve tanë.

Historianët:
Ljubinka Trgovçeviç,
Sima Çirkoviç,
Andrej Mitroviç,
Mirjana Zhivojinoviç,
Ivan Djuriç

Borba, 4 tetor 1991; Vojiçiç dhe Biserko, 2006, nr. 24, fq. 912.

Lexoni sërish fjalitë e mëposhtme: "...ne ju lutemi, madje, nëse është e nevojshme, ju përgjërohemi që të mos lejoni shkatërrimin e asnjë pjese të këtij qyteti historik.Dubrovniku nuk është pjesë e trashëgimisë kulturore vetëm e popullit serb dhe atij kroat, por e mbarë botës". Kthejuni edhe njëherë burimeve të mësipërme për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. A u zbatua kjo thirrje? Çfarë kuptimi kishte? Trashëgimia kulturore i përket vetëm një kombi, apo të gjithë njerëzimit? Diskutoni.

II-52. Gratë në të zeza, rezistencë feministe në Serbi

Më 9 tetor të vitit 1991, gratë e Beogradit u hodhën në protestë, që u quajt "gratë në të zeza kundër luftës". Më 16 tetor, atyre iu bashkuan edhe "Gratë në të zeza" të Pançevos. Ato lëshuan deklaratën e mëposhtme:

- Ne, "GRATË NË TË ZEZA", në këtë mënyrë përkujtojmë të gjithë të rënët e luftës, shprehim
- SOLIDARITETIN TONË ME TË GJITHË ATA QË NGRITËN KRYE KUNDËR LUFTËS, dhe
- PROTESTOJMË KUNDËR TË GJITHË MILITANTËVE QË PËRDORIN ARMËT DHE FJALËT PËR TË NXITUR URREJTJEN DHE VDEKJEN, si dhe
- IU BËJMË THIRRJE TË GJITHË BURRAVE DHE GRAVE TË DALIN KUNDËR LUFTËS.

Gra dhe burra të çdo kombësie, besimi fetar, pikëpamjeje dhe bindjeje.

Le të mblidhemi dhe t'i bashkojmë të gjitha nismat dhe lëvizjet tona që bëjnë thirrje për paqe kudo dhe për këdo. Le t'i bashkojmë. Le të mbledhim dhe të bashkojmë të gjithë ata njerëz që as nuk e duan dhe as nuk dëshirojnë të marrin pjesë në këtë luftë të fëlliqur civile.

Të mos i lëmë të shkatërrojnë shtëpitë, vendet e punës, universitetet dhe rrugët. Të mos i lëmë t'i qëllojnë apo t'i mobilizojnë njerëzit, për shkak të pikëpamjeve të tyre politike. Le t'iu themi të gjithë atyre që nuk duan të shkojnë në luftë se nuk janë tradhtarë. Pushtetarët, gjeneralët që marrin paga të majme, spekulatorët e luftës, të gjithë ata që po i detyrojnë njerëzit të vrasin njerëz, vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet dhe për të ruajtur privilegjet e tyre, duan që kjo luftë të bëhet. NE KËRKOJMË SI MË POSHTË:

- KTHIMIN E TË GJITHË REKRUTËVE DHE REZERVISTËVE NGA FRONTI; ANULIMIN E DËNIMEVE PËR TË GJITHË ATA QË NUK PRANUAN FLETËTHIRRJET E MOBILIZIMIT, OSE QË U KTHYEN NGA FRONTI ME KOKËN E VET NDALIMIN E MOBILIZIMIT JOKUSHTETUES NË SERBI; UDHËHEQJET E PESË REPUBLIKAVE TË TJERA TA KUNDËRSHTOJNË MOBILIZIMIN;

QYTETARËT E SERBISË NUK JANË DHE NUK DUHET TË JENË XHANDARËT E JUGOSLLAVISË DHE TË BALLKANIT.

Beograd, 30 tetor 1991.

"Republika", 32, 16-30 nëntor, 1991.

II-53. Nënat e ushtarëve kroatë që po kryejnë shërbimin ushtarak në UPJ i përgjërohen Veljko Kadijeviçit, Sekretarit Federal të Mbrojtjes Kombëtare, që të mos i dërgojë ushtarët kroatë të vrasin vëllezërit e tyre, janar 1992

Kursejini bijtë tanë!

[…]

Teksa dita ogurzezë e 19 janarit po afron, ne, nënat e ushtarëve të njësive të Ushtrisë Popullore Jugosllave, ju bëjmë thirrje t'i kurseni jetët e bijve tanë të pafajshëm. Në emër të njerëzimit, ndalojeni gjakderdhjen e bijve tanë!

Në emër të paqes, mos i detyroni bijtë tanë të qëllojnë kundër vëllezërve, motrave, prindërve dhe miqve të tyre!

Në emër të lirisë, reshtni së zgjidhuri problemet politike, duke shkelur mbi trupat e pajetë të bijve tanë!

Fuqinë tuaj tregojeni në dialog dhe arsyetim!

Dëgjojeni ndërgjegjen tuaj dhe mendoni për bijtë tanë të pafajshëm, që janë edhe tuajët!

Toliç, 1992, fq. 236.

II-54. Thirrje e Aleancës Liberale të Malit të Zi për qytetarët malazezë, 19 dhjetor 1991

"Ata që nuk duan të marrin pjesë në këtë luftë të ndyrë janë heronj"

Duke marrë shkas nga vdekja e të rinjve malazezë dhe aventura e turpshme luftarake kundër Dubrovnikut, Aleanca Liberale ka përgatitur një thirrje për popullin malazez, ku përcillet mesazhi i mëposhtëm: "Policia kokëkrisur e Sllobodan Millosheviçit në Serbi dhe hordhitë e tij në Mal të Zi, ju kanë shtyrë prej shumë kohësh drejt luftës civile dhe konflikteve, e deri te shfarosja e të gjithë popujve jugosllavë.

Bota është e tronditur nga shkatërrimi dhe numri i viktimave nga të dyja palët në frontin e luftës në Kroaci. Serbia dhe Mali i Zi janë kthyer në sinonime të agresionit në sytë e publikut ndërkombëtar, ndërsa baballarët, bijtë, vëllezërit, miqtë dhe kushërinjtë tanë ose po vriten, ose po gjymtohen përditë në këtë aventurë të pakuptimtë luftarake kundër Dubrovnikut. Mali i Zi është njollosur me një turp të padenjë për historinë shekullore çlirimtare të këtij vendi, dhe paraardhësit e tij të nderuar.

Malazezë, myslimanë, shqiptarë dhe kroatë, qytetarë të Malit të Zi, mos i lejoni të fusin pyka ndërmjet jush, mos e lejoni urrejtjen dhe pasionet luftënxitëse të ulet këmbëkryq në vendin tuaj. Mbrojeni atë nga çnderimi. Mbrojini fëmijët dhe nipërit tuaj nga turpi i madh që sot vërtitet mbi kryet e Malit të Zi. Thojini "jo" kësaj lufte. Mënyra më e mirë për të ndihmuar në zgjidhjen paqësore të krizës së Jugosllavisë, dhe përpjekjet dobiprurëse të bashkësisë ndërkombëtare, që ka qenë dëshmitare e vdekjeve të shumta dhe shkatërrimit në zonën e Jugosllavisë, është të mos pranoni të shkoni në luftë.

Duke marrë shtysë nga historia dhe emri i tij i mirë, Mali i Zi duhet të thotë: Mjaft! Çelësi për të zgjidhur këtë dramë vëllavrasëse, që kërcënon të kthehet në një plojë të përbashkët, dhe madje në një luftë civile në Serbi dhe Mal të Zi, ndodhet në duart tuaja…

Kjo është një luftë e ndyrë, një luftë ku emrat e viktimave nuk bëhen më të ditura. Qëndrimi i vetëm i guximshëm që ju mund të mbani për të ruajtur emrin tuaj të mirë dhe të dilni ballëlart përpara brezave të ardhshëm, është që të mos pranoni të ndiqni symbyllazi udhëheqësit tuaj kombëtarë.

E gjithë bota e qytetëruar është me ju!

"Antiratni pokret u Crnoj Gori 91-92", 2012, fq. 187.

Studioni burimet e paraqitura në këtë kapitull dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme: Cilat grupe shoqërore dhe figura të shquara protestuan kundër luftës?

Rendisni arsyet e protestave. Gjeni të përbashkëtat dhe ndryshimet e shembujve të protestave kundër luftës që janë marrë nga republika të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Cili prej shembujve ju ka lënë më shumë mbresa? Përse?

Protestuesit	Arsyeja e protestës

II.11. LUFTA E GAZETARËVE

II-55. Artikull nga korrespondenti slloven Ivo Shtandeker, vrarë në Sarajevë, 1992

Korrespondenti slloven Ivo Shtandeker, vdiq më 16 qershor të vitit 1992, në rrethimin e Sarajevës prej plagëve të rënda që kishte marrë nga shpërthimi i një granate që ishte hedhur nga radhët serbe. Ky ishte artikulli i fundit që ai shkroi. Në paragrafin hyrës të artikullit, ku kishte parashikuar një luftë të gjatë, që do të ndikonte keqas te të gjithë qytetarët myslimanë, serbë dhe kroatë, gjendet fjalia e tij më e shquar: "Qytetet më pëlqejnë kaq shumë dhe e urrej kur dikush i sulmon."

Çfarë mbeti prej Sarajevës

"Boshnjakët nuk u marrosën nga lufta e shenjtë, por nga mllefi i shenjtë", shkruan Ivo Shtandekeri nga kryeqyteti i rrethuar i Bosnjë-Hercegovinës

Qytetet më pëlqejnë kaq shumë dhe e urrej kur dikush i sulmon.

Në pjesën lindore të Sarajevës, në drejtim të Vogoshçës, gjendet një varrezë e vjetër turke, poshtë së cilës ndodhet një guvë e stërmadhe, që shërbente si strehë gjatë kohës së perandorisë austro-hungareze. Mijëra kryeqytetas dhe banorë të fshatrave përreth i kanë kaluar shumicën e ditëve dhe netëve nën sigurinë e kësaj guve të moçme, teksa shtëpitë dhe qyteti i tyre po shkatërroheshin. […]

Medina, një mikja ime, më tha se, pas lufte, nuk donte të qëndronte më në Sarajevë. Nuk ka mbetur më kurrgjë. As autobusë, as tramvaje. Nëpër rrugë zgjatohen kabllo të këputur elektrikë, të rrethuar nga makina të shkatërruara dhe pirgje xhamash.Çdo xhami apo kishë është rrënuar ose batërdisur. Ndërtesat që dikur i jepnin formë qytetit, janë rroposur ose shkrumbuar deri në themel. Nuk ka mbetur më asnjë pijetore dhe kafene, ku njerëzit zakonisht takoheshin me njëri-tjetrin. Kanë mbetur vetëm hapësira dhe boshllëqe ku ka rrezik të qëllohesh nga skajet e qytetit, nëse orvatesh të shkosh në Fushën e Ali Pashës, e vetmja lagje në Sarajevë ku mund të gjenden disa qepë, spinaq dhe qumësht. "Mbaji mend mirë fqinjët e tu", më pat thënë njëherë Artije Ragushi, zv/presidentja e liberalëve. "Shtëpitë, përpara së cilave kam kaluar gjatë gjithë këtyre viteve, janë mbrusur me njerëz që më qëllojnë me mortaja, raketa dhe mitralozë." […]

Asnjëri nuk e ka të lehtë në Sarajevë, madje as vetë parashikuesit e luftës. Selam Abdiçi, kryeredaktori i "Bosnjës së lirë", gazeta më në zë e Sarajevës, e cila kishte botuar një hartë të rrethimit të qytetit vitin e kaluar, tani sillet si kali në lëmë, për shkak të mungesës së letrës së shtypit. As skicuesi Mithad Ajanoviçi nuk ka ikur. Megjithëse, seritë e tij humoristike nuk bëjnë më aspak për të qeshur. Kur takova Alija Izetbegoviçin, më tha se ishte shumë mirënjohës që Sllovenia po kujdesej kaq mirë për refugjatët nga Bosnjë-Hercegovina. Më pas, shtoi: "Do të jetë luftë e gjatë kjo."

Ivo Shtandeker: [Çfarë mbeti prej Sarajevës?], "Mladina", 23/1992, fq. 1-3.

1. Sipas këtij teksti, si e shkatërron lufta jetën e një qyteti? Krahasojeni tekstin me kapitullin II-21 dhe reflektoni rreth termit "urbicid" (vrasje e qytetit). Lexoni dokumentet në kapitullin II.3 dhe artikullin e Shtandekerit. Si ishte përditshmëria në qytetin e rrethuar të Sarajevës? Duke u mbështetur te burimet e mëparshme, shkruani një fletë ditari të një nxënësi në Sarajevë. Përshkruani ditën, ndjenjat dhe drojat tuaja.

II-56 "Në Sarajevë, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) i duket sikur është kthyer pas në ditët e betejës së Solferinos"

Në Bosnjë-Hercegovinë janë tejkaluar të gjitha caqet. Simboli i Kryqit të Kuq nuk respektohet, madje po përdoret për qëllime ushtarake. KNKK-ja përpiqet që të veprojë përgjatë vendit vetëm me 60 përfaqësues.

[…]

"Përmes fushatës ditore të shtypit që kemi ndërmarrë, për të cilën po punon një person i vetëm me kohë të plotë, po transmetojmë xhirime në televizion ose emisione në radio, ku bëjmë thirrje për respektimin e vlerave humanitare dhe iu kujtojmë pushtetarëve që të mbajnë emblemën e Kryqit të Kuq." Një pikëz uji në oqeanin e propagandës së egër që po bëjnë të dyja palët, përmes transmetimit për orë e orë të tëra të imazheve ngjethëse, me një këmbëngulje dhe vetëkënaqësi rrëqethëse; dhe ngjalljes së reflekseve të hakmarrjes dhe urrejtjes edhe te fëmijët, te të cilët këto imazhe kanë një ndikim të jashtëzakonshëm. […]

Estier, 9 Maj 1992, fq.6.

Lexoni fjalinë: Një pikëz uji në oqeanin e propagandës së egër që po bëjnë të dyja palët përmes transmetimit për orë e orë të tëra të imazheve ngjethëse, me një këmbëngulje dhe vetëkënaqësi rrëqethëse; dhe ngjalljes së refleksеve të hakmarrjes dhe urrejtjes edhe te fëmijët, te të cilët këto imazhe kanë një ndikim të jashtëzakonshëm. Duke u mbështetur në këtë ekstrakt, diskutoni temën "Lufta e propagandës dhe efekti i saj te fëmijët".

II-57. Gazetarja e CNN-it, Kristinë Amanpur, përshkruan përvojën e saj si korrespondente lufte në Bosnjë

Në vitin 1992, Amanpuri shkoi në Bosnjë-Hercegovinë për të pasqyruar në media shpërthimin e dhunës që ajo mendoi se do të kthehej në "luftën e brezit tim". Përmes reportazheve, asaj iu dha merita e vënies së natyrës mizore të atij konflikti, në qendrën e vëmendjes së botës, megjithëse disa e kritikuan për prirjen që kishte për të shprehur mendimet e veta subjektive sesa për të raportuar, duke pretenduar se mbante një qëndrim të njëanshëm kundër serbëve. →

[...]Lufta në Bosnjë është një luftë që bëhet kundër civilëve, brenda në qytet dhe në shtëpitë e njerëzve, jo në fushëbetejë. Organizata e Kombeve të Bashkuara është shprehur se asnjë luftë tjetër bashkëkohore nuk ka prekur kaq shumë fëmijë sa kjo. Është e tmerrshme dhe mizore... Kthehem vazhdimisht sepse nuk arrij ta besoj se si po lejohet kjo gjë. Edhe po të ecësh nga hoteli "Pushimet", në Sarajevë, ku qëndrojnë gazetarët, është e rrezikshme...Vjeshtën e kaluar, një natë, teksa flija, dëgjova një fishkëllimë shurdhuese afër dhomës sime të hotelit. Ishte një predhë murtaje 105 milimetërshe e një obusi, që siç duket, nuk kishte goditur në shenjë. Ajo ra në një dhomë që ndodhej dy dyer matanë dhomës time, por nuk shpërtheu, megjithëse dhoma u shkatërrua vetëm nga forca e rënies. Po të kishte shpërthyer, do më kish marrë lumi.

http://articles.latimes.com/1993-07-14/entertainment/ ca-13112_1_christiane-amanpour, vizituar më 04.01.2016.

II-58. Godina e gazetës "Oslobodjenje" në Sarajevë pas shkatërrimit



Oslobodjenje, arkivat e Oslobodjenjës.

II-59. "Doracak i shkurtër i keqinformimit": Gazetari Gaj Metan, kryetari ekzekutiv i Klubit të Shtypit Zviceran, komenton për përhapjen e lajmit të Bombardimit të NATO-s

[…]Sulmi i armatosur i NATO-s ndaj Jugosllavisë degjeneroi në luftë të mirëfilltë, jo për shkak të armatës së stërmadhe që u mobilizua për shkatërrimin e vendit përmes breshërive të bombave, por për shkak të luftës psikologjike që iu shpall opinionit publik ndërkombëtar në lidhje me shkakun luftënxitës.

Me pak fjalë, risia e këtij konflikti, krahas testimit të armëve vdekjeprurëse, është fushata e keqinformimit që u ndërmor nga SHBA-ja dhe NATO-ja në shkallë botërore. Po si e dallon njeriu keqinformimin? Ku ndryshon nga propaganda e thjeshtë? […]

Metan, 24 prill 1999.

1. Përfytyroni sikur jeni korrespondent lufte në Sarajevë në vitin 1992. Shkruani një artikull të shkurtër për rrethimin e qytetit (përdorni edhe dokumentet e kapitullit II.3).

2. Shkruani një ese për rolin që luan media në (a) manipulimin e mendimit publik (b) parandalimin e krimeve përmes raportimit.

3. Ndajeni klasën në dy grupe dhe diskutoni rreth temës: "A jeni dakord se misioni i gazetarisë është që të zbulojë të vërtetën për publikun, me çdo kusht, edhe gjatë luftërave? Një grup duhet të jetë pro, duke ofruar argumente për të mbështetur temën, ndërsa grupi tjetër duhet të jetë kundër, duke dhënë argumente kundër saj.

4. Lexoni fjalinë: "Risia e këtij konflikti, krahas testimit të armëve vdekjeprurëse, është fushata e keqinformimit." Diskutoni dhe jepni argumente duke marrë shembuj nga luftëra të tjera bashkëkohore, si lufta e Gjirit Persik, Irakut, apo Sirisë.

5. Si mendoni, përse godinat dhe objektet mediatike ishin objektivat e luftës? A mund të gjeni shembuj të tjerë?

II.12. REAGIMET E NDËRKOMBËTARËVE DHE VENDEVE TË BALLKANIT

II-60. Zhan Pier Shëvenmoni, ish-ministri francez i mbrojtjes nga Mastrihti në Sarajevë

Pas vdekjes së Titos, Jugosllavia nuk mund të mbijetonte, megjithatë, ideja jugosllave, e përtërirë nga praktika e demokracisë së pjekur, e meritonte të mbijetonte. Përgjegjësia më e madhe për dramën aktuale bie mbi burokracitë postkomuniste, pasi zgjuan nacionalizmin etnik, por, përgjegjësia për të kundërshtuar këtë qëllim të llahtarshëm dhe mbrojtur patriotizmin e brishtë jugosllav kundër koncepti reaksionar të një kombi, bie mbi Evropën. Mesa duket, në Jugosllavi, ka pothuajse një milion martesa të përziera. Duhet pranuar se Evropa e të Dymbëdhjetëve nuk nxiti modelin francez të kombit civil, por konceptin etnik të një kombi.

"Libération", 2 shtator 1992, fq. 9.

Zhan Pier Shëvenmoni ushtroi detyrën e ministrit në qeveritë socialiste të Francës, gjatë viteve 1980 dhe 1990. Ai u largua nga Partia Socialiste në vitin 1993 dhe themeloi Lëvizjen Qytetare, që do të përkufizohej si një parti e majtë euroskeptike. Ai ishte kundër Traktatit të Mastrihtit pasi e kundërshtonte ashpër federalizmin evropian, si dhe kishte shprehur vazhdimisht vërejtjet e tij për lëvizjet rajonale dhe autonomiste.

Në deklaratën e tij, ish-ministri francez, përmend dy koncepte të kombit: atë civil dhe etnik. Ku ndryshojnë këto dy koncepte? Përse ai mendon se koncepti etnik i një kombi, në rastin e Jugosllavisë, është një prej shkaqeve të luftës? A jeni dakord me pohimin e mëposhtëm: "Ish-ministri francez Zhan Pier Shevenmont e shikon idenë jugosllave si shprehje të konceptit civil të kombit." Argumentojeni përgjigjen tuaj.

II-61. Deklarata e intelektualëve bullgarë për luftën në Jugosllavi, 1999

Intelektualët bullgarë, nuk munden ta anashkalojnë faktin se, në vitin 1991, serbët, nën regjimin e Millosheviçit, ndërmorën një luftë të tmerrshme kundër të gjithë nacionalistëve të tjerë në Jugosllavi, duke e kthyer atë në një luftë, ku u përfshinë disa shtete ballkanike.

Sot, le t'i kthejmë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. A e njohim të drejtën e ekzistencës së etnive dhe kulturave të tjera krah për krah nesh dhe mes nesh? E njohim. A duam që kombe, raca dhe fe të ndryshme të bashkëjetojnë paqësisht nën çatinë e përbashkët të quajtur Evropë? Duam.

2. A e dënojmë luftën e gjatë tetëvjeçare që krerët e Partisë Socialiste Serbe kishin ndërmarrë ndaj të gjithë popujve të ish-Jugosllavisë, dhe kundër vetë qytetarëve të saj? E dënojmë. A e refuzojmë ideologjinë komuniste nacionaliste, që sot personifikohet nga Sllobodan Milllosheviçi, diktatori i fundit i Evropës? E dënojmë.

3. A solidarizohemi me tragjedinë humanitare që po kalojnë serbët dhe shqiptarët e Kosovës? Solidarizohemi. A duam që të gjithë njerëzit që u detyruan të largoheshin nga lufta, të kthehen nëpër shtëpitë e tyre sa më shpejt të jetë e mundur? Duam. […]

4. A solidarizohemi me dramën e vëllezërve tanë maqedonas? Solidarizohemi. A jemi të vetëdijshëm se nëse ata humbasin, humbasim edhe ne? Jemi. A duhet ta ndihmojmë Maqedoninë të shmangë fshirjen e saj nga harta si shtet i pavarur? Duhet. A jemi pro Maqedonisë? Jemi.

5. A do t'i pranojmë garancitë e vetme serioze që mund të marrim për sigurinë tonë kombëtare? Do t'i pranojmë.

6. A duam që ekonomia jonë e pavarur dhe e sapomëkëmbur të fuqizohet dhe që Bullgaria të mos vetizolohet për shkak të refuzimit të bërë në ngut e sipër? Duam.

7. A jemi të bindur se Ballkanit do t'i kthehet paqja dhe qëndrueshmëria vetëm kur të bëhet pjesë e hapësirës së sigurisë euro-atlantike? Jemi.

Atëherë, kjo do të thotë se ne jemi për Bashkimin Evropian, për NATO-n dhe për konfirmimin e identiteteve kombëtare të Ballkanit si pjesë përbërëse të identitetit të të gjithë Evropës. 23 – 26 prill 1999.

http://www.kultura.bg/media/my_html/2078/c_mih.htm, vizituar më 6.10.2016.

II-62. Udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karadzhiç në Athinë, qershor 1993



Në qershor të vitit 1993, një muaj pas nënshkrimit të Planit Vens-Ouen në kryeqytetin e Greqisë, që më pas u kundër-shtua nga serbët e Bosnjës, Radovan Karadzhiçi, udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, pagoi, bëri një vizitë jozyrtare në Athinë, me ftesë të shoqatës për Miqësinë Greko-Serbe. Ai u prit krahëhapur dhe u takua me Kryepeshkopin Serafim të Athinës, dhe Kryeministrin Konstantinos Mitsotakis, që kishte mbështetur qeverinë e Beogradit në kulmin e luftës në Jugosllavi, si dhe kishte tentuar njëkohësisht të ndërmjetësonte midis serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve që paqja të mbizotëronte sërish në rajon. Në ceremonitë që u zhvilluan në Stadiumin e Paqes dhe Miqësisë, pavarësisht se zemrat e njerëzve gufonin nga entuziazmi, shumë vende mbetën bosh. Ata që ishin të pranishëm gjatë veprimtarive, kishin mendime ideologjike dhe politike që ndryshonin nga ato të grupimeve apo bashkimeve të tjera politike, siç mund të shihet edhe në dokumentin e II-62B.

→

A. Serbët dhe grekët

[…]Karadzhiçi, që ishte dje në Athinë për të marrë pjesë në veprimtarinë e organizuar nga Shoqata për Miqësinë Greko-Serbe, tha gjithashtu se populli serb karakterizohej nga e njëjta bukuri shpirtërore si e popullit grek, pasi të dy popujt ishin ortodoksë.

"Nuk është e lehtë të jesh mik i serbëve në ditët e sotme. Por, serbët e vërtetë e tregojnë veten pikërisht në ditë të tilla", ai shtoi. "Ajo që duhet të theksoj është se, si Kisha Serbe, ashtu edhe Kisha Greke, janë tejet patriote", shtoi Karadzhiçi.

Gazeta "Eleftherotypia", 15 qershor 1993, fq. 12.

B. "Grekët dhe Zoti janë në anën tonë"

"Të gjithë po na thonë të dorëzojmë armët, sepse kemi mbetur fillikat. Epo, ne themi që nuk është e vërtetë, nuk kemi mbetur të vetmuar. Ne kemi grekët dhe Perëndinë në anën tonë." Megjithëse stadiumi nuk ishte mbushur plot, të gjithë të pranishmëve u gufonte zemra nga entuziazmi. Edhe grupet ekstremiste nacionaliste të djathta,u përfaqësuan nga një grup i vogël të rinjsh me uniforma ushtarake, bereta të zeza dhe stema me shqiponjën dykrerëshe. Ata vepronin si rrugaçë të rëndomtë nëpër veprimtaritë sportive, ku sokëllinin me parulla të ndryshme.

* Grupi minoritar "Ndërhyrja Autonome" brenda KPP-së pretendon se prania e Konfederatës së Përgjithshme të Punës (KPP) në veprimtarinë që u zhvillua në Stadiumin e Paqes dhe të Miqësisë "bie ndesh me politikën e paqes, bashkëpunimit dhe ortakërive të barabarta me Bashkimet në Ballkan, që kanë qëllime të përbashkëta", duke e cilësuar këtë qëndrim si të njëanshëm dhe pro serbëve të Bosnjës.

Gazeta "Eleftherotypia", 15 qershor 1993, fq. 13.

C. Takimi me Kryeministrin grek Mitsotakis dhe Karadzhdiç në Kryeministri

«Αυτές τις στιγμές δεν είναι εύκολο να είσαι φίλος των Σέρβων. Αλλά σε αυτές τις στιγμές φαίνονται οι αληθινοί αντάρτες», είπε σε κάποιο άλλο σημείο των δηλώσεών του. «Αυτό που έχω να τονίσω, πρόσθεσε ο Κάρατζιτς, είναι ότι τόσο η σερβική όσο και η ελληνική εκκλησία είναι βαθιά πατριωτικές».

Από την πλευρά του ο Αρχιεπίσκοπος **Σεραφείμ** είπε ότι ο ελληνικός λαός παρακολουθεί με ενδιαφέρον τον αγώνα των Σέρβων και βρίσκεται στο πλευρό τους. «Η Εκκλησία της Ελλάδος δεν μπορεί παρά και αυτή μαζί με τον ελληνικό λαό να είναι



Ο Μητσοτάκης με τον Κάρατζιτς χθες στο πρωθυπουργικό γραφείο. Ο Σέρβος ηγέτης ζήτησε ελληνική μεσολάβηση για σερβοκροατική συνεννόηση

Udhëheqësi serb kërkoi ndërhyrjen e menjëhershme të Greqisë për të arritur një marrëveshje ndërmjet serbëve dhe kroatëve. *Gazeta "Eleftherotypia", 15 qershor 1993, fq*. 12.

II-63. Henri A. Kisinger, ish-Sekretari Amerikan i Shtetit, komenton rreth marrëveshjes së Rambujesë në lidhje me Kosovën, 1999

[…] Unë e respektoj arsyen humanitare për ndërhyrje. Por, kjo nuk i çliron demokracitë nga nevoja për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Marrëveshja e Rambujesë nuk e kalon këtë provë. Çelja e negociatave të mbështetura vetëm në një marrëveshje të përpiluar me kancelarë të huaj, dhe zbatimi i saj përmes kërcënimit të bombardimit nga ajri, veçse e ka përkeqësuar krizën në Kosovë. […] Serbët e kanë kundërshtuar marrëveshjen e Rambujesë pasi , sipas tyre, nuk është gjë tjetër veçse preludi i pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, ata e shohin praninë e trupave të NATO-s si një lloj pushtimi të Serbisë nga të huajt, së cilës ajo i ka qëndruar historikisht si në kohërat e perandorive osmane dhe austriake, ashtu edhe në kohërat e Stalinit dhe Hitlerit. Edhe nëse bombardohen deri në kapitullim, duket pak si e zorshme që të kthehen në përkrahës të vullnetshëm të kësaj pasoje. […] Lufta në Jugosllavi duket se sjell mëdyshje. Serbia luftoi krah për krah me ne, në të dyja luftërat botërore, dhe i doli kundër Stalinit, kur ky i fundit ishte në kulmin e fuqisë së tij. Ne nuk mund ta injorojmë mizorinë e Millosheviçit, por prapëseprapë, zhdukja e Serbisë nga ekuilibri ballkanik mund të shkaktojë trazira në vendet e tjera fqinje, ku jetojnë pakicat etnike. […]

Kisinger, 1999, fq. 28-29.

Cilat janë argumentet pro dhe kundër ndërhyrjes së NATO-s?

II-64. Reagimet greke ndaj bombardimit të Serbisë nga NATO-ja

Në fotografinë e çastit ka dalë "Sheshi Kushtetuta", që ndodhet në qendër të Athinës, i mbipopulluar me rastin e koncertit të Mikis Theodorakis kundër bombardimit ajror të Serbisë nga NATO-ja. Koncerti ishte një prej manifestimeve, përmes së cilave populli grek shprehte mbështetjen e tij për popullin serb. Një koncert i ngjashëm, ishte zhvilluar në Beograd dy javë më parë, ku kishin marrë pjesë disa artistë grekë. →

Koncerti i Mikis Theodorakisit kundër bombardimit të Serbisë nga NATO-ja



26 prill 1999; Fotograf: Haris Bilios.

1. Greqia ishte vendi i vetëm në Evropën Perëndimore që kishte përkrahur Serbinë në luftërat jugosllave. Përse mendoni se ndodhi kjo? Çfarë do të thotë shprehja "ne jemi vëllezër"? A ka ndonjë lidhje historike apo lidhje të natyre tjetër ndërmjet dy shteteve?

2. Studioni marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Serbisë në shekullin e XX dhe përgatisni kronologjinë e aleancave dhe konflikteve të tyre. Më pas, diskutoni nëse ka "miq historikë" apo "armiq historikë" (nëse dëshironi, mund të përdorni edhe shembuj të tjerë).

Il-65 Rumania i ofroi NATO-s lehtësira për bombardimin e Serbisë në vitin 1999: reportazh mediatik

Rumania mbështeti veprimet që u ndërmorën për bombardimin e Jugosllavisë gjatë muajve maj-qershor 1999. […] Në tetor të vitit 1998, parlamenti rumun miratoi kërkesën e NATO-s, që avionët e Aleancës përdornin hapësirën ajrore rumune për operacionet e mundshme ushtarake kundër Jugosllavisë, vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe urgjente. […].

Në shkurt të vitit 1999, ushtarakët rumunë dhe amerikanë ngritën një kullë kontrolli për trafikun ajror, që ishte projektuar të mbulonte edhe rajone të tjera fqinje krahas territorit rumun.

[…]Më 18 prill të vitit 1999, NATO-ja i kërkoi Rumanisë ta hapte hapësirën e saj ajrore për avionët e Aleancës. Më 20 prill, Këshilli i Lartë i Mbrojtjes Kombëtare (KLMK) dhe qeveria rumune iu përgjigjën kërkesës. Më 22 prill, parlamenti rumun i autorizoi avionët e NATO-s të përdornin hapësirën ajrore rumune, gjatë kryerjes së operacioneve ushtarake në Jugosllavi. Në maj të vitit 1999, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare konfirmoi se, Forcat Ajrore të NATO-s, kishin të drejtë të përdornin aeroportet rumune gjatë operacioneve kundër Jugosllavisë. […]

Më 17 qershor të vitit 1999, parlamenti rumun miratoi me shumicë votash kërkesën e Presidentit Emil Konstantineskut për t'i lejuar kontingjentet çeke dhe polake të forcave paqeruajtëse ndërkombëtare të Kosovës të kalonin nga Rumania për të mbërritur në Jugosllavi. [...]

"Rumania gjatë luftërave jugosllave", Zëri i Rusisë, i disponueshëm në http://romanian.ruvr.ru/2014_03_24/24-martie-1999-15-ani-de-la-bombardarea-Serbiei-3776/, vizituar më2 7.03.2015; dhe faqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme e Rumanisë: http://www.mae.ro/node/5346?page=2, vizituar më 03.04.2015.



KAPITULLI III; AKTORËT NDËRKOMBËTARË, ÇËSHTJET VENDORE

Hyrje	103
III.1. Çështja e Qipros	105
III.1.1. Gjatë viteve 1990	105
III.1.2. Nga Samiti i Helsinkit te Plani Annan	107
III.2. Çështja e Jugosllavisë	110
III.2.1. Ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare	110
III.2.2. Bisedimet dhe traktatet e paqes	115
III.2.3. Ndjekjet penale, gjykatat, tribunalet	123
III.2.4. Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Pakti i Stabilitetit	132
III.3. Vendet Ballkanike në BE dhe NATO	133
III.3.1. Aderimi në BE	134
III.3.2. Integrimi në Organizatën e Traktatit të Atlantkut Verior NATO	137
III.4. Tranzicionet dhe traditat politike	138

HYRJE

Në dhjetëvjeçarët pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Evropa Juglindore pa një sërë ndryshimesh madhore. Disa nga këto ndryshime u përjetuan dhe nga vendet e Evropës Lindore; si për shembull, tranzicioni drejt demokracisë parlamentare dhe ekonomisë së tregut dhe pranimi në institucionet euro-atlantike. Në vendet ish-komuniste ky tranzicion nuk ishte as i qetë e as i ndershëm. Jo vetëm që nuk të çonte gjithmonë drejt demokracisë, por gjithashtu ndiqte rrugë të ndryshme në secilin vend (p.sh, në Bullgari apo Rumani), dhe karakterizohej nga mbijetesa e strukturave të vjetra politike. Prapësimi apo ndryshimi i emrit i partive dominuese komuniste në vitet e mëparshme nuk do të thoshte margjinalizim i elitave të vjetra politike. Ata i miratuan programet e partive social-demokratike evropiane dhe vazhduan të ishin një faktor i rëndësishëm në sistemin e ri politik. Shumë anëtarë të qeverive komuniste mundën të shfrytëzonin edhe avantazhet fillestare që ata kishin për t'iu bashkuar partive jokomuniste të reja dhe/apo elitave të reja ekonomike. Në krah të politikanëve të vjetër, që kishin kundërshtuar regjimin e mëparshëm, dolën politikanët e rinj. Shpesh ata mbanin fjalime publike nacionaliste dhe/apo populiste me qëllim të mblidhnin mbështetës. Po gjatë kësaj kohe u vu re një rritje e manipulimit të opinionit publik nga media masive, interesat e së cilës zakonisht ndërlidheshin me ato të elitave politike. Skandalet financiare dhe gjyqet për korrupsion vazhdonin të ishin të pranishme, pavarësisht ndarjeve kufitare dhe ndarjeve të vjetra të Luftës së Ftohtë. Aksidenti me makinë në Susurluk të Turqisë në vitin 1996 (shikoni burimin III-47) është vetëm një shembull që paraqet lidhjen midis interesave të rrjeteve financiare dhe politike me ato të veprimtarive kriminale.

Që të mund të kuptohet rëndësia e këtyre dukurive, të cilat edhe pse ndodhnin në një kuadër lokal kanë dimension ndërkombëtar, njeriu duhet të zotërojë njohuri të mjaftueshme për historinë evropiane dhe atë botërore. Këto njohuri duhen zotëruar pasi ndërhyrjet e faktorëve ndërkombëtarë në çështjet vendore kanë qenë vendimtare, më së shumti kjo vërehet në ndarjen e Jugosllavisë. Nuk ka dyshim që njohja e Kroacisë dhe Sllovenisë si shtete të pavarura, së pari nga Gjermania dhe më pas nga Komuniteti Evropian, pati një rol të rëndësishëm në përkeqësimin e krizës jugosllave. Ishte një lloj ndërhyrje "beninje" ndërkombëtare, që pati pasoja të rëndësishme në rang vendor.

Një kontroll i burimeve historike që paraqiten në këtë kapitull dhe në kapitujt I dhe II, tregon gjendjen e ndërlikuar të shkaqeve.

Shumë shtete dhe organizata ndërkombëtare ishin të përfshira në krizën që përfshinte shpërbërjen e Jugosllavisë. Këto shtete janë dhe organizata ndërkombëtare: Kombet e Bashkuara, Komuniteti Evropian (më vonë Bashkimi Evropian), Shtetet e Bashkuara dhe Federata Ruse. Në përgjithësi, këto ndërhyrje nuk patën sukses dhe kjo erdhi si pasojë e disa faktorëve; si mosmarrëveshje midis aktorëve, vlerësimi jo i mirë i ngjarjeve dhe ngurrimi për të ndërkombëtarizuar mosmarrëveshjen dhe përdorimi ashtu siç duhet i trupave. Fillimisht, SHBA-ja ishte e zënë me Luftën e Gjirit dhe më pas ngurroi, ndërsa Komuniteti Evropian ishte i zënë me transformimin e tij në Bashkimin Evropian. Deri në vitin 1995, Fuqitë e Mëdha i kishin kufizuar veprimtaritë e tyre kryesisht në mbështetjen e Forcës Mbrojtëse të OKB-së dhe vënies së embargos së armëve, që në të vërtetë i shërbeu vetëm serbëve.

Nga viti 1991 deri në vitin 1999, BE-ja dhe SHBA-ja ndoqën një politikë ndërhyrjeje, që ishte krijuar për t'i dhënë fund luftës në tokën jugosllave, luftë që po bënte kërdinë në fronte të ndryshme dhe që zhvillohej ndërmjet kundërshtarëve të ndryshëm. U krijuan disa komitete të reja, u mbajtën një sërë konferencash paqeje dhe u paraqitën plane për zgjidhjen e krizës, megjithatë, rezultatet ishin të pakta. Madje as Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995, që dukej se do i jepte fund dramës jugosllave duke krijuar një shtet federal në Bosnje-Hercegovinë nën mbikëqyrjen e komunitetit ndërkombëtar, nuk mundi të ndalonte përkeqësimin e dhunës apo ndarjen e mëtejshme të Jugosllavisë.

Para se organizatat ndërkombëtare t'i drejtoheshin ndërhyrjes ushtarake (bombardimi i Serbisë nga NATO-ja), u përdorën mënyrat alternative të presionit, si për shembull sanksionet ekonomike. Krahas ndërhyrjes diplomatike dhe ushtarake, përfshirja e komunitetit ndërkombëtar ishte dizenjuar për t'iu ofruar ndihmë humanitare popullsisë civile, që ishte viktimë e vuajtjeve të pathëna, që fillonin nga spastrimi etnik e shkonin deri te dëbimi. Forcat Mbrojtëse të OKB-së, me afërsisht 39,00 ushtarë të angazhuar në misione të ndryshme në të gjithë ish- Jugosllavinë, patën një rol thelbësor në shpëtimin dhe dhënien e ndihmës qytetarëve, sidomos të atyre në Bosnjë-Hercegovinë.

Krimet e luftës të kryera përgjatë luftërave Jugosllave, më në fund u nxorën para gjykatave, sidomos para atyre ndërkombëtare, por edhe atyre vendore. Vepra e fundit e "dramës" jugosllave po trajtohet akoma në këto gjykata. Në maj të vitit 1993, Këshilli i Sigurisë së KB-së formoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavinë (GJPNIJ), me seli në Hagë. Pas gjykatave

ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, kjo ishte gjykata e parë ndërkombëtare për luftën, që nga Lufta e Dytë Botërore. Detyra e saj ishte të organizonte gjyqe për vrasjen, torturimin, përdhunimin, mbajtjen e mijëra qytetarëve në kampet e përqendrimit, zhvendosjen e mijëra njerëzve nga shtëpitë e tyre, shkatërrimin e pronave dhe krime të tjera të përcaktuara nga Statuti i saj. Deri më tani, mbi 160 njerëz janë nxjerrë para gjyqit.

Pas luftës, BE-ja, së bashku me ndihmën e organizatave të tjera ndërkombëtare, kishte si qëllim stabilizimin e Evropës Juglindore dhe të ofronte ndihmë ekonomike. Për këtë arsye, në vitin 1999, u krijua Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, me qëllim përforcimin e paqes, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe stabilizimin e ekonomisë në vendet e rajonit. Ky pakt ishte përpjekja e parë nga komuniteti ndërkombëtar për të zëvendësuar "politikën reaktive të ndërhyrjes në krizë" në Evropën Juglindore me një strategji afatgjatë për "parandalimin e konfliktit".

Pa dyshim që në Evropën Juglindore të pas Luftës së Ftohtë, çështja më problematike dhe tronditëse ishte ajo e Jugosllavisë dhe këtë e vërteton rasti i Kosovës, i cili akoma nuk është zgjidhur plotësisht. Një tjetër "nënprodukt" i Krizës Jugosllave është çështja polemizuese e Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, përsa i përket emrit të shtetit të ri. Kjo polemikë filloi një ditë pasi republika e re deklaroi pavarësinë dhe arriti pikën kulminante në vitin 1994 kur Greqia vendosi embargo ndaj republikës së re dhe vetëm në vitin 1995 kjo gjendje arriti të normalizohej sadopak me Marrëveshjen e Përkohshme. Pavarësisht faktit që të dy vendet i kanë rregulluar marrëdhëniet, çështja e emrit nuk ka marrë zgjidhje akoma dhe ende përmendet nga rrethet nacionaliste në të dyja anët e kufirit.

Një tjetër çështje e pazgjidhur e pasviteve 1990, është ajo e Qipros. Këtu futen në lojë marrëdhënia greko-turke dhe shumë aktorë ndërkombëtarë.Pas ndarjes së ishullit në fillim të pushtimit turk të vitit 1974, për herë të parë në vitet 1990 filluan ndryshimet. Nga njëra anë, filloi procesi për aderimin e Qipros në BE dhe, nga ana tjetër, u nisën një sërë planesh nga komuniteti ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes, dhe më i rëndësishmi prej tyre ishte Plani Annan i vitit 2004. Krahas këtyre, u hoqën kufizimet për lëvizjen e njerëzve dhe që nga viti 2003, si qipriotët turq, ashtu edhe ato grekë, kanë të drejtë të vizitojnë "anën tjetër". Vetëm atëherë u prish "Muri i Berlinit" i qipriotëve, edhe pse ishulli i tyre akoma nuk është bashkuar. Pavarësisht se Republika e Qipros ka që në vitin 2004 që është shtet anëtar i plotë i BE-së, përfitimet dhe të drejtat e anëtarësisë në BE zbatohen kryesisht vetëm për qipriotët grekë. Pjesa veriore e ishullit, e njohur si "Republika Turke e Qipros së Veriut", nuk njihet nga komuniteti ndërkombëtar, por vetëm nga Turqia.

Në vitin 2004, Sllovenia u bë republika e parë ish-jugosllave që iu bashkua BE-së, e ndjekur nëntë vite më vonë nga Kroacia. Bullgaria dhe Rumania iu bashkuan BE-së në vitin 2007 dhe deri në fund të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XXI, të gjitha këto vende, përfshirë dhe Shqipërinë, ishin bërë anëtare të NATO-s. Edhe pse Turqia ka që në vitin 1952 që është anëtare e NATO-s, ajo akoma nuk i është bashkuar BE-së. Si rrjedhojë, Evropa Juglindore vazhdon të jetë e ndarë përsa i përket lidhjeve evropiane, pasi shumë shtete të rajonit nuk janë anëtare të BE-së. BE-ja përdor neologjizmën "Ballkani Perëndimor" për shtetet jo-anëtare, përveç Turqisë, që në të vërtetë do të thotë "vendet nga territori i ish-Jugosllavisë (përveç Sllovenisë dhe Kroacisë, përkatësisht në vitin 2004 dhe 2013) dhe Shqipëria. I ashtuquajturi "Ballkani Perëndimor" përfshin Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërinë.

Ky kapitull ka si qëllim paraqitjen e të gjitha zhvillimeve politike në Evropën Juglindore pas Luftës së Ftohtë, që janë zhvilluar në shtetet e rajonit dhe në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

III.1.ÇËSHTJA E QIPROS

Qiproja ishte vendi më nevralgjik dhe më problematik në Evropë (vendin e parë e zinte Lindja e Mesme) deri kur u shpërbë Jugosllavia dhe vazhdon të jetë një nga zonat me më shumë kriza në rajon. Që nga vitet 1950, shumë nga krizat më të mëdha diplomatike në marrëdhëniet kombëtare kanë qenë të lidhura me Qipron (ngjarjet e viteve 1955-58, krizat e viteve 1963-64 dhe 1974, dhe kriza e raketave S-300 ndërmjet viteve 1997 dhe 1999). Rënia e Bashkimit Sovjetik dhe procesi i demokratizimit në vendet e Evropës Lindore, ndryshuan karakterin e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shtuan rreziqet ndaj sigurisë së shteteve më të vogla, si Qiproja. Integrimi i tyre në një organizatë mbikombëtare, që i lidhte ato me një numër më të madh shtetesh, do t'i ofronte atyre jo vetëm sigurinë, por edhe përparësi politike dhe ekonomike. Për më tepër, Lëvizja e Vendeve të Paangazhuara, bashkëthemeluese e së cilës ishte Qiproja, kishte filluar të mos ishte më aq e rëndësishme, ndërsa Bashkësia Evropiane dhe veprimtaria e saj gjithnjë e në zgjerim, po lulëzonin. Viti 2004 shënon një ndryshim shumë të madh në historinë e Qipros: u mbajt një referendum për zgjidhjen e Problemit të Qipros, mbështetur në Planin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan dhe, së dyti, Republika e Qipros aderoi në BE.

III.1.1.GJATË VITEVE 1990

III-1. Një artikull nga Presidenti i Qipros, Xhorxh Vasiliu para se të fillonin bisedimet në Kombet e Bashkuara më 19 shkurt 1990.

Më 4 korrik të vitit 1990, qeveria qipriote, me në krye Xhorxh Vasiliun, sipas nenit 237 të Traktatit të Romës (BEE), paraqitën një aplikim formal për t'u bërë pjesë e Bashkësisë Evropiane Si qeveria turke, ashtu edhe qipriotët turq, reaguan ashpër ndaj këtij aplikimi. Megjithatë, për shkak të këtij veprimi nga ana e Qipros, BE-ja u kthye në faktorin kyç përcaktues të jashtëm në lidhje me evoluimin e konfliktit.

[…]Do të rrezikohet shumë më shumë se vetëm e ardhmja e qipriotëve. Ajo që duhet të vendoset në Qipro është se nëse shtetet me më shumë se një grup etnik mund të mbijetojnë si entitete të bashkuara brenda kufijve të sigurt, apo nëse duhet të ndahen dhe secili komunitet të kërkojë të drejtën për t'u shkëputur me pretendimin se kjo është mënyra më e mirë për të mbrojtur interesat e saj.

"Zgjidhja" e dytë do të sillte fundin e Evropës, madje edhe të botës, dhe është e sigurt që ky fund nuk do të ishte i paqtë. Ndarja e Qipros do të vendoste një precedent, të cilin bashkësia ndërkombëtare nuk e përballon dot.

Vassiliou,2010,fq.97.

Komentoni për deklarimin e mëposhtëm: "Ajo që duhet të vendoset në Qipro është se nëse shtetet me më shumë se një grup etnik mund të mbijetojnë si entitete të bashkuara brenda kufijve të sigurt, apo nëse duhet të ndahen dhe secili komunitet të kërkojë të drejtën për t'u shkëputur me pretendimin se kjo është mënyra më e mirë për të mbrojtur interesat e saj.

III-2. "Diplomacia e tërmeteve" ndërmjet Greqisë dhe Turqisë

Marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Turqisë ishin në tension të vazhdueshëm që nga viti 1974 e më pas, duke arritur kulmin në janar të vitit 1996 me krizën e krijuar për një ishull të cilin në greqisht e quanin "Imia", ndërsa në turqisht "Kardak". Kjo situatë ndryshoi si pasojë e tre ngjarjeve dramatike që ndodhen në vitin 1999. Ngjarja e parë ishte kapja e udhëheqësit të Partisë Punëtore Kurde, Abdulla Oçalan, i cili fshihej në ambasadën greke në Kenia. Ngjarja e dytë ishte bombardimi i Serbisë nga NATO-ja nga marsi deri në maj, që filloi me deklaratat e Presidentit amerikan dhe Kryeministrit britanik të asaj kohe, se një nga arsyet pse po bëhej kjo ishte për të shmangur luftën greko-turke për Kosovën. →

Si grekët ashtu edhe turqit mendonin se këto deklarata ishin plotësisht të pavërteta. Në maj, Ministri i Jashtëm turk, Ismail Xhem, i shkroi një letër Ministrit të Jashtëm grek, Jorgos Papandreut dhe mori një përgjigje miqësore. Ngjarja e tretë dhe njëkohësisht më dramatikja, ishte ajo e dy tërmeteve shumë të forta, njëra afër Stambollit që ndodhi nga mesi i gushtit, dhe e dyta në Athinë që ndodhi në fillim të shtatorit. Në mëngjesin e datës 17 gusht të vitit 1999, rajoni i Marmarasë Lindore në Turqi u godit nga një tërmet 7.4 ballë. Ndërsa kombi ishte kapluar nga tronditja e qyteteve të rrënuara, e mijëra të vdekurve dhe njerëzve të lënduar, në zemrën industriale dhe financiare të vendit nisi paniku. Përgjigja e ndjerë e Greqisë u vlerësua shumë në atë kohë kur ndihma ishte shumë e nevojshme. Më 18 gusht, Kryeministri grek, Kostas Simitis, urdhëroi që të dërgohej ndihmë urgjente në Turqi, që përfshinte tre aeroplanë me staf mjekësor, grup shpëtimi dhe ndihmë materiale ("Yardım Yağıyor", Hürriyet, 18 gusht 1999). Pastaj më 7 shtator, pjesa veriore e Athinës u godit nga një tërmet 6 ballë, nga ku ngelën të vrarë 150 njerëz dhe 2,000 të lënduar. Kësaj radhe, ishin grupet e shpëtimit turke të operacionit të tërmetit në Marmara, që shkuan të jepnin ndihmën e tyre. Atmosfera e qetë ndërmjet dy kombeve gjatë këtyre ngjarjeve, bëri të mundur që të ndërmerreshin masa shtetërore për të përmirësuar marrëdhënien dypalëshe.

A.Stefen Kinzer i gazetës New York Times duke raportuar nga Athina

Një ditë pasi Athina u godit nga tërmeti më i fuqishëm ndër dhjetëvjeçarë të tërë, me miliona shikues panë të frikësuar në televizor se si grupet e shpëtimit turke nxorën një fëmijë grek nga një grumbull i madh rrënojash. Prezantuesit nuk mundën t'iu përmbaheshin emocioneve. "Janë turqit!", tha njëri prej tyre me zë të lartë dhe plot emocion. "E nxorën vogëlushin. E shpëtuan. Tani ai turku po pi një shishe ujë. Është e njëjta shishe nga ku piu dhe ai i grupit të shpëtimit grek. Kjo është dashuri. Është shumë e bukur." […] Nikolas Bërns, Ambasadori i SHBA-së në Greqi u shpreh: "Mendoj se gjendemi në mes të një dukurie të re që mund të quhet diplomaci sizmike apo e tërmetit" "Pamjet e para nga njerëzit në televizor kishin simbolizëm të madh politik dhe ekziston një mundësi që të dyja palët të bëjnë diçka me këtë."[…]

Kinzer,http://www.nytimes com/1999/09/13/world/earthquakes-help-warm-greek-turkish-relations. html?pagewanted=all,accessedon23.05.2016.

B.Një grek anonim i dhuron veshkën një turku, viktimë e tërmetit

"Një mësim në paqe ose një dhurim që shpëton jetë." Nxënësit turq në një shkollë fillore në Gjermani e morën vesh për këtë dhurim dhe i shkruajtën një letër "xhaxhit të panjohur grek".

"Nuk ta di emrin, por kam lexuar në gazetë që do t'i dhurosh veshkën një turku viktimë e tërmetit. Që të dy ne duam që Turqia dhe Greqia të jetojnë në paqe," Kështu fillon letra e Pënar Karabacakut, një nxënëse 13-vjeçare, drejtuar "xhaxhit grek me zemër të bardhë". [...] Ajo nuk ishte e vetmja që shkroi letër. Me dhjetëra fëmijë, fëmijë të emigrantëve turq në Gjermani, i dërguan letër "xhaxhit grek".

Gazeta "Eleftherotypia" , 2 shtator 1999, fq. 47.

III-3."Diplomacia e leuçemisë" në Qipro, në mars të vitit 2000

Në mars të vitit 2000, me mijëra njerëz nga Qiproja, Greqia dhe Turqia dhuruan gjak për Andreasin qipriotin grek, dhe për Kemalin, qipriotin turk, që vuanin nga leucemia dhe kishin nevojë për transplant të palcës kurrizore. E gjithë ngjarja u paraqit nga media ndërkombëtare si një rast i "Diplomacisë së leucemisë" dhe iu shtua kapacitetit të shoqërisë civile për të kapërcyer ndarjet nacionaliste dhe për të ndërtuar ura ndërmjet njerëzve. Si për ironi, nuk u gjetën persona me të njëjtin grup gjaku me Andreasin apo Kemalin. Megjithatë, Andreasit i bënë transplant të gjakut të kordonit umbilikal në një spital amerikan dhe shpëtoi, ndërsa Kemali vdiq pasi gjaku i tij nuk përputhej me atë të dhuruesit.

GJENDJA E VËSHTIRË E DJALIT KAPËRCEN NDARJEN. QIPRIOTËT TURQ I BASHKOHEN TË GJITHË THIRRJES PER TE NDIHMUAR TE SEMURIN ME LEUCEMI

Me qindra qipriotë turq, përfshirë edhe djalin e Rauf Denktashit, udhëheqësit të qipriotëve turq, si edhe udhëheqësin e partisë opozitare, Ali Talat, dhuruan gjak dje, në mënyrë që të mund të gjendej një dhurues i përputhshëm për palcën kurrizore të djalit qipriot grek, të sëmurë me leuçemi, dhe për ta shpëtuar atë […] Denktash dhe Talat thanë që ishte një vepër humanitare dhe që nuk duhej përdorur për qëllime politike. […] "Qipriotët turq e konsideruan tim bir si të tyrin. I ati i Andreas u shpreh: "Dua vetëm t'i falënderoj të gjithë turqit dhe qipriotët turq që kanë ardhur për vogëlushin tim. "Zëdhënësi i qeverisë tha se përpjekja për të gjetur një dhurues kishte kapërcyer ndarjen e ishullit, duke provuar se qipriotët grekë dhe turq mund të bashkëjetojnë"[…]

Kjo situatë e ka lënë pas ndarjen dhe tregoi se qipriotët grekë dhe turq, jo vetëm që mund të jenë qytetarë të të njëjtit shtet, por gjithashtu edhe mund të sillen si të tillë." […]Ndërkohë, shoqatat e diasporës greke dhe turke në Australi kanë deklaruar dje që do t'i bashkohen nismës për të gjetur dhurues të përputhshëm për Andreasin dhe Kemalin.

Gazeta "Cyprus Mail", 28 mars 2000.

1. Sipas burimit, incidenti i përshkruar në dok. III-3, provon që qipriotët turq dhe grekë mund të bashkëjetojnë. Jeni dakord me këtë përfundim? Pse mendoni se vetë politikanët dhuruan gjak për fëmijën në nevojë dhe cili ishte qëllimi dhe simbolika e pjesëmarrjes së tyre në nismë?

2. "Dhe tregoi që qipriotët grekë dhe turq, jo vetëm që mund të jenë qytetarë të të njëjtit shtet, por gjithashtu edhe mund të sillen si të tillë." Diskutoni për thelbin e të qenit një qytetar aktiv (përgjegjësitë, nevojat, sjelljet, aktivizmi).

3. Krahasoni veprimtarinë e "Diplomacisë së leucemisë" me atë të "tërmetit" përshkruar në burimin III-2. Pse mendoni se fatkeqësitë apo çështjet humanitare i afrojnë njerëzit, etnitë apo edhe kombet më shumë me njëri-tjetrin, pavarësisht ndryshimeve apo të shkuarës tronditëse? Ku përqendrohen çështje të tilla dhe çfarë i kujtojnë njerëzve?

4. Diskutoni për fjalët "Diplomacia e leucemisë" dhe "Diplomacia e tërmetit". Pse dhe si përdoret fjala "Diplomaci" në të dyja rastet?

5. Ndajeni klasën në tre grupe. Secili nga grupet duhet të analizojë tërmetet si 1) gazetar i huaj, 2)anëtar i një grupi shpëtimi turk dhe 3)anëtar i një grupi shpëtimi grek, të dërguar për të ndihmuar në zonat përkatëse të prekura nga tërmeti.

6. E gjithë klasa duhet të bëjë një projekt kërkimi mediatik, që të mund të gjejë raste që jo vetëm përfshijnë Greqinë, Turqinë apo Qipron, por edhe të gjithë rajonin e më tej. Gjetjet e kërkimeve do të krahasohen dhe diskutohen në klasë.

III.1.2.NGA SAMITI I HELSINKIT TE PLANI ANAN

III-4. Qipriotët turq shprehin mendime të ndryshme për aderimin në BE

Në dhjetor të vitit 1999, Këshilli Evropian në Helsinki mirëpriti nisjen e bisedimeve të mundësuara nga OKB-ja, me qëllim zgjidhjen e Problemit Qipro, gjithashtu theksoi se zgjidhja politike e Çështjes Qipro do të lehtësonte aderimin e kësaj republike në BE. Po të mos arrihet asnjë marrëveshje deri në përfundimin e negociatave të aderimit, Këshilli theksoi se "vendimi i tij për aderimin do të jepet duke mos i konsideruar negociatat si parakusht" (shikoni edhe kap. III.3.1, III-29). Qipriotët turq kishin mendime të ndryshme për pasojat e Samitit të Helsinkit: Federalistët argumentonin se kjo ishte mundësia më e mirë për të zgjidhur Çështjen Qipro; përkrahësit e ndarjes, nga ana tjetër, mbronin Qipron e Veriut dhe lidhjen e saj me "mëmëdheun Turqi.".

A.Federalistët qipriotë turq

[…]Është e ditur, që nëse Turqia nuk do të kishte një rol të rëndësishëm në Qipron e Veriut, kandidatura e Turqisë do të kishte shumë rrugë për të bërë derisa të futej në BE. Një fakt tjetër është që po të mos kishte aplikuar Qiproja dhe mos të kishte filluar bisedimet për shtet kandidat të BE-së, kandidatura e Turqisë do të kishte po përsëri shumë për të bërë. Të dyja këto fakte mbështeten te Çështja Qipro. Nuk ka dyshim që Qiproja do e çojë Turqinë drejt kandidaturës dhe aderimit në të ardhmen!

[…]Megjithëse përpiqen të na çorientojnë, qipriotët turq mund të merrnin dhuratën e tyre në Helsinki. Në fakt, është dhuratë edhe më e madhe se ajo që iu dha Turqisë! Mund të bëhemi anëtarë të plotë të BE-së menjëherë.

Pse atëherë jemi të trishtuar dhe jo të lumtur? Pse na është lënduar krenaria?

Kjo erdhi për shkak të sjelljes së politikanëve turq, të cilët, një vendim që për ne do të ishte me përfitim, e bënë të duket sikur ishte një vendim negativ.

[…]Ata kanë pranuar çdo gjë te vendimet e Helsinkit, por nuk pranojnë nenin që flet për Qipron. A thua se çështja është ta pranosh apo ta hedhësh poshtë![…]

Fatma Azgın, Gazeta Yenidüzen , 15 dhjetor 1999.

B.Përkrahësit qipriotë turq të ndarjes

Në përfundim të Samitit të Helsinkit, kishte nga ata që ishin të lumtur dhe nga ata që nuk ishin të

lumtur. […] Gjithashtu, u habitëm kur mësuam sa i ndarë ishte populli turk nga "klubi" i BE-së.[…]sot në Turqi, ku reagimi i "neorepublikanëve" dhe qëndresa e fundamentalistëve kundër mirëpritjes së Turqisë nga BE-ja nuk mund të nënvlerësohen.

Dhe shpresat e pashuara të këtij grupimi goxha të madh "bërtasin" me të madhe se: "Turqia nuk do të bëhet asnjëherë anëtare e plotë e BE-së ".

[...]Përplasja e fortë midis fronteve opozitare do të shtohet në mënyrë që mundësia për anëtarësim të plotë të jetë më e vogël dhe për ta kthyer atë në një shpresë të kotë.

[…]Mos harroni që turkomanët, të ardhur nga stepat aziatike të Anadollit, krijuan Perandorinë Osmane. Madje, ata shkuan deri në Vjenë, deri në qytetet në zemër të Evropës…

[…]Dhe Qiproja: merrni parasysh që historinë e çuan 400 vite përpara, deri në vitin 1999. Vendoseni Qipron aty ku i takon në historinë e saj "madhështore". Kur ka qenë jashtë Turqisë dhe pa Turqinë?

[…]Që nga viti 1571, që nga "vuajtjet e modernizimit" të Turqisë e deri më sot, Qiproja është zhvilluar brenda gjirit të shtetit Osman dhe Turqisë dhe tani është sjellë në kohën tonë.

Për këtë arsye, vendimi që lidh Qipron në Helsinki nuk ka aspak rëndësi. Do të vijë koha kur Turqia Evropiane dhe Qiproja Evropiane do të vendosen në vendet që i takojnë me të drejtë. Për sa kohë që Turqia do ta bëjë të vetin këtë proces të "evropianizimit".

Eşref Çetinel, Gazeta Halkın Sesi, 13 dhjetor 1999.

1. Si përshkruhen marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Turqisë në dy dokumentet? Cilat janë dallimet?

2. Gjeni referencat historike në dokumentin e dytë dhe identifikoni për cilat ngjarje flet autori. Mbështetur në këto të dhëna, shpjegoni se si historia përdoret si argument politik.

III-5.Heqja e kufizimeve për të lëvizur lirshëm në Qipron e ndarë, 2003

Ndërmjet viteve 1974 dhe 2003, ishte e pamundur që qytetarët e Qipros të vizitonin dhe takonin personat në anën tjetër. Në prill të vitit 2003 Turqia dhe udhëheqja qipriote turke vendosën të hiqnin kufizimet te disa barrikada, duke i lejuar kështu njerëzit të kalonin. Disa analistë mendojnë se kjo ngjarje ka ardhur si pasojë e trysnisë që qipriotët turq (me demonstrata të vazhdueshme) kishin ushtruar ndaj politikave të Denktashit.

Heqja e pjesëshme e kufizimeve për lëvizjen e lirë drejt dhe nga "Republika Turke e Qipros së Veriut" më 23 prill, solli një epokë të re në historinë e gjatë dhe të trazuar të çështjes kombëtare të Qipros.

Ajo masë ishte rezultat, së pari, i kryengritjes qipriote turke kundër regjimit të Denktashit, përgjatë vitit 2002 dhe në fillim të vitit 2003. Këtu përfshiheshin demonstrata masive, protesta militantësh dhe greva të pandodhura më parë në historinë e Qipros turke. Këto mobilizime e lanë regjimin as këtej e as andej dhe i dërguan qeverisë së re turke me në krye Erdoganin, mesazhin "Mjaft me kaq!

[…]Zgjidhja e çështjes së Qipros dhe aderimi në BE u panë si shpresa e fundit e masave qipriote turke, që kishin vuajtur tre dhjetëvjeçarë me recesion ekonomik, veçim dhe shtypje brutale.

Një "festival" pajtimi masiv

[…]Brenda 15 ditësh, 260,000 qipriotë grekë dhe 90,000 qipriotë turq, afro 40% e popullsisë i kaloi barrikadat! Turma të pafundme njerëzish prisnin me orë të tëra nën diellin përvëlues, ndërsa mijëra të tjerë flinin në makinat e tyre, vetëm e vetëm që, pas 29 vitesh, të mund të vizitonin shtëpitë e tyre apo të dashurit e tyre në "anën tjetër".

Ajo që kishte më shumë rëndësi në të gjithë këtë, ishte se nga ana tjetër nuk i prisnin armiq, siç i kishin thënë për tre dhjetëvjeçarë me radhë nacionalistët e të dyja anëve, por "njerëz të thjeshtë si ne", që kishin bërë çdo përpjekje për të shprehur dashuri dhe miqësi për shekuj me radhë në mënyrë që qipriotët grekë dhe turq të mund të bashkoheshin. Ata ishin njerëz që kishin ruajtur fotografi dhe sende të tjera të vyera të pronarëve të shtëpive dhe ia kthyen atyre 29 vjet më vonë.

U bë e mundur që vetëm brenda pak ditësh të shkatërrohej miti i armiqësisë ndërmjet grekëve dhe turqve, mit që i kishte shërbyer elitave politike për një epokë të tërë. Madje edhe lëvizja e lirë e kufizuar u kthye në një "festival" pajtimi masiv.

Politikanët si spektatorë të "hutuar"

Udhëheqja politike qipriote greke u trondit po kaq shumë.

Shumë mbetën të hutuar nga zhvillimet e ndodhura, ndërsa shumë të tjerë u përpoqën që të dekurajonin lëvizjen e qipriotëve grekë, me justifikimin se po të tregonin pasaportat, atëherë do të thoshte se ata e njihnin shtetin e Denktashit, që lëvizja e lirë i ofron mbështetje financiare pseudo-shtetit, që qeveria nuk mund të garantojë mbrojtjen dhe sigurinë e udhëtarëve, etj.

Populli i "sfidoi" politikanët dhe votuan me këmbët, makinat dhe biçikletat e tyre! Ndjenja mbizotëruese ishte që: "Politikanët" dolën se ishin të paaftë, jo vetëm në zgjidhjen e çështjes kombëtare, por edhe në gjetjen e një mënyre për të na takuar në fshatrat dhe qytezat tona.Nëse bisedimet dhe

komunikimet e vazhdueshme të "politikanëve" me anën tjetër nuk përbëjnë njohje dhe tradhti, pse atëherë njerëzit e thjeshtë u shpallën tradhtarë vetëm sepse vizituan njerëzit e tyre të dashur në veri?"

Mihail,20/5/2003, http://www.xekinima.org/arthra/view/article/kypros-h-eksegersi-ton-tk-anoikse-ta-odofragmata,parë më 19.01.2016.

1. Pse shumë njerëz nga të dyja anët vendosën të kalonin vijën ndarëse dhe të vizitonin vendet e tyre të origjinës, pavarësisht sjelljes negative të udhëheqësve të tyre? Cili ishte ajo arsye kaq e fortë sa i bëri të shkonin në territorin "tjetër"?
Pse politikanët nacionalistë të të dyja anëve i quajtën këto vizita si "vepra tradhtie"?
Si e kuptoni titullin "Politikanët si spektatorë të hutuar"?
2. Imagjinoni sikur doni të kaloni në anën tjetër të vijës ndarëse.
Përshkruani ndjenjat dhe pritshmëritë tuaja.
Pse i frikësoheni anës tjetër dhe çfarë shpresoni të gjeni atje?
Shënoni pikat kryesore të mendimeve tuaja dhe vendosni nëse jeni qipriotë turq apo grekë.
Krahasoni dhe diskutoni.
Më pas shënoni gjetjet tuaja dhe përshkruani se si ndiheni (shikoni edhe kapitujt për Qipron në vëll. 1).

III-6. Referendumi për Planin Annan, 2004

Mes dhjetorit të vitit 1999 dhe nëntorit të vitit 2002, Kofi Annan nisi dhe zhvilloi bisedime paraprake për zgjidhjen e çështjes së Qipros. Mes viteve 2002 dhe 2004 u zhvilluan negociata të drejtpërdrejta. Në vazhdim, Annani hartoi pesë versione të planit të tij për "Republikën e Bashkuar Qipriote". Në dhjetor të vitit 2002 dhe mars të vitit 2003, Rauf Denktashi, udhëheqësi i atëhershëm i qipriotëve turq nuk pranoi Planin e parë dhe të dytë, me teorinë se këtë e bëri për të mirën e komunitetit të tij, që në fakt, ishte e qartë se e mbështeste së bashku me qeverinë turke. Vija e Gjelbër (krahasoni me IV-27, v30) u hap menjëherë pas refuzimit të tij të dytë në prill të vitit 2003. Me mbështetjen e qeverisë turke, versioni i pestë i Planit Anan u vendos në referendum në prill të vitit 2004, pas ndryshimeve të mëtejshme të bëra nga OKB-ja. Plani u pranua nga 64.91% e qipriotëve turq, por u refuzua nga 75.83% e qipriotëve grekë. Një javë pas votimit të referendumit, Republika e Qipros u integrua plotësisht në Bashkimin Evropian, së bashku me gjithë qytetarët e tij, përfshirë këtu edhe qipriotët turq, që po bëheshin qytetarë të BE-së. Megjithatë, Aquis Communitaire nuk zbatohej në vendet që nuk ishin nën kontrollin e qeverisë së Republikës së Qipros.

→

Vota negative për Planin Annan u festua nga komuniteti qipriot grek si "Mbijetesa e Republikës së Qipros".



ΦιλελεύθεροςGazeta(Philelefteros:Liberal), 25 prill 2004.

Do e përshkruanit si pozitive apo negative sjelljen e karikaturistit lidhur me rezultatin e referendumit? Pse figura femërore mban në dorë flamurin e Republikës së Qipros? Cila është deklarata këtu? Mendoni se kjo diçiturë përfaqëson të dyja komunitetet e ishullit? Gazeta ΦιλελεύθεροςGazeta (Philelefteros: Liberal), 25 prill 2004. A mendoni se ka kontradiktë mes mënyrës se si përfaqësohet figura dhe rezultatit të referendumit, sidomos kur bëhet fjalë për qipriotët grekë? Argumentoni përgjigjen tuaj.

III.2. ÇËSHTJA E JUGOSLLAVISË

Komuniteti Evropian ishte i pari që ndërhyri në Jugosllavi. Gjatë luftës në Sllloveni, e ashtuquajtura "Troika" ishte në Zagreb më 28 dhe 29 qershor të vitit 1991 dhe shërbeu si ndërmjetës i një marrëveshjeje armëpushimi dhe i një moratoriumi tremujor për pavarësinë e Sllovenisë, por luftimet vazhduan duke qenë se ushtria nuk ra dakord me marrëveshjen dhe armëpushimi filloi të zbatohej vetëm më 3 korrik. Më 7 korrik në Brijuni, përfaqësuesit e Sllovenisë, Kroacisë, Qeverisë Federale (Jugosllave) dhe Trojka ranë dakord që policia sllovene do të mbikëqyrte kufijtë sllovenë, që gjendja në kufij do të kthehej siç ishte para datës 25 qershor (se si do bëhej kjo nuk ishte e qartë), që njësitë sllovene do të zhbllokonin kazermat ushtarake, duke lejuar kështu tërheqjen e njësive JNA (Ushtria Popullore Jugosllave), që do të ndërprisnin sulmet e tyre, që forcat e mbrojtjes territoriale do të çmobilizoheshin, gjithë të burgosurit do të liroheshin dhe që për tre muaj, Sllovenia do të bllokonte të gjitha masat lidhur me pavarësinë. Kjo ishte ndërhyrja e vetme diplomatike që përfundoi me sukses. Pas përshkallëzimit të luftës në Kroaci në verën e vitit 1991, presidentët e republikave Jugosllave, Presidenca federale dhe qeveria federale, nën mbrojtjen e Trojkës evropiane dhe të udhëhequr nga Hans van den Broek, nënshkruan një marrëveshje armëpushimi që do të zgjeronte veprimtaritë e vëzhguesve të Komunitetit Evropian deri në Kroaci dhe për të nisur një Konferencë për Jugosllavinë në Hagë.

III.2.1. NDËRHYRJA NDËRKOMBËTARE USHTARAKE

III-7. Vëzhguesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Sllloveni



Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Pas zbatimit të Marrëveshjes së Brijunit, që shpalli një moratorium tremujor për pavarësinë e Sllovenisë në mënyrë që të mundësonte armëpushimin ndërmjet Forcave të Armatosura Sllovene dhe Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA), një grup vëzhguesish holandezë erdhën në Sllloveni për një afat të shkurtër kohor dhe me mandat nga Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), e miratuar më 5 korrik të vitit 1991. Ndonëse JNA-ja u përpoq t'i ndalonte, vëzhguesit më në fund arritën të vizitonin pa asnjë ndërprerje kazermat e Mbrojtjes Territoriale dhe komisariatet sllovene..

III-8. UNPROFOR: Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara

UNPROFOR, Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara, e njohur më së shumti si "Helmetat blu", ishte një forcë paqeruajtëse aktive gjatë kohës së luftërave jugosllave në territorin e ish Jugosllavisë (1992-2001). U themelua në shkurt të vitit 1992 nga Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Ndërmjet viteve 1992 dhe 1995 veproi në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovinë (BiH). UNPROFOR u dislokua në dhjetor të vitit 1992 në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për të mbrojtur territorin që kufizonte Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Shqipërinë. Ndërmjet marsit të vitit 1995 dhe shkurtit të vitit 1999, forca paqeruajtëse veproi si Forca e Dislokuar Parandaluese e Kombeve të Bashkuara (UNPREDEP) me detyrën e mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në nëntor të vitit 1995, pas marrëveshjes së Dejtonit, misionet e helmetave blu u pakësuan goxha.

A. Helmetat blu, në shpëtim të qytetarëve

Në vitin 1994, forcat e UNPROFOR-it në Bosnjë dhe Hercegovinë ranë pre e sulmeve të shumta serbe dhe u përfshinë në beteja dhe operacione të shumta ushtarake. Dështimi i tyre më i madh ishte mbrojtja e zonave të ashtuquajtura "të mbrojtura", të cilat sulmoheshin vazhdimisht nga serbët. Për shembull, kur NATO-ja ia ktheu me të njëjtën monedhë serbëve për bombardimet e zonës së mbrojtur Gorazhde, serbët kapën disa anëtarë të UNPROFOR dhe i përdorën si mburojë njerëzore. Zona "e mbrojtur" dhe "pa aeroplanë" në Bihaç, u sulmua nga serbët që përdorën bomba thërrmuese dhe napalmi. Dhuna e forcave serbe shkaktoi një eksod masiv. Sulme të tjera ajrore të NATO-s nuk patën rezultat pasi serbët kapën anëtarë të tjerë të UNPROFOR-it dhe bllokuan dërgesën e ndihmave humanitare. Rezultat nuk pati as edhe mbrojtja e zonës së mbrojtur të Tuzlës. Në maj të vitit 1995, pas sulmeve ajrore në Pale nga NATO-ja, serbët kapën 400 anëtarë të UNPROFOR-it në Sarajevë dhe 12 të tjerë në postin vëzhgues në Urën e Vërbanjës. Gjatës betejës vijuese, anëtarët francezë të UNPROFOR-it vranë katër serbë dhe kapën shumë të tjerë. Megjithatë, krahu serb i detyroi të kërkonin falje pasi ata kishin pengje francezë. Kritikat më të forta ndaj helmetave blu u bënë pas rënies së Srebrenicës dhe gjenocidit vijues. Në prill të vitit 1993, Kombet e Bashkuara e quajtën Srebrenicën zonë të mbrojtur. Në korrik të vitit 1995, ushtria e Republikës Serbe, nën komandën e Ratko Mlladiçit, dhe njësitë paraushtarake serbe sulmuan Srebrenicën. Batalioni holandez i UNPROFOR-it i dislokuar atje nuk mundi ta mbronte. Si rrjedhojë, 8,000 burra dhe djem boshnjakë u vranë.

→

PAQERUAJTËSIT PO VIJNË
NJË SFIDË PËR VENDIN PRITES

[…] siç kanë raportuar nga kohë mediet tona, të vetmit që do të lejohet të marrin familjet janë oficerët e lartë (bashkëshortet do të jenë në radhë të parë). Për rrjedhojë, bashkëshortja e kolonelit Uillson do të qëndrojë në Izrael deri në përfundim të mandatit të tij dhe ajo e vizitonte në Beograd. Ushtarët më të thjeshtë të UNPROFOR-it do të kenë gjashtë ditë pushim çdo muaj, të cilat mund t'i përdorin për të udhëtuar apo takuar familjet e tyre.

Disiplina do të jetë shumë e rreptë, në përputhje me rregullat e rrepta të organizatës ndërkombëtare, për të gjithë paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ekziston diçka e quajtur "politika kombëtare" që ndryshon në varësi të rastit dhe që varet nga vendi i origjinës. Kjo do të thotë se disa çështje varen thjesht nga gjykimi i komandantëve të kontingjentit kombëtar, përfshirë këtu dhe "çështjet dashurore". Disa kontingjentë kombëtarë i lejojnë ushtarët e tyre që të shoqërohen me dikë, të bien në dashuri dhe të martohen me gratë vendase. Ndërsa kontingjentë të tjerë e ndalojnë rreptësisht këtë.

Megjithatë, që të gjithë kontingjentët ndalojnë pirjen e alkoolit gjatë orarit të punës, përfshirjen në akte kontrabande, përfshirjen në tregtinë në të zezë, rishitjen e mallrave... Sidoqoftë, komunikimi me banorët vendas, njohja me ata dhe blerjet në dyqanet vendase janë mese të mirëpritura... Dihet se paqeruajtësit harxhojnë shumë, prandaj një e katërta e buxhetit të planifikuar të këtij

misioni paqeruajtës (rreth 175 milionë dollarë) është përcaktuar për rrogat e tyre. Mbështetur në përvoja të mëparshme nga misione të ngjashme, vendi pritës nxjerr fitime nga bizneset e mëdha dhe të vogla, po ashtu edhe nga konsumet e përditshme të paqeruajtësve. Sigurisht, nëse vendet pritëse dinë si të...

Oslobođenje,28.02.1992, fq..5.

III-13. Marrëveshja e Uashingtonit, 1994


Çfarë do të thotë akronimi UNPROFOR? Cili ishte qëllimi kryesor i UNPROFOR-it? Çfarë tregon ky burim për përbërjen e forcave paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara? Çfarë janë "kontingjentët kombëtarë"? Pse mund të varen rregullat e sjelljes së ushtarëve nga vendi i origjinës i secilit prej kontingjentëve individualë? Si u paraqit në gazetë, përveç misionit të tyre kryesor, pritshmëria e vendasve për paqeruajtësit??

B. Karikaturë për helmetat blu



Gazeta Oslobođenje, 28.02.1992, fq. 5..

C. "Pastrimi me themel" i Kombeve të Bashkuara



Oslobođenje, god.XLIX, br. 15683, Sarajevë, 17.02.1992, fq. 2.

Përshkruani karikaturën. Kush janë dy burrat në të majtë dhe në të djathtë të figurës kryesore? Shpjegoni pikëpamjen e autorit (mos harroni që karikatura është botuar në një gazetë boshnjake. Gjendja politike ishte e tensionuar në Bosnjën e asaj kohe, megjithatë luftë nuk kishte). Mendoni se karikaturistët kroatë apo serbë do e paraqisnin në të njëjtën mënyrë këtë çështje? Përdorni njohuritë që keni për ngjarjet për të dhënë shpjegimin.

D. Përvoja e popullit boshnjak me UNPROFOR-in (Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara) dhe me UNHCR-në (Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët)

Fillimisht, UNPROFOR-i në Bosnjë dhe Hercegovinë mbrojti aeroportin e Sarajevës dhe shoqëroi me sukses autokolonat me ndihma humanitare (ndërmjet korrikut të vitit 1992 dhe janarit të vitit 1993 pothuajse 2.500 mjete ajrore u ulën në Sarajevë dhe kishin 28 ton ndihmë humanitare me vete). Që nga viti 1993 UNPROFOR-i mbrojti zonën e mbrojtur të Srebrenicës dhe më pas edhe zona të tjera (Sarajevë, Gorazhde, Zhepa, Tuzla, Bihaç). Gjatë periudhës së fundit (nga shkurti i vitit 1994 e në vijim) UNPROFOR-i mbikëqyri armëpushimin mes kroatëve dhe boshnjakëve, gjë që solli krijimin e Federatës Myslimane Kroate. Mbikëqyri edhe disa nga pikat kufitare, që shërbenin si pika hyrëse në Federatë. Forcat e UNPROFOR-it mbikëqyrën dhe të ashtuquajturat zonat "pa aeroplanë" (Misioni "Ndalim Fluturimi"). Aeroplanët luftarakë të NATO-s, në bashkërendim me forcat tokësore të UNPROFOR-it rrëzuan disa mjete ajrore serbe.

Cila ishte përvoja juaj me UNPROFOR-in (Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara) dhe me UNHCR-në (Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët)?

- Kisha të njohur që ishin pjesë e UNPROFOR-it në malin Igman. Kam qenë në vijën e frontit me ata. Uleshim dhe pinim bashkë. Na jepnin kafe, çokollata, verë...

- Nuk kisha të njohur tek UNPROFOR-i dhe tek UNHCR-ja, por mendoj se ata nuk e kuptonin se çfarë po ndodhte, nuk e kuptonin se kush po e sulmonte dhe kush po e mbronte qytetin.

-Shisja naftë diesel në tregun e zi në bashkëpunim me UNPROFOR-in...

- Herë pas here blija ndonjë gjë nga ata, por i kishin të gjitha shumë të shtrenjta...

- Njëherë po rrija me një polak që ishte anëtar i Legjionit Francez të të Huajve. Mendoj se ishin dhe më të mjerë se ne.

- I urrej...

- Përvoja ime me UNPROFOR-in është e mirë. Le të themi që unë jam gjallë sot vetëm falë tyre, pasi im shoq dhe ime bijë punonin për ta.

- Në një rast kam parë ushtarët e UNPROFOR-it duke shpërndarë karamele dhe çokollata për fëmijët para ndërtesës së RTV-së.

- Kanë sjellë shumë herë ushqime dhe ilaçe në spital. Ishin shumë të mirë dhe të sjellshëm...

- Edhe pse nuk kisha kontakt me ta, nuk më pëlqenin...

– Këto institucione ishin të tejmbushura me armiqtë tanë, që punonin për interes të vet;

- Ishin që të gjithë hajdutë tek UNPROFOR-i dhe tek UNHCR-ja;

– Po, njihja disa ushtarë francezë nga UNPROFOR-i të cilëve iu shisja gjëra të ndryshme;

– Nuk kisha përvojë personale me ata, megjithëse shihja shpesh vajza që mblidheshin natën përpara bazës së UNPROFOR-it;

– Nuk kisha përvojë personale me ata, por vetëm me makinat e tyre që ua vidhja natën dhe iu merrja naftën diesel dhe benzinën;

Pyetësor mbijetese, Rrethimi i Sarajevës, 1992-1996. FAMA, Sarajevë 2000, fq. 834-1029.

Si ju duket sjellja e ushtarëve të "helmetave blu"? Duke marrë parasysh dok. III-8 A, B dhe C, përpiquni të përshkruani detyrën e forcave ndërkombëtare dhe rreziqet e pranisë së tyre në zona të tilla në konflikt (argumentet pro dhe kundër). Lexoni dok. III-8D në të cilin jepen ekstrakte nga përvojat personale të boshnjakëve dhe në të cilin shprehen sjellje të ndryshme.

Dislokimet e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci



Detyra e UNPROFR-it në Kroaci ishte të mbikëqyrte armëpushimin dhe zonat e çmilitarizuara të luftës (Zonat e mbrojtura nga Kombet e Bashkuara), që Kombet e Bashkuara kishin caktuar të ishin në zona me shumicë serbësh. Më pas misioni u zgjerua në të ashtuquajturat "zonat rozë", në pikat kufitare dhe në zonën e çmilitarizuar në gadishullin e vogël të Prevlakës afër Dubrovnikut. Për më tepër, mbronte urën me rëndësi strategjike në Maslenicë, që ndante Kroacinë përgjysmë dhe që mbikëqyrej nga serbët prej kodrave vendase. Kur autoritetet kroate deshën të rihapnin urën në vitin 1993, serbët e shkatërruan atë dhe për rrjedhojë misioni i UNPROFOR-it nuk pati sukses. Në vitin 1994, helmetave blu iu dha një detyrë e re në emër të Operacionit të Rikthimit të Besimit në Kroaci të Kombeve të Bashkuara (UNCRO). Detyra e tyre e re ishte të mbikëqyrnin armë-pushimin ndërmjet autoriteteve kroate dhe Republikës Serbe të Krajinës. Kësaj detyre i erdhi fundi në fillim të vitit 1996. Operacioni ushtarak kroat "Oluja" (në shqip: Stuhia) u krye gjatë gushtit të vitit 1995 dhe i kishte dhënë fund ekzistencës së Republikës Serbe të Krajinës, duke rezultuar kështu në një eksod masiv të popullsisë serbe.

Krahasojeni këtë hartë me atë që paraqet përbërjen etnike në Jugosllavi (fq.45) dhe me hartën që paraqet vendet e prekura nga lufta (fq.50)

III-9. Trupat e NATO-s në Kosovë pas Marrëveshjes së Kumanovës, 1999

Pas tre muajsh bombardimesh nga NATO-ja dhe pas sulmeve të vazhdueshme nga UÇK-ja (Ushtria Çlirimtare e Kosovës), ushtria jugosllave u detyrua të nënshkruante marrëveshjen në Kumanovë më 9 qershor të vitit 1999. Kjo marrëveshje i detyronte të tërhiqeshin nga Kosova. Po atë muaj, njësitë e NATO-s (KFOR) hynë në Kosovë dhe vazhdojnë të jenë ende aty (edhe pse numri i tyre është zvogëluar me 4,000 anëtarë). Megjithatë, pas luftës, Kombet e Bashkuara krijuan Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që kryen funksion qeverisës atje. Edhe sot atje ka një prani simbolike, megjithëse në vitin 2008 ky funksion iu hoq pasi Kosova shpalli pavarësinë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor të vitit 1999, ndërmjet Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe qeverive të Jugosllavisë dhe Serbisë.



Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Fotografi dhe Gazeta "Daily Press"

III.2.2. BISEDIMET DHE TRAKTATET E PAQES

Pas përshkallëzimit të luftës në Kroaci në verën e vitit 1991, u nënshkrua një armëpushim dhe u nis një Konferencë Paqeje për Jugosllavinë në Hagë, e udhëhequr nga Lordi Pitër Kerrington (Peter Carrington). Në takimin e parë u miratuan një deklaratë paqeje dhe bisedimesh në Jugosllavi dhe një vendim për të krijuar një komision arbitrazhi (Komisioni Badinter). Më 25 shtator të vitit 1991, kriza në Jugosllavi u diskutua për herë të parë në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe u miratua rezoluta 713. Rezoluta i kërkonte palëve që të respektonin marrëveshjen e armëpushimit dhe vendosi një embargo për armët në Jugosllavi, që më së shumti pati ndikim te myslimanët gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Më 8 dhjetor, Komisioni i Arbitrazhit i Komunitetit Evropian vlerësoi që Jugosllavia ishte në proces shpërbërjeje, me fjalë të tjera çështja nuk përfshinte ndarjen dhe si rrjedhojë, problemet e ndarjes duhej të zgjidheshin sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

U hartuan plane të shumta paqeje për Bosnjë dhe Hercegovinën. Në janar të vitit 1993, komuniteti ndërkombëtar hartoi planin e parë të paqes, të ashtuquajturin "Plani Vance-Owen" (quajtur kështu sipas emrit të negociatorit të Komunitetit Evropian, David Ouen (David Owen) dhe ndërmjetësit të Kombeve të Bashkuara, Sajrës Vans (Cyrus Vance), që parashikonte dhjetë kantone etnike gjysmë autonome dhe një kanton të ndarë për Sarajevën. Serbët boshnjakë e refuzuan planin. Plani Ouen-Stoltenberg (i quajtur kështu se mori emrin e Thorvald Stoltenberg, pasardhës i Vance) i marsit të vitit 1994, e parashikonte Bosnjë dhe Hercegovinën si një konfederatë të përbërë prej tre njësish etnike. Edhe ky plan u refuzua nga serbët boshnjakë, ndërsa myslimanët dhe kroatët krijuan Federatën Myslimane Kroate. Grupi Ndërkombëtar i Kontaktit hartoi një plan të ri paqeje. Në pranverë të vitit 1995 u zhvilluan bisedime të reja dhe me ardhjen e verës, në skenë hyri Riçard Holbruk (Richard Holbrook). Marrëveshja e Dejtonit u miratua më 21 nëntor në një bazë ushtarake në Dejton të Ohajos dhe u nënshkrua më 14 dhjetor në Pallatin e Elizes në Paris. Shërbeu dhe si baza për arritjen e një marrëveshjeje midis Tuxhmanit dhe Millosheviçit për sa i përket riintegrimit paqësor të Sllavonisë Lindore, Baranjës dhe Sremit Perëndimor në Kroaci (e ashtuquajtura marrëveshja Erdut e nëntorit të vitit 1995), që do t'i siguronte të drejtat minoritetit serb.

III-10. Komisioni Badinter, 1991

Komisioni i Arbitrazhit, ose i njohur ndryshe si, Komisioni Badinter, u krijua më 7 shtator të vitit 1991 sipas kushteve të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë. Përbëhej nga pesë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese: Roman Herzog (Republika Federale e Gjermanisë), Aldo Korasaniti (Itali), Francisko Tomas y Valiente (Spanjë), Irene Petri (Belgjikë) dhe Robert Badinter (Francë). Ky i fundit u caktua si Presidenti i Komisionit dhe komisioni mori emrin e tij, emër me të cilin njihej në dokumente dhe nga shtypi. Mendohej që komisioni do ta zgjidhte aspektin ligjor të problemeve me të cilat po përballej Konferenca gjatë punës së vet. U parashikua dhe u krijua si pjesë e procesit të bisedimeve politike ndërmjet zonave në luftë të Jugosllavisë, dhe si i tillë, Komisioni ishte një organ i ri, i pahasur më parë në praktikën politike dhe ligjore ndërkombëtare. Komisioni vendosi që RFSJ (Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë) nuk ekzistonte më, që asnjëri nga shtetet e formuar rishtazi, nuk ishin pasardhës të saj, dhe që kufijtë e republikës duhej të konsideroheshin si kufijtë e shteteve të sapoformuar, që nuk mund të ndryshoheshin duke përdorur dhunën.

DEKLARATË PËR JUGOSLLAVINË

Takim i jashtëzakonshëm ministror i bashkëpunimit politik evropian, Bruksel më 16 dhjetor të vitit 1991

Bashkësia Evropiane dhe shtete anëtare të saj, diskutuan për gjendjen në Jugosllavi për shkak të udhëzimeve për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik. Ata miratuan një qëndrim të përbashkët me qëllim njohjen e Republikave Jugosllave. Ata arritën në përfundimin e mëposhtëm:

Komuniteti evropian dhe shtetet anëtare të tij ranë dakord të njohin pavarësinë e të gjitha republikave jugosllave, pasi të përmbushin kushtet e parashtruara më poshtë. Ky vendim do të zbatohet më 15 janar të vitit 1992. Ata iu kërkojnë të gjitha Republikave Jugosllave brenda 23 dhjetorit të deklarojnë nëse: – duan të njihen si shtete të pavarura, apo; […]

– duan të pranojnë dispozitat e paraqitura në draft-Konventën, sidomos ato në kapitullin II për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grupeve kombëtare apo etnike, të cilat Konferenca po i shqyrton Konferenca për Jugosllavinë;

Aplikimet e atyre republikave jugosllave që përgjigjen pozitivisht do t'i dorëzohen Komisionit të Arbitrazhit nga Kryetari i Konferencës për të marrë ndonjë këshillë para dates së zbatimit. Ndërkohë, Komuniteti Evropian dhe shtete e tjera anëtare i bëjnë kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të arritur një armëpushim efektiv dhe për të nxitur një rezultat paqësor dhe me bisedime për konfliktin.

Gjithashtu, Komuniteti Evropian dhe shtetet anëtare të tij kërkuan nga çdo republikë jugosllave që, përpara se të merrte njohjen ndërkombëtare, të zotohej se do të miratonte garancitë kushtetuese dhe politike, që sigurojnë se ato nuk kanë asnjë pretendim territorial ndaj asnjë shteti fqinj anëtar të Komunitetit Evropian, përfshirë edhe përdorimin e emërtimeve shtetërore që nënkuptojnë pretendime territoriale.

Hamill, 2008, kontributet 143-146.

III-11. Një karikaturë për rolin e Lordit Pitër Kerrington

Lordi Pitër Kerrington ka qenë Kryetari i Konferencës së Paqes për Jugosllavinë (Konferenca e Hagës) që u hap më 7 shtator të vitit 1991 te Pallati i Paqes në Hagë dhe vazhdoi deri më 14 gusht të vitit 1992. Në tetor të vitit 1991, Kerringtoni paraqiti një Plan të Komunitetit Evropian, sipas të cilit Jugosllavia do të bëhej konfederatë e lirë, ose bashkim i pavarur republikash; do të nënshkruheshin marrëveshjet për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve etnike dhe me shumë mundësi do të jepet një status i veçantë për zona të caktuara dhe do të përjashtohej çdo mundësi për ndryshime të njëanshme të kufijve të republikës. Plani u refuzua nga Serbia dhe Mali i Zi dhe procesi i paqes u pezullua nga lufta në Bosnjë.



Deus ex machina: Lordi Pitër Kerrington dhe presidentët e gjashtë ish Republikave Jugosllave.
Oslobođenje, Sarajevë, 9.02.1992, fq. 1.

Përdorni njohuritë që keni dhe përshkruani karikaturën. Si do e përshkruanit sjelljen e karikaturistit: me shpresë, ironik, apo tallës?

III-12. "Paqja e nënshkruar nga Karaxhiçi": Artikujt e marra nga një gazetë greke për nënshkrimin e Planit Vance-Ouen në Athinë, në maj të vitit 1993

Athina konsiderohej si një territor mik për serbët, nga ku bashkësia ndërkombëtare mund të bindte Karaxhiçin të nënshkruante planin e paqes të hartuar nga ndërmjetësi i Kombeve të Bashkuara Sajrus Vance (Cyrus Vance) dhe negociatori i BE-së, Dejvid Ouen (David Owen). Nënshkrimi i marrëveshjes u prit me entuziazëm nga shtypi grek dhe u njoh si arritje e Kryeministrit grek, K. Mitsotaqis, pavarësisht vërejtjeve që kishte opozita e udhëhequr nga A. Papandreu. Megjithatë, edhe pse plani u nënshkrua nga Karaxhiçi, përsëri u refuzua nga parlamenti i Republikës Sprska dhe nga qytetarët e saj disa ditë më vonë me anë të një referendumi (96%).

A. Si u hodh hapi i parë



Ο πρόεδρος του ΠΑΣΟΚ κ. Αν. Παπανδρέου με τον ηγέτη των Σέρβων της Βοσνίας κ. Ρ. Κάραζιτς μετά τη χθεσινή τους συνάντηση στην Έκάλη.

Ανδρέας: Χρειάζονται κι άλλες προσπάθειες

Rreziku i luftës po "tërhiqet" nga Ballkani, me kushtin që pasnesër, Kuvendi i Serbisë në Bosnjë të ratifikojë Marrëveshjen për paqe në zonë, që u nënshkrua dje në Athinë nga udhëheqësi i tyre, Radovan Karaxhiçi. Ai e nënshkroi marrëveshjen vetëm pas tensionit të paduerueshëm të kërcënimit se do të bombardohej Bosnjë-Hercegovina.

B. "Prejardhja" e marrëveshjes



Ικανοποίηση για τη συμφωνία

Του ΜΑΝΟΛΗ ΚΑΨΗ

Αναβαθμισμένο το κύρος της Ελλάδας στα Βαλκάνια

Ο κ. Κων. Μητσοτάκης με τον Σέρβο ηγέτη Σλ. Μιλόσεβιτς.

Pas mbledhjeve të shumta dhe të fshehta, raportohet se z. Mitsotaqis u përpoq për herë të fundit dhe i tha Karaxhiçit si më poshtë: "Paqja është gjithmonë më e mirë se lufta. Mendoje që nëse e lë Athinën pa nënshkruar, atëherë do ketë holokaust në Bosnjë." Mitsotaqisi dhe Millosheviçi ia ofruan që të dy penën Karaxhiçit, që ta nënshkruante marrëveshjen. Më pas, Karaxhiçi iu drejtua Kryetarit të Kuvendit të Serbisë në Bosnjë dhe e pyeti: -Çfarë mendon se duhet të bëj? Akoma në zi, pasi pak kohë më parë i ishte vrarë familja gjatë bombardimeve (ende mban kravatë të zezë në shenjë zie), ai iu përgjigj: - "Bëj si të duash".

Gazeta Ethnos, 3 maj 1993, fq. 5.

III-13. Marrëveshja e Uashingtonit, 1994

Marrëveshja e Uashingtonit ishte një marrëveshje paqeje e nënshkruar ndërmjet palës kroate në luftë, e Bosnje-Hercegovinës, dhe përfaqësuesve formalë të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës. Kjo marrëveshje u nënshkrua në mars të vitit 1994 në Uashington dhe Vjenë. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryeministri i Republikës së Bosnjë dhe Hercegovinës, Haris Silajxhiç, Ministri i Jashtëm kroat, Mate Graniç dhe Presidenti i Komunitetit kroat Herceg-Bosna, Kreshmir Zubak. Kjo marrëveshje shënoi fundin e konfliktit mes kroatëve dhe boshnjakëve.

Alija Izetbegoviçi dhe Franjo Tuzhmani duke nënshkruar marrëveshjen në Uashington



https://www.flickr.com/photos/ciagov/9779477576, pare më 1.10.2016.

III-14. Plani Z4, 30 janar 1995

Plani Z4 ishte një përpjekje për arritjen e një zgjidhjeje paqësore të luftës në Kroaci, dhe u hartua nga ambasadorët e SHBA-së, BRSS-së, Kombeve të Bashkuara dhe BE-së. Mendohej që plani do t'iu siguronte serbëve autonomi të një shkalle të lartë në rajonin e Krajinës, por u refuzua nga serbët.

PJESA E PARË:: MARRËVESHJA KUSHTETUESE PËR KRAJINËN

Kapitulli I: Krijimi i Krajinës Serbe
Neni I.1 Kufijtë

1. Do të krijohet Krajina autonome serbe (më poshtë referohet si "Krajina")

2. Kurdo që Marrëveshja në fjalë të hyjë në fuqi, mundet që kufijtë e Krajinës të ndryshohen nga marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë (të reflektohet në legjislacionin përkatës) dhe Legjislaturës së Krajinës. Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes në fjalë, Komisionit të Zbatimit i jepet e drejta që t'i ndryshojë kufijtë për një sipërfaqe që nuk i kalon dy kilometra nga vendndodhja e tyre, në përputhje me Hartën 1 në Aneksin A, me kushtin që vepron në përputhje me konsensusin pasi të ketë dëgjuar fjalët e përfaqësuesve të Qeverive të Republikës Kroate dhe të Krajinës.

3. Nuk do të ketë kontrolle në pikat kufitare ndërmjet Krajinës dhe pjesëve të tjera të Republikës së Kroacisë.

[…]

Neni I.4 Gjuha

Ligjet e Krajinës garantojnë përdorimin e gjuhës serbe dhe të alfabetit cirilik, me kusht të mbrohen interesat e minoriteteve të Krajinës në përputhje me Kapitullin XI.

http://www.b92.net/specijal/oluja/index.php?start=0&nav_id=173983,pare më 29.11.2015.

Analizoni planet e ndryshme të paqes për Jugosllavinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën. Pse mendoni se kanë dështuar shumë prej këtyre planeve?

Marrëveshja e Paqes e Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën, 1995



Marrëveshja e ka ruajtur Bosnjë dhe Hercegovinën si një shtet të vetëm i përbërë nga dy pjesë, nga Federata Boshnjake Kroate, që kontrollon 51% të territorit, dhe nga Republika Serbe e Bosnjës (Republika Srpska), që kontrollon 49% të territorit, me Sarajevën si kryeqytetin e pandarë. Ndonëse tejet i decentralizuar, vendi ka një qeveri dhe bankë qendrore dhe një presidencë kolektive. Secila prej dy njësive federale, ka ligjet dhe organet e veta politike. Marrëveshja parashikon çarmatim dhe tërheqje të trupave në kazerma, dhe të drejtën e refugjatëve për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Në fakt, Bosnja dhe Hercegovina u kthyen në protektorat nën mbikëqyrjen e bashkësisë ndërkombëtare.

Pse mendoni se palëve të konfliktit iu nevojit kaq shumë kohë që të arrinin një marrëveshje paqeje? Cilat janë karakteristikat kryesore të Marrëveshjes së Dejtonit?

III-15. Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Greqisë dhe ish Republikës Jugosllavë të Maqedonisë, 1995.

Menjëherë pasi "Republika e Maqedonisë" shpalli pavarësinë nga Jugosllavia në vitin 1991, Greqia e kundërshtoi emrin "Republika e Maqedonisë". Greqia pranoi ta njihte vetëm nëse hiqte dorë nga emri "Maqedoni". Më 6 janar të vitit 1992 Parlamenti i Republikës së re miratoi dy ndryshime në Kushtetutë si mënyrë për të qetësuar sadopak Greqinë. Në një raport të botuar më 11 janar të vitit 1992, Komisioni Badinter (shikoni burimin III-10) deklaroi, që nga të gjitha ish republikat Jugosllave, vetëm Sllovenia dhe Maqedonia i plotësonin kushtet e BE-së për njohje. Megjithatë, Athina i ushtroi presion partnerëve të saj të BE-së, që të zvarriste procesin, duke pretenduar që republika e pavarur kishte ambicie për t'u zgjeruar drejt rajonit grek të quajtur Maqedoni. Shkupi e konsideroi këtë refuzim të Greqisë si një përpjekje për t'i mohuar asaj statusin ndërkombëtar si shtet. Në vitin 1993 u arrit një kompromis kur republika e pavarur u bë shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, me një klauzolë që thoshte se do quhej përkohësisht "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë". Pavarësisht kësaj mosmarrëveshja vazhdoi. Më 16 shkurt të vitit 1994, qeveria e sapozgjedhur greke e Andreas Papandreut vendosi një embargo për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kjo embargo i shkaktoi pasoja ekonomike ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, pasi deri më atëherë kishte qenë e varur në përdorimin e portit të Selanikut, dhe sepse nuk kishte rrugë të tjera tranziti. Veprimtaritë ekonomike të vendit u dëmtuan rëndë. (Shikoni tabelën në III- 15B). Politika e Andrea Papandreut shkaktoi shumë të madhe kundër Athinës, dhe pati kritika nga pjesë me ndikim të vetë shoqërisë greke. Me ndihmën e SHBA-së dhe të Kombeve të Bashkuara, në shtator të vitit 1995 dy shtetet rifilluan bisedimet dhe nënshkruan një "Marrëveshje të Përkohshme". Athina e hoqi embargon, ndërsa Shkupi hoqi "Yllin e Verginës" nga flamuri (shikoni kap. 1, I-18). E gjitha kjo solli liberalizimin e bashkëpunimit dypalësh.

A. Marrëveshja

GREQIA dhe ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Marrëveshja e Përkohshme (me letrat dhe përkthimet e Marrëveshjes së Përkohshme në gjuhët e Palëve të marrëveshjes). Nënshkruar më 13 shtator të vitit 1995 në Nju Jork.

Teksti origjinal: Anglisht.

Regjistruar nga Greqia më 12 tetor të vitit 1995.

MARRËVESHJA E PËRKOHSHME

Ministri Karolos Papulias, përfaqësues i Palës së parë dhe Ministri Stevo Crvenkovski, përfaqësues i Palës së dytë, DEKLAROJNË DH BIEN DAKORD si më poshtë:

[...]

A. MARRËDHËNIE MIQËSORE DHE MARRJE MASASH PËR RRITJEN E BESIMIT TË NDËRSJELLË

Neni 2. Palët e konfirmojnë kufirin e tyre të përbashkët si një kufi ndërkombëtar të qëndrueshëm dhe të paprekshëm.

Neni 3. Secila palë merr përsipër të respektojë sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të palës tjetër.

Asnjëra nga palët nuk mbështet veprimet e një pale të tretë, drejtuar kundër sovranitetit, integritetit territorial apo pavarësisë politike të palës tjetër.

Neni 6.1. Pala e dytë deklaron solemnisht, që asgjë në Kushtetutën e saj, dhe asgjë në veçanti te Parathënia aty, apo në Nenin 3 të Kushtetutës, mundet ose duhet të interpretohet, ose do të përbëjë bazën e ndonjë pretendimi të pales së Dytë ndaj ndonjë territori që nuk është brenda kufijve ekzistues.

Neni 7.1 Secila palë të marrë masa efektive për ndalimin e veprimtarive armiqësore apo propaganduese nga agjenci të kontrolluara nga shteti dhe për të shkurajuar vepra nga entitete private që me shumë mundësi nxisin dhunë, urrejtje apo armiqësi kundër njëri-tjetrit.

Neni 8.1 Palët të mos pengojnë lëvizjen e njerëzve, apo të mallrave ndërmjet territoreve, apo përmes territorit të secilës prej palëve.

Të dyja palët të bashkëpunojnë për lehtësimin e të tilla lëvizjeve në përputhje me të drejtën dhe normat ndërkombëtare.

2. Palët bien dakord që mund t'iu kërkohet Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të përdorin pushtetin e tyre, për të ndërmarrë masa praktike të përmendura në pikën 2 të nenit 5, për të ndihmuar palët në zbatimin e nenit 8.

http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/MK_http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/950913_Interim%20Accord%20between%20the%20Hellenic%20Republic%20and%20the%20FYROM.pdf, parë më 6.07.2016..

B. Ndikimet e embargos greke

TREGTIA NDËRMJET GREQISË DHE ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË (1993-1996)

	Eksportet greke në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Dollari amerikan)	Importe greke nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (Dollari amerikan)	Suficiti tregtar për Greqinë (Dollari amerikan)
1993	127,473	24,310	103,163
1994	12,301	4,128	8,173
1995	10,532	4,729	5,803
1996	183,589	30,991	152,598
1997	274,661	53,952	220,709

Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, citim i Kristos Nikas, "Ndikimet e Marrëveshjes së Përkohshme në marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", marrë nga Kofos dhe Vladis, 2005, fq.92.

1. Pse u nënshkrua kjo marrëveshje e përkohshme nga të dyja palët?
2. Cili ishte problemi lidhur me mosmarrëveshjen ndërmjet dy shteteve? A kishte rrezik për konflikt ushtarak? A u vunë në diskutim kufijtë ekzistues dhe nga kush? A ishte e mundur të ndërhyje në çështjet e brendshme të një shteti, dhe nëse po, si bëhej kjo?
3. Lexoni Nenin 7. Diskutoni se si propaganda e kontrolluar nga shteti, ose nga entitete private mund "të nxisë dhunë, armiqësi, apo urrejtje kundër njëri-tjetrit".

III-16. Bisedimet në Rambuje për Kosovën, 1999

Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara u përpoq që fillimisht t'i jepte fund luftës në Kosovë, duke miratuar Rezolutën 1160 në mars të vitit 1998, duke dënuar ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për përdorim të tepërt të pushtetit dhe për vendosjen e sanksioneve ekonomike dhe vendosjen e embargos për armët kundër Serbisë. Kjo u ndoq nga veprimtaritë e të ashtuquajturit "Grupi i Kontaktit" (Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia). Në mars të vitit 1999 në kështjellën e Rambuje afër Parisit, u zhvilluan bisedimet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë, me emisarë nga Shtetet e Bashkuara , Rusia dhe Bashkimi Evropian si ndërmjetës. Elementët më të diskutuar gjatë bisedimeve ishin prania e ushtrisë së NATO-së në RFJ, dhe zhvillimi i referendumit në Kosovë tre vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes.

→

Jugosllavia e refuzoi planin dhe NATO-ja e përdori këtë si arsyen e tyre për të kryer sulme ajrore në Kosovë dhe Serbi. Veprimet ushtarake të NATO-s i detyruan forcat jugosllave që të tërhiqeshin nga Kosova, dhe në krahinë u krijua një administratë e përkohshme e Kombeve të Bashkuara.

A. Marrëveshjet në Rambuje. Shtojca B: Statusi i Forcës shumëkombëshe ushtarake të zbatimit

Neni 7, Punonjësit e NATO-së janë me imunitet ndaj çdo lloj forme të arrestimit, hetimit, apo ndalimit nga autoritetet e RFJ-së. Punonjësit e NATO-së të arrestuar apo ndaluar gabimisht, iu dorëzohen menjëherë autoriteteve të NATO-së.

Neni 8, Punonjësit e NATO-së dhe automjetet, anijet, mjetet ajrore dhe pajisjet e tyre kalojnë lirisht dhe pa kufizim në të gjithë RFJ-në, përfshirë dhe në hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale të lidhura me RFJ-në. Këtu përfshihen, por nuk kufizohen, e drejta e fushimit, manovrave, e strehimit dhe e përdorimit të zonave apo ndërtesave për mbështetje, trajnim dhe operacione.

Neni 9. NATO çlirohet nga taksat, tatimet, detyrimet dhe inspektimet dhe nga rregulla doganore, përfshirë përgatitjen e inventarëve apo të dokumentacioneve të tjera doganore për punonjësit, automjetet, anijet, mjetet ajrore, pajisjet, furnizimet dhe nga dispozitat për hyrjen, daljen apo transitin në territorin e RFJ-së në mbështetje të operacionit.

http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf, parë më 14.06.2016..

B. Një artikull në të përjavshmen serbe Vreme

As serbët dhe as shqiptarët nuk nënshkruan asgjë. Krejt papritur, nuk kishte më marrëveshje për sulmet ajrore kundër Jugosllavisë dhe dislokimi i trupave të NATO-së në Kosovë u shty pa afat. Është organizuar një konferencë më 15 mars për zbatimin e marrëveshjes, që për momentin nuk ekziston...

"JO-JA" SHQIPTARE: Amerikanët nuk kishin as dyshimin më të vogël që mbledhja në Rambuje do të shkonte mirë.

Gjithçka dihej paraprakisht. Nëse serbët rezistonin, atëherë do t'i bombardonin brenda pak orësh. Shqiptarët nuk kishin arsye pse të rezistonin sepse u ishte thënë që nëse kjo i shkonte nëpër mend, atëherë SHBA-ja do t'i ndërpriste furnizimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nuk priteshin kundërshtime nga aleatët perëndimorë. Çdo gjë do të merrte fund, sidomos sulmet ajrore, po të kishte ndonjë deri më 1 mars, sepse në atë kohë Kina do të merrte kryesinë e presidencës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe Kina është kundër përdorimit të forcave të NATO-së në Kosovë. Trupat do të dislokohen për të ruajtur paqen dhe interesat perëndimore dhe kjo fitore do të kontribuojë në festimin e përvjetorit të 50-të të NATO-së në prill në Uashington.

Megjithatë, dolën disa pengesa dhe zyrtarët e SHBA-së u habitën më së shumti nga refuzimi i shqiptarëve për marrëveshjen politike, që nuk ishte e sigurt se do t'i siguronte një referendum për pavarësinë brenda tre vjetësh, kohë gjatë së cilës marrëveshja e përkohshme e parashikuar do të ishte në fuqi. Gjithashtu, përfaqësuesit e UÇK-së nuk ishin të gatshëm të çarmatoseshin, siç thuhej në shtojcën ushtarake të marrëveshjes.

Është akoma e paqartë se pse shqiptarët e Kosovës, edhe pse i kishin pranuar të gjitha këto, nuk e nënshkruan marrëveshjen e Rambuje, që mesa dihet, nuk iu kërkonte asgjë më tepër se kaq.

"JO-JA SERBE":nDelegacioni tjetër, që nuk mund të quhej as serb dhe as jugosllav, ndaj është përshkruar si "shtet", nuk donte të binte dakord për asnjë lloj pohimi të pavarësisë së Kosovës në marrëveshjen politike, dhe nuk donte as të diskutonte për shtojcën ushtarake, që parashikonte dislokimin e trupave të NATO-së.

Roksanda Ninčić, "Krah pregovora. Nemoć moćnih" [Bisedime të dështuara.Pafuqia e të Pushtetshmit], "Vreme", 436, 27 shkurt 1999.

Bisedime të dështuara. Pafuqia e të Pushtetshmit "Vreme", 436, 27.02.1999,



Bisedime të dështuara. Pafuqia e të Pushtetshmit "Vreme', 436, 27.02.1999, http://www.vreme.com/arhiva_html/436/index.html, parë më 2016.

Këtë artikull për bisedimet në Rambuje e ka botuar e përjavshmja serbe "Vreme" (Koha). Si e vlerësoni sjelljen e autorit ndaj kësaj çështjeje, a ka për qëllim të informojë apo të mbajë anë? Jepni argumente për përgjigjën tuaj.

III-17. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, 1999

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244 më 10 korrik të vitit 1999 (një ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes ushtarake dhe teknike të Kumanovës), sipas të cilës RFJ-ja (Republika Federale e Jugosllavisë) do të ruante integritetin dhe sovranitetin e saj territorial mbi Kosovën, së cilës i ishte dhënë "autonomi e gjerë" brenda RFJ-së. Kosovës iu dha statusi i protektoratit ndërkombëtar me një administratë civile të përfshirë në kontrollin ushtarak të UNMIK-ut dhe NATO-s dhe të forcave të KFOR-it. Ushtria dhe policia e RFJ-së u detyruan të tërhiqeshin. Kombet e Bashkuara ishin autorizuar të nisnin një proces politik për të përcaktuar statusin e Kosovës dhe Dukagjinit, proces që filloi më në fund në vitin 2005. Gjithashtu sipas Rezolutës, një numër i caktuar i punonjësve të sigurimit serb, do të lejoheshin të ktheheshin dhe qëndronin në "vende të trashëgimisë" serbe dhe në pikat kufitare, por kjo do lejohej vetëm me miratimin e qartë të komandantit të KFOR-it. Barazia e të drejtave të njeriut iu sigurua të gjithë banorëve të Kosovës dhe Dukagjinit, po ashtu edhe e drejta për kthim të lirë dhe të sigurt për të gjithë refugjatët dhe personat e shpërngulur.

Forcat paqeruajtëse të NATO-së në Kosovë, 1999



III.2.3. NDJEKJET PENALE, GJYKATAT, TRIBUNALET

III-18. Gjykata e Hagës për ish-Jugosllavinë

Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GJPNIJ) ka paraqitur padi kundër 161 personave të akuzuar për krime lufte: 104 serbë, 34 kroatë, 9 boshnjakë, 8 shqiptarë, 2 maqedonas dhe 2 malazezë. Etnia e dy të tjerëve ose nuk dihet, ose padia kundër tyre është tërhequr. Në mesin e të paditurve ishin dy presidentë shteti, Sllobodan Millosheviç dhe Milan Milutinoviç, zëv. kryeministri federal Nikola Shainoviç, katër shefa të Shtabit të Përgjithshëm, Dragoljub Ojdaniç, Nebojsha Pavkoviç, Momcilo Perishiç dhe Ratko Mlladiç, dhe shtatë gjeneralë.

A. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë: pjesë e procedurave

TABELA 1 (fq. 39): I përditësuar më 23/03/2015 Tribunali ka akuzuar 161 persona për shkelje të rënda të të drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish-Jugosllavisë Procedurat përfundimtare për 146 të akuzuar		
18 Të shfajësuar	Idriz Balaj, Lube Boshkoski, Ivan Cermak, Zejnil Delaliç, Ante Gotovina, Sefer Haliloviç, Ramush Haradinaj, Zoran Kupreshkiç, Mirjan Kupreshkiç, Vllatko Kupreshkiç, Fatmir Limaj, Mlladen Markaç, Milan Milutinoviç, Isak Musliu, Naser Oriç, Dragan Papiç, Momçilo Perishiç, Miroslav Radiç.	
79 Të dënuar	7 Në pritje të transferimit	Lubisha Beara, Vladimir Lazareviç, Sreten Lukiç, Radivoje Miletiç, Drago Nikoliç, Vinko Pandureviç dhe Vujadin Popoviç
	18 Të transferuar	Lubomir Borovçanin, Miroslav Bralo, Radoslav Brdanin, Vlastimir Dordeviç, Stanislav Galiç, Goran Jelisiç, Radislav Krstiç, Dragoljub Kunarac, Milan Lukiç, Sredoje Lukiç, Milan Martiç, Dragomir Milloshevіç, Mile Mërkshiç, Momir Nikoliç, Nebojsha Pavkoviç, Milomir Stakiç, Nikola Shainoviç, Dragan Zelenoviç.
	51 E kanë shlyer dënimin	Zlatko Aleksovski, Haradin Bala, Predrag Banoviç, Vidoje Blagojeviç, Tihomir Blashkiç, Lahi Brahimaj, Mario Çerkez, Ranko Çeshiç, Hazim Deliç, Damir Doshen, Drazen Erdemoviç, Anto Furundzija, Milan Gvero, Enver Hadzihasanoviç, Dragan Jokiç, Miodrag Jokiç, Drago Josipoviç, Dragan Kolundzija, Dario Kordiç, Milojica Kos, Radomir Kovaç, Momçilo Krajishnik, Milorad Krnolejac, Amir Kubura, Miroslav Kvoçka, Esad Landzo, Vinko Martinoviç,Darko Mrda, Zdravko Muciç, Mlladen Naletiliç, Dragan Nikoliç, Dragan Obrenoviç, Dragoljub Ojdaniç, Biljana Plavshiç, Dragoljub Prcaç, Mllado Radiç, Ivica Rajiç, Vladimir Shantiç, Dushko Sikirica, Blagoje Simiç, Milan Simiç, Veselin Shlivançanin, Pavle Strugar, Dushko Tadiç, Miroslav Tadiç, Johan Tarçulovski, Stevan Todoroviç, Mitar Vasiljeviç, Zoran Vukoviç, Simo Zariç, Zoran Zigiç.
	3 Kanë vdekur gjatë shlyerjes së dënimit	Milan Babiç, Rasim Deliç, Miroslav Deronjiç.
	10 Të raportuar se kanë vdekur para transferimit në Tribunal	Stipo Aliloviç, Janko Bobetko, Goran Borovnica, Simo Drljaça, Dragan Gagoviç, Janko Janjiç, Nikica Janjiç, Sllobodan Miljkoviç, Zeljko Raznatoviç, Vllajko Stojiljkoviç.
	6 Kanë vdekur pas transferimit në Tribunal	Mehmed Alagiç, Dorde Dukiç, Sllavko Dokmanoviç, Milan Kovaçeviç, Sllobodan Milloshevіç, Momir Taliç.

UNICTY,http://www.icty.org/sections/TheCases/KeyFiguresoftheCases,parë më 7.04.2015.

B. Sllobodan Millisheviçi në Gjykatën e Hagës

Gjatë luftës në Kosovë, më 27 maj të vitit 1999, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë paraqiti një padi kundër Presidentit të RFJ-së, Sllobodan Millosheviç për krime kundër njerëzimit. Një vit e gjysmë më vonë, u shtuan akuza për shkeljen e rregullave të luftës dhe të Konventave të Gjenevës, në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë dhe për gjenocid në Bosnjë-Hercegovinë. Pas dy ditësh dramatike dhe pas 7 orësh bisedimesh që ai të dorëzohej, Sllobodan Milosheviçi u arrestua në Beograd më 1 prill të vitit 2001. Ai iu dorëzua Gjykatës së Hagës më 28 qershor, në përputhje me një dekret të Qeverisë Serbe, që ishte nën drejtimin e kryeministrit Zoran Xhinxhiç. Gjykimi në Gjykatë filloi më 12 shkurt të vitit 2002 dhe Milosheviç shërbeu si avokat mbrojtës i vetes, pasi ai nuk e pranonte ligjshmërinë e juridiksionit të gjykatës. Ai u gjend i vdekur në qelinë e tij në Scheveningen më 11 Mars të vitit 2006. Autopsia nxori që ai vdiq si pasojë e një ataku kardiak.

FLETË ME TË DHËNAT E ÇËSHTJES (GJPNIJ) SË SLLOBODAN MILLOSHEVIÇIT

Akuzuar për gjenocid; bashkëfajësi në gjenocid; internim; vrasje; persekutime me bazë politike, racore apo fetare; veprime çnjerëzore, apo shpërngulje të detyruar të popullsisë; asgjësim; burgosje; torturë; vrasje me paramendim; burgim i padrejtë; shkaktimi i vuajtjeve të mëdha me qëllim; internim apo shpërngulje me detyrim; shkatërrim dhe përvetësim pronash jo për qëllime ushtarake, dhe të kryera në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa arsye; trajtim mizor; plaçkitje të pronave publike apo private; sulme ndaj civilëve; shkatërrim apo dëmtim me qëllim të monumenteve dhe institucioneve historike të arsimimit apo fesë; sulme të jashtëligjshme ndaj objekteve civile.

President i Serbisë që nga 26 dhjetori i vitit 1990; President i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) që nga 15 korriku i vitit 1997 deri më 6 tetor të vitit 2000; gjatë kohës kur ishte Presidenti i RFJ-së ishte edhe presidenti i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes të RFJ-së dhe Komandanti i Lartë i Ushtrisë Jugosllave.

– Vdiq më 11 mars 2006

– Seancat gjyqësore përfunduan më 14 mars 2006

UN ICTY, http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/cis/en.pdf, parë më 8.04.2015..

Studioni listën e njerëzve të akuzuar për krime lufte dhe masakra. Çfarë vini re? Cila ishte përsiatja për gjyqin e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë? Mendoni se kjo procedurë është e drejtë për shtetasit e ish-Jugosllavisë, apo do shkaktonte më shumë dhimbje? Cili është përfitimi për shoqëritë që vuajnë prej luftërave civile dhe cili është përfitimi nëse dënohen kriminelët e luftës? Cili është detyrimi moral i shteteve dhe shoqërive, qofshin pala fituese apo pala humbëse, kur përfundon lufta? Diskutoni për këtë çështje me argumente..


III-19. Mandate arresti për Mlladiçin dhe Karaxhiçin.

Radovan Karaxhiçi ka qenë psikiatër, themeluesi i Partisë Demokratike Serbe, në Bosnjë-Hercegovinë dhe Presidenti i Republikës Srpska nga viti 1992 deri në vitin 1996. Në korrik dhe nëntor të vitit 1995 Gjykata e Hagës paraqiti padi kundër Karaxhiçit duke e akuzuar për gjenocid dhe krime kundër njerëzimit, pas të cilave ai dha dorëheqjen dhe u largua nga jeta publike. U nxor një lajmërim ndërkombëtar ku ai "kërkohej" , dhe në nëntor të vitit 1998, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ofruan një shpërblim prej pesë milion dollarësh për personat që do jepnin ndihmën e tyre për sjelljen para gjykatës të personave të akuzuar për krime lufte. Ai u arrestua në Beograd më 21 korrik të vitit 2008 dhe iu dorëzua Gjykatës së Hagës. Pas arrestimit të tij, u zbulua se ai që nga viti 1998 kishte jetuar në Serbi me emrin Dragan David Dabiç. Radovan Karaxhiçi kishte përdorur identitetin e një njeriu që kishte vdekur në Sarajevë në vitin 1993. Ai kishte punuar si psikiatër dhe mjek popullor me këtë emër, dhe madje kishte marrë pjesë në forume dhe leksione publike.



Fotografi e faqes së internetit të Interpolit, parë më 10.01.2010..

Koloneli i përgjithshëm, Ratko Mlladiç ka qenë komandanti i Ushtrisë së Republikës Srpska (VRS) nga viti 1992 deri në vitin 1996. Pas vitit 1995, Gjykata e Hagës paraqiti disa padi kundër tij për krime lufte, përfshirë edhe gjenocidin, bashkëfajësinë në gjenocid, krimet kundër njerëzimit, vrasje, shkelje të ligjeve të luftës, internimet, pengmarrjen etj. Në nëntor të vitit 1996 Mlladiçi u hoq nga detyra e Komandantit të Shtabit Kryesor të VRS-së. Midis viteve 1996 dhe 2011 ai u largua nga jeta publike dhe u fsheh. Disa përpjekje për ta arrestuar nuk patën sukses. Të gjitha gjurmët e tij humbën zyrtarisht në vitin 2005. Ai u arrestua më 26 maj të vitit 2011 në fshatin Lazarevo afër Zrenjaninit. Rreth 10,000 nga mbështetësit e tij protestuan kundër arrestimit të tij në Beograd më 29 maj. Më 31 maj të vitit 2011 ai u transferua në burgun e Scheveningen dhe gjyqi i tij nisi më 16 maj të vitit 2012.



Agjencia e lajmeve "Reuters".

III-20. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në çështjen e Bosnjë-Hercegovinës kundër Serbisë për gjenocid

Në vitin 1993 në kulmin e luftës, Bosnjë dhe Hercegovina (BiH) akuzoi Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) për gjenocid pasi ishte përpjekur të asgjësonte popullsinë myslimane (Boshnjakët) në BiH. Më vonë padisë iu shtuan prova të tjera dhe çështja kryesore e seancës paraprake u bë gjenocidi në Srebrenicë. Në shkurt të vitit 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi që Republika Srpska kishte kryer gjenocid në Srebrenicë. Gjykata nuk e shpalli Serbinë fajtore të drejtpërdrejtë për krimet, por, megjithatë, vendosi që Serbia kishte shkelur Konventën për Gjenocidin pasi nuk e kishte ndaluar gjenocidin dhe nuk kishte plotësuar detyrimet e saj ndaj GJPNIJ-së për kapjen e kriminelëve, posaçërisht të Ratko Mlladiçit, që kishte qenë Komandanti i Ushtrisë së Republikës Srpska. Sipas statutit të Gjykatës, BiH-ja kishte të drejtë të paraqiste një kërkesë për rishikimin e vendimit gjashtë muaj pas zbulimit të fakteve të reja rreth çështjes, ose 10 vjet pas vendimit të Gjykatës.

Bosnjë dhe Hercegovina kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Zbatimi i Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit. Gjykimi i 26 Shkurtit të vitit 2007. Gjykimet [2007] ICJ 2 (26 shkurt 2007) 471. Për këto arsye, GJYKATA, […]

(2) me trembëdhjetë vota kundër dy, shpalli vendimin që, Serbia nuk ka kryer gjenocid përmes organeve apo personave lidhur me të, veprimet e të cilëve përfshijnë përgjegjësinë e saj nën të drejtën ndërkombëtare ligjore, në shkelje të detyrimeve të saj ndaj Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit; […]

(3) me trembëdhjetë vota pro dhe dy kundër, shpalli vendimin se Serbia nuk ka bërë komplot për të kryer gjenocid, as nuk ka nxitur komisionin për gjenocid, në shkelje të detyrimeve ndaj Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit;[…]

(5) me dymbëdhjetë vota pro dhe tre kundër, shpalli vendimin se Serbia e ka shkelur detyrimin për të parandaluar gjenocidin sipas konventës për

parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve të gjenocidit kundrejt gjenocidit që u krye në Srebenicë në korrik të vitit 1995. […]

(6) me dymbëdhjetë vota pro dhe tre kundër, shpalli vendimin qse Serbia nuk ka përmbushur detyrimin ndaj konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit pasi nuk e transferoi Ratko Mlladiçin, i cili ishte akuzuar për gjenocid dhe bashkëfajësi në gjenocid, për procesin gjyqësor nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, dhe si rrjedhim nuk bashkëpunoi plotësisht me Gjykatën; […]

(8) me katërmbëdhjetë vota pro dhe një kundër shpalli vendimin që Serbia duhet të marrë masa të menjëhershme dhe efektive për të siguruar respektim të plotë të detyrimeve ndaj Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit për të ndëshkuar veprat e gjenocidit siç përcaktohet në Nenin 2 të Konventës, apo vepra të tjera të ndaluara nga Neni 3 i Konventës, dhe për të transferuar personat e akuzuar për gjenocid apo për vepra të tjera në procesin gjyqësor nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, dhe për të bashkëpunuar plotësisht me Gjykatën;

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, http://www.worldlii.org/int/ cases/ICJ/2007/2.html, parë më 9.11.2015.

III-21. Vendimi kundër Komandantit Mirko Norac, Kroaci në vitin 1993

Mirko Noraci iu bashkua Forcave speciale të policisë kroate në vitin 1990. Ai shërbeu si komandant brigade gjatë mbrojtjes së Gospiçit në vitin 1991 dhe në vitin 1992. Pavarësisht akuzave për krime të kryera kundër qytetarëve serbë në Gospiç nga anëtarë të caktuar të forcave kroate nën komandën e tij, Presidenti Tuxhman nuk e zëvendësoi. Gjatë luftës ai u bë Gjeneral dhe udhëhoqi trupat e tij në operacionin "Xhepi i Medakut", kur forcat kroate ua rimorën serbëve periferinë e Gospiçit, të quajtur "Xhepi i Medakut". Noraci ka qenë një nga komandantët udhëheqës në operacionin "Stuhia", operacioni i fundit ushtarak që solli fundin e luftës në Kroaci. Në vitin 2000, presidenti Stepjan Mesiç, pasardhësi i Tuxhmanit, e detyroi Noracin të dilte në pension pasi nënshkroi "Letrën e hapur" drejtuar publikut nga dymbëdhjetë gjeneralë, që u interpretua si një përpjekje për grusht ushtarak. Noraci u arrestua në shkurt të vitit 2001, dhe në qershor të vitit 2004, u dënua me dymbëdhjetë vjet burg për krime luftë kundër qytetarëve në Gospiç (dëshmitarët deklaruan se ai kishte vrarë vetë të paktën një grua). Në vitin 2008 ai u dënua edhe shtatë vjet të tjerë burg nga Gjykata e Hagës. Ndërsa kryente dënimin e tij, atij iu dha e drejta për të dalë nga burgu gjatë fundjavës dhe në nëntor të vitit 2011 ai u lirua.

Pas një procesi gjyqësor një-vjeçar, Gjykata e Qarkut të Zagrebit mori vendimin. Në bazë të tij, Ademi u shpall i pafajshëm dhe Norac u dënua me shtatë vjet për "Xhepin e Medakut".

[…] Gjykata arriti në përfundimin se Noraci nuk e kishte urdhëruar nisjen e operacionit më 9 shtator të vitit 1993, por ai ishte përgjegjës për gjithçka kishte ndodhur pas kësaj date në sektorin 1, sepse ai ishte në dijeni të plotë se vartësit e tij po i kryenin ato krime dhe pavarësisht kësaj, ai nuk i ndaloi vjedhjet e pronave, vrasjet e qytetarëve dhe të burgosurve të luftës dhe djegien e godinave.

[…] Noraci u dënua me pesë vjet burg për dy akuza të padisë, pra me një dënim të vetëm prej shtatë vjetësh. Sipas padisë, ishin vrarë 23 qytetarë serbë dhe pesë të burgosur lufte dhe ishin shkatërruar 300 godina në zonën e Xhepit të Medakut, ndërmjet 9 dhe 17 shtatorit, kur forcat kroate u tërhoqën dhe ia "dorëzuan" zonën paqeruajtësve të Kombeve të Bashkuara. SlobodnaDalmacija,30 maj 2008.

III-22. Vladimir Trifunoviç, gjenerali që u gjykua në tre ish-Republika Jugosllave

Vladimir Trifunoviçi ka qenë Gjeneral majori i Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ). Gjatë luftës në Slloveni (një përpjekje 10 ditore ndërmjet UPJ-së dhe Forcave të policisë sllovene dhe Mbrojtjes territoriale) në fund të qershorit të viti 1991 dhe në fillim të korrikut, Trifunoviçi u bë komandant i trupave të Varazhdinit, që mbrojtën pikën kufitare të Sllovenisë dhe Austrisë. Ai i dërgoi trupat atje nën komandën e Kolonelit Berislav Popovit. Ata luftuan kundër Mbrojtjes Territoriale Sllovene, dhe njësitë e tankeve të UPJ-së qëlluan qytetarët dhe ndërtesat rezidenciale, që shkaktuan vdekjen e dy civilëve. Në vitin 2013 Popovi u dënua me 5 vjet burg (në vitin 2015, dënimi u refuzua me anë të apelimit), ndërsa Trifunoviçi u shfajësua. Edhe në Kroaci u ngritën akuza për krimet e luftës ndaj Trifunoviçit dhe Popovit, për kryerjen e krimeve kundër civilëve gjatë rrethimit të kazermave të Varazhdinit në vitin 1991. Predhat e përdorura në këtë betejë shkaktuan gjithashtu dëme në banesa. Në vitin 1993, ata u dënuan me 40 vite burgim për krime kundër popullsisë qytetare, megjithëse më vonë dënimi u ul në 15 vjet. Në Serbi u ngritën akuza kundër tyre. Trifunoviçi u akuzua për cënim të sistemit ushtarak dhe atij mbrojtës të Jugosllavisë, duke urdhëruar 280 ushtarë të UPJ-së të tërhiqeshin nga kazermat e Varazhdinit pas sulmeve të forcave të armatosura kroate. Popovi u dënua me 6 vjet burg, ndërsa Trifunoviçi, pas dy vendimeve që e shpallën atë të pafajshëm, u dënua me 11 vjet për tradhti kombëtare. Vetëm dy vjet nga dënimi i tij i kaloi në burg. Ai u shpreh: "Jam gjenerali i vetëm në

→

të gjithë Kroacinë dhe Jugosllavinë, që jam dënuar për krime lufte të cilat nuk I kam kryer". Në vitin 1996 Trifunoviçi u fal nga presidenti i atëhershëm i Serbisë, Zoran Liliç, ndërsa në vitin 2010 Gjykata e Lartë Serbe e shfajësoi nga të gjitha akuzat e padisë. Megjithatë, në Kroaci nuk u fal. Ai ndërroi jetë në vitin 2017 në dhomën e "Hotel Bristol" në Beograd, ku kishte jetuar që pas daljes nga burgu.

Rrëfimi i Gjeneral Vllado Trifunoviç

Pse nuk e shkatërrova Varazhdinin? Pse nuk e shkatërrova digën që të përmbytej i tërë qyteti? Sepse të gjithë ushtarët e mi do mbyteshin si minjtë dhe bashkë me ta edhe qytetarët e Varazhdinit. Unë nuk linda dhe mbarova shkollën për të kryer krime dhe për të vrarë njerëz. Por asokohe Serbia nuk kishte nevojë për njerëz të gjallë, por për heronj të vdekur me të cilët mund të krenohej dhe ta pasuronte historinë e saj. Nuk duhet harruar se vetëm fëmijët e të varfërve qëndruan me mua. Të gjithë fëmijët dhe ushtarët e tjerë që kishin ndonjë pronë, apo që njihnin dikë që kishte post të lartë apo lidhje të tjera u tërhoqën më herët. U larguan dhe nuk iu bashkuan ushtrisë në Varazhdin. IvaMartinović,"Trifunović:Srbijisutrebalim rtviheroji",

5.01.2010,http://www.slobodnaevropa.org/content/trifunovic_/1921871.html, parë më 14.06.2016.

Cila ishte akuza kundër Gjeneralit Vlado Trifunoviç? Si ndryshon ajo nga akuzat e mëparshme? Cilat ishin mëdyshjet e tij morale?

III-23. Serbia akuzon Kroacinë për gjenocidin gjatë operacionit "Stuhia"

Në vitin 1999, Kroacia ngriti padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) për gjenocid. Në vitin 2010, Serbia apeloi. Të dyja vendet kërkuan dëmshpërblimet e luftës. RFJ-ja u akuzua për gjenocid (siç është përcaktuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Krimet e Gjenocidit në vitin 1948) të kryer nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë mbi veprimtaritë e ushtrisë së saj, njësive paraushtarake dhe shërbimeve të inteligjencës që vepronin në territorin kroat (Knin, Sllavoni Perëndimore dhe Dalmaci), të cilat lidhen drejtpërdrejt me spastrimin etnik, gjenocidin, vrasjet, torturimin e popullsisë dhe shkatërrimin e pronave. Serbia e akuzoi Kroacinë për vepra të ngjashme, të cilat ushtria kroate i kishte kryer kundër serbëve në Gospiç, Sisak, Pakrac, Karlovac, Osijek dhe veçanërisht gjatë operacioneve ushtarake "BLJESAK" (Vetëtima) dhe "OLUJA" (Stuhia), si dhe operacioneve në "Xhepin e Medakut". Serbia e lidhi gjithashtu apelin e saj me spastrimin etnik dhe krimet e kryera nga Shteti Sovran i Kroacisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në muajin shkurt të vitit 2014, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i pushoi të dyja çështjet me arsyetimin se asnjëra palë nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme.

VENDIMI I 3 SHKURTIT 2015 PËR ZBATIMIN E KONVENTËS PËR PARANDALIMIN DHE NDËSHKIMIN E KRIMIT TË GJENOCIDIT (KROACIA k. SERBISË)
VI. SHQYRTIMI I QËNDRUESHMËRISË SË KUNDËRPADISË

444. Në fakt, Serbia i kërkoi Gjykatës të deklaronte se Kroacia kishte shkelur Konventën për Krimet e Gjenocidit, duke kryer krime ndaj grupit etnik dhe kombëtar serb që jetonte në Kroaci, gjatë dhe pas operacionit "Stuhia" në vitin 1955, akte që ndalohen nga Neni II i Konventës, qëllim i të cilave ishte shkatërrimi i grupit si i tillë, qoftë plotësisht apo pjesërisht (pika 6 e parashtresave përfundimtare).

[...]

446. Serbia pretendon se Kroacia ka kryer veprat e mëposhtme, që në Nenin II të Konventës përkufizohen si gjenocid: vrasja e anëtarëve të grupit kombëtar dhe etnik të serbëve që jetonin në Kroaci (II (a)); dëmtimi i rëndë trupor ose mendor i anëtarëve të grupit (II (b)); vënia e grupit qëllimisht në ato kushte të jetesës që duhet të sjellin zhdukjen e plotë ose të pjesshme fizike të tij (II (c)), dhe të gjitha këto vepra janë kryer me qëllimin për ta shkatërruar një grup të tillë, qoftë plotësisht apo pjesërisht.

[…]

479. Në rastin konkret, Gjykata vëren se nuk vihet në diskutim fakti që një pjesë dërrmuese e popullsisë serbe në Krajinë u arratis si pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve ushtarake të ndërmarra nga forcat kroate gjatë operacionit "Stuhia", në veçanti bombardimi i katër qyteteve të përmendura më sipër. Më tej ajo vëren se transkriptimi i takimit në Brion, për të cilin do të flitet më poshtë, e bën të qartë se autoritetet më të larta politike dhe ushtarake kroate, ishin në dijeni se operacioni "Stuhia" do të nxiste një eksod masiv të popullsisë serbe dhe, deri diku, synimi i këtij plani ushtarak ishte eksodi, të cilin jo vetëm e konsideronin të mundshëm, por edhe të dëshirueshëm.

[...]

499. Duke marrë parasysh pikat e sipërpërmendura, Gjykata është plotësisht e bindur se gjatë dhe pas operacionit "Stuhia", forcat e armatosura dhe ato të policisë kanë kryer vepra kriminale ndaj popullsisë serbe të parashtruara në nënpikat (a) dhe (b) të Nenit II të Konventës për Krimet e Gjenocidit, dhe këto vepra përbënin actus reus e gjenocidit. Gjykata duhet të përcaktojë nëse synimi i qëllimit të veçantë (dolus specialis), që karakterizon gjenocidin, është vërtetuar në rastin konkret. [...]

515. Mbështetur në pikat e mësipërme, Gjykata del në përfundimin se nuk është vërtetuar synimi idolus specialis. Për këtë arsye, Gjykata vendos që nuk është vërtetuar se gjatë operacionit "Stuhia" është kryer genocid kundër popullsisë serbe në Kroaci.

http://www.icj-cij.org/docket/files/118/18422.pdf, marrë më 14.06.2016.

III-24. Raporti i Holandës për mizoritë ndaj myslimanëve në Kravicë dhe Bratunac, 1993

"Srebrenica 'një zonë e sigurt', ishte titulli i raportit të hartuar me kërkesë të parlamentit holandez, për të vërtetuar përgjegjësitë e batalionit holandez, detyra e të cilit, në emër të OKB-së, ishte të mbronte Srebrenicën gjatë luftës në Bosnjë-Hercegovinë. Pas një sulmi nga forcat serbe të kryesuara nga gjenerali Ratko Mlladiç në korrik 1995, batalioni holandez ia dorëzoi zonën e sigurt Ushtrisë së Republikës Srpska. Pas një hetimi shtatëvjeçar, në vitin 2002 u botua një raport prej 3400 faqesh, që vërtetoi përgjegjësinë e batalionit holandez dhe të Komandës së Lartë Holandeze për mosveprimin që shkaktoi rënien e Srebrenicës. Përfundimi ishte se misioni nuk ishte planifikuar dhe kryer siç duhet dhe se batalioni holandez dhe Kombet e Bashkuara nuk e kishin kryer detyrën e tyre. Gjithashtu u paraqit një analizë e ngjarjeve që tregonin se sulmi i Ushtrisë së Republikës Srpska në Srebrenicë ishte nxitur nga krimet e kryera nga forcat boshnjake kundër qytetarëve serbë në Kravicë dhe Bratunac në vitet 1992 dhe 1993. Raporti si dhe vetë rasti i Srebrenicës bënë bujë në publikun holandez dhe, gjashtë ditë pasi u botua, kryeministri holandez dha dorëheqjen.

Në pjesën e raportit që lidhej me periudhën para prillit të vitit 1993, shfaqet vlerësimi i mëposhtëm: "Ishte e qartë që serbët do të kishin humbje edhe më të mëdha, sepse myslimanët po sulmonin shumë fshatra dhe katunde serbe. Shumë oficerë serbë humbën jetën, ose u dëmtuan rëndë gjatë luftimeve, si në Kravicë ose Konjevic Polje. Duke qenë se pjesa më e madhe e fshatrave në këtë rajon ishin etnikisht homogjene dhe të vogla, grupet e mëdha sulmuese myslimane e kishin të lehtë t'i dallonin fshatrat serbe nga ato myslimane. Nëse ishte fshat serb, sulmuesit e plaçkisnin digjnin dhe e vinin në grykë të pushkës pa marrë parasysh njerëzit. Gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1992, mësymjet drejt zonës serbe u bënë më të shpeshta e të dhunshme. […] Gjendja e furnizimit me ushqim në rrethimin e Srebrenicës po bëhej më e vështirë dhe kjo ishte një shtysë e fortë për të bastisur. Forcat myslimane kërkonin vazhdimisht mënyra për të forcuar pozicionet e tyre strategjike. Së fundi, hakmarrja luajti rolin e saj. […] Pasi kishte kaluar më shumë se një gjysmë viti mësymjesh, tridhjetë fshatra dhe shtatëdhjetë vendbanime serbe kishin rënë në duart e myslimanëve dhe kishin mbetur pa u marrë vetëm pak vende ku kishte serbë, midis të cilëve Bratunaci. Kravica ra e fundit në duart e myslimanëve, gjatë Krishtlindjes Ortodokse (7 janar1993). Gjithsej, u shkaktuan së paku një mijë viktima serbe. Si pasojë, është e kuptueshme që serbët e konsideruan situatën në Srebrenicë si luftë pushtuese nga ana e myslimanëve. […] Shumica e serbëve prisnin rastin për të marrë hak." (Raporti i Holandës, fq. 1277-1278.)[…]

Zbatimin e Konventës për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit (Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi), http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=3&case=91&p3=4,marrë më 14.06.2016.

III-25. Gjyqi serb për çështjen e Ovçarës

Pas betejës së Vukovarit, UPJ-ja dhe formacionet paraushtarake serbe morën qytetin nën kontroll. Të burgosurit i mblodhën në spitalin e qytetit dhe iu premtua largim i sigurt. E megjithatë i çuan në Ovçara, në një pronë bujqësore ku vranë më shumë se 200 civilë dhe ushtarë kroatë gjatë periudhës 18 dhe 21 nëntor 1991. Oficerët e UPJ-së, Veselin Shlevançanin dhe Mile Mërkshiç u dënuan nga Gjykata e Hagës me akuzën e dorëzimit të të burgosurve te forcat paraushtarake. Dyqind trupa u gjetën pas hapjes së një varri masiv. Një Gjykatë e Posaçme në Beograd për krimet e luftës dënoi 13 persona me 193 vite burg. Disa gjyqe janë ende duke u zhvilluar.

.

RASTET E ZGJIDHURA NË SHKALLËN E DYTË			
ÇËSHTJA	PERSONAT E DËNUAR DHE ATA TË SHFAJËSUAR	VITE NË BURG DHE VENDIMET E SHFAJËSIMIT	VIKTIMAT
Ovçara 1 (Vujoviç dhe të tjerë)	13 të dënuar 5 të shfajësuar	190 vjet burg 5 vendime shfajësimi	Minimuni 193 viktima
Ovçara 2 (Buliç)	1 i dënuar	2 vjet burg	4 viktima
Ovçara 3 (Sireta)	1 i dënuar	15 vjet burg	3 viktima
Ciriç Petar (Ovçara)	1 i dënuar	15 vjet burg	193 viktima
Vukovar (Vujanoviç) (vendim i vetëm nga Ovçara 1)	1 i dënuar (vendim i vetëm nga Ovçara 1)	9 vjet burg (vendim i vetëm për 20 vjet burg nga Ovçara 1)	4 viktima

Republika e Serbisë, ZYRA E PROKURORIT TË KRIMEVE TË LUFTËS ,http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/predmeti_eng.htm,marrë më 14.06.2016.

III-26. Krimet kundër civilëve gjatë konfliktit të viteve 2001-2002 në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

A. Çështja kundër Ministrit të Brendshëm, Lube Boshkoski në Gjykatën e Hagës

Lube Boshkoski ishte Ministri i Brendshëm i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) gjatë periudhës maj 2001 dhe nëntor 2002. Sipas aktakuzës së ndryshuar për herë të dytë, Lube Boshkoski u gjykua për veprat kriminale të vartësve të tij. Pretendohej se ai kishte ose duhet të ishte në dijeni se krimet ishin kryer nga vartësit e tij gjatë sulmit në fshatin shqiptar të Lubotenit më 12 gusht 2001, por nuk ndërmori asnjë veprim për të ndëshkuar autorët e krimit. Boshkoski ishte paditur bashkë me Johan Tarçulovskin. Ai u përball me akuzat në bazë të përgjegjësisë penale individuale për shkeljen e ligjeve dhe normave të luftës, konkretisht vrasje, shkatërrim pa shkak, shkatërrim qytetesh, qytezash ose fshatrash, dhe trajtim mizor i banorëve. Gjyqi kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit nisi më 16 prill 2007 dhe vendimet u dhanë më 6 dhe 8 maj 2008. Boshkoski u shpall i pafajshëm nga të gjitha akuzat. Më 10 korrik 2008, Dhoma Gjyqësore II e shpalli Boshkoskin po ashtu të pafajshëm nga të gjitha akuzat. Më 6 gusht 2008, Prokurori paraqiti kërkesën për apelim kundër vendimit të gjyqit të datës 10 korrik të vitit 2008. Më 19 maj Dhoma e Apelit dha vendimin e saj për Tarçulovskin dhe Boshkoskin. Dhoma e Apelit doli në përfundimin se nuk kishte prova se Boshkoski nuk i kishte marrë masat e duhura dhe të nevojshme për t'i ndëshkuar vartësit e tij që kishin shkelur ligjin. Dhoma e Apelit u shpreh se në rrethanat e rastit në fjalë, duke pasur parasysh edhe përshkrimin e ngjarjeve që përmbante akuza e parashtruar nga Ministria e Brendshme te organet gjyqësore kompetente, mbështetur edhe në një shqyrtim të arsyeshëm të fakteve, e shfajësonte Boshkoskin nga akuza se kishte dështuar të ndëshkonte ata që kishin shkelur ligjin. Dhoma e Apelit e hidhte poshtë kërkesën e Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë së Ljube Boshkoskit.

Portali i Drejtësisë së Hagës, Lube Boshkoski,http://www.haguejusticeportal.net/index.php?id=6001, marrë më 14.06.2016.

B. Ekstrakt nga raporti i Amnesty International për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë lidhur me krimet e luftës në vitin 2001

Konflikti i armatosur në Maqedoni, ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare Shqiptare (UÇK) dhe Forcave të Sigurisë së Maqedonisë, nisi në fillim të janarit të vitit 2001. Në gusht 2001, në Ohër u arrit një marrëveshje ndërmjet palëve, duke krijuar kushtet për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve etnikë. Viktimave të krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur dhe të afërmve të tyre, ende iu mohohet aksesi në drejtësi dhe një dëmshpërblim i përshtatshëm dhe i efektshëm. Njëmbëdhjetë vjet më vonë, autoritetet ende nuk janë në gjendje ta kryejnë detyrën e tyre për të nisur hetime të pavarura, të paanshme dhe të hollësishme për akuzat e zhdukjeve dhe rrëmbimeve të personave gjatë konfliktit të armatosur. Më 19 korrik 2011, parlamenti i Maqedonisë miratoi një "interpretim autentik" të Ligjit për Amnistinë të vitit 2002, që zgjeronte fushëveprimin e dispozitave të ligjit për katër çështjet e krimeve të luftës, që Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN) për ish-Jugosllavinë ia kishte kthyer Maqedonisë për ndjekje penale në vitin 2008. Kjo mbylli në mënyrë të efektshme ndjekjen penale të krimeve të luftës. Që prej vitit 2001, nuk janë ndërmarrë masat e duhura për të hetuar rastet e gjashtë shqiptarëve etnikë, që besohej se ishin viktima të zhdukjes nga policia e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë gjatë konfliktit të armatosur. Nuk janë ndërmarrë as masa të efektshme për të hetuar rrëmbimin e 12 maqedonasve etnikë dhe një qytetari bullgar. Trupat e tyre u gjetën në tre varre pranë fshatit të Nepreshtenit në Tetovë, në muajin nëntor të vitit 2001 dhe menjëherë u zhvarrosën me urdhër të Ministrisë së Brendshme dhe Zyrës së Prokurorit. Të gjithë këta persona mendohet se ishin rrëmbyer nga UÇK-ja gjatë konfliktit të armatosur. Autoritetet nuk kanë kryer hetime të mëtejshme.

"E drejta për të qenë në dijeni: Familjet në Ballkan mbeten në errësirë,", gusht 2012,http://www.refworld.org/pdfid/50474caf2.pdf, vizituar më 14.06.2016.

III-27. Apelimet e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Kosovë në Gjykatën e Hagës për krimet e kryera nga forcat e policisë serbe, 1998

DORËZIM LIGJOR PËR KRIMET E LUFTËS NË GJYKATËN E HAGËS
Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë

PËR PROKURORIN E GJYKATËS PENALE NDËRKOMBËTARE PËR KRIMET E LUFTËS PËR ISH-JUGOSLLAVINË

1. Që prej marsit të vitit 1989, kur pavarësia politike dhe kushtetuese ishin shtypur në mënyrë të dhunshme, në Kosovë u shpall gjendja e emergjencës. Disa vite më vonë kjo gjendje u hoq zyrtarisht, por në të vërtetë ekziston edhe në ditët e sotme. Deri më 31 dhjetor 1997, forcat e policisë serbe dhe jugosllave aty vranë: 171 persona, plagosën 312 të tjerë dhe torturuan fizikisht 10,000 shqiptarë të moshave dhe gjinive të ndryshme. Vrasjet, plagosjet dhe torturat fizike u kryen pa arsye, përveçse për shkak të etnisë së tyre […].

16. Në të njëjtën kohë, në rajonet e tjera të Kosovës, veçanërisht në bashkitë e Deçanit, Gjakovës, Klinës, Malishevës, etj., policia serbe ndërmori sulme të mëtejshme. Këto sulme ishin aksione të ndërmarra drejtpërdrejt nga Ushtria Jugosllave dhe shkaktuan shumë viktima të tjera. Këshilli po mbledh të dhëna lidhur me këto krime të forcave ushtarake dhe policore dhe do t'i paraqesë ato te Prokurori i Gjykatës.

17. Këshilli beson se krimet e përshkruara në këtë dokument përmbajnë të gjithë elementet e krimeve të gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit, të cituara në Nenet 4 dhe 5 të Statutit të Gjykatës. Personat e paraqitur në këtë dokument janë përgjegjës për këto krime si drejtues dhe përgjegjës duke qenë se këto krime ishin planifikuar më parë dhe ishin kryer nën urdhrat e tyre.[…].

18. Ky material mbështetet në provat nën zotërimin e Këshillit, si: dëshmitarë okularë, fotografi dhe kaseta me video të kufomave dhe shtëpive të shkatërruara, listat e viktimave, kërkesat e trupave gjyqësore serbe për të kryer veprime hetimore, etj.
Prishtinë, më 3Maj 1998

Prof. Dr. Pajazit Nushi, Presidenti i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, Dosja: Krimet e Luftës në Kosovë 1997-1999.


Pas vitit 1989, tranzicioni në vendet e Ballkanit që kishin

Pasi të lexoni me kujdes çështjet ligjoret të shteteve dhe rajoneve të ndryshme në ish-Republikën Jugosllave, përpiquni të përqendroheni te akuzat për të dalluar elementet e përbashkëta. Pse pothuajse të gjitha shtetet, apo rajonet apeluan në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës? A morën masa shtetet kundër bashkë-qytetarëve të akuzuar ose të dënuar për krime lufte? Diskutoni detyrimet morale të një shteti ligjor ndaj qytetarëve të tij dhe viktimave nga grupe të tjera etnike.

III.2.4.PROCESI I BASHKËPUNIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE (SEECP) DHE PAKTI I STABILITETIT

Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglin-dore (SEECP) u krijua pas Marrëveshjes së Dejtonit si një mënyrë për të stabilizuar rajonin. Pavarësisht se quhej "Plani Marshall i Ri", SEECP-ja nuk synohej të ishte plan për ndihmën financiare. Strategjia e SEECP-së ishte nxitja e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare lidhur me çështje të përbashkëta, si dhe lehtësimi i integrimit të tyre në strukturat euroatlantike. Erhard Busek, ish-kancelari austriak dhe kreu i Partisë Popullore Konservatore Kristiane (ÖVP), më 19 dhjetor 1996 u caktua Koordinator i SEECP-së. Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (1999-2008) u krijua pas ngjarjeve të luftës në Kosovë, nën kujdesin e Gjermanisë, meqenëse ajo kryesonte presidencën e Bashkimit Evropian në atë kohë. Pakti ishte përpjekja e parë e bashkësisë ndërkombëtare për të zëvendësuar "politikën e reagimit dhe të ndërhyrjes gjatë krizave" në Evropën Juglindore, me një strategji afatgjatë për parandalimin e konflikteve. Sinergjitë midis SEECP-së dhe Paktit të Stabilitetit u konsoliduan kur Erhard Buseku u bë Koordinator i Veçantë i Paktit të Stabilitetit (2002). Në vitin 2008, Pakti i Stabilitetit u ndoq nga një kuadër bashkëpunimi më i veçantë për rajonin, i cili ishte Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC).

Anëtarët dhe vëzhguesit e SEECP-së në vitin 2006



III-28. Fjalimi i ambasadorit Riçard Shifter, në përurimin e SEECP-së, më 5 dhjetor 1996

[…] Siç përshkruhet nga vetë emërtimi, Procesi i Bashkëpunimi të Evropës Juglindore mbështetet në bazë gjeografike. Propozon mbledhjen për diskutim dhe veprim për çështje ndërkufitare dhe mjedisore të dymbëdhjetë vendeve që kanë tipare të përbashkëta në bazë edhe të fqinjësisë së tyre gjeografike. Transporti tokësor dhe ujor, rrjetet e energjisë elektrike, sistemet e komunikimit, nevojat për ujë dhe ajër të pastër në Evropën Juglindore mund të zgjidhen në mënyrë të efektshme vetëm në bazë rajonale. Cilado qofshin historia, origjina, pikëpamjet e përbashkëta ose përkatësitë politike, është pozicioni gjeografik ai që logjikisht i bashkon vendet e rajonit, por edhe gjetja e zgjidhjeve për problemet e njëjta ekonomike dhe mjedisore me të cilat ata përballen. […]

Busek,2006,fq.28.

III.3. VENDET BALLKANIKE NË BE DHE NATO

qenë anëtare të Bllokut Lindor u krye në mënyrë paqësore dhe shumica prej tyre shprehën dëshirën për t'iu bashkuar të ashtuquajturave integrimeve euroatlantike (BE dhe NATO). Përjashtimi i vetëm ishte Jugosllavia që ishte shpërbërë gjatë luftës. Greqia ishte arena e parë e Luftës së Ftohtë në Evropë. Kur komunistët grekë u mundën në luftën civile, Greqia iu bashkua Turqisë si vendi i vetëm jokomunist në rajon. Ata hynë në NATO në vitin 1952. Pas rënies së bllokut sovjetik, në vitin 2004, Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia u bënë anëtarë të NATO-s, të ndjekur nga Shqipëria dhe Kroacia në vitin 2009. Një nga vendet e Evropës Juglindore, Mali i Zi, aktualisht është më pranë anëtarësimit.

Në vitin 1981, Greqia ishte vendi i parë në rajon që u bë anëtar i Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE). Sllovenia dhe Qiproja u bënë anëtarë të Bashkimit Evropian në vitin 2004, Bullgaria dhe Rumania në vitin 2007, ndërsa Kroacia në vitin 2013. Lidhur me kandidaturat për anëtarësimin në BE, kandidati aktual më i hershëm është Turqia, që e paraqiti aplikimin e saj te BEE-ja në vitin 1987. Megjithatë, vendet e BE-së kanë dyshimet më të mëdha për kandidaturën e Turqisë, për shkak të një sërë dallimesh të vërteta ose të hamendësuara politike, kulturore, në lidhje me të drejtat e njeriut dhe lirinë e shtypit, por duke mos harruar këtu edhe çështjen e ndërlikuar të Qipros. Gjatë negociatave me vendet ballkanike para aderimit, BE-ja përdori instrumente të ndryshme, kryesisht Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit, që kërkonin përmbushjen e kushteve të caktuara në fusha të ndryshme (legjislacion, ekonomi, të drejtat e njeriut, etj). Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte vend kandidat që prej vitit 2000, por ecuria e saj ishte bllokuar nga Greqia për shkak të mosmarrëveshjeve për emrin e vendit. Mali i Zi e firmosi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit në vitin 2007 dhe negociatat për aderim nisën në vitin 2012. Shqipëria e firmosi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit në vitin 2006 dhe i nisi negociatat për aderim në vitin 2014. Serbia e firmosi marrëveshjen e Stabilizim Asocimit në vitin 2008 (pasi Kryeprokurorja e GJPNJ-së, Karla del Ponte, dha miratimin e saj që Serbia kishte përmbushur kushtet për të bashkëpunuar me GJPNJ-në), dhe negociatat për aderim nisën në vitin 2014. Bosnjë-Hercegovinës iu deshën shtatë vjet që Marrëveshja e Stabilizim Asocimit të hynte në fuqi (u firmos në vitin 2008, u ratifikua në vitin 2010, dhe hyri në fuqi në vitin 2015), për shkak të situatës së brendshme të ndërlikuar dhe bllokimit të reformave kushtetuese. Marrëdhëniet ekonomike me BE-në qeverisen nga e ashtuquajtura Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë.

III.3.1. ADERIMI NË BE

Aderimi i vendeve të Evropës Juglindore në BE





Turqisë::http://citizensmedia.eu/dialogue/tr-eu/, vizituar më 14.07.2016.

III-29. Samiti i Helsinkit, 1999. Turqia si vend kandidat në BE

Në dhjetor të vitit 1999, Këshilli i Evropës në Helsinki vërejti "me kënaqësi punën e pavarur dhe ecurinë" e arritur gjatë negociatave për aderim me Qipron, Hungarinë, Poloninë, Estoninë, Republikën Çeke, dhe Sllovenine. Këshilli gjithashtu vendosi të niste negociatat në shkurt të vitit 2000 me Rumaninë, Sllovakinë, Letoninë, Lituaninë, Bullgarinë dhe Maltën për hyrjen e tyre në BE. Krahas kësaj ai mirëpriti "zhvillimet e fundit pozitive në Turqi, [dhe] qëllimet e saj për të vazhduar reformat për të përmbushur kriteret e Kopenhagës", duke e njohur kështu zyrtarisht vendin si kandidat për anëtarësim të plotë. Marëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe institucioneve evropiane kanë një histori të gjatë: në vitin 1959, pra vetëm një vit pas themelimit të BEE-së, Turqia paraqiti një aplikim për t'u anëtarësuar. Ky status u arrit në vitin 1963 nëpërmjet të ashtuquajturës Marrëveshja e Ankarasë. Në vitin 1997, u tërhoq statusi i kandidatit për shkak të shkeljeve të të drejtave të njeriut, por u rikthye dy vjet më vonë në Samitin e Helsinkit. Negociatat nisën më 3 tetor 2005. Megjithatë, marrëveshja për anëtarësimin e Turqisë vazhdon të jetë çështje e diskutueshme për procesin e zgjerimit të BE-së.

III-30. Pretendimi turk ndaj Qipros, 29 korrik

Në Samitin e BE-së në Bruksel në dhjetor të vitit 2004, të gjithë shtetet anëtare të BE-së ranë dakord për nisjen e bisedimeve formale me Turqinë për aderim.

Për këtë qëllim, Turqia duhej të ndryshonte Traktatin e Ankarasë të vitit 1963 dhe Traktatin e Bashkimit Doganor të vitit 1995 për të përfshirë 10 anëtarët e rinj të Bashkimit Evropian që kishin aderuar më 1 maj 2004. Pas dështimit të planit Annan në referendumin që u mbajt në ishull në prill 2004, Republika e Qipros u bë vend anëtar i BE-së, por ishulli vazhdonte të mbetej i ndarë. Për këtë arsye, më 29 korrik 2005, Turqia firmosi protokollin shtesë për ndryshimin e Traktatit të Ankarasë dhe bashkimin e doganave, por njëkohësisht Asambleja Kombëtare e Përgjithshme e Turqisë (AKPT) paraqiti një deklaratë ku thuhej se për aq kohë sa çështja e Qipros mbetej pa zgjidhje, Turqia nuk do ta njihte qeverinë e Republikës së Qipros, që ishte njohur ndërkombëtarisht, si përfaqësuesja e vetme dhe e ligjshme e Qipros. Në përgjigje të kësaj deklarate, BE-ja nxori një deklaratë më 21 shtator të vitit 2005, ku dënohej mosnjohja e Republikës së Qipros nga Turqia dhe kërkohej zbatimi i plotë dhe joekskluziv i protokollit shtesë. Qeveria turke nuk e paraqiti protokollin shtesë për ratifikimin në Asamble, por nxori Dekretin e Kabinetit nr. 2006/10895 që hapi portet dhe aeroportet turke për të gjitha vendet anëtare të BE-së përveç Republikës së Qipros.

Deklarata e Turqisë për Qipron, 29 korrik 2005

1) Turqia vazhdon të jetë e vendosur për të gjetur një zgjidhje politike për problemin e Qipros dhe ka shprehur qartë qëndrimin e saj për këtë qëllim. Turqia do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të arritur një gjendje partneriteti të ri dypalësh në Qipro. Një zgjidhje e drejtë dhe e gjatë do të kontribuonte në marrëdhëniet paqësore, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në rajon.

2) Republika e Qipros siç tregohet në protokollin shtesë, nuk është shteti i mbështetur mbi partneritetin, ashtu siç parashikohej me themelimin e tij në vitin 1960.

3) Për këtë arsye, Turqia do të vazhdojë të sillet me autoritetet qipriote greke njësoj si më parë, meqenëse ato kanë autoritet dhe pushtet vetëm në territorin në jug të kufirit të gjelbër dhe nuk e përfaqësojnë popullin qipriot turk.

4) Turqia deklaron se firma e këtij Protokolli nuk tregon njohjen e Republikës së Qipros dhe nuk i shkel të drejtat dhe detyrimet e Turqisë që burojnë nga Traktatet e Garancisë, Aleancës dhe Themelimit në vitin 1960.

5) Turqia konfirmon se firma e saj në Protokollin e sipërpërmendur nuk i ndryshon marrëdhëniet e saj me Republikën Turke të Qipros Veriore.

6) Derisa të gjendet një zgjidhje gjithëpërfshirëse, Turqia nuk do t'i ndryshojë politikat e saj ndaj Qipros. Turqia e deklaron gatishmërinë e saj për të vendosur lidhje nëpërmjet një gjendjeje të re partneriteti në Qipro, që do të vijë si rrjedhojë e zgjidhjes gjithëpërfshirëse.

Bajkal,2013,fq.361-362.

III-31.Festimet në Gorizia/Nova Goricë më 30 prill 2004, për aderimin në BE



Fotografi Borut Krajnc, Arkivi i gazetës Mladina [Rinia].

Festimet e zgjerimit të BE-së dhe mikpritja e dhjetë anëtarëve të rinj u zhvillua në Gorizia/ Nova Goricë, një qytet që iu përkiste dy vendeve, Italisë dhe Sllovenisë. Gorizia ishte bërë pjesë e Italisë më 10 shkurt 1947, në përputhje me Traktatin e Paqes në Paris ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë. Ideja për ndërtimin e një qyteti të ri, lindi fill pas caktimit të kufijve dhe gjithashtu u mbështet nga KPPKJ-ja (Komiteti i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Jugosllavisë). Qyteti i ri u ndërtua përgjatë kufirit të Gorizias italiane në terren kënetor dhe emri Nova Goricë iu vendos në vitin 1949. Festimet e vitit 2004 përcollën mesazhin se në Evropë nuk do të ekzistojnë më kufij.

III-32. Mbështetja në Serbi për aderimin në BE 2003-2008

Data	Pyetja	Po
Dhjetor 2003	T'i bashkohemi BE-së?	72%
Shtator 2004	T'i bashkohemi	71%
2005	T'i bashkohemi	64%
2006	T'i bashkohemi	61%
Dhjetor 2008	T'i bashkohemi	61%

Integrimi i Serbisë në BE i mbështetur nga 51% e qytetarëve, http:// www.seio.gov.rs/news.101.html?newsid=1121; Lidija Valtner, Nikada manja podrška ulasku Srbije u EU, http://www.danas.rs/danasrs/politika/nikada_manja_podrska_ ulasku_srbije_u_eu.56.html?news_id=254980; Galup: Opada poverenje građana u EU, Tanjug | 25. 11. 2010, http://www.blic.rs/Vesti/Politika/219802/Galup-Opada-poverenje-gradjana-u-EU, vizituar më 13.07.2016.

III-33. Aderimi i Qipros në Bashkimin Evropian, pati një ndikim të menjëhershëm. Produktet evropiane me çmim të ulët nisën të qarkullonin në tregun qipriot

Aderimi i Qipros në Bashkimin Evropian në vitin 2004 dhe heqja e detyrimeve doganore nisi të kishte ndikim në ekonominë qipriote. Qiproja kishte hyrë në tregun evropian.

Produkte të lira evropiane që mbizotërojnë në treg		
Uiski	më të lira	£6.00
Fruta	më të lira	£1.00
Djathë	më të lira	£1.00
Mish	më të lira	50 cents
Ushqim për	më të lira	40 cents
Pije të lehta	më të lira	15 cents

Gazeta Φιλελεύθερος [Phileleftheros], 7 maj 2004.

III-34.Shqipëria dhe BE-ja: një vlerësim i Komisionit Evropian, mars 2008

Gjatë periudhës 1991-1999 Shqipërisë iu dhanë grante prej miliarda eurosh nga buxheti i Bashkimit Evropian. Kjo ishte një nga shumat më të larta të ndihmës për sa i përket PBB-së shqiptare dhe përfshinte 256 milionë euro për ndihmë humanitare. Në qershor të vitit 2006, Shqipëria firmosi Marrëveshjen e Stabilizimin Asocimit me BE-në, si hap i parë për t'u bërë kandidate për anëtarësim. Në një dokument të publikuar në mars 2008 nga Komisioni Evropian vërehej ecuria e bërë nga Shqipëria.

Shqipëria vazhdon të ecë përpara me reformat dhe përafrimin me standardet e BE-së. Ajo po zbaton Marrëveshjen e Përkohshme nën MSA dhe po ndërmerr hapa të mirë.

Shqipëria ka mbajtur një pozicion të ekuilibruar në lidhje me çështjen e Kosovës dhe në këtë mënyrë ka dhënë ndihmesën në stabilitetin e rajonit.

Drejtuesit politikë në Shqipëri janë zotuar se do të angazhohen në marrëdhënie konstruktive për kryerjen e reformave kyçe. Reforma zgjedhore, veçanërisht për sa i përket zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, fuqizimit të ligjit, reformave të sistemit gjyqësor dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë kryesore. Një marrëdhënie e përmirësuar në Parlament do të kontribuojë në ecurinë për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Komunikatë për Ballkanin Perëndimor: fuqizimi i pikëpamjes evropiane, http://europa.eu/rapid/press-release_IP-08-378_en.htm?locale=en, vizituar më 29.09.2016.

Përdorni burimet në këtë pjesë për të hetuar lidhur me qëndrimet e ndryshme ndaj BE-së midis vendeve të Evropës Juglindore. Gjeni ngjashmëritë dhe dallimet, hetoni prirjet dhe proceset. Shkruani një ese mbështetur në gjetjet tuaja.

III.3.2. INTEGRIMI NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTKUT VERIOR NATO

Vendet e Evropës Juglindore që u bënë anëtare të NATO-s

Bullgaria	29 mars 2004	Zgjerimi i 5
Rumania	29 mars 2004	Zgjerimi i 5
Sllovenia	29 mars 2004	Zgjerimi i 5
Shqipëria	1 prill 2009	Zgjerimi i 6
Kroacia	1 prill 2009	Zgjerimi i 6
Mali i Zi	5 qershor 2017	Zgjerimi i 7

III-35. Referendum në Sllloveni për integrimin në NATO



Pas pavarësisë, Sllovenia nisi të angazhohej në organizata ndërkombëtare. Në nëntor 2012, ajo mori ftesën për t'u bërë pjesë e NATO-s, bashkë me gjashtë shtete anëtarë të tjerë të rinj: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania dhe Sllovakia. Në mars 2003, Sllovenia zhvilloi një referendum të dyfishtë për hyrjen në BE dhe NATO. Hyrja në BE u mbështet nga 89.64% e votuesve, ndërsa hyrja në NATO u mbështet vetëm nga 66.08%. Në karikaturë shfaqet një Slloveni "shtatëzanë" (me pak fjalë, në nxitim) veshur në kostumin kombëtar, jashtëzakonisht e emocionuar (PO!) që po martohej me NATO-n. Në mars 2003, ushtarët sllovenë iu bashkuan misionit paqeruajtës "Forca e Ndihmës Ndërkombëtare për Sigurinë" (FNNS) në Afganistan. Para referendumit, përkrahësit e NATO-s shfaqën sloganin: "Me shtëpi në Evropë, të sigurt në NATO".

Përshkruajeni karikaturën.
Pse përfaqësohet Sllovenia si nuse shtatzënë? A mund të dalloni ndonjë stereotip? Çfarë nënkupton kjo për marrë-dhënien për të cilën do të zotohet? Diskutoni.

III-36. Vizita e Presidentit të SHBA-së, Xhorxh W. Bush në Shqipëri, 2007



Fotograf Roland Tasho.

Presidenti Xhorxh W. Bush e vizitoi Shqipërinë më 10 qershor të vitit 2007. Bushi ishte i pari president i SHBA-së që vizitonte Shqipërinë dhe ngjarja u konsiderua nga autoritetet shqiptare si "një vizitë historike e një miku të madh". Shqiptarët i konsiderojnë Shtetet e Bashkuara si "aleatin e tyre historik", duke iu referuar kryesisht mbështetjes së SHBA-së për Shqipërinë kur ajo sapo e kishte fituar pavarësinë pas Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, marrëdhëniet midis dy vendeve u ftohën kur komunistët ishin në pushtet në Shqipëri (1944-1990). Regjimi komunist i atëhershëm në Shqipëri e konsideronte "imperializmin amerikan një kërcënim të madh ndaj lirisë së kombeve", dhe në vitin 1946 i ndërpreu plotësisht marrëdhëniet diplomatike me SHBA-në. Marrëdhëniet midis dy vendeve u rivendosën në mars të vitit 1991 dhe që nga ajo kohë SHBA-ja ka luajtur një rol parësor me ndikimin e saj në politikat e brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë dhe veçanërisht për integrimin Euroatlantik të vendit. Në këtë kontekst, vizita e Presidentit të SHBA-së, Bush në Shqipëri në qershor →

2007, shërbeu për të mbështetur më tej reformat e qeverisë shqiptare në sektorin e mbrojtjes, duke synuar aderimin në NATO. Shqipëria u bë zyrtarisht anëtare e NATO-s gjatë Samitit të NATO-s në Bukuresht në prill. Në këtë fotografi shfaqet presidenti amerikan Xhorxh Bush dhe presidenti shqiptar Alfred Moisiu në Tiranë më 10 qershor 2007. Zoti Alfred Moisiu u zgjodh President i shtetit shqiptar në vitin 2002 dhe qëndroi në këtë detyrë deri në fund të mandatit të tij në vitin 2007.

III.4.TRANZICIONET DHE TRADITAT POLITIKE

III-37. Konfliktet midis rumunëve dhe hungarezëve në qytetin e Tergu-Mureshit (kryesisht i populluar nga hungarezë etnikë), 19-20 mars 1990

Shqetësimet në Tergu-Muresh, në mars të vitit 1990, u ndoqën nga disa kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve etnikë hungarezë të Rumanisë; që përqendroheshin veçanërisht në nevojën për institucione arsimore në gjuhën e tyre amtare, që pothuajse ishte braktisur gjatë viteve të fundit të regjimit të N. Çausheskut. Megjithatë, kërkesa bazë e bashkësisë hungareze ishte kthimi i tyre në një formë autonomie politike të ngjashme me atë që kishte gëzuar gjatë regjimit komunist, në periudhën 1952-1968, kur ekzistonte një njësi administrative, me një shumicë hungareze, që ishte "Rajoni autonom i Murshit". Një kërkesë e tillë shihej si kërcënim për unitetin e shtetit rumun, sidomos në kontekstin e tensionit shtetëror dhe shpërbërjeve që erdhën pas rënies së regjimeve komuniste (si në Bashkimin Sovjetik Shumica rumune u habit nga kërkesat ngulmuese të hungarezëve dhe drejtuesit e institucioneve vendore dhe qendrore nuk qenë në gjendje të gjenin zgjidhje politike të kënaqshme. Ngjarjet u zhvilluan në kuadrin e organizimit të zgjedhjeve të para legjislative të lira hungareze dhe çoi drejt rritjes së tensionit në marrëdhëniet midis Rumanisë dhe Hungarisë, që ishte rritur gjatë viteve të fundit. Reagimi i shtetit rumun ishte një ndërhyrje e dhunshme ushtarake, që shkaktoi një duzinë viktimash. Karakteristikat e kësaj periudhe ishin mobilizimi i disa grupeve qytetarësh rumunë dhe apelimi për përdorimin e dhunës. Rezultati i menjëhershëm i këtyre ngjarjeve ishte zhgënjimi i popullsisë hungareze që solli shpërnguljen e tyre nga Rumania kryesisht drejt Hungarisë.

A. Ngjarjet e 19 marsit 1990: ekstrakt nga një kronikë hungareze

Më 19 mars 1990, rreth mesditës, dy ose tre autobusë dhe dy kamionë të mëdhenj, i transportuan banorët rumunë nga fshati në Maroshvasarsheli, vendosjet e Gorgenihodak dhe komunës së Marosorozit. Ata ishin armatosur me mjete për të goditur dhe prerë. Automjetet u parkuan në sheshin kryesor, ngjitur me statujën e Ushtarit Heroik Rumun dhe pasagjerët e tyre zbritën dhe iu bashkuan turmës rumune që tashmë ishte mbledhur në shesh. Nga selia e Vatra Romaneasca, disa metra më tutje, atyre iu bashkuan 50-60 persona dhe e drejtuan turmën drejt rrugës "Bujaj". Gjatë rrugës demonstruesit shkatërruan tabela me shkrime në hungarisht dhe shanë njerëzit me kombësi hungareze.

Rreth orës 4 pasdite, turma e rrethoi godinën që ishte selia e partive politike [...] dhe nisi rrethimin, duke u përpjekur të hynin me sëpata dhe duke i gjuajtur dritaret me gurë. Njerëzit që ishin brenda u përpoqën t'i ndalonin dhe për këtë arsye nisi përleshja në hyrjen e godinës, dhe më pas edhe brenda saj. Kjo përplasje shkaktoi lëndimin e demonstruesve dhe hungarezëve.[...]

Márton dhe Zoltán,2012,fq.327-328.

Vatra Romaneasca (Bashkimi Rumun "Vatra") ishte një organizatë e themeluar me qëllimin për të kundërshtuar BHDR-në (Bashkimin e hungarezëve demokratë nga Rumania). Themeluesit e saj ishin anëtarë të elitës vendase rumune (oficerë ushtarakë, gjykatës, intelektualë, ish-zyrtarë partie, etj.), që mendonin se pozicionet e tyre politike dhe ekonomike po rrezikoheshin gjatë tranzicionit pas rënies së regjimit të Çausheskut. Ligjërata e tyre ishte nacionaliste, kryesisht e orientuar ndaj "kërcënimit" hungarez.

B. Ngjarjet e 19 marsit 1990: një pikëpamje rumune

[…] Me rastin e përvjetorit të 143 të revolucionit të vitit 1848 në Budapest, autoritetet e Republikës së Hungarisë iu kërkuan homologëve të tyre rumunë leje që ambasadori hungarez në Bukuresht dhe zëvendësi i tij të vendosnin kurora në Mirkuja Çuk, Kristuju Sekujes, Tergu-Muresh dhe Albeshti, pranë statujave të Nikollai Bojaçeskut dhe Sandor Petëfit, të cilët kishin luajtur rol të rëndësishëm në ngjarjet që po festoheshin. Autoritetet rumune i siguruan kushtet e nevojshme për plotësimin e kësaj kërkese.[…]

Gjatë ditëve në vazhdim, në qytetin e Tergu-Muresh, u rrit tensioni dhe pati raste dhune, që u shkaktuan nga sjellje dhe veprime nacionaliste, shoviniste dhe revizioniste që shënjestroi Rumaninë.

Qeveria rumune ndërmori masat e nevojshme për të rikthyer qetësinë dhe rendin publik në mbarë zonën. Fatkeqësisht, zbatimi i këtyre masave u pengua nga veprimet e zyrtarëve të Republikës Hungareze. Kjo kulmoi më 18 mars 1990 me një apel nga Presidenti i përkohshëm Matias Szürosh, i cili iu drejtua hungarezëve në Rumani nëpërmjet thirrjes në shtyp që t'i forconin veprimtaritë e tyre dhe të organizoheshin rreth idesë që Transilvania do të ishte "tokë e lashtë hungareze"[...].

Për këtë arsye, në mbrëmjen e 19 marsit, një sërë përleshjesh të dhunshme ndodhën në Tergu-Muresh, që shkaktuan lëndime të qytetarëve rumunë dhe hungarezë, duke përfshirë një figurë të shquar kulturore, shkrimtarin Andras Süto. […] Në mëngjesin e 20 marsit, u zhvilluan përplasje të tjera që shkaktuan edhe më tepër viktima nga radhët e të dyja palëve.

Si nisi kjo gjë? […] Së pari, hungarezët u izoluan nga rumunët. Nëse deri në atë kohë kishin jetuar në harmoni, ose të paktën kështu dukej, kishte ardhur çasti që të bëheshin armiq. Fillimisht shkollat. Shkollat e ndara. Shkolla e mesme "Bolyai". Më pas fakultetet. Studentët hungarezë nuk donin të studionin më së bashku me studentët rumunë. […] Një nga shenjat në hyrje të qytetit u ndryshua. Në vend të tabelës ku shkruhej Tergu-Mureshi ishte shkruar Marosvashaheli. Punonjësit e Azomuresh e vunë sërish tabelën e parë. E njëjta gjë u përsërit edhe ditën tjetër. Dhe ditën tjetër. […] Më pas nisi mungesa e informacioneve të vërteta dhe të plota, si dhe nxitja e armiqësisë nga hiçi. Nga kush? Nuk e dimë? Përse? Është e qartë. Ditën e hënë, më 19 mars, kur shumica e banorëve të qytetit ishin ndarë në dy kampe. Dita e viktimave. Të njëjtat ngjarje pasuan edhe ditët në vazhdim.[...]

Românialiberă,XLVIII/76,22Mars 1990,fq.1,3.

III-38 "Zhivkov vdiq, ndryshime në vlerën e parasë": ligjërimi i ri i medias pas vitit 1989

Shteti socialist kishte pushtet të plotë mbi median, duke përfshirë shkrimet dhe përmbajtjen e gazetave më të lexuara, që ndiqnin rreptësisht linjën politike të Partisë dhe direktivat e ideologjisë zyrtare komuniste. Kjo situatë ndryshoi rrënjësisht me rënien e regjimit komunist në vitin 1989. Dolën shumë gazeta dhe revista të reja, por edhe private, dhe ato nuk i ndiqnin më standardet e mëparshme politike, por përshtateshin me kërkesat e tregut dhe pritshmëritë e reja të lexuesve për lajme të ndryshme, emocionuese dhe argëtuese. Shembulli u vendos nga gazeta "24 hours", që e përshkruante veten si "një gazetë që i thoshte gjërat troç", duke ndërthurur gazetarinë serioze me histori tabloide dhe tronditësse. Kryeartikujt në faqen e parë ishin dhe vazhdojnë të jenë agresivë, skandalozë dhe provokues. Ata lidhin në mënyrë të habitshme ngjarjet e një karakteri krejtësisht të ndryshëm, politik, ekonomik, kulturor, dhe e ekuilibrojnë kufirin ndërmjet seriozes dhe skandalozes. Për këtë arsye, gjatë verës së vitit 1998 lajmi për vdekjen e Todor Zhivkovit, ish-udhëheqësi komunist për një kohë të gjatë i Bullgarisë, u paraqit në të njëjtin kryeartikull me Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Bankës Kombëtare Bullgare për ta stabilizuar levin bullgar me markën gjermane.


24 часа

Живков умря, сменят парите

1 юли 1999: 1 лев = 1 марка

Днес 8 специални страници

„Първият"

Faqja e parë, e 24 orë: "Zhivkov vdiq, ndryshim në vlerës e parasë", 211, 7 gusht 1998..

III-39. Alarm! Alarm!: artikull në një nga gazetat e para nacionaliste (''Zora'', 17 korrik 1990)

''Zora'' (Agimi) ishte gazeta e Partisë Demokratike Kombëtare Bullgare (PDKB), një parti politike relativisht anësore në fillimet e tranzicionit demokratik, e cila e kundërshtoi haptazi Lëvizjen për të Drejtat dhe Liritë (LDL). Suksesi zgjedhor i LDL-së tërboi partitë nacionaliste asokohe dhe shkaktoi një sërë protestash fill pas seancave të para të Asamblesë së Madhe Kombëtare, me sloganët: "Asnjë turk në Parlament!" dhe "Parlamenti duhet të jetë bullgar!" ''Zora'' botoi një sërë informacionesh dhe artikujsh duke paralajmëruar për rrezikun e "asimilimit turk" të bullgarëve në bashkësitë e përziera.

Alarm! Alarm!

Java e kaluar na shfaqi një rrjedhë të rrezikshme të ngjarjeve, për të cilat PDKB-ja dhe ''Zora'' na kanë paralajmëruar vazhdimisht, duke zbuluar rolin panturk dhe çekuilibrues të të ashtuquajturës Lëvizja për të Drejta dhe Liri, e cila në thelb është shtylla e pestë e Turqisë në Bullgari. Faktet janë jashtëzakonisht alarmuese. Në disa fshatra në zonat e Razgradit, Kardzhalit dhe Dzhebelit, ata pak bullgarë që ende jetojnë atje, kanë marrë ultimatume për t'u larguar, të shoqëruar me kërcënime dhe dhunë fizike. Njëkohësisht, emisarët dhe komandantët gjysmëligjorë të Doganovit e bllokuan plotësisht fshatin Rodopian të Pripekut ku jetojnë bullgarët myslimanë, gjuha mëmë e të cilëve është bullgarishtja. Për të protestuar, këta të fundit njoftuan që do të bënin me radhë grevë urie dhe apeluan në Asamblenë e Madhe Kombëtare për mbrojtje nga vizionet asimiluese të atyre që po "turqizoheshin". Partia Demokratike Kombëtare Bullgare shprehu mbështetjen e saj të plotë për atdhetarët nga Pripeku dhe i informoi që do të bënte çdo gjë të mundur që lejohej nga Kushtetuta dhe ligji për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

3opa[Zora],Nr.7, 17 korrik 1990.

III-40. Zhelyu Zhelev, presidenti i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike në Bullgari

Zhelyu Mitev Zhelev (3 mars 1935 – 30 janar 2015), një disident, themelues dhe drejtues i njohur bullgar i Bashkimit të Forcave Demokratike (BFD), ishte presidenti i parë i zgjedhur në mënyrë, demokratike, gjatë periudhës 1990- 1997. Përpjekja e tij e parë për të mbrojtur një tezë doktorature nuk rezultoi e suksesshme, sepse ai u akuzua se po mbështeste pikëpamje antimarksiste. Ai u përjashtua nga Partia Komuniste Bullgare për të njëjtat arsye në vitin 1965 mbeti pa punë për arsye ideologjike dhe politike deri në vitin 1972. Në vitin 1974 ai ia doli mbanë në mbrojtjen e doktoraturës dhe u caktua kandidat profesor në Institutin e Kulturës. Libri i tij studimor "Fashizmi", u botua në vitin 1982 dhe u bë i njohur për analogjitë e qarta që hiqte midis regjimit nazist dhe atij komunist. Megjithëse libri u ndalua dhe u hoq nga libraritë dhe bibliotekat vetëm tre javë pas botimit, ai u përkthye në dhjetë gjuhë. Në vitin 1980 ai bashkëthemeloi Klubin për mbështetjen e Glasnotit dhe Perestrojkës, një nga organizatat e para disidente në Bullgari. Pas 10 nëntorit 1989, ai i hyri rrugës së politikës dhe u bë anëtar themelues i koalicionit Bashkimi i Forcave Demokratike, formacioni i parë politik bullgar që e identifikoi veten si opozitë antikomuniste asokohe. Në qershor të vitit 1990 Zhelevi fitoi një mandat në Asamblenë e Shtatë të Madhe Kombëtare (AMK). Më 1 gusht 1990 AMK-ja e zgjodhi president të Republikës së Bullgarisë, dhe në janar 1992 ai u bë presidenti i parë në historinë e Bullgarisë që u zgjodh drejtpërdrejt nga populli. Zhvillimet pasardhëse sollën përçarje dhe copëzim të formacioneve politike të djathta, dhe për këtë arsye ballafaqimin ndërmjet partive dhe grupeve të ndryshme brenda BFD-së. Deri në fund të karrierës së tij aktive politike, Zhelyu Zhelevi mbeti pjesë e kësaj prirjeje, ishte i lidhur me të moderuarit dhe ndonjëherë me vijën konformiste drejt përfaqësimit politik të ish-partisë komuniste. Pas mbarimit të mandatit të tij si president që përfundoi në janar 1997, ai themeloi Fondacionin Dr. Zhelyu Zhelev, që kërkonte të ushqente frymën demokratike te të rinjtë.



http://25freebg.com/2015/video-jelio-jelev-na-miting-na-sds-ot-1990-godina/,marrë më 14.06.2016.

III-41.Tranzicioni pa ndryshimin e pushtetit në Mal të Zi: Milo Dukanoviç

Milo Dukanoviç ka karrierën më të gjatë nga të gjithë shtetarët në ish-Jugosllavinë. Në moshën 17-vjeçare, ai u bë anëtar i Lidhjes së Komunistëve dhe i ngjiti shpejt shkallët e karrierës së partisë, sidomos pas kontributit të tij në rrëzimin e autoriteteve malazeze në vitin 1989, kur dhe nisi aleancën me Sllobodan Millosheviçin. Si kryeministri i Malit të Zi (nga viti 1991) ai mbështeti sulmin e UPJ-së në Dubrovnik. Kjo përmbysje ndodhi në vitin 1996 kur ai deklaroi se Millosheviçi ishte politikan i vjetëruar. Pas kësaj deklarate ai arriti të mposhtte kundërshtarët e tij në parti dhe të fitonte zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale (1998). Politika e re u mbështet nga vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara. Në qershor 2000, ai i kërkoi ndjesë presidentit kroat Stjepan Mesiç për pjesëmarrjen e malazezëve në sulmin kundër Dubrovnikut në 1991-1992. Pas rënies së Millosheviçit në vitin 2000, ai ndryshoi sërish dhe udhëhoqi përpjekjen politike për pavarësinë e Malit të Zi. Pas fitimit të pavarësisë (2006), ai nisi procesin e integrimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian dhe në NATO.



http://www.predsjednik.gov.me/predsjednik/biografijamarrë më 9.06.2015.

III-42. Universiteti i Tetovës në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Universiteti i Tetovës u themelua më 17 dhjetor 1994, por nuk u njoh zyrtarisht si universitet shtetëror nga qeveria e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë deri në janar të vitit 2004. Zyrtarët e qeverisë reaguan ndaj themelimit të Universitetit të Tetovës duke e mbyllur me forcë. Sipas këndvështrimit të shumicës etnike, "Universiteti shqiptar" shihej si simbol i "dublimit të shtetit" dhe provë e vendosmërisë së shqiptarëve për të arritur synimet e tyre politike. Për disa vite, bashkësia ndërkombëtare ishte përpjekur të gjente një zgjidhje alternative për këtë problem politik polarizues. Së fundi, të mbështetur financiarisht nga OSBE-ja, USAIDI-i, etj, universiteti privat trigjuhësh ndërkombëtar SEE u hap në tetor 2001 në Tetovë (leksionet kryhen në maqedonisht dhe anglisht) për të përmbushur nevojat e popullsisë shqiptare për arsimim të lartë. Në vitin 2004, koalicioni qeveritar më në fund arriti një kompromis lidhur me ligjshmërinë e Universitetit Shtetëror të Tetovës (USHT). Sot, USHT-ja përbëhet nga 11 fakultete, 35 programe studimi, 93 fusha studimi, dhe 3 institute të kërkimit shkencor.

Duke pasur gjashtëdhjetë vota pro dhe dy vota kundër, dje Asambleja i miratoi ndryshimet e Ligjit për arsimin e lartë, duke ofruar një kuadër ligjor për legalizimin e Universitetit të Tetovës, që kishte ushtruar veprimtarinë e tij në mënyrë të paligjshme që nga viti 1994. Ky akt u mbështet nga deputetët e partive në pushtet dhe nga dy deputetë të PDP-së ndërkohë që dy deputetë të opozitës votuan kundër.

SDSM-ja dhe BDI-ja i justifikuan ndryshimet e propozuara të ligjit ekzistues të vitit 2000, me nevojën për t'iu bashkuar proceseve të integrimit në Evropë dhe për të kapërcyer mangësitë e vetë ligjit. VMRO-DPMNE e mohoi nevojën për të miratuar ndryshimet duke përdorur procedura të shpejta, duke kërkuar debat publik dhe mendimin e universitetit…

Gjorgjević,16 tetor 2016,Nr.1222.

Pse mendoni se ishte e rëndësishme që universiteti shqiptar në Tetovë të ligjërohej? Çfarë nënkupton ky veprim parë nga këndvështrime simbolike dhe praktike? Imagjinoni se jeni shqiptar me prejardhje shqiptare, që kërkon mbështetje për funksionimin e një universiteti shqiptar?

III-43. Kryeministri i Shqipërisë Fatos Nano në gjyq për korrupsion, 1993

Në qershor të vitit 1991, Fatos Nano u zgjodh udhëheqësi i parë i Partisë Socialiste, pas ndryshimit të emrit nga "Partia e Punës e Shqipërisë" në "Partia Socialiste". Ish-Partia e Punës e Shqipërisë e kishte qeverisur vendin komunist për afër gjysmë shekulli. Nano e mbajti tri herë postin e kryeministrit të Shqipërisë gjatë periudhës post-komuniste, në vitet: 1991; 1997-1998; dhe 2003-2005. Pas fitores së Partisë Demokratike, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1992, Partia Socialiste kaloi në opozitë. Në korrik të vitit 1993, Nano u arrestua dhe u përball me akuzat për shpërdorim detyre dhe abuzime financiare të kryera në vitin 1991 gjatës kohës që ishte në postin e Kryeministrit. Gjykimi i tij përfundoi në vitin 1994. Ai u shpall fajtor dhe u dënua me 12 vjet burg. Vendimi i gjykatës u kundërshtua nga veprimtarët e të drejtave të njeriut dhe nga analistët që kritikonin Presidentin e Shqipërisë të asaj kohe, Z.Sali Berisha. Sipas tyre, vendimi i dhënë ishte i motivuar politikisht dhe kishte si synim shkatërrimin e Partisë Socialiste si partia kryesore e opozitës. Megjithatë, autoritetet, të cilët nuk mundën të zhvillonin një proces gjyqësor të besueshëm, i hodhën poshtë pretendimet e tyre duke theksuar abuzimet financiare të kryera nga ish-kryeministri socialist. Fatos Nano u lirua nga burgu në vitin 1997, në kohën kur vendi ishte përfshirë nga trazirat masive si pasojë e rënies së skemave piramidale. Ai u zgjodh përsëri kryeministër në vitin 1997, kur Partia Socialiste fitoi në zgjedhjet elektorale të atij viti ndaj Partisë Demokratike të Sali Berishës. Në vitin 1999, gjykata e Tiranës e shpalli Fatos Nanon të pafajshëm ndaj akuzave për korrupsion.



Agjencia Telegrafike Shqiptare.

III-44.Fundi i regjimit të Millosheviçit në Serbi, 5 tetor 2000

Rrëzimi i Sllobodan Millosheviçit ndodhi në 5 tetor të vitit 2000. Opozita Demokratike e Serbisë (ODS) iu bëri thirrje qytetarëve që të mblidheshin atë ditë para ndërtesës së Asamblesë Federale në Beograd, për të protestuar kundër vjedhjes së bujshme të votave të kryer nga Komisioni Federal i Votimit me urdhër të Millosheviçit.


BLIC
Najčitaniji dnevnik u Jugoslaviji
DOS pozvao na generalni štrajk
Masovni protesti, štrajkovi i blokade puteva širom Srbije
Koštunica traži nezavisno brojanje glasova

Blic, 30 shtator - 1 tetor 2000 "ODS (Opozita Demokratike e Serbisë) bën thirrje për një grevë të përgjithshme" "Protesta masive, greva dhe bllokim rrugësh në të gjithë Serbinë" "Koshtunica bën thirrje për numërimin e pavarur të votave"


ВЕЧЕРЊЕ НОВОСТИ
ЧЕСТИТАЛИ КОШТУНИЦИ
ПРВИ ДЕМОКРАТСКИ ДАН ВЕСЕЉА, МИТИНГА И КОНСТИТУИСАЊА НОВЕ ВЛАСТИ
СРБИЈА ОДАХНУЛА

Večernjenovosti, 7 tetor 2000. Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) zgjedh President Millosheviçin dhe Putini uron Koshtunicën. "Ditë demokratike e haresë, e gjithë mbështetësve dhe kushtetutës së autoriteteve të reja" "Serbia merr frymë lirisht."

III-45. Vrasja dhe funerali i Zoran Xhinxhiç, 2003



Fotograf: Ivan Milutinovic.

Kryeministri serb Zoran Xhinxhiç u vra nga një snajper më 12 mars 2003 në oborrin e ndërtesës së Qeverisë së Serbisë në qendër të Beogradit. Funerali i tij u ndoq nga 500,000 qytetarë. Vrasja e tij krijoi një situatë të jashtëzakonshme në Serbi: policia kreu një operacion të koduar "Sablja" (Shpata), gjatë të cilit u arrestuan 11,665 persona. Anëtarët e Njësisë së Operacioneve Speciale të policisë serbe si dhe anëtarët e klanit kriminal të Zemunit, u akuzuan dhe u dënuan për organizimin dhe kryerjen e vrasjes. Ata në maj të vitit 2007 u shpallën fajtorë dhe u dënuan në grup me 378 vjet burg. Komandanti i Njësisë Speciale, Milorad Ulemek a.k.a Legija, u dënua me 40 vjet burgim, po aq sa dhe autori i vrasjes, Zvezdan Jovanoviç, i cili ishte gjithashtu anëtar i Njësisë Speciale të Policisë. Prapaskenat politike të vrasjes së Zoran Xhinxhiç janë ende mister sot e kësaj dite.

III-46. Politika e Turgut Ozalit në vitet 1990

Turqia në vitet 1990 ishte një shtet i qeverisur nga koalicione të dobëta. Turgut Ozali (1927-1993) u ndikua nga tendencat ekonomike botërore të kohës dhe politikat e zbatuara nga Ronald Regan në Shtetet e Bashkuara dhe Margaret Theçer në Mbretërinë e Bashkuar. Ai prezantoi një sërë reformash fiskale që përqendroheshin në privatizimin dhe shkurtimet e shpenzimeve publike. Qeverisja e tij si kryeministër (1983-89) dhe si president (1989-93) u karakterizua nga bashkëjetesa e liberalizmit ekonomik me konservatorizmin politik, si dhe nga shtimi i elitave të reja myslimane që sfidonin hegjemoninë e Kemalistëve të vjetër. Vdekja e papritur e Turgut Ozalit, në prill të vitit 1993, që ishte përpjekur të zgjidhte çështjen kurde, thelloi edhe më tej krizën politike në vend.



https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Turgut_ozal_2.jpg (author:Terryboy668), marrë më 21.10.2015.

III-47. Një aksident me makinë pranë qytetit Susurluk, Turqi 1996: raporti i komisionit hetimor të krijuar nga Asambleja Kombëtare

Viktima të këtij aksidenti me makinë ishin një polic i rangut të lartë, një fituese e titullit të bukurisë "Miss Turkey"…dhe Abdullah Çatlı, drejtues i mirënjohur i organizatës Grey Wolves (Ujqërit gri) të cilët ishin përfshirë në vrasjen e militantëve të krahut të majtë dhe në përpjekjen për vrasjen e Papa Gjon Palit të II-të, në vitin 1982. I mbijetuari i vetëm i aksidentit, Sedat Bucak, ishte udhëheqës i mirënjohur i një fisi kurd dhe i forcave paramilitare dhe në atë kohë ishte deputet i partisë qeveritare Partia e Rrugës së Vërtetë (PRV) të Tansu Çillerit. Hetimet e bëra për aksidentin zbuluan lidhjet e forta mes mafies, të djathtës radikale, forcave të sigurisë dhe politikës.

Raporti i Susurlukit: "Sekret shtetëror"

Janë zbuluar pjesë të Raportit Susurluk të cilësuara si "sekrete shtetërore". Një pjesë e censuruar e raportit prej 12 faqesh u përfshi në shtesën e akt-akuzës së Ergenekonit. Raporti dokumentonte bashkëpunimin e nëpunësve të shtetit, policëve, ushtarëve dhe shumë të tjerëve që kishin pranuar përfshirjen në një sërë aktesh të paligjshme, duke filluar nga përgatitja e një grushti shteti në Azerbajxhan, deri në vrasjet e kryera nga shteti. Në raport shkruhet: "Behçet Canturk u vra nga policia, shumë persona me origjinë kurde u ekzekutuan, ndëshkimi i tyre ishte i drejtë. Megjithatë, pasojat e disa vrasjeve nuk u kuptuan si duhet ... "Abdullah Çatlı u urdhërua nga Hiram Abas të veprojë kundër ASALA, në emër të MIT dhe me lejen e Kenan Evrenit. Pas kthimit të tij, ai u mbrojt nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë". "Ai përdori dëshmitarët e JITEM së bashku me Veli Kuçukun, i cili u bë komandant i grupit. Më vonë, ata kryen vrasje personale". […]

http://www.nasname.com/a/susurluk-raporu-devlet-sirri, marrë më 14.06.2016.

III-48. Procesi i 28 Shkurtit (1997) nëTurqi

Në zgjedhjet e vitit 1995, ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm partish, pas vdekjes së Turgut Ozal në vitin 1993, Partia e Mirëqenies Islamike (Refah Partisi) e Necmettin Erbakan u bë partia kryesore politike në vend me vetëm 21.32% të votave. Më 28 shkurt të vitit 1997, Këshilli i Sigurisë Kombëtare, i mbizotëruar nga ushtria, miratoi një sërë masash të ashpra anti-islamiste që do të çonin përfundimisht në rënien e qeverisë së koalicionit të Erbakanit. Grushti i shtetit i vitit 1997 u quajt "post-modern" pasi ai mundësoi një model të ri të krijimit të institucioneve politike, duke mos u mbështetur te ndërhyrja e drejtpërdrejtë e ushtrisë. Megjithatë, pas vitit 1997, ushtria në fakt mori një rol të rëndësishëm politik, duke vepruar si mbrojtëse e shtetit Kemalist kundër kërcënimeve të aktivizmit islamik dhe separatizmit kurd.

A. Pse grushti i shtetit i 28 shkurtit u quajt "Procesi": Një deklaratë nga gjenerali në pension Huseyin Kıvrıkoglu.

28 shkurti i vitit 1997 është një proces, që filloi në vitin 1923 dhe që nga ajo ditë, deri në ditët e sotme, nuk e ka ndalur vrullin kundër kërcënimit të irtica [Islamit

reaksionar]…Nëse është e nevojshme, procesi i 28 shkurtit do të vazhdojë për dhjetë vjet, për njëqind vjet, në mos, për një mijë vjet.

Ergin, në Kasaba(ed.),2008,fq.312.

B. Çevik Bir, numri dy i ushtrisë dhe arkitekti kryesor i "Procesit" të 28 shkurtit, përshkruan rolin e forcave të armatosura turke në funksionimin e sistemit qeveritar së vendit:

Në Turqi kemi çiftëzimin e Islamit me demokracinë. [...] Laicizmi është pasardhësi i kësaj martese. Në varësi të gjendjes shëndetësore të fëmijës, ne rekomandojmë edhe ilaçin e nevojshëm për të bërë të mundur shërimin e fëmijës.

Kızılyürek,2006,fq.150-151.

C. Vendimi i 28 shkurtit i vitit 1997 i Këshillit të Sigurisë Kombëtare për masat që duhet të ndërmerren ndaj veprimeve reaksionare kundër regjimit:

1- Parimi i laicizmit, që është një nga karakteristikat themelore të republikës sipas Kushtetutës sonë, dhe që mbështetet në nenin 4 të kësaj Kushtetute, duhet të mbrohet me rreptësi dhe ndjeshmëri të lartë; Ligjet ekzistuese që sigurojnë mbrojtjen e tij, duhet të zbatohen pa asnjë dallim dhe nëse ato nuk konsiderohen të përshtatshme kur zbatohen, duhet të hartohen ligje të reja.

3- Për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit të mendjelehtëve të brezit të ri mbi synimet dhe idealet e lartësimit të kombit turk në nivelet e qytetërimit bashkëkohor, kjo arrihet së pari përmes dashurisë për republikën, për Ataturkun, për atdheun dhe kombin, dhe më pas, përmes mbrojtjes së tyre nga ndikimet që vijnë nga drejtime të ndryshme.:

a- Edukimi i detyrueshëm 8-vjeçar duhet të zbatohet në të gjithë vendin.

b- Duhet të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për funksionimin e kurseve të Kuranit nën përgjegjësinë dhe kontrollin e Ministrisë së Arsimit, dhe fëmijët që kanë përfunduar arsimin bazë mund të vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm të tyre nëse familjet përkatëse e dëshirojnë këtë gjë.

7- Duhet të merren nën kontroll publikimet kundër forcave të armatosura dhe anëtarëve të tyre, të bëra me qëllim nga grupe të caktuara mediatike që përpiqen t'i paraqesin Forcat e Armatosura Turke (TSK) si kundërshtare të fesë, duke shfrytëzuar elementë ushtarakë, të cilët, për shkak të veprimtarive të tyre reaksionare i ndërprenë marrëdhëniet me TSK pas vendimeve të dhëna nga Këshillit Suprem Ushtarak.

9- Masat e marra sipas legjislacionit në fuqi për të parandaluar depërtimin e grupeve fetare ekstremiste në TSK, duhet të zbatohen edhe në institucione dhe organizata të tjera publike, veçanërisht në universitete dhe në institucionet arsimore, si dhe në çdo nivel të administratës dhe gjyqësorit.

13- Duhet të parandalohen praktikat që i kundërvihen kushtetutës për sa i përket kodit të veshjes dhe që përpiqen ta paraqesin Turqisë me një imazh të vjetër: ligjet tona dhe vendimet e Gjykatës Supreme mbi këtë çështje duhet të zbatohen me rreptësi, pa kompromis, sidomos në institucionet publike.

17- Duhet të parandalohen me mjete juridike dhe administrative iniciativat që synojnë t'iu japin fund problemeve në vend, sipas konceptit të "ümmet" në vend të "millet" [d.m.th. feja në vend të kombit] i cili është një parim i ndjekur edhe nga organizatat terroriste separatiste.

Shtojca A e Vendimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare e 28 shkurtit të vitit 1997, numër 406.

Ndiqni retorikën dhe mendimin e Çevik Bir për rolin e forcave të armatosura në Turqi në atë kohë. Metafora e një "vendi të sëmurë" dhe ushtria si një mjek që shëronte sëmundjet, u përdor nga diktatori grek George Papadopoulos (gjithashtu një ushtarak), rreth 20 vjet më parë. Cilat ishin përgjegjësitë e ushtrisë sipas burimit të informacionit?

III-49. Reformat ligjore në Turqi në përputhje me normat e BE

Pas njohjes së Turqisë si kandidate për anëtare në BE në dhjetor të vitit 1999 në Samitin e Helsinkit të BE, vendi ndërmori një sërë reformash në përputhje me normat ligjore të vendeve anëtare të BE-së. Hapi i parë thelbësor u bë me ndryshimet kushtetuese në tetor të vitit 2001. Në 3 Tetor 2001, Asambleja e Madhe Kombëtare Turke (AMKT) miratoi ndryshimet gjithëpërfshirëse të Kushtetutës së vitit 1982, ndryshime që s'ishin bërë ndonjëherë që nga koha e hartimit të saj. Ndryshimet çuan në harmonizimin e lirive individuale dhe të drejtave për t'u organizuar në shoqata në bazë të vendimeve përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nga shkurti i vitit 2002 deri në korrik 2004, u miratuan tetë paketa ligjore shtesë për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit. Gjithsej u ndryshuan 218 nene të →

53 ligjeve, duke përfshirë këtu edhe ligjin famëkeq kundër terrorizmit (Terörle Mücadele Kanunu - TMK) si dhe Ligjin nr. 301 të kodit penal që çoi në disa aktakuza bazuar në "fyerjen e kombit turk, republikës dhe TGNA". Ndryshimet gjithashtu mundësuan heqjen e dënimit me vdekje nga sistemi penal i kodit të Turqisë (një ndryshim me rëndësi të jashtëzakonshme për udhëheqësin e burgosur të PKK Abdullah Ocalan), si dhe sollën zgjerimin e "të drejtave kulturore" të individëve dhe grupeve (një çështje tjetër e rëndësishme për përdorimin e gjuhës kurde dhe ruajtjen e kulturës kurde si dhe përdorimin e gjuhës dhe kulturës së minoriteteve). Paketa e shtatë ligjore e harmonizimit që u miratua në korrikut të vitit 2003 çoi në kufizimin e autoritetit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Sekretariati i Përgjithshëm që gëzonte autoritet të plotë të KSK pësoi ndryshime duke iu caktuar një funksion koordinues dhe shumë shpejt drejtimi i tij do t'i besohej një civili. Përveç kësaj, u anulua e drejta e KSK për të mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të KSK, duke ia deleguar qeverisë së zgjedhur funksionet strategjike të mbikëqyrjes dhe të zbatimit të vendimeve.

Ndryshimet e paraqitura në 19 qershor të vitit 2003, për Ligjin nr. 4903 "Ligji për ndryshmin e ligjeve të ndryshme"

Neni 12: "Neni 9 i Ligjit nr. 3257 [Për prodhimet kinematografike, video-filmike dhe televizive] është ndryshuar dhe shtohet paragrafi vijues:

"Në rastet kur një produkt ka dëmtuar parimet themelore të Republikës, siç parashikohet në Kushtetutë: shëndetin publik, rendin dhe moralin publik, atëherë, nëpërmjet një inspektimi të duhur nga autoritetet publike ose qeveritare, produkti mund të ndalohet me urdhër gjykate ose, në rastet kur vonesat përbëjnë rrezik, mund të ndalohet me një dekret ministerial ose publik. Çdo dekret që ushtron një efekt të tillë, duhet të paraqitet për aprovim pranë gjykatës penale të rrethit brenda 24 orëve. Nga momenti i dorëzimit të dekretit në gjykatë, Kryetari i trupit gjykues duhet të marrë një vendim brenda 48 orëve, në të kundërt, dekreti anulohet automatikisht.»

Neni 14: Ndryshimi i nenit 4 të Ligjit nr. 3984 Për themelimin dhe transmetimin e kanaleve radiofonike dhe televizive:

"Qytetarët turq, që nga dita e sotme e në vijim, mund të transmetojnë në të gjitha gjuhët dhe dialektet e ndryshme që përdorin në jetën e tyre të përditshme".

Neni 20: Ndryshimi i Ligjit nr. 3713 Ligji kundër terrorizmit, neni 1 mbi përkufizimin e "Terrori dhe organizata terroriste":

"Terrorizmi nënkupton akte kriminale ku përfshihet dhuna, kanosja dhe kërcënimet, nga individë ose organizata, që synojnë të ndryshojnë parimet themelore të Republikës të përcaktuara në kushtetutë, apo në rendin politik, ligjor, shoqëror, laik dhe ekonomik; prishin unitetin e pandashëm të shtetit dhe të shoqërisë; vënë në rrezik ekzistencën e Republikës dhe Shtetit turk; dobësojnë, shkatërrojnë ose marrin kontrollin e autoritetit të shtetit; shkelin të drejtat dhe liritë themelore; prishin sigurinë e brendshme dhe të jashtme të shtetit, rendin ose shëndetin publik".

ÇeşitliKanunlardaDeğişiklikYapılmasınaİlişkinKanun[Ligji për Ndryshimin e ligjeve të ndryshme] No4903, Asambleja e Përgjithshme e Turqisë,http://www2.tbmm.gov.tr/d22/1/1-0633.pdf, marrë më 31.05.2016.

III-50. Zgjedhjet parlamentare në Turqi, nëntor i vitit 2002 dhe korrik i vitit 2007

Sistemi politik klasik turk u përmbys si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të 2 Nëntorit të vitit 2002. Partia turke AKP (Drejtësi dhe Zhvillimi), degë e Islamizmit klasik turk, e udhëhequr nga ish-kryetari i Bashkisë së Stambollit, Rexhep Tajip Erdogan, mori shumicën absolute në parlament me 34% të votave. Partia arriti të rrisë numrin e saj të votave (46% në vitin 2007, dhe pothuajse 50% në vitin 2011), përpara se të binte në 41% në 2015 dhe më pas mundi të fitojë përsëri me pothuajse 50% të votave në ripërsëritjen e zgjedhjeve në 1 nëntor të vitit 2015. Në përgjithësi, gazetat e krahut të djathtë i konsideruan rezultatet e zgjedhjeve si "fitore të kombit në formë proteste" dhe si manisfetim i zemëratës së popullit ndaj partive të tjera të tilla si MHP (Partisë së Devlet Bahçelit), ANAP (Partisë së Ozalit), DYP (Partisë sëDemirelit) dhe DSP (Partisë së Ecevit), ku të gjitha nuk arritën të kalonin pragun 10% të votave për të hyrë në Parlament. Gazetat Kemaliste ishin shumë skeptike për rezultatet e zgjedhjeve. Më 5 nëntor 2002 gazeta "Cumhuriyet" shkroi artikullin me titull "Pushteti Islamik". Duke iu referuar shtypit evropian, gazeta në mënyrë indirekte argumentonte se fitorja e AKP ishte një kërcënim për procesin e anëtarësimit të Turqisë në BE. Nisur nga botëkuptimi islam dhe pikëpamjet e Erdoganit gjatë mandatit të tij si kryetar bashkie, laikët dhe ushtria ishin të shqetësuara për faktin se AKP mund të mbështeste Islamin politik në Turqi. "Sabah", një nga gazetat më të mëdha dhe më të besueshme në vitin 2002, e cilësoi këtë ndryshim dramatik politik si "Revolucioni i Anadollit".

Nëntor i vitit 2002 Zgjedhjet e Përgjithshme



https://tr.wikipedia.org/wiki/2002_T%C3%BCrkiye_genel_se%C3%A7imleri#/media/File:2002_T%C3%BCrkiye_genel_se%C3%A7im_sonu%C3%A7lar%C4%B1.svg, marrë më 14.06.2016.


Korrik i vitit 2007 Zgjedhjet e Përgjithshme



https://tr.wikipedia.org/wiki/2007_T%C3%BCrkiye_genel_se%C3%A7imleri#/media/File:2007_T%C3%BCrkiye_genel_se%C3%A7im_sonu%C3%A7lar%C4%B1.svg, marrë më 14.06.2016.

Aktiv në Shoqatat Rinore të Partisë për Shpëtim Kombëtar të Necmettin Erbakan që në vitet 1970-të, Recep Tayyip Erdogan u bë udhëheqës i Partisë së Mirëqenies për Degën e Stambollit në vitin 1985. Ai pati një bashkëpunim të suksesshëm me organizatat bazë të partisë, gjë që çoi në zgjedhjen e tij si kryebashkiak i Stambollit në vitin 1994. Pas recitimit të një poeme të konsideruar si "nxitje për intolerancën fetare", mandati i tij përfundoi. Në vitin 1999 ai u dënua me dhjetë muaj burg, nga të cilat kreu vetëm katër muaj. Në vitin 2001, pas shkëputjes së tij nga Erbakan, ai bashkëthemeloi, me Abdullah Gylenin, Partinë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP). Edhe pse dënimi penal që mori e pengoi atë të bëhej Kryeministër gjatë fitores elektorale të AKP-së në vitin 2002, ai ia doli të zgjidhej gjatë zgjedhjeve plotësuese që u zhvilluan në mars të vitit 2003. Erdogani ndërmori reforma të cilat e ndryshuan Turqinë rrënjësisht, duke ruajtur rritjen e shpejtë ekonomike dhe normat e larta të investimeve ndërkombëtare. Tensioni i vazhdueshëm me ushtrinë kulmoi me një memorandum ushtarak në maj 2007, i cili paralajmëronte se ishte kundër islamizimit. Në zgjedhjet që pasuan, AKP-ja triumfoi përsëri. Abdullah Gül u zgjodh President. Pozicioni drejtues i Erdoganit u fuqizua kur Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë në korrik të vitit 2008 një çështje gjyqësore kundër AKP-së. Në vitin 2007, duke nisur me rastin e Ergenekonit, filloi një kundërsulm kundër figurave të shquara ushtarake me përkrahje të gjerë nga mbështetësit e Fetullah Gylenit. Shumë nga vendimet e marra ishin padyshim të padrejta.





KAPITULLI IV: EKONOMIA DHE SHOQËRIA

Hyrje	151
IV.1. Privatizimi dhe çindustrializimi	153
IV.2. Shkatërrimi dhe mbrojtja e mjedisit	158
IV.3. Financat	161
IV.4. Demografia dhe emigrimi	170
IV.5. Pabarazitë sociale dhe minoritetet	175

HYRJE

Situata ekonomike dhe shoqërore në Evropën Juglindore ndryshoi rrënjësisht pas vitit 1990. Këto ndryshime u shoqëruan nga zhvillimet politike, që i paraqitëm në kapitullin III: Hapja e kufijve e të ashtuquajturave vende të Perdes së Hekurt, pas rënies së regjimeve komuniste, si dhe bashkimi i vendeve evropiane, siguruan rritje të tregtisë dhe ekonomisë në përgjithësi; por, pati edhe ndryshime strukturore, që lidheshin me zhvillimet ndërkombëtare të tilla si: rrënimi i sektorëve të vjetër të ekonomisë, përdorimi i teknologjive të reja dhe globalizimi i ekonomisë botërore. Përveç kësaj, "revolucioni i shërbimit" që ndodhi në strukturën profesionale të shoqërive perëndimore, solli ndryshime të mëdha duke përfshirë një rritje të dukshme të shërbimit të punësimit.

Vendet e Evropës Juglindore ndoqën rrugë të ndryshme. Tranzicioni në Qipro, Greqi dhe Turqi kishte filluar më herët; në Greqi dhe Qipro me krizën e vitit 1974, kurse në Turqi me daljen nga diktatura ushtarake në vitin 1983 (shih vëllimin 1, kap. VIII). Greqia ishte vendi i parë në rajon, që në vitin 2001 iu bashkua eurozonës. Në të njëjtin vit, Turqia përjetoi një krizë të rëndë ekonomike, duke filluar me një zhvlerësim masiv prej 40% të lirës turke. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm i një "Programi të fortë ekonomik", i mundësoi Turqisë të realizonte një rritje me ritme të qëndrueshme dhe të fortë në vitet 2000. Qiproja, me bankat e saj të shumta, ishte kthyer në një parajsë të rëndësishme financiare (sipas disa të dhënave, ajo përdorej për të "pastruar" paratë, që vinin nga Ballkani). Greqia dhe Turqia u tronditën nga skandalet e korrupsionit dhe lidhjet, që ekzistonin mes elitave politike dhe grupeve të ndryshme të interesit (p.sh. skandali Susurluk në Turqi, në vitin 1996).

Pas vitit 1990, vendet ish-socialiste kaluan një proces deshtetëzimi, privatizimi dhe në të njëjtën kohë çindustrializimi, pasi industria e tyre nuk ishte konkurruese në treg. Pjesa më e madhe e vendeve u përball me probleme shqetësuese ekologjike. Ish-Jugosllavia ishte vendi me ekonominë më të zhvilluar dhe të orientuar nga perëndimi mes gjithë vendeve socialiste të Ballkanit, me një ekonomi socialiste të përzier me atë të tregut të lirë. Një krizë ekonomike e shoqëruar me një inflacion të madh kishte filluar që në vitet 1980-të, përpara shpërbërjes së vendit. Sllovenia, republika më e zhvilluar e ish-Jugosllavisë, u prek shumë pak nga lufta dhe vetëm për një kohë të shkurtër. Sllovenia ishte vendi me arritjet më të larta gjatë procesit të tranzicionit dhe në vitin 2007 iu bashkua eurozonës. Megjithatë, në vitin 2008 ajo u godit nga kriza ekonomike botërore. Ish-republikat e tjera ekonomikisht ishin të varfra ose për shkak të pasojave të luftës, ose si pasojë e sanksioneve ekonomike ndërkombëtare, ose dhe për të dyja shkaqet e sapopërmendura; ndërkohë, Serbia përjetoi një inflacion të madh, ndërsa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë pësoi një bllokim të jashtëm ekonomik nga ana e Greqisë.

Vendet e tjera socialiste me ekonomi tregu ishin disi më të favorizuara në këtë drejtim, por ato e filluan rimëkëmbjen e tyre nga një pozicion shumë i dobët ekonomik. Në veçanti Shqipëria, e cila ka qenë më e mbyllur se të gjithë vendet e tjera, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Të gjithë këto vende gjatë viteve 1990-të përjetuan paqëndrueshmërinë ekonomike dhe kriza të ndryshme ekonomike. Karakteristikat e përbashkëta të vendeve ish-socialiste të Evropës Juglindore ishin sistemet e paqëndrueshme financiare, liberalizimi i çmimeve, tregtia e jashtme, rënia e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), rritja dramatike e papunësisë dhe përkeqësimi i mëtejshëm i kushteve sociale për shumicën e popullsisë. Në disa vende, njerëzit pësuan rrënim financiar nga të ashtuquajturat skema të firmave piramidale – Shqipëria ishte ajo, që pësoi rrënimin më të madh, por fenomene të ngjashme ndodhën edhe në vende të tjera - ku një pjesë e madhe e popullsisë humbi kursimet e saj. Për shkak të luftës në rajon, investimet e huaja edhe ato që cilësoheshin si të rëndësishme, filluan vetëm pas vitit 2000, kurse në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore filluan në vitin 1990.

Deshtetëzimi dhe privatizimi u kryen në mënyra të ndryshme në vendet e Evropës Juglindore. Të gjitha vendet ish-socialiste në rajon u përpoqën të shmangnin të ashtuquajturën "terapi e shokut", që do të përfshinte privatizimin e shpejtë dhe shitjen e pjesës më të madhe të pronës shtetërore: ata zgjodhën zhvillimin gradual të reformës. Privatizimi u krye në shumë forma të ndryshme: kthimi (rikthimi i pasurive shtetërore tek ish-pronarët e tyre); privatizimi me anë të shpërndarjes së aksioneve falas ose përdorimi i sistemit të letrave me vlerë, (autoritetet iu dhanë letra me vlerë shtetasve ose i shiten ato me një tarifë simbolike (nominale), që ato të përdoreshin për blerjen e aksioneve në ndërmarrje); me anë të shitjeve direkte të ndërmarrjeve; formimit të shoqërive aksionere të përbashkëta të zotëruara nga shteti (Thesari i shtetit); aksioneve të blera nga punonjësit dhe menaxherët (aksionet e një ndërmarrje u janë shitur ose u janë dhënë menaxherëve dhe punonjësve të tjerë). Privatizimi në shkallë të vogël, p.sh.

i dyqaneve të vegjël, në përgjithësi iu nënshtrua një procesi relativisht të lehtë, duke i shitur ato me çmim të lirë te punonjësit e tyre, por procesi i privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha, ishte më i diskutuari dhe më abuzuesi.

Proceset e grumbullimit jo transparent të kapitalit përmes privatizimit, që u kryen kryesisht nga politikanët, ose si rezultat i përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë, krijuan një ndarje të thellë të shtresave shoqërore në shoqëri, ku dikur individët gëzonin të drejta shumë të barabarta, me përjashtim të elitës partiake. U formua një rreth i ngushtë njerëzish të pasur. Përveç kësaj shtrese u krijua një klasë e vogël e mesme dhe më pas shumica e njerëzve, që bënin një jetë shumë modeste dhe ku pjesa më e madhe e tyre jetonin në prag të varfërisë, ose nën pragun e saj. Aktualisht, si rrjedhojë e gjithë këtij procesi, prona private llogaritet rreth 60 - 75% e PBB në ish-vendet socialiste (më e larta në Shqipëri, me 75%). Edhe bankat u privatizuan në shumicën e rasteve - në disa vende, për shembull, në Sllloveni, ky proces ende vazhdon. Rajoni në tërësi ka mbetur prapa ish-vendeve socialiste, të cilat tashmë janë bërë pjesë e BE-së dhe ka dallime të mëdha midis vendeve të veçanta. Disa prej këtyre vendeve janë prekur nga qasja e ndryshme që ka BE-ja kundrejt secilit shtet që s'është anëtar; e gjithë kjo erdhi si rezultat i "lodhjes" nga zgjerimi i BE dhe vetë krizës së brendshme të BE. Procesi i integrimit evropian akoma vazhdon të jetë problem, duke mbetur prapa si pasojë e gjithë këtyre faktorëve. Politikat e dobëta ekonomike të secilit vend dhe konflikti i tyre i brendshëm politik janë gjithashtu faktorë që "e ndihmojnë" këtë situatë.

Pas vitit 1990, tendencat demografike dhe pozita e minoriteteve në rajon ndryshuan rrënjësisht. Nën regjimin socialist, emigrimet nga vendet socialiste (me përjashtim të ish-Jugosllavisë) ishin të rralla pasi kufijtë shtetërorë mbroheshin rreptësisht. Në disa raste, autoritetet vendore mundësuan emigrimin në këmbim të pagesës - për shembull, në Rumani - ose vetë këto vende i dëbuan disa minoritete të caktuara, si për shembull, rasti i Bullgarisë me dëbimin e turqve bullgarë të ashtuquajtur "Ekskursioni i Madh". Para vitit 1990, Greqia, Turqia dhe ish-Jugosllavia përjetuan emigrim masiv drejt vendeve të Evropës Perëndimore ku emigrantët u bënë 'gastarbeiter' (punonjës i huaj). Pas vitit 1990, dhe pasi disa vende të Evropës Juglindore (EJL) ishin bërë anëtare të Bashkimit Evropian (BE) (Sllovenia dhe Qipro në vitin 2004, Bullgaria dhe Rumania në 2007 dhe Kroacia në 2008), fluksi i emigracionit u rrit ndjeshëm. Një pjesë e mirë e emigracionit erdhi si rezultat i luftës në ish-Jugosllavi, ku refugjatët e saj, viktimat e spastrimit etnik dhe minoritetet e dëbuara vërshuan drejt BE, por shumë të tjerë i përkisnin emigracionit ekonomik klasik: "që kërkonin një jetë më të mirë në perëndim". Emigracioni i fundit nga EJL nuk ka të bëjë me punëtorë të kualifikuar pak ose shumë të specializuar, tashmë shihet një rritje e ndjeshme e të ashtuquajturit "largimi i trurit", që nënkupton emigrimin e pjesës më të arsimuar të fuqisë punëtore, që kërkojnë të punësohen në industritë e teknologjisë së lartë dhe shkencore në Evropën Perëndimore, duke braktisur e duke varfëruar edhe më tej vendin e tyre të origjinës.

Emigrimi "i ri" ka ndryshuar marrëdhëniet midis vendeve të rajonit. Ato vende, që tradicionalisht nisnin emigrantë, si Greqia dhe Turqia, u shndërruan në vende pritëse. Një fluks masiv emigrantësh ekonomikë, kryesisht nga Shqipëria, ndryshoi përbërjen demografike të Greqisë dhe krijoi minoritete të reja. Në të njëjtën kohë, ndryshoi edhe pozita e grupeve të vjetra të minoriteteve lokale si pasojë e ndryshimeve drastike të pas vitit 1990 dhe nxitjen e nacionalizmit të vjetër. Në pjesën më të madhe të këtyre vendeve, pozita e minoriteteve nuk u përmirësua, ndërsa në territorin e ish-Jugosllavisë shumë prej tyre u zhdukën ose u margjinalizuan si pasojë e spastrimit etnik.

Siç ka theksuar Mark Mazoweri, që nga fundi i Luftës së Ftohtë, Evropa Juglindore është përballur me dilema tashmë të njohura nga pjesa më e madhe e vendeve evropiane: "si të bashkërendojë modelet e vjetra të mirëqenies sociale me trysnitë konkurruese të kapitalizmit global; si të sigurojë energji të përballueshme financiarisht duke ruajtur mjedisin natyror nga ndotja; si të parandalojë përkeqësimin tërësor të jetesës në zonat rurale dhe si të ndërtojë ekonomi të begatshme, se vetëm duke vepruar kështu do të pakësojë veprimtaritë e krimit të organizuar dhe do të realizojë lulëzimin e demokracisë[1]".

[1] 1 M. Mazower, The Balkans, Londër: Weidenfeld & Nicolson, 2000, fq. 135.

IV.1. PRIVATIZIMI DHE ÇINDUSTRIALIZIMI

IV-1. Dekreti i Ligjit të datës 7 shkurt 1990, mbi ndryshimet e pronës në Rumani

Menjëherë pas revolucionit antikomunist të vitit 1989, shoqëria rumune nuk ndihej gati të hynte direkt në "botën kapitaliste" të të drejtave të pronës, të çmimeve të paqëndrueshme dhe të kostove reale. Zotërimi i një ose disa banesave nga shtetasit e huaj dhe dhënia e të drejtave të pronësisë për këta shtetas, konsideroheshin akoma si situata të dyshimta ose të rrezikshme. Për më tepër, në Kushtetutën e parë post-komuniste të Rumanisë, prona private nuk ishte "e garantuar", por vetëm "e mbrojtur", ndërsa të huajve u ishte mohuar e drejta e pronësisë mbi tokën. Dekreti - ligji nr. 61/7 i shkurtit të vitit 1990, kishte të bënte me privatizimin e banesave të ndërtuara me fonde shtetërore, duke ua shitur ato banorëve dhe në këtë mënyrë u bë e mundur që miliona njerëz, që ishin qiramarrës të pronës shtetërore, të bëheshin pronarë me të drejta të plota të banesave të tyre. Për shkak të inflacionit, shuma e paguar për privatizimin mbulonte vetëm një pjesë të kostos së ndërtimit.

Dekretet e Këshillit të Fronit Kombëtar të Shpëtimit

Neni 1. Sipas dekretit në fuqi, kompanitë e angazhuara në fushën e shitjeve të shtëpive dhe zyrave mund t'iu shesin shtetasve rumunë banesat e ndërtuara me fonde shtetërore.

Neni 2. Banesë, sipas ligjit në fuqi, cilësohet një mjedis, që përfshin një ose më shumë dhoma, banjë, kuzhinë dhe anekse të tjera, duke formuar një njësi të pavarur e përcaktuar si e tillë nga ndërtimi.

Neni 3. Banesat e përcaktuara në Nenin 1 iu shiten shtetasve rumunë me vendbanim në Rumani, pas pagesës së çmimit tërësor të përcaktuar në kontratën e shitblerjes ose pas marrjes së një huaje nga Banka e Kursimeve dhe Kredive, pa kufizime në lidhje me zotërimin e një banese të dytë. Blerësi i banesës merr gjithashtu dhe uzufruktin e pronësisë së tokës përkatëse gjatë ekzistencës së ndërtesës.

Neni 4. Ndalohet blerja e banesave me qëllim rishitjen ose dhënien e tyre me qira.

Neni 5. [...] Banesat me qiramarrës mund t'i shiten vetëm këtij të fundit, bazuar në kërkesat e njësive siç përcaktohet në blerjen e banesës.

Neni 6. Çmimet e shitjes për shtetasit rumunë, për sa i përket banesave të ndërtuara me fonde shtetërore dhe të pranuara deri më 31 dhjetor 1989, janë përcaktuar në përputhje me anekset nr. 1 dhe 2 [...] ".

Dekreti Ligjor nr. 61/7 i shkurtit të vitit 1990, botuar në Fletoren Zyrtare, nr. 8, shkurt, 1990, Pjesa I, nr. 22, fq. 1.

IV-2. Ligji për kthimin e pronave të paluajtshme të shtetëzuara në Bullgari, 1992

Neni 1. (1) Pronësia e çdo pasurie të paluajtshme, të shpronësuar sipas Aktit të Shpronësimit të Pasurive të Paluajtshme Urbane me Sipërfaqe të Madhe (të shpallura në Fletoren zyrtare nr. 87 të vitit 1948; ndryshuar në nr. 91 të vitit 1948), të cilat janë në pronësi të shtetit, të bashkive dhe komunave, të organizatave ose kompanive publike, ose në pronësinë e një kompanie me një aksioner të vetëm, sipas Nenit 61 të Ligjit mbi Tregtinë dhe që ekzistojnë fizikisht, me sipërfaqe të njëjtë me atë që ka qenë në kohën e shpronësimit, i kthehet pronarit.

(2) Çdo transaksion, që kryhet në kundërshtim me rezolutën e Asamblesë Kombëtare të datës 6 dhjetor 1990, mbi heqjen e pjesshme të ndalimit të asgjësimit të pronës shtetërore dhe komunale (Fletorja Zyrtare nr. 101, 1990) shpallet i pavlefshëm dhe pronësia e pronave që i nënshtrohen transferimit, i kthehet pronarit. [...]

Neni 9. Çdo person, të cilit i është kthyer pronësia në bazë të këtij Ligji, mund të marrë certifikatën e pronësisë me anë të verifikimit të rrethanave nëse vërtetohet se ata vetë, ose paraardhësit e tyre kishin të drejtën e pronësisë deri në datën e konfiskimit të pronës. Taksa e vendosur për verifikimin e rrethanave nuk do të paguhet.

Fletorja Zyrtare, nr. 15, 21 shkurt 1992. http://www.pravoto.com/site/zakonodatelstvo/zakoni/13209- zakon-za-vazstanovyavane-sobstvenostta-varhu-odarzhaveni-nedvizhimi-imoti, vizituar më 21.10.2015.

Përse mendoni se ishte e rëndësishme që qytetarët e ish-vendeve komuniste ta rifitonin të drejtën e pronës? Kini parasysh faktin që e drejta e pronës ka qenë një e drejtë themelore e njeriut e njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948, neni 17).

IV-3. Ligji për Fondet e Tokës (18/1991), që pasqyron shkatërrimin e bujqësisë së kolektivizuar, dëmtimin e pronave të fermave dhe uljen drastike të prodhimit në Rumani

Zbatimi i dispozitave të ligjit hasi vështirësi për shkak të mungesës së provave, sasisë së pamjaftueshme të tokës krahasuar me kërkesat e ish-pronarëve, si dhe abuzimeve të shpeshta, ndërhyrjeve, zbatimit jo të duhur të tij, etj. Efekti rrënues i menjëhershëm i këtij procesi u ndje në shkatërrimin e shpejtë të fermave kolektive dhe pajisjeve bujqësore (p.sh. sistemet e ujitjes) të trashëguara nga sistemi i mëparshëm, në rënien e konsiderueshme të prodhimit dhe u vu re që një pjesë e mirë e popullsisë iu kthye punës në bujqësi për të përballuar jetesën.

[...] Neni 1. Parcelat e tokës të çdo lloji, pa marrë parasysh qëllimin e përdorimit të tyre, certifikatën e tyre të pronësisë, ose nëse ato janë pjesë e hapësirave publike ose private, përfaqësojnë një pjesë të fondit të tokave të Rumanisë.

[...]

Neni 3. Në bazë të ligjit në fuqi, pronarë të parcelave të tokës do të cilësohen pronarët që zotërojnë certifikatën e pronësisë, të të drejtave të tjera reale mbi tokën ose ata që, sipas ligjit civil, njihen si pronarë ose mbajtës të përkohshëm.

[…]

Neni 8. Përcaktimi i të drejtave të pronës private në parcelat e tokës, që janë pjesë e trashëgimisë së fermave kolektive bujqësore, bëhet me anë të këtij ligji, duke rivendosur të drejtën pronësore ose duke e përcaktuar këtë të drejtë.

Nga dispozitat e ligjit përfitojnë anëtarët e fermave kolektive që i kanë dorëzuar parcelat e tyre të tokës fermave kolektive bujqësore ose ata që iu është marrë toka me çfarëdo mjeti, si dhe sipas ligjit civil, trashëgimtarët e këtyre të fundit, anëtarët e fermave kolektive që nuk kanë dorëzuar ngastra toke dhe persona të tjerë të përcaktuar në mënyrë të veçantë.

Përcaktimi i së drejtës së pronësisë do të bëhet sipas kërkesës, duke lëshuar certifikata pronësie për sipërfaqe toke të paktën 0.5 ha për çdo person në detyrë me anë të këtij ligji dhe jo më shumë se 10 ha për familje në toka të punueshme. Me familje nënkuptohen bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të pamartuar, nëse këta të fundit janë anëtarë të së njëjtës familje si prindërit e tyre. [...]

Neni 11. Tokat e dorëzuara në një fermë kolektive janë ato që gjenden në: certifikatat e pronësisë; regjistrin e pasurive të paluajtshme; zyrën e regjistrimit të tokës; aplikimet e bëra për t'u bashkuar me një fermë kolektive; regjistrat e fermave kolektive ose, nëse këto mungojnë, çdo dëshmi tjetër, duke përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarëve.

Dispozitat e paragrafit të mëparshëm do të zbatohen gjithashtu për parcelat e tokës të marra në dorëzim nga fermat kolektive ose në bazë të ligjeve të veçanta, ose pa certifikatë pronësie, ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Përcaktimi i një certifikate pronësie bëhet sipas kërkesës së paraqitur, bazuar në gjendjen e pasurive bujqësore të paluajtshme të fermave kolektive që nga 1 janari i vitit 1990, të regjistruara në sistemin e Zyrës së Regjistrimit të Tokave ose Zyrës së Tokave Bujqësore, të ndryshuara nga tjetërsimet e kryera nga fermat kolektive deri në hyrjen në fuqi të ligjit. [...]

Ligji nr. 18/1991, botuar në Fletoren Zyrtare, Pjesa I, nr. 37, 20 shkurt 1991, fq. 1-2.

IV-4. Ndryshimet e situatës së të punësuarve në Rumani gjatë viteve 1989-2006

A. Të punësuarit sipas degëve të ekonomisë kombëtare, 1989

Industria	38.1%
Bujqësia dhe Pyjet	27.9%
Inxhinieria civile	7.0
Transporti	6.2
Qarkullimi i mallrave	5.9
Strehimi i zakonshëm dhe shërbime të tjera jo	4.9
Edukimi, kultura dhe arti	3.4
Shëndeti, ndihma sociale dhe kultura fizike	2.7
Shkencat dhe shërbimet	1.3
Telekomunikacioni	0.7
Administrata	0.5
Degët e tjera	1.4

B. Të punësuarit sipas degëve të ekonomisë kombëtare, 2006

Shërbimet	41
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet	29
Industria	23
Inxhinieria civile	6.

Statistikat vjetore të Rumanisë, 1990, fq. 51, 102-105, 126-127; Statistikat vjetore të Rumanisë, 2000, fq. 52-54, 96, 99, 165; Statistikat vjetore të Rumanisë, 2007, fq. 40, 117-119, 234, 306.

IV-5. “Fruta për çdo fëmijë”: Fermë kooperative me dru frutorë e braktisur në verilindje të Bullgarisë



Fotograf: Alexei Kalionski, 2012.

IV-6. Miron Cozma, udhëheqësi i minatorëve të Valea Jiului, gjatë "mineriadës" (marshimit të dhunshëm të minatorëve në Bukuresht) në vitin 1991



Miron Cozma duke folur me minatorët. http://stirileprotv.ro/stiri/actualitate/miron cozma-nu-am-remuscari-pentru-mortii-de-la-mineriade. html, vizituar më 30.05.2015.

Miron Cozma ishte udhëheqësi më i dalluar i sindikatës së minatorëve në Valea Jiului gjatë dhjetëvjeçarit të parë pas përmbysjes së regjimit komunist. Ai luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e "mineriadës" (marshimit) të vitit 1991, që u pasua me shumë episode të dhunshme dhe me dorëheqjen e kabinetit qeveritar reformist të Petre Romanit. Pas vendimeve të kabinetit qeveritar të kryesuar prej Radu Vasilit në vitin 1999 për mbylljen e minierave të Valea Jiului, minatorët organizuan një tjetër marshim proteste në Bukuresht (në janar). Protesta u përshkallëzua në një konfrontim të përgjakshëm me policinë (e ashtuquajtur "beteja e Costeştit"), por përfundoi me një takim për marrëveshje midis kryeministrit dhe kreut të sindikatës së minatorëve ("Paqja e Kozmës").

Megjithatë, pak kohë më pas (në shkurt 1999), Miron Cozma u arrestua dhe u dënua me 18 muaj burg për krime të kryera gjatë ""mineriadës" (marshimit) të vitit 1991. Dënimi i tij u prit me protesta të mëtejshme nga minatorët. Duke u konsideruar si një prej mbrojtësve të presidentit Ion Iliescu, Cozma fitoi lirinë më 15 dhjetor të vitit 2004, në ditët e fundit të mandatit të Ilieskut. Vendimi për faljen e tij shkaktoi valë protestash nga shoqëria civile dhe nga politikanët perëndimorë, gjë që çoi në revokimin e tij. Pas një gjykimi të ri dhe dënimit, që u vendos për të në vitin 2005, për organizimin e marshimit të dhunshëm të vitit 1999, Miron Cozma përfundimisht u la i lirë në fund të vitit 2007.

IV-7. Një punëtor bullgar i fushës së industrisë përshkruan gabimet e tranzicionit

Unë kam punuar në industrinë e energjisë. Por, më ndodhi një aksident në punë dhe dola në pension. Kam lindur në vitin 1960. Fillova të punoja në kohën e socializmit. Për mendimin tim, ai sistem nuk ishte edhe aq i padëshiruar, për mua të paktën. Ishim me fat që jetuam në vitet më të mira të socializmit dhe demokracisë, sepse gjatë atyre viteve kisha një punë. [...] Kishte shumë entuziazëm [më 10 nëntor të vitit 1989] të gjithë po gëzonin. Në atë kohë banonim në një shtëpi në Kazanlak dhe kur u zgjuam në mëngjes dikush na tha se Todor Zhivkovi kishte rënë nga pushteti. Dhe të gjithë ishim shumë entuziastë, me shpresën se gjërat do të ndryshonin për mirë, në një drejtim pozitiv. Mbi të gjitha, liria e njerëzve, sepse përpara këtij ndryshimi ata nuk e kishin atë lloj lirie. Në të kaluarën, nuk mund të flisje lirshëm, mendimet tuaja duhet të pajtoheshin me politikat e qeverisë. Kudo kishte agjentë të sigurimit dhe ata raportonin për gjithçka tek autoritetet. Nga kjo pikëpamje, ishte stresuese. Por, sa i përket punësimit, atëherë ishte mirë, sepse të gjithë kishin një punë. Pra, ekzistonte një klasë e mesme në Bullgari. Por, gjatë tranzicionit gjithçka u përmbys. Të gjithë shpresonim se gjërat do të ndryshonin për mirë, por në fakt nuk ndodhi kështu. Fillimisht e mbështetëm opozitën, UDF. Por më pas u pa qartë se nuk kishte opozitë të vërtetë, pasi të gjithë në Bullgari po luftonin për pushtet, për të fituar një pozitë të caktuar në administratën shtetërore dhe se askush nuk kujdesej për njerëzit. Më në fund, rreth vitit 2000, nuk kishte më dyshime se çdo gjë që lidhej me tranzicionin ishte krejtësisht e gabuar. Sepse të gjithë edhe pse premtonin se gjërat do të përmirësoheshin, asgjë nuk u përmirësua, çdokush po kujdesej vetëm për interesin e tij. [...] Fabrika e fibrave të poliestrit [në Dimitrovgrad] ishte një nga fabrikat më të mëdha të tekstilit në atë kohë. Ne kemi qenë atje të pranishëm kur ajo do privatizohej dhe që të gjithë ishim të vetëdijshëm se gjithçka ishte rregulluar që fabrikën ta blinte një italian; por pastaj, në minutën e fundit u shfaqën disa turq dhe ai [kryetari i Bashkisë] ua shiti atë këtyre të fundit. Edhe pse kryetari na kishte premtuar se fabrika e fibrave të poliesterit do të vihej në punë përsëri. [...]Vetë qyteti ishte një nga qendrat më të mëdha industriale, por gjithçka u shit shumë lirë. [Fabrika kimike] "Neochim" u braktis në të njëjtën mënyrë, por të paktën ajo vazhdon të punojë. Megjithatë, aty ka një ndryshim të madh midis pagave të punëtorëve dhe punonjësve të administratës. Kjo për shkak se "Neochimi" është ndarë në dy kompani dhe kompania që tani është përgjegjëse për shitjet merr fitimin, ndërsa punëtorët paguhen me rroga mesatare, për të mos thënë me rroga të ulëta. Ata, që në fakt sigurojnë prodhimin [e "Neochemit"], paguhen shumë më pak se ata që merren me shitjen. Pra, ekzistojnë dy kompani, ku njëra është përgjegjëse për shitjen e plehrave, ndërsa tjetra është përgjegjëse për prodhimin e tyre. Fabrika kimike po vazhdon të punojë, kjo është e vërtetë, por vetëm me një të tretën e kapacitetit të saj të mëparshëm. Ajo menaxhohet [sipas rregullave] të ekonomisë së tregut, kështu që drejtuesit e saj i kanë mbyllur disa reparte... Nëse ata një ditë do ta mbyllin të gjithë fabrikën kimike, atëherë qyteti do të kthehet në një fshat të madh. [...] Tregu nuk është i garantuar më si më parë, kriza ndihet kudo. Gjithkush nga ne po heq dorë nga gjërat që dëshiron. Ka pasur [kriza] edhe më parë, më kujtohet ajo e viteve 1992-1994, por prapë njerëzit jetonin shumë më mirë sesa tani. Kriza ka përfshirë gjithë Evropën, por në Bullgari kriza është e përhershme. Në atë kohë [në vitet 1996-1997] kriza ishte diçka katastrofike. Ajo ishte e planifikuar dhe u bë qëllimisht për të marrë paratë e njerëzve. Në fakt, në atë kohë njerëzit kishin kursime të konsiderueshme, që kishin mundur t'i kursenin gjatë periudhës së socializmit. Por gjithçka u bë me qëllim - u ngrit kursi i shkëmbimit të dollarit dhe si rezultat paratë e njerëzve fluturuan. Si rezultat i këtij inflacioni artificial, njerëzit që kishin kursyer mundin dhe djersën gjatë gjithë jetës së tyre, i humbën të gjitha paratë - ky ishte një gabim i madh. Në fillim kam punuar te TKZS (një fermë e kooperativizuar). Në përgjithësi, në vitet e socializmit gjërat ishin pak a shumë të pranueshme, megjithëse njerëzit nuk shpërbleheshin në mënyrë të drejtë, sepse ata që punonin në fusha dhe siguronin gjithë prodhimin iu duhej të punonin sa për të fituar bukën e gojës, ndërsa ata që punonin në administratë përfitonin shumë më tepër. Gjatë tranzicionit, toka iu kthye ish-pronarëve, u rrënuan gjitha fermat e kooperativave dhe nuk kaloi shumë, dhe u shfaqën disa qiramarrës, të cilët morën me qira sipërfaqe toke pa investuar asgjë. Këtyre sipërmarrësve iu interesonte vetëm fitimi dhe kjo u bë përsëri në kurriz të fshatarëve, sepse ata mbillnin vetëm kulturat bujqësore, që nuk kishin nevojë për ujitje dhe qëllimi i tyre i vetëm ishte fitimi. Ata nuk investuan asgjë në bujqësi. Njerëzit i rimorën përsëri tokat e tyre, por shumë pak pronarë privatë u përpoqën të merreshin me bujqësi. Por kur vetë shteti nuk ju siguron treg shitje dhe ju si sipërmarrës privat nuk keni ku t'i shisni prodhimet tuaja, atëherë s'ju ngelet gjë tjetër, veçse të hiqni dorë. Nga ana tjetër, erdhën qiramarrës toke, që u përqendruan në prodhimin e produkteve të drithërave me një kosto të ulët, duke siguruar kështu një fitim më të madh. Në këtë mënyrë, ata mundën të grumbullonin një kapital të konsiderueshëm që në fillim të veprimtarisë. Tashmë, qeveria ka filluar të ofrojë subvencione [...] por prapë ato nuk ofrohen në të njëjtin nivel si në BE. [...] Ata shitën çdo gjë të mundshme dhe kafshët e fermës ua shpërndanë fermerëve në varësi të aksioneve të tyre në TKZS. Në fakt, kushdo që është në pushtet gjithmonë përpiqet të përfitojë nga këto lloj shitjesh. Ata shitën makineritë, shitën gjithçka. Shumë pak sektorë të TKZS u ruajtën, një pjesë shumë e vogël - madje disa të tjera

u zhdukën pa lënë gjurmë, ndërsa një pjesë u plaçkit tërësisht.
[...] Në fillim të gjithë ishin entuziastë për demokracinë, por gjërat kanë shkuar krejtësisht në drejtimin e gabuar. Në fakt, Perëndimi ka përqafuar organizimin tonë të dikurshëm, atë që ne kishim vendosur shumë kohë më parë, që ishte konsolidimi i tokës - ndërsa ne bëmë pikërisht të kundërtën. Po, ky është padyshim një nga gabimet e tranzicionit.

Intervistë me Vasil Valev, Dimitrovgrad, 11 Tetor 2012; Http://prehodbg.com/?q=node/1760, vizituar më 21.07.2016.

IV.2. SHKATËRRIMI DHE MBROJTJA E MJEDISIT

IV-8. Deklarata e Venecias mbi etikën mjedisore të nënshkruar nga Papa Gjon Pali II dhe Patriarku Ekumenik Bartolomeu, 10 qershor 2002

Problemi nuk është thjesht ekonomik dhe teknologjik; ai është moral dhe shpirtëror. Arritja e një zgjidhje në nivelin ekonomik dhe teknologjik mund të realizohet vetëm nëse ne përjetojmë një ndryshim shpirtëror e rrënjësor të zemrës, gjë që mund të çojë në ndryshim të mënyrës së jetesës dhe të modeleve të paqëndrueshme të konsumit dhe prodhimit. [...]

Nevojitet një qëndrim i ri dhe një kulturë e re, bazuar në thelbin e qenies njerëzore brenda krijimit dhe frymëzuar nga sjelljet mjedisore etike, që rrjedhin nga marrëdhënia jonë e trefishtë: me Zotin, me veten dhe me krijimin. [...]

Ne, dhe shumë më tepër fëmijët tanë dhe brezat e ardhshëm, gëzojmë të drejtën për një botë më të mirë, një botë pa varfëri, pa dhunë dhe pa gjakderdhje, një botë plotë mirësi dhe dashuri. [...]

Nuk është aspak vonë. Dora e Zotit ka fuqi të jashtëzakonshme shëruese. Brenda një brezi të vetëm ne mund ta drejtojmë planetin drejt së ardhmes së fëmijëve tanë. Të mundësojmë fillimin e atij brezi tani, me ndihmën dhe bekimin e Zotit.

Chryssavgis, 2012, fq. 336-338.

Një seri konferencash të organizuara në vitet 1988, 1989 dhe 1991 e shtynë Bartolomeun, i cili u zgjodh Patriarku i Kostandinopojës në vitin 1991, ta konsideronte krizën mjedisore si një nga temat kryesore të misionit të tij në ripërtëritjen e Kishës. Në vitin 1992, të gjitha kishat ortodokse autoqefale bënë një deklaratë të përbashkët mbi këtë çështje, ndërsa vetë Patriarku Bartolome ndërmori një sërë udhëtimesh nëpër dete dhe lumenj, duke theksuar faktin se shkatërrimi i mjedisit është një mëkat i madh. Gjatë udhëtimit të tij në Adriatik, ai u takua me Papa Gjon Palin II dhe të dy bënë një deklaratë historike të përbashkët, një shembull i mirë i bashkëpunimit gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet Perëndimit të krishterë dhe Lindjes gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit.

IV-9. "Mos e prekni natyrën e Bullgarisë": një peticion i ndërmarrë nga koalicioni i organizatave joqeveritare mjedisore bullgare, në vitin 2006

"Për natyrën e Bullgarisë", një koalicion i përbërë nga 30 organizata mjedisore bullgare duke përfshirë këtu edhe Fondin Botëror për Ruajtjen e Jetës së Egër (World Wildlife Fund) organizoi një seri protestash në Sofje, Varna dhe në vendbanime të tjera ku u mobilizuan mijëra njerëz. Protesta e 7 tetorit, "Të ngremë zërin, të mbrojmë natyrën", mblodhi mijëra qytetarë që marshuan mes përmes Sofjes dhe Varnës duke luajtur me instrumente muzikore, duke përplasur fort tenxhere dhe tiganë për të dhënë alarmin për bashkëqytetarët e tyre, që të "zgjoheshin nga gjumi që i kishte zënë", dhe t'i kundërviheshin situatës me veprime konkrete. Koalicioni "Për natyrën" ka paraqitur tashmë një numër të madh ankesash zyrtare pranë Komisionit Evropian në lidhje me zonat e mbrojtura. Komisioni i është përgjigjur duke i përkrahur ankesat për sa i përket përcaktimit të vendeve të "Natyrës 2000", duke ushtruar trysni mbi qeverinë bullgare që t'i përfshijë të gjithë aktorët përkatës në këtë çështje, por kjo e fundit akoma nuk ka ndërmarrë veprime serioze për të ndaluar shkatërrimin e vazhdueshëm të zonave të mbrojtura.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Kushtetuta jonë deklaron se Republika e Bullgarisë do të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe llojshmërinë e kafshëve të egra. Si qytetar i Republikës së Bullgarisë, unë ju bëj thirrje ju - përfaqësuesve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor - të ndërmerrni të gjitha veprimet dhe vendimet e duhura brenda kompetencave tuaja për të mbrojtur natyrën bullgare dhe për të garantuar respektimin e Kushtetutës sonë.

Më shqetëson shumë fakti që në vitet e fundit territoret natyrore më me vlerë të Bullgarisë, zonat e mbrojtura dhe zonat e propozuara si Zona me mbrojte të veçantë - janë përkeqësuar si rezultat i zhvillimit, shpyllëzimit dhe sistemeve kulluese. Jam veçanërisht i shqetësuar nga ndërtimet e shumta dhe "betonizimi" i bregdetit të Detit të Zi, ndërtimi i vendpushimeve

dimërore të skive gjithnjë e më shumë në lartësitë e maleve dhe ngritja e instalimi i dhjetëra turbinave me erë në vende të papërshtatshme, të cilat vrasin zogjtë dhe rrezikojnë shëndetin e njeriut. Nuk pajtohem me përpjekjet e disa investitorëve dhe organeve qeveritare për rihapjen e minierave të uraniumit në vend dhe për të futur teknologjinë cianide në miniera.

Padyshim që jam pro zhvillimit dhe rritjes ekonomike në Bullgari, por jo në kurriz të natyrës dhe interesave të njerëzve.

Për këtë arsye, unë mbështes plotësisht iniciativat e nismës: "Mos e prekni natyrën e Bullgarisë" dhe këmbëngul që ju të merrni masat e mëposhtme:

Miratimin e ndryshimeve për Ligjin për Zonat e Mbrojtura; Ligjin për Zhvillimin e Hapësirës dhe Ligjin e Pronës Shtetërore, si dhe për Ligjin e Pyjeve dhe Ligjin për Zhvillimin e Bregdetit të Detit të Zi, të cilat do të garantojnë zhvillim të pacenueshëm në Zonat e mbrojtura dhe Zonat me mbrojte të veçantë. Organizatat joqeveritare mjedisore kanë hartuar propozime efikase në këtë drejtim. [...]

http://old.bluelink.net/zaprirodata/send_appeal.php, vizituar më 21.07.2016.

IV-10. Projekti i minierave Roşia Montana në Rumani: shkatërrimi i mjedisit dhe i trashëgimisë kulturore

Në vitin 1997, një kompani minerare kanadeze filloi një projekt 17 vjeçar të shfrytëzimit të minierave të arit në Roşia Montană, që iu përkasin minierave më të vjetra në Rumani. Fillimisht, në vitin 131 pas Krishtit, këto miniera kanë qenë nën kontrollin romak dhe përfshijnë galeritë minerare romake të ruajtura më mirë se në çdo vend tjetër. Rreziku i shkatërrimit të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit shkaktoi një reagim kombëtar dhe ndërkombëtar, që zgjati deri në vitin 2015, kur qeveria rumune e anuloi projektin. Fushata kundër shfrytëzimit të minierave në Roşia Montana ishte në fakt një nga fushatat më të mëdha të organizuara ndonjëherë gjatë 20 viteve të fundit në Rumani për një çështje jo politike dhe ku u pa qartë qëndresa e shoqërisë civile kundër presionit të madh politik dhe ekonomik.

A. Një artikull nga Ionel Haiduc, Kryetar i Degës së Kluzhit të Akademisë së Shkencave të Rumanisë, mbi rreziqet e projektit të shfrytëzimit të minierave të Rosia Montanës, në vitin 2003

Aspektet ekonomike dhe shoqërore: Aspektet ekonomike dhe shoqërore: Është parashikuar që nxjerrja e arit dhe argjendit në zonën e Roşia Montana të zgjasë për një periudhë 17 vjeçare. Kjo nënkupton faktin që, në fund të projektit, kjo zonë do të përjetojë përsëri papunësinë, me një numër të madh të papunësh (dhe me një mjedis të shkatërruar - vide infra), sepse problemi shoqëror nuk ka zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme . [...]

Aspektet teknologjike: Teknologjia e përdorur në projektin e shfrytëzimit të këtyre minierave bazohet në nxjerrjen dhe veçimin e arit nga mineralet e imëta të tokës, duke e kulluar atë me një solucion të cianidit të natriumit. Përdorimi i kësaj teknologjie bazuar në kullimin e cianidit rrezikon seriozisht mjedisin. [...]

Aspektet ekologjike dhe të ruajtjes së mjedisit: Shfrytëzimi i puseve të hapura të minierës shkakton erozion të konsiderueshëm të mjedisit natyror, duke e prishur me të vërtetë peizazhin, duke lënë pas katër kratere të stërmëdhenj dhe mbetje të shumta të materialeve inerte [...]

Aspektet shkencore arkeologjike – historike: Zona ku do të zhvillohet projekti ka rrënoja arkeologjike me interes të madh shkencor, të cilat janë të veçanta jo vetëm në Evropë, por ndoshta dhe në botë. [...] Minierat e depozitave të arit do të shkatërronin tërësisht pjesën më të madhe të zonës arkeologjike, çka do të ishte një humbje e jashtëzakonshme dhe do ta bënte të pamundur krijimin e turizmit kulturor në këtë zonë, si një zgjidhje ekonomike afatgjatë. [...] Shkatërrimi i rrënojave arkeologjike, me një vlerë të tillë të paçmueshme, do të ishte një krim kulturor. [...]

Zgjidhje alternative: Nevojitet një alternativë, që të ofrojë zgjidhje afatgjatë për sa i përket problemit të papunësisë dhe varfërisë në gjithë zonën përreth. Një zgjidhje e tillë duhet të bazohet në burimet rigjeneruese të zonës, si p.sh. në turizmin kulturor, ku pasuria arkeologjike e zonës mund të jetë një vend me të vërtetë tërheqës. Shpallja e zonës si Park Arkeologjik i Trashëgimisë Botërore, nën mbrojtjen e UNESCO-s (gjë që është e realizueshme) do të rriste interesin turistik dhe do të hapte dyert për fondet e Bashkimit Evropian për vazhdimin e gërmimeve arkeologjike. [...]

Academica, nr. 13-14, prill-maj 2003, fq. 77-80.

B. Projekti Roşia Montană

1.346 ha tokë për t'u shfrytëzuar; 2.388 ha tokë e licencuar për t'u përdorur; 300 ha tokë të mbuluara nga pirgjet e mbetjeve të metaleve të rënda dhe cianideve, të cilat paraqesin një rrezik të përhershëm për jetën e rreth 6.000 banorëve, që jetojnë në zonat fqinje; 4 masive malore, që do të shpërthehen; 2.064 prona private do të zhvendosen; 975 shtëpi do të shkatërrohen nga të cilat 47 janë pjesë e trashëgimisë kombëtare; 7 kisha do të shemben, duke u hedhur

në erë ose do të mbulohen nga pirgjet e cianideve; 11 varreza do të zhvendosen; 12,000 ton cianide do të përdoren çdo vit (në tërësi 204,000 ton) dhe do të hapen vetëm 634 vende pune gjatë këtyre 17 viteve [...]

http://www.rosiamontana.org/ro/pe-scurt-despre-proiectul-minier, vizituar më 28.03.2015.

C. Grafiti "Salvaţi Roşia Montană" në Cluj-Napoca, Rumani



https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Salvati_Rosia_Montana.jpg, vizituar më 21.06.2016.

IV-11. Centrali bërthamor në Krsko, Sllloveni

Në vitet 1980-të, Sllovenia dhe Kroacia ndërtuan bashkërisht një central të energjisë bërthamore në Krsko. Përveç këtij reaktori bërthamor, Instituti Jozef Stefan në Lubjanë ngriti një reaktor tjetër bërthamor, që përdoret për qëllime kërkimore. Çështja e mbetjeve bërthamore mbetet një nga problemet më të rëndësishme dhe të diskutueshme. Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, Sllovenia ndërtoi disa depo, që do të shërbenin për magazinimin e këtyre mbetjeve bërthamore në vendin e quajtur Brinje, të cilat ishin të pajisura sipas standardeve më të fundit ndërkombëtare. Kushtet e punës në këto depo si dhe mjedisi, që i rrethon ato, konsiderohen krejtësisht të sigurta.



Magazinimi i mbetjeve bërthamore - Brinje.
ARAO - Agjencia sllovene për mbetjet radioaktive.

1. Bazohuni te shembujt rumunë dhe bullgarë, dhe përpiquni të ndiqni ndryshimet madhore, që kanë të bëjnë me tranzicionin në një shtet me ekonomi të kontrolluar, në një shtet me ekonomi të tregut të lirë.

2. Nxënësit organizohen në dy grupe ku secili grup do të diskutojë mbi zhvillimin si mënyrë për të përmirësuar jetesën, si dhe për rritjen e punësimit dhe të mirëqenies për shtetasit bullgarë dhe rumunë. Njëri grup mbron dhe përkrah masat, që ndihmojnë zhvillimin, ndërsa grupi tjetër mbron me forcë ruajtjen e mjedisit. Çfarë rreziqesh paraqiten për njerëzimin dhe për mjediset natyrore, dhe kulturore? Përpiquni të diskutoni dhe të ofroni zgjidhjet e duhura për të dy synimet e parashtruara: Çfarë i nevojitet një vendi për një zhvillim të qëndrueshëm? (Studioni me kujdes zgjidhjet dhe burimet). Pse mendoni se shtetet në tranzicion si Bullgaria apo Rumania janë të prekura nga kjo dukuri? Si veproi Sllovenia?

3. Shkruani një ese mbi organizimin e shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Evropën Juglindore.

IV.3. FINANCAT

IV-12. Certifikatat e pronësisë në Slloveni në vitin 1993

Gjatë tranzicionit nga sistemi socialist në sistemin kapitalist në Slloveni, gjatë vitit 1993 u përdorën certifikatat e pronësisë dhe vlera e përgjithshme e tyre kapi shifrën e 567 miliardë dollarëve. Pjesa më e madhe tyre, 58%, u shfrytëzuan nga kompanitë me investim të autorizuar, 32% u investuan në kompani të tjera, ndërsa 67 miliardë dollarë mbetën të paprekura. Çdo qytetar slloven u informua për hapjen e një llogarie bankare për certifikatën e pronësisë, në të cilën do të depozitohej një sasi e caktuar monetare, e ndarë në mënyrë të barabartë mes të gjithë qytetarëve sllovenë. Kjo certifikatë pastaj mund të arkëtohej në sportelet e bankave, gjë që nënkuptonte që çdo slloven mund të përfitonte të drejtën e pronësisë në kompanitë sllovene. Shumë kompani me emër dhe fonde investimi anonimë u përfshinë në luftën për certifikatat e qytetarëve. Fushatat reklamuese mundën të tërhiqnin investitorë të ndryshëm me anë të personaliteteve të njohura sllovene. Këtu mund të përmendim fituesin e medaljes së bronzit në lojërat olimpike Jure Kosir, i cili konsiderohej si një nga personazhet më të famshëm në gjysmën e parë të viteve 1990.



Përkthimi: Unë do t'ia besoj Atenës certifikatën time. Atena, mençuria që jep dividentë.

Gazeta "Gorenjski glas".

IV-13. Ëndrrat për t'u pasuruar brenda natës dhe mashtrimet e mëdha të viteve 1990-të: Skema piramidale "Karitas" dhe "Fondi Kombëtar i Investimeve" (FNI në gjuhën rumune)

A. "Karitas" - mashtrimi i parë rumun

[...] Një nga legjendat financiare të Clujit është padyshim skema e kompanisë piramidale "Karitas". Ajo u organizua nga kompania Karitas e Cluj-Napoca, e themeluar nga Ioan Stoica dhe filloi veprimtarinë e saj në vitin 1991. Kjo kompani premtonte se pas gjashtë muajsh do t'u paguante klientëve të saj një shumë parash tetë herë më të madhe se ajo e investuar. Zyrtarisht, "Karitasi" tërhoqi në lojën e saj afro 400,000 depozitues nga i gjithë vendi, të cilët investuan 1,257 miliardë lei (me vlerë 1 miliardë dollarë), por më 14 gusht të vitit 1994 falimentoi me borxhe që arrinin deri në 450 milionë dollarë.

Paratë shkuan drejt e në xhepat e udhëheqësve politikë të kohës, policëve, oficerëve të sigurimit, si dhe punonjësve të sistemit gjyqësor dhe të rendit publik. Disa nga politikanët i investuan këto para në krijimin e bizneseve të ndryshme dhe sot ata janë në krye të këtyre sipërmarrjeve, ose zotërojnë kompani të suksesshme. Për më tepër, komuna e Fanariotit i ofroi kompanisë një ndërtesë për zyrat qendrore; ndërsa themeluesit të "Karitasit", "babait" të saj, një shtëpi.

Që të siguronte garanci për biznesin e tij, Xhorxh Funar (një politikan i shquar nacionalist, që kishte qenë kryetar i Bashkisë së Kluzhit nga vitit 1992 deri në vitin 2004), së bashku me personalitete të tjera vendore, u shfaq në krah të Stoicës duke synuar ta paraqiste këtë të fundit si shpëtimtarin e xhepave të rumunëve. Kur gjithçka falimentoi dhe atyre që kishin investuar pará në "piramidë" nuk u mbeti më asgjë, u zbulua se e gjithë loja në të vërtetë kishte funksionuar pa të dhëna financiare e mbajtje llogarish, nuk ishin zbatuar rregullat e punës dhe se vetë Stoica nuk e kishte regjistruar pagën e tij. Në fakt, të gjitha të dhënat e kompanisë ishin ruajtur në disqe, të cilët u zhdukën pas hetimeve të prokurorëve.

[...] Gjyqi i "babait" të "Karitasit", Ioan Stoicës, që u zhvillua në gjykatat rumune, pati fund të lumtur për mashtruesin. Në vitin 2004, ai përfitoi nga miratimi i një urdhri të veçantë, që nuk është më në fuqi, - një statut me dispozita të veçanta [...]. Dosja e "Karitasit" konsiderohet si dosja më voluminoze, që është hetuar ndonjëherë në Rumani (jo më pak se 5 tonë dokumente). Megjithatë, "burokracia" piramidale i kushtoi Stoicës vetëm disa muaj burg, gjatë viteve 1994 dhe 1995. [...]

http://gazetadecluj.ro/stiri-cluj-investigatii/karitas-prima-escrocherie-romaneasca/, vizituar më 28.03.2015.

B. "Çështja "FKI"", arti i lakmisë

"Fondi Kombëtar i Investimeve" [FNI në gjuhën rumune] pasqyroi falimentimin më dramatik të një skeme piramidale, me mbi 300,000 depozitues të dëmtuar dhe pothuajse 400 milionë euro të humbura në mashtrime [...]

Po të kishte qenë një biznes privat i menaxhuar sipas rregullave, çdo gjë do të kishte shkuar mirë. Por gjatë vitit të fundit të ekzistencës, ""FKI"" tërhoqi në rrjetën e saj edhe shtetin – si nga pikëpamja financiare ashtu edhe nga ajo juridike, për shkak të lidhjes së saj me Bankën CEC (Banka e Depozitave dhe e Dërgesave). Shteti nuk ushtroi kontroll të rreptë mbi biznesin në të cilin ishte përfshirë, kështu që nga mesi i viteve 2000, kur Fondi falimentoi, ishin krijuar të gjitha kushtet që dëmet e mëdha të shkaktuara nga fondi t'i transferoheshin borxhit publik. [...]

Për më tepër, kur u lidh kontrata mes të dy palëve, ""FKI"" mori të drejtën për të përdorur logon e CEC. Një garanci e tillë nga shteti bëri që ""FKI"" të tërhiqte akoma më shumë qytetarë, të cilët u dyndën në sportelet e këtij fondi për të depozituar kursimet e tyre [...].

Pas falimentimit të "FKI"-së, u ndërmorën një sërë veprimesh ligjore për të përcaktuar se deri në ç'shkallë ishte e vlefshme kontrata midis Bankës CEC dhe "FKI"-së, që ishte lidhur në mënyrë të paligjshme dhe nëse kjo kontratë ishte e vlefshme, sa do të ishte vlera e dëmeve që "FKI" duhet të paguante [...] Gjykatat vendosën që kompensimet duhej të bëheshin në masën e vlerës së fundit të deklaruar, gjë që çoi në një faturë përfundimtare prej 7,480 miliardë lei (monedha rumune) - rreth 350 milionë dollarë.

Kjo shumë e madhe parash u konsiderua si borxh publik, duke shmangur në këtë mënyrë falimentimin e Bankës CEC dhe që nga ajo ditë e më pas, çdo vit gjatë periudhës 2004-2012 u caktuan shuma të mëdha parash nga buxheti publik në AVAS - Autoritatea pentru Valorificarea Activelor Statului [Autoriteti për Rimëkëmbjen e Aseteve Shtetërore] - për t'i paguar borxhet me këste. [...]

http://adevarul.ro/news/societate/afacerea-fniarta-lacomiei 1_50ada9b87c42d5a66398e077/index.html, vizituar më 28.03.2015.

IV-14. Protesta popullore në Rumani kundër falimentimit të "Fondit Kombëtar të Investimeve" ("FKI"), ku mbi 300,000 investitorë pësuan humbje (maj 2000)



Kujtime nga Burgu. Pjesa 1, http://www.libertatea.ro/detalii/articol/amintiri-din- puscarie-episodul-1-336739.html, vizituar më 21.11.2015.

IV-15. Skandali i skemave piramidale në Shqipëri, 1997

Gjatë viteve 1996-97, Shqipëria u trondit nga krijimi, rritja dhe rënia dramatike e disa firmave financiare të mëdha piramidale. Në janar të vitit 1997, dy skemat piramidale, "Sudja" dhe "Gjallica", deklaruan falimentimin duke shkaktuar trazira në popullsi. Menjëherë pas kësaj, skemat e tjera ndërprenë dhënien e pagesave. Marsi i vitit 1997 e gjeti Shqipërinë në kaos. Shumë efektivë nga forcat ushtarake dhe policore dezertuan dhe rreth 1 milion armë u plaçkitën nga depot e armatimeve. Vendi u përfshi nga anarkia dhe përfundoi në një situatë të ngjashme me atë të luftës civile ku u vranë rreth 2.000 njerëz. Në prill të atij viti një forcë humanitare ushtarake ndërkombëtare evropiane, e quajtur "Alba" (me rreth 7.000 ushtarë, nën drejtimin e Italisë) mbërriti në Shqipëri për të ndihmuar autoritetet shtetërore në rivendosjen e rendit. Në një situatë të tillë, filloi evakuimi i shtetasve të huaj dhe emigracioni në masë i shqiptarëve. Qeveria u detyrua të japë dorëheqjen. Skemat piramidale ishin një shenjë se tranzicioni që pasoi komunizmin në Shqipëri po merrte dy drejtime paralele: a) reforma të thella të ekonomisë së tregut, pas gjysmë shekulli nën zgjedhën e sistemit komunist radikal; dhe b) lulëzimi i një sektori ekonomik ilegal, që arriti kulmin me lulëzimin e skemave piramidale që pushtuan gjithë vendin. "VEFA Holding" ishte firma kryesore piramidale dhe simboli i gjithë dukurisë së këtyre firmave piramidale në Shqipëri.

A. Protestat kundër firmës piramidale "VEFA Holding" në shkurt të vitit 1997



Fotograf: Roland Tasho.

B. "Ku janë paratë tona?" Një artikull gazete, i datës 22 janar 1997

XHAFERRI MBYLL SPORTELET

Lajme kontradiktore për "Gjallicën". Policia: "U arrestua". Babai i tij: "Ai është në shtëpi". Listat mbeten enigmë. Kreditorët: "Gjeneral, na tregoni ku janë paratë tona?"

Nga firma piramidale "Sudja" dhe milionat e saj, tashmë kishin ngelur vetëm lista. Huadhënësja u arrestua dhe përfundoi prapa hekurave së bashku me të gjithë stafin e saj teknik, që për pesë vjet rresht kishte kaluar nëpër duart dhjetëra miliona dollarë.

Nga zyrat e firmës piramidale "Sudja" mbetën vetëm rrënojat dhe listat e gjata të klientëve që nuk u paguan kurrë. Ajo çka mbeti nga kjo firmë ishte një arkiv i çrregullt, që të sjell ndër mend tapitë e tokave dhe dokumentet e hipotekës që regjimi komunist gjeti pas Luftës së Dytë Botërore.

Fati i Sudes është burgu, por cili është fati i mijëra depozituesve, që i besuan asaj paratë e tyre? Atmosfera në fakt nuk duket aspak optimiste. Megjithatë, depozituesit nuk mund të bëjnë asgjë, veçse të shpresojnë dhe ta ngushëllojnë veten me deklaratat

e bëra nga Rrapush Xhaferri, që premton se do ta ndihmojë Suden. Por askush nuk mund të luajë me paratë dhe dokumentet e qytetarëve. Madje as Enver Hoxha nuk u soll në këtë mënyrë me të shpronësuarit, prandaj nuk ka më shpresë për qytetarët shqiptarë, pasi ata kanë humbur edhe kursimet e tyre të fundit në skemën piramidale "Sudja". [...]

"Gjeneral" Xhaferri u rrah dje
Dje, rreth orës 14.10 pranë degës së Fondacionit "Xhaferri" (afër poliklinikës "Gjallica"), një numër i madh kreditorësh rrethuan makinën e presidentit të Fondacionit "Xhaferri" z. Rrapush Xhaferri dhe tentuan ta përmbysin atë, pasi ai nuk po u kthente paratë e tyre. Në këtë moment, ndërhyri policia dhe truprojat e tij, duke e shpëtuar atë nga goditjet e depozituesve, që ishin në pritje të parave të tyre. Zemërimi i kreditorëve arriti kulmin kur u njoftuan se edhe Fondacioni "Xhaferri" kishte falimentuar dhe se kishte mbyllur të gjitha sportelet e tij në të gjithë vendin, duke humbur shpresat e mijërave njerëzve. "Gjenerali" u kthye në shtëpi pa spaletat e një gjenerali. [...]

"Xhaferri mbyll sportelet", Editorial, gazeta: "Koha jonë", 22 janar 1997.

Tapia është certifikata e pronësisë e çdo lloj pasurie të zotëruar nga një qytetar. Rrapush Xhaferri ishte oficer i ushtrisë komuniste shqiptare para viteve 1990-të. Ai u bë "i pasur" me skemat piramidale pas vitit 1990 dhe më pas njerëzit filluan ta thërrasin atë me ironi "gjeneral".
"VEFA Holding" u themelua nga Vehbi Alimuca, ish-oficer i ushtrisë komuniste shqiptare. Ai u burgos në vitin 1998, një vit pas mbylljes së skemave piramidale.

IV-16. Qiproja ishte një nga destinacionet e parave "të zeza" të Millosheviçit

[...] Greqia, Qiproja dhe Zvicra janë tre vendet në të cilat ish-presidenti jugosllav Sllobodan Millosheviç ka transferuar në mënyrë të paligjshme shuma të mëdha parash, kjo sipas njoftimit të faqes së parë të gazetës "*Washington Post*" të së dielës. Artikulli i gjatë pasqyron përpjekjet e bëra nga autoritetet jugosllave për të zbuluar një shifër që shkon nga 200 milionë dollarë deri në një miliardë dollarë, të paguara nga organizatat telefonike të Italisë dhe Greqisë, kompanisë publike të telefonisë celulare të Serbisë. [...] Gazeta pretendon se janë transferuar ilegalisht shufra ari dhe vë në dukje eksportin e paligjshëm të rreth 700 kilogramë ar gjatë tre viteve të fundit nga MCC, një kompani me seli qendrore në Qipro. "Zyrtarët perëndimorë dhe jugosllavë thonë se të gjitha hetimet e bëra deri tani i çojnë në një pikë takimi, në Qipro", ndërsa Prokurorja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Karla Del Ponte, dyshon se për këto transferta parash janë përfshirë një kompani ligjore qipriote si dhe disa politikanë të njohur qipriotë. Sipas gazetës "Washington Post", edhe pse autoritetet greke dhe ato qipriote nuk kontribuan në hetimet e bëra për zbulimin e fondeve, nënvizohet fakti se nën presionin e përpjekjeve të anëtarësimit në BE, qeveria qipriote filloi të bashkëpunojë. Ajo pranoi të mbyllte llogaritë bankare, që u përkasin nëntë kompanive që Gjykata Penale Ndërkombëtare i kishte lidhur me skemat e pastrimit të parave, duke përfshirë këtu dhe një llogari bankare ku ishin depozituar 56 milionë dollarë, që iu përkiste tre bashkëpunëtorëve të rangut të lartë dhe të lidhur ngushtë me Millosheviçin.

Gazeta Φιλελεύθερος [Philelefteros], 12 mars 2001.

IV-17. Tregu i Arizonës në Bosnjë dhe Hercegovinë



Arkivi i Oslobodjenja.

Tregu i Arizonës, i njohur nga vendasit si "Korridori", ndodhet rreth 15 km nga qyteti i Brçkos. Historia e tregut filloi pas mbarimit të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit të nënshkruar në nëntor të vitit 1995. Pas një vendimi të marrë nga forcat ndërkombëtare paqeruajtëse të IFOR-it, një zonë që nuk i përkiste askujt, pranë vijës së demarkacionit në atë kohë në zonën e Brçkos, u caktua si pikë takimi e çmilitarizuar. Menjëherë pas pastrimit të zonës nga minat, tezga tregu u ngritën njëra pas tjetrës dhe filloi tregtia midis të dy palëve, të cilat deri pak kohë më parë kishin qenë në luftë me njëra-tjetrën. Qarkullojnë shumë histori rreth kontrabandës, prostitucionit dhe veprimtarive të tjera kriminale, që lidhen me tregun e Arizonës, i cilësuar si qendër e zhvillimit të "ekonomisë gri". Në vitin 2001, qeveria e distriktit të Brçkos vendosi ta sistemojë tregun dhe shpalli zyrtarisht një tender publik ndërkombëtar për ndërtimin e një tregu të ri, i cili hapi dyert për tregtarët në vitin 2004.

IV-18. Kriza ekonomike e shkurtit të vitit 2001 dhe "tranzicioni i Turqisë drejt një programi të fortë ekonomik"



Askush nuk lejon që FMN të ndërhyjë në çështjet tona të brendshme ...
Sepse në fakt ata nuk kanë nevojë të na pyesin.
Oran, vëll. 2, fq. 217.

Qeveria e koalicionit trepalësh me në krye kryeministrin Bulent Ecevit, e përbërë nga Partia Demokratike e së Majtës (Demokratik Sol Parti - DSP) e Bulent Ecevit, Partia e Lëvizjes Kombëtare (Milliyetçi Hareket Partisi - MHP) e Devlet Bahçelit dhe nga Partia e Vatanit (Anavatan Partisi - ANAP) e Mesut Y?lmaz, u përball me pasojat e padëshiruara të krizës aziatike të vitit 1998, si dhe me dëmet materiale të shkaktuara nga tërmeti i gushtit të vitit 1999 në Marmara (që arrinin një vlerë, që shkonte nga 11 deri në 20 miliardë dollarë). Kështu, në nëntor të vitit 1999, Turqia nënshkroi një marrëveshje emergjente me FMN dhe filloi një regjim këmbimi të fiksuar, që mbështetej në një program reformash strukturore. Megjithatë, populizmi dhe korrupsioni i papërmbajtur i klasës drejtuese politike, penguan realizimin e një pjese të mirë të reformave strukturore që iu premtuan FMN-së. Në dimrin e viteve 2000-2001, Banka Qendrore e Turqisë u përpoq ta mbante kursin e këmbimit të qëndrueshëm, pasi rezervat e saj në dollarë u pakësuan. Në shkurt të vitit 2001, një diskutim me tone të larta midis Presidentit Ahmet Nexhdet Sezer dhe Kryeministrit Bulent Eçevit, shkaktoi një krizë besimi politik dhe shitjen në masë të lirës turke (monedha turke) po atë ditë, gjë që çoi në një zhvlerësim prej 40% të saj. Për të përballuar krizën, qeveria i bëri thirrje Kemal Dervies, ekonomistit të njohur turk, që në atë kohë ishte dhe zëvendëspresidenti i Bankës Botërore, përgjegjës për rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikën e Veriut, që të kthehej në Turqi dhe të merrte postin e Ministrit të Ekonomisë pasi i garantoheshin edhe kompetenca të plota për fillimin e një programi reformash. Derviesi e pranoi ofertën e parashtruar dhe gjatë mandatit të tij ministror, ai ndërmori një reformë të quajtur "Tranzicioni i Turqisë drejt një programi të fortë ekonomik". Bazuar në masat shtrënguese, ndryshimet ligjore si dhe në krijimin e organeve autonome për rregullimin e ekonomisë, programi u konsiderua si tepër i suksesshëm. Megjithatë, zbatimi i reformave të vështira strukturore u kushtoi partive të koalicionit qeverisës gjithë kapitalin e tyre politik. Në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2002, duke përfituar nga ligji sipas të cilit partitë kishin nevojë për 10% të votës së përgjithshme për të hyrë në Parlament, AKP i hoqi nga pushteti partitë e qendrës së krahut të djathtë dhe të majtë duke i lënë jashtë pushtetit qeverisës, dhe mori në dorë kontrollin e politikës turke. Si rezultat i këtij programi dhe kushteve të favorshme të kandidaturës së Turqisë për t'u anëtarësuar në BE, si dhe likuiditetit të periudhës pas 11 shtatorit të viteve 2000, Turqia mundi të arrinte një normë rritje të qëndrueshme dhe të fortë duke iu bërë qëndresë efekteve të padëshirueshme të krizës financiare të vitit 2008 dhe më vonë paqëndrueshmërisë që pllakosi rajonin pas Pranverës Arabe. Ka pasur një diskutim të vazhdueshëm se të kujt janë meritat për suksesin ekonomik të vendit: ndërkohë që specialistët pro-qeveritarë argumentojnë se ishin pikërisht AKP dhe Erdogani, ata që duhej të vlerësoheshin për ecurinë ekonomike të vendit, ndërkohë që të dhënat e opozitës sugjerojnë se AKP dhe Erdogani vetëm korrën sukseset e programit të reformave strukturore, pasi aspektet më të mprehta politike të tyre ishin zgjidhur nga qeveria e mëparshme.

→

Si e percepton karikaturisti rolin dhe përfshirjen e FMN-së në ekonomitë shtetërore? A mund të sillni shembuj të tjerë? Diskutoni sesi një situatë e dobët financiare mund të dëmtojë sovranitetin e një vendi.

IV-19. Greqia i bashkohet eurozonës në vitin 2001. Kryeministri Simitis prezanton kartëmonedhat e para të monedhës EURO

Greqia miratoi monedhën euro në vitin 2001. Në foto, kryeministri Simitis prezanton kartëmonedhat e para të euros. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij të parë (1996-2000) Kryeministri Kostas Simitis, udhëheqës i partisë së PASOK-ut, pasardhës i Andreas Papandreut, përcaktoi si objektivin e tij kryesor anëtarësimin e Greqisë në Unionin Ekonomik dhe Monetar (UKM) të BE. Ky angazhim u konsiderua thelbësor për forcimin e pozitës së Greqisë në Evropë dhe në mbarë botën. Për të përmbushur këtë objektiv dhe në kuadër të modernizimit, qeveria e kryeministrit Simitis ndërmori një sërë masash për zhvillimin dhe stabilizimin e ekonomisë.



ΕΡΑ/ΑΠΕ-ΜΠΕ/MILOS BICANSKI.


IV-20. Rruga drejt krizës ekonomike greke

Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, ekonomia greke filloi të përjetonte gjithnjë e më shumë përkeqësimin e çekuilibrimeve financiare që, së bashku me krizën financiare globale, çoi në krizën ekonomike të viteve 2009-2010. Edhe pse deri në vitin 2007, Greqia pati një normë mesatare rritjeje më të lartë sesa partnerët e saj në BE-15, në të njëjtën kohë ajo pësoi rritje alarmante të deficitit të llogarisë rrjedhëse, që kapi majat gjatë viteve 2007 dhe 2008. Ndërkohë në fillim të viteve 2000 u vu re një përmirësim i gjendjes financiare. Suficitet primare të grumbulluara në vitet 1990-të u pakësuan dhe shumë shpejt u shndërruan në deficite primare. Në veçanti, të ardhurat nga taksat pësuan një rënie të dukshme. Si përfundim, përpjekja e Ministrit të Punës për reformimin e sistemit kombëtar të sigurimeve në vitin 2001 dështoi, ashtu siç dështoi dhe reforma e shërbimit shëndetësor kombëtar një vit më vonë. Pas vitit 2006, financat publike në Greqi u përkeqësuan akoma më shumë dhe në vitin 2009 deficiti i sektorit publik doli jashtë kontrollit. Në të njëjtën kohë, si normat e inflacionit, ashtu edhe kostot nominale të punës për njësi, treguan mospërputhje të vogla, por sistematike, krahasuar me ato të vendeve të tjera të eurozonës, të cilat goditën konkurrencën e produkteve greke. Burimet në vijim paraqesin të dhëna mbi inflacionin, deficitin e sektorit publik dhe deficitin e llogarisë rrjedhëse.

A. Inflacioni në Greqi dhe në BE-17. Ndryshimet vjetore në Indeksin e Çmimeve të Konsumit

Grafiku tregon se normat e inflacionit në Greqi ndryshonin nga ato të partnerëve të saj në BE-17 gjatë viteve që çuan drejt krizës financiare. Kjo erdhi si rezultat i faktorëve të brendshëm të inflacionit: konsumi i tepërt dhe kërkesa për investime, rritja e kostove nominale të punës për njësi (me paga që pësojnë rritje më shpejt se produktiviteti) dhe rritjet oportune në marzhet fitimprurëse. Në periudhën e viteve 2007-2008, inflacioni i ekonomisë greke u thellua: prodhimi dhe furnizimi nuk mund të përballonin dot kërkesën.

CPI – Greqi



CPI – EU-17 IÇK = Indeksi i Çmimeve të Konsumit
Të dhënat e Eurostatit në C. Iordanoglou, Historia ekonomike e Greqisë pas luftës civile, dorëshkrim i pabotuar, Athinë.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) tregon se si niveli aktual i çmimeve të një shporte të caktuar mallrash dhe shërbimesh ka ndryshuar në raport me nivelin e çmimeve të së njëjtës shportë mallrash dhe shërbimesh, që kanë mbizotëruar në periudha të caktuara në të kaluarën. IÇK pasqyron ndryshimet që ka pësuar kostoja e jetesës. (http://www.businessdictionary.com/definition/consumer-price-index-CPI.html, vizituar më (21.06.2016).

B. Tërësia e deficitit të sektorit publik dhe suficiti primar ose deficiti si përqindje e PBB-së, gjatë viteve 1999-2009

Viti	Deficiti i përgjithshëm i sektorit publik si % e PBB-së	Suficiti publik primar (+) ose deficiti (-) si % e PBB-së
1999	- 3.1	+ 4.3
2000	- 3.7	+ 3.7
2001	- 4.5	+ 2.0
2002	- 4.9	+ 0.7
2003	- 5.7	- 0.7
2004	- 7.6	- 2.6
2005	- 5.5	- 1.0
2006	- 5.9	- 1.5
2007	- 6.7	- 2.2
2008	- 10.2	- 5.4
2009	- 15.2	- 10.1

Deficiti i përgjithshëm i sektorit publik (suficiti) është diferenca midis të ardhurave të përgjithshme të Qeverisë minus shpenzimet e përgjithshme të saj. Deficiti primar (suficiti) janë të ardhurat e përgjithshme të Qeverisë minus shpenzimet e saj duke përjashtuar pagesat e interesit.

C. Deficiti i llogarisë rrjedhëse si përqindje e PBB-së, vitet 1999-2009

Viti	Deficiti i llogarisë rrjedhëse si % e PBB-së	Viti	Deficiti i llogarisë rrjedhëse si % e PBB-së
1999	- 5.6 %	2005	- 7.6 %
2000	- 7.8 %	2006	- 11.4 %
2001	- 7.2 %	2007	- 14.6 %
2002	- 6.5 %	2008	- 14.9 %
2003	- 6.5 %	2009	- 11.2 %
2004	- 5.8 %		

Banka e Greqisë dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).

Llogaria rrjedhëse paraqet rezultatin përfundimtar të të gjitha transaksioneve rrjedhëse të një shteti me pjesën tjetër të botës. Është dallimi midis të ardhurave që merr shteti (nga të gjitha burimet) nga jashtë, minus të gjitha pagesat që ky shtet ka për të bërë jashtë shtetit. Nëse pagesat janë më të mëdha se të ardhurat, shteti ka deficit të llogarisë rrjedhëse. Deficiti duhet të financohet nga një lloj huamarrjeje e jashtme: ose nëpërmjet hyrjes së kapitalit të huaj (të tilla si investime të huaj të drejtpërdrejta; hyrje për blerjen e obligacioneve; aksione dhe pasuri të paluajtshme vendase), ose nëpërmjet huave të siguruara nga institucionet e huaja.

IV-21. Futja e Euros në Malin e Zi

Monedha e vetme vendase e Malit të Zi ka qenë 'perper', e cila u fut në përdorim nga viti 1906 deri në vitin 1918. Që nga ajo kohë e më pas, Mali i Zi, si pjesë e ish-Jugosllavisë, përdori monedhën-dinarin jugosllav dhe vetëm në nëntor të vitit 1999 e ndryshoi atë, dhe futi në përdorim markën gjermane. Po edhe Marka gjermane u zëvendësua me euron në vitin 2002, edhe pse Mali i Zi nuk ishte as shtet i pavarur, dhe as shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Banka Qendrore Evropiane nuk pati ndonjë kundërshtim për futjen e njëanshme në përdorim të euros si monedhë zyrtare e Malit të Zi, por Komisioni Evropian shprehu disa herë pakënaqësinë e tij për këtë çështje dhe Komisioni i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të këtij vendi me BE-në deklaroi se përdorimi i njëanshëm i euros ishte i papranueshëm. Megjithatë, Komisioni nuk e kundërshtoi përdorimin e euros në Malin e Zi, për shkak se fusha e veprimi të ekonomisë së vendit në raport me ekonominë e eurozonës ishte e vogël: nuk ekzistonte rreziku i kërcënimit të stabilitetit të euros. Në dhjetor të vitit 2010, Mali i Zi u pranua shtet kandidat për anëtarësim në BE dhe vendimi përfundimtar për përdorimin e euros do të vendoset nëpërmjet negociatave të pranimit.

A. Ligji për Bankën Qendrore të Malit të Zi, 2 nëntor 2000

Neni 1 - Banka Qendrore është një organizatë e pavarur e Republikës së Malit të Zi dhe është i vetmi institucion përgjegjës për politikën monetare, për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi bankar të qëndrueshëm dhe për kryerjen e transaksioneve efektive të pagesave brenda Republikës.

Politika monetare e Bankës Qendrore bazohet në DEM/ Markën gjermane / si njësi monetare, si mjet pagese dhe si monedhë e rezervës, deri në futjen e EURO-s.

"Gazeta Zyrtare" e Republikës së Malit të Zi, nr. 52/2000, 3 nëntor 2000, fq. 497.

B. Këshilli i Bankës Qendrore të Malit të Zi vendos për procedurën e konvertimit në Euro, 27 dhjetor 2001

Udhëzime për mënyrën dhe procedurën e konvertimit e Markës gjermane dhe monedhave të tjera në EURO.

[...] 3. Subjektet fizike mund ta konvertojnë DEM-ën (Markën gjermane) dhe monedha të tjera në EURO, në bankat që janë miratuar nga Banka Qendrore e Malit të Zi, si dhe në vetë Bankën Qendrore të Malit të Zi, si më poshtë:

– qytetarët e Malit të Zi mund ta bëjnë konvertimin në bankat e nivelit të dytë dhe në Bankën Qendrore;

– personat, që nuk janë shtetas të Republikës së Malit të Zi, lejohen ta bëjnë konvertimin në bankë;

4. Një person, pa qenë e nevojshme të hapë një llogari bankare, mund të konvertojë deri në 10,000 DEM ose një monedhë tjetër me të njëjtën kundërvlerë.

5. Llogaritë bankare në DEM dhe monedha të tjera, do të konvertohet automatikisht më 1 janar 2002, pa komision.

6. Konvertimi do të kryhet sipas një kursi këmbimi të përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane.

7. Banka Qendrore do të konvertojë DEM gjatë periudhës 1 janarit 2002 - 30 qershorit 2002.

"Gazeta Zyrtare" e Republikës së Malit të Zi, nr. 64/2001, 29 dhjetor 2001, fq. 659.

IV-22. EURO në Sllloveni, viti 2007



Përkthimi: Lëviz dhe pak më mbrapa!
Arkivat e gazetës "Delo".

Më 1 janar 2007, Sllovenia ishte vendi i parë i ish-Bllokut të Lindjes, që iu bashkua eurozonës. Megjithatë, jo të gjithë ishin dakord për miratimin e futjes në përdorim të monedhës së euros. Me anëtarësimin në BE, Sllovenia gëzonte të drejtën që monedhat e saj euro të mbanin simbole kombëtare sllovene. Sllovenia, me vendosjen e Gurit të Princit në monedhën me vlerë dy centshe, shkaktoi përsëri përplasje me Austrinë, njëlloj siç veproi me bonot e thesarit të hedhura në qarkullim në vitin 1991.

1. A është autori i karikaturës pro apo kundër miratimit të euros? Parashtroni argumente për përgjigjen tuaj.

2. Krahasojeni me pikën I-21. Pse mendoni se Sllovenia vendosi dy herë të fuste në qarkullim një simbol të kundërshtuar nga Austria?

IV.4. DEMOGRAFIA DHE MIGRIMI

IV-23. Niveli i përgjithshëm i lindjeve sipas vendeve në vitet 2000-2009

Shteti	Vit									
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Bullgaria	1.27	1.24	1.21	1.23	1.29	1.31	1.38	1.42	1.48	1.57
Republika Çeke	1.14	1.15	1.17	1.18	1.23	1.28	1.33	1.44	1.50	1.49
Gjermania	1.38	.	.	1.30	1.40	1.30	1.34	1.37	1.38	1.35
Irlanda	1.90	1.96	1.98	1.98	1.95	1.88	1.91	2.03	2.10	2.00
Greqia	1.27	1.25	1.27	1.29	1.31	:	1.38	1.42	1.51	1.52
Spanja	1.23	1.24	1.26	1.31	1.33	1.35	1.36	1.39	1.46	1.39
Franca	1.89	1.90	1.88	1.89	1.92	1.94	2.01	1.98	2.01	1.99
Italia	1.26	1.25	1.27	1.29	1.33	1.32	1.35	1.37	1.42	1.41
Qiproja	1.60	1.60	1.50	1.50	1.49	1.40	:	1.39	1.46	1.51
Hungaria	1.33	1.31	1.31	1.28	1.29	1.32	1.35	1.32	1.35	1.33
Austria	1.36	1.33	1.40	1.38	1.42	1.41	1.41	1.38	1.41	1.39
Polonia	1.37	1.32	1.25	1.22	1.23	1.24	1.27	1.31	1.39	1.40
Portugalia	1.56	1.46	1.47	1.44	1.40	1.41	1.36	1.34	1.37	1.32
Rumania	1.30	1.20	1.30	1.30	1.30	1.30	1.31	1.29	1.35	1.37
Sllovenia	1.26	1.21	1.21	1.20	1.25	1.26	1.32	1.38	1.53	1.53
Mbretëria e Bashkuar	1.84	1.63	:	:	1.77	1.79	1.85	1.90	1.96	1.94
Norvegjia	1.85	1.78	1.75	1.80	1.83	1.84	1.90	1.90	1.96	1.98
Turqia	2.27	2.25	2.24	2.22	2.21	2.19	2.18	2.15	2.14	2.12
Rusia	1.21	1.25	1.30	1.31	1.33	1.29	1.30	1.41	1.49	1.54

http://alternativi.unwe.bg/alternativi/br49/03.pdf, vizituar më 21.06.2016.



Shpjegoni sa është niveli i përgjithshëm i lindjeve. Krahasoni të dhënat statistikore të çdo vendi në tabelë dhe gjeni tendencat, ngjashmëritë dhe dallimet.

IV-24. Rënia e nivelit të lindjeve në Rumani (1989-2006)


Viti	Niveli i rritjes (për 1,000 banorë)
1989	5.5
1992	-0.2
1999	-1.4
2002	-2,5
2006	-1,8

"Statistikat vjetore të Rumanisë", 1990, fq. 51; "Statistikat vjetore të Rumanisë", 2000, fq. 52-54, 64-65; "Statistikat vjetore të Rumanisë", 2007, fq. 40, 52-53.

IV-25. Migrimi ndërkombëtar i bullgarëve


Emigrimi i bullgarëve jashtë vendit, para dhe pas vitit 1989, nxitur nga faktorë ekonomikë, politikë ose faktorë të tjerë, mund të pasqyrohet jo vetëm nga evidentimi i numrit të emigrantëve (shikoni vëll. 1, kapitulli VI-2), por edhe nga të dhënat e personave ose grupeve, që kthehen në atdhe (shikoni gjithashtu vëll. 1, kapitulli VI-3, VI-5). Sipas statistikave zyrtare, brenda viteve 1980-2011, 233,463 persona ndërruan adresat e tyre të banimit nga jashtë vendit me një adresë në Bullgari. 91.9% e tyre ishin shtetas bullgarë, që u kthyen në Bullgari pas emigrimit jashtë vendit. Gati 73% e tyre kishin banuar jashtë Bullgarisë nga një deri në pesë vite; 17.1% nga këta kishin banuar nga gjashtë deri në dhjetë vjet jashtë vendit dhe vetëm 7.2% kishin banuar jashtë më shumë se 11 vjet. 57.5% e numrit të përgjithshëm të emigrantëve ishin meshkuj. Përqindja më e lartë i përkiste shtetasve bullgarë, që kishin qëndruar në Federatën Ruse (16.1%), pasuar nga personat që u kthyen nga Spanja (9.3%), nga Gjermania (9.2%), nga Greqia (9.1%) etj. Para vitit 1989, niveli i emigrimit sezonal të punëtorëve bullgarë në BRSS ishte shumë i lartë. Pas ndryshimeve rrënjësore në fushën ekonomike dhe shoqërore, filloi emigrimi në masë drejt Evropës Perëndimore, SHBA-së dhe Kanadasë. Emigrimet ekonomike sezonale vazhduan, po këtë herë drejt Evropës Perëndimore, Turqisë dhe Greqisë. Sipas statistikave, pas vitit 1989 përafërsisht dy milionë shtetas bullgarë (kryesisht të arsimuar dhe aktivë, siç pasqyrohet në kapitullin IV-26), u shpërngulën përkohësisht ose përgjithmonë jashtë vendit. Si në shumicën e vendeve të Evropës Lindore, ky emigrim pati një ndikim të rëndësishëm, të padëshirueshëm, në prirjet demografike. Në vitin 1989, popullsia e Bullgarisë ishte pothuajse nëntë milionë banorë; në vitin 2001 ishte 7,973,671 banorë dhe në vitin 2011 numri ajo në 7.364.570 banorë. Grafiku i kapitullit IV-26 jep të dhëna të rëndësishme mbi mbështetjen financiare të emigrantëve në ndihmë të familjeve ose të afërmve të tyre që jetonin në Bullgari, si dhe investimet e tyre në ekonominë kombëtare.

IV-26. Paraqitja grafike e numrit të shtetasve bullgarë sipas arsimit të kryer, që kanë jetuar jashtë shtetit (2011)



http://www.nsi.bg/census2011/PDOCS2/Census2011?nal_en.pdf, vizituar më 21.06.2016.

IV-27. Transfertat e parave në Bullgari, nga të mërguarit bullgarë që jetojnë përgjithmonë jashtë vendit, arrinin shifrën e miliona eurove në muaj



Banka Kombëtare e Bullgarisë http://www.nsi.bg/sites/default/files/files/pressreleases/ Census2011final.pdf, vizituar më 21.06.2016

IV-28. Fluksi i emigrantëve dhe refugjatëve në Greqi, viti 1998

Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, Greqia gjithnjë e më shumë e ndryshoi pozitën e saj; ajo nga një vend që "eksportonte" njerëz u shndërrua në një vend pritës, ku vërshuan mijëra emigrantë ekonomikë nga vendet ish-komuniste të Evropës (shih tabelën në kapitullin IV-28A), si dhe refugjatë nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore. Duke iu referuar historisë së vetë grekëve si refugjatë dhe si emigrantë, grafiti në një mur të Athinës, paraqet dyzimin e shoqërisë vendase pritëse kundrejt të sapoardhurve.


A. Pasqyra sipas kombësisë së emigrantëve të cilëve iu është dhënë "karta e bardhë" greke

Vendi i origjinës	% e shumës së përgjithshme
Shqipëria	65.00
Bullgaria	6.80
Rumania	4.60
Pakistani	2.90
Gjeorgjia	2.00
India	1.70
Egjipti	1.70
Filipinet	1.40
Moldavia	1.20
Vendet e tjera (me më pak se një për qind)	7.80

(Shuma e përgjithshme: 371,641) Ιστορία του Νέου Ελληνισμού 1770-2000 ["Historia e helenizmit modern"], 2003, vëllimi l. 10, fq. 329.

B. Një grafiti në Athinë që dënon racizmin ndaj emigrantëve

Grafiti iu referohet refugjatëve grekë të ardhur në Greqi nga Turqia në vitin 1923 dhe emigrimit grek drejt Perëndimit të industrializuar pas përfundimit të luftës.



Përkthimi: Gjyshërit tanë ishin refugjatë, prindërit tanë ishin emigrantë, ndërsa ne vetë jemi racistë. http://www.logiosermis.net/2012/03/blog-post_5655.html#.VRkWtl6wccQ, vizituar më 21.06.2016.

1. Lexoni shtjellimin e problemit në kapitullin IV-28: Çfarë domethënie ka ky grafit për ju? Pse është e rëndësishme për grekët (dhe për të gjithë shtetasit të kombësive të tjera), që ta kujtojnë dhe të kuptojnë historinë e dhimbshme të brezave paraardhës për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë?
2. Përgatisni një projekt për krijuesit e fushave të artit (në fushën e letërsisë, kinematografisë, fotografisë, grafitëve dhe muzikës) duke synuar paraqitjen e gjendjes së emigrantëve dhe refugjatëve në vendin tuaj dhe në vendet e Evropës Juglindore.

IV-29. Pjesë e shkëputur nga një intervistë biografike e një emigranti bullgar për integrimin jashtë vendit

Ju çdo gjë e filloni nga e para dhe si arrini mbërrini në njëfarë pike, e rifilloni përsëri nga fillimi ...

Intervistë me Şukranin, lindur në vitin 1975, agjent i pasurive të patundshme nga Razgradi.

Duket se bashkëkombësit tanë, ashtu si të gjithë bullgarët, duhet ta fillojnë çdo gjë nga e para, dhe prapë, kudo që të shkojnë duhet ta rinisin nga fillimi. Pavarësisht nëse janë bullgarë, turq apo ciganë. Disa do të shkojnë në Belgjikë, një pjesë tjetër në Spanjë dhe ca të tjerë në Holandë - por të gjithë, pa përjashtim duhet ta fillojnë jetën nga e para. Ata vendosin të kthehen pasi nuk e përballojnë dot më jetesën atje dhe pastaj shkojnë në Turqi, ku çdo gjë e fillojnë përsëri nga e para; ata kthehen nga Turqia dhe shkojnë në një vend tjetër, duke u endur vazhdimisht nga një vend në tjetrin, në kërkim të një jete më të mirë. Kështu, shumë prej të njohurve tanë shkojnë në Spanjë për të mbledhur portokaj, ata qëndrojnë aty deri në fund të sezonit dhe pastaj shkojnë në Francë për të vjelë rrush ose për t'u marrë me çfarëdolloj pune tjetër dhe çdo gjë e nisin nga e para. Kohët e fundit, një pjesë e mirë e tyre shkojnë në Qipro për të punuar si kuzhinierë, si ndihmës kuzhinierë, si pastrues nëpër hotele, e kështu me radhë. Dhe ata fillojnë çdo gjë nga e para. Ju çdo gjë e filloni nga e para dhe si arrini në njëfarë pike, dhe e rifilloni përsëri nga fillimi. Por shumë shtetas bullgarë, miq dhe të njohurit tanë, tashmë po jetojnë në Belgjikë - ata kanë vendosur të qëndrojnë atje, dhe janë pajisur me dokumentet e nevojshme. Të paktën 40-50% e këtyre emigrantëve kanë blerë atje apartamente dhe shtëpi me kredi, dhe dëshirojnë që fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë [...] Në Belgjikë fëmijët përkrahen që ta jetojnë fëmijërinë e tyre dhe u kushtohet shumë kujdes. Jeta është më e lehtë dhe fëmijëve ju pëlqen jetesa atje. Përveç kësaj, ata atje kanë mundësi të mësojnë një, dy ose tre gjuhë të huaja dhe kanë shumë përparësi të tjera. Çdo gjë është e organizuar siç duhet: - shërbimet sociale, tregu i punës, praktikat e përgjithshme. Ne shpenzojmë shumë para për ilaçet në Bullgari. Kam jetuar në Belgjikë për dhjetë vjet, por

asnjëherë nuk më është dashur të paguaj një shumë të tillë parash për kujdesin shëndetësor të fëmijës tim, pasi fëmija im atje kishte sigurim shëndetësor.

Kjo intervistë u zhvillua në vitin 2008, në kuadër të programit hulumtues MICROCON [Një analizë e nivelit mikro të konflikteve të dhunshme].

IV-30. Emigrantët rumunë në Paris

"Ne ishim 70 vetë që në dimrin e vitit 1997 u larguam nga fshati ynë", thotë Pop Toader, i biri i Pi?oaies nga fshati Tar?ol?, ?ara Oasului, i cili ka punuar si bojaxhi në Paris për 15 vjet rresht." Një natë dimri, vijon rrëfimin ai, të gjithë siç ishim kaluam kufirin me një furgon, që ngjante me një thertore. Udhëtonim ngjitur me njëri-tjetrin në mënyrë që të linim pak hapësira midis nesh. Ishte janar, ftohtë, kishim frikë se do të ngrinim, por në furgon pothuajse u asfiksuam. U përpoqëm të ndiznim një cigare, por nuk kishim as çakmak. Pothuajse ikëm nga kjo botë. Atë moment, unë u përkula disi dhe një fqinji im hipi mbi shpatullat e mia, ndërsa dy udhëtarë të tjerë e mbanin që të mos rrëzohej. Pasi arriti një lloj ekuilibri, ai, me anë të një thike, filloi të shpojë tavanin e furgonit derisa arriti të hapte një vrimë. Sa me fat që ishim. Shpëtuam. Përndryshe ne nuk do të kishim mbërritur të gjallë në Paris. A mendoni se pasi arritëm atje shpëtuam? Përkundrazi, gjendja jonë atje ishte më e vështirë se sa arratia nga vendi ynë. Të paktën deri atje u shoqëruam dhe drejtuam nga të tjerët, po më pas? -Zbrisni dhe shkoni, duhet t'ia dilni vetë mbanë tani na thanë! Po ku të shkonim se? Nga t'ia mbanim? Në cilin krah? Gjuhën vendase nuk e flisnim; njeri që të na priste atje nuk kishim. Nuk kishim asnjë plan. Kështu ishte në fillim." [...]

Cotrosi nuk e flet shumë mirë gjuhën frënge, madje as edhe pas 17 vitesh punë në Paris, por nuk e ka problem fare këtë gjë. Ai madje tregon, duke qeshur, se si njëherë shkoi për vizitë te mjeku, që i kishte thënë të hidhte disa pika ilaçi në sy, por ai, duke mos e ditur mirë gjuhën, nuk e kuptoi tamam atë, që i ishte thënë mjeku dhe e piu ilaçin. Dhe në fund të fundit, për çfarë i duhet gjuha frënge atij? Përgjegjës ka djalin e tij të vogël, që sapo i ka mbushur 23 vjeç dhe drejton një kompani të vogël ndërtimi, e cila është mjaft e suksesshme. Ai punon 10 orë në ditë me një grup punëtorësh që vijnë nga Oasi; ai të dielat i kalon me familjen ose është i ftuar nga fqinjët e vendlindjes së tij, të cilët gjithashtu jetojnë në Paris. Për atë, aventura tashmë ka mbaruar. Cotrosi është pjesë e brezit bashkëkohor modern të emigracionit ekonomik nga Rumania. Pas rënies së komunizmit, kur sistemi i ekonomisë së centralizuar në Rumani mori fund dhe mundësi të punësimit në vend pothuajse nuk kishte, një pjesë e banorëve të fshatit Certeze u detyruan të marrin rrugën e emigracionit përtej kufirit në kërkim të vendeve të punës. Cotrosi ishte një prej tyre. Pas këtij largimi të parë, brenda disa vjetëve, një përqindje e madhe e popullsisë aktive nga ?ara Oasului e kaloi kufirin në mënyrë të paligjshme.

Pasi u përpoqën disa herë të gjenin punë në vende të ndryshme të Evropës, nga fillimi i viteve 1990-të, pjesa më e madhe e tyre u grupuan në Francë, në Paris. [...] Megjithatë, e vetmja gjë që dëshiron Cotros është të rikthehet në vendlindjen e tij. Ai do të qëndrojë edhe ca vite në Paris "deri sa të mbushë vitet e nevojshme të punës për daljen në pension" dhe më pas planifikon të rikthehet në Certeze, ku ëndërron të ngrejë një fermë fazanësh. [...]

Fragmente të shkëputura nga historitë e mbledhura në projektin e titulluar " Mandrieşibeton" [Krenaria dhe Betoni]; Http://www.mandriesibeton.ro/povestea.php, vizituar më 28.03.2014.

IV-31. Epirotët Veriorë (anëtarë të minoritetit grek) që emigruan nga Jugu i Shqipërisë në Greqi

Romani rrëfen historinë e një familjeje greke nga Epiri i Veriut/ Jugu i Shqipërisë prej vitit 1943 deri në fillim të viteve 1990-të. Në fragmentin e shkurtër që vijon më poshtë, një anëtar i kësaj familjeje rrëfen për ditët e tyre të para në Greqi pas hapjes së kufijve.

Unë me vëllanë u larguam nga fshati dhe shkuam për të gjetur babanë, që jetonte në Filat. Ishim të vegjël kur ishin mbyllur kufijtë. Babai ynë ka qenë tregtar shëtitës, por për shkak të sistemit komunist marrëdhëniet tona u ndërprenë. Ne shkuam së bashku në Filat dhe menduam të takonim një vendas. Babai ynë kishte një dyqan në atë kohë, kështu që i morëm dyqanet radhë për ta gjetur. Çfarë pamje shtrihej para syve tanë. Gjithçka që kishim ëndërruar ndonjëherë: pajisje elektrike, veshje, fruta dhe perime të çdo lloji. Nuk ngopnim dot sytë me të parë. Më në fund, arritëm ta gjenim babanë dhe u përqafuam shumë e me mall me njëri-tjetrin, saqë kalimtarët aty pranë u përlotën, dhe vetë gurët derdhën lot.

Më pas, dolëm nëpër dyqanet aty rrotull, por të gjithë i kthenin kurrizin monedhës tonë lekut. Në mbrëmje u mblodhëm përsëri në sheshin e fshatit. Ishim aq shumë të ardhur, sa s'kishe ku të hidhje kokrrën e mollës. Banorët e fshatit hapën një kuzhinë, ku shërbehej supë për të sapoardhurit. Ne iu bashkëngjitëm radhës, por ajo sa vinte dhe dyfishohej. Me sa dukej, nëna jonë nuk do të arrinte të merrte gjë. Edhe shumë të tjerë nuk morën gjë fare. Ne filluam të bërtisnim, por vendasit thirrën policinë që mbërriti aty me shkopinj gome dhe mburoja. Policët filluan të godisnin fort parmakët me shkopinjtë e gomës. Ne i mbushëm nga frika.

Dolëm të gjenim ndonjë punë. Një nga fshatarët na mori e na çoi te toka e tij, e cila ishte plot me gëmusha. Shtruam kurrizin mirë dhe e pastruam parcelën dhe e bëmë dritë. I zoti i tokës na dha një dorë me para, paratë e para për ne. Me to blemë çokollata dhe nuk kishim të ngopur aq të mira ishin. I dhamë dhe djalit, ai ngriu.

Dimitriou, viti 2000, fq. 68-69.

Studioni me kujdes dokumentet IV-27, IV-28, IV-29 dhe IV-30. Më pas bëni në klasë një rreth me karrige. Në karrigen, që ndodhet në qendër të rrethit ose ndryshe "karrigia e nxehtë", çdo 3 minuta do ulet një nxënës dhe do rrëfejë historinë si emigrant, duke përfaqësuar kështu një grup nxënësish. Gjatë këtij rrëfimi, ai do të përmendë arsyet pse u largua nga vendi, cila ishte vendmbërritja dhe plani i tij, cilat ishin frika dhe pritshmëritë që pati, me çfarë u përball dhe si ndihet për të ardhmen e tij. Përpiquni t'i kuptoni historitë e mësipërme dhe tregoni histori të tjera në klasë. Lidheni këtë detyrë me krizën e tanishme të refugjatëve (Lindje e Mesme, Evropë) dhe krizën financiare në Jug (të Greqisë).

IV-32. Emigrantët shqiptarë në kinemanë greke

Filmi "Mirupafshim", 1997, me regjisorë Kristos Voburas dhe Jorgos Koras, përqendrohet në marrëdhënien midis një profesori grek me bindje të krahut të majtë dhe tre emigrantëve të jashtëligjshëm ekonomikë nga Shqipëria, të cilëve iu ka ofruar strehim. Për shkak të marrëdhënieve të tij me këta emigrantë, ai ka mosmarrëveshje me të afërmit dhe miqtë e tij, që i shohin emigrantët me dyshim dhe shfaqin shenja të sjelljes raciste. Profesori, që të njihet me jetën e emigrantëve viziton Shqipërinë, po shumë shpejt zhgënjehet. Filmi pasqyron përpjekjet e protagonistit për të kuptuar dhe për t'u ndërgjegjësuar dalëngadalë për tjetërsimin e emigrantëve në një mjedis, që lidhet më shumë me shfrytëzimin e tyre ekonomik.



Koleksion privat i regjisorit Kristos Voburas.

1. Ndajeni klasën në pesë grupe. Secili duhet të trajtojë mënyrën se si artet dhe media e paraqesin problemin e emigrimit (letërsi, arte pamore, teatër, kinema, televizion).

2. Përgatisni një projekt, ku të kërkoni shkaqet dhe pasojat e emigrimit, si për vendin nga largohen ashtu edhe për atë të mbërritjes, duke u përqendruar në Evropën Jugore. Diskutoni për identitete, kufij dhe pasaporta të ndryshme. Filloni me burimin IV.3.

IV.5. PAKICAT DHE PABARAZITË SHOQËRORE

IV-33. Qëndrimi i turqve ndaj pakicave

A. Karikaturë e reagimeve të ndryshme ndaj të njëjtit lajm



Përkthim: Turqit e Bullgarisë hyjnë në parlament; deputetët kurdë hyjnë në parlamentin turk.
Oran, 2008, fq. 14.

B. Popullsia kurde në Turqi dhe djegia e fshatrave kurde

Në vitin 1998, një komision i Asamblesë së Madhe Kombëtare i drejtuar nga Z. Sejit Hashim Hashimi (Deputet i qytetit të Dijarbakërit për Partinë e Virtytit, me në krye Z. Erbakan), i paraqiti parlamentit raportin e tij. Ky raport, Raporti i Komisionit të Kërkimit në Parlament 10/25 për problemet e shtetasve, që kanë migruar për shkak të evakuimit të banorëve në Turqinë Lindore dhe Juglindore, nxori në pah se në qershor të vitit 1995, të paktën 3,000 fshatra i ishin nënshtruar shpërnguljes së detyrueshme nga autoritetet shtetërore për arsye sigurie gjatë luftës me PKK-në.
Deri në korrik të atij viti, këto shpërngulje kishin prekur më shumë se 311.000 njerëz dhe qeveria nuk kishte marrë masat e duhura për t'i rikthyer ata në shtëpitë e tyre në kuadër të nismës "Kthimi në fshat".

Raport i komisionit parlamentar për shqyrtimin e problemeve që kanë hasur shtetasit që kanë migruar, për shkak të shpërnguljeve të banorëve të Anadollit Lindor dhe Juglindor dhe dhënien e mendimeve për zgjidhjen e tyre.
https://www.tbmm.gov.tr/sirasayi/donem20/yil01/ ss532.pdf, vizituar më 28.05. 2016.

Vitet 1980 ishin kohë kritike si për turqit, që banonin në Bullgari, ashtu edhe për kurdët që banonin në Turqi. Ankaraja ishte e shqetësuar për formimin e një "trekëndëshi" me banorë kurdë ndërmjet Irakut, Iranit dhe Turqisë, ndërkohë që lëvizja kombëtare kurde ishte radikalizuar (Shih vëllimin 1, ???-23). Si rrjedhojë, Turqia ndoqi një politikë shtypëse, që përfshinte shpërnguljen e detyruar të popullsisë fshatare kurde. Nga ana tjetër, një politikë e tillë shtypëse u ndoq nga qeveritarët e Sofjes kundër banorëve me kombësi turke në Bullgari, gjë që çoi drejt "Ekskursionit të madh" të turqve të Bullgarisë. Megjithatë, në zgjedhjet parlamentare të vitit 1991, Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë (LDL), që ishte partia përfaqësuese e turqve të Bullgarisë (e themeluar në vitin 1990), fitoi 7.6% të votave dhe 24 mandate nga 240 që ishin gjithsej në parlament, duke nxitur reagime të ashpra nga ana e partive nacionaliste bullgare. Në Turqi, krahas luftës guerrile të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), lindi një lëvizje politike kurde, falë aleancës me partinë e Erdall Inonysë (SHP) dhe si pasojë një numër i madh deputetësh kurdë hynë në parlamentin turk pas zgjedhjeve të vitit 1991.

1. Shikoni karikaturën dhe përshkruani reagimet e turqve në të dy situatat. Lexoni çelësin dhe krahasojeni me çelësin e burimit III-39. Cilat mendoni se janë arsyet pse reagimet e turqve ishin të ndryshme në rastin e qëndrimit ndaj kurdëve dhe ndaj atyre të turqve të Bullgarisë? Krahasoni →

reagimin turk ndaj hyrjes së deputetëve të pakicës turke në parlamentin bullgar, me reagimin nacionalist siç është shprehur në moton "Asnjë turk në parlament".
2. Diskutoni për përfaqësimin politik të pakicave në parlamentet kombëtare. A keni parti pakicash në vendin tuaj? A përfaqësohen ato në parlament?

IV-34. Strategjia për Zhvillimin e Shërbimeve për Fëmijët dhe Familjet në Bashkinë Sliven, 2001–2003

Bashkia Sliven është institucioni shtetëror i një prej komuniteteve më të mëdha rome në Bullgari. Sipas të dhënave nga Zyra e Statistikave Territoriale, më datën 1 mars të vitit 2001, popullsia rome në rreth ishte 29,698 banorë. Nga këta banorë, 6,206 ishin regjistruar në Zyrën e Punësimit të Slivenit, gjë që nënkupton se 45% e të papunëve ishin anëtarë të komunitetit rom. Megjithatë, shifra e vërtetë është shumë më e lartë.

Për shkak të mungesave të mëdha materiale, gjendja socio-psikologjike në shumë prej familjeve është e vështirë. Përballimi i krizës është edhe më i vështirë për prindërit e sëmurë, ata të vetmuarit apo të papunët. Viktimat e kësaj situate janë më shumë fëmijët, sepse nuk mund të shkojnë në kopsht dhe u mungon dëshira për të studiuar, dhe për të ndjekur mësimet në shkolla. Kompetenca e ulët shoqërore dhe paaftësia e romëve për të administruar buxhetet e tyre e bëjnë të pamundur planifikimin e të ardhmes së fëmijëve të tyre. Vështirësitë financiare të familjeve shpeshherë çojnë drejt braktisjes dhe institucionalizimin e fëmijëve.

Shumica e romëve në bashkinë e Slivenit kanë edhe probleme të tjera. Mëmësia në moshën e hershme është e përhapur në popullsinë rome. Departamenti i Regjistrimit Civil dhe Shërbimeve Administrative të bashkisë së Slivenit ka raportuar një rast të një vajze 12-vjeçare, që ka lindur një fëmijë. Më shumë se gjysma e fëmijëve të lindur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2001 nuk e njohin babain biologjik dhe shumica e nënave kanë identitet etnokulturor rom. Meqenëse këta fëmijë janë kontigjentë që braktisen, është e nevojshme që romët të njihen me edukimin seksual dhe planifikimin familjar.

Sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Inspektorati i Arsimit në Sliven, numri i nxënësve që braktisin shkollën është shumë i ulët, vetëm 30 nxënës. Megjithatë, numri i përgjithshëm i fëmijëve romë në moshë shkollore, që nuk e ndjekin shkollën është shumë i lartë, 641.
Ofrimi i ndihmës për këto grupe të rrezikuara rregullohet me anë të Rregulloreve për Zbatimin e Aktit të Ndihmës Shoqërore (RRZANSH). Në varësi të granteve për projektet dhe burimet e disponueshme financiare, Kryqi i Kuq Bullgar ofron vaktin e drekës falas gjatë ditëve të shkollës për fëmijët, që vijnë nga familjet e pafavorizuara. Gjatë viteve të ndryshme shkollore, numri i fëmijëve, që përfitojnë nga ky shërbim rrallëherë, ka qenë më shumë se 100 për të gjithë qytetin. www.mlsp.government.bg, vizituar më 21.10.2015.

IV-35. Komuna Shuto Orizari në qytetin e Shkupit

A. Stema e komunës Shuto Orizari



Komuna Shuto Orizari (Shutka), e cila është kryesisht e banuar nga popullsi rome, është komuna e parë në Evropë ku romët kanë vetëqeverisje vendore, me kryetar bashkie dhe administratë rome. Me vendndodhje në pjesën veriore të qytetit të Shkupit, komuna u krijua në vitin 1996 si një nga 10 komunat e qytetit.

B. Rrugë në Shuto Orizari



Fotografuar nga Vanco Dzambaski.

IV-36. Pasuria dhe varfëria relative në Evropën Juglindore

PBB për frymë
(Pariteti i fuqisë blerëse, dollarë amerikanë), 2005

Zvicër	35,600
Francë	30,400
Greqi	23,400
Sllloveni	22,300
Poloni	13,800
Kroaci	13,000
Bullgari	9,000
Bosnjë dhe Hercegovinë	7,000
Shqipëri	5,300
Filipine	5,100
Armeni	5,000

NEQ (Nisma Evropiane për Qëndrueshmëri); http://www.esiweb.org/ index.php?lang=en&id=311&?lm_ID=3&slide_ID=30, vizituar më 14.07.2016.

IV-37. "Perandoria e Lypësve të Vegjël" në Tiranë. Rreth 200 fëmijë i kanë ndarë zonat ku lypin: ata operojnë pranë semaforëve, në kryqëzime dhe te hotelet

Varfëri dhe miliona në "perandorinë e lypësve". Jeta në trotuare dhe semaforë, zhvillohet në pluhurin dhe baltën e rrugës, ku lindin dukuri të zakonshme dhe të pazakonshme. Lojëra dhe punë, dredhi, mashtrime, drekë, kumar, drogë, vjedhje, etj., përjetohen çdo ditë nga "fëmijët e rrugës" dhe nga njerëzit e zakonshëm paçka se në përmasa më të ndryshme nga këta të fundit. Puna në semaforë ose nën varësinë e të tjerëve është sfilitëse dhe e pasosur. Por përfitimet nuk mungojnë. Tregtia e kryer duke zgjatur duart është e ngjashme me biznesin e tregtarëve të mëdhenj. Ndonjëherë sjell shumë fitime dhe ndonjëherë jo, por gjithmonë mbetet diçka. Në disa raste, ndonjë person me zemër të mirë ose dikush që ka qëllime të tjera, jep para që mjaftojnë sa për një çamçakëz. Në rrugët plot me fëmijë, që lypin gjithmonë është një i rritur, qoftë prind, vëlla ose i panjohur, që korr fitimet në lloj-lloj mënyrash. Zonat e ndikimit ndërmjet lypësve janë ndarë tashmë. Lypësit më të mëdhenj kanë marrë "racionin e luanit", me fjalë të tjera qendrën e qytetit të Tiranës.

Të tjerët punojnë nëpër kryqëzime dhe rrugë kryesore. Rivaliteti ekziston te lypësit, por ata dinë t'iu përmbahen kufijve të vendosur nga tutorët e tyre. Sipas lypësve njëra nga tutoret është milionere dhe madje ka ndihmuar familjet e varfra në lagjen e saj. Me pak fjalë, kartëmonedhat 1 mijëshe dhe milionat e fshehura në rrobat e palara të fëmijëve që lypin, përfundojnë në duart e të tjerëve.

Ndarja e zonave

Mbi 200 fëmijët e rrugës, që ushtrojnë "profesionin" e lypësit, janë në dijeni të faktit se puna e tyre, nëse mund ta quajmë kështu, lejohet vetëm në zonat e paracaktuara. Fëmijët lypin çdo ditë në hotelet luksoze të kryeqytetit, si: "Tirana International", "Dajti", dhe "Rogner", te semaforët afër sheshit, kioskat e shumta te ish-parku "Rinia", si dhe në stacionet e autobusit po në këtë zonë. Ndërkohë, pjesët e tjera të Tiranës së madhe nuk parapëlqehen nga fëmijët. Kufijtë e qendrës së Tiranës përcaktohen nga tutorët, që zakonisht janë gra në moshë, të cilat i përdorin fëmijët si "magnet" parash në zonat më fitimprurëse të sheshit. Kufijtë ndajnë dy zona të mëdha. Njëra është rruga pas Ministrisë së Mbrojtjes. Pjesa sipër saj deri te stacioni i trenit është zona më e populluar dhe zotërohet nga një grua. Pjesa e poshtme deri te Presidenca përbëhet nga lypës në moshën e adoleshencës dhe prindërit e tyre. Në semaforë, lypësit e vegjël përfitojnë nga drita e kuqe dhe lajnë xhamat e makinave. Shpeshherë njerëzit iu zgjasin kartëmonedha nga dritaret, por lypësit thonë se ndonjëherë njerëzit i pështyjnë dhe i fyejnë me fjalë nga më të ndryshmet. Ndërkohë të huajt nëpër hotele janë "preja" më e dëshiruar. Kafenetë dhe qoshet e qytetit janë vendet e përshtatshme ku lypësit presin zakonisht për kalimtarët e mëshirshëm. Por në krahasim me faktet e sipërpërmendura, ata nuk fitojnë aq shumë. […]

Gazeta "Koha Jonë", 17 janar 1997.

Cila është detyra e fëmijëve të rrugës? Kush i përcakton kufijtë e zonave ku punojnë? Pse fëmijët braktisen dhe detyrohen të lypin? Si po vepron shteti për zgjidhjen e këtij problemi? Si lidhet kjo dukuri me varfërinë në vend?

IV-38. Trafikimi i femrave në Bullgari



18 TETOR: Dita Evropiane kundër TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE. Afishe e fushatës kundër trafikimit të qenieve njerëzore të Qendrës për Mbështetjen e Komunitetit (Bullgaria Jugperëndimore). http://dupnitsa1.sonikstart.eu/public_html/%D0%BA%D0%B0%D0%BC%D0%BF%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D1%8F-3-%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%84%D0%B8%D0%BA-%D0%BD%D0%B0-%D1%85%D0%BE%D1%80%D0%B0/, vizituar më 21.06.2016.

Trafikimi është problem madhor që u rrit jashtë mase pas rënies së regjimeve komuniste. Cila është arsyeja pse kaq shumë vajza të reja shfrytëzohen nga rrjetet e mafies? Çfarë po bën shteti për zgjidhjen e këtij problemi? Si lidhet kjo dukuri me varfërinë në vend? Cila është përgjegjësia e vendeve të pasura të Perëndimit?

IV-39. Vrasja e femrave në Turqi prej *namusit* (nder)

Në Turqi, virgjëria e një femre mbetet një nga mekanizmat më të rëndësishëm të kontrollit të lirisë së femrave. Institucionet shoqërore si familja, gjykatat dhe traditat kulturore përbëjnë shtyllën e këtij mekanizmi kontrolli. Virgjëria e femrës në shoqërinë moderne turke mishërohet me konceptin e namusit, nderit të familjes që ekziston edhe në vende të tjera mesdhetare. Namusi mund të përkthehet si virtyt ose pastërti seksuale. […]

Një nga aspektet e pastërtisë seksuale është ndalimi i rreptë i marrëdhënieve para ose jashtëmartesore. Dallimi bazë midis shoqërisë turke dhe asaj evropiane është se në Turqi këto veprimtari nuk janë personale, por përfshijnë edhe autoritetet shtetërore. Shteti në Turqi luan rol në veprimtaritë seksuale të femrave duke pasqyruar vlerat e shoqërisë lidhur me pastërtinë seksuale të femrave. Për shembull, gratë e martuara që kapen duke tradhtuar bashkëshortin dënohen me burgim; femrat beqare që kapen me një burrë të martuar mund t'iu nënshtrohen testeve të virgjërisë për të përcaktuar nëse kanë kryer marrëdhënie seksuale; vajzat nën kontrollin e shtetit, si p.sh në jetimore, shkolla shtetërore dhe spitale psikiatrike mund t'iu nënshtrohen testeve të virgjërisë. […]

Namusi mund të lahet vetëm me gjak, sepse është njollosur nga femra. Për këtë arsye, femra duhet vrarë nga njëri prej meshkujve të familjes së saj. Vrasjet për namusin janë të zakonshme në Turqi, sidomos te grupet me status të ulët shoqëror dhe ekonomik. Ato dallojnë shumë nga krimet e pasionit. Një shembull i përkryer i këtij "procesi larjeje të namusit" është rasti në Turqinë Juglindore në prill të vitit 1996 kur një 13-vjeçare braktisi shtëpinë dhe familja e urdhëroi kushëririn e saj 14-vjeçar ta vriste për të vënë në vend nderin. Në gjyq, gjykatësi e dënoi me 2 vite e gjysmë burg për shkak të traditave të rajonit ku kishte ndodhur ngjarja.

Müftüler-Bac, 1999, fq. 303–315.

1. Krahasoni dokumentet IV-38 dhe IV-39 dhe diskutoni vendin e femrave në shoqëritë e Evropës Juglindore. Gjeni shembuj të femrave në vendin tuaj, që kanë pasur sukses në politikë, art ose media gjatë 20 viteve të fundit.

2. Ndajeni klasën në dy grupe dhe diskutoni për emancipimin e gruas. Njëri grup do të paraqesë arsyetime pro emancipimit seksual të grave dhe lirisë për të vendosur vetë për jetën e tyre të mbështetur në modelin perëndimor të të drejtave të njeriut, dhe grupi i dytë do të mbrojë praktikat tradicionale duke kërkuar një sjellje seksuale "morale".

IV-40. "Dhuratat e pushtetarëve për Krishtlindje", 2005

Artikulli i mëposhtëm rendit "dhuratat e Krishtlindjes" të një prej qeverive të koalicionit socialist asokohe në Bullgari: çmime më të larta të shërbimeve dhe mallrave, spitale të pista që ofrojnë shërbime jo të mira, si dhe pensione të ulëta. Në të njëjtën kohë, anëtarët e parlamentit blinin makina dhe mobilje të reja për shtëpitë e tyre me paratë e taksapaguesve.

Çuditërisht, kur socialistët vinin në pushtet në Bullgari, rrota e historisë kthehej pas. Qeveria e Zhan Videnovit na ktheu në kodrën, që po ngjisnim dhe na çoi sërish në fillim të tranzicionit, kur ishim të varfër dhe të stresuar. Para kësaj, dimri i Lukanovit na kishte rikthyer kujtimet e bashkatdhetarëve më të vjetër me sistemin e racionimit dhe vitet e urisë të Luftës së Dytë Botërore. […]

Një javë para Krishtlindjes, u bënë pikërisht 4 muaj që kur [kreu i Partisë Socialiste Bullgare Sergej] Stanishevi dhe shokët e partisë morën drejtimin e qeverisë. Ata arritën të përgatisnin dhurata shumë të hidhura për festat e Krishtlindjes për popullin, prandaj nuk është e habitshme që atmosfera në vend ishte e zymtë dhe nëse nuk do ta shihnin datën në kalendar, askush nuk do të kujtohej se është kohë festash. Megjithatë, pushtetarët festonin dhe gëzonin nëpër gosti gjatë Krishtlindjes, duke shijuar dhuratat që i kishin bërë vetes. […]

Në shtator rritja e çmimit të karburantit i kishte rritur në qiell edhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve. Nëse parashikimi se një kilogram mish derri gjatë Krishtlindjes do të kushtojë 15 leva është i vërtetë,

atëherë copat e mishit të derrit nuk do jenë asgjë më shumë se luks.

Ministri i Shëndetësisë Radoslav Gaidarski u paraqiti zgjedhësve një dhuratë të veçantë Krishtlindjesh. […] Me anë të një lëvizjeje burokratike, Gaidarski përvetësoi të drejtën për të autorizuar personalisht ndërhyrjet e kushtueshme kirurgjikale. Me pak fjalë, ai i ndaloi ndërhyrjet kirurgjikale. Në të vërtetë, ai i zhveshi ekspertët nga e drejta për të gjykuar dhe vendosur si t'i trajtojnë pacientët e tyre.

Një dhuratë modeste nuk mund të mungonte as nga Ministrja Sociale Emilia Maslarova. […] Pensionet e personave të moshës së tretë do rriten me 5% në janar. Megjithatë, për Krishtlindje ata do të marrin një bonus prej 50 levash, në mënyrë që edhe ata të marrin pjesë në festime. Në të njëjtën kohë, rrogat e punonjësve të sektorit publik do të rriten plot 6%, një dhuratë e vogël por me shumë dashuri nga Maslarova. Edhe nënat e reja duhet të jenë të lumtura, sepse pagesat për fëmijët janë "rritur" me dy leva në muaj. […]

Kaq shumë dhurata Krishtlindjeje nën pemën e madhe të qeverisë. […] Por rreth 20 ditë më parë të gjithë ne taksapaguesit iu bëmë pushtetarëve një dhuratë me 25 automjete të blinduara. Shërbimi Kombëtar i Mbrojtjes bleu 15Mercedes S-class dhe 10 BMW për 2,170,000 leva. Ato do të dërgohen rreth datës 20 dhjetor.

Dafinova, Monitor, 19 dhjetor, 2005

1. Cilat janë masat e ndërmarra si "dhurata"?
2. Identifikoni referencat historike dhe shpjegoni se si janë përdorur.

IV-41. Varfëria në Rumani

A. Të dhëna e kërkimit për varfërinë

[…] Zbatimi i tre përmasave të varfërisë për shpërndarjen e familjeve sipas të ardhurave neto rezultoi se nga numri i përgjithshëm i popullsisë në vend shifrat e mëposhtme përfaqësonin personat e varfër:

-9.9 milionë persona (42%) në kategorinë "niveli minimal i jetesës së denjë"

-7.1 milionë persona (30%) në kategorinë "niveli minimal i jetesës në periudhën e tranzicionit"

-3.1 milionë persona (13%) në kategorinë "nivel jetese"

Nga numri i përgjithshëm i familjeve, 42% jetojnë në kushte që nuk i përmbushin kriteret e nivelit minimal të jetesës së denjë.

Nga numri i përgjithshëm i familjeve, 31% nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat themelore të nivelit minimal të jetesës për periudhën e tranzicionit.

Nga numri i përgjithshëm i familjeve, 16% jetojnë në varfëri në rritje dhe nuk janë në gjendje të sigurojnë kushtet për jetesë minimale. […]

Në rastin e pensionistëve me sigurime publike shoqërore, gjysma e tyre jetojnë në skamje, pa përfituar nga kushtet minimale të jetesës.

Familjet me dy pensionistë kanë një përqindje paksa më të ulët varfërie (27% në variantin e nivelit të jetesës dhe 38% në variantin e nivelit minimal të jetesës në periudhën e tranzicionit) në krahasim me personat e pamartuar.

Shkalla e varfërisë në mjedisin rural është më e ulët në të njëjtat lloje familjesh, për shkak të faktit se një pjesë e madhe e konsumit ushqimor mbulohet nga produktet e tyre. […]

Puwak, 1992, fq. 267-268.

B. Përllogaritje subjektive e kushteve të varfërisë

[…] sipas përllogaritjes subjektive të varfërisë, mbi 85% e familjeve të të punësuarve jetonin në varfëri, ndërkohë që sipas nivelit minimal të jetesës së denjë përqindja ishte 42.5%. […]

Përveç përllogaritjes së numrit të të varfërve sipas kritereve të mirëcaktuara të varfërisë, është shumë e rëndësishme të dini përpjesëtimin e atyre, që thonë se jetojnë në varfëri (pavarësisht gjendjes së tyre reale mbi ose nën kufijtë e varfërisë).

Rezultatet treguan se 48.8% e të intervistuarve shpreheshin se jetonin në varfëri.

Duke e krahasuar "përllogaritjen e përafërt" të varfërisë me rezultatet e zbatimit të përcaktimit "nivel minimal i jetesës së denjë", që ishte 42%, është e thjeshtë për ta kuptuar se përllogaritja e përafërt, siç pritet, është më e lartë dhe dallimi nuk i ndryshon përfundimet. Ajo është më e theksuar te personat e pamartuar (60.6%) dhe familjet me 3 ose 4 fëmijë (60-70%). Dallimet e vetëvlerësimit si i varfër varen nga kategoritë socio-profesionale dhe hasen më shpesh te familjet e të papunëve (62.5%), dhe të pensionistëve (56.7%).

Sipas llojit të banesës, rreth 60% e familjeve, që janë qiramarrës të apartamenteve shtetërore shpreheshin

se jetonin në varfëri, njësoj si 63% e familjeve të qiramarrësve të shtëpive shtetërore. Të vetmuarit (68%) dhe të divorcuarit (70%) shpreheshin më shpesh se jetonin më në varfëri, sesa personat e pamartuar. (38%) [...]

Viorel, 1992, fq. 292-293.

IV-42. Qendra e parë komuniste në Rumaninë postkomuniste, 1999



Hapja e një qendre tregtare në fund të viteve 1990]; histori dhe fotografi nga hapja e një qendre moderne tregtare, http://www.wall-street.ro/articol/Real- Estate/176395/cum-arata-un-mall-acum-15-ani-povesti-si- fotogra?i-de-la-prima-deschidere-de-centru-comercial-de-la- noi.html, vizituar më 22.11.2015.

Grupi turk i investitorëve shpenzoi 45 milionë dollarë për ta pajisur qendrën tregtare (Shtator 1999, Qendra Tregtare e Bukureshtit).

IV-43. Qendra tregtare BTC City në Lubjanë

Për shkak të rrethanave politike konsumerizmi u rrit në Sllloveni pak më vonë se në Evropën Perëndimore. Rritja e madhe e konsumerizmit mori hov në vitet 1990, kur firmat tregtare botërore hynë në Sllloveni. Ato u shfaqën në qendra të mëdha dhe premtuese, duke ofruar jo vetëm mundësi zgjedhjeje për konsumatorët, por edhe mënyra alternative për të kaluar kohën. Qendrat e para tregtare në Sllloveni u hapën në vitin 1993, me emrin Magazina Publike. Nga të gjitha qendrat tregtare, më tepër u zhvillua BTC City. Në vitin 2003, kjo qendër vizitohej nga 18 milionë njerëz. Megjithatë, midis viteve 1995 dhe 2000 zgjerimi i qendrave tregtare në Sllloveni shkaktoi mbylljen e dyqaneve dhe bizneseve të vogla, që dikur kishin qenë shumë të suksesshme, sidomos në qytetet e vogla.



Magazinat Publike në vitin 1960; Arkivat e BTC City-t.
BTC City në vitin 2015; Arkivat e BTC City-t.




1. Krahasoni shkallën e varfërisë të përshkruara në burimin IV-41 me të dhënat për komunitetet rome në vendin tuaj.

2. Krahasoni shkallën e varfërisë të përshkruara në burimin IV-41 me konsumerizmin e përshkruar në burimin IV-42. Diskutoni kundërshtitë midis varfërisë "subjektive" dhe konsumerizmit agresiv që karakterizon periudhën e tranzicionit pas rënies së regjimeve komuniste.

3. Krahasoni konsumerizimin në rritje në Sllloveni dhe Rumani të ilustruar nga qendrat tregtare me gjendjen e tregut shtetëror para vitit 1990. Përdorni shembuj nga vëllimi 1.


MERKUR
HOTEL



KAPITULLI V: KULTURA

Hyrje	185
V.1. Teknologjitë e reja dhekomunikimi	187
V.2. Feja	190
V.3. Kinemaja, teatri dhe muzika	202
V.4. Sporti dhe Lojërat Olimpike	206

HYRJE

Për sa i përket kulturës, si në kuptimin e saj më të ngushtë (letërsia, teatri, filmi dhe muzika) dhe më të gjerë (mënyra e jetesës, karakteristikat etnologjike, ushqimi, veshjet, strehimi, koha e lirë dhe feja), Evropa Juglindore është një nga rajonet më të larmishme në Evropë. Në pjesën më të madhe të këtyre shoqërive, që janë kryesisht tradicionale dhe agrare, proceset e modernizimit filluan me shpejtësi që në kohën e socializmit; në vendet josocialiste modernizimi ndoqi një formë tjetër (për shembull, krijimi i Turqisë moderne në kohën e Ataturkut) dhe sipas një kronologjie të ndryshme. Procesi i ndarjes së kishës nga shteti, emancipimi i grave, elektrifikimi dhe industrializimi, si edhe mënyra e jetesës e orientuar drejt një konsumi të llojit perëndimor, kanë ndryshuar në mënyra nga më të ndryshmet panoramën sociale të rajonit dhe kjo varion nga njëri shtet te tjetri. Në të shumtën e rasteve, ky proces ka qenë thjesht sipërfaqësor dhe jo rrënjësor. Në shoqëritë më të hapura, një rol të rëndësishëm ka luajtur media, por rol më vendimtar ka luajtur televizioni. Megjithëse ka njerëz në Jugosllavi që e mohojnë ekzistencën e kulturës së përbashkët, në të vërtetë dukej se një kulturë e tillë ekzistonte, të paktën në muzikë (e ashtuquajtura "Yugo-rock" dhe "turbo-folk", që ishin të njohura në të gjithë vendin), por edhe në kinematografi, dhe pjesërisht në teatër dhe letërsi, dhe mbi të gjitha në sporte (p.sh. basketboll dhe futboll).

Kjo ishte e dukshme edhe pas fundit të luftës së viteve 1990, kur muzika "jugosllave" u rigjallërua dhe fitoi popullaritet dhe yjet e muzikës "jugosllave" filluan të performonin live në të gjitha Republikat dhe krahinat e ish-Jugosllavisë. Në periudhën para se të fillonte lufta dhe gjatë saj, kultura popullore jugosllave përvetësoi karakteristika kombëtare (p.sh. nacionaliste) të dallueshme, ku media e ktheu një komb kundër tjetrit, dhe fansat, veçanërisht fansat e futbollit, luajtën një rol edhe më negativ në nxitjen e urrejtjes. Këto grupe vazhdojnë nxisin nacionalizmin dhe idetë fashiste (për shembull, ato të ustashëve dhe të çetnikëve) edhe në ditët e sotme.

Pas vitit 1990, ne mund të vëmë re karakteristika të përbashkëta si në vendet post-komuniste të rajonit ashtu edhe në ato të Evropës Juglindore, nga të cilat dy janë shumë të dallueshme. Njëra prej tyre është fuqizimi i rolit të fesë dhe ndikimit të saj në jetën publike, veçanërisht në arsim, në normat morale publike dhe kulturë. Kjo aplikohet veçanërisht nga të tre besimet fetare më të mëdha: mysliman, ortodoks dhe katolik. Në vendet post-komuniste, institucionet fetare janë rishfaqur si aktorë publikë dhe politikë të rëndësishëm. Pushimet fetare, që ishin ndaluar në të shkuarën, kanë marrë një rol të rëndësishëm në jetën publike. Në vendet ish- komuniste, ky ishte një reagim ndaj ateizmit të imponuar më parë. Në Jugosllavi, feja luajti një rol të rëndësishëm në luftën e viteve 1990 dhe pas saj, dhe ndikimi i fesë në të gjitha shtetet e reja u rrit. Në Greqi dhe Qipro, Kisha Ortodokse kishte tradicionalisht një rol të fuqishëm dhe mbizotërues në disa sfera të jetës shoqërore, dhe në Turqi faktori fetar është forcuar me rritjen e Islamit politikisht konservativ. Turqia, në veçanti, ka përdorur institucionet fetare për të rritur ndikimin e saj në popujt e Ballkanit.

Një tjetër karakteristikë e përbashkët ishte zgjerimi i globalizimit. Kjo ndodhi nëpërmjet medias elektronike, veçanërisht televizionit (satelitor dhe kabllor), si edhe kompjuterave dhe celularëve. Kjo ka sjellë përzierje kulturore të pazakonta, që nga njëra anë mbështeten te modelet e globalizuara të sjelljes, veçanërisht në modë, ushqim, muzikë, mënyrat e jetesës, dhe ato të kalimit të kohës së lirë, dhe nga ana tjetër ka shënuar kthimin te tradicionalizmi, traditat fetare dhe kombëtare, të shoqëruara me paragjykime kundrejt gjithçkaje që ishte e ndryshme. Traditat (kryesisht amerikane) perëndimore (dita e Shën Valentinit, Halloween-it) iu janë shtuar pushimeve dhe kremtimeve fetare tradicionale, nën ndikimin e medias që ka nxitur konsumerizmin sistematik të mbizotëruar nga rrjetet e shitjes me pakicë dhe reklamat.

Disa karakteristika të përbashkëta të rajonit mund të vihen re edhe në muzikë dhe vallëzim, që bazohen te traditat (vendet e Ballkanit kanë sjellë melodi të rajonit në atë që më parë njihej ekskluzivisht si Festivali Evropian Perëndimor i Këngës). Në fushën e sporteve u organizuan disa konkurse rajonale. Për shembull, pas vitit 2001, u krijua liga e Adriatikut për basketbollin, që përfshiu kryesisht vende nga ish-Jugosllavia. Dy vende të rajonit, Jugosllavia në periudhën socialiste në vitin 1984 dhe Greqia në vitin 2004, organizuan Lojërat Olimpike (Jugosllavia organizoi Lojërat Dimërore dhe Greqia Lojërat Verore). Në të dyja rastet, organizimi i tyre u shoqërua me shumë kundërshtime publike.

Në kuptimin më të ngushtë të kulturës, disa regjisorë filmash u afirmuan në nivele evropiane dhe ndërkombëtare (në vitet 1990, një temë veçanërisht popullore ishin luftërat jugosllave, dhe para kësaj, diktaturat turke dhe greke); dhe disa kompozitorë dhe këngëtarë e këngëtare kanë arritur gjithashtu famë botërore. Në fushën e letërsisë, autori turk Orhan Pamuk ishte shkrimtari i katërt nga rajoni që fitoi çmimin

Nobel. Gjithashtu, fundi i Luftës së Ftohtë hapi kufijtë për kontakte kulturore më intensive ndërmjet shteteve fqinje: romane të shkruar nga autorë të Ballkanit janë përkthyer në gjuhët e rajonit, ku edhe u organizuan veprimtari për letërsinë dhe u krijuan çmime në këtë fushë (si Çmimi Balkanika për Letërsinë).

Kapitulli V përmban burime që pasqyrojnë larminë dhe kundërshtitë e jetës kulturore në periudhën e globalizimit. Më shumë se kurrë më parë në historinë e njerëzimit, qytetarët komunikojnë me njëri-tjetrin edhe përtej kufijve dhe janë të informuar për çdo ngjarje që ndodh në skajet më të largëta të botës. Karakteristikat kulturore qarkullojnë shpejt nga njëri vend në tjetrin, moda dhe shijet ndryshojnë pareshtur, zhvillimet teknologjike ndikojnë në mënyrën e jetesës, punës dhe si e kalojmë kohën e lirë, veçanërisht brezat e rinj. Megjithatë, ritmi i ndryshimeve ndeshet me reagime, frikë dhe rigjallërime tradicionale. Studentëve do t'iu kërkohet të reflektojnë për kontradiktën zhgënjyese, të vëzhguar në Evropën Juglindore, ndërmjet konsumerizmit në masë të orientuar drejt Perëndimit dhe novacionit teknologjik nga njëra anë, dhe lirisë së fesë dhe muzikës tradicionale nga ana tjetër.

V.1. TEKNOLOGJITË E REJA DHE KOMUNIKIMI

V-1. Të nxënit ndërmjet brezave në Sllloveni

Në gjysmën e dytë të viteve 1990 u vu re një zhvillim i shpejtë në telefoninë celulare. Në vitin 2000, më shumë se një milion banorë në Sllloveni kishin filluar të përdornin celularët, dhe numri i tyre po shtohet ende. Teknologjitë e reja janë veçanërisht të rëndësishme për brezin e vjetër që ka nevojë të mësojë se si t'i përdorë ato. Si rrjedhojë, në Sllloveni u ndërmorën disa nisma që nxisnin të nxënit ndërmjet brezave. Një prej tyre ishte Projekti Simbioza (në gjuhën sllovene: Projekt Simbioza), ku nxënësit e shkollave të mesme iu mësonin të moshuarve se si t'i përdornin celularët dhe internetin.



Fotograf: Alesh Çernicev, Arkivi i gazetës "Delo".

V-2. Pikëpamjet e profesionistëve të rinj të IT-së për brezin e tyre në Bullgari

Pjesa në vazhdim është një ekstrakt nga një dokument i Orlin Spasov që del nga vëzhgimet antropologjike të të rinjve (të moshës 18-30 vjeç) nga Sofja për internetin. Ekstrakti paraqet një mënyrën se si brezi i teknologjisë së re krijon imazhin e vetvetes, të brezit të ri të IT. Të anketuarit e përshkruajnë veten si të mirëinformuar, të paangazhuar në politikë dhe të përqendruar te e ardhmja e tyre.

Një element i rëndësishëm i vetëperceptimit të profesionistëve të rinj të IT-së në Bullgari, është besimi se ata janë specialistë të vetëpërgatitur. Kjo është e vërtetë veçanërisht për të diplomuarit në fushën e TIK-ut dhe fusha të ngjashme. Ata të gjithë mendojnë se teknologjitë e reja nuk përvetësohen si duhet në vendin e punës. Pasi kanë filluar punën, dhe shumë shpesh gjatë kohës së studimeve universitare, qytetarëve të punësuar në sektorin e TIK-ut iu kërkohet të ndjekin disa muaj trajnim praktik shtesë.

Si rrjedhojë, arsimi universitar në sektorin e TIK-ut po i hap rrugë vetëarsimimit. […]

Profesionistët e rinj të TIK-ut janë dukshëm të vetëdijshëm se kanë një pozicion të privilegjuar krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre. Kjo është arsyeja se përse kur ata diskutojë për brezin e tyre, ndonjëherë ata flasin nga pozicioni i një statusi paksa të lartë. Ata e përcaktojnë brezin e tyre si brez të tranzicionit në Bullgari, dhe që i kalojnë të gjitha vitet e tyre të rinisë në këtë periudhë. Mendimi mbizotërues është se ky brez ka vuajtur nga tranzicioni. Sipas profesionistëve të rinj të TIK-ut, kjo shpjegon faktin se përse shumë prej bashkëmoshatarëve të tyre votojnë "kundër" dhe se përse shumë pak prej tyre janë veprimtarë politikë. Shumë prej tyre janë të orientuar drejt mjedisit, por ata përqendrohen te mjedisi, dhe jo te politika e mbrojtjes së mjedisit; kjo është arsyeja se përse ata i bashkohen fushatave mjedisore vetëm rastësisht dhe nuk janë vazhdimisht në mbështetje të tyre. Megjithëse ata nuk janë anëtarë të ndonjë prej organizatave, mendohet se ata kanë pikëpamje shoqërore dhe politike që megjithatë nuk janë të qëndrueshme. Profesionistët e rinj të TIK-ut mendojnë se brezi i tyre është shumë i mbyllur dhe i paaftë për të prezantuar veten politikisht. Të rinjtë janë të mirëinformuar por jo shumë të komunikueshëm, dhe nuk mund t'ua përçojnë problemet e tyre publikut.

Në tërësi, mendohet se brezi i ri aktual në Bullgari është pragmatik dhe i orientuar drejt konsumit. Në të njëjtën kohë, ai nuk është shumë i motivuar për ndryshim. Të rinjtë janë të kënaqur me *status quo*-në dhe nuk janë për ndryshim rrënjësor; përfundimisht ata janë pasivë. Gjithsesi, ata janë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e ndryshimeve pas aderimit të Bullgarisë në BE. Janë gjithmonë e më shumë të rinjtë që kanë mundësi më të mëdha për t'u promovuar dhe për të përfituar nga financimet që vijnë nga fondet e BE-së.

Profesionistët e rinj të TIK-ut mendojnë se brezi i tyre nuk është aq idealist. Ata besojnë se prindërit e tyre ishin më shumë idealistë dhe intelektualë se të rinjtë e sotëm. Paraja dhe pasuria janë idhujt e rinj të brezit të ri të sotëm. Mënyra e re e jetesës ka shumë rëndësi dhe po zëvendëson idealet e vjetra. Sportet janë të rëndësishme edhe për ata që përdorin drogë dhe alkool. Drogat janë të lira dhe mund të gjenden lehtësisht, dhe përdorimi i

marijuanës është i zakonshëm. Veprimtaritë e kohës së lirë janë më të rëndësishme se puna. Në këtë kontekst, shumë të rinj nuk janë të kënaqur me profesionet e tyre, për të cilat ata mendojnë se nuk janë mjaftueshëm krijuese.

Spasov, 2009, fq. 46, 56.

1. Diskutoni se si është arritur afrimi me teknologjinë e re të komunikimit, si në rastin e Sllovenisë dhe Bullgarisë, sipas burimeve të mëparshme. Si po ndikon përdorimi i saj në qëndrimin e të rinjve ndaj vetes, të mirës së përbashkët, dhe lidhjes me shoqërinë në të dyja rastet? Çfarë po ndodh në vendin tuaj?
2. Sipas mendimit tuaj, cili është kuptimi i fjalive të mëposhtme: "Profesionistët e rinj të TIK-ut mendojnë se brezi i tyre nuk është aq idealist. Ata besojnë se prindërit e tyre ishin më shumë idealistë dhe intelektualë se të rinjtë e sotëm. Paraja dhe pasuria janë idhujt e rinj të brezit të ri të sotëm. Mënyra e re e jetesës ka shumë rëndësi dhe po zëvendëson idealet e vjetra"? Si lidhen këto dukuri me procesin e tranzicionit të vendit nga një sistem politik në tjetrin?

V-3. Televizioni kabllor në Sllloveni

Sistemet e para kabllore në Jugosllavi u zhvilluan në vitin 1983 për përgatitjen e Lojërave Olimpike që u zhvilluan në Sarajevë në vitin 1984. Lidhjet e para për televizionin kabllor në Sllloveni u krijuan në mesin e viteve 1980 nga elektricistë amatorë. Kurse lidhja e parë tregtare u krijua në Ruše (pjesa verilindore e Sllovenisë) në vitin 1985, ku u lidhën 3,000 familje. Më pas lidhja e tyre u shtri në zonat më të populluara. Në vitin 1988, kishte afërsisht 50,000 abonentë të lidhur në rrjetin kabllor. Numri i linjave u rrit veçanërisht pas vitit 1991, dhe në fund të mijëvjeçarit kishte rreth çerek milioni familje të lidhura në rrjet, ose 40% e të gjitha familjeve. Si rrjedhojë, Sllovenia u rendit në vendet evropiane me mbi 50 për qind për sa i përket mbulimit me lidhje kabllore. Antenat e para satelitore, u shfaqën në fillim të viteve 1980; dhe, me vendosjen e këtyre antenave, ndërtesat rezidenciale u bënë operatorë kabllorë të vegjël. Me shfaqjen e ofruesve të rrjetit kabllor, përqindja e antenave satelitore private u bë e papërfillshme.




Tabela 1: Kabelski priključki v Sloveniji v obdobju 1988 – 1999

Përkthimi: Tabela 1: Lidhjet kabllore në Sllloveni midis viteve 1988 dhe 1999.
Tabela nga Milan Perko dhe Dr. Matjazh Debevc, Perko dhe Debevc, 2001, fq. 2.

V-4. Demonstratat për Radio 101, më 21 nëntor 1996, në sheshin kryesor të Zagrebit

Radio 101, filloi transmetimin në vitin 1984 dhe ishte stacioni i parë radiofonik alternativ në Kroaci, i administruar nga Bashkimi zyrtar i të Rinjve dhe që mbante një qëndrim kritik ndaj regjimit komunist. Në vitet 1990, Radio 101 u bë zëri kritik ndaj regjimit të Tuxhmanit, që u përpoq ta mbyllte në vitin 1996 duke ia hequr licencën e transmetimit në favor të një stacioni tjetër radiofonik. Kjo provokoi demonstrata masive në Zagreb, që ishin ndër protestat më të mëdha kundër regjimit të Tuxhmanit. Në ballkonin në sfond mund të vihet re një banderolë e varur me logon e Radio 101. Protestuesit mbanin në duar qirinj. Tuxhmani iu përgjigj duke bërë akuza kundër "mbeturinave komuniste jugosllave" që shoqëroheshin me "djajtë e zinj, jeshilë dhe të verdhë" që vepronin kundër "lirisë dhe pavarësisë së Kroacisë". Pas rënies së regjimit komunist, Radio 101 iu ble Unionit të të Rinjve nga disa prej gazetarëve të tij.

RADIO 101
MY POWER STATION

Radio 101 logo.

Logoja e Radios 101.



Arkivat e Radios 101.

V-5. Radio B92 (Serbi)

Logoja e Radios B92.

Stacioni radiofonik i Beogradit B92 transmetoi për herë të parë në vitin 1989. Gjatë luftërave të viteve 1990, B92 ishte një nga burimet shumë të pakta të lajmeve që nuk ishin të kontrolluara nga regjimi i Millosheviçit. B92 u mbyll katër herë. Në vitin 1999 gjatë bombardimit të NATO-s qeveria e mori në dorëzim stacionin, por ekipi i Radios B92 vazhdoi të transmetonte në studio të marra me qira si B2-92. Gjatë një sulmi në agim të një dite maji të vitit 2000, trupat e qeverisë sekuestruan të gjitha pajisjet e këtij radiostacioni, por transmetimi nëpërmjet internetit nga studio sekrete, vazhdoi deri në largimin e Millosheviçit në tetor të vitit 2000, kur të dyja stacionet u bashkuan. Që prej asaj kohe ajo ka vazhduar si stacion radiofonik duke transmetuar muzikë dhe lajme. TV B92 filloi punën në tetor të vitit 2000.

V-6. Antenat satelitore në Kosovë 1992-1999

Radio Prishtina filloi punë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, në Prizren dhe më pas u transferua në Prishtinë. Televizioni i Prishtinës (TVP) filloi transmetimin e programeve në vitin 1974 dhe ishte stacioni i parë televiziv në Kosovë që transmetonte në gjuhën shqipe. Radio Televizioni i Prishtinës u mbyll nga qeveria serbe në vitin 1990 me akuzat se ai u bë zëdhënës për "nacionalizmin dhe separatizmin shqiptar". Bazuar në Deklaratën Kushtetuese të korrikut të vitit 1991, shqiptarët e Kosovës krijuan institucionet e tyre politike të pavarura, që Serbia i quante "institucione paralele". Përfaqësuesit e këtyre institucioneve nënshkruan një marrëveshje me Radio Zagrebin për të përdorur rrjetin e saj satelitor për të bërë transmetimin e lajmeve në gjuhën shqipe me një kohëzgjatje prej 7 minutash. Në vitin 1992, qeveria e Kosovës në mërgim arriti një marrëveshje me Radio Televizionin Shqiptar - RTSH, për të krijuar Departamentin e Informacionit të Kosovës, për të transmetuar lajme në gjuhën shqipe nëpërmjet satelitit. Për këtë arsye, qytetarët shqiptarë të Kosovës filluan të blinin antena satelitore për të ndjekur programet e reja. Brenda një kohe të shkurtër, pothuajse çdo shtëpi në Prishtinë, qendra të tjera urbane dhe fshatra në Kosovë kishin instaluar antenat satelitore në ballkone, çati, apo pjesë të tjera të shtëpisë.



Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, Fondi Fotografitë. [Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës].

1. Studioni burimet (tekstet, fotografitë dhe grafikat). Më pas përpiquni të shpjegoni: Qëndrimin e qytetarëve për mjetet e lira dhe alternative të komunikimit (transmetim satelitor, transmetim radiofonik, televizion kabllor), duke marrë parasysh politikat e regjimeve autoritare për kontrollin e informacionit dhe komunikimit.
2. Diskutoni se në cilat rajone të vendit tuaj dhe në cilat pjesë të qytetit tuaj ka antena satelitore. Kush i zotëron ato? Për çfarë arsye?

V.2. FEJA

V-7. Rigjallërimi i fesë në Serbi

Sipas studimit të kryer nga sociologë që studiojnë fenë, profili i besimtarëve në Serbi ndryshoi ndërmjet viteve 1980 dhe fundit të viteve 1990. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2010, jo vetëm që kjo pirje u konfirmua, por besimi fetar në Serbi vazhdoi të rritej. Me ndryshimet politike në tetor të vitit 2000, Kisha Ortodokse Serbe jo vetëm që e ruajti pozicionin e saj si institucioni fetar mbizotërues në Serbi, por e forcoi pozicionin e saj në shoqëri. Në korrik të vitit 2001, filloi zyrtarisht mësimi i fesë në shkolla fillore dhe të mesme. Fakulteti i Teologjisë u bë sërish pjesë e Universitetit të Beogradit dhe priftërinjtë u rikthyen në ushtrinë profesioniste. Pronat e kishës që pas Luftës së Dytë Botërore ishin marrë nga shteti, iu rikthyen kishës, ose u bë kompensimi i tyre. Prania e klerikëve në veprimtari publike, dhe e elitës publike në mbledhje fetare, u njoh dhe u pasqyrua edhe nga media. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2000 jo vetëm që u rrit pirja e vetëidentifikimit fetar, por u shtuan gjithashtu edhe ceremonitë tradicionale lidhur me kishën dhe fenë, edhe pse në përqindje shumë më të vogla.

Cili është qëndrimi juaj ndaj fesë?
A jeni ju personalisht (%)

	1999	2010
Fetar	59	78
Të pavendosur dhe indiferentë	21	4
Jofetarë	19	14

Lidhja tradicionale e kishës dhe fesë (%)

	1999	2010
Fëmijë të pagëzuar	84	87
Festimi i pushimeve zyrtare	87	92
Varrime me ceremoni kishtare	86	87

Radisavljeviç-Çiparizoviç, 2011, fq. 25-43

V-8. Ligji i parë postkomunist për arsimin në Rumani, 1995; feja si lëndë e detyrueshme

Ligji konfirmoi praninë e praktikave post-komuniste që tashmë ishin në fuqi: ulja e arsimit të detyrueshëm në 8 vite, depolitizimi i arsimit, mësimi i fesë në shkolla, prania e institucioneve arsimore private, mbledhja e taksave madje edhe brenda sistemit të arsimit publik (teorikisht falas), zhvillimi i arsimit për pakicat etnike kombëtare, etj.

Neni 3 (1) Arsimimi synon arritjen e idealit arsimor bazuar te [...] vlerat e demokracisë dhe [...] kontribuon në ruajtjen e identitetit kombëtar. [...]

Neni 4. (2) Arsimi garanton rritjen e dashurisë për vendin, për të shkuarën historike dhe për traditat e rumunëve [...]

Neni 6. Arsimi i përgjithshëm i detyrueshëm përfshin 8 klasë. Arsimi i detyrueshëm përfundon në moshën 16 vjeç.

Neni 7. (1) Arsimi publik është falas.

Neni 9. (1) Kurrikulat e arsimit fillor, të mesëm, dytësor dhe profesional përfshijnë si lëndë mësimore edhe fenë. Në arsimin fillor feja është lëndë e detyrueshme, në arsimin e mesëm është fakultative, dhe në arsimin dytësor dhe profesional nuk është e detyrueshme. Nxënësi, me pëlqimin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë, zgjedh se cilën fe dhe besim të studiojë. [...]

Neni 11. (1) Arsimi nuk është subjekt i synimeve dhe doktrinave të nxitura nga partitë ose grupet e tjera politike.

Neni 14. Alternativat arsimore mund të organizohen brenda sistemit arsimor publik dhe privat, bazuar në vlerësimin dhe **kontrollin** e Ministrisë së Arsimit.

Neni 15 (3) Privatizimi i institucioneve dhe strukturave arsimore është i ndaluar.

Neni 103 (1) Arsimi privat është një alternativë ose shtesë për arsimin publik.

Neni 104 (1) Arsimi privat është në përputhje me ligjin nëse:

a) Organizohet dhe funksionon sipas parimeve jofitimprurëse.
b) Organizohet sipas parimeve mosdiskriminuese dhe nuk pranon ide, pirje dhe qëndrime jodemokratike, ksenofobike, shoviniste dhe raciste.
c) Respekton standardet kombëtare.

Neni 120 (3) Në kurrikulat dhe tekstet shkollore të historisë botërore dhe historisë së Rumanisë, do të pasqyrohet historia dhe traditat e pakicave etnike kombëtare të Rumanisë.

(4) Me kërkesë, në arsimin e mesëm, historia dhe traditat e pakicave etnike kombëtare do të përfshihen si lëndë shkollore. Kurrikulat dhe tekstet shkollore për këtë lëndë janë miratuar nga Ministria e Arsimit.

Ligji Nr. 84, 24 korrik 1995, i publikuar në "Fletoren Zyrtare", nr. 167, 31 korrik 1995, fq. 1-17.

1. Si do ta shpjegonit se çfarë është arsimi i detyrueshëm? Rendisni disa arsye se përse shtetet janë të interesuara në arsimimin e brezave të rinj.
2. Cilat ishin parimet dhe synimet bazë të arsimit në Rumani në vitin 1995?
3. Krahasoni Nenet 3, 4 dhe 120. A mendoni se ato bien në kundërshtim me njëra-tjetrën?
4. A është feja lëndë e detyrueshme mësimore në shkollat e vendit tuaj?

V-9. Përmendorja e Nënës së Shenjtë të Zotit, Haskovo, Bullgari, e ndërtuar në vitin 2003

E ndërtuar me nismën e pushtetit vendor të qytetit, kjo statujë përfaqëson shtimin e simboleve fetare në të gjithë rajonin (kryqe të mëdha në kodra, minare të larta të reja, ndërtesa fetare të reja dhe të mëdha, etj.). Duke pasur parasysh nivelet e ndryshme të lirisë fetare në shoqëritë e Evropës Juglindore, ndërtimi i kësaj përmendoreje të veçantë, përballë kufirit me Turqinë, u nxit kryesisht nga zelli nacionalist sesa ai fetar. Haskovo ndodhet në pjesën juglindore të Bullgarisë, një rajon me pakicë turke të konsiderueshme, dhe përmendorja supozohet të frenojë ndonjë ndërhyrje të jashtme. Një shfaqje krejtësisht nacionaliste do të kishte qenë e papranueshme; ndërsa një shfaqje fetare mund të mirëpritej. Përmendorja është certifikuar nga Libri i Rekordeve Botërore Guinness si statuja më e lartë në botë e Virgjëreshës Mari me Jezusin foshnjë.



http://www.peika.bg/statia/5_lyubopitni_fakta_za_Haskovo_koito_ne_znaete_l.a_i.83441.html, vizituar më 02.07.2016.

V-10. Kryqi katolik romak në kodrën Hum, Mostar

Kryqi më i madh në Bosnjë-Hercegovinë ndodhet në kodrën Hum në Mostar. Kryqi 33 metër i lartë, i quajtur Kryqi i Mijëvjeçarit, u ndërtua për të simbolizuar jubileun e 2000 viteve të Krishtërimit. Lartësia e tij 33 metër përfaqëson moshën e Jezusit në kohën që ai u kryqëzua. Kryqi mund të shihet nga çdo pjesë e Mostarit. Duke qenë se myslimanët (boshnjakët) e konsideronin kryqin në kodrën Hum në Mostar si provokim, herë pas here shumë portale ndërmerrnin veprime për heqjen e tij.



Tomislav Milicevic Koleksion Privat, janar 2014.

1. Simbolet monumentale fetare, si statuja e Virgjëreshës Mari ose kryqi katolik romak në burimet e mëparshme, përfaqësojnë qëndrime të reja ndaj fesë pas rënies së regjimeve komuniste. A mund ta shpjegoni nevojën për këtë lloj deklarate publike?

2. Diskutoni çështjen e identitetit fetar si pjesë e identitetit kombëtar (përdorni gjithashtu dokumentet V-7 dhe V-8).

V-11. Deklarata e Asamblesë Boshnjake, Sarajevë, 27 shtator 1993

Në kulmin e luftës në Bosnjë-Hercegovinë, Asambleja e parë e të gjithë boshnjakëve, që vendosi sovranitetin politik të kombit mysliman, i zhvilloi punimet më 27 shtator 1993, në Holiday Inn Hotel në Sarajevë, e ndjekur nga 377 asamblistë dhe 80 deputetë nga shumë qytete në Bosnjë-Hercegovinë, si edhe përfaqësues të fushës diplomatike, ushtarake dhe kulturore. Pas refuzimit të planit të paqes Owen–Stoltenberg, Asambleja Boshnjake vendosi t'iu rikthente myslimanëve të këtushëm "emrin historik dhe kombëtar të boshnjakëve". Me refuzimin e planit të paqes dhe përdorimin e termit boshnjak, bashkësisë ndërkombëtare dhe pjesëtarëve të besimit mysliman iu dërgua një mesazh si një shprehje e qartë e sovranitetit politik. Për shumicën e myslimanëve të Bosnjë-Hercegovinës, kjo nënkuptonte fundin e shkrimit të etnisë së tyre me M të madhe (për Mysliman) dhe zëvendësimin e saj me termin boshnjak.

Boshnjakët,
115 vite më parë boshnjakët u mblodhën në haremin e xhamisë Beg, për të diskutuar mbrojtjen e vendit të tyre. Në verën e vitit 1878, ne jemi mbledhur sërish, nën emrin tonë kombëtar dhe traditën e lavdishme, në interes të vendit, shtetit dhe popullit tonë.

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë historike të kohës së mbledhjes sonë dhe sfidave me të cilat ndesheshim, ne ishim të vendosur për t'iu rikthyer bashkatdhetarëve tanë emrin historik dhe kombëtar boshnjak, dhe si rrjedhojë të bashkoheshim me vendosmëri me shtetin tonë të Bosnjës, gjuhën tonë boshnjake dhe me të gjithë traditën tonë historike fetare.

Të frymëzuar prej emrit tonë të rivendosur dhe identitetit të konfirmuar, ne pohojmë se e konsiderojmë atdheun tonë, Bosnjën, si një bashkësi të lirë dhe demokratike, që do të mbajë gjallë dhe forcojë përpjekjet shumëshekullore drejt tolerancës dhe respektit reciprok të të gjithë traditave dhe banorëve që jetojnë në të. Historia shekullore e kombit tonë do të jetë dëshmitare e kësaj ngjarjeje të rëndësishme.

Për të vazhduar, forcuar dhe konsoliduar ekzistencën e kombit tonë, vendin dhe misionin e tij në botën ku ne jetojmë, për të konfirmuar institucionet tona kombëtare dhe shtetërore, ne vendosëm që asambleja boshnjake do ta vazhdojë punën e saj në të ardhmen. Asambleja do të jetë një institucion kombëtar ku të gjithë boshnjakët do të vijnë të diskutojnë për problemet e rëndësishme të popullit dhe shtetit tonë me liri të plotë mendimi, duke respektuar bindjet e ndryshme dhe me kompetencë dhe përgjegjësi maksimale, do të përcaktojnë rrugën për përpjekjet kombëtare.

Allahu qoftë dëshmitari ynë për qëllimet tona të ndershme dhe na dhëntë mbështetje.

Musić, 1995, fq. 38.

V-12. Pelegrinazhet kishtare në Sllloveni

Pasi Sllovenia shpalli pavarësinë në vitin 1991, pelegrinazhet kishtare filluan të tërhiqnin më shumë vëmendjen e medias. Kryepeshkopi i Lubjanës dhe metropoliti slloven fituan më shumë autoritet publik. Pelegrinazhi më popullor i vitit kryhet në Ditën e Shën Marisë, kur mijëra pelegrinë arrijnë në qytetin e Brezjes, zona e varrit kombëtar të Virgjëreshës Mari. Fjalimet e Kryepeshkopit në këtë ceremoni, kanë tërhequr gjithmonë vëmendjen e publikut, qoftë për shkak të marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe kishës para nënshkrimit të Konkordatit midis Selisë së Shenjtë dhe Sllovenisë në vitin 2004, qoftë për shkak të pikëpamjeve morale të udhëheqësve klerikë. Për shembull, Kryepeshkopi Franc Rode, prezantoi temën e ateizmit liberal në rritje, për të cilën ai mendonte se po minonte bazat e shoqërisë sllovene.

Ateizmi liberal është fajtori

Në prani të rreth tetë mijë personave në Brezje, Dr. Rode deklaroi: Media po ia vë fajin Kishës - kombi slloven është i mbyllur, në depresion dhe i ndarë
Brezje – gjatë meshës së shenjtë në ceremoninë e djeshme të Ditës së Fjetjes së Hyjlindëses, si edhe përvjetorit të shenjtërimit të kombit slloven ndaj Virgjëreshës Mari në Brezje, Kryepeshkopi i Lubjanës dhe Metropoliti, Dr. Franc Rode, thanë se ateizmi liberal po drejtonte shtetet tona, dhe se humbja e besimit është arsyeja e pakësimit të lindjeve dhe shtimit të aborteve, vetëvrasjeve, abuzimit me drogë dhe seksualizmit të shfrenuar. […]

"Hapësira jonë publike është marrë në kontroll nga një ideologji e mesianizmit [lëvizje e bazuar në besimin e ardhjes së Mesisë] ateist. Në vend të ish-Marksizmit, ne jemi drejtuar nga ateizmi liberal. Kjo mund të shihet shumë mirë në mediat publike, veçanërisht në shtypin e shkruar. Në vend që ata të vëzhgojnë në mënyrë kritike funksionimin e qeverisë, ata sulmojnë Kishën me qëllim diskreditimin moral të saj dhe heqjen e statusit që ajo ka te njerëzit. Në këtë çështje, ky është ndoshta veprimi më i padëshirueshëm, më dritëshkurtëri dhe më i dëmshmi në vendin tonë. Duke qenë se besimtarët janë krejtësisht të pabarabartë në këtë fushë, ne nuk kemi asgjë tjetër se çfarë mund të bëjmë përveçse të jemi kritikë dhe të mos mashtrohemi nga informacioni i rremë, veprimet e padenja dhe trajtimi i njëanshëm i fakteve. […]

Felc, Delo, 16 gusht 1999,

Përse mendoni se ateizmi, qoftë marksist apo liberal, konsiderohet nga kryepeshkopi i Lubjanës si fajtor për të gjitha të këqijat që ndodhin në Serbi? Si përkufizohet ateizmi marksist dhe liberal? Cili është ndryshimi? Diskutoni.

V-13. Feja në Shqipëri

Popullsia shqiptare është e ndarë në tre grupe fetare kryesore. Bashkësia më e madhe, ajo myslimane, ka në radhët e saj myslimanë syni dhe myslimanë bektashi , ku këta të fundit janë sekt heterodoks. Nuk ka ende statistika zyrtare të sakta për përkatësinë fetare. Statistikat para Luftës së Dytë Botërore tregojnë se rreth 70% e popullsisë së përgjithshme janë myslimanë, 20% ortodoksë dhe 10% katolikë romakë. Ato nuk marrin në konsideratë brezat e vonë të shqiptarëve, disa prej të cilëve kanë një "ndjenjë ateiste shumë të dallueshme", ndërsa shumë të tjerë, fëmijët nga martesa të përziera, nuk kanë përkatësi fetare të veçantë. Kjo është pasojë e sundimit të ideologjisë komuniste nga viti 1944 deri në 1990, kur në vitin 1967 u mbyll/n institucionet fetare, duke e deklaruar Shqipërinë si "shtetin e vetëm atesit në botë". Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1990, u rikrijuan bashkësitë fetare. Në korrik të vitit 1991, Sinodi i Patriarkatit Ekumenik të Kostandinopojës emëroi Kryepeshkopin Anastas Janullatos, ish-profesor i Teologjisë në Universitetin e Athinës, si Kreun e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Kryepeshkopi Janullatos dha një kontribut të rëndësishëm në rigjallërimin e institucioneve të Kishës Ortodokse dhe Kisha u angazhua gjithashtu në veprimtari shoqërore dhe kulturore. Fillimisht disa grupe besimtarësh ortodoksë shqiptare, e kundërshtuan emërimin e Janullatosit, duke pretenduar se një shtetas grek nuk mund ta drejtojë hierarkinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe ka pasur kundërshtime të vazhdueshme për të nga disa shqiptarë të bashkësive të tjera fetare.

A. Deklarata e Kishës Ortodokse Shqiptare

KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË
Rr. e Kavajës Nr. 151, Tiranë. Tel 234117
DEKLARATA

E përshëndesim me gëzim dhe shpresë Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të nënshkruar këto ditë

ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian dhe ne do dëshironim t'i përgëzonim itharët e saj.

Por, në kundërshtim me këto zhvillime, javët e fundit ne kemi dëgjuar thirrje ekstremiste dhe nacionaliste që po përpiqen të cenojnë, nëpërmjet akuzave tinëzare dhe historive të shtrembëruara, klerikët ortodoksë dhe Kishën Ortodokse në përgjithësi dhe Kryepeshkopin e tij në veçanti. Duke iu referuar ceremonive mortore të administruara nga një prift ortodoks në Përmet, gjatë zhvarrosjes së ushtarëve grekë, disa politikanë kërkuan vazhdimisht (pa kurrfarë logjike) largimin e Kryepeshkopit Ortodoks. Personat e paaftë, të njohur apo jo, që janë pjesë e bashkësive të tjera fetare, ose që nuk i përkasin asnjë lloj feje, vazhdojnë të përzihen në punët e brendshme të Kishës Ortodokse, duke pretenduar madje se kanë aftësi për të vendosur për drejtuesit e saj. Kjo ndërhyrje në punët e brendshme cenon bashkëjetesën paqësore ndërmjet bashkësive fetare që deri më tani ka qenë krenari e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare; dhe kjo ka qenë një arsye e fortë e mbështetjes për miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Besimtarët dhe klerikët protestojnë me vendosmëri kundër zhurmës së padrejtë dhe të sajuar që qarqe të veçanta përdorin në përpjekjet e tyre për të dëmtuar Ortodoksinë dhe drejtuesit e saj. Gjatë gjithë këtyre viteve, pas rigjallërimit të plotë të Kishës, Kryepeshkopi Anastas, nëpërmjet pranisë dhe veprimtarisë së tij, mesazheve të dashurisë, shpresës, ndershmërisë, dhe pajtimit dhe paqes që ka drejtuar, si edhe veprimtarisë së tij ndërfetare dhe programeve shoqërore që ai ka ndërmarrë dhe zhvilluar (në fushën e kujdesit, shëndetit, arsimit, zhvillimit të bujqësisë, kulturës, etj.), ka hapur mijëra vende të reja pune dhe iu ka ardhur në ndihmë njerëzve të cilësdo përkatësie fetare qofshin ata. Ai ka dhënë një kontribut të çmuar gjatë këtyre viteve për zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe integrimin e saj në familjen evropiane.

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë vazhdon të kryejë punën e saj krijuese duke treguar respekt për të gjithë, dhe në të njëjtën kohë kërkon që të gjithë t'i respektojnë institucionet dhe pavarësinë e saj, siç e përcakton edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Tiranë, 16 qershor 2006
Sinodi i Shenjtë, Klerikët Ortodoksë dhe Këshilli Kleriko-Laik

B. Durrës, qyteti i dytë i Shqipërisë. Xhamia në sheshin kryesor të qytetit, një shenjë e rigjallërimit të fesë në Shqipërinë postkomuniste



Fotografi: Roland Tasho.

B. Një nga vizitat e Nënë Terezës në Shqipëri

Nënë Tereza, ose ndryshe Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, lindi më 26 gusht 1910 në Shkup, në një familje shqiptare katolike dhe vdiq më 5 shtator të vitit 1997 në Kalkuta, Indi. Ajo ishte humaniste katolike dhe për veprimtarinë e saj humanitare në botë fitoi Çmimin Nobel për Paqen në vitin 1979. Në vitin 2003 ajo u lumturua nga Vatikani. Ndërkohë që feja e saj në vitet e diktaturës komuniste në Shqipëri u shpall e paligjshme, ajo nuk mundi t'i vizitonte të afërmit e saj në atdhe. Vizitën e saj të parë në vendlindje ajo e bëri në vitin 1989 pasi regjimi komunist i Ramiz Alisë filloi të ndërmerrte disa reforma liberalizuese. Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1990, Nënë Tereza krijoi rrjetin e misionarëve në Shqipëri. Ajo dhe shkrimtari i njohur Ismail Kadare u bënë pika referimi dhe simbole për Shqipërinë postkomuniste, në një kohë kur vendi që dikur konsiderohej "një kështjellë komuniste e izoluar" po kërkonte një afirmim të ri të identitetit të tij, një proces që shpesh përshkruhej si "rikthim në Evropë". Nënë Tereza, si një simbol identiteti i rëndësishëm, u vu në qendër të diskutimeve ndërmjet nacionalistëve shqiptarë dhe atyre maqedonas, që kërkonin "identitet kombëtar të veçantë" për të, duke e paraqitur atë herë si shqiptare dhe herë si maqedonase.



Fotograf: Petrit Kumi.

Përse mendoni se reagimet e bazuara në qëndrimet nacionaliste, përpiqen të përcaktojnë ose formësojnë praninë dhe veprimtarinë e autoriteteve ose udhëheqësve fetarë si: Kryepeshkopi Anastas dhe Nënë Tereza?

V-14. Myslimanët pa xhami në Sllloveni



Lutja kryesore në mjediset sportive Kodeljevo, Lubjanë, shënon fillimin e pushimeve myslimane të Eid al-Adha, 2008. Fotografi nga: Tamino Petelinsek/STA.

Që në vitet 1960 u ndërmorën disa nisma për të ndërtuar një xhami në Lubjanë. Megjithatë, autoritetet shtetërore dhe vendore e shmangën ndërtimin e saj, madje edhe sot çështja e vendit të duhur për ndërtimin e objektit të kultit për myslimanët, mbetet ende e pazgjidhur, dhe për rrjedhojë, bashkësisë myslimane sllovene i duhet t'i kryejë ritet e tij në faltore të vogla. Gjatë pushimeve më të rëndësishme, bashkësia myslimane duhet të marrë me qira një sallë sportive ku pjesëtarët e tij mund të luten.

Përse mendoni se disa shtete si Sllovenia (ose Greqia) ende e refuzojnë, ose e vonojnë lejen për ndërtimin e një xhamie në kryeqytetet e tyre ku jetojnë një numër i konsiderueshëm besimtarësh myslimanë? Diskutoni çështjen.

V-15.Kisha e pavarur e Malit të Zi

Në vitin 1920, metropolitanati i Malit të Zi hyri në strukturën e një organizimi të unifikuar të kishës në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Idetë për ndarjen e Kishës Ortodokse të Malit të Zi nga struktura e Kishës Ortodokse Serbe (KOS), u shfaqën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, por nuk u realizuan. Në vitet 1990, ideja se duhej të kishte një Kishë Ortodokse në Malin e Zi, u mbështet nga udhëheqja politike e Malit të Zi. Kisha Ortodokse e Malit të Zi u krijua ose "restaurua" më 31 tetor 1993. Selia e saj ndodhet në

→

Cetinje. Në vitin 1996, Arkimandriti Mirash Dedeiç u zgjodh kreu i KOM me emrin Metropoliti Mihailo. Nga ana tjetër, Metropolitanati i Malit të Zi dhe Litorali (titull i peshkopit i KOS), i drejtuar nga Metropoliti Amfilohije Radoviç, zotëron asete të mëdha në Mal të Zi dhe ka marrëdhënie shumë të mira me Kishën Ortodokse Ruse dhe Patriarkanën e Kostandinopojës. Kisha Ortodokse e Malit të Zi, që nuk njihet nga kishat e tjera ortodokse, ka një numër të paktë besimtarësh dhe mbijeton kryesisht falë mbrojtjes dhe mbështetjes nga disa parti politike. Prej shumë vitesh KOM dhe KOS jetojnë paralelisht dhe në mosmarrëveshje të vazhdueshme.

A. Intervistë me Metropolitin e Kishës Ortodokse të Malit të Zi (KOM) Mihailo

"Pjesa më e vështirë ishte fillimi kur Kisha Ortodokse e Malit të Zi u konfirmua në vitin 1993, kur aty ishte Peshkopi Antonije. Presioni ra gradualisht, por ne anatemoheshim gjithë kohës, na quanin "përçarës". Megjithatë, ne punuam për këtë, dhe në vitin 2000 ne u njohëm zyrtarisht dhe u regjistruam nga shteti i Malit të Zi... Pas konfirmimit të plotë të shtetësisë, për herë të parë ne ishim pjesë e buxhetit të shtetit të Malit të Zi, dhe si rrjedhojë ne sot marrim nga shteti një shumë të caktuar parash njësoj si edhe bashkësitë e tjera fetare në Mal të Zi... Lidhur me çështjen e autoqefalisë së Kishës së Malit të Zi, ajo ka qenë autoqefale që prej vitit 1766, pra ajo ka qenë praktikisht e pavarur që prej 300 vjetësh. Gjatë kësaj kohe, ajo nuk ka qenë nën juridiksionin e ndonjë Kishe Ortodokse të Evropës Lindore... Kisha e Malit të Zi më vonë vuajti më shumë nga përndjekja që zhvilloi kundër saj Kisha Ortodokse Serbe. […]. Akti ligjor themeltar, Kushtetuta e Malit të Zi e vitit 1905, e përcaktoi Kishën Ortodokse të Malit të Zi autoqefale. […] Personave përgjegjës të autoriteteve tona unë iu thashë: Nëse doni ta stabilizoni Malin e Zi si shtet, ju duhet të zgjidhni çështjen e Kishës Ortodokse të tij. Nëse ju planifikoni t'ia jepni pronën e CPC-së Kishës Ortodokse Serbe, kjo do të thotë se Mali i Zi është një shtet serb, duke i bërë malazezët subjekt të të tjerëve.

Të prirur drejt përkrahjes së Kishës së Malit të Zi janë: Milo Gjukanoviç, Ranko Krivokapiç dhe kolegë të tjerë. […]Unë kam qenë tri herë në Vukovar pasi aty ndodhi një krim i paprecedentë. Unë ndjeva nevojën për t'i nderuar ato viktima, si edhe për shkak të gjithçkaje që ndodhi në Dubrovnik... Unë isha në Srebrenicë gjithashtu, si peshkopi i parë ortodoks nga Evropa.

"Pobjeda", numër 14 , 2010, fq. 2-5.

B. Djegia e një turre drurësh Yule në Malin e Zi nga Metropoliti Amfilohije, 2002



Fotografi nga: Savo Prelevic (Vijesti-Mal i Zi).

Turra e drurëve Yule që digjet gjatë Krishtlindjeve, është një turrë drurësh e përzgjedhur posaçërisht për t'u djegur në vatër si traditë e Krishtlindjeve në një sërë shtetesh në Evropë. Origjina e kësaj tradite folklorike është e paqartë. Shumë studiues kanë vënë re se ashtu si në traditat e tjera të shoqëruara me Yule (si derri i egër), zakoni mund ta ketë origjinën nga paganizmi gjermanik.

Ndiqni mendimet dhe qëndrimet e Metropolitit Mihailo.

1. Cilat janë argumentet bazë dhe më të rëndësishme që mbrojnë Kishën Autoqefale të Malit të Zi? A janë ato argumente fetare, historike apo politike? Cili është roli i fesë dhe kishës në shtetin modern?

2. Cili është kuptimi i deklaratës "Pozicioni im është se kishat duhet të jenë të hapura për të gjithë priftërinjtë që iu shërbejnë besimtarëve. Lërini të gjithë që të vijnë aty. Kishat malazeze nuk do të mbyllen për priftërinjtë serbë, ose për ata katolikë"? Si e kuptoni këtë deklaratë?

3. "Unë kam qenë tri herë në Vukovar pasi aty ndodhi një krim i paprecedentë. Unë ndjeva nevojën për t'i nderuar ato viktima, si edhe për shkak të gjithçkaje që ndodhi në Dubrovnik... Unë isha në Srebrenicë gjithashtu, si peshkopi i parë ortodoks nga Evropa": Përse mendoni se Metropoliti Mihailo iu referohet këtyre vendeve? Çfarë ndodhi aty? Si lidhet kjo deklaratë me atë të mëparshme (shihni pyetjen 2)?

V-16. Futja e fesë si lëndë shkollore në Rumani

Në periudhën pas luftës, liria e shprehjes së ndjenjës fetare u bë simbol i kundërshtimit të regjimit komunist, që propagandonte ateizmin dhe imponoi laicitetin në jetën publike. Madje edhe shkëndijat e Revolucionit të dhjetorit të vitit 1989 filluan nga solidariteti i treguar nga banorët e Timisoaras (pavarësisht etnisë ose besimit të tyre fetar) kundër persekutimit të pastorit protestant hungarez Laszlo Tokes. Që nga fillimi, udhëheqësit e rinj të vendit (Fronti Kombëtar i Shpëtimit) e lidhnin veten me simbolet dhe ritet e Kishës Ortodokse Rumune, duke nxitur rikonfirmimin e shpejtë dhe mbresëlënës të institucionit që ka mbijetuar nën hijen e diktaturës komuniste. Në kontekstin e mbështetjes popullore dhe politike në rritje, Kisha Ortodokse ndërmori ndryshime në kurrikulat kombëtare, në një kohë kur pranoheshin vetëm heqje të tyre (edukimi politik, trajnimi paraushtarak, edukimi teknologjik i tepërt, etj.), krahas rikthimit të atyre teksteve shkollore të historisë kombëtare të përdorura deri në vitet 1940.

A. Pasi ta bëni vetë kryqin si duhet, duke thënë: "Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë, Amen"



Institutului Biblic şi de Misiune al Bisericii Orodoxe Române, 1992, fq. 9, 37.

A. Dhënia e këshillave për mësimdhënien e fesë në shkollë

Çfarë ndodhi gjatë 45 viteve të diktaturës komuniste, materialiste dhe ateiste? [...] Mohimi i kuptimit të ekzistencës njerëzore me përpjekje për ta zëvendësuar këtë mungesë nga hibride të ndryshme: ideologji, veprimtari politike, një vizion shkencor të rremë ose praktika pseudo-shpirtërore (p.sh. meditim transcendental). Një shkatërrim moral në të gjitha sferat e shoqërisë. Por [...] Hyjnorja [...] nuk mund të asgjësohet. Kjo është arsyeja se përse në datat 16-22 dhjetor të vitit 1989, ishin kryesisht të rinjtë që kanë qenë subjekt i ateizmit, që nxorën në dritë nga thellësitë e tyre [...], vërtetimin më të pastër të sakrificës hyjnore.
Îndrumări *metodologice...*, 1990, fq. 3, 9.

B. Si u ndëshkua Vasilika ngaqë donte të prishte çerdhen e dallëndysheve

Jini të sjellshëm me të gjitha krijesat. Fëmijët janë të sjellshëm me kafshët dhe zogjtë. Ato janë krijesa të Zotit. Zoti i do ato. Ai i ushqen dhe kujdeset për to. Por Vasilika është djalë i keq. Ai i torturon kafshët. Një ditë ai donte të prishte çerdhen e dallëndysheve, por ndodhi diçka e padëshirueshme. Ai u ngjit në shkallë. Ai donte të prishte çerdhen por nuk ia doli. Shkalla rrëshqiti dhe Vasilika u rrëzua. Gjithë verën ai e kaloi në spital i shtrirë në shtrat. Dallëndyshet cicërojnë të lumtura! Ato falënderojnë Zotin që i mbrojti nga Vasilika!

Saucă, 1992, fq. 37.




Cili është konteksti dhe stili i tekstit shkollor rumun të fesë (dokumenti V-16.A)? A flet lënda për arsimin fetar në përgjithësi apo mund të zbulojë dikush predikim fetar (konvertim)? Diskutoni për këtë duke marrë gjithashtu parasysh dokumentin C.

V-17. Dhënia e letërnjoftimit në Greqi

Në maj të vitit 2000, Ministri i Drejtësisë në qeverinë socialiste të Kostas Simitis njoftoi se, në përputhje me Ligjin 2472/1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", përfshirjes së detyrueshme të deritanishme të besimit fetar në letërnjoftime do i jepej fund. Kjo ndeshi me kundërshtimin e vrullshëm të hierarkisë së Kishës dhe qarqeve konservatore në shoqëri. Karizmatiku dhe populisti Christodoulos, Kryepeshkopi i Athinës, udhëhoqi fushatën duke organizuar manifestime masive dhe duke mbledhur shumë firma për një referendum lidhur me këtë çështje. Përpjekjet e tij nuk sollën asgjë.

A. Koleksioni i firmave



ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ

ΙΕΡΑ ΣΥΝΟΔΟΣ ΣΤ

ΤΗΣ ΕΚΚΛΗΣΙΑΣ ΤΗΣ ΕΛΛΑΔΟΣ

No.

ΣΥΛΛΟΓΗ ΥΠΟΓΡΑΦΩΝ

ΓΙΑ ΤΗΝ ΔΙΕΝΕΡΓΕΙΑ ΔΗΜΟΨΗΦΙΣΜΑΤΟΣ

Επίθετο

Όνομα

Όνομα Πατρός

Δήμος ή Κοινότητα Κατοικίας

Αριθμός Ταυτότητος

Υπογραφή

Koleksion privat.

B. Sinodi i Shenjtë bën thirrje për një referendum për të vendosur nëse duhet regjistruar apo jo feja në letërnjoftime

REPUBLIKA HELENE
SINODI I SHENJTË
I KISHËS SË GREQISË
KOLEKSIONI I FIRMAVE
PËR MBAJTJEN E REFERENDUMIT

Unë dëshiroj vënien në veprim të nenit 44 të Kushtetutës aktuale për mbajtjen e referendumit në mënyrë që unë, si qytetar grek, të shpreh pikëpamjen time nëse duhet regjistruar apo jo feja në letërnjoftime.

Kërkesa ime bazohet gjithashtu në nenet 1/pikat 2 dhe 3, 5/pika 1, 13/pika 1, dhe neni 25/ pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës së vendit, si edhe në Konventën e të Drejtave të Njeriut (nenet 9 dhe 10) dhe në të drejtën e vetëvendosjes individuale.

Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Greke, i referohet Kushtetutës së Greqisë dhe Konventës së të Drejtave të Njeriut për të drejtën e vetëvendosjes individuale kur bëhet fjalë për mundësinë e qytetarëve për të pasur të deklaruar në letërnjoftime fenë e tyre. Sipas mendimit tuaj, përse mendonin ata se ishte e rëndësishme për njerëzit që të deklarojnë fenë e tyre në publik? Çfarë lloj dokumenti është një kartë identiteti? A është çështja e besimit dhe orientimit fetar një çështje publike apo private, apo të dyja? Diskutoni duke marrë parasysh shprehjet e skajshme të besimit fetar.

V-18. Feja dhe identitetet: Ekstrakte nga Ligji rumun Nr. 489/2006 "Për lirinë fetare dhe statusin e përgjithshëm të feve"

Ligji shmangu në mënyrë të qartë gjithëpraninë e padiskutueshme të Kishës Ortodokse Rumune në vend, duke garantuar mundësinë e shfaqjeve publike për çdo fe apo besim tjetër që kanë mundësi të përmbushin një sërë kushtesh të përfaqësimit. Megjithatë, kishte një perceptim diskriminues për disa grupe minoritare që nuk mund të mobilizonin burime të mjaftueshme për të përmbushur kushtet ligjore (për shembull dëshmitarët e Jehovait),

→

ose disa institucioneve që nuk iu ishin kthyer asetet e konfiskuara nga regjimi komunist (rite lindore të Kishës Katolike). Ky diskriminim u konsiderua si një rrjedhojë e bashkëbisedimeve shumëpalëshe ndërmjet përfaqësuesve të feve "historike" (Ortodokse, Katolike, Protestante), që në të vërtetë deklaruan se ata ishin të kënaqur me tekstin e ligjit. Kritikat erdhën veçanërisht nga SHBA-ja dhe përfaqësuesit e besimeve fetare, zëri i të cilëve nuk ishte dëgjuar dhe që ishin persekutuar nga regjimi komunist (protestantët e rinj, Baha`i), një qëndrim që ishte trashëguar nga zyrtarë të autoriteteve post-komuniste.

Neni 1. – (1) Shteti rumun respekton dhe garanton të drejtën themelore të lirisë së mendimit, vetëdijes dhe fesë për çdo qytetar në territorin rumun, në përputhje me Kushtetutën dhe traktatet ndërkombëtare ku Rumania është palë. [...]

Neni 2. – (1) Liria e fesë përfshin të drejtën e çdo qytetari për të pasur ose përvetësuar një fe, për të manifestuar individualisht ose kolektivisht, publikisht apo privatisht, nëpërmjet praktikave dhe riteve të veçanta, edukimit fetar, si edhe lirisë për të ruajtur ose ndryshuar besimin fetar të dikujt.

(2) Liria për të treguar fenë e dikujt nuk mund të jetë subjekt i kufizimeve që nuk janë përcaktuar në ligj dhe që nuk përfaqësojnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike për sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, shëndetit ose moralitetit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. […]

Neni 7. – (1) Shteti rumun njeh rolin e partneritetit shpirtëror, arsimor, shoqëroro-bamirës, kulturor, dhe shoqëror të feve, si edhe statusin e tyre si aktorë të paqes shoqërore.

(2) Shteti rumun njeh rolin e rëndësishëm të Kishës Ortodokse Rumune dhe të kishave dhe feve të tjera të njohura në historinë kombëtare të Rumanisë dhe jetën e shoqërisë rumune.

Neni 8. – (1) Fetë e njohura janë subjekte ligjore me interes publik. Ato janë të organizuara dhe funksionojnë sipas dispozitave të Kushtetutës dhe në përputhje me ligjin në fuqi, në mënyrë të pavarur, sipas rregulloreve dhe kodeve të tyre kanonike.[…]

Neni 9. – (1) Në Rumani nuk ka fe shtetërore; shteti është asnjanës në lidhje me besimin fetar apo ideologjinë ateiste.

(2) Fetë janë të barabarta para ligjit dhe autoriteteve publike. Shteti, nëpërmjet autoriteteve të tij, nuk nxit apo favorizon dhënien e privilegjeve ose krijimin e diskriminimit ndaj fesë. […]

(4) Shteti rumun, nëpërmjet autoriteteve kompetente publike, mbështet veprimtarinë shpirtërore, kulturore dhe shoqërore të kryer jashtë besimeve fetare të njohura në Rumani.

Neni 10. – (1) Shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve fetare dhe veprimtarive të tyre do të mbulohen kryesisht nga të ardhurat e vetë feve, të krijuara dhe administruara në përputhje me rregulloret e tyre.

Ligji Nr. 489/2006, i publikuar në "Fletoren Zyrtare", Pjesa I, nr. 11, 18 janar 2007, fq. 2-3.

V-19. Kundërshtitë për shaminë në Turqi

Kundërshtitë për shaminë në shkolla dhe institucione publike datojnë me rregulloren e hartuar në vitin 1984, në periudhën pas grushtit ushtarak të shtetit të 12 shtatorit të vitit 1980. Megjithëse ushtria ia kaloi pushtetin qeverisë civile, pas zgjedhjeve të vitit 1983, ajo vazhdoi të ushtronte ndikim nëpërmjet zyrës së Presidentit, të uzurpuar nga udhëheqësi i grushtit të shtetit të vitit 1980, Kenan Evren, si edhe nëpërmjet ndikimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Rregullorja që ndalonte shaminë në universitete dhe institucione publike, mbeti në fuqi për 30 vite, por u zbatua me më shumë rreptësi pas ndërhyrjes ushtarake të 28 shkurtit të vitit 1998, që rrëzoi koalicionin e udhëhequr nga Partia e Mirëqenies dhe u zotua për të "luftuar Islamizmin reaksionar". Në kohën kur AKP erdhi në pushtet në vitin 2002, ndalimi i shamisë mbeti ende në fuqi. Më pas ky ndalim u zbut gradualisht, së pari nga Bordi i Arsimit të Lartë nëpërmjet një dekreti të vitit 2008 që i lejoi studentet me shami të kishin akses të pakufizuar në universitete. Ky dekret u pasua nga paketa e demokratizimit e tetorit të vitit 2013, që ndryshoi nenin 5 të kodit të veshjes për nëpunësit publikë, duke hequr në këtë mënyrë kufizimet për përdorimin e shamisë në institucione publike përveç ushtrisë, policisë dhe gjykatave. Në Asamblenë e Madhe Kombëtare të Turqisë, përpjekja e parë e prezantimit të një deputeteje me shami nga Partia e Virtytit në vitin 1999 rezultoi në përjashtimin e deputetes (Merve Kavakçı) nga parlamenti. Megjithatë, pak kohë pas vendosjes së ndalimit të shamisë në institucionet publike, më 31 tetor 2013, katër deputete të AKP-së hynë në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë (AMKT) të veshura me shami dhe nuk pati reagime negative nga opozita.


"Vendosja e shamive duhet të jetë e lirë në universitete"

Joost Lagendijk, bashkëkryetar i Komisionit të Përbashkët Parlamentar BE-Turqi, në një panel të organizuar nga Instituti Turk në Utreht, me titullin "Modernizimi dhe Demokratizimi në Turqi", u shpreh se shfuqizimi i ligjit të ndalimit të shamisë nuk bie ndesh me parimet e BE-së. Duke cituar si shembuj atdheun e tij, Holandën, dhe Britaninë, Lagendijk deklaroi:

"Të dyja palët duhet të përpiqen të gjejnë gjuhën e përbashkët për çështjen dhe të çojnë drejt një liberalizimi të përgjithshëm të mjedisit dhe të pranojnë faktin se studentët janë të rritur dhe mund të vendosin vetë për vete." Lagendijk shprehu gjithashtu mbështetjen për përgatitjet e vazhdueshme për një kushtetutë të re në Turqi, duke thënë se "Parlamenti Evropian e mbështet debatin e ri për kushtetutën në Turqi. Të gjitha këto çështje me ngarkesë ideologjike për të cilat Turqia po harxhon kohë dhe energji, shpresojmë se do të zgjidhen me kushtetutën e re."

"Lagendijk: Türban Üniversitede Serbest Olmalı"[Lagendijk: Vendosja e shamive duhet të jetë e lirë në universitete], NTV, 4 shkurt 2008, http://arsiv.ntv.com.tr/news/434324.asp, vizituar më 01.07.2016.

V-20. Harta e popullsisë alevi në Turqi



https://en.wikipedia.org/wiki/Alevism, vizituar më 23.12.2015.

Popullsia alevi e Turqisë (rreth 15% e popullsisë së përgjithshme) përbën bashkësinë më të madhe jo syni në vend. Në vitin 1970, të rinjtë u rreshtuan në masë në anën e të majtës radikale, ndërsa bashkësia aleve u vu në objektiv të organizatës nacionaliste të ekstremit të djathtë, "Ujqërit Gri". Një nga sulmet më të përgjakshme kundër veprimtarëve alevi, i njohur si "Masakra e Marashit", ndodhi në qytetin e Kahramanmaras, në dhjetor të vitit 1978. Në hartë, krahinat turke me përqindje të lartë të popullsisë alevi tregohen me ngjyrën blu (ato me ngjyrë më të errët si Tunceli dhe Sivas kanë më shumë se 90%), ndërsa ato me ngjyrë të bardhë tregojnë përqindje të vogël të popullsisë alevi (më pak se 10%).

V-21. "Top Sekreti" i Nedko Solakov

Artisti evropian bashkëkohor Nedko Solakov ka krijuar një sërë vizatimesh, pikturash, performancash dhe instalacionesh në të cilat ai përdor humorin dhe absurditetin për të vënë në pikëpyetje nëpërmjet kritikës praktikat dhe institucionet e artit, si edhe normat dhe pritshmëritë shoqërore. Në një nga krijimet e tij më të rëndësishme, që tingëllon edhe si një akt katarsisi dhe hapjeje, i titulluar "Top Sekreti" (1989), Solakov mbushi një arkë të vogël me letra që jepnin hollësi për bashkëpunimet e tij, në moshë të re, me policinë sekrete bullgare. Duke

→

reaguar ndaj kundërshtive që lindën për punën dhe rrëfimin tronditës që ai përmbante, Solakov shkroi, "Vetëm ai ose ajo që kapërcen frikën e tij ose saj mund të jetë artist i vërtetë". https://www.artsy.net/artist/ nedko-solakov, vizituar më 21.10.2015). Ishte pikërisht kjo krijimtari që e bëri atë jashtëzakonisht të njohur. Tashmë kjo krijimtari e tij ndodhet në koleksionin e Van Abbemuseum në Eindhoven.

Një bisedë me Nedko Solakov

Ky punim [*Kameleoni*, shkurt 1990] u porosit prej Komitetit Qendror të Komsomolit nga Qyteti, si një grup që konsiderohet si mbështetës i ideve të reja; ata na paguan për këto punime. Fillimisht, ne kishim si synim të zbukuronim disa pllaka druri me kartat e dala boje të anëtarësisë në Komsomol (Bashkimi i të Rinjve Komunistë Dimitrov, i njohur zakonisht si Komsomol, u shndërrua në Rininë Demokratike Bullgare), të kuqe të ndezura nga jashtë dhe blu nga brenda, dhe t'i vendosnim ato para Pallatit Kombëtar të Kulturës në Sofje. Më pas, më lindi ideja e bërjes së një siluete të kameleonit. Kartat e anëtarësisë u bënë luspa të kuqe në lëkurën e tij, dhe çdo herë që frynte "era e ndryshimit" ato hapeshin dhe zbulonin pjesët e tyre të brendshme me ngjyrë blu të hapur (ngjyra e opozitës, Bashkimi i Forcave Demokratike/SDS). Dhe kjo ndodhi vërtetë. Njerëzit filluan të sillnin kartat e tyre të Komsomol-it, që në atë kohë ishin ende një dokument identifikimi shumë serioz, dhe ne i ngjitëm ato në trupin e kameleonit. […]

"Top Sekreti", i krijuar në dhjetor të vitit 1989 dhe shkurt të vitit 1990, është një kuti treguese, e mbushur me një sërë kartash që japin hollësi për bashkëpunimin në vitet e rinisë së artistit me sigurimin e shtetit bullgar, veprimtari të cilën ai e ndërpreu në vitin 1983. Në Bullgari, 25 vite pas ndryshimit të regjimit, dokumentet zyrtare mbetën të mbyllura, dhe nuk ka dokumente që njihen nga publiku për këtë bashkëpunim të artistit. Puna e tij shkaktoi kundërshti të mëdha kur u ekspozua për herë të parë në verën e vitit 1990, në kulmin e ndryshimeve politike pas sundimit të gjatë komunist. Ky gjest vetëzbulues si një projekt artistik është ende i veçantë në kontekstin e Evropës postkomuniste, dhe që prej shfaqjes së tij, *"Top Sekret"* u bë ikonë e kohës së saj. Një video 40 minuta e gjatë, që paraqet artistin duke rilexuar përmbajtjen e kutisë treguese, u regjistrua në studion e tij në Sofje në vitin 2007.

Vassileva, fq. 280, 286.
[Autori i tekstit të "Top Sekret" është Lachezar Boyadzhiev, një tjetër artist i famshëm bullgar.]


V-22. Santa i Ballkanit



Turqit bullgarë gjatë Krishtlindjeve në qytetin e Ardinos, Rodopet Jugore, 2007. Fotografi: Aleksei Kalionski.

V.3. KINEMAJA, TEATRI DHE MUZIKA

V-23. Palma e Artë për "*Bodrumi*" (Underground) e Kusturicas



http://www.kustu.com/w2/en:underground, vizituar më 03.07.2016.

"Underground" (e njohur gjithashtu si "Dikur ishte një vend") nga Emir Kusturica fitoi çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit të Kanës, në vitin 1995 dhe u nominua gjithashtu për Çmimin e Akademisë për Filmin më të Mirë të Huaj. Historia epike e dy shokëve, është përdorur për të paraqitur historinë e Jugosllavisë nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore deri në fillimin e Luftërave Jugosllave në vitet 1990. Historia me pak fjalë: Viti 1941. Beograd. Aktivisti komunist Marko ndihmon shokun e tij Blacky te hyjë në Parti. Kur Gjermania pushton Jugosllavinë të dy shokët do të ndajnë kohën e tyre ndërmjet pjesëmarrjes së tyre në rezistencë dhe në kontrabandën shumë të leverdishshme të kohës. Ata do të ndajnë gjithashtu të bukurën Natalija, një aktore që po e "mbron" një oficer nazist. Gjatë konfliktit, Marko do të organizojë fshehjne e Blecky-it dhe grupit të tij në bodrumin e një shtëpie në Beograd, dhe ai do të ketë mundësi ta mbajë Natalijan për vete. Në vitin 1945, kur vendi do të çlirohej, ai nuk do t'i tregonte gjë shokut të vet. Por një ditë, robërit do të largoheshin nga bodrumi dhe do ta shihnin vendin e tyre të shkatërruar nga lufta civile.

V-24. Filmi boshnjak *"Toka e askujt" (No Man's Land)* nga Danis Tanoviç fitoi Çmimin Oskar për Filmin më të Mirë të Huaj në vitin 2001

"Toka e askujt" është një film që paraqet dy ushtarë të plagosur, një boshnjak dhe një serbo-boshnjak. Ata u kapën në kufi në tokën e askujt, në një përpjekje për mbijetesë. Të dy ushtarët u ndeshën me njëri-tjetrin në një kanal, ku iu desh të prisnin derisa të errej.



Oslobođenje, viti LIX, botimi 19804, Sarajevë, 6.04.2002, fq. 5.

Tema e filmit "*Toka e askujt*" është lufta në Bosnjë-Hercegovinë në vitet 1990. Megjithëse kjo luftë nuk është pjesë e mësimeve të historisë, përse mendoni se është më e vështirë për të mësuar këtë temë sesa për të diskutuar për të në kulturën popullore?

→

V-25. Muzika turbo-folk. Koncert nga Svetlana Ceca Raznatoviç (e veja e Arkanit) në Beograd (Ushçe) përballë rreth 120,000 spektatorëve, 17 qershor 2006

Turbo-folku është një zhanër muzikor me rrënjë të thella në folkun komercial dhe muzikën e re folklorike, që ishte shumë e njohur në të gjithë Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë (RFSJ) dhe Ballkanin në tërësi. Këngëtarja Lepa Brena i hapi rrugën rritjes së turbo-folkut, por rritja më e madhe e popullaritetit të tij erdhi në vitet 1990, në kohën e luftërave civile dhe të sanksioneve ekonomike kundër Serbisë.

Arkan (Zeljko Raznatoviç) ishte komandant i një force paraushtarake në luftërat jugosllave. Ai u akuzua për krime kundër njerëzimit, por u vra në vitin 2000, para se të gjykohej.



Toronto Novine.

V-26. Kompozitori grek Mikis Theodorakis në Shkup

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së përkohshme ndërmjet Greqisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në vitin 1995, kompozitori i njohur grek Mikis Theodorakis dirigjoi simfoninë e tij "Greku Zorba" në Teatrin Kombëtar në Shkup (1997). Koncerti u vlerësua si ngjarja e vitit, si në aspektin artistik edhe në atë politik. Presidenti i Republikës Kiro Gligorov dhe pothuajse e gjithë udhëheqja politike e vendit, si edhe shumë intelektualë të shquar ndoqën koncertin. Një delegacion grek prej 200 përfaqësuesish të partive politike, anëtarë të parlamentit, profesorë universitetesh, biznesmenë dhe artistë udhëtuan në Shkup. Gjatë qëndrimit të tij atje, Theodorakis vizitoi varrin e Jorgios Zorbas, i varrosur në varrezën e Shkupit në vitin 1943. Ka një dokumentar të shkurtër kushtuar kësaj ngjarjeje të paraqitur nga televizioni grek: https://www.youtube.com/ watch?v=RfmLOpTa2pw, vizituar më 03.07.2016.



Dokumentari "Në kërkim të Zorbas"; ERT S.A. Arkivi.

V-27. "Oresti" i Unkovskit në Epidaurus, 2008

Slobodan Unkovski lindi në vitin 1948 në Shkup. Ai u diplomua për regji në vitin 1971 në Akademinë e Filmit, Teatrit dhe Televizionit në Beograd. Nga viti 1996 në vitin 1998 ai shërbeu si Ministër i Kulturës në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. "Oresti" (2008) ishte realizimi i veprës së tretë nga Unkovski në gjuhën greke, pas "Motra e Katërt" nga Glovacki dhe "Mbreti Lear" nga Shekspiri (2005), të dyja të vëna në skenë në Teatrin Kombëtar të Athinës. "Oresti" u vu në skenë në Epidaurus në gusht të vitit 2008 dhe në shumë teatro në Greqi (në tërësi 27 shfaqje me më shumë se 23,000 spektatorë).



Koleksion privat (Arkivi i Slobodan Unkovskit).

Kultura mund të hapë mundësi të ndryshme në marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. A mund të gjeni ju ndryshime të tjera kulturore? A mendoni se një "diplomaci e kulturës" mund të jetë një qasje alternative për të gjetur gjuhën e përbashkët për të zgjidhur situatat e tensionuara dhe konfliktuale ndërmjet dy shteteve apo nuk është e rëndësishme? Diskutoni.

V-28. Çmimi "Balkanika" për Letërsinë dhe "letërsia e Ballkanit"

Pas fundit të Luftës së Ftohtë, një sërë organesh botuese shtetërore dhe private morën përsipër të financonin përkthimin e krijimeve letrare të Ballkanit në gjuhët e Evropës Juglindore. Synimi i nismave të tilla ishte njohja e lexuesve me letërsinë e autorëve të Ballkanit dhe promovimi i mirëkuptimit reciprok, duke pasur parasysh se gjatë kohës së Luftës së Ftohtë përkthime të tilla ishin shumë të pakta. Në vitin 1995, disa shtëpi botuese, një nga secili shtet, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumani, Serbi dhe Turqi, krijuan Çmimin "Balkanika" për Letërsinë. Çmimi i jepej çdo vit një autori nga Ballkani vepra e të cilit ishte botuar jo më shumë se dy vite para nominimit. Me përjashtim të botuesit nga vendi i origjinës së marrësit, të gjithë botuesve të tjerë u kërkohet të përkthejnë punën që është nderuar me çmim në gjuhën e tyre. Fituesi i parë i çmimit në vitin 1996 ishte David Albahari nga Serbia. Fituesit pasardhës janë Anton Donchev dhe Zdravka Evtimova nga Bullgaria, Nikos Bakolas dhe Maro Douka nga Greqia, Ismail Kadare nga Shqipëria, Aleksandar Prokopiev dhe Venko Andonovski nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe Tahsin Jycel dhe Nedim Gyrsel nga Turqia.

A. Anton Donchev (Bullgari)

Në Ballkan ka ndryshime të mëdha, si në aspektin e politik edhe për sa i përket zhvillimit të shoqërive, që na largojnë nga njëri-tjetri. Në mënyrë të veçantë, vetëvlerësimi i qytetarëve në ish-vendet komuniste është veçanërisht i ulët dhe ata e gjejnë veten në një situatë të paqartë. Si rrjedhojë, ne nuk mund ta përkufizojmë me pak fjalë termin letërsi ballkanike. Ajo çfarë ne duhet të mbajmë parasysh është se të gjithë ne përbëjmë një bashkësi. Ne jemi si një orkestër, ku secili dhe të gjithë ne duhet të jemi kategoria e parë, kështu që edhe rezultati përfundimtar të mund të jetë gjithashtu i kategorisë së parë.

B. David Albahari (Serbi)

Ne mund ta konceptojmë letërsinë ballkanike vetëm si një term gjeografik. Ekzistojnë ndryshime si ndërmjet kombeve edhe ndërmjet zhanreve letrare. Takimet si ai që ndodhi së fundmi në Athinë nuk krijojnë një letërsi uniforme, që do të ishte patjetër e mangët, por na ndihmojnë të kuptojmë më mirë njëri-tjetrin. Ato lejojnë çdo zhanër letrar të ndikojë te njëri-tjetri. Në rrethanat aktuale, ndërveprimet e këtij lloji mund të jenë mjaft me vlerë.


C. Nedim Gyrsel (Turqi)

Ka shumë vepra letrare të krijuara në hapësirat ballkanike, dhe unë mendoj se një pikënisje e mirë për klasifikimin e tyre është të mendojmë për historinë. Ka nga ata që shohin nga e shkuara dhe pasurojnë të shkruarit e tyre krijues me material historik, dhe nga ata që shqetësohen për të tashmen. Ideja e Çmimit Balkanika për Letërsinë është shumë pozitiv pasi i vendos autorët në lidhje me njëri-tjetrin, veçanërisht në një kohë kur rajoni ynë është i mbërthyer nga konflikte.

Gazeta "To Vima", 6 dhjetor 1999, fq. 57.

Ndajeni klasën në grupe, secili grup përfaqëson një shtet të Evropës Juglindore. Studentëve të secilit grup iu kërkohe ttë përgatisin një listë me emrat e autorëve të vendit të tyre të zgjedhur dhe me punimet e tyre (jo vetëm në fushën e letërsisë), që janë përkthyer në gjuhën amtare të studentëve gjatë pesë viteve të fundit. Secili grup përzgjedh një ose dy libra të shtetit që ata studiojnë dhe diskutojnë për përmbajtjen e librit (librave) në klasë.

V-29. Konkursi i këngëve të Eurovizionit



Who voted for who in the 'Balkan bloc' 2003-2011
Addition of top scores only (12, 10,8 and 7 points)

www.euronews.com/2012/05/21/eurovision-the-great-voting-conspiracy, vizituar më 03.07.2016.

Pjesëmarrja në Festivalin e Këngës në Eurovizion u bë një shprehje e sovranitetit kombëtar për shtetet e reja të pavarura të ish-Jugosllavisë. Në vitin 1993, Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, së bashku me Rumaninë dhe disa shtete të Evropës Lindore hynë për herë të parë në konkurs si shtete të pavarura, ndërsa Serbia mori pjesë për herë të parë nën flamurin jugosllav. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë hyri fillimisht në konkurs në vitin 1996, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi morën pjesë si një shtet i vetëm në vitin 2004 dhe 2005, dhe që prej vitit 2007 secila prej këtyre shteteve ka marrë pjesë veçmas. Shqipëria bëri debutimin e saj në vitin 2004. Midis shteteve të Evropës Juglindore, filloi të shfaqej i ashtuquajturi votimi i bllokut të Ballkanit. Brenda bllokut të Ballkanit ka lidhje të dukshme ndërmjet Greqisë dhe Qipros, Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë, si edhe brenda shteteve të ish-Jugosllavisë. Shteti i parë nga shtetet e pavarura të ish-Jugosllavisë që fitoi Festivalin e Këngës Eurovizion ishte Serbia në vitin 2007 me këngën "Lutje", që u këndua nga Marija Sherifoviç. Në vitin 2004, BBC-ja nxori në pah se "Siç ka treguar tradita në Festivalin e Këngës, fqinjët shpesh votojnë për njëri-tjetrin, ku shtetet e Ballkanit i japin më shumë pikë njëra-tjetrës."

A mendoni se në veprimtari kulturore masive siç është Festivali i Këngës Eurovizion, ka për shprehjen e qëndrimeve nacionaliste? A keni votuar ndonjëherë në një veprimtari të tillë? Diskutoni.

V.4. SPORTI DHE LOJËRAT OLIMPIKE

V-30. Lojërat Olimpike në Athinë, 2004

Lojërat Olimpike Verore të 2004-s (Lojërat e Olimpiadës XXVIII) u organizuan në Athinë nga data 13 deri më 29 gusht. Nën moton "Mirë se vini në shtëpi", ato u përshëndetën nga presidenti i IOC si "lojërat e paharrueshme që ata kishin ëndërruar". Lojërat u konsideruan një sukses, si në aspektin e organizimit edhe në numrin e Komiteteve Kombëtare Olimpike që morën pjesë, si edhe për sa i përket vlerësimeve nga teleshikuesit. Pavarësisht kritikave nga disa qarqe, publiku grek u shpreh, në një masë të madhe, shumë pozitivisht ndaj tyre, duke i konsideruar ato një arritje të re kombëtare që lidhej drejtpërdrejt me imazhin e vendit në mbarë botën.


A. Ceremonia e hapjes së Lojërave



Imazhe në lëvizje, Tomas Krisohoidis.

Nën drejtimin e koreografit Dimitris Papaioanu, ceremonia e hapjes së Lojërave vuri në duke lidhjen e Greqisë bashkëkohore me qytetërimin antik grek si vendlindja e qytetërimit botëror (dhe e Lojërave Olimpike). Ajo krijoi gjithashtu idenë e historiografisë kombëtare greke, që ka vazhdimësi nga periudha parahistorike në atë të tashmen.

B. Reagime për Lojërat Olimpike të 2004-s



Përkthimi:
Frika dhe Korrupsioni / Varri i punëtorëve të panjohur / Ata u vranë në kantieret e ndërtimit të "idesë së madhe" nga kapitalizmi dhe drejtuesit politikë: PASOK, Demokracia e Re, SHBA-ja dhe BE-ja.

https://ektostonteixon.files.wordpress.com/2010/10/aixmh-afisa-sintonistikou2.jpg, vizituar më 03.07.2016.

Megjithatë, pas fasadës plot shkëlqim të ceremonisë së hapjes, kushteve të përkryera të shesheve të ndërtuara së fundmi, dhe suksesit të përgjithshëm të organizimit të lojërave, fshiheshin edhe disa probleme: buxheti që kishte kaluar dukshëm mbi vlerat e parashikuara fillestare, akuzat për doping kundër atletëve grekë, parregullsi financiare të shoqëruara me përmirësimin e infrastrukturës së qytetit, një duzinë instalacionesh në trajtën e "elefantëve të bardhë", mirëmbajtja e të cilëve kishte kosto shumë të lartë. Afishja V-30B u krijua nga një sërë organizatash të krahut të majtë, pa përfaqësim parlamentar dhe lëvizje të qytetarëve. Ajo paraqiste dy maskotat e Lojërave, Athina dhe Febusi, të veshur si "Frika" dhe "Korrupsioni".

1. Studioni kontekstin verbal dhe pamor, dhe përshkruani afishen e mësipërme. Si janë veshur dy maskotat? Çfarë përfaqësojnë ato? Në çfarë janë transformuar rrathët olimpikë? Si mund ta zbuloni ideologjinë politike të krijuesve? Bëni lidhjen e afishes me rënien financiare të Greqisë pas vitit 2010.

2. A ka organizuar vendi juaj një veprimtari sportive ndërkombëtare? Nëse po, gjeni afishe të veprimtarisë dhe analizoni simbolet e tyre. Shpjegoni se cilat janë kriteret për të zgjedhur një simbol apo një tjetër, dhe se si lidhen ato me imazhin e vendit. Bëni kërkime për temën: ***A kishte reagime kundër organizimit të veprimtarisë dhe nga kush? Cilat ishin argumentet e kundërshtarëve?***

V-31. Liga e Basketbollit Jadran në ish-Jugosllavi

Liga e Adriatikut u krijua në vitin 2001 dhe mëposhtme: Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, dhe Mali i Zi, ose shtete që dikur ishin pjesë e ish-Jugosllavisë. Vitin pasardhës u bashkuan edhe klube nga Serbia. Liga është një shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit (në sporte) ndërmjet shteteve që kanë qenë në luftë, vetëm pak vite më parë.

BASKETBOLL – Themelimi i asamblesë së klubeve të ligës së re rajonale u organizua në Zagreb
Liga e Adriatikut fillon më 29 shtator. Cibona VIP luan në Podgoricë
[…]
Asambletë e klubit të Ligës së Adriatikut kanë krijuar një organ të hallkës së dytë, që do të quhet Juria e Apelit. […] Ky organ do të funksionojë nëpërmjet një dhome me tre anëtarë, ku Presidentit Lorbek do i bashkëngjiten dy persona të tjerë nga klubi që nuk kanë konflikt. Gjyqtarët e konkursit do të jenë nga shtetet pjesëmarrëse, por shteti nga vjen skuadra e Buduçnost-it do të përfaqësohet vetëm nga gjyqtarë malazezë. Ashtu si edhe në Ligën e Evropës, do të ketë tre gjyqtarë për secilën ndeshje. […]

Liga Jadranska – dokumenti 1 (lista Jutarnji, 04.07.2001)

V-32. Sportistët si heronj

Tenisti më i mirë i Kroacisë, Goran Ivanisheviç fitoi kampionatin e Wimbledon-it në vitin 2001. Si një hero kombëtar, atij iu bë një mikpritje madhështore në qytetin e tij të lindjes, Split.


Në skenën e portit të Splitit ishte varur një afishe ku shkruhej "Goran, Spliti të do" dhe ishin mbledhur rreth 150,000 tifozë dashamirës në një festim të një rëndësie që rrallë ishte parë në historinë e sportit kroat. Shumë prej arritjeve sportive janë festuar në Split, por këdo që ju të pyesni do të thotë "Ky ishte festimi më madhështor krahasuar me gjithë festimet e tjera". Askush nuk ka mbledhur kaq shumë tifozë sa Goran Ivanisheviç. […]

Numri i vizitorëve në faqet e internetit të televizionit kroat dhe Hinet theu të gjitha rekordet ditën e martë. Tifozë nga e gjithë bota donin të shihnin drejtpërdrejt festimin në Split, dhe në të njëjtën kohë të dërgonin emaile për një bluzë me imazhin e Zec / Lepur/ dhe mbishkrimin "Unë jam gjeni", pavarësisht kostove të tyre […]

Četvrtak, www.monitor.hr, 12.07.2001.

V-33. Mbishkrimi "Djemtë e këqij blu" në Zagreb

Me nismën e presidentit kroat Tudjman, klubi i futbollit "Dinamo" e ndryshoi disa herë emrin e tij duke qenë se emri "Dinamo" u konsiderua shumë komunist. Në vitin 1993, emri i klubit u ndryshua në "Kroaci", që solli një pakënaqësi më të madhe ndërmjet tifozëve të "Dinamos" që i kërkuan klubit të rikthente emrin e vjetër. Ky klub u riquajt "Dinamo" vetëm pas vdekjes së Tudjman në vitin 2000.



Përkthimi: Nëse do të kishte liri dhe demokraci, ajo do të quhej Dinamo dhe jo Kroacia.

Koleksion privat.

Përdorni informacionin e pjesës me figurën e çelësit për të shpjeguar tekstin e mbishkrimit. Përse mbishkrimi e lidh emrin e klubit të futbollit me lirinë dhe demokracinë?

V-34. Mundja, sporti tradicional në qytetin e Asenovgradit, Rodopet Veriore, Bullgari, 2008

Mundja me vaj (*Yağlı Güreş* në turqisht, *pehlivanski borbi* në bullgarisht) ka qenë një sport tradicional që prej periudhës së hershme osmane. Para çdo ndeshjeje, mundësit i lyejnë trupat e tyre me vaj ulliri dhe ndeshjet zhvillohen në një fushë të hapur me bar ose në tapete, ku konkurrentët janë të veshur vetëm me pantallona prej lëkure që arrijnë deri pak poshtë gjurit. Këto ndeshje janë popullore ndërmjet myslimanëve në Evropën Juglindore, dhe shpesh marrin pjesë edhe mundës jomyslimanë dhe publiku vendas nga të gjitha bashkësitë.



Fotografi nga Kremena Yordanova.

1. Si mendoni se sportet mund të kontribuojnë qoftë në bashkimin e njerëzve, qoftë në zhvillimin e armiqësisë dhe antagonizmit, duke nxitur qëndrime dhe reagime nacionaliste? Gjeni shembuj për të dyja rastet dhe diskutoni ekuilibrin e brishtë ndërmjet një ndeshjeje miqësore dhe një përplasjeje të ashpër.

2. Diskutoni lidhjen ndërmjet huliganizmit dhe nacionalizmit. Gjeni shembuj nga vendi juaj për ndeshje futbolli, ku tifozët kanë ushtruar dhunë ndaj simboleve kombëtare. Krahasojini me rastet e paraqitura në seksionin II-2 të kapitullit II.



KAPITULLI VI: MËNYRAT E PËRKUJTIMIT

Hyrje 211

VI.1. Fshirja dhe rishikimi i të shkuarës komuniste 213

VI.2. Rishikimi i kujtesës së Luftës së Dytë Botërore 221

VI.3. Përkujtimi i luftërave të fundit 226

VI.4. Pajtimi nëpërmjet rindërtimit ose shkatërrimit të kujtesës 229

HYRJE

Zakonisht, teksti shkollor i historisë përfundon brenda kufirit kohor të përcaktuar në përshkrimin e një periudhe historike të caktuar. Gjithsesi, një mësim historie nuk mund të shmangë mënyrat se si ne e kujtojmë dhe e fiksojmë në kujtesë të kaluarën historike. Është e rëndësishme për studentët e degës së historisë që t'i kuptojnë pikëpamjet e shoqërisë për ndryshimet e ndodhura në të kaluarën dhe se këto pikëpamje kushtëzohen nga e tashmja. Këto tekste të së shkuarës të paraqitura nëpërmjet këndvështrimit të së tashmes, janë riprodhuar dhe shpërndarë kryesisht nga institucionet shtetërore, si sistemi arsimor dhe muzeumet. Ato përfshijnë rrëfime hegjemonike, që kanë prirje të margjinalizojnë lexime të tjera kundërshtuese ose alternative.

Duke folur në mënyrë skematike, ekzistojnë dy lloje kujtese kolektive: "kujtesa zyrtare", që si rregull është identifikuar me kujtesën e shtetit-komb; dhe kujtesat "margjinale" dhe alternative, që zakonisht anashkalohen nga "kujtesa zyrtare" dhe në disa raste përplaset me këtë të fundit. Rastet e përplasjes ndërmjet kujtesës "zyrtare" dhe "jozyrtare", janë shumë të dukshme në fushën e arsimit, pasi shkolla është kryesisht institucioni ku të rinjtë marrin pjesë në socializimin dhe përçimin e vlerave shoqërore mbizotëruese. Megjithatë, shumë shpesh, ajo që mësohet në shkollë është në kundërshtim të plotë me realitetin shoqëror dhe kulturor të klasës. Si perceptohet një tekst shkollor i historisë kombëtare, nga nxënësit e një klase shumëkulturore ku bashkëjetojnë shumë komunitete konkurruese të kujtesës? Dhe sa i shkëputur dhe "neutral" mund të jetë një mësim historie në një mjedis të pastronditur?

Kapitulli VI synon të paraqesë aspekte të llojeve të ndryshme të kujtesës, edhe pse theksi është kryesisht te kujtesa zyrtare dhe mbizotëruese, duke qenë se ajo u rikonfigurua në vigjilje të fundit të Luftës së Ftohtë. Në të gjithë Evropën, rishikimi i historisë së periudhës 1939-1989 filloi pas vitit 1990. Në ish-shtetet komuniste, nuk u kufizua deklarimi i simboleve dhe historigrafisë. Ajo përfshin të gjitha fushat e kujtesës, ose siç e ka quajtur historiani francez Pierre Nora, nëpërmjet një termi shumë të njohur «lieux de memoire». Përmendoret u rrafshuan dhe u ndërtuan të reja; u anuluan festimet e ngjarjeve kombëtare dhe u vendosën data të reja; u "shpikën" dhe u krijuan tradita të reja; heronjtë e vjetër u demonizuan dhe heronj të rinj zunë vendin e tyre. Pas viteve 1990, u rishikua kujtesa e komunizmit dhe e Luftës së Dytë Botërore. Qasja e re politike drejt regjimeve ish-komuniste kishte të bënte kryesisht me dënimin e krimeve të regjimeve komuniste totalitare dhe barazimin e komunizmit me nazizmin. Pika e kthesës ishte botimi i librit: *"Libri i Zi i Komunizmit: Krime, Terror, Shtypje"*, botuar në vitin 1997, nga Stefan Kurtua (botimi i parë në frëngjisht), që e krahasonte komunizmin me nazizmin, për sa i përket numrit të viktimave dhe metodave të asgjësimit në masë të kundërshtarëve. Ky libër provokoi mbështetje dhe kritika, dhe u diskutua gjerësisht. Në ish-shtetet komuniste, *"Libri i Zi..."* u përdor për të justifikuar procesin e "viktimizimit të dyfishtë", p.sh. kujtesa e Luftës së Dytë Botërore u rishikua me qëllim që këto shtete (shtetet baltike, Polonia) ta paraqisnin veten si viktima të nazizmit dhe komunizmit. Qëndrimi u formulua përfundimisht si pjesë e axhendës politike evropiane në janar të vitit 2006, kur Këshilli i Evropës miratoi Rezolutën 1481, që dënon "shkeljet masive të të drejtave të njeriut të kryera nga regjimet komuniste totalitare". Në vitin 2008, Parlamenti Evropian caktoi gjithashtu Ditën evropiane të përkujtimit të viktimave të stalinizmit dhe nazizmit, e njohur si Dita e Shiritit të Zi: kjo ditë përkon me 23 gushtin (përvjetori i nënshkrimit të paktit Molotov-Ribbentrop) si dita e përkujtimit ndërkombëtar të viktimave të stalinizmit, nazizmit dhe fashizmit.

Shoqëritë ishin të ndara lidhur me kujtimin e Luftës së Ftohtë. Në të vërtetë, "luftërat e kujtesës" kanë qenë një karakteristikë e vazhdueshme e vendeve të Ballkanit, gjatë kësaj periudhe, që është quajtur "bumi i kujtesës" dhe vazhdon nga çereku i tretë i shekullit të njëzetë deri në ditët e sotme: ka pasur kundërshti publike të rëndësishme, mosmarrëveshje të forta dhe diskutime të vazhdueshme, dhe madje përplasje të dhunshme të lidhura kryesisht me përvojat historike traumatike të shekullit të njëzetë, siç ishin luftërat, gjenocidet, dëbimet e popullsisë, shpërnguljet masive dhe luftërat civile. Në rastin e përkujtimit të Luftës së Ftohtë, ne kemi qenë dëshmitarë të "nostalgjisë komuniste" aktuale në shtete ku i ashtuquajturi "tranzicion" drejt një ekonomie tregu ka qenë traumatik dhe shkatërrues për disa grupe shoqërore. «Jugonostalgjia" është shfaqur në disa ish Republika Jugosllave si reagim ndaj «parajsës së humbur" të "bashkim-vëllazërimit".

Kapitujt Vl.1 dhe Vl.2 lidhen dhe i mbivendosen pjesërisht njëri-tjetrit në rastin e ish vendeve komuniste. Arsyeja për këtë është se pas vitit 1945, leximet dhe interpretimet e Luftës së Dytë Botërore kushtëzoheshin nga dogmat politike dhe ideologjike të regjimeve që

mbizotëruan në secilin shtet. Për shembull, në rastin e Greqisë, disfata e komunistëve në luftën civile të viteve 1946-1949, pati si pasojë historike zhdukjen e qëndresës komuniste ndaj pushtimit të Fuqive të Boshtit. Vetëm në vitin 1982, dhe nën një qeveri socialiste, "qëndresa kombëtare" dhe veprimtaritë e organizatave të krahut të majtë kundër Boshtit u njohën zyrtarisht nga shteti. Nga ana tjetër, në shtetet e Bllokut Lindor, partitë komuniste në pushtet përdornin përkujtimet zyrtare të qëndresës komuniste si një gur themeli për regjimet e tyre të reja, nëpërmjet ngritjes së një sërë përmendoresh dhe krijimin e riteve të reja. Në ato shtete, regjimet e të cilave vareshin më shumë nga Bashkimi Sovjetik, si Bullgaria dhe Rumania, u ndërtuan përmendore kushtuar Ushtrisë së Kuqe dhe ushtarit sovjetik, të cilit iu atribua roli i "çlirimtarit" nga pushtuesit gjermanë.

Në rastin e Jugosllavisë, elementi themelor i kujtesës zyrtare ishte Lufta për Çlirim Kombëtar, që u barazua me revolucionin socialist. E udhëhequr nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, lëvizja partizane nga viti 1941 deri në vitin 1945 organizoi qëndresën kundër forcave pushtuese të Gjermanisë, Italisë, Bullgarisë dhe Hungarisë, si edhe kundër bashkëpunëtorëve vendas, si ustashët dhe çetnikët. Si rrjedhojë, nëpërmjet përkujtimit të Luftës për Çlirim Kombëtar, Jugosllavia e Titos, iu dha fund mosmarrëveshjeve me armiqtë e saj të "brendshëm" ideologjikë dhe politikë.

Pas vitit 1989, rishikimi i kujtesës së periudhës komuniste, shkoi paralel me atë të Luftës së Dytë Botërore dhe për pasojë ishte e vështirë të bëhej ndarja në dy grupe. Si rrjedhojë, kapitujt Vl.1 dhe Vl.2 duhet të studiohen paralelisht, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë se rishikimi i interpretimit mbizotërues të Pushtimit dhe Qëndresës, pas fundit të Luftës së Ftohtë, varet kryesisht nga vullneti i interpretimit komunist të këtyre. Si rezultat i një rishikimi të tillë, me pasoja shumë të rrezikshme, ka pasur një negocim të karakterit antifashist të qëndresës partizane dhe një përpjekje për t'i barazuar krimet e nazizmit me ato të kryera nga partizanët.

Sigurisht që situata u ndërlikua më vonë për shkak të luftërave jugosllave të viteve 1990, ku mosmarrëveshjet ideologjike dhe politike u shkrinë me konfliktin etnik. Në Kroacinë e pas viteve 1990, procesi i pajtimit me të shkuarën komuniste u gërshetua me kundërshtimin radikal të Jugosllavisë. Për nacionalistët kroatë, shtetet jugosllave, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, ishin struktura kryesisht antikroate të krijuara vetëm për të siguruar sundimin serb. Ashtu si edhe në Serbi, luftërat e viteve 1991-1995 ringjallën kujtimet e regjimit ustash dhe u instrumentalizuan në konflikt të ri. Luftërat jugosllave krijuan viktima të reja, heronj të rinj dhe kujtime tronditëse të reja, që u bashkëshoqëruan me ato të vjetra dhe në njëfarë shkalle u bënë përcaktuese për to. Përmendoret që kanë qenë të ngritura për shumë dhjetravjeçarë si: "Flaka e përjetshme" në Sarajevë, kërkonin një kuptim dhe simbolikë të re. Në të njëjtën kohë u ngritën përmendore të reja për të nderuar kujtimin e atyre civilëve që ranë në luftërat e viteve 1990. Kapitulli Vl.3 paraqet shembuj të tillë dhe i fton nxënësit të mendojnë për kuptimet e heroizmit dhe tronditjes shpirtërore.

Kapitulli Vl.4 synon të tregojë se si mund të përdoret kujtesa dhe harresa, në mënyrë që ata që janë ndarë me njëri-tjetrin në të shkuarën të mund të pajtohen. Është e rëndësishme që të kuptojmë se si lidhen njerëzit me përmendoret dhe objektet historike, se si objektet e kujtesës bëhen pjesë kryesore e politikave të kujtesës dhe harresës, dhe se si janë lidhura politikat e rindërtimit të kujtesës me proceset e pajtimit. Shpesh, luftërat kanë pasur si objektiv përmendoret (kryesisht objektet me karakter fetar) që simbolizojnë "tjetrin", një fakt që ka çuar në shkatërrimin ose vandalizmin e disave dhe (ri) ndërtimin e të tjerëve (shihni këtu kapitullin 11.7). Nga ana tjetër, shumë site, të tilla si fshatra të shkatërruar, sinagoga, xhami dhe kisha, varreza dhe përmendore që përkujtojnë "heronjtë" dhe "martirët" përfaqësojnë një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore të kundërshtuara dhe të papranuara nga shumë grupe dhe shtete. Restaurimi i përmendoreve fetare (xhamive dhe kishave) në Qipro, që kanë qenë objekt i dhunës ndërmjet grupeve fetare dhe pushtimit turk na lejon ne, nëpërmjet një nisme të ndërmarrë nga shoqëria civile, të fillojmë një diskutim për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet urrejtjes etnike dhe për përgjegjësinë që kanë qytetarët për ta mbrojtur dhe ruajtur këtë trashëgimi.

Në përgjithësi, kapitulli Vl synon t'u japë nxënësve mundësinë për të menduar në mënyre kritike për të shkuarën "e ndezur" dhe helmuese duke parë mënyrat se si ne e kujtojmë atë. Synimi për çdo komunitet nuk është që t'i rikthehen tronditjes shpirtërore të tij, por të njohin atë të komunitetit tjetër. Vetëm atëherë përpjekja për pajtim mund të shndërrohet në një proces për vendosjen e paqes.

VI.1. FSHIRJA DHE RISHIKIMI I TË SHKUARËS KOMUNISTE

VI-1. Heqja e statujës së Titos në Uzice, Serbi, 1991

Përmendorja e Josif Broz Titos, një statujë bronzi prej 4.75 m e lartë, punim i skulptorit të njohur Frano Krshinic, u ndërtua dhe u vendos në Sheshin e Partizanëve në Titovo në Uzice, në vitin 1961. Tre dekada më vonë, më 28 gusht 1991, përmendorja u hoq dhe u çua në kopshtin e Muzeut Kombëtar të Uzices. Ky akt ishte në përputhje me "Rekomandimin për heqjen e emrave të qyteteve, shesheve, rrugëve, institucioneve arsimore dhe kulturore të atyre personave përgjegjës për padrejtësitë e mëdha të kryera kundër popullit serb", të miratuar nga parlamenti i Serbisë, më 24 korrik të vitit 1991.



Milos Cvetkovic Koleksion Privat.

VI-2. Përmendoret e shkatërruara të NOB (kushtuar Luftës për Çlirimin e Popullit) në Kroaci

Ndërmjet viteve 1945-1990, në Kroaci u ndërtuan dhe u krijuan rreth 6,000 monumente, buste, skulptura dhe pllaka përkujtimore për ngjarje dhe persona që kishin lidhje me Lëvizjen Kombëtare Çlirimtare të Kroacisë dhe Jugosllavisë. Por në periudhën mes viteve 1990-2000, saktësisht janë shkatërruar ose dëmtuar 2,964 objekte përkujtimore (731 përmendore dhe 2,233 përkujtimore të tjera). Deri në vitin 2012, u restauruan rreth 400 përkujtimore antifashiste me më pak vlerë artistike, si edhe disa përmendore të tjera të rëndësishme (përmendorja e të burgosurve të Jadovno; "Thirrja për kryengritje" në Bjelovar; përmendorja e kryengritjes së popullit kroat në Srb, etj.).

Hrzenjak, 2002, fq. XII.

VI-3. Rrëzimi i statujës së madhe të Enver Hoxhës nga protestuesit në Tiranë, 20 shkurt 1991



Fotograf: Roland Tasho.

Ky akt simbolizoi rënien e regjimit komunist në Shqipëri. Disa ditë më parë, studentët e Universitetit të Tiranës kishin hyrë në grevë urie, ku kërkonin heqjen e emrit të "Enver Hoxhës" nga Universiteti Shtetëror i Tiranës.

VI-4. Shkatërrimi i mauzoleut të Dimitrovit, 1999

A. Fotografi e shkatërrimit të tij



http:// ww w.chudesa.net, vizituar më 21.10.2015.

B. Përshkrim i ndërtimit dhe shkatërrimit të përmendores

Gjithçka filloi më 2 korrik të vitit 1949, kur Gjergj Dimitrov, "udhëheqësi dhe mësuesi" i popullit bullgar, vdiq në Moskë. Të nesërmen, më 3 korrik, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, vendosi që trupi i tij të balsamosej dhe vendosej në mauzole si trupi i Leninit. Shembulli sovjetik duhej të ndiqej edhe në varrimet e udhëheqësve. Modeli arkitekturor i ndërtimit u projektua gjatë natës dhe puna për ndërtimin e tij filloi mëngjesin e 4 korrikut. Kjo u bë e mundur nëpërmjet Trupave të Shërbimit të Punës. Ndërtimi përfundoi brenda pesë ditësh dhe netësh. Sipas të dhënave të ndryshme, gjatë ndërtimit të këtij objekti vdiqën gjashtë rekrutë. Kufoma e balsamosur e Dimitrovit u transportua nga Moska së bashku me një arkivol të veçantë dhe pajisje të tjera, dhe u varros më 10 korrik. Që nga ajo ditë, deri në 9 shtatorin e fundit, atë të vitit 1989, banorëve të Sofjes iu duhej që në çdo pushim zyrtar, të parakalonin me vetëdije para mauzoleut, nën vështrimin e udhëheqësve të regjimit komunist, që qëndronin në tribunë. Si rrjedhojë, varri i Gjergj Dimitrov u shndërrua nga një objekt i zakonshëm kulti, në vendin më të urryer nga banorët e Sofjes. Një vizitë në mauzole ishte pjesë e detyrueshme e programit të turit për grupet e qytetarëve dhe nga pjesa tjetër e nëpunësve të institucioneve shtetërore, të organizuar në sindikata. Më pas erdhi 10 nëntori i vitit 1989. Banderola shumëngjyrëshe u valëvitën në

tribunë dhe vetë ndërtesa u mbulua me mbishkrime. Disa ishin parulla antikomuniste, por shumë prej tyre ishin simbole të të rinjve. Më 18 korrik të vitit 1990, qeveria e Andrei Lukanov e hoqi kufomën e Dimitrovit nga vendpushimi i tij "i përdhosur" dhe e varrosi në Varrezën Qendrore të Sofjes. Kjo ishte periudha kur filloi beteja e vërtetë për fatin e ndërtesës. Përkrahësit e ruajtjes së saj dolën me shumë ide për shndërrimin e saj, që nga ndërtimi i një galerie arti ose panteoni për banorët e Sofjes, të vrarë në luftë, deri te ndërtimi i një diskoje. Debati për të ardhmen e mauzoleut vazhdoi për plot nëntë vjet. Si përfundim, pikëpamja që mbizotëroi ishte fakti se, pavarësisht se në çfarë forme, nëse blloqet e betonit do të mbeteshin në qendër të Sofjes, ato do të ishin simbol i totalitarizmit dhe një vend për takimet, dhe mbledhjet komuniste nostalgjike. Kjo është arsyeja se përse duhej shkatërruar. Vetë procesi i shkatërrimit tregoi se ishte i sikletshëm për shkatërruesit. U deshën shtatë ditë që të shkatërrohej, më shumë kohë sesa u desh për ndërtimin e mauzoleut. Shpërthimi i parë ndodhi në orën 2:37 të pasdites së 21 gushtit të vitit 1999. Pjesët e fundit u larguan nga zona, pasditen e vonë të 27 gushtit. Gjatë shkatërrimit u vu re se në vitin 1957 dhe 1978, ndërtesa ishte përforcuar dhe rimodeluar, duke dyfishuar mbrojtjen si strehë mbrojtëse kundër armëve bërthamore. Por kjo lajthitje qartësisht teknike u harrua shpejt. Sot, zona e mauzoleut është thjesht pjesë e kopshtit publik përballë Teatrit Kombëtar.

CTaHAapT [Standard], 19 gusht 2003.

VI-5. Statuja e ushtarit sovjetik zhduket në Jashi



http:// www .ziaruldeiasi.ro/sti ri/ ostasu1-sovietic-care-fusese-tran sformat-in-mihai-viteazu1-reapare-in-copou--85941.ht ml, vizituar më 15.02.2016.

"Ushtari sovjetik" në Jashi u vendos në zonën rezidenciale të qytetit për të përkujtuar Ushtrinë e Kuqe si "çlirimtare e Rumanisë nga fashizmi".Pas rënies së regjimit komunist, shumë përmendore të ngjashme u përdhosën apo shkatërruan. "Ushtari sovjetik" u zhvendos dhe u çua në Eternitatea, varreza kryesore e qytetit dhe më pas u zhduk fare. Në fakt, statuja u largua për t'u shkrirë dhe më pas u bë lëndë e parë për një statuje të re, të ndërtuar në vitin 2002 në kujtim të princit rumun Mihai Viteazul [Mikael Trimi], heroit që arriti bashkimin e parë, në vitin 1600, të të gjitha krahinave rumune. Zhdukja e statujës origjinale e "Ushtarit sovjetik" nga varreza Eternitatea, u konstatua nga ambasadori rus në Rumani që kishte shkuar për të vendosur aty një kurorë lulesh; ky veprim në vitin 2007 u shndërrua në një incident diplomatik ndërmjet dy shteteve.

VI-6. Riemërtimi i rrugës kryesore në Lubjanë nga Rruga "Tito" në Rrugën "Dunajska" (Vjena)



Muzeu i Historisë Bashkëkohore, Lubjanë.

Pas rënies së komunizmit, shumë rrugë, sheshe, shkolla dhe madje edhe kazerma ushtarake u riemërtuan. Kjo prirje vazhdoi në mënyrë periodike deri në ditët e sotme, në varësi me atmosferën politike të momentit. Fotografia tregon tabelën e rrugës kryesore të Lubjanës, e cila u riemërtua nga Rruga "Tito" (Titova cesta) në Rrugën "Vjena" (Dunajska cesta) nga njëra anë dhe Rruga "Sllovenia" (Slovenska cesta) në anën tjetër.

VI-7. Kushtetuta e Kroacisë, 1997

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KROACISË BAZAT HISTORIKE

Identiteti kombëtar mijëvjeçar i kombit kroat dhe vazhdimësia e shtetësisë së tij, i konfirmuar nga rrjedha e gjithë përvojës së tij historike në forma të ndryshme politike, dhe vazhdimi, dhe zhvillimi i idesë së shtetformimit të rrënjosur në të drejtën historike të kombit kroat për sovranitet të plotë, është treguar:

- në krijimin e principatave kroate në shekullin e shtatë;
- në shtetin e pavarur mesjetar të Kroacisë të krijuar në shekullin e nëntë;
- në Mbretërinë e Krotatëve të krijuar në shekullin e nëntë;
në ruajtjen e funksioneve të shtetësisë sipas Bashkimit Kroato-Hungarez;
në vendimin e pavarur dhe sovran të Parlamentit të Kroacisë në vitin 1527 për të zgjedhur një mbret nga dinastia Habsburg;
- në vendimin e pavarur dhe sovran të Parlamentit të Kroacisë për të ratifikuar Sanksionin Pragmatik në vitin 1712;
- në përfundimet e Parlamentit të Kroacisë të vitit 1848, për rivendosjen e integritetit të Mbretërisë Triune të Kroacisë nën autoritetin e Banit (nënmbreti), të rrënjosur në të drejtën historike, kombëtare dhe të natyrshme të kombit kroat;
- në Kompromisin Kroato-Hungarez të vitit 1868, që rregullonte marrëdhëniet ndërmjet Mbretërisë së Dalmacisë, Kroacisë dhe Sllovenisë dhe Mbretërisë së Hungarisë, duke u mbështetur në traditat ligjore të të dyja shteteve, dhe në Sanksionin Pragmatik të vitit 1712;
- në vendimin e Parlamentit të Kroacisë të datës 29 tetor të vitit 1918 për të prerë të gjitha lidhjet kushtetuese ndërmjet Kroacisë dhe Austro-Hungarisë, dhe njohjen e menjëhershme të Kroacisë së pavarur, duke kërkuar të drejtat e saj kombëtare historike dhe të natyrshme nga shteti i sllovenëve, kroatëve dhe serbëve, të shpallura në territorin e mëparshëm të Perandorisë Habsburge;
- në faktin se Parlamenti i Kroacisë nuk e ratifikoi kurrë vendimin e marrë nga Këshilli Kombëtar i shtetit të sllovenëve, kroatëve dhe serbëve për t'u bashkuar me Serbinë dhe Malin e Zi në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (1 dhjetor 1918), që më pas u shpall si Mbretëria e Jugosllavisë (3 tetor 1929);
në krijimin e Banatit të Kroacisë, në vitin 1939,
që rive- ndosi autonominë e shtetit kroat brenda Mbretërisë së Jugosllavisë;
- në hedhjen e themeleve të shtetit sovran gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, siç shprehet në vendimin e Këshillit Antifashist Territorial të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë (1943) në kundërshtim me shpalljen


e shtetit të pavarur të Kroacisë (1941) dhe më pas në Kushtetutën e Republikës Popullore të Kroacisë (1947), dhe në të gjitha kushtetutat pasardhëse të Republikës Socialiste të Kroacisë (1963-1990); në momentin e kthesës historike, që u karakterizua nga rënia e sistemit komunist dhe ndryshimet në rendin ndërkombëtar në Evropë; në zgjedhjet e para demokratike (1990), kombi kroat rikonfirmoi, nëpërmjet vullnetit të tij të lirë, shtetësinë e tij mijëvjeçare; - në Kushtetutën e re të Republikës së Kroacisë (1990) dhe në fitoren e kombit kroat, dhe mbrojtësve të Kroacisë në luftën e drejtë, legjitime dhe mbrojtëse për çlirim, Lufta për Atdheun (1991-1995), ku kombi kroat tregoi gatishmërinë e tij për të krijuar dhe mbrojtur Republikën e Kroacisë, si shtet i pavarur dhe autonom, sovran dhe demokratik.

htt p:// www.zakon.hr/z/94/ Usta v-Repub like-Hrvatske, vizituar më 21.1 0.2015

VI-8. Historia e popullit shqiptar: një version i ri i historisë kombëtare (2002-2008)

Historia e popullit shqiptar, në katër vëllime, është një botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese "Toena». Ky botim është një punë kolektive studimore nga anëtarët e fushave të ndryshme të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përfshirë historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etj. Puna për botimin filloi në vitin 2002 dhe përfundoi në vitin 2008. Ndarja e punimit në katër vëllime ishte tematike: Vëllimi i parë pasqyron periudhën nga antikiteti deri në vitin 1830, periudhën e reformave të Tanzimatit në Perandorinë Otomane dhe përqendrohet kryesisht në "fillimin e lëvizjes kombëtare". Vëllimi i dytë pasqyron periudhën e lëvizjes kombëtare shqiptare deri në krijimin e shtetit shqiptar (1830-1912). Vëllimi i tretë pasqyron historinë e shtetit shqiptar që nga shpallja e pavarësisë deri në pushtimin italian të vendit (1912-1939). Vëllimi i katërt mbulon historinë e vendit duke filluar që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, vendosja e regjimit komunist deri në rënien e sistemit komunist (1944-1990). Ky libër historik është "versioni zyrtar" i historisë së Shqipërisë dhe përfaqëson historinë e shqiptarëve, duke u mbështetur tek ideja e evolucionit në kohë dhe zhvillimit linear të procesit historik.

→



VI-9. Kujtimi i komunizmit në Rumani: fragmente nga librat e historisë, 1997, 1999

Të gjitha tekstet e historisë të botuara pas vitit 1989 pasqyronin pikëpamjen antikomuniste mbi historinë e pasluftës, e cila minimizon dhe mohon aspektet pozitive të periudhës, gjë që ende ushqen nostalgjinë e shumë segmenteve të shoqërisë. Madje edhe kur përmendin disa zhvillime, që të lënë mbresa dhe që janë të shumta, si ato që lidhen me: planifikimin urban, industrializimin, rritjen e jetëgjatësisë, zhvillimin e formave të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor, ose aksesin në arsim; autorët i theksojnë gjithmonë mangësitë dhe prapambetjet krahasuar me standardet perëndimore të jetesës. Kundërshtimi ndaj sistemit komunist u ekzagjerua shumë në narrativën që u zhvillua në periudhën post-komuniste, duke synuar të jepej ideja se ai qenkësh një fenomen masiv.

A. Periudha e diktaturës komuniste (1945-1989)

Diktatura komuniste solli ndryshime të mëdha në jetën e njerëzve, duke ndikuar te mënyra e tyre e të menduarit dhe e sjelljes. Në fshatra filloi *kolektivizimi*. Duke qenë se nuk kishin më prona, shumë fshatarë shkuan në qytete për të punuar në fabrika. Industrializimi i detyruar shkaktoi largime masive të banorëve nga fshatrat dhe përshpejtoi moshimin e popullsisë. Në qytete, u ndërtuan komplekse banimi standarde për punëtorët, të cilat nuk kishin asnjë individualitet.

Shkatërrimi i fshatrave dhe shtëpive, ndërtesave historike dhe kishave që ndodhi nën regjimin e Çausheskut, së bashku me shpërfilljen e mjedisit, krijoi për Rumaninë imazhin e një shteti të izoluar dhe të pazhvilluar.

Liviu et al, 1997, fq. 95.

B. Bashkëpunimi

Në një klimë terrori, frike dhe pasigurie fizike, shumë persona u detyruan të bashkëpunonin me regjimin, ose për shkak të oportunizmit ose frikës nga ndëshkimi. Bashkëpunimi ishte një formë e neutralizimit të individit dhe bashkëjetesës jo të dhunshme me të keqen, që sundonte mbi shoqërinë. Individi, i kontrolluar nga Partia, bënte atë që i kërkohej në vendin e punës dhe në shoqëri.


Kishte gjithashtu një lloj bashkëpunimi të dëshiruar kryesisht nga disa intelektualë, që kishin zënë poste të veçanta në regjimin e vjetër dhe që shumë shpejt u *'riorientuan'* drejt Partisë Komuniste, duke u shndërruar në shërbyesit e saj të devotshëm [...] Te njerëzit u zhvillua një aftësi për t'u përshtatur në shoqëri dhe kjo ishte një karakteristikë e përhapur gjerësisht me qëllim për të siguruar mbijetesën. Masa e gjerë e njerëzve e kundërshtoi regjimin në një mënyrë që nuk u shfaq hapur. Një rezistencë e heshtur kolektive ekzistonte në periudhën 1945-1989.

Seurtu et al, 1999, fq. 149-150.

Vl-10. Përkujtimorja Sighet e represionit komunist në Rumani

Në 1993, poetja Ana Blandiana (një ish disidente antikomuniste) i paraqiti Këshillit të Evropës një projekt për ta transformuar ish burgun e Sighet në një Përkujtimore në nder të viktimave të Komunizmit dhe Rezistencës. Sighet është një vend simbolik në hartën e përndjekjes komuniste në Rumani. Këtu kanë qenë burgosur mbi njëqind persona të rëndësishëm nga i gjithë vendi (ish ministra, anëtarë të Akademisë, ekonomistë, ushtarakë, historianë, gazetarë, politikanë), si edhe 45-50 priftërinj, dhe peshkopë të Kishës Katolike Lindore, dhe asaj Katolike Romake. Për këtë arsye, ai u quajt gjithashtu "burgu i personaliteteve të rëndësishëm". Në vitin 1995, Këshilli i Evropës mori nën mbrojtjen e tij Përkujtimoren Sighet dhe në vitin 1998 e emërtoi atë si një nga vendet më të rëndësishme të ruajtjes së kujtesës së kontinentit, krahas muzeut të Aushvitzit dhe Përkujtimores së Normandisë për Paqen. Sallat e para të muzeut u inauguruan në qershor të vitit 1997. Në muret e Zonës së Qetësisë dhe Lutjes, e projektuar nga arkitekti Radu Mihailesku, u shkruan emrat e mbi 8,000 personave, që vdiqën në burgjet dhe kampet e punës në Rumani gjatë periudhës komuniste.

→



htt p:// sigh et.ro/ 7p age _id=557, vizituar më 17.06.2015, and http:// ww w.memoria lsighe t.ro/ index.php/ index. ph p7opt ion= com _conten t&view=arti cle&id= 58&1temid= 103&1 anq= ro, vizituar më 29.03.2015

VI-11. Nostalgjia postkomuniste

A. Jugo-nostalgjia: Klubi Fejst në Sllloveni



Fotografi nga arkivi i Darja Kerec.

Megjithëse termi «Jugo-nostalgjik» u përdor për herë të parë si një term përçmues në Kroaci, gjatë viteve 1990, e ashtuquajtura «Jugo-nostalgjia», apo nostalgjia e krijuar në kujtim të Jugosllavisë socialiste ose «Jugosllavia e Titos», filloi të përdorej më shumë me fillimin e shekullit 21. Specialistët në studimet e tyre kulturore shpjegojnë se shumica e nostalgjikëve të Jugosllavisë nuk dëshirojnë vërtetë që të rilidhen apo rikthejnë regjimin e mëparshëm, por ata përpiqen të rikrijojnë përvojat kulturore, që ata i kanë ndarë me shokët dhe bashkatdhetarët e tyre më shumë në bazë të kujtesës së detajeve të përzgjedhura sesa në bazë të kombësisë dhe fesë. Shumë sociologë e konsiderojnë Jugo-nostalgjinë si një koncept me shumë kuptime, që ka domethënie të ndryshme për persona të ndryshëm: për sa u përket të rinjve, që është një përqindje e vogël e popullsisë, nostalgjia e tyre lidhet kryesisht me magjepsjen për diçka jugosllave, për të cilën u kanë treguar prindërit. Ndërmjet të moshuarve, që është një përqindje më e madhe e popullsisë, kjo nostalgji lidhet me kulturën popullore që u zhvillua në ish-Jugosllavi.

Në muret e një klubi të quajtur klubi Fejst, në qytetin e nxjerrjes së qymyrit në Zagorje në qendër të Sllovenisë, u shfaqën simbole që lidheshin me idenë e Jugo-nostalgjisë. A mund të njihni disa prej tyre? Diskutoni.

B. Intervistë me Florentina Ichim: Ishte shkëlqyeshëm, ishte mirë, ne kishim para.

E vetmja mangësi e asaj periudhe ishte se ne nuk mund të shkonim jashtë shtetit. Epo në fakt, kishit gjithçka që ju nevojitej... ushqim, pije, veshje, këpucë, shtëpi dhe jetesë, mund t'i shijonit pushimet edhe në shtëpi, edhe nëse nuk mund të vizitonit shtete të huaja [...]Ato ishin krijuar në Rumani, por ishin gjëra të mira. [. ..] për mendimin tim, mua nuk më pëlqen kjo kohë, ky regjim. Madje edhe nëse ka liri, madje edhe nëse ju mund të thoni gjithçka gjithkund. Vetëm flitet dhe shihet, asgjë më shumë. Sepse ju nuk mund të blini asgjë tani [...] në regjimin e Çausheskut, në një vit ju mund të blinit një makinë dhe mobilie [...] Unë mund t'i përballoja me pagën time. Im shoq fitonte të tijat, unë të miat. Me pagën time ne paguanim këstet. [...] Ditën që ne merrnim rrogat, ne mund të blinim veshje, paguanim borxhet dhe ende na mbeteshin para në xhep. Ne pothuajse nuk e harxhonim fare pagën e tim shoqi. Unë shkoja tek CEC [bankë shtetërore].

Ishte bukur. Dhe ashtu siç e thashë, sot unë nuk kam gëzim. Në atë kohë unë kisha arsye për të qenë e gëzuar [...] Unë ju thashë që ne kishim para t'i blinim të gjitha [...] *Evropa e Lirë dhe Zëri i Amerikës* bërtitnin se njerëzit po vdisnin nga uria. Askush nuk vdiq nga uria. Në fakt, nëse e mendojmë pak, më duket se tani njerëzit po vdesin nga uria [...] në regjimin e Çausheskut, unë nuk kam dëgjuar për të tilla raste. [. ..] frigoriferi im ishte plot - dhe unë kisha dy të tillë në

fakt - plot me mish. Unë kisha furnizime për dy muaj. Nëse shikoni sot në frigorifer, gjithçka që kam është vetëm një pako me kocka. E ashtuquajtura demokraci. Sepse kjo nuk është demokraci [...] Por, sot ju punoni dhe nuk keni para. [...] më parë nuk ishte kështu. Nëse diplomoheshe në një fakultet, e kishe vendin e punës të sigurt. Diplomoheshe, dhe sot ose të nesërmen ishe i punësuar. Sot, ti ndjek një ose dy fakultete dhe askush nuk interesohet [...]. Ose nëse nuk kishe shtëpi, ata të jepnin shtëpi. Nuk kishe punë, ata të gjenin punë.[...] Dhe kjo ishte gjë e mirë".

Lungu, 2003, fq. 127-128, 146, 162-163, 178.

Libri nga sociologu Dan Lungu ishte një nga të parët, që tërhoqi vëmendjen e publikut dhe specialistëve në historinë e komunizmit për realitetin e nostalgjisë për komunizmin. Intervista e cituar më sipër e frymëzoi atë të shkruante një roman të suksesshëm, ***"Sunt o baba comunista",*** (2007) [Unë jam një shtrigë e vjetër komuniste], që u përkthye në 11 gjuhë dhe më vonë u bë film.

C. Përkujtimi i ditëlindjes së Çausheskut, 2003

Rreth 100 njerëz ishin dje të pranishëm në varrin e Nikolai Çausheskut në Varrezën Ushtarake të Ghenceas. Ata po përkujtonin 85 vjetorin e lindjes së ish-kreut të shtetit, që lindi më 26 janar të vitit 1918, në Skorniçesti . Rreth orës 11 të paradites, një delegacion i Partisë së Punëtorëve të Rumanisë, vendosi një kurorë lulesh në varrin e Çausheskut. Disa prej të pranishmëve mbajtën fjalime, recituan poezi, ndezën qirinj dhe shpërndanë afishe me portretin e Çausheskut.

Curierul National, 27 janar 2003.

1. Lexoni dokumentin VI-11B dhe krahasojeni atë me dokumentin IV-7 në kapitullin IV.1. Hartoni një listë të përparësive të regjimit komunist sipas të dyja dëshmive. Përse mendoni se këta njerëz janë nostalgjikë për regjimin e mëparshëm?
2. Lexoni dokumentin VI-11C. A mendoni se përkujtimi i ditëlindjes së Çausheskut është një veprimtari anësore apo kryesore? Shpjegoni pse. Përpiquni të gjeni dëshmi të ngjashme të kultit pas vdekjes të diktatorëve të tjerë.

VI-12. Filmi bullgar *"Granitza"* (Kufiri, 1994)



http://drugotokino.bg/content/ 10-nai-uspeshni-blgarski-f Ima sled-l 990-na-l 9-iya-so fi ya-film-fest, vizituar më 01.07.2016.

Me skenat e tij brutale dhe kritike për të shkuarën bullgare, ky film, me regji të Ilian Simeonov dhe Kristian Nokev, provokoi menjëherë debat të fortë dhe madje u bënë edhe përpjekje për ta ndaluar transmetimin e tij në televizionin kombëtar bullgar. Megjithatë, në vitin 1994, ai fitoi çmimin: "Filmi i parë më i mirë" në Festivalin e filmit bullgar me metrazh të gjatë "Trëndafili i Artë". Ngjarjet e filmit ndodhin në një pikë të vogël kufitare në vitet 1970. Rojat e kufirit (rekrutë, që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak), nën komandën e kapitenit Naum Shapov, duhet t'iu binden urdhrave të tij, duke u kthyer në këtë mënyrë në viktima të sistemit. Ushtarët mund të zgjedhin ndërmjet dy mundësive: të bëhen heronj dhe të fitojnë leje për të shkuar në shtëpi duke vrarë personat, që përpiqen të largohen përmes kufirit, ose të bëhen tradhtarë duke refuzuar t'iu binden rregullave të sistemit duke qëlluar mbi "dhunuesit" e kufirit".

1. Shpesh filmat trajtojnë çështje kontraversale nga e kaluara ose e tashmja. Përdorni njohuritë tuaja për historinë bullgare për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme: Përse mendoni se ky film ishte kontraversal në Bullgari në vitin 1994? A ishte ky film kontraversal edhe në vendin tuaj?
2. Ky film trajton çështje të heroizmit dhe patriotizmit. Diskutoni se çfarë do të thotë të jesh hero ose patriot, kur një shtetas përballet me vendimin e vështirë nëse duhet t'iu bindet urdhrave që mund të kundërshtojnë vlerat njerëzore ose vlerat e sistemit të dikujt.

VI.2. RISHIKIMI I KUJTESËS SË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

VI-13. Marshimi i Lukovit: Paradë për një gjeneral pronazist, 2006



http:// www.lukovmarsh .info/ category/ %D1%81%D0%BD%D0 %B8%D0 %BC%D0%BA%D0%B8/, vizituar më 01.07.2016

Marshi i Lukovit është një paradë e përvitshme me pishtarë të ndezur për nder të gjeneralit të ushtrisë bullgare i njohur për veprimtaritë e tij pronaziste dhe antisemitike gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Ajo konsiderohet si ngjarja më e rëndësishme publike për nacionalistët e rinj bullgarë. Marshimi i parë i Lukovit u organizua në vitin 2013, por ai ka një histori dhe origjinë interesante, duke qenë një nga nismat e shumta nacionaliste të periudhës së tranzicionit, kur paralelisht me ndryshimet demokratike kishte edhe beteja të ndryshme për kujtimin e të shkuarës së afërt dhe të largët. Marshimi i Lukovit u ndërmor nga Bashkimi Kombëtar i Bullgarisë (BKB), një organizatë rinore ekstremiste e djathtë, të cilit iu bashkuan edhe formacione të tjera kombëtare në vitet pasardhëse. BKB-ja ka fituar popullaritet ndërmjet disa grupeve të të rinjve për shkak të "kodit moral patriotik" dhe ushtarak të tij. Ai ka "trupa humanitare" dhe organizatë sportive, uniforma e së cilës ishin pantallona të zeza ushtarake dhe bluzë bezhë. Kjo uniformë bëri lidhjen e drejtpërdrejtë me trupat sulmuese të Hitlerit. BKB-ja është përfshirë në shumë protesta antikomuniste, në veprime kundër bashkësisë rome të Bullgarisë, kundër Paradës së Homoseksualëve të vitit 2008 në Sofje dhe të tjera.

Në vitin 2010, nisma qytetare «Njerëzit kundër racizmit" organizoi protestën e parë ose veprimin e parë antifashist kundër Marshimit të Lukovit, ku i dorëzuan Marshit të Lukovit, ku i dorëzuan një notë proteste këshillit bashkiak të Sofjes. Në vitin 2013, u organizua një notë proteste këshillit bashkiak të Sofjes. Në vitin 2013, u organizua Marshimi i parë kundër Lukovit si një veprimtari jopartizane duke bashkuar të gjithë protestuesit kundër instancave të diskriminimit racor, etnik, ksenofobik dhe gjinor në shoqërinë bullgare.

Megjithatë, nuk duhet thënë që deri në atë kohë diskursi antikomunist agresiv, nacionalist dhe i ekstremit të djathtë ka monopolizuar vlerësimet e së kaluarës. Paralelisht me disa organizata të të djathtës radikale, pas viteve 1990, në Bullgari u krijuan, megjithëse ngadalë, media dhe përfaqësi politike alternative. Ato përfshinin krahun e majtë, grupet dhe formacionet antifashiste, që kishin ndikim real te kultura e të rinjve. Si rrjedhojë, Indymedia Bullgari, që e përkufizonte veten si mbështetëse të ideve të majta radikale dhe pikëpamjeve të majta radikale, u krijua në 2003-2004. Krahas vetëdeklarimit të saj kundër anëtarësimit të Bullgarisë në NATO, ajo pasqyron protestat për mjedisin dhe publikon njoftime mbi aktivitete të lëvizjes së anarkistëve. Një tjetër organizatë e krahut të majtë është "Priziv" (Thirrja), një lëvizje e studentëve dhe e nxënësve, e krijuar në vitin 2008, që bënte thirrje për ndryshime në sistemin arsimor, si sigurimi i teksteve falas dhe subvencioneve për vaktet e të ngrënit në shkolla dhe universitete.

VI-14. Varreza e partizanëve në Mostar, para vitit 1992

Varreza e partizanëve në Mostar u ndërtua në vitin 1965 në kujtim të të gjithë qytetarëve të Mostarit, që ranë në Luftën për Çlirim Kombëtar. Ajo ishte punim i arkitektit të famshëm Bogdan Bogdanoviç. Varreza kishte 810 varre në formën e trungjeve të pemëve, që është simbol i të rinjve, që kanë vdekur para kohe. Varreza u shkatërrua gjatë luftës së viteve 1992-1995, por në vitin 2006 ajo u shpall Përmendore Kombëtare e Bosnjë-Hercegovinës.



VI-15. Përmendoret e shkatërruara të Luftës së Dytë Botërore në Serbi

Pjesa më e madhe e 650 përmendoreve, shatërvanëve dhe pllakave përkujtimore që u ndërtuan në Serbi si përkujtimore të Luftës për Çlirim Kombëtar, ndodhen ende në vendet e tyre të origjinës. Megjithëse disa janë dëmtuar dhe të tjerat shfaqin shenja të dukshme të përkeqësimit, ato nuk u përdhosën apo shkatërruan, ashtu siç ndodhte në disa shtete fqinje. Në fillim të viteve 1990, Shoqëria e Mbrojtësve të Serbisë miratoi pikëpamjen se përmendoret kushtuar Luftës së Dytë Botërore dhe atyre të socializmit, nuk duheshin shkatërruar, ashtu si edhe ato të ndërtuara në periudhën e pasluftës. Një problem më i madh sesa heqja e disa përmendoreve për arsye politike ishte mirëmbajtja dhe riparimi i papërshtatshëm. Një tjetër problem ishte se përmendoret prej bronzi dhe tunxhi vidheshin shpesh, duke përfunduar në pirgje grumbullimi metalesh dhe mbetjesh, ose duke u shitur nga pastruesit si materiale të dorës së dytë për riciklim. Të gjitha përmendoret, jo vetëm ato që i kushtoheshin Luftës së Dytë Botërore, shpesh ishin objektiv i vandalëve dhe ekstremistëve të krahut të djathtë. Në gusht të vitit 2011, në Nish, neonazistët ("Aksioni Serb" - AS) i mbuluan përmendoret e heronjve partizanë me çanta të zeza plastike, dhe shkruan mbishkrime për "krimet komuniste".

Parku Përkujtimor i Sumaricës, Kragujevac, përmendorja "Flaka e përjetshme" u shkatërrua dy herë



Arkivat e parkut Spomen "Kragujevacki oktobar".

Vrasjet në masë nga ushtria gjermane në Kragujevac më 21 tetor 1941, përfaqësojnë një nga krimet më të mëdha të kryera nga pushtuesit nazistë në Luftën e Dytë Botërore. Shumica e të ekzekutuarve ishin serbë, por kishte edhe hebrenj, romë, myslimanë, maqedonas, sllovenë dhe pjesëtarë të kombësive të tjera. Në tri ditë u vranë 2,794 burra dhe gra: vetëm 26 mbijetuan. Rreth 300 viktima ishin të rinj dhe nxënës të shkollave të mesme,si dhe kishte 40 fëmijë të moshës 12 dhe 15, kryesisht romë. Pas luftës, në vitin 1953, vendi ku ndodhën vrasjet e para u shndërruan në park përkujtimor: dhjetë nga varret u zbukuruan me përmendore artistike, një prej të cilave u quajt "Përmendore për nxënësit dhe mësuesit e vrarë". Përmendorja "Flaka e përjetshme e lirisë" u vendos në vitin 1978. Parku Përkujtimor i Sumaricës dhe objektet artistike të tij, janë plaçkitur vazhdimisht gjatë viteve të fundit: të tilla si "Statujat e drerit të vogël" u vodhën dhe u shkrinë në fonderinë vendore. Parkut i mungojnë gjithashtu 18 buste në anën e heronjve kombëtarë, të cilët janë zhdukur disa vite më parë. Përdhosja e përmendoreve në Serbi, p.sh. vjedhja e bronzit ose pjesëve të tjera me vlerë për t'i shitur në tregun e e zi, është diçka që ndodh shpesh dhe paralelisht me thellimin e krizës financiare.

VI-16. "Flaka e përjetshme" në Sarajevë

Përkujtimorja e "Flakës së përjetshme", që ndodhet në qendër të qytetit, është bërë simbol mbizotërues i Sarajevës. Teksti origjinal, i shkruar aty që në vitin 1946, është:

Me guxim dhe gjakun e derdhur të luftëtarëve të Brigadave boshnjake, kroate, malazeze dhe serbe të Ushtrisë Kombëtare të Lavdishme Jugosllave; me përpjekjet dhe sakrificat e përbashkëta të patriotëve të Sarajevës, serbëve, myslimanëve dhe kroatëve, Sarajeva, kryeqyteti i Republikës Populllore të Bosnjë-Hercegovinës, u çlirua më 6 prill të vitit 1945. Mirënjohje dhe lavdi e përjetshme për heronjtë e rënë për çlirimin e Sarajevës dhe atdheut të tyre, në përvjetorin e parë të çlirimit të tij, Sarajeva e madhe.

Në vitin 1981, teksti u ndryshua si më poshtë:

Me guxim dhe gjakun e derdhur të luftëtarëve të Trupave të II-ta, III-ta dhe II-ta të Ushtrisë Jugosllave dhe Grupeve Sulmuese të Lëvizjes së Sarajevës për Çlirim Kombëtar, Sarajeva u çlirua më 6 prill 1945.

Në këtë ndryshim nuk përmenden tre popuj - serbët, myslimanët dhe kroatët, ose brigadat boshnjake, kroate, malazeze dhe serbe.

Jo shumë vonë, në shkurt të vitit 1990, kur Jugosllavia po shkonte drejt shpërbërjes, kur po krijoheshin partitë kombëtare dhe kur po bëheshin përgatitje për zgjedhje shumëpartiake, teksti në pllakën përkujtimore ndryshoi sërish dhe në të shkruhej:

Mirënjohje dhe lavdi e përjetshme për çlirimtarët e qytetit, luftëtarët e luftës për çlirim kombëtar. ***Në përvjetorin e parë të çlirimit të tij, Sarajeva e madhe.***


Flaka u shua gjatë rrethimit të Sarajevës. Gjatë periudhës më të vështirë në historinë e Sarajevës, përmendorja dhe flaka e shuar simbolizonin fatin e qytetit, si një përpjekje për të ripërtërirë të gjithë jetën në qytet. Flaka u rindez në vigjilje të Vitit të Ri 1999, pasi u pagua fatura e gazit.



Fotografi nga Vera Katz.

Përdorni njohuritë e historisë së Jugosllavisë socialiste dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe shpjegoni se si në këtë rast të veçantë e tashmja ndikon në interpretimet e së shkuarës.

VI-17. Luftërat e kujtesës në kampin e përqendrimit të Jasenovacit



Përmendorja ***"Lulja e gurtë"*** në Jasenovac, Bogdan Bogdanoviç, 1966. Pronë e: JUSP / Zona Përkujtimore e Institucionit Publik/ Jasenovac. http:// www.jusp-jas enovac.hr/ Defau1t. aspx7si d = 5904, vizituar më 01.07.2016

Kampi i përqendrimit të Jasenovacit, i ndërtuar në shtetin e pavarur të Kroacisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishte kampi më i madh i shfarosjes në territorin e ish-Jugosllavisë. Viktimat e tij ishin kryesisht antifashistë serbë, romë, hebrenj dhe kroatë. Numri i saktë i atyre që vdiqën në kamp nuk u bë kurrë i ditur sepse arkivat e kampit u shkatërruan dhe për shkak të manipulimeve të mëvonshme politike. Gjatë regjimit komunist, shifrat për rreth 600,000 dhe 700,000 viktima ishin të diskutueshme. Megjithatë, gjatë viteve 1990, në ish-Jugosllavinë, secila anë përdorte shifra të ndryshme për qëllimet e saj, ku Serbia shpesh deklaronte se ishin rreth një milion të vrarë, ndërsa Kroacia e ulte numrin në rreth 30,000 ose më pak. Duke përdorur metoda demografike dhe statistikore, dhe duke bërë një listë të emrave, studiuesit kanë përllogaritur se numri i personave të vrarë në kamp ishte midis 60,000 dhe 80,000 të rënë. Kampi i Jasenovacit u rrafshua në prill të vitit 1945 nga ustashët pas revoltës së fundit të të burgosurve. Përmendorja qendrore në zonë, "Lulja e Gurtë", që simbolizonte pathyeshmërinë e jetës dhe që ishte një vepër e arkitektit Bogdan Bogdanoviç, u ngrit në vitin 1966. Pas krijimit të shteteve të reja, territori i kompleksit përkujtimor u shpërnda ndërmjet tyre, dhe si rrjedhojë e saj zonat përkujtimore në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë (Republika Srpska) ofrojnë këndvështrime të ndryshme për kampin. Koncepti i muzeut të ri, që u hap në vitin 2006, pati gjithashtu debate të ashpra. Qëllimi i autorëve të konceptit të ri ishte të ofronte një kujtesë moderne dhe personale të viktimave, por kritikët e kundërshtuan me faktin se ai nuk shpjegon ideologjinë në emër të së cilës u kryen vrasjet, dhe fsheh tmerrin dhe mizoritë e llahtarshme, që ndodhën. Përkujtimet e përvitshme, të organizuara në përvjetorin e revoltës të të burgosurve në prill të vitit 1945, vazhdojnë të shaktojnë kundërshti, duke përkeqësuar herë pas here marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë, dhe duke provokuar debate në skenën politike kroate.

→

VI-18. Ligji për barazimin e çetnikëve dhe partizanëve

Më 21 dhjetor 2004, Asambleja e Serbisë miratoi ndryshimet në Ligjin "Për të drejtat e veteranëve, veteranëve invalidë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre", duke barazuar të drejtat e anëtarëve të lëvizjeve të çetnikëve dhe partizanëve. Propozimi nga Lëvizja për Rilindjen Serbe (SPO) u përkrah nga 176 deputetë, ndërsa 24 deputetë votuan kundër tij. Ligji u miratua nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, me shpjegimin se ajo mbështetej në të vërtetën historike dhe se ajo ishte e nevojshme për të barazuar të drejtat e të gjithë atyre që luftuan kundër pushtuesve, fashistëve dhe nazistëve. Vetëm deputetët e Partisë Socialiste të Serbisë dhe Partisë Socialdemokrate votuan kundër ligjit të ri.

LIGJI PËR TË DREJTAT E VETERANËVE, VETERANËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PJESËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE

Neni 2. Ushtarët e Luftës për Çlirimin e Popullit (në vijim: ushtarët NOR), sipas këtij ligji, do të konsiderohen persona që iu bashkuan luftës për çlirimin e popullit para 1 janarit të vitit 1944 (burra), ose para 1 janarit të vitit 1945 (gra), nëse koha që ata kanë kaluar në luftën për çlirimin e popullit, deri më 15 maj 1945 llogaritet si vite intensive të shërbimit sipas rregulloreve për pensionin e punëtorëve dhe pagesa për aftësinë e kufizuar. [...]Sipas këtij ligji dhe në përputhje me të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, statusin e ushtarit NOR e gëzojnë edhe anëtarët e Ushtrisë Jugosllave në Atdhe dhe të Lëvizjes Ravna Gora, midis periudhës 17 prill 1941 dhe 15 maj 1945. [...]

Neni 3. Bazuar në këtë ligj, veteranët dhe personat me aftësi të kufizuara, kanë të drejtën për pagesa familjare të aftësisë së kufizuar, krahas personave që i gëzojnë këto të drejta sipas rregulloreve të vlefshme që përcaktojnë të drejtat bazë të veteranëve me aftësi të kufizuara dhe të familjeve të ushtarëve të rënë, si edhe përfshijnë veteranët me aftësi të kufizuara dhe familjet e anëtarve të rënë të Ushtrisë Jugosllave në Atdhe dhe të Lëvizjes "Ravna Gora". Medalja Përkujtimore "Ravna Gora" u krijua në vitin 1941 dhe ato iu dhanë personave, që iu bashkuan shtabeve të Lëvizjes "Ravna Gora", ose Ushtrisë Jugosllave në Atdhe në periudhën 17 prill 1941 deri 1 dhjetor 1941. Bazuar në të drejtat e përcaktuara nga ky ligj, mbajtësit e tyre janë të barabartë me mbajtësit e Medaljes Përkujtimore të Partizanëve 1941. [...]

Fletorja Zyrtare e RSS-së (Republikës Socialiste të Serbisë), nr. 54/89 dhe Fletorja Zyrtare e RS-së (Republikës së Serbisë), nr. 17/2004.

Lëvizja e "Rilindjes Serbe" (SPO), e krijuar si parti politike në mars të vitit 1990, në Beograd, dhe e kryesuar nga shkrimtari Vuk Drashkoviç, ka përkrahur krijimin e një monarkie parlamentare nën dinastinë e Karagjorgjeviç, rehabilitimin e Drazha Mihailoviç dhe të të gjithë viktimave të sistemit komunist, dhe hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Simboli i SPO-së është një dorë e ngritur me tre gishta. Në vitet '90, SPO udhëhoqi protestat antiqeveritare. Në vitin 1998, pas shpërthimit të konfliktit në Kosovë, SPO hyri në të ashtuquajturën "Qeveria e bashkimit kombëtar", dhe mbeti pjesë e saj gjatë bombardimit të NATO-s, deri në korrik të vitit 1999. SPO shtoi kritikat për regjimin e Millosheviçit pasi u largua nga koalicioni qeveritar, gjë që çoi në dy tentativa për vrasjen e Vuk Drashkoviç.

VI-19. Njohja në vitin 1982 e Rezistencës Kombëtare ndaj pushtimit prej Boshtit të Greqisë

Ekstrakte nga fjalimi i Kryeministrit Andrea Papandreu në parlamentin grek më 17 gusht 1982. Projektligji për njohjen e Rezistencës Kombëtare pranoi një sërë organizatash të krahut të majtë, që luftuan kundër Boshtit gjatë pushtimit të trefishtë (gjerman, italian dhe bullgar) të vendit, dhe që është përshkruar këtu për shkak të orientimit politik të krahut të majtë. Ky projektligj parashikonte gjithashtu akordimin e pensioneve shtetërore për individët, që mund të vërtetonin pjesëmarrjen e tyre në Rezistencë.

Nëpërmjet diskutimit të sotëm për projektligjin që njeh Rezistencën Kombëtare konstante të popullit grek, ne zgjedhim të nderojmë ata, që ranë për lirinë e vendit.

Sigurisht që ne mund të zgjidhnim çdo datë, sepse gjatë viteve të errëta të skllavërisë, në çdo qytet dhe në çdo fshat të atdheut, çdo ditë lidhej me Rezistencën Kombëtare kundër pushtimit fashist dhe nazist. Ajo ishte një rezistencë spontane ose masive e organizuar, apo edhe individuale, që përbën një epope në historinë moderne greke, një sekuencë e natyrshme e Epikës legjendare shqiptare.

Në vorbullën e madhe të përçarjes që pasoi, këto gjëra u harruan. Historia u shtrembërua. Ne të gjithë e dimë se Greqia ishte shteti i vetëm në Evropë që nuk e ka shlyer, deri më tani, borxhin ndaj Rezistencës, pavarësisht faktit se ishte i vetmi vend, që iu rezistoi forcave pushtuese.

Ne nuk kemi ardhur këtu sot për të gjykuar dhe as për të ndarë. Qëllimi kryesor i projektligjit është bashkimi kombëtar. Sigurisht, pas kaq shumë vitesh, është detyra jonë të shprehim mirënjohjen tonë për ata që luftuan. Sigurisht, pas kaq shumë vitesh, është detyra jonë të nderojmë ata që u harruan, ata që u ndaluan dhe ata që u persekutuan.

Ne mund t'i japim popullit tonë kujtesën e tij kombëtare dhe unë mendoj, se kjo është oferta më e mirë që ne mund të bëjmë. Kujtesa që është e nevojshme si për vetëndërgjegjësimin e popullit tonë, ashtu edhe për bashkimin e kombit tonë.

Botsiou (ed.), 2010, fq. 620-621.

Studioni me kujdes dy burimet e mësipërme. Serbia dhe Greqia kanë marrë vendime për rikthimin e statusit të disa grupeve, që janë ndaluar të jenë pjesë e kujtesës kombëtare zyrtare, ose për të cilët është heshtur për arsye të ndryshme. Gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet në të dyja rastet. Krahasoni arsyet themelore dhe përpiquni të kuptoni se si ndryshojnë qëndrimet me kalimin e kohës. Diskutoni.

VI.3. KUJTIMI I LUFTËRAVE TË FUNDIT

VI-20. Trëndafilat e Sarajevës

A. Historia e Trëndafilave të Sarajevës

Në fjalët e Nexhad Kurto, ideja për të krijuar Trëndafilat e Sarajevës erdhi nga nocioni i vuajtjes kolektive. Në opinionin e tij, çdo zonë në Sarajevë përfaqësonte vuajtjen e personave, që kishin vendosur të qëndronin në Sarajevë dhe vuajtja ishte pjesë e jetës së çdo personi gjatë rrethimit. Njerëzit atje prisnin çdo ditë në radhë për t'u furnizuar me bukë dhe ujë. Si rrjedhojë, Trëndafilat e Sarajevës përfaqësonin jo vetëm përkujtimin e atyre që vdiqën, por edhe të atyre që ia kushtuan jetën e tyre përballjes me vuajtjet për të jetuar në Sarajevë. Në këtë kuptim, Trëndafilat duket se përkujtojnë rrethimin, vuajtjen njerëzore dhe, madje, më e rëndësishmja, pafuqinë e tyre për të bërë diçka për ta mposhtur vuajtjen, ndërsa shënojnë gjurmët konkrete të vdekjes. [...]

Ideja e krijimit të Trëndafilave i lindi Nexhad Kurtos, pas masakrës që ndodhi në tregun Markale në shkurt të vitit 1994 [...] Kurto shpjegoi se ai nuk donte të ndërtonte një përmendore "socialisto-realiste" madhështore, që thjesht do të fliste për vendin. Ai donte të tregonte se si ndodhën shpërthimet e predhave në tokë, ndërsa njerëzit ishin shtrirë dhe përpiqeshin të mbroheshin nga predhat e tjera, që binin në tokë. Në perceptimin e Kurtos, vetë toka kishte një kuptim shumë simbolik dhe objekti përkujtimor duhej vendosur në nivelin e tokës. [...]

Opinioni i Kurtos është se Trëndafilat aty kanë vetëm domethënie dokumentuese dhe, si rrjedhojë, mund të zhduken në çdo moment, pasi nuk është e nevojshme që të mirëmbahen rregullisht. [...] Ai ka theksuar se qëllimi ishte të tërhiqte me takt vëmendjen e atyre, që tashmë e dinin se përse ishin krijuar këto site dhe se Trëndafilat duhet të vihen re nga personat e zakonshëm.

Junuzoviç, 2006, fq. 240-243.

B. Një nga Trëndafilat e rindërtuar të Sarajevës



Fotografi nga Vera Katz.

VI-21. Gjenocidi në Srebrenicë

A. Lulja e Srebrenicës - simbol i dhembshurisë dhe kujtesës



www.pinterest.com, vizituar më 21.10.2015

B. Përkujtimorja Srebrenica-Potoçari dhe Varreza me mbi 8,000 gurë varri



Robert Donia, Fotografia nr. 507, 11 korrik 2015, Qendra Përkujtimore e Srebrenicës, Donji Potocari.

VI-22. Srdjan Aleksiç, hero modern

Srdjan Aleksiç, me etni serbe, lindi në Trebinjë (Bosnjë-Hercegovinë) më 9 maj 1966. Ai ishte ushtar i Ushtrisë së Republikës Srpska dhe u vra ndërsa mbronte bashkëqytetarin e tij Alen Glavoviç (boshnjak) nga anëtarët e tjerë të Ushtrisë së Republikës Srpska, në tregun e Trebinjës, më 27 janar 1993. Në nekrologjinë e të birit, i ati i Srdjanit, Rade, shkroi: "Ai vdiq duke kryer detyrën e tij si qenie njerëzore". Disa qytete, kanë rrugë dhe sheshe që kanë marrë emrin e tij, në kujtim të veprës së tij të guximshme dhe njerëzore.



"Hero i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, lavdia dhe paqja e përjetshme qofshin me të". Srdjan Aleksiç 1966 - 1993 ww w.prozor-x.com, vizituar më 15.10.2015.

Komentoni fjalët e të atit të Srdjan Aleksiç: "Ai vdiq duke kryer detyrën e tij si qenie njerëzore". Si kontribuoi veprimi i Srdjanit në përkufizimin e një heroi?

VI-23. Tekst në kujtim të Josip Joviç, viktima e parë e luftës

Në të dielën e Pashkëve të vitit 1991, u zhvillua një përplasje e armatosur ndërmjet policisë kroate dhe milicisë vendase serbe në Plitvice. Aty u vra polici kroat Josip Joviç, që konsiderohet si viktima e parë kroate e Luftës për Pavarësinë e Kroacisë (Lufta për Atdhe).

Në kujtim të Josip Joviç

Përvjetori i parë i vdekjes së Josip Joviç, një luftëtar i ri dhe guximtar, do të kremtohet të martën, më 31 mars 1992. Josip Joviç ishte luftëtari i parë kroat, që u vra për të sjellë lirinë dhe pavarësinë e Kroacisë dhe, si rrjedhojë, ai është personifikimi i personave të tjerë të njohur dhe të panjohur, që e mbrojtën atdheun e tyre në këtë luftë të ashpër të pushtimit për Serbinë e Madhe.

Pavarësisht asaj që ndodhi, me dhimbje dhe hidhërim të thellë, dhe të përkulur mbi varrin e Josip Joviç, ne u betuam se do të çlironim çdo centimetër të territorit kroat, pa dyshuar as në atë kohë kur Kroacia kishte rënë në thellësinë e humnerës, se sa e vështirë dhe e mundimshme do të ishte rruga jonë, dhe se sa mijëra arkivole do të pasonin atë të Josipit në rrugën drejt lirisë, demokracisë dhe pavarësisë.

Sulmi i paprecedentë kundër Kroacisë, të gjitha tmerret e shkatërrimit, persekutimi, torturat dhe vrasjet, imazhet e përditshme të trupave të gjymtuar, dhe kortezhet funerale të gjata, dhe të dhimbshme, fatkeqësisht, kanë pakësuar kujdesin tonë për të evidentuar saktësisht numrin e luftëtarëve, dhe civilëve kroatë të rënë në luftë. Ky është një gabim që ne kemi bërë dhe që duhet ta zhbëjmë. [...]

Është detyra jonë të vazhdojmë deri në fund rrugën që kemi nisur, së pari duke i çliruar të gjitha pjesët e atdheut tonë dhe duke dëbuar pushtuesin serbo-çetnik dhe, më pas, nëpërmjet rimëkëmbjes shpirtërore dhe materiale të forcojmë Kroacinë si një shtet demokratik, me sundimin e ligjit që ishte dëshira dhe amaneti i atyre që u vranë. [...]

Bordi Kryesor i HNS-së (Partia Popullore Kroate) iu propozon të gjitha shoqatave rajonale dhe degëve të HNS-së që të bëjnë më të mirën e tyre për të marrë pjesë dhe ndjekur meshën e shenjtë të 31 marsit të vitit 1992 (e martë) kudo në Kroaci, kudo që ata jetojnë, si shenjë e mirënjohjes dhe shpirtit dashamirës ndaj të gjithë atyre që kanë humbur jetën, në kujtim të Josip Joviç dhe për t'u lutur për Paqen dhe për të mirën, për të gjithë ata që kanë dhënë jetën në këtë luftë për çlirimin e atdheut tonë, për një shtet kroat të pavarur.

Presidenca e Partisë Popullore Kroate
Vjesnik, 31 mars 1992

Përkujtimorja është një tekst ose fjalim që i përkushtohet dikujt që ka vdekur. Sa mund të mësoni për Josip Joviç në këtë nekrologji? Cili mendoni se është qëllimi kryesor i këtij teksti?

VI-24. Përmendore për bombardimin e stacionit televiziv kryesor të Beogradit nga NATO-ja (i ndërtuar nga familjet e viktimave) me mbishkrimin «Pse?»



Fotografi nga Radmila Radie

Vl-25. Përmendore në parkun Tashmajdan të Beogradit për Milica Rakiç, një vajzë e vogël, që u vra gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999.



Fotografi nga Radmila Radie

Përmendorja me mbishkrimin "Ne ishim thjesht fëmijë", u ndërtua në vitin 2000, në përvjetorin e parë të bombardimit në përkujtim të 79 fëmijëve viktima të bombardimit të RFJ-së (Republikës Federale të Jugosllavisë) nga NATO-ja. Projektimi u bë nga skulptori Ostoja Balkanski dhe skulptura me imazhin e vogëlushes Milica u bë falas në fonderinë Jeremiç.

Përdorni njohuritë tuaja lidhur me bombardimin e Serbisë nga NATO dhe komentoni mbishkrimet në të dyja përmendoret e ndërtuara në nder të viktimave civile: Përse? dhe "Ne ishim thjesht fëmijë". Si e nxjerrin ato përmendore në pah absurditetin e luftës?

VI.4. PAJTIMI NËPËRMJET RIKTHIMIT OSE SHKATËRRIMIT TË KUJTESËS

Vl-26. Djegia e dosjeve të sigurimit, 1989 (Greqi)

Në kapitullin Vl-26A gjendet kopertina e gazetës së përditshme të Athinës "Ta Nea", që paraqet një fotografi për djegien e rreth 17 milionë dosjeve që shërbimet e sigurimit i kanë krijuar që prej periudhës ndërmjet dy luftërave për qytetarët me besime politike të majta. Vendimi për t'i shkatërruar dosjet u mor nga koalicionin qeveritar i të djathtëve dhe të majtëve, këtij lloji në historinë e vendit. Ai ishte një lëvizje simbolike, që shënoi fundin e trashëgimisë së luftës civile. Në të njëjtën ditë, parlamenti votoi një ligj, që barazoi luftëtarët komunistë të DSE-së (Ushtria Demokratike e Greqisë) me ushtarët e Ushtrisë Kombëtare. Vendimi për t'i djegur dosjet ndeshi në kundërshtimin e historianëve dhe arkivistëve.

A. Kopertina e gazetës së përditshme të Athinës, 30 gusht 1989



Titulli: Dje në Parlament ATA DOGJËN/formalisht/të shkuarën, por... /e tashmja është plot me zjarre / Tensione ndërmjet Papandreut dhe Florakis / DIGJEN 15 MILIONË DOSJE

B. Gjashtëdhjetë historianë nënshkruan një peticion publik kundër djegies së dosjeve

Në Evropën e fundit të shekullit të njëzetë, kur të gjitha kombet ballafaquan me seriozitet historinë e tyre të viteve të fundit, Greqia nuk e merr parasysh historinë e saj. Vendimi i qeverisë për të shkatërruar dosjet i mohon historisë sonë një tjetër burim të saj. Vetëpërmbajtja dhe objektiviteti i nevojshëm në ballafaqimin e historisë, zëvendësohet me simbolizmin e përshtatshëm politik. Me fjalë të tjera, ai cakton një zgjidhje që nuk ndryshon nga ato që kanë çuar në shkatërrimin sistematik të arkivave dhe përmendoreve tona moderne.

Gazeta *"Ta Nea"*, 28 gusht 1989.

1. Cilat janë argumentet pro dhe kundër për shkatërrimin apo ruajtjen e dosjeve që shërbimet e sigurimit krijuan për qytetarët?
2. Vendoseni veten në vendin e një qytetari që është persekutuar në të shkuarën për shkak të besimeve të tij/saj politike, si edhe në vendin e një historian.
3. Krahasoni peticionin e nënshkruar nga historianët grekë me atë të nënshkruar nga historianët serbë (dok. 11-51): A mund të gjeni argumente të ngjashme? A ishin këto thirrje të suksesshme apo jo? Shpjegoni pse.
4. Diskutoni për rolin publik të historianit.

VI-27. Ura e Vjetër në Mostar

Ura e Vjetër u ndërtua nga arkitekti Hajrudin, ndërmjet viteve 1557 dhe 1566 në periudhën otomane. Megjithatë, në luftën e viteve 1990, ajo u bë simbol i konfliktit ndërmjet boshnjakëve dhe kroatëve në këtë qytet. Fillimisht ajo u dëmtua nga ushtria serbe dhe Ushtria e Popullit të Jugosllavisë, dhe më 10 nëntor 1993 ajo u shkatërrua plotësisht nga Këshilli Kroat i Mbrojtjes (Ushtria e kroatëve të Bosnjës). Gjenerali Slobodan Praljak u akuzua për shkatërrimin e Urës së Vjetër në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë; ai u dënua me 20 vite burgim për veprimtari kriminale të përbashkët me zyrtarët kroatë. Pas leximit të verdiktit, më 29 nëntor 2017 ai vetëhelmohet para trupit gjykues dhe vdiq. Ura u ndërtua në vitin 2004, me kontributin e komitetit shkencor ndërkombëtar të krijuar nga UNESCO. Pas restaurimit të saj, ajo u shtua dhe u rendit në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, dhe konsiderohet si simbol i "pajtimit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bashkëjetesës së komuniteteve kulturore, etnike dhe fetare të ndryshme".



Kartolinë: Peizazh i Mostarit, nga "Slovo" Blagaj-Mostar.

VI-28. Restaurimi i përmendoreve në Qipro, pas vitit 2004: Komiteti Teknik për Trashëgiminë Kulturore

Në prill të vitit 2008, udhëheqësit e komuniteteve të qipriotëve grekë dhe qipriotëve turq, me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ranë dakord për krijimin e disa komiteteve teknike, përfshirë Komitetin për Trashëgiminë Kulturore, që i "dedikohet njohjes, promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të pasur dhe të larmishme të ishullit". Komiteti, puna e të cilit financohet nga Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, beson se "mbrojtja e trashëgimisë kulturore, është pjesë përbërëse e procesit të vazhdueshëm të zgjerimit të fushave të bashkëpunimit" ndërmjet dy komuniteteve. Mandati i tij përfshin sigurimin e "një mekanizmi reciprokisht të pranueshëm", për zbatimin e masave praktike për ruajtjen, mbrojtjen fizike dhe restaurimin e përshtatshëm" të përmendoreve që janë dëmtuar, ose që janë në rrezik dëmtimi. Deri më tani janë restauruar shumë përmendore, kryesisht kisha dhe xhami që ishin dëmtuar ose gjatë sulmeve ajrore, të vitit 1974, ose për shkak të pakujdesisë dhe plaçkitjes së qëllimshme nga kontrabandistë të sendeve antike, veçanërisht në veri të ishullit. Në vitin 2015, Takis Haxhidhimitriu dhe Ali Tuncay, krerët qipriotë përkatësisht grek dhe turk të Komitetit morën çmimin e "Qytetarit Evropian" për punën e tyre në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të ishullit.

A. Punimet restauruese në manastirin e apostullit Andreas, një qendër pelegrinazhi në gadishullin Karpas, në skajin verilindor të Qipros



Arkivi CAN (Agjencia e Lajmeve e Qipros) - Katia Kristodhulu.

B. Xhamia në Evretu (rrethi Pafos) në pjesën jugore të ishullit, është restauruar gjithashtu me nismën e KTTK-së



Arkivi CAN (Agjencia e Lajmeve e Qipros) - Katia Kristodhulu.

1. Çfarë ishte Komiteti Teknik për Trashëgiminë Kulturore? Çdo të thotë shprehja "dedikuar njohjes, promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të pasur dhe të larmishme të ishullit"? Cila ishte rëndësia e marrëveshjes së përmendur më sipër, dhe cili ishte mesazhi që iu dha dy komuniteteve të ishullit? Diskutojeni çështjen duke mbajtur parasysh shkatërrimin e trashëgimisë kulturore sot në Siri?

2. Në rastin e parë (VI-26) dokumentet historike u shkatërruan me argumentin e vetëm se harresa sjell pajtim. Në rastin e dytë (VI-27 dhe 28), trashëgimia historike është restauruar dhe ruajtur me argumentin se ne duhet ta njohim dhe ta kujtojmë të shkuarën për të arritur pajtimin. Ndajini nxënësit në dy grupe dhe kërkojuni atyre të diskutojnë për çështjen. Secili grup duhet të kërkojë shembuj nga shtete të tjera.

PYETJE TË PËRGJITHSHME PËR KAPITULLIN VI

PJESA A

Përdorni dokumentet VI-1, VI-3, VI-4 dhe VI-6, dhe përgjigjjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Këta shembuj lidhen me kujtesën e tre udhëheqësve komunistë: Enver Hoxha, Josif Broz Tito dhe Gjergj Dimitrov. Gjeni informacione për ta dhe shkruani biografi të shkurtra për ta.

2. Cili është kuptimi simbolik i emrave të rrugëve, përmendoreve dhe mauzoleve? Përse shoqëritë i emërtojnë rrugët sipas emrave të personave të rëndësishëm ose ndërtojnë përmendore me emrat e tyre?

3. Krahasojini këto raste dhe gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet.

4. Lexoni historinë për shkatërrimin e Mauzoleut të Gjergj Dimitrovit dhe radhisni në listë të paktën tre arsye për shkatërrimin e tij. Cilën prej tyre ju e vlerësoni më të rëndësishmen?

5. Çfarë bëjmë ne me emrat e rrugëve dhe përmen-doreve që i referohen kuptimit të së shkuarës që shoqëria tashmë nuk i përdor më, veçanërisht nëse ata lidhen me kujtime të dhimbshme ose traumatike të së shkuarës? A mendoni se ka një alternativë për heqjen ose shkatërrimin e tyre?

PJESA B

1. Përdorni dokumentet VI-14, VI-15 dhe VI-5. Këto tre raste studimore lidhen me kulturën e përkujtimit të ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore në: Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe Rumani. Shihni tre përmendoret e treguara në fotografitë, lexoni çelësin dhe plotësoni tabelën e mëposhtme.

	Varreza e partizanëve në Mostar	Parku përkujtimor në Sumaricë	Ushtari sovjet në Jashi
Kur dhe pse u ndërtua përmendorja?			
Përshkruani trajtën, formën dhe simbolet, mbishkrimet, etj.			
Kur u shkatërrua përmendorja?			
Cilat janë arsyet e shkatërrimit të përmendores?			

2. Krahasoni atë çfarë ndodhi me përmen-doret dhe përkujtimoret e ndërtuara për të përkujtuar Luftën për Çlirim Kombëtar në Kroaci dhe Serbi. Përse shumica e tyre janë shkatërruar, dëmtuar apo janë braktisur? A bini dakord me pohimin e mëposhtëm: "Trajtimi i përmendoreve dhe përkujtimoreve të NLS-së në Kroacinë dhe Serbinë postkomuniste evidenton kujtesën e ndarë për Luftën e Dytë Botërore në të dyja shtetet"?

PJESA C

1. Përdorni dokumentet VI-7, VI-8 dhe VI-9. Të gjitha këto raste studimore përfaqësojnë përpjekje për ta bërë historinë zyrtare. Sido ta shpjegonit këtë term (historia zyrtare ose versioni zyrtar i historisë)? Nxirrni përfundime nga këta shembuj: Cilët janë aktorët (kush e ka të"drejtën" për të krijuar dhe bërë histori të tilla), dhe kush janë marrësit e këtyre versioneve zyrtare të historisë? Cili është qëllimi i tyre? Cilat janë mjetet për shpërndarjen e versioneve të tilla zyrtare të historisë?

2. A mendoni se historia zyrtare është e barabartë me "të vërtetën historike"? A është e mundur të ketë versione të ndryshme, por njësoj të vlefshme të historisë? Çfarë e bën një histori më të besueshme se një tjetër? Diskutoni burimet, evidencat, njohuritë, metodat, kërkimin.



Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1944	**Janar**	**27** Përfundon rrethi mi gjerman i Leningradit.	
	Janar-Prill		Aleatët ndër marrin sul me masive ajrore në Sofje (që prej nëntorit të vitit 1943); u shkatërrua treçereku i ndërtesave të q ytetit, vdiqën mbi 2,000 njerëz.
	Mars		**10** Fronti Nacionalçlirimtar (EAM) krijon Komitetin Politik për Çliri min Kombëtar (PEEA) si administratë paralele me qeverinë z yrtare greke në Kajro.
	Maj	**9** Trupat sovjetike çlirojnë Sevastopolin.	**11-20** Konferenca e Libanit formohet qeveria greke e Bashki mit Kombëtar me pjesëmarrjen e ministrave të FNÇ-së.
	Qershor	**6** Dita-D, hapet Fronti i Dytë me mbërritjen e Forcave Aleate në Normandi.	**1** Krijohet qeveria e re mbretërore në Bullgari nën udhëheqjen e Ivan Bagrianovit. **16** Marrëveshja e parë ndër mjet udhëheqjes komuniste të Jugosllavisë, e udhëhequr nga Titoja, dhe kryeministrit jugosllav të qeverisë në mërgim, Ivan Shubashiç; fati i monarkisë përcaktohet me referendu m, çetnikët përjashtohen përfundi misht nga qeveria e pasluftës.
	Qershor-Korrik	Ushtria e Kuqe shkatërron Batalionin Qendror Gjer man në Bjellorusi	
	Gusht	**15** Forcat Aleate zbarkojnë në jug të Francës. **25** Çliri mi i Parisit.	**23** Grusht shteti në Rumani, pas përpari mit të Frontit të Tretë Sovjetik ukrainas. Mbreti Mihai, me mbështetjen e koalicionit të partive më të mëdha dhe komunistëve, arrestojnë Jon Antoneskun dhe qeverinë e tij. **26** Kryeministri bullgar Bagraniov shpall asnjanësinë dhe përpiqet të negociojë me Aleatët Perëndi morë në Ankara dhe Kajro.
	Shtator	**3** Çliri mi i Brukselit. **19** Armëpushim ndërmjet Finlandës dhe Aleatëve. . **25** Aleatët çajnë Vijën Gotike të mbrojtjes gjermane në Itali.	**2** Në Bullgari krijohet qeveria proruse, e udhëhequr nga Konstantin Muravievi; më 5 shtator Bashki mi Sovjetik i shpall luftë Bullgarisë dhe pushton vendin më 8 shtator; në po të njëjtën ditë, qeveria e Muravievit i shpall luftë Gjer manisë. **9** Komunistët marrin nën kontroll Bullgarinë; ata përbëjnë shu micën e koalicionit qeveritar të Frontit për Çliri min e Atdheut, i udhëhequr nga Kimon Gjeorgjevi.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1944	Shtator		26 Nënshkruhet Marrëveshja Varkiza ndërmjet qeverisë së Bashkimit Kombëtar, forcave britanike dhe organizatave kkryesore të qëndresës, në një klimë ku mbizotëronin dyshimet nga të dyja palët; të gjitha forcat e qëndresës u vunë nën kontrollin britanik; trupat e ELAS u ndaluan të hynin në zonën e Athinës së Madhe.
	Tetor	2 Ushtria gjermane shtyp kryengritjen e Varshavës, të organizuar nga ushtria polake (jo komuniste). Forcat sovjetike të dislokuara afër qytetit nuk ndërhynë. 9 Nënshkruhet "Marrëveshja e Përqindjeve" ndërmjet Çurçillit dhe Stalinit për ndarjen e zonave të influencës në Evropën Lindore.	8 Bullgaria ndërmerr operacione ushtarake kundër forcave gjermane në Jugosllavi; nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, njësitë ushtarake të ushtrisë bullgare, si pjesë e Frontit të Tretë Ukrainas, luftojnë në Hungari dhe arrijnë deri në Austri. 12 Ushtria gjermane largohet nga Athina. 20 Çlirimi i Beogradit nga Ushtria e Kuqe dhe partizanët sovjetikë. 23 Krijimi i Qeverisë së Përkohshme të udhëhequr nga Enver Hoxha; më 29 nëntor vendi çlirohet nga pushtuesit. 25 Forcat sovjetike dhe rumune dëbojnë ushtrinë hungareze nga Transilvania.
	Tetor 1944-Shkurt 1945	Forcat amerikane kthehen në Filipine dhe mposhtin ushtrinë japoneze.	
	Dhjetor		3 Demonstratat e organizuara nga EAM-i në Athinë përfundojnë në gjakderdhje; përplasje të armatosura ndërmjet EAM-it dhe LAS-it (Ushtria Kombëtare për Çlirimin e Popullit) dhe fillon sprapsja e forcave të qeverisë greke nga britanikët.
	Dhjetor 1944-Janar 1945.	Dështon kundërofensiva gjermane në Arden.	
1945	Janar	17 Çlirimi i Varshavës nga Ushtria e Kuqe. 20 Hungaria nënshkruan armëpushimin me Aleatët.	Rreth 70, 000 gjermanë të Rumanisë dëbohen në Bashkimin Sovjetik.
	Shkurt	4-11 Konferenca e Jaltës. 13-15 Forcat e Aleatëve bombardojnë Dresdenin. 19 Trupat amerikane zbarkojnë në Iwo Jima .	12 **Marrëveshja** Varkiza parashikon çarmatimin e ELAS-it. 23 Turqia i shpall luftë Gjermanisë dhe Japonisë.
	Mars	3 Finlanda i shpall luftë Gjermanisë. 22-23 Aleatët kalojnë Rinin.	1 Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rimëkëmbje (UNRRA) ndërmerr furnizimin e Greqisë me materiale për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e vendit. 6 Formohet koalicioni qeveritar i Petru Grozës nga sovjetikët në Rumani.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1945	**Mars**	**12** Vdes presidenti amerikan Frenklin D. Rusvelt; pasohet nga Herri S. Truman.	Prezantohet programi i UNRRAS për rindërtimin e bujqësisë, industrisë dhe transportit në Jugosllavi.
	Prill	**1** Ushtria amerikane zbarkon në Okinava. **25** Trupat amerikane dhe sovjetike takohen në lumin Elb në afërsi të Torgaut. **28** Benito Musolini ekzekutohet nga partizanët italianë. **30** Vetëvritet Adolf Hitleri.	**28** SHBA-ja njeh qeverinë e përkohshme jugosllave të Titos, të përbërë prej Partisë komuniste, Partisë së Fshatarëve Kroatë dhe Partisë Demokratike.
	Maj	**2** Kapitullimi i mbrojtësve nazistë të Berlinit; ushtria sovjetike merr kontrollin e plotë të qytetit. **7** Kapitullimi i Gjermanisë.	**2** Ushtria e partizanëve jugosllavë hyn në Trieste; konflikti ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë. **15** Përfundimi i luftës në Jugosllavi; mposhtja e një kolone gjermane në tërheqje dhe e kolaboracionistëve nga partizanët jugosllavë në Poljana, Slloveni, një prej betejave të fundit të Luftës së Dytë Botërore në Evropë; rreth 100,000 kroatë, sllovenë dhe çetnikë u dorëzuan në Bleiburg, Austri; ndërmarrja e ekzekutimeve në masë dhe dëbimeve çnjerëzore drejt Jugosllavisë.
	Qershor	**5** Aleatët e ndajnë Gjermaninë në katër zona pushtimi. **26** Karta e themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nga përfaqësuesit e të pesëdhje të shteteve.	
	Korrik	Pas fitores spektakolare të Partisë Laburiste, Klement Atli zgjidhet kryeministër (1945-1951) dhe zëvendëson Uinston Çurçillin në mbledhjen e tre superfuqive: SHBA-së, Bashkimit Sovjetik dhe Mbretërisë së Bashkuar. **17 Korrik – 2 Gusht** Konferenca e Postdamit.	
	Gusht	**6** SHBA-ja hedh bombën atomike në Hiroshimë. **8** Bashkimi Sovjetik i shpall luftë Japonisë. **9** SHBA-ja hedh bombën atomike në Nagasaki.	**7** Ligjësimi i opozitës politike në Bullgari.
	Shtator	**2** Kapitullimi i Japonisë.	**19-25** Jugosllavia, Turqia dhe Greqia bëhen anëtare të OKB-së.
	Tetor		

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1945	Nëntor		11 Zgjedhje në Jugosllavi; Fronti Kombëtar i udhëhequr nga Titoja fiton 90% të votave; Asambleja Kombëtare shfuqizon monarkinë.
1946	Janar	1 Perandori i Japonisë Hirohito deklaron se nuk është hyjni; në nëntor shpallet kushtetuta e re.	Libri i "G ramatikës së gjuhës maqedonase" futet për herë të parë si tekst mësimor në shkollat e Republikës Popullore të Maqedonisë. Krijohet Partia Demokratike në Turqi, duke shënuar krijimin e një sistemi shumëpartiak. 11 Asambleja Kombëtare në Tiranë shpall Republikën Popullore të Shqipërisë. 31 Kushtetuta e parë e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë.
	Shkurt	Diplomati amerikan Xhorxh F. Kenan propozon "strategjinë e frenimit" ndaj Bashkimit Sovjetik, që më vonë u bë pjesë e Doktrinës së Trumanit.	
	Mars	5 Fjalimi i Uinston Çurçillit në Fulton, Misuri : Një "Perde e hekurt" ka rënë në Evropë.	31 Zhvillohen zgjedhjet e para të pasluftës në Greqi; e djathta fiton bindshëm me shumicë dërrmuese votash, e majta dhe komunistët abstenojnë.
	Prill	5 Bashkimi Sovjetik bie dakord për tërheqjen e Ushtrisë së Kuqe nga Irani. 17 Siria shpall pavarësinë nga Franca.	
	Maj	9 Mbreti Viktor Emanueli III i Italisë, abdikon dhe zëvendësohet nga i biri Umberto II; më 2 qershor, monarkia rrëzohet me referendum; pas zgjedhjeve parlamentare, krijohet koalicioni qeveritar nga Partia Demokristiane, Partia Socialiste dhe Partia Komuniste. 26 Komunistët fitojnë zgjedhjet parlamentare në Çekosllovaki; krijohet koalicioni me kryeministër udhëheqësin komunist Klement Gotvaldin; Edvard Beneshi dhe Jan Masariku vazhdojnë të mbajnë detyrat e tyre përkatëse si president dhe ministër i jashtëm i republikës.	
	Qershor	3 Gjykata Ndërkombëtare në Tokio çon para gjyqit kriminelët e luftës.	1 Ekzekutohet ish-diktatori rumun Jon Antonesku.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1946	Korrik	4 Filipinet fitojnë pavarësinë nga SHBA-të.	5 Dragoljub Mihailoviçi, udhëheqësi i çetnikëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dënohet me vdekje për bashkëpunim dhe krime lufte kundër civilëve joserbë". 9 Nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në Tiranë.
	KorrikTetor	Konferenca e Paqes në Paris.	
	Shtator		1 Shtabi i Përgjithshëm i partizanëve merr emrin Ushtria Demokratike e Greqisë (DSE, komunist). Fillimi i luftës civile. 1 Në referendumin për çështjen kushtetuese, 68% votuan pro Mbretit Jorgo II, që u kthye në Greqi më 27 shtator. 8 Referendumi në Bullgari miratoi me shumicë votash (85%) heqjen e monarkisë dhe vendosjen e një republike.
	Tetor	16 Dhjetë udhëheqës nazistë u varën pak pas përfundimit të gjyqeve të Nurenbergut.	27 Fronti i Atdheut në Bullgari, ku mbizotëronin komunistët, fitoi bindshëm në zgjedhje; më 23 nëntor, Gjergj Dimitrovi bëhet kryeministër.
	Nëntor		19 Zgjedhjet e para të pasluftës në Rumani sollën formimin e një parlamenti me shumicë komuniste; gratë rumune ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar për herë të parë.
	Nëntor-Dhjetor	Konferenca e Parë e Përgjithshme e UNESCO -s.	
	Dhjetor		7 Shtetëzimi i pronës private në Jugosllavi (përfundoi në vitin 1948).
1947	Shkurt	Në Bashkimin Sovjetik fillon të transmetohet stacioni i radios "Zëri i Amerikës". 10 Traktatet e Paqes së Parisit, të nënshkruara nga: Finlanda, Italia, Hungaria, Rumania dhe Bullgaria, i japin fund zyrtarisht Luftës së Dytë Botërore.	Ishujt Dodekanezë iu dhanë Greqisë; krijohet kampi i përqendrimit Makronisos për rehabilitimin e komunistëve dhe simpatizantëve të majtë.
	Mars	Kuomintangu dhe Partia Komuniste e Kinës rinisin luftën civile. 12 Përpara seancës së përbashkët të Kongresit, presidenti i SHBA së mban një fjalim për Doktrinën e Trumanit.	
	Prill		1 Themelimi i Linjës Ajrore Jugosllave.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1947	Qershor	5 Fjalimi i Sekretarit të Shtetit Xhorxh Marshall në Universitetin e Harvardit, ku shpalli planin për rindërtimin e Evropës së pasluftës.	20 Marrëveshja SHBA-Greqi e qershorit, parashikon krijimin e Misionit Amerikan për Ndihmën ndaj Greqisë (AMAG).
	Korrik		30 Korrik–1 Gusht Përmbyllja e Marrëveshjeve të Bledit, një hap drejt Federatës jugosllave-bullgare.
	Gusht	15 Përfundimi i sundimit britanik në Indi, një fazë madhore për procesin e shkolonizimit në Azinë Jugore dhe Juglindore.	
	Gusht-Shtator		Nikola Petkov, udhëheqësi i Bashkimit Kombëtar Agrar të Bullgarisë (BKAB) gjykohet, dënohet me vdekje dhe ekzekutohet, ndërsa partia u shpall e jashtëligjshme.
	Shtator	COMINFORM-i (1947-1956) shpallet si pasardhësja e Internacionales së Tretë.	
	Dhjetor	Bell Labs shpik transistorin.	Bisedimet për përfshirjen e Shqipërisë në një Federatë të ardhshme ndërmjet Jugosllavisë dhe Bullgarisë. 4 Asambleja e Madhe Kombëtare në Sofje shpall kushtetutën e parë të Republikës Popullore të Bullgarisë (RPB) dhe voton disa ligje për shtetëzimin e ndërmarrjeve private industriale dhe minerare dhe për vendosjen e monopolit mbi sistemin bankar. 27 Partia Komuniste e Greqisë (KKE) dhe degët e saj shpallen të jashtëligjshme përmes një dekreti urgjent. 30 Mbreti Mihai detyrohet të abdikojë dhe largohet nga Rumania.
1948	Shkurt	25 Grusht shteti nga komunistët në Çekosllovaki; komunistët marrin nën kontroll të gjithë Evropën Lindore.	26 Plani Marshall i ofron Greqisë një ndihmë prej 694 milion $.
	Prill		13 Krijimi i qeverisë së Republikës Popullore të Sllovenisë.
	Maj	14 Krijohet shteti i Izraelit; koalicioni me forcat fqinje arabe sulmojnë shtetin e ri; përfundon lufta e parë arabo-izraelite në shkurt të vitit 1949.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1948	Qershor	Bllokada sovjetike e Berlinit Perëndimor synon tërheqjen e Aleatëve Perëndimorë nga zonat e pushtimit në qytet; plani u prish nga furnizimi i zonës perëndimore përmes rrugëve ajrore.	**28** Jugosllavia përjashtohet nga COMINFORM-i, gjë që pohon prishjen e marrëdhënieve Tito-Stalin.
	Korrik		**4** Turqia përfiton ndihmë në kuadrin e Planit Marshall; në vitin 1952 vendi merrte mbi 400 miliard dollarë.
	Tetor-Nëntor		Merr fund opozita antikomuniste në Bullgari, partia prokomuniste BANU, së bashku me Frontin për Atdheun përbëjnë një pluralizëm politik dekorativ.
	Tetor 1948 Maj 1949		Rreth 32,000 hebrenj bullgarë (tre e katërta) emigrojnë në Izrael.
	Nëntor	**12** Ish-kryeministri japonez Hideki Tojo dënohet me vdekje për krime lufte nga Gjykata Ushtarake Ndërkombëtare e Lindjes së Largët.	
	Dhjetor	**10** Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Paris shpall Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.	**18–25** Kongresi i Pestë i Partisë së Punëtorëve të Bullgarisë; partia e ndryshon emrin në Partia Komuniste Bullgare (PKB) dhe ndërmerr reforma radikale ekonomike dhe shoqërore.
1949	Janar	Themelimi i Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER) nga Bashkimi Sovjetik, Bullgaria, Çekosllovakia, Hungaria, Polonia dhe Rumania; Shqipëria u anëtarësua pas një viti (por, në vitin 1961 nuk luajti asnjë rol aktiv), që u ndoq nga Republika Demokratike e Gjermanisë (RDGJ) në vitin 1950, Mongolia në 1962-in, Kuba në 1972-in dhe Vietnami në 1978-in, Jugosllavia u anëtarësua në 1964-n.	
	Prill	**4** SHBA-ja, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Britania, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia dhe Portugalia krijuan Organizatën e Traktatit Atlantik Verior (NATO).	**24** Themelohet Universiteti "Kirili" dhe "Metodi" në Shkup. **27** Krijimi i kampit të punës Belene, kampi më i madh i përqendrimit në Bullgari.
	Maj	**5** Nënshkruhet Statuti i Këshillit të Evropës nga dhjetë vende në Londër. **23** Themelohet Republika Federale e Gjermanisë (RFGJ); përbëhet nga zonat e pushtuara nga aleatët Perëndimorë.	Në Turqi mbërrin dërgesa e parë e traktorëve, në kuadrin e Planit Marshall. **25** Fillon të funksionojë fabrika e parë e penicilinës në Zemun; Jugosllavia bëhet vendi i katërt në botë që prodhon penicilinë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1949	Korrik		Hapja e kampit të përqendrimit në ishullin Goli; simbol i spastrimeve mizore dhe shtypjes së egër politike në Jugosllavinë e hershme të Titos. 2 Vdes udhëheqësi komunist bullgar, Gjergj Dimitrovi. 10 Menjëherë pasi KKE-ja u bë palë me Bashkimin Sovjetik, pas prishjes së marrëdhënieve Tito-Stalin, Jugosllavia mbylli kufijtë e saj me Greqinë, duke ndërprerë linjat kryesore të furnizimit të DSE-së.
	Gusht	29 Prova e shpërthimit të një bombe atomike sovjetike; fundi i monopolit nuklear të SHBA-së.	30 Ushtria Kombëtare Greke mposhti shumicën e forcave të DSE-së në Maqedoninë Perëndimore; përfundimi i luftës civile në Greqi.
	Tetor	1 Udhëheqësi komunist i Kinës, Mao Ce Duni shpall krijimin e Republikës Popullore të Kinës. 7 Themelohet RDGJ-ja; përfshinte zonën e pushtuar sovjetike.	
	Nëntor	2 Holanda njeh Indonezinë si shtet të pavarur.	
1950	Janar		15 Kisha Ortodokse e Qipros organizon një referendum për qipriotët grekë për bashkimin me Greqinë; 95,7% votuan pro bashkimit.
	Shkurt	9 Senatori Xhozef Mekarthi zbulon se qeveria e SHBA- së "është mbrusur me komunistë"; në vitet 1950 fillon edhe "qjuetia e shtrigave" e intelektualeve dhe të dyshuarve të tjerë, që u quajt Mekarthizëm.	
	Mars		5 Njëzet e nëntë parti kundërshtojnë zgjedhjet parlamentare në Greqi; e Djathta humbet shumicën në parlament, që tani kontrollohet nga një qendër heterogjene.
	Maj	9 Deklarata e ministrit francez Robert Shuman për krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (themeluar në vitin 1951: nga Franca, RFGJ-ja, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu); një hap madhor drejt integrimit evropian.	14 Partia Demokratike fiton zgjedhjet e para shumëpartiake në Turqi: Xhelal Bajari bëhet president, ndërsa Adnan Menderesi kryeministër.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1950	Qershor	17 Kryhet për herë të parë operacioni i transplantit të veshkës së njeriut në Çikago. 25 Forcat e armatosura të Koresë së Veriut pushtojnë Korenë e Jugut; fillimi i Luftës Koreane (1950-1953). Fillon transmetimin Radioja "Evropa e lirë".	Përfundon seksioni i parë i rrugës automobilistike "Bashkim - Vëllazërim" ndërmjet Zagrebit dhe Beogradit. 26 Asambleja Kombëtare Jugosllave miraton Ligjin e Vetadministrimit të Punëtorëve.
	Korrik		Parlamenti turk anulon dekretin për ndalimin e përdorimit të gjuhës arabe gjatë thirrjeve për falje; qeveria vendos të dërgojë trupa turke për të luftuar në Luftën e Koresë si pjesë e koalicionit të OKB-së të drejtuar nga SHBA-ja; në tetor futet edhe udhëzimi i detyrueshëm fetar.
	Tetor	Ushtria kineze pushton de facto shtetin sovran të Tibetit; pas kryengritjes kundër sundimit kinez, në vitin 1959, Dalai Lama i Katërmbëdhjetë mërgon në Indi.	Marrëveshja ndërmjet SHBA-së dhe Jugosllavisë parashikon ndihmë humanitare dhe ushtarake.
	Nëntor	Kina hyn në Luftën Koreane; Presidenti i SHBA-së, Trumani kërcënon Maon me bombë atomike.	
1951	Shkurt		14 Sekretarja e Shtetit, Din Açsoni, deklaron se nëse Jugosllavia sulmohet, SHBA ja do të përgjigjet si në rastin e Koresë.
	Qershor	Në SHBA, vihet në punë kompjuteri i parë.	
	Korrik		25 Miratohet ligji kundër shpifjeve ndaj Ataturkut.
	Shtator	1 Në San Francisko, nënshkruhet Traktati i Sigurisë së Paqësorit (Pakti ANZUS) ndërmjet Australisë, Zelandës së Re, dhe SHBA-së 8 Traktati i San Franciskos i jep fund luftës ndërmjet Japonisë dhe dyzet e shtatë aleatëve të Luftës së Dytë Botërore (nuk u nënshkrua nga shumica e vendeve aleate me Bashkimin Sovjetik) si dhe i dha fund pushtimit amerikan; në të njëjtën ditë arrihet edhe një marrëveshje sigurie ndërmjet SHBA-së dhe Japonisë.	
1952	Shkurt		18 Greqia dhe Turqia hyjnë në NATO.
	Maj	2 Avioni i linjës ajrore Comet fluturon me 46 pasagjerë në bord nga Londra drejt Johanesvurgut, duke inaguruar shërbimin e parë të programuar të linjës ajrore me avionë reaktivë. 26 Britania njofton se ka një bombë bërthamore.	28 Në Greqi, grave iu jepet e drejta e votimit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1952	Nëntor		2-7 Partia Komuniste e Jugosllavisë ndërron emrin në Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. 16 Zgjedhjet parlamentare në Greqi përfunduan me fitoren dërrmuese të partisë "Tubimi Grek", e drejtuar nga Marshall Papagosi, modeli i së cilës ishte frymëzuar nga partia "Tubimi i Popullit Francez" të drejtuar nga Sharl dë Goli.
1953	Janar	20 Duajt D. Aizenhaueri zgjidhet presidenti i SHBA-së.	20 Zgjidhet gruaja e parë deputete në parlamentin e Greqisë.
	Shkurt	28 **Xhejms Uatson dhe Francis Krik,** shkencëtarët e Universitetit të Kembrixhit, njoftojnë se kanë gjetur strukturën me helikë të dyfishtë të ADN-së; në vitin 1962, të dy ata, së bashku me Mauris Uilkinsin morën çmimin "Nobel" në fiziologji.	28 Nënshkruhet në Ankara Marrëveshja për Miqësi dhe Bashkëpunim ndërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë.
	Mars	5 Vdekja e Stalinit; udhëheqje kolektive deri në shkurt të vitit 1955 kur Nikita Hrushevi bëhet udhëheqësi i ri i Bashki mit Sovjetik.	
	Maj	29 Edmund Hillari dhe Tenzing Norgei arrijnë majën e malit Everest, pikën më të lartë të botës.	10 Restaurimi i Partiarkatit Bullgar.
	Qershor	Kryengritje në RDGJ kundër regjimit dhe pushtimit sovjetik.	
	Korrik	27 Marrëveshja Koreane e Armëpushimit përcakton demarkacionin në paralelin e 38-të.	
	Dhjetor		Në Jugosllavi. ndalohet festimi i Krishtlindjeve.
1954	Janar	21 Krijohet nëndetësja e parë me energji bërthamore, USS Nautilus.	Milovan Gjilasi, një komunist i spikatur jugosllav dhe kritik i sistemit ekzistues, përjashtohet nga Partia dhe arrestohet; dënohet me 13 vjet burgim në vitin 1962 (u lirua në vitin 1966).
	Mars	22 Hapet qendra e parë tregtare në Southfield, Miçigan. 31 Bashkimi Sovjetik ofrohet t 'i bashkohet NATO-s.	
	Prill	25 Shoqëria " Bell Labs " zbulon baterinë e parë me energji diellore.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1954	Maj	7 Garnizoni francez dorëzohet në Dien Bien Phu në Vietnamin Veriperëndimor, i ndjekur nga tërheqja e forcave koloniale franceze nga Indokina dhe ndarja e vendit përgjatë paralelit të 17-të.	
	Qershor		Hapja e "Urës së miqësisë" mbi lumin Danub, e projektuar nga inxhinierët sovjetikë, që lidh qytetin bullgar të Rusit me qytetin rumun të Giurgusë.
	Gusht		Greqia i dorëzon OKB-së thirrjen për vetëvendosjen e Qipros. 10 Traktati i Aleancës, Bashkëpunimit Politik dhe Asistencës Reciproke ndërmjet Greqisë, Turqisë dhe Jugosllavisë (Pakti i Ballkanit).
	Shtator	SHBA-ja, Britania, Franca, Zelanda e Re, Australia, Filipinet, Tailanda dhe Pakistani krijojnë Organizatën e Traktatit të Azisë Juglindore (SEATO).	
	Tetor		5 Përmbyllet Memorandumi i Londrës për Territorin e Lirë të Triestes: Zona A, duke përfshirë Triesten, iu dha Italisë; ndërsa zona B, iu dha Jugosllavisë (Kroaci dhe Sllloveni).
	Dhjetor		8 Marrëveshja e Novi Sadit për gjuhën serbo-kroate. Petar Gubeira i Universitetit të Zagrebit publikon parimet e tij për Metodën Verbo-tonale për rehabilitimin e fëmijëve të shurdhër, që u zbatua në mbi 70 vende.
1955	Shkurt Nëntor	Themelimi i Organizatës Qendrore të Traktatit (CENTO, ose Pakti i Bagdadit) nga Irani, Iraku, Pakistani, Turqia dhe Britania.	
	Mars	15 Traktati i Vjenës; Britania, Franca. Bashkimi Sovjetik dhe SHBA restaurojnë pavarësinë e Austrisë.	
	Prill	Përfaqësues nga 29 vende të painkuadruara nga Azia, Afrika dhe Lindja e Mesme marrin pjesë në një konferencë të mbajtur në Bandburg, Indonezi. 18 Udhëheqësi komunist i Hungarisë, Imre Nagi u detyrua të jepte dorëheqjen si kryeministër .	1 Organizata Kombëtare e Luftëtarëve të Qipros (EOKA) fillon luftën e armatosur kundër sundimit kolonial britanik, duke synuar bashkimin e ishullit me Greqisë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1955	Maj	9 Republika Federale e Gjermanisë hyn në NATO. 14 Themelohet Organizata e Traktatit të Varshavës (Pakti Varshavës) nga: Bashkimi Sovjetik, Shqipëria, Bullgaria, Çekosllovakia, Hungaria, Polonia, Rumania; RDGJ-ja anëtarësohet në vitin 1956.	26 Nikita Hrushovi viziton Jugosllavinë; marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve fillojnë të normalizohen.
	Korrik		18-19 Josif Broz Tito, Xhaurahalal Nehruja dhe Xhamel Abdel Naseri u takuan në Brijuni, Kroaci, dhe themeluan Lëvizjen e Shteteve të Paangazhuara. 27 Avioni i linjës ajrore "Israeli" me 51 pasagjerë dhe 7 anëtarë ekuipazhi në bord, qëllohet dhe rrëzohet në hapësirën ajrore të Bullgarisë.
	Shtator		6-7 Pogromi kundër pakicës greke në Stamboll.
	Dhjetor		-25 Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania bëhen anëtare të OKB-së.
1956	Janar		3 Konstantinos Karamanlis riemërton partinë "Tubimi Grek" në Bashkimin Kombëtar Radikal (ERE) dhe siguron shumicën në zgjedhjet e 19 shkurtit, edhe pse akuzohet për një sistem zgjedhor të njëanshëm.
	Shkurt	Nikita Hrushovi denoncon stalinizmin në Kongresin e Njëzetë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.	
	Prill		2-6 Pas destalinizimit të Nikita Hrushovit, Partia Komuniste e Bullgarisë denoncon në plenumin e saj stalinizmin dhe kultin e individit; Todor Zhivkovi bëhet udhëheqësi i padiskutueshëm i Bullgarisë deri në vitin 1989.
	Maj	24 Konkursi i parë i Këngës në Eurovizion në Lugano, Zvicra italiane.	15 Televizioni i Zagrebit fillon transmetimin.
	Qershor		Titoja viziton Rumaninë; normalizimi i marrëdhënieve Rumani-Jugosllavi.
	Korrik-Nëntor	Pas shtetëzimit të kanalit të Suezit nga presidenti Naser, Britania, Franca dhe Izraeli sulmojnë Egjiptin.	
	Tetor-Nëntor	Demonstrata masive në Hungari ku bëhej thirrje për demokratizim; Imre Nagi bëhet kryeministër dhe premton zgjedhje të lira; trupat sovjetike shtypin kryengritjen hungareze.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1957	**Janar**	**5** Në janar, presidenti Duajt D. Aizenhauer shpall Doktrinën Aizenhauer, një zhvillim i mëtejshëm i strategjisë kryesore amerikane të Luftës së Ftohtë, për "frenimin" e Bashkimit Sovjetik.	
	Mars	**25** Franca, RFGJ-ja, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu nënshkruajnë Traktatin e Romës duke themeluar Bashkësinë Ekonomike Evropiane (KEE).	
	Tetor	**4** Bashkimi Sovjetik hedh në hapësirë satelitin e parë artificial, Sputnik 1; fazë e re e garës së armëve dhe tensioneve të Luftës së Ftohtë; fillon "gara e hapësirës".	Themelohet Universiteti Shtetëror i Tiranës, institucioni i parë i arsimit të lartë në Shqipëri.
	Dhjetor		**26** Rezoluta e Byrosë Politike të Partisë Komuniste Bullgare bën thirrje për fuqizimin dhe përmirësimin e propagandës për ateizmin; arrestime të priftërinjve ortodoksë, pas përndjekjes së mëparshme dhe dënimit të klerikëve katolikë, ortodoksë dhe protestantë.
1958	**Mars**	**12** Dita e Perandorisë Britanike shpallet si Dita e Komonuelthit.	
	Prill	**4** Marshimi i parë kundër armëve bërthamore në Angli.	
	Maj		Trupat sovjetike fillojnë tërheqjennga territori rumun. Gjatë festivalit të filmit në Kanë, kritikët francezë të kinematografisë Zhorzh Sadul dhe Marsel Martini krijojnë termin "Shkolla e filmave vizatimorë të Zagrebit"; gjatë dy dhjetëvjeçarëve në vijim, shkolla do të prodhonte 400 filma dhe do të fitonte shumë çmime ndërkombëtare. **11** E majta e Bashkuar Demokratike (EDA) kthehet në opozitën zyrtare me 24% të votave, në zgjedhjet parlamentare të Greqisë.
	Qershor	**16** Ekzekutohet Imre Nagi për shkak të reformave liberale (1953-1955) dhe rolit të tij gjatë kryengritjes hungareze të vitit 1956.	**2-7** Nikita Hrushovi merr pjesë në Kongresin e Shtatë të Partisë Komuniste Bullgare; shpallet "fitorja e sistemit socialist" në Bullgari me mbi 92% tokë të lëvrueshme duke përfshirë edhe fermat kooperativiste; planet për industrializimin, duke i dhënë përparësi industrisë së rëndë dhe "intensifikimit të bujqësisë".

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1958	Shtator	5 Regjistrohet videoja e parë me ngjyra me kasetë magnetike në Sharlotë, SHBA.	
	Nëntor		29 Fillon transmetimin Radio Televizioni Jugosllav (RTJ, Beograd).
1959	Janar	2 Forcat revolucionare të Kubës hyjnë në Havana.	
	Shkurt		Marrëveshjet e Zyrihut dhe Londrës ndërmjet Britanisë, Greqisë dhe Turqisë parashikojnë Republikën e pavarur të Qipros në Komunuelthin e Britanisë.
	Mars	24 Prezantohet një nga qarqet e para të ngurta dhe të integruara, ose mikroçipet, në një nga ekspozitat e para të Institutit të Inxhinierëve të Radios; pajisja kthehet në elementin bazë të shpikjeve progresive si makina llogaritëse e dorës, kompjuteri personal, telefoni celular, Interneti dhe gjithçka që përfshin teknologjinë digjitale.	
	Prill		Filmi "Yjet" (Stars,) një bashkëprodhim gjermano-bullgar me regjisor Konrad Ulfin, fiton Çmimin e Madh të Jurisë në Festivalin e Filmit në Kanë.
	Nëntor		1 Transmetimi i parë televiziv në Bullgari.
1960	Janar	23 Batiskafi "Trieste" me eksploruesit Zhak Pikardin dhe Don Ualshin në bord, arrijnë në fund të kanalit Mariana, pikën më të thellë të oqeaneve të botës.	
	Janar-Nëntor	"Viti i Afrikës": shtatëmbëdhjetë vende shpallin pavarësinë nga sundimi kolonial francez, belg, britanik dhe italian.	
	Shkurt	Fillimi i protestave masive për të drejtat civile të afro-amerikanëve.	
	Maj	9 Administrata amerikane për Ushqimin dhe Barnat miraton pilulën e parë kontraceptive të prodhuar në botë, duke u dhënë më tepër mundësi gratë për lirinë e riprodhimit dhe planifikimit familjar; pilula u bë një nga simbolet e "revolucioni seksual" të viteve 1960 dhe 1970.	27 Grusht shteti ushtarak në Turqi; Gjenerali Xhemal Gyrsel bëhet president.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1960	Qershor		Shqipëria shpall mbështetjen e saj ndaj Kinës kundër BRSS-së në një mbledhje të partive komuniste në Bukuresht.
	Gusht		**16** Themelimi i Republikës së Qipros; në maj të vitit 1961, shteti i ri bëhet anëtar i OKB-së, Komonuelthit, Lëvizjes së Shteteve të Painkuadruara dhe Këshillit të Evropës.
1961	Janar	**20** Xhon F. Kenedi bëhet president i SHBA-së.	
	Prill	**12** Kozmonauti sovjetik Juri Gagarin, bëhet njeriu i parë në botë që ndërmerr një udhëtim në hapësirë. **13** Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dënon aparteidin në Afrikën e Jugut.	**19** Kompozitori grek Manos Haxhidakis fiton çmimin Oskar për kolonën më të mirë zanore të filmit të Zhyl Dasinit "Kurrë të dielave" (Never on Sunday).
	Maj	**28** Shtatëdhjetë e tetë vjet pas udhëtimit të parë, "Ekspresi i Lindjes" bën udhëtimin e fundit nga Parisi në Bukuresht.	
	Qershor	**23** Hyn në fuqi Traktati i Arktikut, ku parashikohej se burimet e kontinentit do të përdoren vetëm për qëllime paqësore dhe bashkëpunim ndërkombëtar.	
	Korrik		**9** Marrëveshje Asocimi në Athinë ndërmjet Greqisë dhe BEE-së.
	Gusht	**13** Mbyllet kufiri ndërmjet Berlinit Lindor dhe Perëndimor; fillon ndërtimi i Murit të Berlinit.	
	Shtator		**1** Organizohet në Beograd samiti i parë i Lëvizjes së Shteteve të Painkuadruara. **16-17** Ekzekutohet ish-kryeministri turk Adnan Menderes dhe dy ministra të tij, që ishin arrestuar pas grushtit të shtetit të vitit 1960.
	Tetor		**29** ERE-ja e Karamanlisit siguron shumicën në parlament në zgjedhjet parlamentare të Greqisë; rezultati u denoncua nga partitë opozitare si rrjedhojë e "dhunës dhe mashtrimit"; Giorgios Papandreu, që sapo kishte themeluar Bashkimin e Qendrës, shpall "luftën e palëkundur".
	Dhjetor		Romancieri dhe poeti jugosllav, Ivo Andriçi, fiton çmimin "Nobel" në letërsi.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1961	Dhjetor		7 Sipas ndryshimeve kushtetuese pas grushtit të shtetit të vitit 1960, në Turqi mblidhet për herë të parë Këshilli Kombëtar i Sigurisë nën kontrollin ushtarak. 10 Shqipëria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Bashkimin Sovjetik.
1962	Shkurt	10 Piloti amerikan, Geri Pauërs, avioni spiun U-2 i të cilit u qëllua nga avionët hapësinorë sovjetikë, shkëmbehet me Rudolf Abelin, një nga spiunët më të mirë të KGB-së sovjetike, i kapur në SHBA, në një urë që lidhte Berlinin Perëndimor me atë Lindor.	
	Mars	18 Marrëveshja e Paqes ndërmjet Francës dhe Frontit Nacionalçlirimtar i jep fund luftës shtatëvjeçare algjeriane për pavarësi.	
	Prill		Përfundon kolektivizimi i Rumanisë. 2 Lindja e qytetarit të tetë miliontë të Bullgarisë, shpallet si sukses i madh i politikave demografike të RPB-së. 9 April Dushan Vukotiçi është shtetasi i parë joamerikan dhe karikaturisti i parë kroat që fiton çmimin "Oskar" për filmin vizatimor "Substitute".
	Korrik		Qeveria greke mbyll kampin e fundit të përqendrimit në vend.
	Tetor	Zgjidhet Kriza Kubane e Raketave; Nikita Hrushovi dhe Xhon F. Kenedi bien dakord për largimin e raketave sovjetike nga Kuba dhe të raketave amerikane nga Turqia.	
	Tetor-Nëntor	Lufta kino-indiane përgjatë kufirit të Himalajeve.	
1963	Janar	11 Hapet diskoteka e parë në Los Anxhelos.	
	Mars	20 Ekspozita e parë e popit në Nju Jork.	
	Prill		9 Republika Popullore Federale e Jugosllavisë miraton një kushtetutë të re dhe merr emrin Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë.
	Maj	26 Themelohet Organizata e Bashkimit Afrikan.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1963	Qershor	16 Kozmonautja sovjetike Valentina Tereshkova, bëhet gruaja e parë në botë që fluturon në hapësirë. 20 SHBA-ja dhe Bashkimi Sovjetik bien dakord për krijimin e linjës telefonike për komunikimin e drejtpërdrejtë në rast emergjencash.	
	Korrik		26 Shkupi goditet nga tërmete të forta, ku humbën jetën mbi 1,000 njerëz dhe u shkatërruan rreth 65% e ndërtesave të qytetit; OKB-ja dhe 90 shtete të tjera ofrojnë ndihmën e tyre pas fatkeqësisë; Shkupi pagëzohet si "qyteti i solidaritetit të botës".
	Gusht	5 SHBA-ja, Britania dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruajnë në Moskë Traktatin për Ndalimin e Provave Bërthamore.	
	Shtator		12 Marrëveshja e Asocimit të Ankarasë parashikon themelimin progresiv të një bashkimi doganor ndërmjet BEE-së dhe Turqisë dhe anëtarësimin e mundshëm.
	Nëntor	22 Vritet Xhon F. Kenedi në Dallas, Teksas; Lindon B. Xhonson bëhet presidenti i SHBA-së.	
	Dhjetor		4 Në plenumin e PKB-së diskutohet propozimi që Bullgaria të bëhet republika e shtatëmbëdhjetë e Bashkimit Sovjetik. Poeti grek Georgios Seferis fiton çmimin "Nobel" në letërsi. Luftime ndëretnike në Qipro, që sollën edhe dërgimin e forcave paqeruajtëse të OKB-së në mars të vitit 1964, prish marrëdhëniet greko-turke gjatë viteve në vijim.
1964	Shkurt		16 EK-ja siguron shumicën në zgjedhjet parlamentare në Greqi.
	Qershor	12 Nelson Mandela dhe shtatë veprimtarë të tjerë të luftës kundër aparteidit në Afrikën e Jugut dënohen me burgim të përjetshëm; Mandela qëndron në burg për 27 vjet e tetë muaj.	6 Presidenti amerikan Lindon B. Xhonson, paralajmëron presidentin turk Inony kundër ndërhyrjeve ushtarake në krizën e Qipros.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1964	Gusht	7 Rezoluta e Gjirit të Tonkinit e Kongresit Amerikan kthehet në bazën ligjore për përfshirjen e mëtejshme të SHBA-së në konfliktin ndërmjet Vietnamit Jugor dhe Verior (me mbështetjen e Bashkimit Sovjetik dhe Kinës).	
	Tetor	14 Leonid Brezhnevi bëhet udhëheqësi i Bashkimit Sovjetik. 16 Prova bërthamore kineze del e suksesshme: Kina bëhet vendi i pestë në botë me armë bërthamore. së bashku me SHBA-në. Bashkimin Sovjetik, Britaninë dhe Francën.	
	Dhjetor		1 Hyn në fuqi Marrëveshja e Asocimit të Ankarasë me Komunitetin Ekonomike Evropiane. .
1965	Mars	Në Vietnam, mbërriinë trupat e para ushtarake amerikane.	19 Vdes udhëheqësi komunist rumun Gjergj Gjeorgjiu Dezh ; pasohet nga Nikolai Çaushesku.
	Korrik		11-15 Përplasja kushtetuese me Mbretin Konstantin II sjell dorëheqjen e kryeministrit Giorgios Papandreu.
	Tetor	1 Ushtria indoneziane shtyp grushtin e shtetit kundër Presidentit Sukarno; Gjeneral Muhamed Suharto ndërmerr një fushatë spastrimi kundër komunistëve indonezianë, duke vrarë me mijëra prej tyre dhe duke marrë pushtetin absolut në vitin 1967.	27 Partia e Drejtësisë e udhëhequr nga Sylejman Demireli fiton zgjedhjet në Turqi me 52,9% të votave.
	Dhjetor		27 Rezoluta e Komitetit Qendror të PKB-së "P ër fuqizimin e propagandës ateiste dhe asgjësimin e ndikimit të fesë në jetën e përditshme".
1966	Janar	13 Presidenti Xhonson emëron anëtarin e parë afro-amerikan të kabinetit, Robert Uiverin si shefin e Departamentit të Strehimit dhe Zhvillimit Urban.	
	Shkurt		23 Transmetimi i parë televiziv në Greqi.
	Korrik		1 Plenumi i Brijunit i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë shënon fillimin e reformave dhe demokratizimin relativ; abuzimet e shërbimeve Sekrete kritikohen ashpër.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1967	Shkurt		Fjalimi i Enver Hoxhës kundër praktikave fetare; mbyllja e objekteve të kultit dhe institucioneve fetare; Shqipëria bëhet vendi i parë ateist në botë.
	Mars		2 Deklarata për emërtimin dhe pozitën e gjuhës kroate, miratuar nga shumica e institucioneve kulturore dhe shkencore kroate. Në të kërkohej pozita e barabartë e gjuhës kroate në Jugosllavi në të gjitha sferat e jetës. Shoqata Serbe e Shkrimtarëve nuk bie dakord me Deklaratën; të dyja palët kritikohen nga Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë.
	Prill		21 Oficerët e rinj realizojnë me sukses grushtin e shtetit në Greqi (diktatura e kolonelëve).
	Qershor	Lufta gjashtëditore: Izraeli mposht Egjiptin, Jordaninë dhe Sirinë dhe pushton Gadishulin Sinai, Rripin e Gazës, Bregun Perëndimor, Jeruzalemin Lindor dhe lartësitë e Golanit.	
	Korrik		19 Kisha Ortodokse Maqedonase shpallet autoqefale; nuk njihet nga Patrikana serbe.
	Gusht	8 Indonezia, Malajzia, Filipinet, Singapori dhe Tajlanda krijojnë Bashkimin e Kombeve Aziatike Juglindore (ASEAN).	
	Tetor	9 Ekzekutohet në Bolivi Ernesto "Che" Guevara, udhëheqësi socialist revolucionar i forcave guerrilase.	
	Dhjetor	3 Transplanti i parë i suksesshëm i zemrës nga Kristian Barnardi dhe ekipi i tij, në Afrikën Jugore.	13 Dështon operacioni i Mbretit Konstandini II kundër grushtit të shtetit; familja mbretërore ikën në mërgim.
1968	Janar-Tetor	Operacioni Tet nga vietnamezët veriorë dhe forcat e Viet Kongut në Vietnamin Jugor; lufta e Vietnamit përshkallëzohet gjatë viteve të ardhshme; protesta masive për paqe në SHBA dhe në të gjithë botën.	
	Janar		31 Transmetimi i parë televiziv në Turqi.
	Shkurt		Ngjarjet në Çekosllovaki dhe pozicioni i Bashkimit Sovjetik shkaktojnë ndarjen e KKE-së në dy pjesë: në partinë komuniste kryesisht ortodokse dhe partinë komuniste të brendshme, një formacion euro-komunist.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1968	Prill	4 Martin Luter Kingu, udhëheqësi i lëvizjes për të drejtat qytetare amerikane vritet në Memfis, Tenesi.	
	Maj	Protestat studentore në Paris përshkallëzohen në grevë në të gjithë vendin; një nga demonstratat e shumta masive të të rinjve kundër sistemit (revolucionet e të rinjve) në botën perëndimore (ndërsa në Evropën Lindore, në Çekosllovaki dhe Poloni).	Presidenti francez Sharl dë Gol viziton Rumaninë.
	Maj 1968-Gusht 1973		Nacionalistët kroatë akuzohen për disa sulme terroriste në Jugosllavi.
	Qershor		2 Demonstratat e majta studentore kundër "borgjezisë së kuqe" në Beograd, sulmohen nga policia.
	Korrik	1 Traktati për Ndalimin e Plotë të Provave bërthamore i nënshkruar nga Fuqitë e Mëdha bërthamore. Përveç Kinës dhe Francës dhe disa vende jobërthamore (përveç Indisë dhe Pakistanit, që do t'i bashkoheshin "klubit bërthamor" përkatësisht në vitin 1974 dhe 1983).	
	Gusht	20 Vendet e Traktatit të Varshavës pushtojnë Çekosllovakinë; fundi i Kryengritjes së Pragës.	21 Çaushesku dënon pushtimin e Çekosllovkisë nga Vendet e Traktatit të Varshavës.
	Shtator		Shqipëria tërhiqet zyrtarisht nga Traktati i Varshavës.
	Nëntor		Ushtria dhe policia jugosllave shtypin demonstratat e shqiptarëve të Kosovës, që kërkonin ndryshimin e statusit të Kosovës, nga Krahinë Autonome në Republikë.
1969	Janar	20 Riçard Niksoni bëhet president i SHBA-së.	
	Shkurt	4 Themelimi i Organizatës Palestineze për Çlirim, lëvizjes kryesore palestineze guerrilase; fushatë terroriste kundër Izraelit në vitet 1970 dhe 1980.	16 Demonstrata të dhunshme në Stamboll kundër pranisë së Flotës së Gjashtë amerikane në ujërat turke ("E diela e përgjakur").
	Mars	Përplasje të armatosura ndërmjet trupave ushtarake sovjetike dhe kineze përgjatë kufirit të lumit Usuri, shënojnë kulmin e konfliktit sovjetiko-kinez pas përçarjeve ideologjike në fundin e viteve 1950 dhe në fillim të viteve 1960.	
	Prill	7 Data simbolike e lindjes së Internetit.	
	Korrik	20 Astronautët amerikanë Neil Armstrong dhe Baz Aldrin, bëhen njerëzit e parë që zbresin në Hënë.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1969	Nëntor		18 Miratohet ligji për themelimin e Universitetit të Prishtinës nga Asambleja e Krahinës socialiste të Kosovës.
	Dhjetor		29 Në vigjilje të përjashtimit të Greqisë nga Këshilli i Evropës, për shkak të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, junta e kolonelëve tërhiqet nga Këshilli i Evropës; Greqia do të pranohej sërish më 28 nëntor të vitit 1974.
1970	Shkurt		3 BEE-ja ngrin negociatat me Greqinë deri në rivendosjen e regjimit demokratik në vend; heqja e pengesave tarifore dhe detyrave doganore vazhdon sipas programit.
	Prill	22 Në SHBA, festohet për herë të parë "Dita e Tokës", miliona shtetas amerikanë marrin pjesë në tubime, marshime dhe programe edukative, duke treguar ndërgjegjësimin për problemet mjedisore të botës.	
	Maj		Jugosllavia fiton Kampionatin Botëror të Basketbollit.
	Tetor		Përfundon elektrifikimi i të gjithë Shqipërisë.
1971	Janar		Seanca e dhjetë e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Kroacisë dënon "politikat unitariste" të disa komunistëve kroatë, duke shënuar fillimin e "Kryengritjes Kroate", që zgjati deri në 1 dhjetor.
	Mars	15 Krijohen për herë të parë në Internet dhomat virtuale të bisedave.	12 Grushti i shtetit në Turqi i dha fund qeverisë së Sylejman Demirelit (1965-1971); ligjit ushtarak në fuqi në 11 krahina.
	Qershor		30 Kushtetuta e Republikës Federale Socialiste e ndryshuar; autonomi më e madhe për Kosovën, Vojvodinën në Serbi.
	Nëntor		Demonstratat masive studentore në Kroaci; kulmi i "Kryengritjes Kroate".
	Dhjetor	Lufta e tretë ndërmjet Indisë dhe Pakistanit solli pavarësinë e Bangladeshit (Pakistanit Lindor).	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1972	**Janar**	**30** "E diela e përgjakur": Ushtria britanike hap zjarr ndaj demonstruesve në Deri, Irlandën e Veriut, arrestime dhe burgosje në masë pa gjyq i mbështetësve të dyshuar të Ushtrisë Republikane Irlandeze (IRA) dhe fushata e saj kundër Britanisë (26 civilë të paarmatosur qëllohen për vdekje, 14 të vdekur).	
	Janar 1972-Janar 1975		Arrestimi i 11 udhëheqësve intelektualë kroatë, pasohet nga spastrimet, arrestimet dhe dërgimi para gjyqit i studentëve profesorëve dhe disidentëve të tjerë në të gjithë Jugosllavinë nga Lidhja e Komunistëve; merren masa kundër liberalëve dhe nacionalistëve/separatistëve për të përballuar krizën politike.
	Shkurt	Presidenti amerikan Riçard Nikson viziton Kinën; fillimi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.	
	Maj		**6** Varen në Turqi tre udhëheqës të studentëve. Hapet zyrtarisht Stacioni Hidroelektrik Porta e Hekurt I në Danub, diga më e madhe në Danub dhe një nga hidrocentralet më të mëdha në Evropë; projekt i përbashkët rumuno-jugosllav (filloi në vitin 1964).
	Korrik	**21** "E Premtja e Përgjakur": vriten 9 qytetarë dhe 130 të tjerë plagosen nga bombardimet e IRA-s në Belfast.	
1973	**Janar**	Britania, Irlanda dhe Danimarka i bashkohen BEE-së. Tërheqja e trupave amerikane nga Vietnami i Jugut; Konferenca e Paqes në Paris (shkurt-mars).	
	Maj		**23** Dështon grushti i shtetit i oficerëve të marinës kundër juntës greke.
	Qershor		**1** Junta greke rrëzon Mbretin Konstandin II; referendumi i rremë i mbajtur sipas ligjit ushtarak vendosi "republikën presidenciale parlamentare (29 korrik).
	Shtator	**11** Grushti ushtarak kundër qeverisë së majtë të president Salvador Alende, në Kili, vendos regjimin autoritar të Gjeneral Augusto Pinoçetit.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1973	Tetor	Lufta arabo-izraelite Bashkimi Sovjetik dërgon furnizime ushtarake në Egjipt dhe Siri, ndërsa SHBA-ja furnizon Izraelin me armë në rrugë ajrore; "diplomacia ecejake" e SHBA-së, solli nënshkrimin e Traktatit të Paqes ndërmjet Izraelit dhe Egjiptit në mars të vitit 1979.	**14** Zgjedhjet e përgjithsh me në Turqi; regjim i paqëndrueshëm parlamentar dhe thellimi i krizës politike deri në vitin 1980.
	Nëntor		**15–17** Ushtria shtyp protestën e studentëve në Universitetin Politeknik të Athinës.
1974	Shkurt	**13** Shkrimtari disident, Aleksandër Solzhenicin, dëbohet nga Bashkimi Sovjetik.	**21** Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë miraton kushtetutën e re, që forcoi rendin federal dhe konfirmoi vetëqeverisjen e të gjithë klasës punëtore, si tiparin thelbësor të socializmit; përforcohet mbizotërimi i Partisë Komuniste në të gjitha sferat e jetës shoqërore.
	Prill	**25** Përfundon regjimi autoritar shumëvjeçar në Portugali.	**29** Themelohet Universiteti i Malit të Zi.
	Korrik-Gusht		Grusht shteti në Qipro kundër presidentit Makarios, i organizuar nga junta greke; Turqia mësyn Qipron dhe pushton një të tretën e ishullit; bie regjimi ushtarak në Greqi; Konstandinos Kara manlisi kthehet në Greqi, pasi kishte mërguar me vullnetin e tij të plotë në Paris, dhe drejton qeverinë e "bashkimit kombëtar"; hiqet ligji ushtarak, lirohen të burgosurit politikë, junta greke kthen sërish në punë nëpunësit e shkarkuar civilë, ligjërohet KKE-ja.
	Gusht	**9** Riçard Niksoni jep dorëheqjen pas procedimit penal pas skandalit "Watergate"; Xherald Fordi bëhet presidenti i SHBA-së. 15 Reagimi ndaj zaptimit dhe pushtimit të Qipros, një grup demokratësh të Kongresit, të udhëhequr nga Dr. Xhon Brademas (D-Indiana), i njohur për kundërshtinë e vazhdueshme ndaj juntës greke, kërkojnë vendosjen e embargos amerikane ndaj Turqisë. Më 24 shtator, nga 307 anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve, 90 votuan pro embargos, siç ishte propozuar nga rezoluta Rozenhal/Dypon. Dhoma afirmoi sërish qëndrimin ndaj trysnisë së pushtetit ekzekutiv, më 31 korrik të vitit 1975, ku nga 223 anëtarë, 206 votuan pro embargos. E ndryshuar në tetor të vitit 1975, më në fund, Dhoma e hoqi embargon në gusht të vitit 1978, me një ndryshesë prej vetëm një vote.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1974	Shtator	4 SHBA-ja dhe RDGJ-ja vendosin marrëdhënie diplomatike.	4 Vihet në punë reaktori i parë i stacionit të energjisë bërthamore Kozloduj në Bullgari; për rrjedhojë, eksportet e energjisë elektrike të Bullgarisë kthehen në importe për ekonomitë turke dhe greke.
	Dhjetor		8 Me plebishit, hiqet monarkia në Greqi me 69,2% të votave.
1975	Janar-Qershor	Pavarësia e Angolës dhe Mozambikut shënon fundin e sundimit portugez në disa koloni afrikane; luftëra civile në të dyja vendet ndërmjet qeverive marksiste dhe forcave opozitare guerilase, të mbështetura nga SHBA-ja dhe Afrika e Jugut; dërgohen këshilltarë sovjetikë ushtarakë dhe trupa kubane në Angola (1975) dhe Etiopi (1977).	
	Mars-Prill	Ushtria e Vietnamit Verior pushton jugun; njësimi i vendit si Republika Socialiste e Vietnamit.	
	Qershor-Korrik	Konferenca e OKB-së për pozitën e grave miraton Deklaratën e Meksikës, për Barazinë e Grave dhe Kontributin e tyre në Zhvillim dhe Paqe.	
	Korrik	17 Anija kozmike sovjetike "Soyuz" dhe anija kozmike amerikane "Apollo" dalin në hapësirë.	
	Gusht	1 Përfundon Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, me nënshkrimin e Aktit Final të Helsinkit nga të gjitha vendet evropiane (përveç Shqipërisë), SHBA-së dhe Kanadasë.	
	Nëntor	20 Vdekja e Fransisko Frankos; fillimi i demokratizimit të Spanjës.	10 Jugosllavia dhe Italia nënshkruajnë Traktatin e Osimos, duke zgjidhur më në fund konfliktin për kufijtë e zonës A dhe B të ish-Territorit të Lirë të Triestes.
	Dhjetor		23 Në sulmin e saj të parë, organizata terroriste greke "17 nëntori" vret një oficer të CIA-s në Greqi; deri në vitin 2002, do të vriste edhe 22 persona të tjerë.
1976	Mars		Esma Redzepova Teodosievska, këngëtarja, kompozitorja dhe humanistja e shquar rome, nga Shkupi, shpallet nga kryeministrja indiane Indira Gandi si "Mbretëresha e muzikës cigane" në Festivalin e parë të organizuar në Çandigar, Indi.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1976	Shtator	9 Vdekja e Mao Ce Dunit, pas vitit 1978, komunisti kinez Hua Kofeng dhe Ten Siao Pin miratojnë liberalizimin ekonomik ("katër modernizimet") dhe shpallin politikën e "dyerve të hapura" kundrejt Perëndimit dhe Japonisë.	
1977	Janar	20 Xhimi Karter bëhet president i SHBA-së.	
	Prill - tetor	"Vjeshta gjermane": fraksioni i majtë terrorist "Ushtria e Kuqe" e RFGJ-së (Grupi Bader-Mainhof), kryen një sërë rrëmbimesh dhe vrasjesh; në tetor bashkon forcat me Frontin Popullor për Çlirimin e Palestinës në marrjen peng të avionit Lufthansa.	
	Maj		1 Policia hap zjarr në një demonstratë masive punëtorësh në Stamboll, vriten 34 persona.
	Gusht		Me mijëra minatorë rumunë hyjnë në grevë në luginën Xhiului.
	Shtator	7 Presidenti Xhimi Karter dhe Omar Torrijos nënshkruajnë traktatin ku parashikohej kalimi i kontrollit të Kanalit të Panamasë nga SHBA-ja në duart e Panamasë në fund të shekullit të njëzetë.	7 "Vrasja me çadër": vrasja e disidentit bullgar Gjergj Markov në Londër.
	Tetor		20 Vendimi i Këshillit të Ministrave të Bullgarisë për fermat individuale, që synonte vetëmjaftueshmërinë e popullsisë për sa i përket furnizimit me fruta, perime, mish, qumësht, vezë dhe peshk".
	Nëntor		20 Karamanlis fiton zgjedhjet parlamentare në Greqi; Lëvizja Socialiste Panhelenike e Andrea Papandreut (PASOK), merr zyrtarisht rolin e opozitës.
1978	Maj	9 Grupi i majtë terrorist italian "Brigadat e kuqe", ekzekutojnë ish-kryeministrin Aldo Moro.	
	Korrik		Prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me Kinën; vendi hyn në izolim.
	Tetor		Jugosllavia fiton Kampionatin Botëror të Basketbollit.
	Nëntor		Krijohet Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PPK).
	Dhjetor		22 Pogrome kundër alevitëve në Turqi.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1979	Janar	7 Ushtria vietnameze hyn në kryeqytetin e Kamboxhias, Pnom Pen; përfundon regjimi maoist i Kmer Ruzhit, që karakterizohej nga gjenocidet; luftë ndërmjet Kinës dhe Vietnamit (shkurt-mars).	
	Janar-Shkurt	Revolucioni islamik në Iran.	
	Mars	26 Nënshkruhet Traktati i Paqes ndërmjet Izraelit dhe Egjiptit në Uashington; arritje madhore e politikës së jashtme të SHBA-së.	
	Maj		28 Nënshkruhet Traktati për aderimin e Greqisë në KEE (1 janar, 1981) në Athinë.
	Qershor	17 Presidenti amerikan Xhimi Karter dhe udhëheqësi sovjetik Leonid Brezhnev nënshkruajnë Traktatin e Vjenës për Bisedimet Strategjike të Kufizimit të Armëve (SALT II).	
	Korrik	Fitorja e lëvizjes revolucionare Sandinista ndaj diktatorit nikaraguas Anastasio Somoza, një aleat i ngushtë i SHBA-së; ndihma ushtarake dhe financiare e SHBA-së për guerilasit antikomunistë Kontras në Nikaragua dhe regjimit të ashpër diktatorial në El Salvador kërcënohet nga fronti marksist FMNL.	
	Dhjetor	Trupat sovjetike pushtojnë Afganistanin; fillimi i luftës shkatërruese me guerilasit muxhahedinë, të mbështetur nga SHBA-ja dhe aleatët e tij Islamikë.	Poeti grek Odisea Elitis fiton çmimin "Nobel" në letërsi.
1980	Maj	8 Organizata Botërore e Shëndetit shpall zyrtarisht fitoren ndaj lisë, sëmundja e vetme ngjitëse, që u zhduk plotësisht përmes një fushate vaksinimi botërore (filloi në vitin 1967).	4 Vdekja e Titos. 5 Karamanlis zgjidhet Presidenti i Republikës së Greqisë.
	19 Korrik – 3 Gusht	Lojërat e XXII Olimpike Verore në Moskë; bojkoti i 65 vendeve i drejtuar nga SHBA-ja për shkak të pushtimit të Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik; disa atletë nga vendet bojkotuese marrin pjesë në lojërat e Flamurit Olimpik; Bashkimi Sovjetik dhe 14 aleate të tij, bojkotojnë Lojërat Olimpike Verore të Los Anxhelosit të vitit 1984.	
	Gusht	Krijohet sindikata e pavarur "Solidariteti" (Solidarnost) në Poloni si forca më e madhe opozitare, pas një sërë grevash që paralizuan ekonominë.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1980	Gusht	2 Nga shpërthimi i stacionit hekurudhor qendror në Bolonjë, për të cilin u fajësua grupi neofashist, u vranë 85 njerëz dhe u plagosën 200 të tjerë; sulmi më i rëndë joajror në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore (deri në vitin 2004, kur në Madrid u kryen disa akte terroriste islamike).	
	Shtator	Fillimi i luftës iraniano-irakiane (vazhdoi deri në korrik të vitit 1988).	12 Grusht shteti në Turqi; vendosja e juntës së Gjeneral Kenan Evren (1980-1983). Regjisori grek Teodoros Angelopulos fiton çmimin "Luani i Artë", në Festivalin e Filmit të Venecias, për filmin "Aleksandri i Madh". 1 Greqia i bashkohet BEE-së si anëtari i dhjetë.
1981	Janar	20 Ronald Regani bëhet presidenti i SHBA-së.	
	Mars-Prill		Demonstrata masive nga shqiptarët e Kosovës; shpallet gjendja e jashtëzakonshme në krahinë; përplasje ndërmjet shqiptarëve vendas dhe serbëve gjatë viteve 1980.
	Prill	12 Anija kozmike "Kolumbia" niset nga kepi Kanaveral, Florida, duke u bërë anija e parë kozmike e komanduar nga njeriu që udhëtoi në hapësirë.	
	Tetor		18 PASOK-u fiton zgjedhjet parlamentare në Greqi.
	Dhjetor	13 Miratohet ligji ushtarak në Poloni; veprimtaria e "Solidaritetit" shpallet e jashtëligjshme.	
1982	Janar		BEE-ja pezullon marrëveshjen e saj me Turqinë.
	Prill		Vendimi i Çausheskut për pagimin e menjëhershëm të borxhit të huaj të vendit prej 11 miliard $ pasohet nga masa të ashpra ekonomike.
	Prill – qershor	Argjentina dhe Britania futen në luftë për ishujt Falkland; në vitin 1983 regjimi ushtarak tiranik në Argjentinë zëvendësohet me regjimin civil.	
	Maj		Regjisori turk me origjinë kurde Jëllmaz Gyneji, fiton çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit në Kanë për filmin "Rruga".
	Nëntor	12 Juri Andropov bëhet udhëheqësi i Bashkimit Sovjetik.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1983	Mars	Presidenti Regan i referohet publikisht Bashkimit Sovjetik si "perandoria e së keqes" dhe shpall Nismën e Mbrojtjes Strategjike, që u pagëzua menjëherë si "Nisma e luftës së yjeve".	
	Gusht		21 "Gjyqi i Sarajevës": Intelektualët myslimanë boshnjakë, dënohen me burgim, midis të cilëve edhe Alija Izetbegoviçi për shkak të Deklaratës së tij Islame.
	Tetor	25 Duke cituar kërcënimin që iu bë shtetasve amerikanë, presidenti Regan dërgon trupa në ishullin Grenada të Karaibeve; brenda një jave rrëzohet qeveria marksiste prokubane.	22 Në Turqi, ndalohet gjuha kurde.
	Nëntor		6 Partia e Mëmëdheut (ANAP) fiton zgjedhjet e përgjithshme në Turqi; Turgut Ozali bëhet kryeministër. 15 Shpallja e pavarësisë së Republikës Turke të Qipros së Veriut njihet vetëm nga turqit.
1984	Janar		Fillon veprimtaria e stacionit të parë të energjisë bërthamore në Jugosllavi (projekt i përbashkët slloveno-kroat) në Krshko.
	Shkurt	13 Konstandin Çernenko bëhet udhëheqësi i Bashkimit Sovjetik.	8-19 Zhvillohen në Sarajevë Lojërat Olimpike Dimërore XIV.
	Gusht		15 PKK-ja ndërmerr sërish lëvizjen e armatosur në Turiq, duke shkaktuar mbi 40,000 vdekje në harkun kohor të pesëmbëdhjetë viteve të ardhshme.
	Tetor	Një ekip gazetarësh fillojnë të informojnë për urinë në Etiopi (1983–1985), një prej fatkeqësive më të mëdha të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. 31 Indira Gandi vritet nga dy truprojat e saj sikh si ndëshkim për atë që kishte ndodhur në Tempullin e Artë në Amritsar.	
	Nëntor		Krijohet Komiteti për Mbrojtjen e Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes në Beograd.
	Nëntor 1984-Shkurt 1985		Fushatë masive për riemërimin e pakicës turke në Bullgari; fillimi i politikës së ashpër të asimilimit ("Procesi i Ringjalljes")

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1985	Mars	11 Mikhail Gorbaçovi bëhet sekretari i përgjithshëm i PKBS dhe udhëheqësi i Bashkimit Sovjetik; fillimi i politikës së "Glasnostit" (transparencës) dhe "Perestrojka" (ristrukturimit). 15 Regjistrohet për herë të parë adresa e internetit.	
	Prill		11 Vdes Enver Hoxha ; Ramiz Alia zgjidhet si pasardhësi i tij.
	Maj		Regjizori jugosllav Emir Kusturica fiton çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit në Kanë për filmin "Kur babai ishte në një udhëtim pune" (When Father was Away on Business).
	Korrik	10 Anija flamurmbajtëse e organizatës mjedisore "Greenpeace", "Luftëtari ylber", u fundos nga agjentët e shërbimit sekret francez, në Oklend, për të parandaluar veprimet kundër provave bërthamore në Polinezinë franceze.	
1986	Janar	Spanja dhe Portugalia i bashkohen BEE-së.	Sllobodan Millosheviçi bëhet kryetari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Serbisë.
	Prill	26 Ndodh aksidenti më i rëndë bërthamor në botë, në stacionin e energjisë bërthamore të Çernobilit, në Bashkimin Sovjetik.	
	Shtator		Publikimi i memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë për problemet politike dhe situatën e serbëve në Jugosllavi. 11 Deklarata greko-bullgare e Miqësisë dhe Bashkëpunimit, parashikonte konsultime kur siguria e secilit vend vihej në rrezik; kulmi i zhvillimit ishte krijimi i marrëdhënieve dypalëshe pas vitit 1974, ku armiqësia e përbashkët me Turqinë ishte një faktor tejet i rëndësishëm.
	Tetor	Ronald Regan dhe Mikhail Gorbaçovi takohen në Rejkjavik.	Mikhail Gorbaçovi viziton Bullgarinë dhe bën thirrje për reforma.
1987	Prill		14 Turqia bën kërkesë për anëtarësi të plotë në BEE.
	Maj		Mikhail Gorbaçov viziton Rumaninë; Çaushesku refuzon çdo lloj bisedimi për reformat.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1987	Qershor	Vriten njëzet e një blerës në një markatë në Barcelonë në sulmin më të përgjakshëm terrorist të organizatës separatiste baske "Shteti dhe Liria e Baskë ve" (ETA).	**25** Plenumi i PKB-së miraton zyrtarisht politikën e perestrojkës dhe kalimin në socializmin demokratik dhe ekonomi tregu.
	Korrik	**11** Matej Gashpari nga Zagrebi, zgjidhet nga OKB-ja si qenia njerëzore e pesë miliardtë në Tokë.	
	Gusht		**28** Qeveria greke i jep fund në mënyrë të njëanshme gjendjes së luftës me Shqipërinë, që ishte në fuqi që prej vitit 1940. **30** Atletja bullgare, Stefka Kostadinova, fiton garën e kërcimit së larti për femra, në kampionatin botëror të atletikës në Romë, duke vendosur rekord të ri botëror prej 2,09 metrash.
	Nëntor		**15** Demonstrata masive në qytetin rumun të Brashovit.
	Dhjetor	Fillimi i Intifadës Palestineze; trazira në rripin e Gazës dhe në Bregun Perëndimor (deri në vitin 1992). **8** SHBA-ja dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruajnë një marrëveshje për kontrollin e armëve, që pakësoi numrin e armëve bërthamore me një të pestën	
1988	Mars		**8** Krijohet Komiteti për Mbrojtjen e qytetit rus nga ndotja e gazit pa leje zyrtare.
	Maj	**15** Trupat sovjetike fillojnë tërheqjen nga Afganistani.	**13** Formimi i Bashkimit të Fermerëve Sllovenë, partisë së parë opozitare.
	Tetor		**5–8** "Revolucioni i kosit" në Vojvodinë.
1989	Janar	**10** Tërheqja e trupave kubane nga Angola. **20** Në vitin 1989, Xhorxh Bushi bëhet presidenti i SHBA-së.	**19** "Mëngjes me Miteranin" gjatë vizitës së tij zyrtare në Bullgari, presidenti francez takon 12 intelektualë disidentë.
	Shkurt	**6** Fillojnë bisedimet zyrtare të tryezës së rrumbullakët midis përfaqësuesve të "Solidaritetit" dhe qeverisë polake në Varshavë, e ndjekur nga zgjedhjet e lira në qershor; në gusht, Tadeush Mazovjecki bëhet kryeministri i parë jokomunist i vendeve të Evropës Lindore pas vitit 1948.	**20–28** Greva e minatorëve shqiptarë në Trepçë të Kosovës, ku protestonin kundër shkarkimit të Azem Vlasit dhe udhëheqësve të tjerë shqiptarë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1989	Maj		6 Sllobodan Millosheviçi zgjidhet presidenti i Serbisë. 8 Opozita sllovene publikon "Deklaratën e majit", një program politik që kërkonte një sistem shumëpartiak dhe një shtet slloven sovran. 20 Themelohet Partia kroate Social-liberale, si partia e parë opozitare në Kroaci. 29 Teodor Zhikovi i bën thirrje Turqisë të hapë kufijtë; fillimi i emigrimeve në masë të turqve bullgarë.
	Maj - Qershor	Me mijëra demonstrues pushtojnë sheshin Tiananmen në Pekin duke kërkuar më shumë demokraci; protestat shtypen nga ushtria.	
	Qershor		18 Zgjedhjet parlamentare në Greqi sjellin formimin e koalicionit qeveritar nga komunistët dhe konservatorët. 28 Millosheviçi flet për betejat e ardhshme në një mbledhje të madhe, ku përkujtohej 600 vjetori i Betejës së Fushë-Kosovës.
	Shtator	Trupat vietnameze tërhiqen nga Kamboxhia. 10 Hungaria hap kufijtë me Austrinë; mijëra qytetarë të RDGJ-së shkojnë në Perëndim.	
	Tetor	23 Qeveria liberale komuniste e Hungarisë, miraton kushtetutën e re, që lejonte sistemin shumëpartiak.	31 Turgut Ozali zgjidhet presidenti i Turqisë; në dhjetor, shfuqizohet ligji për ndalimin e shamive nëpër universitete.
	Nëntor	9 Mijëra gjermanë shembin Murin e Berlinit.	10 Plenumi i PKB-së e detyron Teodor Zhikovin të japë dorëheqjen. 18 Tubimi i parë publik me kërkesa të hapura politike në sheshin Aleksandër Nevski në Sofje.
	Dhjetor	3 Presidenti Bush dhe Mikhail Gorbaçovi shpallin përfundimin e Luftës së Ftohtë në samitin e Maltës. 5 Krijohet qeveria jokomuniste në Çekosllovaki pas "Revolucionit të kadifenjtë"; më 29 dhjetor udhëheqësi disident Vaclav Havel zgjidhet president.	7 Bashkimi i Forcave Demokratike (BFD) u themelua nga njëmbëdhjetë organizata publike në Bullgari, si përgjigje ndaj sundimit të komunistëve. 17 Policia dhe ushtria rumune hapin zjarr ndaj mijëra protestuesve kundër qeveritarëve në Timishoara.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1989	**Dhjetor**		**21** Tubim në Bukuresht në mbështetje të regjimit, kthehet në revoltë; Nikolai dhe Elena Çaushesku arratisen nga kryeqyteti dhe i gjithë vendi përfshihet nga protestat. **25** Gjykimi dhe ekzekutimi i Nikolae dhe Elena Çausheskut. **29** Plenumi i PKB-së deklaron të drejtën e myslimanëve bullgarë për të rivendosur emrin e tyre fillestar dhe dënon "Procesin e Ringjalljes" si një "gabim të rëndë politik" të qeverisë së Teodor Zhikovit.
1990	**Janar**	**16** Bashkimi Sovjetik dërgon trupa në Kaukaz për të ndërhyrë në luftën civile ndërmjet armenëve dhe azerbajxhanasve.	**20–22** Kongresi i Katërmbëdhjetë i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në Beograd; tërheqja e komunistëve sllovenë dhe kroatë sjell shpërbërjen e Lidhjes. **3 janar- 15 maj** Tryeza e Rrumbullakët Bullgare: një sërë negociatash për kalimin në demokraci dhe ekonomi tregu ndërmjet qeverisë dhe opozitës. **28-29 janar -18-19 shkurt** Ndërhyrje e dhunshme e minatorëve të qymyrgurit kundër intelektualëve dhe autoriteteve në Bukuresht (Mineriada e Parë dhe e Dytë); përsëritet në 13-15 qershor për të shkatërruar kampin e protestuesve në sheshin e universitetit.
	Shkurt	**1** Lirimi i Nelson Mandelës, udhëheqësit të Kongresit Kombëtar Afrikan (KKA), pas 27 vitesh burgim. **2** Konferenca e Otavës. Bashkimi i Gjermanisë do të vendoset nga negociatat "dy plus katër" (2: RDGJ - ja dhe RFGJ-ja; 4: SHBA-ja, Franca, Britania dhe Bashkimi Sovjetik).	
	Mars	**11** Parlamenti lituan voton për pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik. **11** Rënia e regjimit të Pinoçetit në Kili. Pinoçeti ia kalon pushtetin presidentit të zgjedhur në mënyrë demokratike Patrisio Ajlvin. **14** Kongresi i Përfaqësuesve të Popullit të Republikës Federale Socialiste Sovjetike, zgjedh Mikhail Gorbaçovin si president.	**19-21** Përplasje etnike në Targu Muresh, ndërmjet rumunëve dhe hungarezëve.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1990	**Mars**	**19** Opozita e Letonisë shpall fitoren në zgjedhjet e lira që mbaheshin për herë të parë pas 50 vjetësh. **23** Armëpushim midis presidentit të zgjedhur Çamorro dhe Kontras në Nikaragua, i mbikëqyrur nga vëzhguesit ndërkombëtarë.	
	Prill	**24** Kina dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi 10 vjeçare.	**3** PKB-ja ndërron zyrtarisht emrin në Partia Socialiste e Bullgarisë (PSB). **8–22** Koalicioni Opozita Demokratike (DEMOS) fiton zgjedhjet e para shumëpartiake parlamentare në Sllloveni; Milan Kuçani, udhëheqësi i komunistëve të reformuar, zgjidhet president. **10** Miratohet ligji për partitë politike në Bullgari; në 20 vitet e ardhshme zyrtarizohen mbi 400 parti politike nga gjykata. **26** Transmetohen për herë të parë festimet e Bajramit nga televizioni publik në Bosnjë-Hercegovinë. **28** Krijohet banka e parë private në Bullgari.
	Prill- Maj		Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) fiton zgjedhjet e para shumëpartiake në Kroaci, Franjo Tugjmani zgjidhet president.
	Maj	**29** Boris Jelcini zgjidhet president i Federatës Ruse.	**6** "Ura e Luleve' mbi Prut": të paktën 1.2 milion rumunë kaluan lumin Prut në Republikën Sovjetike Socialiste të Moldavisë, për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore. **13** Trazira në Zagreb gjatë një ndeshjeje futbolli ndërmjet skuadrës së "Dinamos" të Kroacisë dhe "Crvena Zvezdës" së Serbisë. **15** Komanda e Lartë e Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ) vendos çarmatosjen e Mbrojtjes Territoriale Sllovene dhe dorëzimin e të gjithë armëve në depot e UPJ-së; masa të ngjashme u morën edhe nga UPJ-ja e Kroacisë në shkurt, dhe e Bosnjë-Hercegovinës në qershor, përveç bashkive me shumicë serbe. **16** Vdes minatori legjendar Alija Sirotanoviçi i minierës Breza në Bosnjë Hercegovinë, simboli i Jugosllavisë, në kohën e shpërbërjes së saj.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1990	**Maj**		**20** Fronti i Shpëtimit Kombëtar, i udhëhequr nga Ion Iliesku, ish-udhëheqës komunist dhe kundërshtar i Nikolai Çausheskut që nga fillimi i viteve 1970 e në vijim, fiton zgjedhjet e para të lira pas rënies së regjimit komunist në Rumani. **26** Themelohet Partia e Aksionit Demokratik (SDA) në Sarajevë nën udhëheqjen e Alija Izetbegoviçit.
	Qershor	**3** Samiti i Uashingtonit: Presidenti Bush dhe Gorbaçov hedhin bazat për traktatet e pakësimit të armëve.	**7** Republika Socialiste e Maqedonisë heq përcaktorin "socialiste" nga emri zyrtar. **10-17** Partia Socialiste e Bullgarisë fiton zgjedhjet e para demokratike për Asamblenë e shtatë të Madhe Kombëtare. FBD-ja kundërshton rezultatin e zgjedhjeve. Fillimi i krizës politike.
	Korrik	**17** "Mbledhja dy plus katër" në Paris; përfaqësuesit e RDGJ-së, RFGJ-së, SHBA-së, Britanisë, Francës dhe Bashkimit Sovjetik, me pjesëmarrës nga qeveria polake, bien dakord për të garantuar kufirin polako-gjerman përgjatë lumit Oder-Naise.	"Kriza e Ambasadave " në Shqipëri; eksod masiv i njerëzve që hynin në ambasadat perëndimore në Tiranë. **2** Deputetët e Kosovës shpallin "Republikën e Kosovës" përpara godin ës së kuvendit. Në pesë korrik, shpërbëhet kuvendi i Kosovës nga autoritetet serbe. Vijojnë demonstrata masive. **12** Themelohet në Sarajevë Partia Demokratike Serbe, nën udhëheqjen e Radovan Karadzhiçit. **25** Miratohen ndryshimet kushtetuese në Kroaci. Serbët e Kroacisë, miratojnë deklaratën e Sovranitetit dhe Autonomisë së Serbëve dhe krijojnë Këshillin Kombëtar Serb.
	Gusht	**2** Iraku pushton Kuvajtin, duke marrë në kontroll emiratin e pasur në naftë. **7** Presidenti Bush dërgon trupa amerikane në Arabinë Saudite, kundër një pushtimi të mundshëm të Irakut. Fillon lufta e Gjirit. **26** Osetia Jugore, një rajon verior qendror i Gjeorgjisë me një popullsi prej 100,000 banorësh, shpall pavarësinë.	**16-17** Këshilli Kombëtar Serb vendos të organizojë një referendum. Serbët bllokojnë rrugët që lidhnin Kninin, Benkovaçin dhe Obrovacin (Kroaci). Përplasjet e para më Benkovac. Fillimi i të ashtuquajturit "revolucioni i trungjeve" në Kroaci. **18** Themelohet Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) në Sarajevë.
	Shtator		**3** Grevë e përgjithshme e shqiptarëve të Kosovës. **7** Miratohet Kushtetuta e Kaçanikut e Republikës së Kosovës. **28** Miratohet Kushtetuta e re e Republikës së Serbisë. Krahinat e Kosovës dhe Vojvodinës gëzojnë vetëm autonomi territoriale.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1990	Shtator		Mbahet referendum në bashkitë e Kroacisë me shumicë serbe; serbët shpallin autonominë e tyre.
	Tetor	**3** RFGJ-ja dhe RDGJ-ja shpallin Ditën e Bashkimit Gjerman, një bashkim që u realizua pas 45 vitesh ndarje.	**3** Sllovenia dhe Kroacia paraqesin planin e konfederatës jugosllave.
	Nëntor	**17** Nënshkruhet Traktati i Forcave të Armatosura Konvencionale në Evropë.	**18** Mbahen zgjedhjet e para shumëpartiake në Bosnjë-Hercegovinë; fitojnë partitë kombëtare. **25** Mbahen zgjedhjet e para shumëpartiake në Republikën e Maqedonisë. Fiton Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (VMRO -DPMNE).
	Dhjetor	**2** Mbahen zgjedhjet e para në Gjermaninë e Bashkuar; fiton aleanca e kancelarit Kohl. **9** Leh Valesa, udhëheqësi i sindikatës "Solidariteti" dhe i grevave të viteve 1980, zgjidhet me votë të përgjithshme president i Polonisë. **17** Kongresi i Përfaqësuesve të Popullit të Republikës Federale Socialiste të Bashkimit Sovjetik miraton planin e president Gorbaçovit për të rishikuar autoritetin e qeverisë qendrore; ministri i punëve të jashtme Eduard Shevardnadze jep dorëheqjen.	Fillon privatizimi në Bullgari, ndërsa inflacioni arrin në 500%. Protestat e para stuentore në Universitetin e Tiranës. Komiteti Qendror i Partisë së Punës në Shqipëri pranon pluralizmin politik. Krijohet Partia Demokratike, partia e parë antikomuniste që prej Luftës së Dytë Botërore. **8, 23** Zgjedhjet e para shumëpartiake në Serbi, bojkotohen nga shqiptarët. Fiton Partia Socialiste e Serbisë; Sllobodan Millosheviçi zgjidhet president. **9** Lidhja e Komunistëve të Malit të Zi, nën drejtimin e Milo Gjukanoviçit, fiton zgjedhjet e para shumëpartiake. **21** Shpallet Krahina Autonome Serbe (KAS) e Krajinës në Kroaci. **22** "Kushtetuta e Krishtlindjes", e votuar nga parlamenti kroat, parashikon demokraci parlamentare dhe u heq serbëve statusin e një kombi përbërës, si dhe i cilëson si pakicë. **23** Referendum për pavarësi në Sllloveni; 88% e votave për një Sllloveni sovrane, të shkëputur nga Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë (RFSJ).
1991	Janar	**17 janar- 27 shkurt** Lufta e Gjirit/ Operacioni "Stuhia e shkretëtirës". SHBA-ja udhëheq një koalicion të madh prej 34 shtetesh kundër Irakut për të çliruar Kuvajtin. Sulmet ajrore pasohen nga mësymja tokësore. Protesta masive kundër Sadam Hyseinit në Irak.	**8–10** Protestat studentore masive që prej nëntorit të vitit 1990 në të gjithë Greqinë, kulmojnë me vrasjen e mësueses të shkollës nëntëvjeçare gjatë një demonstrate nga një anëtar i organizatës rinore të partisë në pushtet, gjë që solli dorëheqjen e ministrit të arsimit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1991	**Janar**		**9** Presidenca e RFSJ-së lëshon një urdhër për të shpërndarë të gjitha forcat e armatosura dhe për të kthyer armët që kishin hyrë në mënyrë të paligjshme në vend. Republika Socialiste e Kroacisë dhe Sllovenisë refuzojnë ta zbatojnë këtë vendim në territorin e tyre. **12–19** Zhelu Zhelev fiton zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për president në Bullgari. **27** Kiro Gligorovi bëhet presidenti i parë i Republikës së Maqedonisë që zgjidhet në mënyrë demokratike. "Skandali i Martin Shpegelit" në Kroaci; transmetim televiziv i një filmi të regjistruar në fshehtësi dhe me qëllime të caktuara, i titulluar "E vërteta rreth armatosjes së HDZ- së në Kroaci" mendohej të shërbente si shkak për shpalljen e gjendjes së emergjencës dhe arrestimit të Ministrit kroat të Mbrojtjes, Martin Shpegeljit. Turqia hyn në luftën e Gjirit duke mbajtur anën e SHBA-së.
	Shkurt	**25** Traktati i Varshavës shpërbën institucionet ushtarake dhe ekonomike.	Gjyq kundër Todor Zhikovit në Bullgari. Në shtator të vitit 1992, ai u dënua me shtatë vite burgim, por u shpall i pafajshëm në shkurt të vitit 1996. **20-26** Krijohet Rajoni Autonom Serb i Sllavonisë, Baranjës dhe i Sremit Perëndimor. **23** Në Kongresin e saj të Njëmbëdhjetë, Lidhja e Komunistëve të Bosnjë-Hercegovinës merr emrin Aleanca Socialiste Demokratike.
	Mars		Parandalohet shpallja e gjendjes së emergjencës në një seancë të Presidencës së RFSJ-së në Beograd. Presidenca e RFSJ-së lidh marrëveshje për hapjen e bisedimeve për të ardhmen e Jugosllavisë. Organizohen pesë mbledhje, por pa asnjë rezultat. Pas Luftës së Parë të Gjirit, Turqia autorizoi përdorimin e gjuhës kurde bisedore në publik. **2-4** Përplasje ndërmjet policisë kroate dhe serbëve vendas të Pakracit. UPJ-ja ndërhyn për herë të parë ndërmjet palëve ndërluftese. **9** Demonstrata opozitare kundër kontrollit të medias në Beograd. Burgoset udhëheqësi opozitar Vuk Drashkoviçi. Rrugët e Beogradit pushtohen nga tanket.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1991	**Mars**		**19** Krahina Autonome Serbe e Krajinës shpall shkëputjen nga Kroacia dhe njësimi i asaj çka kishte mbetur nga Jugosllavia. **22** Zgjedhjet e para demokratike në Shqipëri. Partia Komuniste Shqiptare pushon së ekzistuari. **25** Takimi i Millosheviçit dhe Tugjmanit në Karagjorgjevo, pasohet nga një tjetër takim në afërsi të Osijekut më 15 prill. **29-31** Përplasje në Plitvicë (Kroaci). Vritet polici i parë kroat nga rebelët serbë.
	Mars- Qershor	Shfuqizohet aparteidi në Afrikën e Jugut.	
	Prill	**9** Pavarësia e Gjeorgjisë.	Dhjetëra mijëra kurdë kërkojnë strehim në Greqi pas revoltës në Irak. Turgut Ozali dhe Fransua Miteran kërkojnë krijimin e një "zone mbrojtjeje" në një pjesë të Kurdistanit iraken. **1-2** Këshilli Ekzekutiv i Krahinës Autonome Serbe të Krajinës , miraton një rezolutë, duke e përfshirë në Republikën e Serbisë. **5** Rumania dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruajnë Traktatin e Paqes, Bashkëpunimit dhe Marrëdhënieve të Fqinjësisë së Mirë.
	Maj	Fillon lufta civile në Somali. Këshilli i Sigurimit të OKB-së ndërmerr Operacionin e Kombeve të Bashkuara në Somali (UNOSOM I dhe II) për të ofruar ndihmë humanitare dhe për të vendosur rregull. Forcat paqeruajtëse të OKB-së tërhiqen në vitin 1995.	Krijohet organi "Trupat e Rojës Ndërkombëtare" (ZNG), pararendësi i ushtrisë kroate. **12** Referendum në Krajinë; 99% e pjesëmarrësve votojnë për shkëputjen nga Kroacia. **19** Në Kroaci, mbahet referendumi për shkëputjen nga Jugosllavia, pa përfshirë Jugosllavinë (83,56% votuan për pavarësinë e Kroacisë).
	Qershor	**28** Shpërbërja e KNER-it (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke Ekonomike).	**16** "Ura e dytë e luleve" përgjatë kufirit rumuno-moldav. **25-26** Kroacia dhe Sllovenia miratojnë vendimet kushtetuese për pavarësinë. **26-27** Këshilli Federal Ekzekutiv kthen mbrapsht brenda natës vendimin e parlamentit slloven dhe kroat për shkëputje nga Jugosllavia dhe lëshon urdhrin për marrjen nën kontroll të pikave kufitare. Korparmata e Trembëdhjetë e UPJ-së nga Rjeka (Kroaci) merr nën kontroll pikat kufitare me Italinë në pjesën bregdetare të Sllovenisë pa e tërhequr asnjë herë të vetme këmbëzën. **27** Fillon Lufta Dhjetëditëshe për Pavarësinë e Sllovenisë. **30** Jugosllavia fiton Kampionatin Evropian të Basketbollit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1991	**Korrik**	**1** Shpërbëhet Traktati i Varshavës. **31** Presidenti i SHBA-së Xhorxh Bush dhe udhëheqësi sovjetik Gorbaçov nënshkruajnë Traktatin për Pakësimin e Armëve Strategjike (START 1) për heqjen e 25-30% të raketave bërthamore strategjike.	**7** Marrëveshja e Brijunit ndërmjet trojkës së Komisionit Evropian dhe përfaqësuesve të Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë dhe presidencës federale. Sllovenia dhe Kroacia bien dakord për shtyrjen e zbatimit të deklaratave për pavarësi, por jo të vetë deklaratave. Gjithashtu, ata ranë dakord që forcat e armatosura sllovene të hiqnin bllokadën ndaj njësive dhe objekteve të UPJ-së, që Mbrojtja Territoriale Sllovene të çmobilizohej dhe që të gjithë të burgosurit e ndaluar për shkak të veprimeve ushtarake që prej 25 qershorit të vitit 1991 të liroheshin menjëherë. **12** Asambleja e Madhe Kombëtare miraton Kushtetutën e Republikës së Bullgarisë.
	Korrik-Dhjetor		Konflikt i armatosur në Kroaci. Ushtria e Krahinës Automome të Krajinës merr nën kontroll një të tretën e territorit kroat, gjë që solli braktisjen e vendit nga 700,000 kroatë dhe bombardimin e qyteteve kroate; krimet më të rënda u kryen gjatë sulmeve kundër Dubrovnikut dhe Vukovarit.
	Gusht	**19–21** Grusht shteti kundër presidentit sovjetik Mikhail Gorbaçov. Ai ngjitet sërish në pushtet me ndihmën e presidentit rus Boris Jelcin dhe për shkak të rezistencës popullore. **20** Pavarësia e Estonisë. **21** Pavarësia e Lituanisë **24** Pavarësia e Ukrainës. **25** Pavarësia e Bjellorusisë. **27** Pavarësia e Moldavisë. **29** Pavarësia e Azerbajxhanit. **31** Pavarësia e Uzbekistanit dhe Kirgistanit.	
	Shtator	**7** Konferenca e Paqes në Jugosllavi në Hagë, e kryesuar nga Lordi Kerrington. **21** Pavarësia e Armenisë. **25** Rezoluta 713 për Jugosllavinë, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, vendos embargon e armëve për RFSJ-në.	Vrasja e civilëve serbë në Sisak nga forcat ushtarake kroate. Më vonë, vrasjet e serbëve do të përfshijnë të gjithë Gospiçand Pakracin. UPJ-ja përfshihet në mënyrë aktive në luftën kundër Kroacisë; pushton Pretinjën dhe Hrvacka Kostajnicën dhe ndërmerr sulme kundër Vukovarit. **8** Në referendumin për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë marrin pjesë shumica e qytetarëve, megjithëse u bojkotuan nga shqiptarët.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1991	**Shtator**		**26-30** Shqiptarët e Kosovës mbajnë një referendum jozyrtar, ku shumica votoi për pavarësi dhe shkëputje nga Serbia.
	Tetor	**23** Të katër fraksionet e Kamboxhias nënshkruajnë marrëveshjen e paqes. **27** Pavarësia e Turkmenistanit.	Asambleja kroate ndërpret të gjitha marrëdhëniet shtetërore dhe të detyruara me ligj me RFSJ-në. **1** UPJ-ja dhe njësitë paraushtarake nga Mali i Zi sulmojnë Dubrovnikun. **8** Sllovenia hedh në qarkullim monedhën e re, tolarin. **20** Zgjedhjet në Turqi sjellin krijimin e një koalicioni qeveritar ndërmjet Demirelit, udhëheqësit të partisë së djathtë, dhe Erdal Inonysë, udhëheqësit të partisë së majtë (20 nëntor 1991 deri në 25 qershor 1993).
	Nëntor	Marrëveshja e Gjenevës ndërmjet Tugjmanit, Millosheviçit dhe Sajrus Vencit (i dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së) parashikon ndërprerjen e përplasjeve të armatosura dhe tërheqjen e UPJ-së nga Kroacia. **1** Presidenti çeçen Dzhokar Dudajev shpall pavarësinë. **5** Kina dhe Vjetnami normalizojnë marrëdhëniet diplomatike që nuk kishin ekzistuar pothuajse fare që prej vitit 1979, për shkak të një konflikti kufitar. **27** Rezoluta nr. 721 e Këshillit të Sigurimit së OKB-së parashikon dërgimin e forcave paqeruajtëse në Jugosllavi.	**9-10** Serbët e Bosnjës mbajnë referendum për qëndrimin e mëtejshëm të Bosnjës në një shtet me Serbinë, Malin e Zi, Krahinën Autonome të Krajinës dhe Krahinën Autonome të Sllavonisë, Baranjës dhe Sremit Perëndimor. **15** Fillojnë punimet për ndërtimin e një rrjeti hekurudhor nëntokësor të zgjeruar në Athinë; faza e parë përfundon në dhjetor në vitit 1999, kostoja e të cilave arrinte në 2. 2 miliard €. **18** Vjeshta e Vukovarit; përndjekja dhe vrasja e qytetarëve dhe mbrojtësve të qytetit nga rebelët serbë dhe trupat e UPJ-së. Në po të njëjtën ditë, rebelët serbë masakruan popullsinë e Shkabrnjës, në afërsi të Zadarit.
	Dhjetor	**9-10** Këshilli Evropian në Hagë përpilon Traktatin e Bashkimit Evropian (Traktati i Mastrihtit). **13** Traktati për pajtim, mossulmim dhe bashkëpunim ndërmjet Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut. **16** Pavarësia e Kazakistanit. **17** Këshilli i Ministrave të BE-së vendos të njohë pavarësinë e të gjitha republikave të Jugosllavisë që nënshkruan Deklaratën për Kriteret e Njohjes së Shteteve të Reja. **21** Përfaqësuesit e 11 ish-republikave sovjetike mblidhen në Alma dhe krijojnë Komonuelthin e Shteteve të Pavarura.	**6** Bombardimi i qyteti të vjetër të Dubrovnikut nga UPJ-ja, shumica e së cilës përbëhej nga trupat malazeze. **7** Forcat speciale të policisë kroate, vrasin familjarët e Mihajlo Zecit në Zagreb. **8** Kushtetuta e parë demokratike pas rënies së regjimit komunist në Rumani; Rumania shpallet Republikë dhe një shtet i bashkuar nga pikëpamja kombëtare. **17** Grekët kundërshtojnë kërkesën e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, për njohje ndërkombëtare me emrin Republika e Maqedonisë të pranuar nga Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtëm të BE-së.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1991	**Dhjetor**	**23** Gjermania njeh pavarësinë e Sllovenisë dhe Kroacisë. **25** Gorbaçovi jep dorëheqjen. Bashkimi Sovjetik shpërbëhet. Të nesërmen, Komisioni Evropian njeh Rusinë. Flamuri tringjyrësh i Rusisë (e bardhë, blu dhe e kuqe) zëvendëson çekiçin dhe draprin mbi Kremlin. **31** Armëpushimi me mbështetjen e OKB-së i jep fund luftës civile në El Salvador.	**9** Krahina Autonome e Krajinës dhe Sllavonisë, Baranjës dhe Sremit Perëndimor bashkohen dhe formojnë Republikën e Krajinës Serbe. **0** Jep dorëheqjen kryeministri jugosllav Ante Markoviçi. **28** Varrosja rishtas e Niko Zahariadisit, udhëheqësit të KKE-së gjatë periudhës 1931-1956, ku morën pjesë përfaqësues të të gjithë partive politike, kthehet në simbol të përfundimit të Luftës Civile Greke.
1992	**Janar**	**15** Bashkësia Evropiane njeh pavarësinë e Sllovenisë dhe Kroacisë.	**2-3** F. Tugjmani dhe S. Millosheviçi nënshkruajnë marrëveshjen për planin e operacioneve paqeruajtëse në Jugosllavi (Plani Vens). Krijohen katër zona sigurie të OKB-së, UPJ-ja tërhiqet nga territori kroat. **9** Shpallet Republika Autonome e Serbëve të Bosnjë-Hercegovinës. **11–12** Referendumi jozyrtar i shqiptarëve të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, shërben si tregues i dëshirës për autonomi territoriale. **16** Bullgaria, e ndjekur nga Turqia, njeh Republikën e Maqedonisë. Presidenti bullgar Zhelu Zhelev deklaron se njohja e shtetit nuk nënkupton njohjen e kombit. **16** Ish-ministri grek Andrea Papandreu, i gjykuar në mungesë, shfajësohet për të gjitha akuzat për shpërdorim detyre.
	Shkurt	**7** Nënshkruhet Taktati i Mastrihtit ose Traktati për Bashkimin Evropian, që parashikonte Politikën e Përbashkët të Huaj dhe të Sigurisë (CFSP), Drejtësisë dhe Punëve të Jashtme (DPJ) dhe Bashkimit Monetar dhe Ekonomik (BME). **27** Rezoluta nr. 743 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së themelon UNPROFOR-in (Forcën Mbrojtëse) për krijimin e tre zonave të mbrojtura (ZMKB) në Kroaci.	Demonstrata masive në Greqi kundër përdorimit të emrit "Maqedoni" nga ish - Republika Jugosllave e Maqedonisë. **29 shkurt– 2 mars** Referendum për pavarësinë e Bosnjë-Hercegovinës. Shumica e myslimanëve dhe kroatëve votuan për pavarësi, ndërsa shumica e serbëve abstenuan.
	Prill	**26** Rusia i bashkohet Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).	**3** Udhëheqësi i Partisë Demokratike të Shqipërisë Sali Berisha zgjidhet president nga Kuvendi. **6** Këshilli i Ministrave i Bashkësisë Evropiane, njeh Bosnjë-Hercegovinën si shtet sovran dhe të pavarur një ditë pas SHBA-së, Austrisë dhe Kroacisë. Fillon lufta dhe rrethimi i Sarajevës.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1992	**Prill**		**8** Republika Socialiste e Bosnjë-Hercegovinës ndryshon emrin në Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës. **25** Mbreti Mihai I lejohet të vizitojë Rumaninë për herë të parë pas largimit me forcë në vitin 1947. **27** Krijohet Republika Federale e Jugosllavisë, e përbërë prej shteteve federale të Serbisë dhe Malit të Zi. Dobrica Çosiçi bëhet presidenti i parë.
	Maj	**30** Këshilli i Sigurimit të OKB-së vendos sanksione kundër RFSJ-së përmes Rezolutës nr. 757. Gjatë periudhës 1992-1995, sanksionet herë zbuteshin e herë ashpërsoheshin.	**3 & 15** Sulmet e forcave boshnjake për tërheqjen e autokolonave të UPJ-së në rrugën Dobrovoljaçka në Sarajevë dhe Tuzla. Vriten disa dhjetëra ushtarë. **7** Bullgaria bëhet anëtar i Këshillit të Evropës. **22** Sllovenia, Kroacia, dhe Bosnjë-Hercegovina bëhen anëtare të OKB-së. **24** Shqiptarët e Kosovës zhvillojnë zgjedhje jozyrtare për të zgjedhur parlamentin dhe presidentin e "Republikës së Kosovës".
	Qershor	**2** Danezët refuzojnë Traktatin e Mastrihtit me referendum. Në maj të vitit 1993, e miratuan. **3-14** Samiti i OKB-së për Tokën, për ndryshimet klimatike në Rio de Zhaneiro. **27** Këshilli Evropian miraton deklaratën e Jugosllavisë, ku shpreh gatishmërinë për ta njohur ish-republikën Jugosllave të Maqedonisë me një emër që të mos përfshijë termin "Maqedoni". Për shkak të kundërshtimeve të grekëve, BE-ja njeh republikën e re vetëm nën emrin e ish-Republikës Jugosllave në Maqedoni, por shtetet anëtare mund të përdorin edhe emrin Republika e Maqedonisë.	Inflacioni në Serbi rritet me 100% në muaj. **19** Fillon konflikti myslimano-kroat në Bosnjë-Hercegovinë.
	Qershor-Korrik		Demonstrata masive kundër Millosheviçit në Beograd.
	Korrik		**31** Parlamenti grek ratifikon Traktatin e Mastrihtit.
	Gusht		**7–8** Qeveria greke ndërmerr një program masash të rrepta ekonomike dhe privatizimin e ndërmarrjeve të shërbimeve publike, në përputhje me kriteret e konvergjencës të Traktati të Mastrihtit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1992	**Shtator**	Shpërthen lufta ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit, për Nagorni-Karabakun. **15** RFSJ-ja përjashtohet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.	**27 shtator– 11 tetor** Zgjedhje parlamentare dhe presidenciale në Rumani; Ion Iliesku dhe Partia e tij Social Demokrate në Rumani, (ish-Fronti për Shpëtimin Kombëtar) zgjidhet sërish për një mandat tjetër katërvjeçar.
	Tetor		Forcat kroate çajnë rrethimin e Dubrovnikut dhe marrin sërish jugun e Kroacisë.
	Nëntor		Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Butros Gali paraqet disa ide për zgjidhjen e Çështjes së Qipros, që u refuzua menjëherë nga udhëheqësi turko-qipriot Rauf Denktash. Fitorja e Glafkos Cleridesit në zgjedhjet presidenciale të muajit shkurt të vitit 1993, solli refuzimin edhe nga ana e qipriotëve grekë.
	Dhjetor	**3** Në MB, dërgohet makina e parë që krijonte mesazhe SMS (2G teknologji, brezi i dytë i telefonave celularë).	
1993	**Janar**	**1** Divorci i Kadifenjtë: Shpërbëhet Çekosllovakia; Republika Çeke dhe ajo Sllovake ndahen. **3** Në Moskë, nënshkruhet Traktati (START II) për Pakësimin e Armëve Strategjike Bërthamore ndërmjet SHBA-së dhe Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (CIS). **20** Uilliam J. Klinton (Demokrat) fillon mandatin e tij si presidenti i SHBA-së.	Operacioni Maslenica e ushtrisë kroate në rrethinat e Zadarit. **7** Masakra e Krishtlindjes e civilëve serbë në Kravicë nga forcat boshnjake.
	Shkurt	Belgjika hedh hapat e para drejt shtetit federal.	
	Prill	Këshilli Evropian për Kërkimin Bërthamor (CERN) i vë në dispozicion botës Rrjetin e Gjerë Botëror falas.	**6** Masakra e civilëve boshnjakë nga forcat kroate në Ahmiçi. **7** Vdes Turgut Ozali. Demireli bëhet pesident i Turqisë, ndërsa Tansu Çiller e zëvendëson si kryeministër (25 qershor 1993-5 tetor 1995).
	Maj	**25** OKB-ja themelon Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë nëpërmjet Rezolutës nr. 827.	
	Korrik		**2** Islamistët radikalë dhe të djathtët i vënë flakën një hoteli, në Sivas të Turqisë, ku mbetën të vrarë 37 intelektualë, shumica e të cilëve ishin alevitë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1993	**Gusht**		**28** Shpallet Bashkësia Kroate e Herceg-Bosnjës në Grudë.
	Shtator	**13** Marrëveshja e Oslos ndërmjet Izraelit dhe Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP). Palestinezët njohin zyrtarisht Izraelin dhe gëzojnë të drejtën e vetëqeverisjes në disa pjesë të Rripit të Gazës dhe të Bregut Perëndimor.	Ushtria kroate dhe Ministria e Punëve të Brendshme organizon Operacionin "Xhepi Medakut", duke marrë sërish nën kontroll Gospiçin; krime lufte kundër civilëve serbë; shkatërrohen 11 fshatra serbe. **27** Shpallet Krahina Autonome e Bosnjës Perëndimore në Velika Kladusha.
	Nëntor	**1** Në përputhje me Traktatin e Mastrihtit, Komisioni Evropian bëhet Bashkimi Evropian (BE).	**8-9** Këshilli i Mbrojtjes Kroate (Ushtria e Kroatëve të Bosnjës) bombardon Urën e Vjetër të Mostarit. **16** Greqia dhe Qiproja, nënshkruajnë një pakt të përbashkët mbrojtjeje.
1994	**Janar**	Xherri Jangu dhe Deivid Filoja krijojnë Yahoo!-në; fillon të përdoret nga publiku më 2 mars të vitit 1995. **1** SHBA-ja, Kanadaja dhe Meksika nënshkruajnë Traktatin e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (ALENA), hyri në fuqi në dhjetor të vitit 1992. **10–11** NATO-ja publikon nismën e Partneritetit për Paqe (PP) për të fuqizuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e Evropës, veçanërisht në Bllokun e Vendeve Lindore.	**26** Rumania nënshkruan dokumentin kuadër të PP-së; rrjedhimisht, ajo merr pjesë në misionet paqeruajtëse ushtarake dhe civile të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës, Shqipërisë, Kosovës, Kuvajtit, Afganistanit dhe Irakut.
	Janar - Qershor		Greqia merr presidencën e BE-së.
	Shkurt		**5** Masakër në tregun Markale në Sarajevë; 68 civilë vriten nga bombardimi i serbëve. **7** Miratohen sulmet e NATO-s mbi pozicionet e serbëve të Bosnjës. **16** Qeveria greke vendos embargon tregtare ndaj ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duke kundërshtuar emrin e republikës dhe simbolet e saj shtetërore.
	Mars	**28** Koalicioni i djathtë dhe nacionalist i Aleancës së Lirisë korr fitore dërmuese në zgjedhjet e mbajtura në Itali. Në prill, manjati i medias Silvio Berluskoni bëhet kryeministër.	**31** Krijohet Federata e Bosnjë-Hercegovinës (Marrëveshja e Uashingtonit); fundi i luftës ndërmjet boshnjakëve dhe kroatëve.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1994	**Prill**	**15** Marrëveshja e Marrakeshit, e nënshkruar nga 123 shtete, themelon Organizatën e Tregtisë Botërore (WTO), duke zëvendësuar Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT) (në fuqi që prej vitit 1958).	**14** Parlamenti grek miraton konfiskimin e pronës së ish-mbretit në Greqi dhe i heq shtetësinë greke. Në nëntor të vitit 2000, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që të drejtat e tij të njeriut ishin shkelur dhe e dëmshpërbleu atë me 12 milion euro (nëntor 2002).
	Prill-Korrik	Gjenocidi në Ruanda. Masakër masive e tutsive nga anëtarët e shumicës hutu që ishin në pushtet. Vriten rreth gjysmë deri në një milion shtetas ruandezë. Gjenocidi u planifikua nga anëtarët e elitës kryesore hutu, radhët e ushtrisë ruandeze, xhandarmëria, ushtarakët e përkrahur nga qeveria, si dhe civilët e thjeshtë. Në nëntor të vitit 1994, Këshilli i Sigurimit të OKB-së themelon Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ruandën (GJPNR). Derisa sa ajo u shpërbë më 31 dhjetor të vitit 2015, ajo gjykoi 95 veta, prej të cilëve 61 u dënuan.	
	Maj	**10** Pas fitores së Kongresit Kombëtar Afrikan (KKA) në zgjedhjet e para demokratike në historinë e vendit, Nelson Mandela bëhet Presidenti i Afrikës së Jugut.	
	Korrik	**5** Themelohet Amazon.com (tregtia amerikane elektronike) nga Xhef Bezosi.	
	Gusht	Ushtria Republikane Irlandeze (IRA) shpall armëpushimin me Irlandën e Veriut.	**4** Serbët e Bosnjës refuzojnë planin e paqes së grupit të kontaktit. Millosheviçi resht së mbështeturi udhëheqësit serbë të Bosnjës.
	Shtator		**12** Regjisori maqedonas Milço Mançevski, fiton çmimin "Luani i Artë", së bashku me një regjisor tjetër, në Festivalin 51 Ndërkombëtar të Venecias me filmin "Përpara se të bjerë shi" (Before the Rain).
	Nëntor	**27-28** Norvegjia voton kundër anëtarësisë në BE.	
	Dhjetor	**5-6** Samiti i Budapestit. Pesëdhjetë e dy shtete themelojnë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila zëvendëson Komisionin për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë. **11** Fillon Lufta e Parë Çeçene. Trupat ruse pushtojnë Çeçeninë. Lufta njëzetmuajshe merr jetët e 300,000 njerëzve duke përfshirë edhe Dudajevin, Presidentin e Çeçenisë.	**17** Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, themelohet në mënyrë të jashtëligjshme " Universiteti Shtetëror i Tetovës", si nismë e intelektualëve dhe OJF-ve shqiptare. Autoritetet arrestojnë dhe dënojnë rektorin e tij me dy vite e gjysmë burgim. Universiteti do të njihej nga shteti në vitin 2004.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1995	Janar	1 Austria, Finlanda dhe Suedia bëhen anëtare të BE-së.	30 Pala serbe refuzon planin e paqes Z-4, që iu jepte autonomi të një niveli të lartë serbëve të Krajinës.
	Shkurt		1 Bullgaria bëhet kandidate për t'u anëtarësuar në BE.
	Mars	26 Zona Shengen: Anulimi i kontrolleve të pikave kufitare ndërmjet shteteve anëtare të BE-së.	12 Protestat e alevitëve në Gazi, Stamboll, morën jetën e 25 njerëzve.
	Maj		1 Ushtria kroate ndërmerr Operacionin "Vetëtima" në Sllavoninë Veriore. 25 Masakra e Portës së Tuzlës në Bosnjë; nga bombardimet serbe humbin jetën 71 të rinj, si dhe u plagosën 240 të tjerë. 28 Regjisori Emir Kusturica (Serbia dhe Mali i Zi) fiton çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit në Kanë për filmin "Nëntokë" (Underground).
	Qershor		21 Marrëveshja e Snagovit: të 14 grupet politike të parlamentit rumun nënshkruajnë me konsensus dokumentin, duke mbështetur një rend dite politik pro-evropian. 22 Rumania dorëzon kërkesën zyrtare për t'u anëtarësuar në BE.
	Korrik		11 Nën komandën e Ratko Mladiçit, ushtria e Republikës së Krajinës Serbe masakron 8,000 burra e djem në "zonën e sigurt" të Srebenicës; Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë së OKB-së, e cilëson si gjenocid.
	Gusht		4 Fillon Operacioni "Vetëtima" e ushtrisë kroate; Kroacia merr sërish kontrollin e Kninit të Krajinës; 150,000 refugjatë serbë largohen drejt Serbisë; kryhen krime lufte kundër civilëve, kryesisht të moshuar në disa fshatra serbe. 28 Masakër në një treg të Sarajevës; bombardimi serb la 43 të vdekur dhe 81 të plagosur. 29 gusht 14-shtator Bombardimi i pozicioneve serbe nga NATO-ja në Republikën e Krajinës Serbe.
	Shtator		13 Marrëveshje e Përkohshme ndërmjet Greqisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë; hiqet embargoja greke.
	Tetor		3 Kiro Gligorovi, Presidenti i Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, i mbijeton një atentati vrasës me shpërthim automjeti, por plagoset keqas, duke humbur syrin e djathtë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1995	Tetor-Nëntor		**Tetor 25- 5 Nëntor** Në Sarajevën e rrethuar, organizohet Festivali i Parë i Filmit në Sarajevë.
	Nëntor	**4** Vritet në Tel aviv nga një grup ekstremist fetar izraelit Jitzak Rabini, kryeministri i Izraelit dhe mbështetësi aktiv i paqes në Lindjen e Mesme.	**12** Marrëveshja Erdut ndërmjet autoriteteve kroate dhe serbe në Sllavoninë Lindore parashikon riintegrimin e rajonit (duke përfshirë edhe Baranjën dhe Srijemin Perëndimor) në kuadrin ligjor dhe shtetëror të Kroacisë. **22** Heqja e sanksioneve kundër Serbisë.
	Dhjetor	**21** Nënshkruhet zyrtarisht Marrëveshja e Paqes e Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën në Paris. Zgjidhja e konfliktit.	
1996	Janar	Jaser Arafati zgjidhet president i Autoritetit Ndërkombëtar Palestinez.	Hyn në fuqi Bashkimi Doganor ndërmjet BE-së dhe Turqisë. **28-31** "Kriza e Imias" që lidhej me ishujt e pabanuar të Egjeut, e çon Greqinë dhe Turqinë thuajse në prag të luftës; kriza zgjidhet pas ndërhyrjes diplomatike të SHBA-së.
	Shkurt		Fillimi i përplasjeve të armatosura në Kosovë. Një vit më vonë, do të shfaqej Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). **29** Qeveria boshnjake shpall zyrtarisht përfundimin e rrethimit të Sarajevës.
	Prill	**21** Aleanca e Ullirit fiton zgjedhjet e përgjithshme në Itali. Ish-kryeministri Bettino Craxi dënohet me tetë vite burgim për korrupsion.	
	Maj	Greva në Gjermani kundër masave shtrënguese ekonomike.	
	Qershor		Pas një krize të rëndë politike në Turqi, Nexhemedin Erbakani, udhëheqësi i Partisë së Mirëqenies Islamike, bëhet kryeministër, ndërsa Tansu Çiller zëvendëskryeministre.
	Korrik	**5** Lind delja e klonuar Doli.	
	Gusht	Hidhet në treg telefoni i parë celular, që mundësonte emailin dhe lidhjen e internetit me valë nga Nokia Communication. **31** Rusia dhe Çeçenia nënshkruajnë një marrëveshje paqeje, duke e "ngrirë" çështjen e pavarësisë për pesë vjet, por duke njohur autonominë e Çeçenisë.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1996	Shtator	27 Talebanët hyjnë në Kabul, një zhvillim ky që u mirëprit nga SHBA-ja.	Themelohet në Shkup Bashkia rome e Shuto Orizarit, e njohur gjerësisht si Shutka, si një prej dhjetë bashkive të qytetit. E vetmja bashki në Evropë shumica e popullsisë dhe gjuha zyrtare e së të cilës është rome.
	Nëntor		3 Skandali Susurluk në Turqi nxjerr në shesh marrëdhëniet ndërmjet forcave të sigurisë, së djathtës radikale dhe krimit të organizuar. 3 & 17 Konventa demokratike rumune, një koalicion i djathtë partish, nën udhëheqjen e Emil Konstandineskut, fiton zgjedhjet parlamentare dhe presidencale. 17 Partitë opozitare në serbi fitojnë zgjedhjet. Millosheviçi nuk njeh rezultatet. Demonstratat zgjasin për tre muaj.
	Dhjetor	29 Nënshkruhet traktati i paqes ndërmjet Presidentit të Guatemalës dhe guerilasve të vendit , duke i dhënë fund konfliktit të armatosur që për 36 vjet me radhë mori jetët e mbi 100,000 njerëzve, pa përfshirë 40,000 të zhdukurit.	
1997	Janar	1 Diplomati nga Gana Kofi Anan bëhet Sekretari i shtatë i Përgjithshëm i OKB-së; në vitin 2001 ai fiton çmimin "Nobel" për Paqe, së bashku me OKB-në. 20 Bill Klintoni fillon mandatin e tij të dytë si presidenti i SHBA-së.	
	Janar-Mars		Rënia e 25 skemave priamidale në Shqipëri, shkakton trazira të papërmbajtshme, rënien e qeverisë dhe thuajse një luftë civile, ku mbetën të vrarë afro 2 ,000 njerëz.
	Shkurt		28 Grusht shteti post moderni në Turqi, kundër koalicionit qeveritar të Erbakanit; Këshilli i Sigurisë Kombëtare miraton një sërë masash të ashpra kundër islamistëve.
	Maj	27 Nënshkruhet në Paris Akti Themelues për Marrëdhënie e Ndërsjellta, Bashkëpunim dhe Siguri ndërmjet NATO-s dhe Federatës Ruse.	22 Gjykata Kushtetuese ndalon përdorimin e flamurit shqiptar në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. 30 Karlos Uestendorpi, ish-ministri spanjoll i Punëve të Jashtme, emërohet si përfaqësuesi i parë i lartë i Bashkësisë Ndërkombëtare në Bosnjë-Hercegovinë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1997	Qershor	17 Traktati i Mastrihtit ndryshohet me Traktatin e Amsterdamit.	15 Franjo Tugjmani fiton zgjedhjet e para presidenciale në Kroaci. 18 Trysnia ushtarake dhe ultimatumet detyrojnë Kryeministrin turk Erbakan të jepte dorëheqjen. 30 Qeveria e re në Turqi drejtohet nga Mesut Jëllmazi, udhëheqësi i Partisë së Mëmëdheut (do të vazhdojë deri në nëntor të vitit 1998).
	Korrik	1 Hong Kongu, që kishte qenë koloni britanike për 150 vjet, i kthehet sërish Kinës.	8 Protestat e shqiptarëve në Tetovë dhe Gostivar, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përfundojnë në përplasje të dhunshme me forcat e sigurisë. Vriten tre shqiptarë, si dhe arrestohen shumë të tjerë. Rufi Osmani, Kryetari i Bashkisë së Gostivarit dënohet me pothuajse 14 vjet burgim, pasi u shpall fajtor për ndezjen e tensioneve etnike, por u lirua pas dy vitesh.
	Gusht	31 Vdes në Paris si pasojë e një aksidenti automobilistik Princesha e Uellsit, Diana.	
	Tetor		5 & 19 Zgjedhje në Mal të Zi; në janar të vitit 1998, Milo Gjukanoviçi zgjidhet President i Malit të Zi.
	Dhjetor	11 Protokolli i Kiotos për ngrohjen globale nënshkruhet nga 123 vende, duke përfshirë edhe 15 shtete anëtare të BE-së. SHBA-ja dhe Federata Ruse refuzojnë ta ratifikojnë Protokollin.	
1998	Janar		16 Gjykata Kushtetuese e Turqisë shpërbën Partinë e Mirëqenies dhe e përjashtuan Erbakanin nga politika për pesë vjet.
	Shkurt		28 Fillon lufta në Kosovë; zgjat deri më 11 qershor të vitit 1999.
	Mars		14 Dhrahmia greke zhvlerësohet me 14% për t'iu bashkuar mekanizmit të kursit të këmbimit.
	Prill	10 Nënshkruhet Marrëveshja e së Premtes së Mirë në Belfast ndërmjet Britanisë së Madhe, Republikës së Irlandës dhe partive unioniste dhe republikane të Irlandës Veriore.	
	Maj		24 Regjisori grek Theo Angelopulos fiton çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit në Kanë p ër filmin "Përjetësi e një ditë".
	Qershor	1 Fillon të veprojë Banka Qendrore Evropiane me zyra qendrore në Frankfurt.	22 Marka e këmbyeshme bëhet monedha zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1998	Qershor - Korrik	**15 qershor-17 korrik** Në një mbledhje të OKB-së në Romë, themelohet Gjykata Penale Ndërkombëtare me zyra qendrore në Hagë.	
	Gusht		Zjarret shkatërruese në pyje godasin Greqinë, duke kërcënuar Athinën dhe disa prej vendeve më të spikatura turistike të vendit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës vret civilë serbë në fshatin e Kleçkës.
	Shtator	**4** Themelohet Google-i në Kaliforni.	
	Dhjetor		**2** Bylent Eçevit, udhëheqësi i Partisë së nacionaliste të Majtë Demokratike Kombëtare (PMD), formon një qeveri minoritare në Turqi. **7** NATO-ja dislokon një kontigjent të konsiderueshëm në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për të parandaluar dhunën nga Kosova.
1999	Janar	**1** Në të njëmbëdhjetë shtetet anëtare të BE-së, futet euroja, monedha evropiane.	
	Shkurt		**16** Abdullah Oçalan, udhëheqësi i PPK-së zihet rob në Kenia; fundi i lëvizjes së armatosur kurde.
	Mars	**12** Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke hyjnë në NATO. **18** Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë (Marrëveshjet e Rambujesë) parashikojnë administrimin e Kosovës si krahinë autonome brenda RFSJ-së; rendi në Kosovë vendoset nga 30,000 trupa të NATO-s. Marrëveshjet nënshkruhen nga delegacionet e shqiptarëve të Kosovës, amerikane dhe britanike, ndërsa delegacioni serb dhe rus refuzojnë. Për shumë diplomatë dhe vëzhgues të tjerë, Marrëveshjet ishin hapi i parë drejt bombardimit të Serbisë nga NATO-ja.	**23** Asambleja Kombëtare e Serbisë refuzon planin e paqes së Rambujesë për Kosovën. **24** NATO-ja ndërmerr sulme ajrore të përmasave të mëdha ndaj Serbisë, dhe sulme ajrore me përmasa të kufizuara ndaj Malit të Zi deri në mesin e muajit qershor.
	Prill		**18** Zgjedhje parlamentare në Turqi. PMD-ja dhe Paria për Aksion Kombëtar e Devlet Bahçeliut, krijojnë Koalicion qeveritar me kryeministrin Eçevit.
	Maj		**4** Hapet hapësira ajrore bullgare për operacionet e NATO-s në Jugosllavi.
	Maj - Qershor		Rumania hap tre aeroporte dhe hapësirën e saj ajrore për avionët ushtarakë të NATO-s; në pjesën perëndimore të vendit, ngrihet kampi i parë i refugjatëve të ish-Jugosllavisë; protesta popullore kundër bombardimit të Serbisë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
1999	Qershor		10 Nënshkruhet marrëveshja e Kumanovës; ushtria e RFSJ-së tërhiqet nga Kosova. Përfundon bombardimi i Serbisë nga NATO-ja. Dislokimi i forcave ushtarake të OKB-së. Afro 200,000 refugjatë serbë largohen drejt Serbisë.
	Gusht		17 Tërmeti i fortë i në rajonin e Marmarës Lindore në Turqi, lë pas 18,000 të vdekur, 44,000 të plagosur dhe 200,000 të pastrehë.
	Shtator		7 Tërmeti i fortë në Athinë lë pas mbi 150 të vdekur dhe të plagosur, si dhe 10,000 të pastrehë.
	Nëntor	30 Demonstrata kundër globalizimit në Siatëll.	
	Dhjetor	11 Samiti i Helsinkit . BE-ja e njeh Turqinë si vend kandidat për anëtarësi të plotë.	10 Vdes Franjo Tugjmani.
2000	Janar		3 Koalicioni i udhëhequr nga Partia Social-Demokratike fiton zgjedhjet parlamentare në Kroaci, duke i dhënë fund mbizotërimit politik të HDZ-së.
	Mars	20 Vladimir Putini, që tashmë vepronte si president i përkohshëm i Federatës Ruse pas dorëheqjes së Jelcinit, zgjidhet zyrtarisht president.	
	Maj	24 Izraeli tërhiqet nga Libani Jugor, që e kishte pushtuar që prej vitit 1978.	
	Qershor		Komisioni Evropian çmon se Greqia i ka përmbushur kërkesat për anëtarësim në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar; Greqia bëhet shteti i parë anëtar i BE-së që gjobitet nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë për lejimin e hedhjes së mbetjeve toksike në një shtrat lumi në Kretën Perëndimore.
	Korrik	11-25 Dështon Samiti i Paqes në Kampin David në Lindjen e Mesme.	Legjislacioni i ri lejon përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet e arsimit të lartë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
	Shtator	28 Fillon Intifada e Dytë Palestineze kundër Izraelit.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2000	Tetor		Qeveria greke nxjerr ligje për heqjen e fesë nga letërnjoftimi, të gjendur përballë kundërshtisë së fortë nga Kisha greke dhe qaerqet nacionaliste. **5-7** Millosheviçi humbet zgjedhjet presidenciale; demonstratat në Beograd e detyrojnë të pranojë humbjen.
	Dhjetor	**7-11** Samiti i BE-së në Nisë shpall Kartën e të Drejtave Themelore.	
2001	Janar	**15** Publikohet Wikipedia, enciklopedia e lirë në internet. **20** Presidenti i SHBA-së, Bill Klinton pasohet ngarepublikani Xhorxh W. Bush, djali i ish-presidentit Xhorxh Bush.	**1** Greqia bëhet vendi i dymbëdhjetë anëtar i BE-së që i bashkohet Eurozonës.
	Shkurt		Gjenerali kroat Mirko Norac arrestohet mbi bazën e akuzave të krimeve të luftës. Fillon kriza ekonomike në Turqi. **26** Forcat e sigurisë së shtetit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe të UÇK-së përplasen më fshatin e Tanushevcit. Konflikti përhapet në të gjitha rajonet e banuara nga shqiptarët, në afërsi të Kumanovës dhe Tetovës. këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1345, duke dënuar ashpër dhunën.
	Mars	**1-2** Organizata e Bashkimit Afrikan (OBA) merr emrin Bashkimi Afrikan (BA) me 54 shtete anëtare. **21** Në Luksemburg, nënshkruhen Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit, ndërmjet BE-së dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.	**25** Regjisori boshnjak Danis Tanoviçi fiton çmimin "Oskar" për "Filmin më të mirë të huaj me filmin "Toka e askujt".
	Prill		**10** Në BE, hyn në fuqi regjimi i lirë i vizave bullgare.
	Maj	Kompania NTT DoCoMo në Japoni publikon modelin e parë të rrjetit 3G; rrjeti i parë 3G hidhet në treg më 1 tetor të vitit 2001.	
	Qershor		**22** Gjykata Kushtetuese e Turqisë e shpall të jashtëligjshme veprimtarinë e Partisë Virtyti. **28** S. Millosheviçi dërgohet në Gjykatën e OKB-së në Hagë për Krimet e Luftës.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2001	Gusht		**13** Nënshkruhet Marrëveshja Kuadër e Ohrit (Marrëveshja e Paqes) nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe partitë shqiptare. Gjashtëmbëdhjetë ndryshime kushtetuese fuqizojnë pozitat e shqiptarëve dhe të bashkësive të tjera në shkallë kombëtare dhe vendore. **14** Në Turqi, krijohet Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (PDZH).
	Shtator	**11** Sulmet e nëntë shtatorit të grupit terrorist islamik Al-Kaeda ndaj Qendrës Tregtare Botërore në Nju Jork dhe në Pentagon, Uashington DC, morën jetën e 2,996 njerëzve, duke përfshirë edhe jetën e 19 pengmarrësve të avionit dhe shkaktoi të paktën 10 miliard $ dëme. SHBA i shpall luftë terrorizmit. **17** Kina pranohet në Organizatën Botërore të Tregtisë.	
	Tetor		Gjykata e Krimeve të Luftës në Hagë, ngre padi ndaj gjeneralëve kroatë Ante Gotovina dhe Rahim Ademi; Ademi shkon me vullnet të plotë në Hagë, ndërsa Gotovina largohet nga Kroacia. **3** Asambleja e Madhe Kombëtare Turke (AMKT), miraton paketën e parë të harmonizimit për të përmbushur kriteret e Kopenhagës për anëtarësimin në BE.
	Dhjetor	**9** Bie regjimi taleban në Afganistan dy muaj pas bombardimit nga SHBA-ja dhe ndërhyrjes tokësore të NATO-s.	
2002	Janar	Në janar, Argjentina shpall falimentin financiar, duke pasur një borxh prej 132 miliard dollarësh. Në vitin 2004 fillon rimëkëmbja. **1** Monedha e Euros futet për herë të parë në 12 shtetet anëtare.	
	Shkurt	**12** Fillon gjykimi i Sllobodan Millosheviçit për akuzat për krime lufte kundër njerëzimit në Hagë.	
	Mars	**22** Trupat amerikane dhe ato afgane, ndërmarrin Operacionin "Anaconda" kundër luftëtarëve talebanë dhe të Al-Kaedës, që kishin mbetur në Afganistan.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2002	Prill	4 Rebelët e Bashkimit për Pavarësinë e Plotë të Angolës (UNITA) dhe qeveria angoleze nënshkruajnë armëpushimin, duke i dhënë fund luftës civile tridhjetëvjeçare.	24 Bosnjë-Hercegovina bëhet anëtare e Këshillit të Evropës.
	Qershor-Shtator		Arrestohen dhe dërgohen para gjyqit, katërmbëdhjetë anëtarë të organizatës terroriste greke "17 nëntori", që ishte përgjegjëse për 23 vrasje që prej fundit të vitit 1974.
	Shtator	Gjykata për Krimet e Luftës në Hagë, merr për gjykim pesë raste nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, që lidheshin të gjitha me konfliktin e armatosur të vitit 2001 ndërmjet forcave të sigurisë së shtetit dhe UÇK-së.	
	Tetor	23 "Kriza e Pengjeve në Teatrin e Moskës", që njihej edhe si rrethimi i Nord-Ostit i vitit 2002 nga 40-50 çeçenë të armatosur duke kërkuar tërheqjen e forcave ruse nga Çeçenia.	
	Nëntor	14 Jiang Zemin del zyrtarisht në pension si Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Kinës, pasohet nga Hu Jintao.	3 PDZH-ja e Rexhep Tajip Erdoganit fiton në mënyrë të padiskutueshme shumicën në zgjedhje.
	Dhjetor	12-13 Samiti i Kopenhagës: Pesëmbëdhjetë udhëheqës të BE-së refuzojnë kërkesën e Turqisë për të përcaktuar një datë për hapjen e negociatave për aderimin e vendit në BE.	12-13 Udhëheqja qiprioto-turke refuzon Planin e Dytë Anan.
2003	Janar-Qershor		Greqia merr presidencën e BE-së.
	Shkurt	5 Sekretari i Shtetit Kollin Pauëll, shprehet se armët e shkatërrimit në masë të Irakut mund të përbëjnë kërcënim të mundshëm për sigurinë e botës.	Kroacia bën kërkesë për anëtarësi në BE. 4 Në përputhje me Marrëveshjen e Beogradit ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi (2002), dhe me ndërmjetësimin e BE-së, të dy palët lidhën marrëveshje për bashkëpunimin e vazhdueshëm, dhe vendosën të hiqnin emrin Jugosllavi; krijohet kështu Bashkimi Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi.
	Mars	19 Lufta e Dytë e Gjirit. SHBA-ja dhe Britania i shpallin luftë Irakut, pa Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Franca, Gjermania dhe Rusia kundërshtojnë ndërhyrjen ushtarake.	1 Parlamenti turk refuzon kërkesën e SHBA-së për të hapur një front të dytë në Turqinë Juglindore kundër Irakut; kriza turko-amerikane. 12 Vritet kryeministri serb Zoran Gjingjiçi. 14 Tajip Erdoani bëhet kryeministër i Turqisë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2003	Prill	29 Betohet kryeministri i parë palestinez, Mahmut Abasi.	Udhëheqja qiprioto-turke heq kufizimet për kalimin e vijës kufitare të ishullit, që ishte në fuqi që prej vitit 1974.
	Maj	15 Nestor Kirçneri zgjidhet presidenti i Argjentinës, duke i dhënë fund krizës ekonomike dhe politike.	
	Korrik		Asambleja e Madhe Kombëtare Turke (AMKT) voton paketën e shtatë të harmonizimit, duke kufizuar pushtetin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare.
	Tetor		29 Presidenti i Turqisë, refuzon të ftojë në pritjen zyrtare, me rastin e 80 vjetorit të Republikës së Turqisë, gratë me shami të ministrave të AKP-së dhe zyrtarët e saj të lartë, duke nxitur tensione në Asamblenë e mbizotëruar nga AKP-ja-ja.
	Nëntor		Sulmet kundër bashkësisë hebraike dhe objekteve britanike në Stamboll, që mendohej se u organizuan nga Al-Kaeda dhe turqit islamistë, morën jetën e 62 njerëzve. 23 HDZ-ja fiton zgjedhjet parlamentare në Kroaci; Ivo Sanaderi bëhet kryeministër.
	Dhjetor	13 Sadam Hyseini zihet rob nga trupat amerikane në Badgad.	Opozita e udhëhequr nga Mehmet Ali Talat fiton zgjdhjet turko-qipriote.
2004	Shkurt	4 Krijohet shërbimi i rrjetëzimit social Facebook nga Mark Zukerbergu.	15 Regjisori turk i lindur në Hamburg Fatih Akin, fiton çmimin "Ariu i Artë" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Berlin për filmin "Me kokën lart" (Head - On).
	Mars	11 Sulme terroriste në Spanjë (të njohura si 11-M). Nga bombardimi i bashkërenduar kundër rrjetit hekurudhor të Madridit, mbetën të vrarë mbi 200 njerëz. Al-Kaeda merr përsipër përgjegjësinë. 29 NATO-ja pranon zyrtarisht shtatë shtete të reja: Bullgarinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Sllovenine.	
	Prill		Në Qipro, mbahet referendum për versionin e pestë të Planit Anan; qipriotët turq e pranojnë, ndërsa qipriotët grekë e refuzojnë.
	Maj	1 Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia hyjnë në BE.	

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2004	Qershor		Kroacia merr statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.
	Gusht		**13–29** Në Athinë organizohen Lojërat e XXVIII Olimpike Verore.
	Shtator	**1–3** Rrethimi i shkollës Beslan: Terroristët çeçenë marrin peng mbi 1,200 nxënës dhe të rritur në Beslan, Rusi; nga shpërthimi i eksplozivëve vriten 330 njerëz.	
	Nëntor	**2** Xhorxh W. Bushi merr sërish detyrën e presidentit të SHBA-së. **4** SHBA-ja e njeh Republikën e Maqedonisë nën emrin e saj kushtetues.	**24 nëntor & 12 dhjetor** Koalicioni i djathtë i Traian Baseskut fiton zgjedhjet parlamentare me dy raunde në Rumani.
	Dhjetor	**26** Cunami i fuqishëm shkatërron Azinë Juglindore, duke marrë jetën e 150,000 njerëzve.	
2005	Shkurt	**14** Hidhet në treg YouTube-i, faqja për shpërndarjen e videove.	
	Mars		Ish-ministri i brendshëm i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Ljube Boshkoski, akuzohet nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për vrasjen e civilëve në fshatin Ljuboten, krahas policit Johan Tarçulovskit, dhe ekstradohet në Hagë.
	Maj	Referendumi i mbajtur në Francë hedh poshtë Kushtetutën e propozuar evropiane.	
	Korrik		**15** Parlamenti i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, miraton ligjin për ta lejuar bashkësinë shqiptare të përdorë flamurin etnik në godina publike, në ato zona ku përbënin shumicën e popullsisë.
	Dhjetor		Greqia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë hapin Zyrën për Marrëdhëniet Konsullore, Ekonomike dhe Tregtare në Bitolë dhe në Konsullatën e Selanikut. Megjithatë emri mbetet ende një problem i pazgjidhur.
2006	Shkurt		**18** Regjisorja boshnjake Jasmila Zhbaniç, fiton çmimin "Ariu i Artë" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Berlin për filmin "Grbavica".
	Mars	Krijohet Twitter-i, shërbimi në internet i rrjetëzimit social, që i lejon përdoruesve të dërgojnë dhe marrin mesazhe të shkurtra; do të hidhej në treg në korrik të vitit 2006.	**11** Vdes në Hagë Sllobodan Millosheviçi nga një infarkt në zemër. Gjykimi i tij katërvjeçar për krimet e luftës ishte pothuajse drejt përfundimit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2006	Maj		21 Miratohet referendumi për pavarësi në Malin e Zi, ku pragu i 55%-it u kalua me vështirësi. Rezultati njihet nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Asambleja e Republikës së Malit të Zi bën Deklaratën formale të Pavarësisë më 3 qershor.
	Qershor		5 Serbia bën Deklaratën formale të Pavarësisë. Pas shpërbërjes së Bashkimit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi, Serbia bëhet pasardhësja zyrtare e Bashkimit, ndërsa Mali i Zi do të bënte rishtas kërkesë për anëtarësi në organizatat ndërkombëtare.
	Tetor		Shkrimtari turk Orhan Pamuk fiton çmimin "Nobel" në l etërsi.
	Nëntor	5 Në vitin 1988, Sadam Hyseini akuzohet për gjenocid nga gjykata e Irakut, për fushatën kundër popullsisë kurde irakene. Dënohet me vdekje dhe ekzekutohet më 30 dhjetor.	
2007	Janar		1 Bullgaria dhe Rumania bëhen anëtare të BE-së. 1 Sllovenia fillon të përdorë euron.
	Mars	26 Jan Peisli dhe Geri Adams, udhëheqësit kryesorë të partive unioniste dhe republikane të Irlandës së Veriut, takohen për herë të parë dhe bien dakord për të krijuar një administratë me pushtet të ndarë në rajon.	
	Prill		16 Fillon procesi gjyqësor i Ljube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit në Hagë. Pas një viti, Boshkoski shpallet i pafajshëm, ndërsa Tarçulovski dënohet me 12 vjet burgim.
	Maj		27 Regjisori rumun Kristian Mungiu fiton çmimin "Palma e Artë" në Festivalin e Filmit në Kan ë për filmin "4 muaj, 3 javë e 2 ditë".
	Dhjetor	14 Shtetari i Koresë së Veriut Ban Ki-Mun bëhet Sekretari i tetë i Përgjithshëm i OKB-së. Kriza e ekonomisë botërore.	
2008	Janar-Qershor		Sllovenia merr presidencën e BE-së.

Viti	Muaji	Në botë	Në Evropën Juglindore
2008	**Shkurt**	**18** SHBA-ja dhe disa shtete të tjera, duke përfshirë Britaninë, Gjermaninë dhe Francën, njohin Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur.	**17** Meqenëse negociatat tremujore ndërmjet BE-së, Federatës Ruse dhe SHBA-së për të ardhmen e Kosovës, arrijnë "pikën e vdekur", Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi shpall pavarësinë nga Serbia. **21** Në Serbi organizohet një tubim me parullën "Kosova është Serbi", ku morën pjesë gjysmë milioni njerëz. Pjesëmarrësit djegin ambasadën e SHBA-së.
	Prill		Kroacia merr ftesë për të hyrë në NATO. **2–4** Samiti i NATO-s në Bukuresht konsiderohet si mbledhja më e rëndësishme e mbajtur ndonjëherë në Rumani; në samit marrin pjesë 3,000 delegatë nga 26 shtete anëtare të NATO-s dhe 23 partnerë të NATO-s.
	Maj	**7** Dmitri Medvedevi zgjidhet presidenti i Federatës Ruse. Putini bëhet kryeministër.	
	Qershor– Dhjetor		Fillon kriza ekonomike në Evropën Juglindore; vendet e Evropës Juglindore zhyten në krizë të thellë ekonomike të vitit 2009; pjesa më e madhe e vendeve rimëkëmben nga vitit 2010-2011, ndërsa disa të tjera hyjnë sërish në krizë në vitin 2012. Vetëm Greqia përjetoi një krizë të pandërprerë ekonomike gjatë periudhës 2008-2013 dhe gjysmës së dytë të vitit 2015.
	Korrik	**8-24** Në Pekin organizohen Lojërat e XXIX Olimpike Verore.	Udhëheqësi serbo-boshnjak Radovan Karadzhiç arrestohet në Beograd dhe dërgohet në Gjykatën e Krimeve të Luftës së OKB-së në Hagë.
	Gusht		
	Dhjetor		**6** Vrasja e një nxënësi të shkollës së mesme nga policia në Athinë, ndez një sërë protestash dhe demonstratash, që morën përmasat e rebelimit.



"Adevărul-ziar al Frontului Democratic Român din Arad" ['E Vërteta – gazeta e frontit Demokratik Rumun në Arad], viti 1, nr. 1, 23 dhjetor 1989.

"Antiratni pokret u Crnoj Gori 91-92" [Lëvizja kundër luftës në Malin e Zi 91-92], Matica crnogorska [Trashëgimia malazeze], Podgoricë, 2012.

Baykal, S., "Ek Protokol Deklarasyonları" [Deklarata për Protokollin shtesë] në Baskın Oran (b.), Türk Dış Politikası [Politika e jashtme turke], vëll. III: 2001-2012, İletişim, Stamboll 2013.

Profili i migracionit i Bosnjë-Hercegovinës për vitin 2011, Ministria e Sigurisë e Bosnjë-Hercegovinës, Sarajevë, mars 2012

Botsiou, K. (b.), Τετράδια Κοινοβουλευτικού Λόγου [Fletoret e Ligjërimeve Parlamentare], Fondacioni për Parlamentarizëm dhe Demokraci të Parlamentit Helen, Athinë 2010.

Busek, Er. (b.), 10 vjet Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore nga Dejtoni në Bruksel, Springer, Vjenë, Nju Jork 2006.

Chryssavgis, John, Në Tokë ashtu si dhe në Parajsë: Vizioni ekologjik dhe nismat e patriarkut ekumenik, Bartolomeu, Fordham University Press, Bronks NJ 2012.

Çota, Lulzim, "Gozhda e fundit mbi Traktatin e Varshavës", Zëri i Popullit, 27 mars 1991.

Cupek Hamill, Mirjana, Konferencija o miru u Jugoslaviji i raspad Jugoslavije [Konferenca e paqes në Jugosllavi dhe rënia e Jugosllavisë], Zagreb 2008, LEYKAM international, kontribute 143-146.

Dafinova, Elizabet, Коледните подаръци на властта [Dhurata për Krishtlindje nga fuqitë ekzistuese], Монитор [Monitorimi], 19 dhjetor 2005.

Danilović, Jovica, "Sarajlije posekle parkove" [Pemët e parqeve priten nga banorët e Sarajevës], Politika, 17
dhjetor 1992.

"Des réfugiés serbes en Roumanie: «Nous sommes les parias de l'Europe»" [Refugjatët serbë në Rumani: "Ne jemi shtresa e ulët e Evropës"],Gazeta "Le Monde", 30 prill 1999, nr. 16877, fq. 3.

Dimitriou, Sotiris, I bekuar qoftë emri Yt, përkthyer nga Leo Marshall, Universiti i Birminghamit, Birmingham 2000.

Donev, D., Onceva, S., Gligorov, l., "Kriza e refugjatëve në Maqedoni gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999", Croat Med J, prill 2002, 43(2).

Ergin, Sedat, "Askerden 12 mesaj" [12 mesazhe nga ushtria], Hürriyet, 4 shtator 1999 në R. Kasaba (b.), Historia e Turqisë nga Kembrixhi, Vëllimi 4: Turqia në botën moderne, Cambridge University Press, 2008.

Estier, Sabine, "À Sarajevo, le CICR se croirait revenu au temps de Solferino" [Në Sarajevë, kthimi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në kohën e Solferinos], Gazeta "Le Nouveau Quotidien", Gjenevë, maj 1992.

Felc, Vlasta, "Krivec liberalni ateizem" [Fajtor është Ateizmi liberal], Delo, 16 gusht 1999.

Gjorgjević, Žaklina, "Пратениците дадоа виза за легализација на тетовскиот универзитет," [Deputetët i japin dritën jeshile legalizimit të Universitetit të Tetovës] Utrinski vesnik, 16 tetor 2006, nr. 1222.

Grujić, Jelena, "Srbi sa Kosova. Igre s građanima drugog reda" [Serbët e Kosovës, Të bërit lojëra me pakicat kombëtare], Vreme nr. 446, 24 korrik 1999.

Hrženjak, Juraj (ed.), Rušenje antifašističkih spomenika u Hrvatskoj 1990-2000 [Shkatërrimi i monumenteve kundër fashizmit në Kroaci 1990-2000], SABA RH, Zagreb 2002.

Îndrumări metodologice și didactice pentru predarea religiei în școală, cu aprobarea și binecuvântarea Prea Fericitului Părinte Teoctist, Patriarhul Bisericii Orto- doxe Române [Këshilla metodologjike dhe për mësimdhënien e fesë në shkolla, me miratimin dhe bekimin e Patriarkut Teocid, Patriarku i Kishës Ortodokse Rumune], Bukuresht 1990.

Iseni, Mair, Menaj, Petrit dhe Osmani, Rufi, Избор текстови за конфликтот во 2001 година [Tekste të zgjedhura për konfliktet e vitit 2001], Shoqëria "SOROS", Shkup 2008.

Janković, Dobrivoje, "Fudbal i Tuđmanovština" [Futbolli dhe Tuxhmanizmi], Politika SPORT për të martë, 260, 15 maj 1990.

Junuzović, Azra, Sarajevske ruže – ka politici sjećanja [Trëndafilat e Sarajevës – Drejt politikës së kujtimit], Armis Print, Sarajevë 2006.

Karović Babić, Merisa, Vrasje masive e qytetarëve në Sarajevë gjatë Rrethimit, 1992-1995, Instituti kërkimor për krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare i Universitetit të Sarajevës, Sarajevë 2014.

Kinzer, Stephen, "Tërmetet ndihmojnë në rregullimin e marrëdhënieve greko-turke", Gazeta "New York Times", 13 shtator 1999. Kissinger, Henry A., "Plagosja e historisë", Newsweek, prill 1999.

Kızılyürek, Niyazi, Κεμαλισμός [Kemalizmi], botimet Mesogeios, Athinë 2006.

Kofos, Ev. dhe Vlasidis, Vl. (b.), Athinë-Shkup: Një simbiozë e lëkundur, ELIAMEP, Athinë 2005.

Liviu, Burlec, Liviu, Lazăr, and Teodorescu, Bogdan, Istoria românilor. Manual pentru clasa a IV-a [Historia e rumunëve. Libri i klasës së katërt],

Editura All Educaţional, Bukuresht 1997.
Lučindan [St. Luke's Day], Kisha Ortodokse Malazeze, numri 37, viti XIII, Cetinje 2010.
Lungu Dan, Povestirile vieţii. Teorie şi documente [Histori jete.
Teori dhe dokumente], Editura Universităţii "Al. I. Cuza", Iashi 2003.
Márton, Laszlo and Novák Csaba Zoltán, A Szabadság
Terhe, Pro-Print Könyvkiadó, Csíkszereda 2012. Mavratsas, Kesar, Όψεις του ελληνικού εθνικισμού στην
Κύπρο [Aspekte të nacionalizmit grek në Qipro], Katarti, Athinë 1998.
Mazower, Mark, Ballkani, Weidenfeld & Nicolson, Londër 2000.
Mettan, Guy,"Petit précis de désinformation", Le Nouvelliste, Suisse, 24 prill 1999.
Mihail, Doros, "Qipro: Kryengritje turko-qipriote (T/Q) hoqi barrikadat", Xekinima (Organizata Socialiste Ndërkombëtare), 20 maj 2003.
Milošević, B., "Hrvatski gardisti ne poštuju ni svoje minister" [Ushtarët e gardës kroate nuk respektojnë as ministrat e tyre], Politika, 7 dhjetor 1991.
Müftüler-Bac, Meltem, "Gjendja e vështirë e grave turke",
Forumi i studimeve ndërkombëtare të grave, vëll. 22, nr. 3, 1999.
Musić, Šemsudin (b.), Bošnjačko pitanje [Çështja e Bosnjës], Administrata për udhëzimin moral të stafit të Ushtrisë së Republikës së Bosnjë-Hercegovinës (Biblioteka ushtarake, vëllimi 14), Sarajevë 1995.
Nettelfield, Lara J. dhe Wagner, Sarah E., Srebrenica në pasojat e gjenocidit, Cambridge University Press, Nju Jork 2014.
"O sută de oameni, ieri, la mormântul lui Ceauşescu" [Njëqind njerëz dje te varri i Çausheskut], Curierul Naţional, 27 janar 2003.
Gazeta Zyrtare e RS (Republika e Serbisë), nr. 17/2004.
Gazeta Zyrtare e popullit serb në Bosnje-Hercegocinë, viti I, nr. 1, 15 janar 1992.
Gazeta Zyrtare e RSS (Republika Socialiste Serbe), nr. 54/89.
Oran, Baskın (ed.), Türk Dış Politikası. Kurtuluş Savaşından Bugüne Olgular, Belgeler, Yorumlar [Politika e jashtme turke. Faktet, dokumentet, komentet nga Lufta e Pavarësisë deri më sot], Iletishim, Stamboll 2002.
Oslobođenje, god. XLIX, br. 15694, Sarajevë, 28.02.1992.
Panagiotopoulos, Vasilis (b.), Ιστορία του Νέου Ελληνισμού
1770-2000 [Historia e Helenizmit Modern], vëll. 10, Ellinika Grammata, Athina 2003.
Perko, Milan and Debevc, Matjaž, "Kabelska omrežja v Sloveniji: organiziranost, razvitost in nivo storitev" [Kabllorët në Slloveni: organizimi, zhvillimi dhe niveli i shërbimeve], në Mitja Štular, Anton Umek e të tjerë. (b.), Dostop do telekomunikacijskih storitev: zbornik refereatov, Elktrotehniška zveza Slovenije [Aksesi në shërbimet e telekomunikacionit: Mbledhja e dokumenteve], Lubjanë 2001.
Petroska-Beska, Violeta dhe Najcevska, Mirjana, Raport i posaçëm, Maqedoni. Të kuptuarit e historisë, parandalimi i konflikteve të ardhshme, USIP, shkurt 2004.
Pobjeda, 25 mars 1999.
Puwak, Hildegard, Dimensiune a sărăciei în România [Dimensioni i varfërisë në Rumani], botuar në Revista Calitateavieţii ["Gazeta "Cilësia e jetesës"], nr. 3/1992.
Radisavljević-Ćiparizović, Dragana, "Religioznost građana Srbije i njihov odnos prema EU - sociološki ugao" [Fetaria e qytetarëve serbë dhe marrëdhënia e tyre me BE-në nga pikëpamja sociologjike], Religioznost građana Srbije i njihov odnos prema procesu evropskih integracija [Fetaria e qytetarëve serbë dhe qëndrimi i tyre ndaj procesit të integrimit në BE], Hrišćanski kulturni centar, Konrad-Adenauer- Stiftung, Beograd 2011.
Repe, Božo, Milan Kučan, prvi predsednik [Milan Kučan, Presidenti i parë], Modrijan, Lubjanë 2015. Fotografi: Zoran Vogrinčič.
"România liberă", yr. XLVIII, seria e re, nr. 74, 20 mars 1990; nr. 76, 22 mars 1990.
Sabchev, Konstantin, Мавзолеят, който разделяше хората [Mauzoleu që ndau njerëzit], Стандарт [Standart], 19 gusht 2003.
Saucă, Prifti dr. Ioan, Abecedarul micuţului creştin [ABC-ja e të krishterit të vogël], Editura Institutului Biblic şi de Misiune al Bisericii Orodoxe Române, Bukuresht 1992.
Scurtu, Ioan, Curculescu, Marian, Dincă, Constantin, dhe Soare, Aurel Constantin, Istoria românilor, din cele mai vechi timpuri până astăzi. Manual pentru clasa a XII-a [Historia e rumunëve që nga lashtësia deri më sot. Libri i klasës së dymbëdhjetë], Editura Petrion, Bukuresht 1999.
Skupština Republike Bosne i Hercegovine, Zapisnici zajedničkih sjednica Skupštine Republike Bosne i Her- cegovine 1990-1996 [Asambleja parlamentare e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës. Pak minuta para fillimit të seancës së përbashkët të Asamblesë parlamentare të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës 1990-1996], Sarajevë 1996.
Spassov, Orlin, Информационно-технологичните млади [Profesionist të rinj të Teknologjisë së Informacionit], në Ditchev, Ivaylo – Spassov, Orlin (b.), Новите млади и новите медии [New Youth

dhe New Media], Fondacioni "SOROS", Sofje, 2009.

Pyetësor mbijetese – Rrethimi i Sarajevës 1992-1996, FAMA, Sarajevë 2000.

Tafro, Aziz, Ruski i Grčki plaćenici u ratu u Bosni i Hercegovini [Mercenarët rusë dhe grekë në luftën e Bosnjë-Hercegovinës], 2014.

Tolić, Dubravka Oraić (ed.), Hrvatsko ratno pismo [Shkrimet kroate të luftës], Zagreb 1992.

E ardhmja e Evropës Lindore (CNF). Vlerësimi i shërbimeve informative kombëtare, Drejtor i Shërbimeve Informative Qendrore, NIE 12-90, prill 1990, kopja 857.

Vassileva, Maria, "Një bisedë me Nedko Solakov", në Vasileva, Maria (b.), Arti për ndryshim 1985-2015, Shtëpia Botuese Ushtarake, Sofje, 2015.

Vassiliou, George, Nga zyra e Presidentit. Një rrugëtim drejt pajtimit në një Qipro të ndarë, I. B. Tauris, Londër dhe Nju Jork 2010.

Viorel, Gheorghe, "Dimensiuni subiective ale fenomenu- lui sărăciei în România" [Dimensionet subjektive të dukurisë së varfërisë në Rumani], Revista Calitateavieţii [Gazeta "Cilësia e jetesës"], nr. 3/1992.

Vojičić, Branko, dhe Biserko, Sonja, Dubrovnik: "Rat za mir", [Dubrovnik:"Lufta për paqe"], Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Beograd 2006.

Wertheime-Baletić, Alice, Stanovništvo Vukovara i vukovarskog kraja [Popullsia e Vukovarit dhe rajoni i Vukovarit], Globus, Zagreb 1993

Redaktore e serisë

KRISTINA KOULOURI, profesore e Historisë Bashkëkohore dhe Moderne, Dekane e Fakultetit të Shkencave Politike, në Universitetin e Shkencave Politike dhe Sociale të Panteonit, në Athinë.

Kryetare e Komitetit për Edukimin e Historisë në CDRSEE (Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore) që prej vitit 1999, si dhe Drejtoreshë e Qendrës Kërkimore të Historisë Moderne (KENI) në Universitetin e Panteonit, në Athinë. Gjithashtu, ajo është kërkuese shkencore në UMR-IRICE: Njësia e Përbashkët Kërkimore (Identitetet, Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Qytetërimet në Evropë), Paris I & CNRS (Qendra Kombëtare e Kërkimit Shkencor), Paris. Ajo ka studiuar në Universitetin e Athinës, në Shkollën e Studimeve të Larta për Shkencat Sociale, si dhe në Universitetin Paris I - Panteon - Sorbonë ku mori edhe doktoraturën. Në vitin 1994 fitoi çmimin "Nicolas Svoronos" për kërkimet historike dhe veprat e botuara, ndërsa në vitin 2012 fitoi çmimin "Delphi" të Akademisë Ndërkombëtare Olimpike. Ka qenë anëtare e grupit për projektin e Këshillit të Evropës për "Të mësuarit dhe mësimdhënia e Historisë së Evropës në shekullin e 20-të" (1996-2000). Ka qenë anëtare e komisioneve shkencore për autorizimin e teksteve të historisë në shkollat e mesme greke dhe koordinatore e projekteve për historinë e teksteve shkollore dhe për historinë e Komitetit Olimpik Helenik. Gjithashtu, ajo është autore e disa librave për kujtesën dhe identitetin kombëtar, si dhe për historinë e sporteve dhe të Lojërave Olimpike.

Redaktorët e Librit të Punës

NEVEN BUDAK, profesor i Historisë Mesjetare kroate në Universitetin e Zagrebit, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Sociale. Ai ka dhënë lëndën "Historia Mesjetare Urbane dhe Juglindore e Evropës" në Universitetin e Evropës Qendrore në Budapest. Ai është anëtar I fondacionit "Alexander-von- Humboldt" dhe ka marrë çmime të ndryshme në Gjermani dhe Austri. Është anëtar i bordeve redaktuese të revistave historike në Kroaci, Gjermani, Hungari, Slloveni dhe Rusi, si dhe anëtar nderi i Komisionit Ndërkombëtar për Historinë e Qyteteve. Ka qenë i ftuar për të dhënë leksione në universitete të ndryshme në Britaninë e Madhe, Irlandë, Kanada, Australi, Japoni, Gjermani, Hungari, Poloni, Slloveni dhe Bullgari. Ka qenë dekan i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Sociale, në Universitetin e Zagrebit, President i Komitetit Kombëtar Kroat të Shkencave Historike, Këshilltar i Veçantë i Shkencave i Kryeministrit të Kroacisë dhe autori kryesor i Strategjisë Kroate për Arsimin, Kërkimin dhe Teknologjinë.

ALEKS KALIONSKI, profesor i asociuar i Historisë Moderne në Universitetin e Sofjes "Shën Kliment Ohridski", Fakulteti i Historisë, në Bullgari. Ai jep mësim në Bachelor dhe Master për Historinë Ballkanike dhe Osmane; për historinë para-moderne dhe historinë e hershme të Rusisë, të Evropës Lindore dhe të Euroazisë; për pakicat; për migrimin dhe për shoqëritë nomade. Në vitin 2002 mori doktoraturën në fushën e historisë në Universitetin e Sofjes. Gjithashtu, ka mbajtur leksione në universitetin e Uludag në Bursë, Turqi; në Qendrën për Studime Islame dhe të Lindjes së Mesme në Bergen, Norvegji; si dhe në CNRS-EHESS (Qendra Kombëtare e Kërkimit Shkencor - Shkolla e Studimeve të Larta për Shkencat Sociale) në Paris, Francë. Në vitin 2013, fitoi çmimin "Gipson" për disertacionin e tij të shquar për periudhën osmane në Ballkan, në Qendrën Kërkimore Amerikane në Sofje. Ai ka rreth 40 botime, midis tyre tre libra: për komunitetin Yuruk gjatë sundimit osman në Ballkan;për turqit dhe myslimanët në Bullgari (1944-1989), në Bullgarisht; si dhe librin "Komunitetet, Identitetet dhe Migrimet në Evropën Juglindore": Artikuj të mbledhur (Sofje,Anamnesis,2014), në Anglisht.

BOZO REPE, profesor i Historisë Bashkëkohore në Fakultetin e Arteve në Lubjanë.

Gjatë viteve 1990 dhe 2000 ai ishte Shefi i Departamentit të Historisë. Që prej vitit 2009, ka qenë administrues projekti i grupit "Historia Sllovene". Fusha e tij kërkimore përfshin historinë bashkëkohore të Sllovenisë, të vendeve jugore Sllave dhe të Evropës Qendrore. Gjithashtu, ai merret me çështje që kanë të bëjnë me mësimdhënien e historisë nëpër shkolla të ndryshme. Ka qenë profesor i ftuar në universitetin Vytatus Magnus në Kaunas, si dhe ka mbajtur leksione në universitete dhe institute të tjera, si p.sh në Universitetin e Vjenës, Bratislavës dhe Grazit, në Universitetin Charles në Pragë dhe në Universitetin Norvegjez të Shkencës dhe Teknologjisë në Tronheim. Ka zhvilluar kërkime në Institutin Austriak të Studimeve të Lindjes dhe Evropës Juglindore (Osterreichisches Ost-und Sudosteuropa-Institut) në Vjenë dhe në Institutin e historisë të kohëve të tanishme(Institut d'histoire du temps present) në Paris.

Këshilltarët redaktorialë

NIYAZI KIZILYÜREK, profesor në Universitetin e Qipros, Dekan I Fakultetit të Shkencave Humane.

Ai ka lindur në Potami, një fshat i banuar nga qipriotët turq dhe grekë. Gjatë konflikteve ndërkomunale në vitet 1963-1964, ai dhe familja e tij u bënë refugjatë duke u zhvendosur në geton e Qipriotëve turq në Louroujinë. Ai ka studiuar Shkenca Shoqërore dhe Politike në Universitetin e Bremenit në Gjermani dhe ka zhvilluar dizertacionin për problemin e Qipros dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Që

prej vitit 1995, ai ka punuar në Departamentin e Studimeve Turke dhe Lindore të Universitetit të Qipros. Në vitin 1997 ai u nderua me çmimin "Ipekçi" për Paqe dhe Miqësi, për kontributin e tij në pajtimin e dy komuniteteve në Qipro, si dhe midis Greqisë dhe Turqisë. Në vitin 2006 u nderua nga qeveria franceze me "Urdhrin e Palmave Akademike" për kontributin e tij në shkencë dhe për punën e tij në vendosjen e paqes në Qipro. Ai ka shkruar disa libra në greqisht dhe turqisht, si dhe artikuj të shumtë akademikë në revista shkencore të ndryshme. Kërkimet e tij janë të përqendruara në historinë e Turqisë moderne, në problemin e Qipros dhe nacionalizmin, si dhe në konfliktet nacionaliste.

GRUPI I PROJEKTIT

DUBRAVKA STOJANOVIÇ, profesore e Historisë Bashkëkohore të Përgjithshme, në Fakultetin e Filozofisë, Universiteti i Beogradit.

Ajo është këshilltare e Kombeve të Bashkuara për çështjet e historisë dhe kujtesës, si dhe për keqpërdorimet e historisë në arsim. Gjithashtu, është anëtare e Komisionit Drejtues të Projektit COST "Në Kërkim të Kujtesës Ndërkulturore në Evropë". Në vitin 2015, ajo u nderua nga qeveria franceze me titullin "Kalorëse e Urdhrit Kombëtar të Meritës", ndërsa në vitin 2004 mori Çmimin e Qytetit të Beogradit për Shkencat Shoqërore për librin e saj "Serbia dhe demokracia 1903-1914". Në vitin 2011 u nderua me "Çmimin e Paqes" nga Qendra e Beogradit për Paqe dhe Demokraci, për angazhimin e saj në procesin e pajtimit përmes mësimdhënies së historisë në Evropën Juglindore, dhe në vitin 2012 mori "Çmimin e Lirisë" për gratë e angazhuara në lëvizjet aktiviste për të drejtat e njeriut. Së bashku me Prof. Milan Ristoviç, ajo redaktoi librin e materialeve shtesë të mësimdhënies për shkollat e mesme "Fëmijëria në të kaluarën", i cili tani përdoret në 11 vende të Evropës Juglindore.

Ka qenë redaktore e botimit serb të katër librave të parë të punës së "Projektit të Historisë së Përbashkët" (JHP). Fushat e saj të interesit janë proceset e modernizimit dhe evropianizimit në Evropën Juglindore, proceset e demokratizimit në Serbi, historia e urbanizimit, historia e Beogradit, marrëdhënia midis historisë dhe kujtesës, dhe paraqitja e historisë në tekstet shkollore të historisë.

Këshilltarët Pedagogjik

SNJEZHANA KOREN, shefe e Katedrës së Mësimdhënies së Historisë në Departamentin e Historisë të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Sociale, Universiteti i Zagreb-it.

Ajo ka mbrojtur doktoraturën në fushën e Historisë Moderne dhe Bashkëkohore në të njëjtin universitet. Më parë, ka punuar për disa vjet si mësuese historie dhe ka marrë pjesë në trajnimet e mësuesve të tjerë. Krahas mësimdhënies në universitet, ajo është e angazhuar në provimet e shtetit për mësuesit e historisë në Kroaci. Interesat e saj kërkimore dhe fushat në të cilat ka botuar gjerësisht përfshijnë politikën e historisë dhe të kujtesës në Jugosllavinë socialiste dhe në shtetet e saj anëtare, historinë e historiografisë dhe mësimdhënien e historisë, analizat krahasuese të teksteve mësimore të historisë dhe programet mësimore, trajnimin themelor të mësuesve në Evropë, edukimin ndërkulturor etj. Që prej vitit 1999, ajo është përfshirë në disa projekte ndërkombëtare dhe kroate që kanë të bëjnë me temat e lartpërmendura. Ajo ka botuar dy libra (Politika e historisë në Jugosllavi 1945-1960: Partia Komuniste e Jugosllavisë, mësimdhënia e historisë dhe historiografia; Çfarë është mësimdhënia e historisë? Edukimi në histori, ide për nxënien dhe mësimdhënien, dhe rezultatet e nxënies), disa artikuj dhe kapituj libri, si dhe disa tekste mësimore që merren me historinë e shekullit të XX-të.

VASILIKI SAKA, historiane, trajnuese e mësuesve, këshilluese shkolle, Athinë.

Ajo ka studiuar Histori dhe Arkeologji në Univer-sitetin e Athinës. Ka diplomë Master në Mësimdhënien e Historisë (Universiteti i Athinës, Departamenti i Filozofisë, Pedagogjisë dhe Psikologjisë) dhe doktoraturë në Histori dhe Arsimimin e të Rriturve (Universiteti i Peloponezit, Departamenti i Politikës Sociale dhe Arsimore). Ka punuar si mësuese e historisë dhe e gjuhës në arsimin e mesëm që prej vitit 1985, tanimë punon si këshilltare shkolle dhe trajnuese mësuesish. Ajo shkruan dhe vlerëson tekstet mësimore të historisë dhe materialet arsimore. Gjithashtu, ajo ka përgatitur materiale shkencore dhe ka kryer kërkime arsimore për Mësimdhënien e Historisë, Historinë Publike dhe Orale, Edukimin për Holokaustin, Qëndrimet dhe besimet e mësuesve të historisë,Njohuria pamore etj.; Anëtare e Bordit të Shoqatës EUROCLIO që prej vitit 2006 dhe Presidente e Bordit ne vitet 2010-2012.

Lexuesit e specializuar

FLORIAN BIEBER, profesor i Studimeve të Evropës Juglindore dhe Drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit, në Austri.

ANDREAS DEMETRIOU, Profesor i psikologjisë dhe Presidenti i Fondacionit të Kërkimeve Shkencore në Universitetin e Nikozisë.

MARIA TODOROVA, Profesoreshë e Historisë, Universiteti i Illinois, SHBA

Anëtarët e Komisionit të Burimeve
Dr. Kornelija Ajlec, Lubjanë (Profesore asistente e Historisë Bashkëkohore Botërore në Fakultetin e Arteve, Departamenti i Historisë në Lubjanë).
Prof. Hamit Bozarslan (Profesor në Shkollën e Studimeve të Larta në Shkencat Sociale - EHESS në Paris).
Prof. Frashër Demaj, Prishtinë (Këshilltar shkencor në Institutin e Historisë në Prishtinë; profesor në Kolegjin FAMA)
Prof. Valentina Duka, Tiranë (Profesore e Historisë së Popullit Shqiptar në Universitetin e Tiranës)
Dr. Galina Goncharova, Sofje (Profesore asistent në Departamentin e Studimeve Kulturore, Universiteti i Sofjes).
Dr. Vangelis Karamanolakis, Athinë (Profesor asistent për Teorinë dhe Historinë e Historiografisë në Universitetin e Athinës).
Dr. Vera Katz, Sarajevë (Hulumtuese në Institutin e Historisë në Universitetin e Sarajevës).
Dr. Hrvoje Klasiç, Zagreb (Profesor Asistent në Departamentin e Historisë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Sociale, Universiteti i Zagrebit).
Dr. Catalina Mihalaçe, Iashi (Hulumtuese në A.D Instituti i Historisë Ksenopol në Akademinë Rumune).
Dr. Dragutin Papoviç, Podgoricë (Lektor në Programin e Studimeve Historike në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Malit të Zi në Nikshiq).
Dr. Pavlos Pavlou, Nikozi (Lektor i Historisë dhe Historisë së Arsimimit në Universitetin Evropian të Qipros).
Dr. Radmila Radiç, Beograd (Anëtare kryesore e kërkimeve në Institutin e Historisë së Vonë së Serbisë në Beograd).
Dr. Irena Stefoska, Shkup (Profesore në Departamentin e Historisë në Universitetin Shën Kirili dhe Metodij në Shkup).

Kontribuesit
Vuk Bacanoviç, Sarajevë
Dr. Philip Carabott, Athinë
Prof. Todorov Chepreganov, Shkup
Aioanei Dumitru-Alexandru, Darabani
Prof. Ivan Elenkov, Sofje
Admir Ibriciç, Sarajevë
Hariuc M. Ionut, Vaslui
George Limantzakis, Athinë
Dr. Artan Puto, Tiranë
Sanja Radoviç, Beograd
Dr. Mehmet Ali Tugtan, Stamboll
Fatmiroshe Xhemalaj, Tiranë

Hartuesit e Hartave
Dr. Rok Ciglič, Dr. Drago Kladnik, Dr. Mateja Breg Valjavec,
Dr. Matjaž Geršič, Jure Tičar, Dr. Matija Zorn,
Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë Sllovene të Shkencave dhe Arteve,
Anton Melik Instituti Gjeografik,
Lubjanë

Përkthyesit
BESTRANS EOOD, Sofje
Ergys Bezhani, Tiranë
Philip Carabott, Athinë
Ognen Cemerski, Shkup
Evagrina Dirtu, Iasi
Zeljka Hasanagiç, Sarajevë
Sabina Kosednar, Lubjanë
Myisly Mperin, Athinë
Katerina Popova, Sofje
Eleni Pseftelis, Selanik
Rea Wallden, Athinë
Maja Zavasnik, Lubjanë

Këshillues ligjorë
Dr. Evangelia Mitrou, Athinë
Dr. Evangelia Vagena, Athinë

Falënderojmë:
Të gjitha Ministritë e Arsimit që bashkëpunuan dhe mbështetën këtë projekt.
Qendrën për Arsim të Kosovës.
Qendrën për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjes së konflikteve
Shoqatën Kroate të Mësuesve të Historisë (HUNP)
Shoqatën e Mësuesve të Historisë së Malit të Zi (HIPMONT)
Shoqatën për Përfshirje Sociale - Euroclio
Shoqatën e Mësuesve të Historisë së Shqipërisë (ALBNA)
Shoqatën e të Drejtave të Qytetarëve
Jean-François Berger
Dr. Ioannis Grigoriadis, Stamboll
Dr. Chryssafis Iordanoglou, Athinë
Efi Pavlogeorgatou, Athinë
Kalina Sotirova, Sofje Dzetved Tuzlic, Sarajevë
Dr. Vassiliki Tzachrista, Athinë
Dr. Gurkan Yellice, Izmir